




REPUBLIKA E SHQIPËRISË KONTROLLI I LARTË I SHTETIT

RAPORT

PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2012



L I G J
Nr. 10 487, datë 5.12.2011
PËR BUXHETIN E VITIT 2012
Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1
dhe 158 të Kushtetutës,
si dhe të nenit 30 të ligjit nr. 9936,
datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor
në Republikën e Shqipërisë",
me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I:

Buxheti i Shtetit për vitin 2012 është:
Të ardhurat
Shpenzimet
Deficiti

milionë lekë
milionë lekë
milionë lekë

Neni 2

Tiranë, 2013

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

RAPORT

**PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT
TË VITIT 2012**

Tiranë, Shtator 2013

PËRMBAJTJA:

		Faqe
Përmbledhje e Raportit		3
PJESA E PARË	PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHETIT TË VITIT 2012	
Kapitulli I	<i>Treguesit e planit të buxhetit të shtetit të vitit 2012</i>	41
Kapitulli II	<i>Treguesit kryesorë fiskalë të buxhetit të konsoliduar</i>	42
Kapitulli III	<i>Realizimi i të ardhurave të buxhetit të shtetit</i>	44
III.1	Të ardhurat nga ndihmat	46
III.2	Të ardhurat tatimore	46
III.2.a	Realizimi të ardhurave tatimore nga tatimet	47
III.2.b	Realizimi të ardhurave tatimore nga doganat	58
III.3	Të ardhurat jotatimore	68
III.3.a	Rregullshmëria e përcaktimit dhe e kalimit të fitimit të BSH	69
III.3.b	Të ardhurat nga institucionet buxhetore	73
Kapitulli IV	<i>Administrimi i shpenzimeve të buxhetit të shtetit</i>	76
IV.1	Shpenzimet korrente	79
IV.2	Shpenzimet për fondin rezervë të KM dhe të kontigjencës	86
IV.3	Shpenzimet për investime kapitale	94
IV.3.a	Shpenzimet për investime të brendshme	94
IV.3.b	Shpenzimet me burime të huaja financimi	96
Kapitulli V	<i>Deficiti i përgjithshëm buxhetor dhe financimi i tij</i>	99
V.1	Mbi saktësinë e mbajtjes së llogarisë “Depozitë e Qeverisë”	101
V.2	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për arkëtimet e pagesat e kryera	102
V.3	Rakordimi i bankave të nivelit të dytë me BSH dhe degët e thesarit	104
VI.	Borxhi i brendshëm dhe i jashtëm shtetëror	105
VI.1	Borxhi i brendshëm dhe shërbimi i tij	107
VI.1.a	Përcaktimi i nevojave për huamarrje, llogaritja e nevojave për sasinë e bonove të thesarit dhe obligacionet që emetohen	108
VI.1.b	Mbi rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit	113
VI.1.c	Mbi rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të obligacioneve	114
VI.1.d	Mbi ecurinë e tregut të bonove të thesarit dhe obligacioneve	116
VI.1.e	Mbi borxhin e garantuar në tregun e brendshëm	122
VI.2	Borxhi i jashtëm shtetëror dhe shërbimi i tij	123
VI.2.a	Shpenzimet për shërbimin e borxhit të jashtëm	124
VI.2.b	Mbi rregullshmërinë e evidentimit të marrveshjeve të nënhuave	126
VI.2.c	Mbi zbatimin e planit të buxhetit të shtetit	133
Kapitulli VII	<i>Për përgatitjen dhe saktësinë e raportit vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit.</i>	147
Kapitulli VIII	<i>Administrimi i buxhetit të pushtetit vendor</i>	150
VIII.1	Në fushën e të ardhurave	151
VIII.2	Në fushën e të shpenzimeve	154
Kapitulli IX	<i>Administrimi i buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore</i>	156
IX.1	Buxheti i sigurimeve shoqërore	158
IX.2	Buxheti i sigurimeve shëndetësore	183
IX.3	Rekomandimet e bëra nga KLSH në ISSH dhe ISKSH si dhe zbatimi i tyre	196
PJESA E DYTË	MENDIME PËR RAPORTIN E KM PËR SHPENZIMET E VITIT TË KALUAR FINANCIAR, PARA SE TË MIRATOHET NGA KUVENDI	208
PJESA E TRETË	MBI MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM	213
Kapitulli I	<i>Mbi vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar.</i>	216
Kapitulli II	<i>Mbikëqyrja e veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm</i>	223
Kapitulli III	<i>Marrdhëniet e bashkpunimit ndërmjet KLSH me Ministrinë e Financave (NJQH/AB dhe DIFP)</i>	235
Kapitulli IV	<i>Zbatimi i masave të rekomanduara nga KLSH për NJQH/AB</i>	236

PJESA E KATËRT	MBI AUDITIMET E PERFORMANCËS	242
ANEKSE		
Aneksi nr.1	Lista e subjekteve të audituara për zbatimin e buxhetit të vitit 2012	256
Aneksi nr.2	Të dhëna përmbledhëse sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar dëmet ekonomike në të ardhurat, shpenzimet dhe detyrimet debitore.	259
Aneksi nr.3	Fjalori i shkurtimeve	261

PËRMBLEDHJE E RAPORTIT

1. HYRJE

Raporti “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2012” është përgatitur në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 164, pika 1, germa a-b; ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 1/6/2000, neni 18, pika 1, gërmat a-b dhe të ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, nenet 62 e 63; si dhe të ligjit nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për Buxhetin e vitit 2012”.

Raporti jep një përjasje të kujdesshme mbi treguesit kryesorë makroekonomikë për vitin 2012 dhe përpjekjet e qeverisë për ruajtjen e stabilitetit ekonomik në këtë kohë të vështirë të krizës globale. Kemi patur në fokus dhënien e një opinioni të drejtë në lidhje me mbledhjen e të ardhurave kryesore të buxhetit të shtetit, si dhe një vlerësim të kujdesshëm mbi nivelin e shpenzimeve të kryera, duke i krahasuar ato edhe me nivelin e planifikimit të tyre, si dhe të ardhurat dhe shpenzimet faktike të vitit të kaluar. Në raport shprehemi për zbatimin e ligjshmërisë dhe efijencën e zbatimit të buxhetit faktik të pushtetit vendor dhe fondeve të Sigurimeve Shoqërore dhe Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor.

Përfundimet e këtij raporti janë përmbledhje e materialeve të përgatitura nga KLSH gjatë auditimit të 118 subjekteve (aneksi nr. 1 bashkëlidhur këtij raporti). Këto materiale përfshijnë auditimet e realizuara gjatë 3/mujorit të katërt të vitit 2012, si dhe auditimet e realizuara deri në muajin shtator të vitit 2013. Përparësi në planifikimin dhe kryerjen e auditimeve kanë patur institucionet qendrore apo ente publike, të cilat gjatë vitit 2012 kanë përdorur dhe administruar fonde buxhetore të konsiderueshme, sipas programeve të miratuara me ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për Buxhetin e vitit 2012”, ndryshuar me ligjin nr. 99/2012, datë 18/10/2012 dhe ligjin nr. 126/2012, datë 20/12/2012.

Ndër subjektet kryesore të audituara për qëllime të këtij raporti janë: *Ministria e Financave*, si institucioni përgjegjës i ngarkuar drejtpërdrejtë me hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit, raporti i auditimit i së cilës është fokusuar mbi rregullsinë dhe ligjshmërinë e transaksioneve, si dhe saktësinë e raportimeve në lidhje me zbatimin e buxhetit; të borxhit publik dhe menaxhimit të tij; përdorimit të fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe fondit të kontigjencës; funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar e të kontrollit, si dhe organizimin e funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik; *Banka e Shqipërisë*, e cila në cilësinë e agjentit fiskal të qeverisë, realizon zhvillimin e tregut të bonove të thesarit e të obligacioneve, mban llogarinë e unifikuar të thesarit, nxit ruajtjen e likuiditetit, aftësinë paguese dhe funksionimin normal të sistemit bankar, të bazuar në parimet e tregut, *Ministritë dhe organet e pushtetit vendor, si prefektura, bashki, këshilla qarqesh dhe komuna*, të cilat luajnë një rol mjaft të rëndësishëm për administrimin dhe përdorimin ligjor të fondeve publike; Institucionet qendrore buxhetore, veçanërisht *Institutin e Sigurimeve Shoqërore* dhe *Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor*, të ngarkuar me administrimin e buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe të atij shëndetësor, si dhe efektivitetin e përdorimit të këtyre fondeve; organet e sistemit fiskal, sidomos ato doganore dhe subjekte të tjera, në nivel qendror dhe lokal, të ngarkuar me programimin, vjeljen dhe arkëtimin e burimeve të të ardhurave buxhetore, si dhe Drejtori të ndryshme të përgjithshme, sipërmarrje, shoqëri anonime dhe projekte që operojnë me fonde buxhetore.

Drejtimet kryesore të veprimtarisë audituese të ushtruar nga KLSH për efekte të këtij raporti kanë qenë;

Së pari, zbatimi i dispozitave ligjore në fushën ekonomike, financiare, fiskale e kontabël, me synim identifikimin e gjendjes reale, të metat apo parregullsitë e mundshme në menaxhimin dhe përdorimin e fondeve publike, kjo me synimin kryesor për të rekomanduar masat e nevojshme që duhen marrë për mënjanimin dhe mospërsëritjen e të metave dhe parregullsive të konstatuara.

Së dyti, realizimi faktik i Buxhetit të vitit 2012 (të ardhurat dhe shpenzimet e përgjithshme buxhetore, deficitin e përgjithshëm buxhetor dhe burimet e financimit të tij) si dhe saktësia e regjistrimit të tyre, duke përfshirë ndryshimet e bëra gjatë këtij viti.

Së treti, respektimi i dispozitave dhe i procedurave ligjore në kryerjen e veprimeve financiare, në fushën e të ardhurave dhe shpenzimeve, duke patur theksin në auditimin e ligjshmërisë në prokurimin e fondeve publike, me burim të brendshëm financimi dhe shpenzimeve kapitale me burim të huaj financimi.

Së katërti, rregullshmëria dhe korrektësia e mbajtjes së dokumentacionit financiar dhe atij kontabël.

Së pesti, respektimi i kufijve vjetorë për rritjen e stokut të borxhit të brendshëm, borxhit të jashtëm të Shtetit dhe garancive të Shtetit në dobi të palëve të treta përfituese, të përcaktuar me ligjin vjetor të buxhetit, duke audituar saktësinë e raportimit të borxhit publik dhe menaxhimit të tij.

Së gjashti, ligjshmëria e përdorimit të fondit rezervë të KM dhe të fondit të kontigjencës.

Së shtati, zbatimi i kërkesave të përcaktuara ligjore mbi paraqitjen e llogarive vjetore për raportimet buxhetore.

Së teti, funksionimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe organizimin e funksionimit të auditimit të brendshëm në sektorin publik, etj.

Së nënti, zbatimi i ligjshmërisë në menaxhimin e fondeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore dhe Institutit të Kujdesit Shëndetësor.

Së dhjeti, kryerja e auditimeve të performancës si një prioritet i veprimtarisë Audituese të institucionit të KLSH e orientuar drejt praktikave më të mira të fushës.

Rezultatet përfundimtare të auditimeve të kryera dhe masat e rekomanduara për përmirësimin e gjendjes për çdo subjekt të audituar, u janë dërguar të gjithë subjekteve të audituara dhe, në disa raste të veçanta edhe institucioneve të tyre drejtuese. Gjykuar në rëndësinë apo peshën që kanë zënë gjetjet në kontekstin e përdorimit të fondeve buxhetore, raportet dhe masat e rekomanduara u janë dërguar edhe institucioneve më të larta drejtuese të shtetit. Me rezultatet e auditimeve dhe masat e rekomanduara është njohur edhe publiku i gjerë, nëpërmjet përdorimit të formave të ndryshme të komunikimit e të informimit, por duke qenë të vëmendshëm gjithmonë në respektimin e të drejtave të subjekteve që ne auditojmë.

Fusha audituese. Çështjet, nënçështjet, konstatimet, gjetjet, problematikat, rekomandimet dhe masat e programuara e të zbatuara për përmirësimin e gjendjes si dhe vlerësimet për menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditimin e brendshëm, të pasqyruara dhe trajtuara në këtë Raport, janë **produkt i shqyrtimit dhe nxjerrjes së përfundimeve nga raportet finale të auditimeve të kryera.** Auditimi për zbatimin e buxhetit të vitit 2012, ka përfshirë fushën e ekonomisë, të industrisë, bujqësisë, shëndetësisë, arsimit, mbrojtjes dhe rendit publik, transportit e telekomunikacionit, mbrojtjes së ambientit, dhënies me qira të objekteve shtetërore, administrimit të pronës dhe një sërë aktiviteteve të tjera ekonomike e sociale. Sa cituar më sipër, objekt auditimi kanë qenë

institucionet qendrore dhe vendore, disa sipërmarrje publike ku shteti zotëron mbi 50% të aksioneve, si dhe një numër subjektësh (institucionesh) të pavarur.

Objektivi i Raportit. Objektivi kryesor është dhënia e një tabloje të qartë dhe reale të zbatimit të Buxhetit të vitit 2012, si dhe dhënia e mendimeve mbi raportin e Këshillit të Ministrave mbi shpenzimet e vitit të kaluar financiar, mbështetur në rezultatet përfundimtare të auditimeve mbi rregullsinë dhe ligjshmërinë e transaksioneve, realizimin e të ardhurave dhe administrimin e shpenzimeve, mbajtjen dhe raportimin e borxhit publik, përdorimin e fondit rezervë të KM dhe kontigjencave, funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik etj, të realizuara për llogari të buxhetit të vitit 2012.

Burimi i të dhënave. Burimi kryesor i të dhënave kanë qenë raportet përfundimtare të auditimeve të ushtruara për llogari të zbatimit të buxhetit të shtetit të vitit 2012, në 118 subjekte, si ministri dhe institucione të tjera qendrore, njësi të pushtetit vendor, shoqëri anonime apo me kapital të përbashkët, sipërmarrje, etj, legjislacioni në fuqi, dokumentacioni dhe materialet e ndryshme të vëna në dispozicion lidhur me zbatimin e buxhetit të vitit analizues nga Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Banka e Shqipërisë, INSTAT, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, përfshirë buletinet periodikë informativë e statistikorë të botuar nga këto institucione për vitin 2012, etj.

Opinionimi i përgjithshëm mbi zbatimin e buxhetit të shtetit 2012


Mbi bazën e rezultateve përfundimtare të auditimeve të kryera, me objekt zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2012, vlerësimi me kujdes të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 506 datë 13.06.2013 “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2012”, **opinionimi i përgjithshëm i Kontrollit të Lartë të Shtetit për zbatimin e Buxhetit të Shtetit për vitin 2012**, para miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë, **është se përgatitja, shqyrtimi dhe miratimi i buxhetit, zbatimi, ndjekja dhe rishikimi i tij, të drejtat dhe kufizimet për huamarrjen, garancitë dhe format e tjera të rrjedhura prej tyre si dhe kontrolli, kontabiliteti, raportimi dhe auditimi i këtij buxheti, janë kryer në respektim të kërkesave të Kushtetutës dhe ligjeve; Ligjit nr. 9936, datë 26/6/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”; ligjit nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, ndryshuar me ligjin nr. 99/2012, datë 18/10/2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 26/9/2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012”; shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7803, datë 30/10/2010; ligjit nr. 126/2012, datë 20/12/2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit” nr. 6, datë 7/12/2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012” të ndryshuar; shpallur me dekretin e Presidentit të Republikës nr. 7915, datë 7/01/2013; dhe ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.**

Në kontekstin e mjedisit të pafavorshëm në të cilin u realizua Buxheti i vitit 2012 si pasojë e ndikimit të elementëve të krizës botërore, KLSH vlerëson pozitivisht punën e bërë nga Qeveria, Ministria e Financave, Ministrinë, Institucionet e tjera qendrore dhe vendore, si dhe entet publike të audituara, për përmbushjen e objektivave dhe realizimin e detyrave të marra përsipër për zbatimin e Buxhetit të vitit 2012, po kështu ndjekjen dhe raportimin sistematik lidhur me zbatimin e masave të programuara në kuadër të “Planit Kombëtar për zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim Asocimit Shqipëri-BE”.

2. TREGUESIT E KONSOLIDUAR FISKALË TË BUXHETIT 2012


Realizimi i treguesve të konsoliduar fiskalë të Buxhetit të Shtetit të vitit 2012 paraqitet si vijon:

Të ardhurat e përgjithshme të Buxhetit të Shtetit janë realizuar në vlerën 330,384 milionë lekë duke përfaqësuar 24.54 % të PBB-së të vitit 2012, nga 25.47% të PBB-së që rezultoi në vitin 2011.




Burimi: Ministria e Financave.

Shpenzimet e përgjithshme buxhetore janë realizuar në vlerën 376,241 milionë lekë, duke përfaqësuar 27.95% të PBB-së të vitit 2012, nga 29% që rezultoi një vit më parë. Në krahasim me vlerën faktike të shpenzimeve të rezultuara në vitin 2011 (376,352 milionë lekë), ato paraqiten me rënie në një vlerë prej 111 milionë lekë. Ndërkohë që shpenzimet për investime kapitale në vitin 2012 janë realizuar në vlerën 61,656 milionë lekë ose në nivelin 4.58% të PBB-së të rezultuar këtë vit, nga 70,679 milionë lekë ose në masën 5.45% të PBB-së që zinin në vitin 2011.



Burimi: Ministria e Financave.

Deficiti i Përgjithshëm i Buxhetit në fund të vitit 2012 rezultoi në vlerën 45,857 milionë lekë nga 49,538 milionë lekë ose në masën 92.6% të planit. Nëse i referohemi deficitit kundrejt PBB-së të vitit 2012, niveli i deficitit arriti në 3.41% të PBB-së, nga 3.53% të rezultuar në vitin 2011, pra është konstatuar një ulje prej 0.12 pikë përqindje. Më poshtë po japim trendin e këtij treguesi në 8 vitet e fundit.



Burimi: Ministria e Financave.


Borxhi publik në total, në fund të vitit 2012 rezultoi në vlerën 828,275 milionë lekë ose në masën 61.53% kundrejt PBB-së të këtij viti nga 772,743 milionë lekë që rezultoi në vitin 2011 dhe që përfaqësonte 59.55 % të PBB-së. Nga ky borxh, *borxhi publik i qeverisjes qendrore* rezultoi 827,987 milionë lekë dhe *borxhi i qeverisjes vendore* 288 milionë lekë.

Stoku i borxhit të brendshëm shtetëror në fund të vitit 2012 rezultoi me rritje kundrejt vitit 2011 në shumën 31,776 milionë lekë, nga 438,582 milionë lekë në vitin 2011, në 470,358 milionë lekë në vitin 2012 ose në masën 7.24% më shumë. Në raport me PBB-në e vitit 2012, ky stok zë 34.94% të PBB-së, nga 33.80% të PBB-së që zinte një vit më parë, me një rritje prej 1.14%.

Stoku i borxhit të jashtëm shtetëror në fund të vitit 2012 arriti në 357,629 milionë lekë ose në masën 26.57% të PBB-së të këtij viti, kundrejt 333,943 milionë lekë rezultuar në fund të vitit 2011, ose në masën 25.73% të PBB-së të këtij viti, me një rritje kundrejt vitit 2011 në shumën 23,686 milionë lekë.

Borxhi i qeverisjes vendore në fund të vitit 2012 rezultoi 288 milionë lekë ose në masën 0.021% të PBB-së, nga 217.8 milionë lekë ose 0.016% të PBB-së që rezultoi në vitin 2011.

Më poshtë japim dinamikën e stokut të borxhit në vite e shprehur në terma kundrejt PBB-së:



Burimi: Ministria e Financave.

3. GJETJET DHE REKOMANDIMET

3.1 Nga auditimi në Ministrinë e Financave

3.1.1 Mbi menaxhimin e borxhit publik.

Duke ndjekur me kujdes zhvillimet ekonomike dhe duke qenë të ndjeshëm ndaj nivelit të borxhit publik dhe risqeve që ai mbart në situatën e brishtë makroekonomike të vendit, KLSH u fokusua në auditimin e ligjshmërisë në menaxhimin e borxhit publik dhe rregullshmërisë ligjore për nivelet e tij për vitin 2012. Theksojmë se me ligjin nr. 114/2012, datë 07/12/2012 dekretuar më datë 17/12/2012, dhe hyrë në fuqi me 3 Janar të vitit 2013, është hequr kufiri ligjor i borxhit prej 60% të PBB-së, duke lënë në këtë mënyrë borxhin publik pa një tavan të përcaktuar dhe duke krijuar premisa për rritje të vazhdueshme të tij në periudhat në vazhdim. Nga auditimi, u konstatuan tejkalime të këtij kufiri duke rezultuar në muajin e fundit të vitit 2012 në nivelin 61% të PBB-së¹. Referuar sa më sipër, duke marrë shkas edhe nga tendenca e vërejtur dhe nga fakti që ndryshimi i kuadrit rregullator të kufizimit të borxhit publik ndaj PBB-së (ligji nr. 114/2012, datë 07.02.2012) legjitimon mungesën e një tavani për borxhin publik dhe riskun e rritjes së tij, por nga ana tjetër duke qenë në unison me Institucionet Financiare Ndërkombëtare që theksojnë se trajtimi i borxhit kërkon një angazhim të besueshëm afatmesëm, si dhe në përputhshmëri të plotë me rekomandimin e lënë në vitin 2012, **kemi rekomanduar që Ministria e Financave:**

- *Të ngrejë një grup pune me ekspertët më të mirë të fushës për përgatitjen dhe paraqitjen e një nisme ligjore për vendosjen në Kushtetutë dhe në Ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të treguesit të borxhit publik ndaj PBB-së, në nivelin 60%, ku të parashikohet që: “Përfundim nga ky rregull të bëjnë rastet e emergjencave, katastrofave natyrore dhe krizave ekonomike”.*

- *Të analizojë mundësinë e vendosjes së një pragu të nivelit të borxhit publik kundrejt PBB-së, pas të cilit (nëse kalohet ky prag) Qeveria duhet të marrë masa për balancimin e buxheteve.*

- *Të ndërmarrë të gjitha veprimet për hartimin e një politike kuadri fiskal, i cili të synojë në uljen e nivelit të borxhit publik në një periudhë të përcaktuar kohore.*

Për sa më sipër, vlerësojmë dakordësinë dhe vullnetin pozitiv të Ministrisë së Financave, të shprehur në shkresën nr. 5167/21, datë 06.09.2013 në të cilën cilësohet: “Në lidhje me rekomandimin që ka të bëjë me vendosjen e një kufiri ligjor për borxhin publik, në parim jemi shprehur dakord, pasi një nga objektivat parësore të Ministrisë së Financave është pikërisht mbajtja e tij në nivele të pranueshme. Të gjitha parashikimet tona makrofiskale kanë synuar dhe synojnë që të reduktojnë borxhin në nivele optimale. Por ky proces do të jetë gradual. Vendosja në Kushtetutë kërkon më shumë konsensus dhe procedura, por krahas sa më sipër vendosja edhe në ligjin organik do të jetë një masë e duhur e karakterit legjislativ dhe funksional”.

3.1.2 Mbi fuqizimin e Ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”

Nga auditimi, është konstatuar që ligji “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” rezulton me një rezistencë të ulët dhe është lehtësisht i ndryshueshëm nga pikëpamja e vendimmarrjes së Kuvendit (me shumicë të thjeshtë votash). Me synimin e zvogëlimit të risqeve potenciale për kryerjen e ndryshimeve dhe ndërhyrjeve eventuale në këtë ligj, i cili është ligji bazë themeltar për menaxhimin e financave publike në vend, **kemi rekomanduar që:**

- Shqyrtimi i rishikimeve të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe miratimi i tij në Kuvend të bëhet me një shumicë të cilësuar parlamentare.

¹ Llogaritja është bërë me stokun e borxhit publik referuar nivelit të PBB-së zyrtarizuar me VKM nr 544 datë 01.08.2012 me efekte deri në 23.01.2013

Ministria e Financave ka shprehur dakordësinë në shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 në të cilën cilësohet: Lidhur me rekomandimin që konsiston në ndryshimin e ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor nga i thjeshtë në ligj me shumice të cilësuar, shprehem plotësisht dakort.

3.1.3 Mbi përdorimin e të ardhurave të privatizimit për uljen e borxhit publik

Në ligjet vjetore të buxhetit ndër vite konstatohen përcaktime të ndryshme për përdorimin e të ardhurave nga privatizimet në nenet respektive të përcaktimit të kufirit të defiçitit. Kështu, në Aktin Normativ nr. 6 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2009”, të ndryshuar, ishte përcaktuar që të ardhurat nga privatizimet të përdoren 50% për uljen e huamarrjes dhe 50% të përdoren nga Këshilli i Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime, ndërsa në ligjin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2012 është përcaktuar që: “Çdo e ardhur nga privatizimi e arkëtuar mbi shumën e parashikuar në këtë ligj, përdoret me vendimet e Këshillit të Ministrave për rritjen e kufirit të shpenzimeve për investime dhe uljen e huamarrjes”. Në ligjin nr. 119/2012, datë 17.12.2012 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2013” në nenin 9 përcaktohet që: “Të ardhurat nga privatizimi mbi shumën e parashikuar në këtë buxhet përdoren me VKM për rritjen e kufirit të shpenzimeve kapitale dhe/ose uljen e huamarrjes, e cila automatikisht rrit kufirin e defiçitit”. Duke patur parasysh ngadalësimin e rritjes ekonomike të konstatuar dhe duke marrë shkas nga përcaktimet e ndryshme të përdorimit të të ardhurave nga privatizimet strategjike të konstatuara, **kemi rekomanduar që:**

- Në ligjin “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktohet që të ardhurat nga privatizimet duhet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër të shkojë për investime kapitale. Realizimi i këtij rekomandimi do të ndikojë pozitivisht në reduktimin e nivelit të borxhit publik.

Ministria e Financave ka shprehur dakordësinë në shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013, në të cilën cilësohet: “Në lidhje me rekomandimin shprehem dakort në parim. Por nisur nga fakti se ky ligj mund të ndryshojë në një periudhë afatmesme ky përcaktim mund të vendoset edhe në ligjin vjetor të buxheti”.

3.1.4 Mbi detyrimet që Buxheti i Shtetit ka kundrejt sipërmarrësve privatë

Krahas rritjes së borxhit publik dhe masave që duhen marrë në këtë drejtim, shqetësim për ekonominë tonë përbëjnë dhe detyrimet që Buxheti i Shtetit ka kundrejt sipërmarrësve privatë. Në raportin që KLSH ka paraqitur në Kuvend në vitin 2012 “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2011” ka trajtuar fenomenin e detyrimeve të Buxhetit të Shtetit ndaj kontraktorëve dhe ka rekomanduar: “Në kushtet aktuale sugjerojmë saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së këtyre borxheve, përcaktimi i masave për t’i dhënë mundësi dhe për të lehtësuar sa të jetë e mundur sipërmarrjen private nga kosto e kredive që ato mund të kenë marrë për përmirësimin e situatës së tyre financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për ristrukturimin e kredive dhe ndërkohë mbledhjes së borxheve të këqija. ...”. Nga auditimi u konstatua një përkeqësim i situatës dhe mosangazhim për të zbatuar rekomandimin e lënë një vit më parë.

U konstatuan praktika të çeljes së fondeve në mënyrë pjesore dhe në vlera të vogla, apo realizimi i investimeve të reja, ndërkohë që ekzistojnë të pa mbuluara me fonde “investimet në proces”, praktika që kanë sjellë shtyrjen e realizimit të investimeve për dy apo më shumë vite buxhetore dhe ulje të efektivitetit të tyre, por nga ana tjetër kanë krijuar vështirësi për sipërmarrjen private që ka kontrata për punë apo shërbime me sektorin publik. Ministria e Financave nuk ka të evidentuar **detyrimet ndaj operatorëve ekonomikë** për punë publike, mallra ose shërbime të kontraktuara dhe/ose të kryera. Referuar domosdoshmërisë së evidentimit të tyre për të patur një pasqyrim sa më të drejtë të detyrimeve afatshkurtra dhe afatmesme në pasqyrat financiare të shtetit nga njëra anë, por dhe nevojës për të realizuar një planifikim të kujdesshëm të Buxhetit për periudhat në vijim, pa harruar shqetësimin e sipërmarrjes private, **kemi rekomanduar që:**

- Në Ligjin “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014” krahas përcaktimeve në Ligjin Organik të Buxhetit, të parashikohet që të ardhurat nga privatizimet duhet të përdoren së pari dhe kryesisht për të ulur borxhin publik, ku 50% të jetë kufiri i poshtëm, dhe pjesa tjetër të shkojë për uljen e detyrimeve për faturat e papaguara ndaj sipërmarrësve privatë për punët publike të realizuara.
- Në Ligjin e zbatimit të Buxhetit për vitin 2014, të parashikohet që institucionet buxhetore, gjatë detajimit të fondeve të investimeve publike, të kenë detyrimin e përfshirjes në financimin e vitit “**në radhë të parë**” të të gjitha investimeve të kontraktuara apo punimeve, të cilat rezultojnë të realizuara dhe nuk janë financuar për vitin ushtrimor; dhe për të gjitha projektet e investimeve “**objekte të reja**” të synohet në financimin e projekteve në vlerën e plotë të projektit, kur vlera e tyre është e realizueshme brenda vitit buxhetor.
- Ministria e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit dhe Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit) të marrin masa për **evidentimin e saktë të të gjitha detyrimeve ndaj sipërmarrësve privatë të angazhuar në realizimin e punëve publike, mallra dhe shërbime dhe planifikimin e shlyerjes së tyre në buxhetet afatshkurtër apo afatmesëm. Këto masa të përfshihen në udhëzimin specifik për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2014.**

Në përgjigjen e Ministrisë së Financave dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013, cilësohet: “Lidhur me rekomandimin për përfshirjen e përcaktimeve specifike në përdorimin e të ardhurave nga privatizimet sqarojmë se nga pikëpamja teorike të ardhurat nga privatizimi mund të përdoren për uljen e borxhit ose investimet publike. Duke qenë se detyrimet e papaguara lidhen me investimet kapitale, mendojmë se kjo pjesë është e zgjidhur sipas përcaktimit më sipër”. “Lidhur me rekomandimin që konsiston në përcaktime specifike për investimet publike në ligjin e buxhetit të vitit 2014” **shprehemi dakord.**

Ndërsa në shkresën nr. 5167/27 date 03.09.2013, Ministria e Financave ka shprehur dakordësinë për sa rekomanduar nga KLSH, në lidhje me evidentimin e detyrimeve apo angazhimeve ndaj sipërmarrjes private: “Ministria e Financave (DPB dhe DPTH) të marrë masa për evidentimin e saktë të të gjitha detyrimeve e borxheve për pune publike dhe procedimin për buxhetimin e tyre duke parashikuar procedurat përkatëse që duhet të ndjekin NJQP dhe MF në udhëzimin specifik për zbatimin e buxhetit për vitin 2014, **shprehemi dakord**”.

3.1.5 Mbi regjistrimin e angazhimeve shumëvjeçare në sistemin informatik të Thesarit

Për shkak të ndjeshmërisë së madhe që ka fenomeni i detyrimeve të Buxhetit të Shtetit ndaj kontraktorëve privatë, auditimi u fokusua jo vetëm në faktin nëse është regjistruar apo jo ky lloj angazhimi në sistemin e Thesarit, por edhe në mënyrën e regjistrimit në sistemin informatik, duke vlerësuar maksimalisht rëndësinë e informacionit të drejtë në sigurimin e një vendimmarrje të kujdesshme. Nga auditimi i kryer në disa degë Thesari, rezultoi se, për kontratat shumëvjeçare, regjistrimi në sistemin informatik të Thesarit kryhet për vlerën totale dhe për vitin korrent në shumën e fondit të alokuar. U konstatua se për vitin buxhetor 2013, evidentohet vlera e mbetur e kontratës, duke mos marrë në konsideratë afatet e realizimit të këtyre kontratave në vite dhe nevojën për financime sipas këtyre afateve. Bazuar në këtë situatë, kemi **rekomanduar që:**

- Në Udhëzimin standard të zbatimit të Buxhetit të shtohet përcaktimi që: “Degët e Thesarit në rrethe, në rastin e kontratave shumëvjeçare, të regjistrojnë në sistem kontratat në shtrirje sipas viteve të parashikuara për realizimin dhe financimin e tyre”. Ky regjistrim jo vetëm do të sigurojë informacion të drejtë dhe të plotë për angazhimet financiare, bazuar në kontratat shumëvjeçare, por do të mundësojë përdorimin e këtij informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit për nevojat e planifikimit të Projekt-Buxhetit Afatmesëm.

Në përgjigjen e Ministrisë së Financave dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 cilësohet: Për sa është rekomanduar **shprehemi dakord** dhe sqarojmë se regjistrimi i kontratave shumëvjeçare i shtrirë në vite do të realizohet me projektin e AFMIS si kusht kryesor për planifikimin buxhetor afatmesëm/afatgjatë.

3.1.6 Mbi hartimin dhe zbatimin e Buxhetit

Kemi rikonstatuar rishikimin e treguesve buxhetorë gjatë ekzekutimit të buxhetit, shkak i të cilës në gjykimin tonë është parashikimi optimist i performancës së të ardhurave buxhetore në fillim të vitit. Kjo situatë është shoqëruar me **reduktimin e shpenzimeve buxhetore gjatë vitit dhe shoqërohet me efekte negative në ruajtjen dhe mbajtjen e një disipline fiskale efektive**. Një situatë e tillë e planifikimit të Buxhetit me shkurtime dhe reduktime të paplanifikuara, krahas efekteve negative në menaxhimin jo efektiv të shpenzimeve publike, nga ana tjetër “kompromenton” edhe proceset e planifikimit të projektbuxheteve afatmesme.

	Të ardhurat	Shpenzimet	Defiçiti
Plani	355.759	396.922	-41.163
Plani i rishikuar	332.758	382.296	-49.538
Fakti	330.384	376.241	-45.857

Burimi: Ministria e Financave.

Për vitin 2012 konstatohet se të ardhurat e përgjithshme buxhetore nga **355.7 miliardë lekë** të planifikuara me buxhetin fillestar, u korrektuan me rreth **23 miliardë lekë** dhe shpenzimet nga **397 miliardë lekë** u shkurtuan me rreth **14 miliardë lekë**, duke rezultuar me mosrealizim në fund të vitit me **6 miliardë lekë**. Defiçiti me planin fillestar ishte në **41.1 miliardë lekë**, me rishikime pati një **rritje me 8 miliardë lekë**, duke arritur në nivelin **49.5 miliardë lekë** dhe fakti i vitit 2012 rezultoi me mosrealizim **3.6 miliardë lekë**. Bazuar në sa më sipër, **kemi rekomanduar që,**

- Nga Ministria e Financave të merren masa për realizimin e proceseve të planifikimit mbi baza realiste, si dhe forcimin e kapaciteteve planifikuese, me synim që të ndërpriten praktikat e korrektimit të buxheteve dhe shkurtimit të shpenzimeve gjatë ekzekutimit të Buxhetit.

3.1.7 Mbi pasqyrat financiare të konsoliduara të Shtetit

Në disa vite rresht, në raportet tona kemi evidentuar **problematikën e mungesës së pasqyrave financiare të konsoliduara të Shtetit**, situatë që është përsëritur edhe këtë vit. Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit, që në bazë të ligjit është përgjegjëse për raportimin financiar, nuk ka bërë të mundur hartimin e këtyre pasqyrave në përputhje me të gjitha kërkesat ligjore dhe rregullatore që lidhen me raportimin financiar. Kjo drejtori ka relatuar një sërë pengesash teknike për realizimin e këtij funksioni, të lidhura me mungesën e formatimit të disa zërave në sistemin kompjuterik të Thesarit.

Gjithashtu, kemi konstatuar që hartimi i bilancit pasuror të shtetit, në përputhje me standartet ndërkombëtare të kontabilitetit publik është një objektiv strategjik për të cilin është parashikuar realizim gradual. Duke vlerësuar si të domosdoshme pasqyrat financiare të konsoliduara të Shtetit në marrjen e një pamje të qartë të situatës financiare të Shtetit, por dhe duke njohur rëndësinë e tyre për të siguruar një qeverisje më të mirë, **kemi rekomanduar që:**

- **Ministria e Financave (Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit) të marrë masa të menjëhershme për përgatjen e pasqyrave financiare të konsoliduara të Shtetit për vitin 2012, dhe në vijim të realizohet rishikimi brenda një kohe të shkurtër i kuadrit të plotë rregullator të raportimit financiar në sektorin publik, duke mbajtur parasysh Standartet Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik, si dhe duke i dhënë rëndësinë e duhur fuqizimit të sektorit të kontabilitetit dhe raportimit financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.**

Në përgjigjen e Ministrisë së Financave, dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 cilësohet: “Drejtorja e Administrimit të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ) sqaron se përgatitja e pasqyrave financiare në SIFQ është në proces dhe është pjesë e strategjisë së Qeverisë për integrimin e IPSAS në sektorin publik (në 6 vjet dy standarte) për realizimin e së cilës është kërkuar asistencë e huaj”.

3.1.8 Mbi përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave dhe kontigjencave

Nga auditimi i përdorimit të Fondit Rezervë të Këshillit të Ministrave për vitin 2012, në shumicën e vendimeve u konstatua përdorimi korrekt dhe ligjor i këtij fondi nga Këshilli i Ministrave, por në disa raste u evidentuan shkelje dhe mangësi të lidhura me mungesa në dokumentacion, në relacionet shpjegues dhe preventiva shpenzimesh apo trajtimin e tij si shtesë buxheti për institucionet përfituese.

Në ligjin e Buxhetit të vitit 2012, neni 13, përcaktohet se: *Fondi i Kontigjencës për ruajtjen e deficitit prej 2,661 milionë lekë përdoret me Vendime të Këshillit të Ministrave*. Gjatë auditimit të Fondit të Kontigjencës, u konstatua përdorimi i tij në vlerën 245,8 milionë lekë “Për kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetra tek njësitë e qeverisjes vendore”, si dhe në vlerën 2,000 milionë lekë për dhënie hua afatshkurtër KESH sh.a. me *Vendime të Këshillit të Ministrave*. Për sa konstatuar por dhe me të njëjtën frymë të rekomandimit të dhënë në Raportin e Buxhetit të vitit 2011, **kemi rekomanduar që:**

- *Në planifikim, në ligjin vjetor të buxhetit, Ministria e Financave të kërkojë që përdorimi i Fondit të Kontigjencës për ruajtjen e deficitit buxhetor, të bëhet me miratim nga Kuvendi i Shqipërisë.*

Në përgjigjen e Ministrisë së Financave dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 cilësohet: *Për rekomandimin që në ligjin vjetor të buxhetit të përcaktohet që fondi i kontigjencës për ruajtjen e deficitit buxhetor të përdoret vetëm nga Kuvendi i Shqipërisë, shprehemi dakord.*

3.1.9 Mbi garancitë shtetërore në dobi të palëve të treta përfituese

Auditimi i garancive shtetërore në dobi të palëve të treta, rishtas konstatoi shuma të konsiderueshme të papaguara nga huamarrësit dhe përfituesit e garancive, detyrime këto që në fund të vitit 2011 ishin në **shumën rreth 1.7 miliardë lekë** dhe në fund të vitit 2012 arritën nivelin **5.6 miliardë lekë**, rritje kjo si pasojë e problematikës së shfaqur nga ujësjellësit në këto vitet e fundit, por edhe mungesës së zgjidhjes së këtyre problematikave, pavarësisht takimeve të shumta nga struktura përkatëse të MF-së me institucionet përgjegjëse.

Ne e kemi trajtuar në vazhdimësi këtë problem dhe nga Ministria e Financave gjatë zbatimit të rekomandimeve të një viti më parë, u ra dakord gjithsesi që të niset një inspektim financiar, i cili deri tani rezultoi i përcaktuar. Për këtë, edhe njëherë kemi **rekomanduar që:**

- *Mbështetur në ligjin nr. 10294, datë 1/07/2010 “Për Inspektimin Financiar Publik”, neni 2; neni 3; neni 4/pikat 1,4,6,8,13; neni 7; neni 8- pika 2/ç dhe neni 9, propozojmë kryerjen e inspektimeve financiare për ndërmarrjet e ujësjellësve përfituese të nënshprehura dhe garancive në lidhje me:*

i. *Mënyrën e menaxhimit të fondeve publike, mënyrë që ka sjellë performacë financiare të ulët me pasojë paaftësi paguese në shuma të konsiderueshme të këtyre njësive.*

ii. *Dokumentacionin, inventarizimin dhe kontabilizimin e drejtë të përfitimeve nga projektet.*


Madje, në zbatim të Marrëveshjes së Bashkëpunimit ndërmjet KLSH-së dhe Ministrisë së Financave, nëse Ministria e Financave e gjykon të arsyeshme dhe të nevojshme, kemi shprehur gadishmërinë tonë për të kontribuar në këtë drejtim.

Në përgjigjen e Ministrisë së Financave dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 cilësohet: *“... për periudhën në vijim meqënëse është përsëritur rekomandimi edhe këtë vit nga ana e KLSH-së, kjo problematikë do të jetë objekt rishqyrtimi dhe analizimi me synim që të realizojmë një mision inspektimi në këtë aspekt”.*

3.1.10 Mbi financimin me prioritet për dëmshpërblimin e të përndjekurve politikë:

Për sa i përket buxhetimit për dëmshpërblimin e të përndjekurve politikë nga Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, në raportin e paraqitur në Kuvend në vitin 2012 është rekomanduar që: *“Pavarësisht tendencës në rritje të buxhetimit të kësaj kategorie shpenzimesh, theksojmë që*

nevojat dhe detyrimet ligjore e morale për këtë shtresë sociale kërkojnë planifikimin e shifrave shumë më të larta se sa financimi faktik”. Financimi në vite nga Buxheti i Shtetit në favor të dëmshpërblimit të të përndjekurve politikë ka patur trend të ndryshëm. Fondet e akorduara nga buxheti për këtë shtresë në harkun kohor 2009-2012 jepen në paraqitjen grafike të mëposhtme.



Burimi: Ministria e Financave.

Duke vlerësuar ndjeshmërinë e të gjithë shoqërisë për prioritetin që duhet të ketë trajtimi financiar i shtresës së të përndjekurve politikë dhe situatës jo në përmirësim, lidhur me trajtimin e kësaj shtrese, **kemi rekomanduar që:**

- Të shqyrtohet mundësia që në Ligjin “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2014” të parashikohet financimi me prioritet edhe nga të ardhurat e privatizimeve (10-20% të tyre) i dëmshpërblimit ligjor të ish të përndjekurve politikë.

3.2 Nga auditimi në Bankën e Shqipërisë

Duke vlerësuar maksimalisht rolin e rëndësishëm që ka patur Banka e Shqipërisë në ruajtjen e stabilitetit monetar dhe krijimin e një klime sa më garantuese për biznesin e brendshëm dhe të jashtëm, si dhe duke patur parasysh vështirësitë e krizës , mjedis i cili nuk kishte si të mos ndikonte në politikat monetare të Bankës së Shqipërisë, theksojmë se konstatimet e auditimit në këtë Institucion nuk mund të zbehin përpjekjet pozitive që ka bërë Banka e Shqipërisë për të arritur objektivat e saj, duke realizuar politika të kujdesshme dhe të suksesshme monetare.

3.2.1. Në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” përcaktohet se Banka e Shqipërisë është e pavarur në marrjen e vendimeve të saj në fushën e kompetencave, ligji i akordon asaj pushtet dhe pavarësi dhe sipas nenit 45, i atribuon Këshillit të saj Mbikëqyrës të drejtën për të përcaktuar nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të Guvernatorit, Zv. Guvernatorëve dhe personelit të Bankës së Shqipërisë. Bazuar në këtë të drejtë që i jep ligji, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar Vendime që rregullojnë pagën bazë të punonjësve dhe nivelin e shpërblimit për anëtarët e tij dhe Kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës. Nga auditimi, rezultoi rregullshmëria ligjore e pagesave të mbështetura në vendimet e cituara më sipër, ndërkohë që nga ana tjetër konstatojmë mosrespektim të ndjeshmërisë qytetare në lidhje me përdorimin e fondeve në dispozicion, kjo referuar niveleve shumë të larta të pagesave për nivelet drejtuese, si pagë dhe shpërblime të ndryshme, të trajtimeve dhe për udhëtime e dieta, krahasuar me nivelin e pagës të punonjësve të institucioneve kushtetuese. **Për sa më sipër, kemi rekomanduar që:**

- Të iniciohen nisma ligjore për rishikimin e Ligjit për Bankën e Shqipërisë, në frymën e minimizimit të riskut potencial të abuzimit me pavarësinë dhe shmangies së konfliktit të

interesit, që evidentohet në praktikat e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve për nivelet drejtuese.

- Të përcaktohet një kornizë e kujdesshme rregullatore në lidhje me nivelin e pagës së Guvernatorit, e cila duhet të ndjekë trendin e pagave të tregut bankar, por gjithmonë duhet të jetë në raporte të pranueshme krahasuar me pagën e Presidentit të Republikës, bazuar kjo në përvojat dhe praktikat më të mira të vendeve të ngjashme, por pa harruar përshtatshmërinë me realitetin shqiptar. Gjithashtu, të vendosen nivele të arsyeshme për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, nivele shpërblimi të cilat, duke marrë në konsideratë edhe nivelin e pagës bazë të tyre, nuk duhet të tejkalojnë gjithsesi pagën e Guvernatorit, apo këto paga të jenë më shumë sesa paga e anëtarëve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.

Në përgjigjen e kthyer nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 660/9, datë 16/08/2013 theksohet: *“Nuk ka shkelje të ligjeve të miratuara dhe Banka e Shqipërisë nuk mund të ndryshojë dhe miratojë vetë ligjin për Bankën e Shqipërisë”. Gjithashtu, shton se rritja e fondit të pagave në Bankën e Shqipërisë është kryer me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të vitit 2009, ndërsa rritjet e mëparshme kanë pasur si pikësynim domosdoshmërinë e ruajtjes së aftësisë konkurruese të Bankës së Shqipërisë në punësimin e burimeve njerëzore cilësore, në funksion të arritjes së objektivave të saj, për të ruajtur një qëndrueshmëri afatgjatë të këtyre burimeve. Niveli i pagave të niveleve drejtuese të Bankës së Shqipërisë është disa herë më i ulët se niveli në banka apo institucione financiare që varen prej saj.*

3.2.2. Në Ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 68, theksohet: *“Llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të kontrollohen nga kontrollorë të jashtëm të institucioneve kontrolluese të njohura në arenën ndërkombëtare dhe që caktohen nga Këshilli Mbikëqyrës”. Për plotësimin e këtij detyrimi ligjor është vepruar me audituesin e jashtëm të pavarur “Grant Thornton” sh.p.k., i cili ka audituar llogaritë dhe ka dhënë opinion për to në datën 06.03.2013. Në opinionin e këtij audituesi theksohet: “Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2012, rezultatin e saj financiar dhe fluksin e saj të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me politikat kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, siç është shpjeguar në pasqyrat financiare”. Për të rritur mirëqeverisjen, transparencën dhe besueshmërinë e publikut, duke parë caktimin e audituesit të jashtëm nga Këshilli Mbikëqyrës i cili nuk është i ndarë nga ekzekutivi për shkak të drejtimit të tij nga Guvernatori, **kemi rekomanduar:***

- Ndryshimin e mënyrës së përzgjedhjes së audituesit të pasqyrave financiare për të shmangur konfliktin e interesit në përzgjedhjen e tij, duke ia kaluar këtë kompetencë Kuvendit të Shqipërisë, referuar edhe praktikave më të mira botërore. Kuvendi përzgjedh vetëm audituesin ndërkombëtar të pavarur dhe nuk merr përsipër pagesën e shërbimit, që mbulohet nga vetë Banka e Shqipërisë.

Në përgjigjen e kthyer nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 660/9, datë 16/08/2013 theksohet: *“Në praktikat botërore të auditimit ka eksperiencë të ndryshme. Në Bankën e Shqipërisë përzgjedhja e auditit të jashtëm është bërë me “tender të hapur”, ku konkurrentët i nënshtrohen kriterit lidhur me aftësinë profesionale e më pas vlerësohet dhe oferta më e ulët. Materialet e auditimit nënshkruhen edhe nga zyra të tjera të kompanive fituese jashtë Shqipërisë. Gjithashtu, përbërja e Këshillit Mbikëqyrës në shumicën e vet përbëhet nga anëtarë të pavarur ekzekutivë, të cilët nuk janë të përfshirë në detyra administrimi dhe janë personalitete me ekspertizën e duhur, gjë që përbën garanci ligjore për drejtimin dhe vendimarrjen në përputhje me standartet e kësaj fushe”.*

Ne, si Institucion Suprem Auditimi mendojmë që Komisioni i Ekonomisë, Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi duhet të trajtojë këtë problematikë në thellësi, në mënyrë që, duke mos cënuar pavarësinë e këtij Institucioni të rëndësishëm dhe në kujdes të ruajtjes së qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore cilësore të tij, të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore, në bashkëpunim dhe në respekt të Bankës së Shqipërisë dhe drejtuesve të saj por mbi të gjitha në respekt të ndjeshmërisë qytetare.

3.2.3 Banka e Shqipërisë kryen kreditimin e qeverisë brenda kufijve të parashikuar në nenin 30 të Ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”. Niveli i kreditimit të verifikuar është akoma në tejkallim të limitit të financimit prej 5% të të ardhurave mesatare vjetore të 3 viteve të fundit, pavarësisht tendencës në rënie të tij. Megjithë rekomandimet e auditimeve të mëparshme dhe dakordësisë së gjetur pranë Bankës së Shqipërisë në lidhje me domosdoshmërinë e arritjes së limiteve të kreditimit të parashikuara, nuk gjetëm konkretizim të përmirësimeve të synuara, për këtë **kemi rekomanduar**

- *Prezantimin e një plani të detajuar masash dhe veprimesh efektive me afate konkrete që do të mundësonin arritjen e shpejtë të këtij limiti kreditimi referuar kushteve aktuale të zhvillimeve ekonomike të vendit*

3.2.4 Auditimi lidhur me zbatimin e kontratës së ndërtimit për “Realizimin e disa punimeve shtesë në ndërtesën e re të DE” si dhe asaj për “Realizimin e punimeve shtesë për rikonstruksionin e godinës qendrore dhe ndërtimin e kompleksit të ri të Bankës së Shqipërisë”, kemi konstatuar tejkallime të afateve të përfundimit të punimeve. Pavarësisht identifikimit të arsyeve objektive ose jo të mosrealizimit të kontratave brenda afateve, jo për çdo kontratë janë bërë ndryshimet për pjesën e shtyrjes së afateve, me miratimet sipas kompetencave. Ndërsa në tenderin “Realizimi i punimeve të prishjeve ndërtimore në godinën e ish-“Hotel Dajtit”, është shtyrë procedura e tenderimit për arsye të mosplotësimit të kuorum-it. Komisioni i Prokurimit duhet të kishte marrë vendimin për shtyrjen e procedurave të prokurimit dhe ta kishte shoqëruar me procesverbalin përkatës. Lidhur me sa më sipër, **kemi rekomanduar:**

- *Për të gjitha rastet e identifikuar të kontratave të papërfunduara dhe me tejkallim të afateve, të analizohen shkaqet dhe të kontabilizohen penalitetet që duhet t'i kërkojnë sipërmarrësit për mosrealizim të punimeve në kohë apo ndërprerje që vonojnë realizimin e veprës.*

- *Duhet të vlerësohet kostoja oportune e pagesave të qerasë të cilat vazhdojnë të paguhet nga BSH, ndërkohë që për kohën e shtyrjes së kontratave kjo kosto duhet t'i ngarkohet sipërmarrësit që nuk ka realizuar në kohë projektin apo nëse janë fajtorë persona brenda BSH, të përcaktohen këto përgjegjësi që efekti të mos rëndojnë në rezultatin e bankës.*


Banka e Shqipërisë, në qëndrimin e saj ka theksuar fillimin e analizave për shqyrtimin e shkaqeve që kanë çuar në tejkallimin e afateve të mosrealizimit të kontratës së rikonstruksionit të godinës qendrore të BSH dhe rasteve të tjera të konstatuara duke sqaruar edhe trajtimin e masës së penaliteteve të aplikueshme për rastet e vonesave.

3.3 Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet tatimore

Auditimi konstatoi se nga DPT dhe njësitë vartëse të saj nuk arritën të realizoheshin treguesit e programuar për vitin 2012 në mbledhjen e të ardhurave tatimore dhe për më tepër, të ardhurat e kësaj periudhe ishin edhe nën nivelin e realizuar një vit më parë. Kështu, të ardhurat tatimore neto (pa kontributet e sigurimeve) janë realizuar në masën 98.95%, nga 105,190 milionë lekë të planifikuara janë mbledhur vetëm 104,083 milionë lekë, me një impakt defiqitar prej 1,107 milionë lekë. Krahasuar me në vit më parë, këto të ardhura rezultojnë me rënie në masën 3,416 milionë lekë apo 3.2% (104,083:107,499) më pak.

3.3.1 Mbi realizimin e të ardhurave tatimore sipas strukturës


Po të shikohet struktura e të ardhurave vihet re se të ardhurat personale kanë sjellë 27% të të ardhurave totale kundrejt 24% të pjesës që ka sjellë TVSH, pasuar nga 16% të krijuara nga Tatim-fitimi dhe 13% nga taksa nacionale, 11% akciza dhe 9% tatime të tjera. Gjithashtu të dhënat tregojnë se të ardhurat nga tatimet indirekte zënë 33 përqind etë të ardhurave (TVSH dhe Akciza), kurse tatimet direkte 67 përqind e të ardhurave. Në skemën e mëposhtme dalin qartë konstatimet e cituara më lart.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

1. Të ardhurat e planifikuara nga TVSH për vitin 2012 nuk janë realizuar me 168,417 mijë lekë ose -0,68% referuar nivelit të të ardhurave të realizuara nga TVSH për 2012-n (nga 24,928 milionë lekë të planifikuara janë realizuar në fakt 24,760 milionë lekë). Analiza jonë është bazuar në TVSH (neto) dhe tregon se masat organizative dhe teknike të marra nga administrata tatimore në menaxhimin e TVSH-së *nuk kanë qenë efektive dhe aq më pak eficënte*.
2. Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për vitin 2012, nga 16,553 milionë lekë të planifikuara, në fakt rezultojnë në 16,853 milionë lekë, me një realizim prej 101.8% ose në vlerë një tejkalim prej 300 milionë lekësh.
3. Të ardhurat nga akciza për vitin 2012 rezultojnë me realizim në masën 100%, nga 11,867 milionë lekë plani, në fakt janë mbledhur 11,868 milionë lekë. Peshën më të madhe të akcizës e ka patur NJTPM me rreth 95% të totalit të të ardhurave nga akciza duke reflektuar natyrën e përqëndrimit të këtij tatimi në tatimpagues të mëdhenj.
4. Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhura personale për vitin 2012 janë realizuar në masën 99.3%. kështu, nga 28,128 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 27,933 milionë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 195 milionë lekë. *Duke qënë se në këtë grup të ardhurash përfshihen nga të ardhurat mbi pagën, të të ardhurat nga biznesi i vogël e deri tek tatimi mbi dividendë, analiza na con në konstatimin se shumë nga DRT rajonale nuk kanë punuar mjaftueshëm për verifikimin, evidentimin dhe deklarimin e pagave reale nga tatimpaguesit si dhe zbatimin korrekt të ligjit në drejtim të evidentimit dhe pagesës së detyrimit të tatimit mbi dividendin, i cili zë një peshë akoma të vogël në këtë grupim.*
5. Të ardhurat nga taksa nacionale për vitin 2012 rezultojnë me tejkalim në masën 5.84% mbi nivelin e planifikuar. Nga 12,714 milionë lekë plani, në fakt janë mbledhur 13,457 milionë lekë, me një tejkalim në vlerë prej 743 milionë lekë më shumë.

Po japim grafikisht të dhënat për realizimin e të ardhurave sipas Drejtorive Rajonale



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Të dhënat tregojnë se NJTPM mbledh rreth 46% të të ardhurave tatimore ndërkohë që ajo ka një strukturë me 168 punonjës, ndërsa 1251 punonjës të tjerë realizojnë 54% të të ardhurave tatimore pa përmendur strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve prej 187 punonjësish.


3.3.2 Detyrimet tatimore (borxhi tatimor)

Për vitin 2012, Detyrimet tatimore rezultuan në një nivel të lartë. Kështu në nivel DPT-je, nga 64,734 milionë lekë që ka qenë gjendja në fillim të vitit 2012, në fund të tij arriti në shumën **69,936 milionë lekë**, me një rritje në masën 8% dhe në vlerë 5,202 milionë lekë. Megjithë pakësimin e gjendjes së debitorëve, si pasojë e zbatimit të ligjit nr. 10418, datë 21.04.2011 "Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor" **përsëri gjendja e borxhit në datën 31/12/2012 paraqitet me rritje, duke theksuar paaftësinë e administratës tatimore në menaxhimin e borxhit**. Në analizën sipas llojit të tatimeve e taksave, rezulton që peshën kryesore të detyrimeve të papaguara e zënë:

	në milionë lekë	
	Vlerë	%
1 Detyrime për Tatim Fitimin	16,060	23%
2 Detyrime për TVSH	25,380	36%
3 Detyrime për Kontributet e sigurimeve shoqërore	8,542	12%
4 Detyrime për Akcizën	8,541	12%
5 Detyrime për TAP	2,248	3%
6 Detyrime të tjera	9,165	17%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Mosha e borxhit është një tjetër tregues i natyrës së tij. Nëse do t'i referohemi tabelës më poshtë, shikojmë se masa më e madhe e borxhit është ai 1-2 vjeçar



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Auditimi i të dhënave për arkëtimet e detyrimeve dhe gjëndjes së borxhit në fillim dhe në fund të vitit 2012, në total dhe sipas DRT-ve, rezulton se ka një rënie të konsiderueshme të vlerës së

arkëtuar në krahasim me vlerën e propozuar si dhe inefficiencë të masave shtrënguese. Kështu, vlera e arkëtuar në raport me vlerën e propozuar rezulton 6.7% në vitin 2011 dhe rreth 8.7% në vitin 2012, gjë që ka ardhur kryesisht si pasojë e:

- Mungesës së kontrolleve apo vizitave në Drejtoritë Rajonale Tatimore për të shqyrtuar funksionimin e mbledhjes dhe masave shtrënguese nga zyra, detyrë kjo e përcaktuar në pikën 15.3 në Rregulloren e Brendshme të DPT-së;
- Mosvlerësimi dhe mospropozimi të masave disiplinore nga Drejtoria e Borxhit në DPT për punonjësit e DRT-ve të ngarkuar me ligj për aplikimin e masave shtrënguese ndaj subjekteve debitoare;
- Mungesës së mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Borxhit nga strukturat përkatëse të Drejtorisë së Mbledhjes së të Ardhurave në DPT;
- Mosrakordimit të gjendjes së borxhit nga DRT-të me DPT-në dhe mosrakordimit të nivelit të borxhit midis Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Drejtorisë së Borxhit brenda vetë strukturave të DPT-së, etj, kjo si pasojë e mungesave në parashikimet e rregullimeve kontabël që duhet të shoqëronin skemën e faljeve dhe teknikat e këtyre procedurave për elementë të caktuar të ligjit të faljes.

Mbi auditimin në njësinë e mbikqyrjes së lojrave të fatit

- Nga auditimi i ushtruar në njësinë e mbikqyrjes së lojrave të fatit në tremujorin e dytë të vitit 2013, u konstatuan mjaft mangësi e shkelje të legjislacionit në fuqi, si në drejtim të parregullshmërisë së dokumenacionit në lidhje me dhënien e licensave për ushtrim aktiviteti dhe hapjen e sallave të lojrave të fatit mungesës së certifikimit të makinerive paisjeve të lojrave të fatit si dhe mungesës së ushtrimit të kontrollit të plotë në terren.
- Në përfundim të këtij auditimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr 205/10 datë 05.08.2013 i ka rekomanduar Ministrin të Financave, ngritjen e në taskforce të veçantë për të pasqyruar zhvillimet informale në këtë sektor nëpërmjet kryerjes së një auditimi në terne pranë subjekteve që zhvillojnë aktivitetet në fushën e lojrave të fatit.

3.3.3 Mbi pamundësinë për të audituar të ardhurat në DPT

Një problem tepër shqetësues dhe tejet pengues për KLSH-në për ushtrimin e detyrave të tij kushtetuese dhe ligjore që vazhdon prej vitesh dhe kërkon zgjidhje, është konflikti i kompetencave të krijuar artificialisht ndërmjet KLSH dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. DPT, aktualisht është i vetmi institucion shtetëror që nuk i nënshtrohet plotësisht procesit të auditimit të mbledhjes së të ardhurave, siç përcaktohet në Deklaratën e Limës ose ndryshe Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit, në Kushtetutën e Shqipërisë, Ligjin Organik të KLSH-së dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit.

DPT dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore në varësi të saj, në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore në fuqi, kanë ndërhyrë në të drejtat dhe kompetencat që i takojnë ekskluzivisht KLSH-së, si Institucioni Suprem i Auditimit, nëpërmjet mosvënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar prej tij në zbatim të programeve të auditimit dhe të vendosjes së procedurave kufizuese "ekstra ligjore", nëpërmjet të cilave kërkohet miratimi paraprak nga ana e DPT-së, i programeve të auditimit të KLSH dhe dokumentacionit që do t'i vihet atij në dispozicion.

Përpjekjet e KLSH-së për zgjidhjen me mirëkuptim dhe në rrugë administrative të konfliktit të mësipërm të kompetencave kanë qenë të vazhdueshme, madje për këtë janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm për arritjen e nënshkrimit të një memorandumimi mirëkuptimi ndërmjet KLSH-së, DPT-së dhe Ministrisë së Financave. Ndonëse në lidhje me këtë iniciativë ndërinstucionale me mirëkuptimin dhe dakordësinë e Ministrin të Financave u arrit të përgatitej edhe një draft memorandum, DPT e ka lënë këtë çështje në heshtje të plotë institucionale.

Për pasojë, ndërmjet institucionit të KLSH dhe DPT vazhdon të jetë e pranishme situata e konfliktit të kompetencave dhe e pengimit të KLSH-së në ushtrimin e funksioneve të tij audituese. Për këtë konflikt, i jemi drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kemi pritshmërinë e konfirmimit prej saj të së drejtës ligjore që ka KLSH për ushtrimin e pushtetit të tij në drejtim të aksesit të plotë dhe pa kushte në dokumentacionin e konsideruar prej tij si të nevojshëm për kryerjen e auditimeve.

3.4 Mbi administrimin e të ardhurave buxhetore nga organet doganore

Nga auditimi u konstatua një punë e mirë nga DPD në realizimin e të ardhurave tatimore nga sistemi doganor për vitin 2012 pasi janë realizuar të ardhura në vlerën 128,334 milionë lekë krahasuar me 130,732 milionë lekë të planifikuar për vitin 2012, DPD paraqitet me mosrealizim në masën 1,84%.

3.4.1 Mbi realizimin e të ardhurave doganore sipas strukturës

Analiza sipas strukturës tregon se të ardhurat nga taksat doganore janë realizuar në masën 101.1%, me një tejkalim prej 65 milionë lekë. Theksojmë se të ardhurat nga taksat doganore, si rezultat i uljes së përvitshme të nivelit të tyre, kanë ardhur në rënie të vazhdueshme nga viti në vit. Kështu në vitin 2012 krahasuar me realizimin faktik të 4 viteve më parë (viti 2008), ato janë ulur në vlerë 2,542 milionë lekë, ose në masën 41,5%, por duke qënë se pritet të zbatohen marrveshjet e tregtisë së lirë lidhur me importet nga vendet e Bashkimit Europian kjo taksë po shkon drejt fundit të zbatimit të saj.

1. Të ardhurat nga akciza në doganë rezultojnë me rënie në masën 0.3% kundrejt planit të rishikuar pas kalimit të akcizës të administrata doganore dhe në të njëjtin nivel realizimi me një vit më parë. Në nivelin e realizimit të akcizës ka ndikuar kryesisht rënia e importit të karburanteve dhe e importit të birrës.
2. Të ardhurat nga TVSH-ja rezultojnë në masën 97.5%, me një mosrealizim prej 2,339 milionë lekë, shkaktuar kryesisht nga rënia e nivelit të importit të mallrave të taksueshëm dhe rezultat i zbatimit të politikave qeverisëse mbi importet, si dhe skemat e shtyrjes së TVSH në doganë.
3. Për t'u evidentuar është fakti se të ardhurat nga renta minerare në eksport janë realizuar në masën 99.1% dhe në krahasim me një vit më parë, paraqiten me rritje të konsiderueshme në masën rreth 60.2% më shumë, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore.

3.4.2 Detyrimet doganore (borxhi doganor)

Gjatë vitit 2012, borxhi doganor rezulton me rritje, duke u shtuar me 39 subjekte dhe në vlerë 1,127 milionë lekë, krahasuar me gjendjen më 31/12/2011. Borxhi doganor i trashëguar është rritur për efekt të vendimeve administrative të nxjerra nga autoritetet doganore kompetente. Kundrejt të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2012, vlera e borxhit doganor prej 4,086 milionë lekë zë rreth 3.18% të totalit të të ardhurave të realizuara, nga 2.3% që zinte një vit më parë, me një rritje prej 0.88 pikë përqindje.

Konstatohen përpjekje të pafinalizuara të autoriteteve doganore kompetente dhe strukturave të specializuara të Administratës Doganore në zbatimin e plotë të kërkesave të përcaktuara në nenin 245 të Kodit Doganor dhe akteve të tjera nënligjore nxjerrë në zbatim të tij, për rikuperimin e borxhit doganor qoftë dhe me forcë.

Gjithashtu, gjatë auditimeve të kryera për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2012, në gjashtë degë doganore kemi konstatuar dhe shkelje të legjislacionit doganor në fuqi me pasojë dëm

ekonomik në vlerën 29,3 milionë lekë, kryesisht detyrime doganore të pallogaritura e të papaguara për moszbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve; detyrime dhe penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me regjimin e përpunimit aktiv; detyrime doganore të papaguara për diferencë në peshë; detyrime dhe penalitete të pavendosura për mospagim të TVSH-së; detyrime doganore të papaguara në zhdoganimin e automjeteve, etj.

Bazuar në sa kemi konstatuar gjatë auditimit të aktivitetit të DPD, kemi rekomanduar që DPD brenda vitit 2013, të ndjekë të gjitha procedurat ligjore për arkëtimin e vlerës së dëmit prej 29,3 milionë lekë dhe nëpërmjet strukturave të saj të specializuara, të organizojë punën dhe të marrë masa për zvogëlimin deri në arkëtimin e plotë të borxhit doganor në vlerën 4,086 milionë lekë.

3.5 Mbi auditimin e zbatimit të buxhetit të pushtetit vendor

Një vëmendje të veçantë gjatë vitit 2012, i kemi kushtuar vlerësimit të punës së njësisve të pushtetit vendor në mbledhjen e të ardhurave dhe përdorimit të fondeve në dispozicion të tyre. Për të mundësuar dhënien e një opinioni të bazuar për nivelin e performacës së këtyre njësisve të pushtetit vendor në administrimin e fondeve për llogari të Buxhetit të vitit 2012, në nivel vendor janë audituar 48 subjekte, nga të cilat 22 bashki, 11 komuna, 2 këshilla qarqesh, 2 prefektura dhe 3 ndërrmarrje në varësi të Bashkisë Tiranë.

3.5.1 Mbi realizimin e të ardhurave

Të ardhurat ngë njësitë e pushtetit vendor kontribojnë në mënyrë modeste në totalin e të ardhurave të buxhetit, me rreth 3% të tij. Nga auditimi ka rezultuar se, *të ardhurat në total të grumbulluara nga strukturat përkatëse në pushtetin vendor janë realizuar në masën 98.1%*, nga 11,073 milionë lekë plani me ndryshime në 10,859 milionë lekë realizimi faktik, *me një impakt deficitar në vlerë prej 214 milionë lekë*. Kundrejt të ardhurave të realizuara në vitin 2011, përkatësisht në shumën 11,791 milionë lekë, të ardhurat e realizuara në vitin 2012 paraqiten me ulje në shumën 932 milionë lekë, ose 9.2 pikë përqindje më pak.

Ndër arsyet kryesore që kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave në njësitë e pushtetit vendor, mund të theksojmë:

- Mosmbajtjen e regjistrave të taksave dhe tarifave vendore nga zyrat e taksave e tarifave vendore në disa njësi të pushtetit vendor, lidhur me të dhënat për vendndodhjen, numrin e identifikimit, llojin e aktivitetit, detyrimin financiar të ndarë sipas kësteve për biznesin e vogël dhe detyrime të tjera për taksat dhe tarifatat vendore.
- Mospërdorimin e kasave fiskale nga mjaft subjekte në njësitë e qeverisjes vendore, ndonëse KM ka marrë vendime për vendosjen, madje dhe rimbursimin e tyre.
- Mungesën e rakordimeve dhe bashkëpunimit të frutshëm të zyrave të taksave në njësitë e pushtetit vendor me Drejtoritë Rajonale të Tatimeve, Zyrave të Gjendjes Civile, Zyrave Rajonale të Regjistrimit të Pasurive dhe Zyrat e Kadastrave, madje dhe ndërmjet të vetë zyrave të bashkive apo komunave, në funksion jo vetëm të ploanifikimit por dhe të realizimit të ardhurave nga taksat dhe tarifatat vendore.
- Mosmiratimin e një metodike të drejtë (bazuar në përvojat më të mira në vend) për të siguruar grumbullimin nga popullata në qytetet e kategorisë së I-rë, të taksës së ndërtesës, tarifës së pastrimit, gjelbërimit etj. Për t'u përmendur p.sh Bashkia Fier e cila megjithëse është e organizuar në 4 Njësi administrative (Rajone), auditimi konstatoi se nuk kanë paguar taksën e ndërtesës dhe pastrimit mbi 3000 familje apo 30% e popullatës me një impakt negativ në buxhetin e kësaj Bashkie në shumën 7.5 milionë lekë/vit. *Fenomeni i mospagesës së taksave të pastrimit dhe ndërtesave nga popullata është konstatuar pothuajse në të gjitha bashkitë.*

3.5.2 Mbi fondet e shpenzuara

Shpenzimet faktike të vitit 2012 rezultuan në masën 101.1% kundrejt planit. Nga 27,049 milionë lekë të planifikuar, janë shpenzuar në fakt 27,333 milionë lekë, me një mbishpenzim në vlerë prej 284 milionë lekë. Krahasuar me nivelin e shpenzimeve të realizuara në vitin 2011 (28,119 milionë lekë), ato rezultojnë me ulje në masën 2.8%, e barabartë me 786 milionë lekë më pak.


Në fushën e shpenzimeve, auditimet e ushtruara nga KLSH janë përqëndruar në zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare, lidhur me administrimin dhe përdorimin e fondeve buxhetore, në përfundim të të cilave krahas punës së bërë, janë konstatuar edhe mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, si në fushën e pagave dhe shpërblimeve, në shpenzimet operative, në fushën e prokurimit publik etj.

*Ndërsa, vlera e dëmit ekonomik të rezultuar si rrjedhojë e shkeljeve të dispozitave ligjore në fuqi në 40 subjektet e audituar, llogaritet **në shumën 170,2 milionë lekë**, nga të cilat 79 milionë lekë përfaqësojnë mungesë në të ardhurat nga qiratë, taksat vendore dhe taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe 90,9 milionë lekë në fushën e shpenzimeve buxhetore si pasojë e shkeljeve të dispozitave ligjore në fuqi, nga ku rreth 90% e shkeljeve është konstatuar në fushën e prokurimeve.*

3.6 Mbi zbatimin e buxhetit të Sigurimeve Shoqërore

3.6.1 Mbi realizimin e të ardhurave

Aktiviteti ynë ka patur në fokus edhe auditimin e të ardhurave të realizuara nga skema e sigurimeve shoqërore, të cilat sigurojnë 15% të të ardhurave të Buxhetit të Shtetit por kjo e shoqëruar dhe me një analizë të fondeve të harxhuara.



Burimi: Ministria e Financave

Nga ISSH janë ndjekur dhe respektuar çdo muaj kufijtë e programuar të fondeve për transfertat në buxhetet familjare sipas programit të përcaktuar me ligjin për buxhetin e shtetit të vitit 2012 dhe me vendime të veçanta të KM. Shpenzimet janë ndjekur dhe mbajtur nën kontroll për të gjitha skemat. Gjithashtu, janë përmirësuar procedurat e shërbimeve ndaj përfituesve, është fuqizuar kontrolli i brendshëm etj. Ndonëse objektivat, në përgjithësi janë realizuar në aspektet e parashikuara, po theksojmë disa konstatime:

Mosrealizim i të ardhurave të programuara nga shmangia e pagesës së kontributeve nga të punësuarit në subjektet juridike fizike, si pasojë e numrit mjaft të ulët të kontribuesve që mbledhen nga DPT.

Rritje e gjëndjes së detyrimeve të kontributeve të pa paguara nga subjektet juridik e fizik në fund të vitin 2012 rezultoi 8,054 milionë lekë dhe vetëm këtë vit janë shtuar këto detyrime me 320 milionë lekë.

Numri i lartë i subjekteve debitore dhe i kontribuesve që ato përfaqësojnë, me pasojë mosmbledhjen e të ardhurave në shuma të konsiderueshme, krijimin e deficitit dhe subvencionimin e tij nga buxheti i shtetit. Si rezultat i mospagesave të kontributeve nga këto subjekte debitore, një numër i madh i personave të punësuar në to, nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore asnjë lloj pensioni.

Mosdorëzimi në shumë raste i listëpagesave nga subjektet e biznesit të vogël dhe të madh (kryesisht listëpagesave tremujore të biznesit të vogël) duke shkaktuar vështirësi në funksionimin e skemës së pensioneve lidhur me përcaktimin e masës së pensionit të pleqërisë, madje denatyrton edhe llogaritjen e borxhit të subjekteve për kontributet e papaguara ose të paguara pjesërisht.

Për eliminimin e këtyre pasojave, ***kemi rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme nga ISSH, Ministria e Financave dhe DPT, për bërjen e rregullimeve të nevojshme në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e sigurimeve shoqërore. Në veçanti, kërkohet hartimi i një udhëzimi të Ministrit të Financave, ku të përcaktohet mënyra e raportimit dhe evidentimi i kontributeve në përgjithësi dhe në veçanti, mënyra e raportimit të të dhënave mujore dhe atyre progresive për detyrimet e kontributeve të papaguara në afat dhe për kamatvonesat e tyre, apo të kontributeve të paguara pjesërisht për çdo subjekt privat, si dhe sanksione më të ashpra për mosdorëzim të listëpagesave brenda afateve.***

2. Të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi që mblidhen nga ISSH rezultojnë me një mosrealizim, ku ndër faktorët që kanë ndikim të drejtpërdrejtë theksojmë largimin e një pjese të popullsisë nga zonat rurale në drejtim të zonave urbane apo emigracion si dhe tërheqja nga skema e personave që kanë plotësuar vjetërsinë e nevojshme prej 35 vitesh punë dhe nuk paraqesin më interes për sigurim, pasi nga sigurimi mbi 35 vjet nuk përfitojnë shtesë pensioni. Gjithashtu, rezulton një numër mjaft i lartë i të vetëpunësuarve në bujqësi që nuk përfshihen në skemën e sigurimeve shoqërore në fshat për vitin 2012 rreth 111,709 persona, duke krijuar një efekt negativ në të ardhura llogaritur në shumën **2,319 milionë lekë.**

3. Të ardhurat nga sigurimi vullnetar paraqiten me një mosrealizim në vlerë prej 23.3 milionë lekë, shkaktuar në mënyrë të drejtpërdrejt nga mosrealizimi i numrit të personave të siguruar, ulja e tyre në krahasim me një vit më parë.

3.6.2 Mbi shpenzimet për përfitime

Në fushën e shpenzimeve për përfitime, shpenzimet për "Pensione" në total nga 71,707.9 milionë lekë të programuara, në fakt janë shpenzuar 71,631.6 milionë lekë, ose në masën 99.9%, me një mosshpenzim minimal vetëm 76.3 milionë lekë. Në krahasim me realizimin e vitit 2011, programi i vitit 2012 është rritur me 4,240 milionë lekë, rritje e cila ka mbuluar kryesisht shpenzimet për pensionet e qytetit, kjo dhe për arsye se shumë përfitues që paraqiten si të vetëpunësuar në bujqësi, si pasojë e plotësimit më shumë se 50% të vjetërsisë në punë në marrëdhënie sigurimi, përfitojnë pensione qyteti. Ndër problemet e konstatuara në fushën e shpenzimeve paraqesim:

Vendimmarrjet e Komisioneve Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Punë, Rajonale dhe Eprore (për dhënien e invaliditetit), dhumë nga të cilat mkanë sjellë shtimin e padrejtë të shpenzimeve për invaliditetin, duke thelluar më shumë deficitin e degës së pensioneve.

Shuma e shpenzimeve për komisione të pagesave për vitin 2012, të përfituar nga Posta Shqiptare sh.a., për shërbimin e pagesave të pensioneve rezultoi 499.3 milionë lekë, e cila krahasuar me ato të vitit 2006, është rritur me rreth 200 milionë lekë, ndërkohë që numri i personave dhe pensionisteve që u kryhet shërbimi nga viti 2006 në vitin 2012 është rritur me vetëm rreth 10%.

Rritja e pensioneve nuk ka pasur raport të drejtë me rritjen e inflacionit gjatë vitit 2012, më konkretisht pensionet janë rritur 5.4%, ndërsa inflacioni sipas të dhënave të INSTAT nga 3% në 4% dhe kjo rritje nuk është shoqëruar me rritje të të ardhurave nga kontributet e drejtpërdrejta. Për pasojë, efektet e rritjes mbi nivelin e inflacionit janë mbuluar me subvencione buxhetore të cilat janë rritur nga viti në vit, çka ka ndikuar në thellimin e deficitit të degës së pensioneve.

Në zbatim të ligjit nr. 7703, datë 11/05/1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, në nenin 71 përcaktohet krijimi i Fondit Rezervë për të mbuluar të paktën 3 muaj shpenzime për pensione. Në fakt, në fund të vitit 2012, ky fond rezultoi në vlerën 3.888,5 milionë lekë ose në masën rreth 21.7% të normativës ligjore, vlerë e cila mbulon vetëm 65% të pagesave të pensioneve të një muaji. Ndërkohë, po t’i referohemi nenit 69 të këtij ligji, ku përcaktohet se fondi i pensioneve garantohet nga Buxheti i Shtetit, arrijmë në përfundimin se duhen bërë përmirësime ligjore lidhur me uljen e normativës ligjore, duke e reduktuar atë për mbulimin të paktën vetëm të një muaji pagesash, pasi krijimi dhe mbajtja e një rezerve 3-mujore në vlerë shumë të madhe, madje dhe investimi i tyre në bono thesari është i pakuptimtë, në një kohë që dega e pensioneve planifikohet me defiçit që subvencionohet nga Buxheti i Shtetit, po kështu dhe emetimi i bonove të thesarit nga Qeveria për mbulimin e defiçitit, ka kosto të lartë që rëndon borxhin e Shtetit.

3.6.3 Mbi deficitin e skemës së sigurimeve shoqërore

Problemet e mësipërme dhe të tjera të konstatuara gjatë auditimit kanë ndikuar në përkeqësimin e rezultatit financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore, i cili për vitin 2012 paraqitet me humbje në shumën 928.1 milionë lekë, të cilat në veçanti ndikojnë direkt në thellimin e defiçitit të degës së pensioneve. Konstatohet se defiçiti i degës së pensioneve nga viti në vit është rritur me ritme të shpejta dhe vetëm për vitin 2012, krahasuar me PBB-në e këtij viti ai zë 1,49% të tij, ndërsa krahasuar me vitin 2009 ky defiçit është rritur me rreth 14.3 miliardë lekë. Për ndryshimin e kësaj gjendjeje, **kemi rekomanduar**

- *ISSH në bashkëpunim me MF dhe DPT të studjojnë dhe propozojnë një reformë të plotë për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore, që të mund të zgjidhen problemet lidhur me nivelin e personave të siguruar, sistemin e pensioneve, mënyrën dhe rregullat e indeksimit të pensioneve, si dhe skemat e veçanta shtetërore dhe suplementare të pensioneve etj.*

- *Për përmirësimin e gjendjes, kemi kërkuar marrjen e menjëhershme të një sërë masave organizative, të cilat të mundësonin zbutjen e evazionit fiskal që ka sjellë rritjen e defiçitit të skemës, rishikimin e formulës aktuale mbi kufizimet për pensionet maksimale, stimulimin e pjesëmarrjes në skemë të personave të vetëpunësuar etj.*

3.7 Mbi zbatimin e Buxhetit të Sigurimeve Shëndetësore

Nga auditimi i ushtruar në ISKSH mbi hartimin dhe zbatimin e buxhetit të vitit 2012, u konstatua se përgjithësisht nga të gjitha strukturat e këtij institucioni janë bërë përpjekje për ndjekjen dhe plotësimin e detyrave të përcaktuara për këtë vit. Por auditimi nxorri në pah edhe disa të metave dhe magësive. Auditimi i treguesve të buxhetit për Shërbimin Shëndetësor Parësor, të detajuar sipas rajoneve, konstatoi se *ekziston një shpërndarje dispropocionale midis ngarkesave dhe numrit të mjekëve të përgjithshëm e të familjes në raport me personelin infermier e ndihmës, si pasojë e mungesës së përcaktimit të kriterëve për këtë çështje, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe strukturave të tjera përgjegjëse.*

1. Raporti mjek i përgjithshëm ose i familjes me personelin ndihmës, ka luhatur të mëdha nga një Drejtori Rajonale e Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor DRSKS në tjetrën dhe brenda një DRSKSH-je, nga njëra Qendër Shëndetësore (QSH) në tjetrën. Kështu në shkallë vendi, numri i mjekëve të përgjithshëm e të familjes (MPF) gjithsej është 1684, kurse numri i personelit tjetër

arrin në 7353 punonjës gjithsej, ose i takon mesatarisht 4.37 punonjës të personelit mbështetës (PM) për 1 mjek të përgjithshëm e të familjes (MFP) ndërsa në shkallë DRSKSH-je, raporti i personelit tjetër ndaj numrit të MP në QSH luhatet ndjeshëm, nga niveli 3.4 (pra nën mesataren e vendit prej 4.37 PM/MPF) deri në 10.7 punonjës mbështetës për 1 mjek (d.m.th mbi 2 herë më të lartë se sa mesatarja e vendit). Për këtë, ***i kemi rekomanduar:***

- *ISKSH dhe Ministrisë së Shëndetësisë studimin dhe vlerësimin real të gjendjes, si dhe përcaktimin e kriterëve të zbatueshme për këtë çështje.*

2. Lidhur me mënyrën e llogaritjes dhe vlerësimit të kostos së shërbimit shëndetësor, në zbatim të VKM nr. 140, datë 17.02.2010 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor", me ndryshimet e mëvonshme, u konstatua se, Ministria e Shëndetësisë nuk ka përcaktuar dhe publikuar një udhëzim të veçantë për përcaktimin e "Standardeve të shërbimit spitalor", si bazë për llogaritjen e kostove të çdo shërbimi, detyrim që sipas VKM duhej përmblusur brenda vitit 2010, duke sjellë si pasojë që financimi i shërbimeve të kontraktuara të vijojë sipas buxhetit historik. Për këtë, ***i kemi rekomanduar***

- *Këshillit Administrativ të ISKSH të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë, përcaktimin e "standardeve të shërbimit spitalor" për çdo diagnozë të veçantë, që do të shërbejnë jo vetëm për disiplinimin e shërbimeve, por edhe trajtimin e të sëmurëve me medikamente sipas protokolleve të miratuara, si detyrim që buron nga VKM nr. 140, datë 17.02.2010 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor".*

Mungesa e standardeve të miratuara dhe protokolleve të mjekimit për çdo diagnozë spitalore, si dhe ndryshueshmëria e skemave të mjekimit kanë vështirësuar procesin e llogaritjes së kostove në shërbimin spitalor, për rrjedhojë, kostot e shërbimit për diagnoza dhe shërbime të njëjta, sipas rajoneve apo rretheve, rezultojnë me diferencë të konsiderueshme në Shërbimin Patologjik.

3.8 Mbi auditimin e investimeve dhe projekteve me financim të huaj

Në lidhje me auditimin e projekteve dhe investimeve me financim të huaj, theksojmë se për periudhën deri në muajin shtator të këtij viti janë realizuar 10 auditime, me periudhë auditimi nga fillimi i zbatimit të projektit. Këto auditime kanë mbuluar nivele fondesh të disbursuara për vitin buxhetor 2012 me rreth 51.5 milionë euro. Nga këto auditime të ligjshmërisë e rregullshmërisë financiare kanë rezultuar mangësi dhe probleme të shoqëruara me ***dëm ekonomik në shumën 103.3 milionë lekë***, kryesisht në zbatimin e kontratave për punime civile, mallra dhe shërbime, si dhe evazion fiskal si pasojë e mosderdhjes së detyrimeve të tatimit mbi të ardhurat nga kompanitë e huaja të konsulencës. Në mënyrë të përmbledhur, paraqesim problematikën kryesore të evidentuar:

Njësitë e Zbatimit të Projektit ose entet menaxhuese nuk kanë arritur të koordinojnë dhe të harmonizojnë veprimtarinë e tyre me institucionet e tjera shtetërore për të siguruar realizimin e parashikimit të disbursimeve, me qëllim shmangien e efekteve negative financiare në koston e projektit.

Paaftësia e Njësive të zbatimit për të nisur në afate dhe patur ecuri normale të projekteve sipas parashikimit në marrëveshje, ka sjellë si pasojë jo vetëm vonesa në realizimin e projekteve dhe komponentëve por edhe ulje të efektivitetit të synimeve të projektit për përfituesit e tyre.

Mungesa e monitorimit të veprimtarisë së mbikëqyrjes gjatë zbatimit të kontratave për punime civile, nga ana e Njësive të Zbatimit të Projektit, ka sjellë për pasojë dëme ekonomike për pagesa të punimeve të pakryera, ndryshime të specifikimeve të kontratës, cilësi që lë për të dëshiruar, përlllogaritje të gabuara etj., si dhe vonesa të pajustificuara në realizimin e tyre.

Parregullsi në paraqitjen e raporteve periodike mbi progresin e arritur ekonomik dhe financiar, si dhe programimi i aktiviteteve të projektit nga ana e konsulentit apo mbikëqyrësit kanë sjellë si pasojë vonesat në zbatimin e projekteve, si dhe mungesën analizës dhe evidentimit të përgjegjësive.

Njësitë e Zbatimit të Projekteve nuk janë treguar të kujdesshme në kërkesat për eliminimin e defekteve të shfaqura gjatë periudhës së garancisë së kontratave për punime civile në infrastrukturën rrugore të cilat nuk plotësojnë standardet teknike.

Drejtuesit e projekteve nuk shfaqen kërkuar për penalizimin e kontraktorëve të cilët nuk përmbushin në afat detyrimet kontraktuale për punime civile, mallra dhe shërbime, për shkak të paaftësive në bashkërendimin e punës tyre, duke u pajtuar me vonesa në përfundimin e zbatimit të projekteve.

Entet zbatuese të projekteve kanë shfaqur mangësi në planifikimin, sigurimin dhe saktësimin e fondeve të nevojshme lokal, taksës doganore dhe TVSH, duke reflektuar në menaxhimin joefektiv financiar të projekteve me financime të huaja.

Njësitë e zbatimit të Projekteve dhe institucioneve të tjera përgjegjëse vazhdojnë të mos e trajtojnë dokumentacionin e projekteve siç duhet të kenë mangësi në dokumentacionin e dosjeve të prokurimit dhe dosjeve të tjera teknike, ekonomike dhe financiare dhe deri në inventarizimin e tij.

Segmentet rrugore të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga FSHZH, nuk kanë kaluar akoma në inventarin e Autoritetit Rrugor Shqiptar, në përputhje me VKM nr. 184, datë 13.03.2012 “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKM nr. 405, datë 08.01.1996 “Për administrimin e rrjetit rrugor kombëtar dhe rrjetit rural”.

Për përmirësimin e gjendjes dhe mospërsëritjen në të ardhmen të mangësive dhe shkeljeve të sipërcituara, ***kemi rekomanduar për të 10 projektet e audituar gjithsej 88 masa organizative të ndryshme në varësi të problematikës së rezultuar dhe fushës së zbatimit të projektit; krahas tyre është kërkuar marrja e masave për shpërblimin e dëmit në 31 raste në shumën 510,096 euro, 161,228 USD ose 103,3 milionë lekë gjithsej.*** Gjithashtu, KLSH ka kërkuar ndëshkimin i personave dhe subjekteve përgjegjës për mangësitë dhe problematikën e evidentuar gjatë auditimit të projekteve me financim të huaj me masa disiplinore që nga largim nga puna dhe deri tek vërejtje me shkrim, për drejtues projektesh dhe deri nëpunës të thjeshtë, si dhe me masa administrative.

3.9 Mbi auditimin e shoqërive aksionere

Auditimi i kryer në 9 shoqëri aksionere ka identifikuar mjaft të meta dhe parregullsi në menaxhimin e tyre, madje dhe shkelje të ligjshmërisë me pasojë ***dëm ekonomik në fushën e shpenzimeve në vlerën rreth 524.1 milionë lekë, nga i cili vlera prej 447.3 milionë lekë i përket dëmit ekonomik të konstatuar në Albpetrol. Sha.***

Gjatë auditimit të ushtruar në vitin 2013, në këto shoqëri aksionere, janë evidentuar problematika të lidhura me:

Dokumentacioni ligjor i shoqërive publike (Statut, rregullore e brendshme, kontrata kolektive dhe individuale të punës, dokumentet e regjistrimit etj.) nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi;

Këshillat Mbikëqyrëse përgjithësisht nuk kanë përbërjen e duhur, konform përcaktimeve në udhëzimet përkatëse duke patur si pasojë shpesh herë vendime të nxituara dhe të pabazuara ligjërisht, madje të shoqëruara me efekte financiare në dëm të personit juridik publik. Funksionimi i këtyre për të dëshiruar sidomos lidhur me analizat periodikike mbi aktivitetin e shoqërisë apo raportimin në institucionet përkatëse;

Drejtori dhe/ose Drejtoritë nuk përmbushin kërkesat për hartimin e programeve ekonomiko-financiare të shoqërisë, nuk raportojnë periodikisht në institucionet e prapë, marrin vendime duke anashkaluar Këshillat Mbikëqyrëse, nuk mbajnë përgjegjësi për mosrealizimin e treguesve ekonomiko-financiar dhe pasojat e menaxhimit jo të mirë të shoqërisë.

Në fushën e menaxhimit financiar vërehen abuzime në shpenzimet për personelin, mungesë të dokumentacionit justifikues në kryerjen e pagesave me arkë dhe bankë, dhënie sponsorizimesh të pabazuara ligjërisht, shpenzime për telefonat celular në kundërshtim me legjislacionin, abuzime në përdorimin e kursit të këmbimit të valutës, dhënie pa kriter të paradhënies, mosshlyerje në afat të detyrimeve të ndryshme, dhënie shpërblim në fund të vitit për punonjësit e shoqërisë edhe në rastet kur shoqëria ka rezultuar me humbje; mangësi në dokumentet justifikues për shpenzimet e karburantit dhe pagesat për udhëtim e dieta; probleme në procesin e rivlerësimit të aseteve të shoqërisë, mungesë transparence gjatë rekrutimit të stafit dhe mosplotësim të dosjeve të personelit;

Në fushën e prokurimeve publike, mospërcaktimi i saktë i vlerës limit të kontratës; hartimi i dokumentacionit në kundërshtim me dispozitat ligjore të fushës, zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me hapat proceduriale të përcaktuara nga ligji i prokurimit publik, me rregullat e prokurimeve, DST dhe urdhrat, udhëzimet dhe shkresat e dala nga institucionet që administrojnë procesin e prokurimeve publike, shqyrtimi me mangësi i ofertave të operatorëve ekonomik nga KVO-të, moszbatim të kriterëve ligjore lidhur me trajtimin e ofertave anomalisht të ulta; mosrespektim të afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave dhe zvarritje, në ndonjë rast dhe anulim të procedurave pa argumente të forta ekonomike etj.

Mangësi të theksuara në menaxhimin e kontratave të lidhura, dhënie me qira të objekteve pronë e shoqërive, duke favorizuar subjekte private dhe duke cënuar interesat e shoqërisë etj.

Për përmirësimin e gjendjes, **kemi rekomanduar që:**

- **Shoqëritë aksionere të audituara, METE dhe ministritë respektive**, të marrin masa të menjëhershme për mënjanimin e shkeljeve të disiplinës financiare në fushën e pagave dhe shpërblimeve, nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës dhe pagat; madje, nisur nga aktet e shumta ligjore e nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e pagave, vështirësitë në zbatimin e tyre dhe hapësirat e mundshme që ekzistojnë për interpretim apo keqinterpretim,

- **kemi rekomanduar kryerjen me doemos të një studimi për dhënien e një zgjidhjeje të plotë dhe përfundimtare problemit të pagave dhe të shpërblimeve në shoqëritë publike.**

- **Ministritë e linjës dhe METE** të krijojnë linja të llogaridhënies, të monitorojnë këshillat mbikëqyrëse dhe menaxherët ekzekutiv dhe të kërkojnë prej tyre llogaridhënie, të angazhohet në rolin e pronarit në një mënyrë tjetër duke rritur parakushtet më të mira të mundshme për shoqërinë, të emërojnë menaxherë më të mirë ekzekutiv, madje, METE të analizojë arsyet për mangësitë në shërbimet ndaj qytetarit, të zhvillojë strategji të qarta lidhur me përmirësimin e gjendjes aktuale të shoqërive aksionare; të rishikojë strukturën ligjore të tyre dhe të nxjerrë të gjitha modelet e rregulloreve të cilat do të ndihmojnë funksionimin e tyre përfshirë funksionimin e shoqërive; menaxhimin e pasurive dhe trajtimin e kërkesave të arkëtueshme; raportimin e duhur etj.

- **Ritmi i privatizimit duhet të jetë më i shpejtë dhe i saktë për të siguruar objektivat e vëna, duke i kushtuar vëmendje forcimit të mjedisit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm si një bazë për një menaxhim të shëndoshë dhe efikas të procesit të privatizimit. Për pasuritë strategjike si nafta, privatizimi duhet të orientohet drejt partnerëve gjeostrategjikë të Shqipërisë dhe Kombit Shqiptar.**

1. Problematika e shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Fier. Edhe në auditimin e përfunduar dhe sapo evaduar në ditët e para të muajit shtator 2013, përsëri janë evidentuar mjaft parregullsi dhe

shkelje të legjislacionit me pasojë dëm ekonomik, për mënjanimin e të cilave kemi bërë rekomandimet përkatëse. Me konkretisht, *KLSH ka kërkuar arkëtimin në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative të vlerës **prej 5,374 milionë lekë që Shoqëria “Armo” sh.a. Fier, i ka shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Fier** (detyrim ky i konstatuar dhe lënë detyrë për arkëtim në **auditimin e mëparshëm të KLSH**). Madje, për këtë detyrim, është bërë kërkesë padi në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 25/06/2013, me paditës shoqëria “Albpetrol” sh.a. Fier dhe i paditur Shoqëria “Armo” sh.a. Fier. Gjithashtu, është kërkuar në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, arkëtimi i vlerës **prej 2,198 milionë lekë për shlyerjen e detyrimit të furnizimit me 42,302.12 tonë naftë dhe 6,491,741 MN m3 gaz, nga 3 (tre) kompani që operojnë në fushën e naftës dhe të gazit.** *Krahas sa më sipër KLSH gjatë auditimit ka konstatuar një dëm ekonomik në fushën e shpërblimeve në vlerën rreth 447 milione lekë.**

2. Për koncesionet në fushën e bakrit, kromit dhe energjetikës. Auditimi i koncesioneve në fushën e bakrit kromit dhe energjitikes nga KLSH ka filluar që nga muaji qershor 2013, me qëllim që rezultatet e auditimit t’i raportojmë në Tetor në Kuvend. Ky auditim nuk është përfunduar, pasi për një periudhë prej një muaj e gjysem grupi i auditimit është penguar të realizojë misionin e tij nga ish Sekretari i Përgjithshëm Dardan Domi. Falë ndërhyrjes së ish ministrit, aktualisht Deputet i Kuvendit z. Florjon Mima, kjo situatë jo normale u kalua dhe po vazhdon në vijimësi puna audituese. Brenda vitit 2013, Komisioni i Ekonomisë do të informohet për rezultatet përfundimtare të këtij auditimi.

3. Mbi garancinë e ofertës në privatizimin e shoqërisë “Albpetrol” sh.a., Patos”. Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, në bazë të programit të auditimit nr. 478/1, datë 29.05.2013, me ndryshime të miratuar nga Kryetari i KLSH-së me objekt: “Auditim mbi ecurinë e arkëtimit të garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “Vetro Energy PTE Ltd” për privatizimin e shoqërisë “Albpetrol”sha, Patos”, rezultoi se:

Garancia e ofertës që duhej të tërhiqej në rastin e një kandidati fitues, kur ai nuk arrin, që brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat standarte të tenderit të nënshkruajë marrëveshjen ose të dorëzojë garancinë e kontratës, të kërkuar nga marrëveshja nuk është bërë e mundur të realizohet. Garancia e ofertës ishte 10% të çmimit total, që kandidati fitues ofroi për blerjen e aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sha, pra 85.000.000 Euro. Auditimi konstatoi se kompania “Vetro Energy PTE Ltd.” ka sjellë një garanci oferte në shumën 85.000.000 Euro lëshuar nga American Chartered Bank, që nuk përfshihet në 50 bankat kryesore të botës (sipas kushteve të kërkuara në tender).

Duke qënë se nuk u arrit, nga kandidati fitues, që brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat standarte të tenderit të nënshkruajë marrëveshja, garancia e ofertës duhej të ishte arkëtuar në buxhetin e shtetit. Nga ana e METE janë bërë komunikime elektronike për procesin dhe garancinë e ofertës, por edhe pas mbylljes së procedurave të privatizimit e deri më tani nuk është arkëtuar garancia bankare në **shumën 85.000.000 euro, ose rreth 11.9 miliardë lekë, duke i shkaktuar dëm ekonomik Buxhetit të Shtetit në këtë shumë.**

Arkëtimi i kësaj shume duhet të vazhdojë të ndiqet me përparësi nga të gjithë institucionet përgjegjëse shtetërore duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet referuar kuadrit regullator vendas e të huaj.

3.10 Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin, si dhe performancën e auditimit të brendshëm në sektorin publik.

3.11.1 Mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në lidhje me zbatimin në praktikë të Ligjit nr. 10296, datë 8/7/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, gjatë auditimit të kryer në njësitë shpenzuese janë konstatuar mjaft probleme të cilat po i rendisim më poshtë:

1. Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Financave për periudhën objekt auditimi, ka zbatuar rregullat e përcaktuara në **Ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”**, por nga zbatimi në praktikë i këtij ligji konstatohet se ka mjaft probleme që lidhen me menaxhimin financiar të fondeve publike dokumentimin e veprimeve ekonomike, me mbajtjen e kontabilitetit, me caktimin e nëpunësit zbatues të njësive publike, me përcaktimin e përgjegjësive materiale të punonjësve që shkaktojnë dëme ekonomike, me sanksionet që duhen aplikuar për parregullsitë financiare të konstatuara etj. Bazuar në sa më sipër, kemi rekomanduar që:

- *Ministria e Financave të ndërmarrë procedurat e duhura ligjore për përmirësimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në drejtimet e mëposhtme:*

1-*Nëpunësit zbatues të cilët kryejnë funksionet e punonjësve të nivelit të lartë të menaxhimit të njësive publike dhe që janë drejtuesit e Financave të katër njësive duhet të disponojnë diplomë “në shkencat ekonomike për kontabilitet dhe financë” dhe të shfuqizohet përcaktimi që këta punonjës të jenë “me diplomë universitare në shkencat ekonomike ose juridike...”. Funksionet që mbulojnë drejtuesit e financave si : funksioni i planifikimit, monitorimit, zbatimit të buxhetit, kontabilitetin dhe përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore të njësive nuk përputhet me kriterin e arsimimit “Diplomë Juridike”.*

2- *Të përcaktohet përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.*

3-*Të standardizohen programet kompjuterike të certifikuara, që duhet të përdorin të gjitha njësive të qeverisjes së përgjithshme për mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e pasqyrave financiare etj.*

Në përgjigjen e Ministrisë së Financave dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 cilësohet: *I konsiderojmë shumë të rëndësishme propozimet e KLSH për fuqizimin e Ligjit bazë të financave publike dhe ndryshimet e propozuara nga KLSH në Ligjin e Menaxhimit Financiar dhe udhëzimet e dala në zbatim të tij (përfshi udhëzimin e menaxhimit të aktiveve). Keto do të diskutohen me Komisionin Europian dhe MoF Austriake dhe Franceze në kuadrin e implementimit të projektit IPA 2012, që do të nisë në Janar 2014 dhe ku është parashikuar rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues.*

2. Duke marrë shkas nga konstatimi se rreth 20% e nëpunësve zbatues të Njësive të qeverisjes së përgjithshme nuk përmbushin kriteret e kuadrit rregullator (arsimimi dhe linjat e raportimit) dhe meqenëse njësive publike në reflektim të rekomandimit të lënë nga KLSH, ju la afati kohor 3 muaj (nga data e marrjes së shkresës së MF) për rregullimin e situatës, por në asnjë rast nuk u krye bllokimi i veprimeve në Thesar, **kemi rekomanduar që:**

- *Për të gjitha rastet e konstatimit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara, të njoftohen titullarët e njësive shpenzuese që të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e procedurave për emërimin e nëpunësve zbatues sipas kriterëve ligjore në rast të kundërt të fillojnë procedurat, të bllokohen veprimet në Thesar të katër punonjësve, pasi ushtrojnë funksione në statusin e punonjësve të cilët nuk përmbushin kriteret ligjore.*

Në përgjigjen e Ministrisë së Financave dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 cilësohet: Në lidhje me zbatimin e rekomandimit, do të merren masat me procedim, me qëllim zbatimin e këtij rekomandim.

3.11.2 Mbi performancën e auditimit të brendshëm

Duke e konsideruar auditimin e brendshëm një mjet shumë të rëndësishëm në ndihmë të një qeverisje sa më të mirë, i kemi ka kushtuar një vëmendje të madhe vlerësimit të veprimtarisë të strukturave të auditimit të dhe masave që duhen marrë për rritjen e rolit të tyre në institucionet publike, në funksion të realizimit të objektivave.

1. Auditimi konstatoi se, pavarësisht kritereve të përcaktuara në VKM nr. 212, datë 30.03.2012 “Për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm”, në këtë vendim, nuk janë përcaktuar kritere të matshme për ngritjen e këtyre njësive në raport me rëndësinë dhe madhësinë sipas llojeve të institucionit, fondet buxhetore që menaxhojnë këto institucione etj. Bazuar në këtë, kemi rekomanduar:

- *Njësia Qëndrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm NJQHAB të nisë procedurat ligjore për përmirësimin e VKM nr. 212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”, me qëllim përcaktimin e kritereve të matshme për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm dhe strukturën e tyre në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Këto kritere duhet të vendosen duke mbajtur parasysh rëndësinë, madhësinë, strukturat vartëse, treguesit vjetorë buxhetorë, numrin e punonjësve të punësuar në këto njësi dhe tregues të tjerë, të cilët të vlerësuar në kompleks janë elementë që shërbejnë për të përcaktuar ngritjen e një strukture auditimi dhe nivelin e saj.*

Në përgjigjen e Ministrisë së Financave dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 cilësohet: “NjQH/AB do kërkoë miratimin e urdhërit dhe ngritjen e grupit të punës për të përmirësuar VKM 212, datë 30.03.2012, “Për miratimin e kritereve për ngritjen e Njësive të AB në sektorin publik”..... Përmirësimi do të konsistojë në vendosjen dhe përcaktimin e kritereve të matshme për ngritjen e NjAB në institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale të lidhura me treguesit buxhetorë, mënyrën e organizimit operacional dhe funksional, vartësinë, nr e punonjësve, etj..”.

2. Nga auditimi në drejtim të përbërjes profesionale të stafit auditues u konstatua se, nga 391 punonjës auditues që janë të punësuar në fund të vitit 2012, 330 prej tyre ose 84% janë specialistët të fushave ekonomike, 42 auditues janë të profesionit juristë ose 11% e tyre dhe vetëm 19 auditues ose 5%, u përkasin specialiteteve të tjera teknike. Nga shqyrtimi i të dhënave që kanë paraqitur njësitë e AB në NJQH/AB rezulton se, nga njësitë audituese janë rekrutuar edhe punonjës me profesione që nuk përshtaten me vendin e punës, si ing.mekanik, zooteknikë, mësues edukimi fizik, gjuhë letërsi, punë sociale, ushtarakë, ing.gjeolog dhe agronomi, konkretisht: Në NJQH/AB në Ministrinë e Financave me profesion zooteknik dhe ing.mekanik, SAB në Ministrinë e Shëndetësisë auditues me arsim edukim fizik, në METE auditues me arsim gjuhë letërsi, ISSH auditues me profesion ushtarak etj. Këto emëtime bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010. Sipas të dhënave që kanë raportuar SAB në NJQH/AB, në fund të vitit 2012 në këto struktura ishin të punësuar si auditues të brendshëm 71 punonjës të paçertifikuar. Për shkak të problematikave të konstatuara në disa njësi të auditimit të brendshëm por dhe duke e konsideruar me rëndësi rekrutimin e audituesve të sektorit publik lidhur me plotësimin me sukses të misionit të tyre në përmirësimin e sistemeve të drejtimit dhe të kontrollit **kemi rekomaduar që:**

- *NJQHAB të ndërmarrë iniciativën e duhur ligjore për hartimin dhe miratimin nga Ministri i Financave të një udhëzimi, në të cilën të përcaktohen a) kriteret e punësimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, duke specifikuar në mënyrë të veçantë rastet tepër të rralla, kur në*

këto struktura do të punësohen punonjës të profesioneve të tjera jashtë përcaktimit kryesor ekonomist dhe jurist, b) prioritetin që duhet të kenë personat e certifikuar si auditues të brendshëm publik nga NJQH/AB, për t'u punësuar si auditues i brendshëm c) rastet kur nuk është e mundur rekrutimi i personave të certifikuar, të përcaktohet detyrimi i certifikimit të tyre jo më vonë se dy vjet nga data e punësimit në këto struktura d) përgjegjësia që NJQH/AB ka në monitorimin e punësimit të audituesve në SAB, dhe detyrimin e raportimit periodik tek ministri për zbatimin e këtij udhëzimi si dhe krijimin i rregjistrimit kombëtar të audituesve të sektorit publik të punësuar.

Në përgjigjen e Ministrise së Financave dërguar me shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013 cilësohet: “NjQH/AB do kërkojë miratimin e urdhërit dhe ngritjen e grupit të punës për hartimin udhëzimit lidhur me përcaktimin e kriterëve më të detajuara dhe më të hollësishme lidhur me punësimin e AB me profesion të ndryshëm nga ekonomistë dhe juristë referuar nenit 19 të Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm..”.

Për mënjanimin e të metave dhe mangësive të konstatuara në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe në organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm, KLSH i ka dërguar MF-ve dhe njësisve shpenzuese të audituara një sërë rekomandimesh të karakterit organizativ, një pjesë e mirë e të cilave kërkojnë programimin e masave apo detyrave dhe zbatimin e menjëhershëm të tyre.

3.12 Mbi disa gjetje dhe konstatime të detyrimeve ndaj të tretëve që KLSH ka evidentuar gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese.

KLSH gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese është fokusuar në evidentimin e mënyrës së buxhetimit të punëve, mallrave dhe shërbimeve, duke e parë këtë si shkak të rritjes së detyrimeve të Buxhetit të Shtetit ndaj operatorëve ekonomikë. Në raportin që KLSH paraqiti në Kuvend “Për zbatimin e Buxhetit të Shtetit të vitit 2011” ka trajtuar fenomenin e detyrimeve të buxhetit të shtetit ndaj kontraktorëve dhe ka rekomanduar: “Në kushtet aktuale sugjerojmë saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së këtyre borxheve, përcaktimi i masave për t’i dhënë mundësi dhe për të lehtësuar sa të jetë e mundur kompanitë private nga kosto e kredive që ato mund të kenë marrë për përmirësimin e situatës së tyre financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për ristrukturimin e kredive dhe ndërkohë mbledhjen e borxheve të këqija. Gjithashtu duhet kërkuar nga sistemi bankar të inkurajojë dhënien e kredive. Madje, vlen të përmendet fakti se disa sipërmarrje private po marrin kredi informale, veprim i cili ka pasojë të dëmshme për ekonominë dhe vetë biznesi.

Edhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë për vitin 2012, KLSH ka patur në qendër të vëmëndjes evidentimin e këtij problemi dhe dhënjen e rekomandimeve për eliminimin e këtij fenomeni në drejtimit e mëposhtme:

1. Veprime të shpejta operative nga Ministria e Financave **për evidentimin (inventarizimin)** e këtyre detyrimeve.
2. Përcaktimin e **përdorimit të të ardhurave të privatizimit** për mbylljen e këtyre detyrimeve.
3. Marrjen e masave për regjistrimin në sistemin e thesarit kontratat në shtrirje sipas viteve të parashikuara për financimin e tyre”. Ky rregjistrim jo vetëm do të sigurojë informacion të drejtë dhe të plotë për angazhimet financiare bazuar në kontratat shumëvjeçare, por do të mundësojë përdorimin e këtij informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit për nevojat e planifikimit të PBA-së.

Në vite kemi evidentuar problemin e **financimit** të kontratave të lidhura në mënyrë pjesore, hapjen e projekteve të reja pa mbyllur ato në vazhdim duke nxjerrë në pah problematikat që kanë

të bëjnë më shtimin gjithmonë e më shumë të detyrimeve të Buxhetit të Shtetit ndaj palëve të treta.

Më poshte po japim disa argumente me shifra referuar gjëndjes së konstatuar nga auditimi në disa institucione buxhetore:

1. KLSH ka ushtruar auditim në Autoritetin Rrugor Shqipar të kryer sipas Programit të Auditimit nr nr.1107/1, datë 30.09.2012, për periudhën e auditimit 01.01.2012 deri më 31.10.2012. Nga auditimi ka rezultuar **se deri më datë 31.10.2012**, për 95 kontrata të lidhura, të cilat datojnë që nga viti 2007 e në vazhdim, në vlerë totale në rreth prej 53,8 miliardë lekë janë paraqitur për financim për punime të kryera në vlerë të përgjithshme rreth 37 miliardë leke dhe janë financuar deri më 31.10.2012 gjithsej rreth 21,8 miliardë lekë, me një detyrim për financim ndaj sipërmarrësve për punime të kryera në vlerë rreth **15,2 miliardë lekë** dhe me një detyrim kontraktual që përfaqëson punime të papërfunduara dhe të përfunduara, në shumën rreth **32 miliardë lekë**. Ky detyrim për financim të punimeve të kryera, ka ardhur duke u rritur në masën rreth **3,3 miliardë lekë** krahasuar me detyrimin sipas Raportit Përfundimtar të auditimit të mëparshëm të kryer nga KLSH me periudhë auditimi deri më 31.12.2011, i cili ka qenë në shumën rreth **11,8 miliardë lekë**.

Vlen të theksohet se në disa objekte edhe pse punimet **kanë përfunduar**, sipërmarrësve nuk u është shlyer detyrimi nga ARRSH-ja, e konkretisht në 39 objekte me vlerë kontraktuale rreth 15,4 miliardë lekë janë situacionuar rreth 15,1 miliardë lekë dhe janë financuar gjithsej rreth 10,8 miliardë lekë dhe **vlera e mbetur për financim është rreth 4,3 miliardë lekë**. Theksojmë se për muajt pas auditimit tonë nuk kemi të dhëna se çfarë punimesh të situacionuara apo faturash janë shlyer nga Buxheti i Shtetit.

Ky detyrim, në vlerë të konsiderueshme për buxhetin e shtetit është krijuar nga prokurimi i fondeve për projektet e infrastrukturës rrugore me vlerën e plotë të tyre, por i pa shoqëruar me financimin pjesor (vjetor) nga buxheti i shtetit për të mbuluar punimet e kryera në përputhje me grafikun e punimeve të përcaktuar në kontratat e lidhura, të cilat janë në vlerë të plotë të realizimit të objekteve dhe në to nuk është parashikuar mënyra e kryerjes së pagesave e shtrirë në disa vite buxhetore në varësi të fondit që do të çelet, pavarësisht realizimit të grafikut të punimeve.

Edhe pse një pjesë e sipërmarrësve të punimeve i kanë realizuar punimet sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratat e lidhura, ARRSH dhe MPPT, në buxhetet e tyre nuk kanë parashikuar fondet e nevojshme për mbulimin e këtyre punimeve.

Megjithëse prokurimi i fondeve për projektet e infrastrukturës rrugore në vlerën e plotë të tyre vlerësohet pozitivisht, fakti që nuk bëhet financimi në kohë i punimeve të kryera në përputhje me grafikun e punimeve të përcaktuar në kontratat e lidhura, ndikon negativisht në:


1. Zgjatjen e zbatimit të objektit tej afateve të përcaktuara në kontratat e lidhura, pasi për ato objekte të cilat janë kryer, një pjesë e punimeve duhet të presin vitet e ardhshme buxhetore për t'u financuar, ndërkohë që për mungesë të fondeve sipërmarrësit nuk avancojnë në punime sipas grafikut ;
2. Rritjen e detyrimeve ndaj këtyre sipërmarrësve, pasi për vlerën e punimeve të kryera dhe të pa likuiduara, atyre u lind e drejta sipas përcaktimeve në kontratat e lidhura të kërkojnë penalitetet për vonesa në likuidim;
3. Në planifikimin e fondeve buxhetore, pasi detyrimet e mbartura nga viti në vit rriten në shuma të konsiderueshme dhe krijojnë vështirësi për t'u paguar njëherësh nga buxheti i shtetit, si dhe rritja e detyrimeve mund të sjellë rritje të kostos së borxhit të brendshëm të shtetit ;
4. Krijimin e premisave për evazion fiskal në rastin kur sipërmarrësit avancojnë me punime dhe nuk dorëzojnë situacione për shkak të mosfinancimit të tyre ;

5. Braktisjen e punimeve nga shoqëritë sipërmarrëse për shkak të mosfinancimit të tyre në kohë
6. Investimet e kryera, të situacionuara dhe të marra në dorëzim nuk evidentoheshin në pasqyrat financiare të ARRSH.

Sa më sipër, me shkresën nr 1107/6 datë 15.02.2013 kemi dërguar rekomandime ARRSH-së për marrjen e masave me synim përmirësimin e gjëndjes dhe konkretisht:

- Për njohjen dhe pasqyrimin e detyrimit prej 15 160 milionë lekë , të kontabilizohen në pasqyrat financiare të ARRSH, vlerat e palikujduara të situacioneve të paraqitura nga sipërmarrësit për punime të kryera, me qëllim identifikimin, evidentimin dhe rregjistrimin e këtyre detyrimeve në sistemin e thesarit
- Të planifikohen për financim dhe të financohen “në radhë të parë” të gjitha punimet e realizuara dhe të pafinancuara, me qëllim minimizimin e detyrimeve dhe borxhit të krijuar kundrejt kontraktorëve ndër vite.
- Të bëhet me dije Ministria e Financave në lidhje me detyrimin e mbetur për financim ndaj sipërmarrësve për punime të kryera.

2. Në auditimin e realizuar në QSUT, u konstatuan detyrime të prapambetura lidhur me furnizimet dhe shërbimet të cilat nga viti në vit krijojnë një borxh me trend në rritje, **ndërkohë që buxheti vjetor pothuajse është në nivelet e këtij borxhi.** Bazuar në bilancet kontabël të QSUT-së, rezultojnë se në fund të vitit 2010 ky borxh ishte në shumën 1,046.3 milionë lekë, në fund të vitit 2011 ky nivel borxhi arriti në rreth 1,564 milionë lekë ndërsa në fund të vitit 2012 rezultoi në rreth 2,295 milionë lekë.



Burimi: Pasqyrat financiare QSUT

Një mënyrë e tillë e menaxhimit të fondeve në kushtet e pamjaftueshmërisë së tyre, përveç të tjerash, sjell edhe kryerjen e likuidimeve ndaj operatorëve privatë në mënyrë selektive, për rrjedhojë rezultojnë operatorë me detyrime të pashlyera që nga vitit 2008 e në vijim. Nga ana tjetër, kontratat e lidhura me operatorët ekonomikë përmbajnë edhe sanksionet të cilat Shteti duhet të paguajë ndaj operatorëve ekonomikë, në rastet kur autoriteti kontraktor nuk paguan në kohë detyrimet, gjë e cila nuk është zbatuar. **Sa më sipër, me shkresën nr 1241/7 datë 15.05.2013, kemi rekomanduar në QSUT:**

- Me synim uljen e nivelit të borxhit i cili nga viti në vit ka rezultuar me një tendencë në rritje, nga ana e strukturave të QSUT-së në bashkëpunim dhe me Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të analizohet gjendja e borxhit, të përcaktohet një plan masash, të cilat do të synojnë dhënien e rrugëzgjidhjeve për alokimin e fondeve me prioritet shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe uljen e borxhit të trashëguar. Gjendja e krijuar si dhe plani i masave t'i paraqitet për shqyrtim Bordit Drejtues, i cili është organi më i lartë i drejtimit të QSUT-se dhe që kryesohet nga Ministri i Shëndetësisë.

- *Me qëllim shmangjen e fenomenit të kryerjes së likuidimeve selektive, preferenciale apo klienteliste, të përcaktohen kriteret të cilat do të jenë referuese për likuidimin e kontratave ndaj operatorëve ekonomikë.*

Në përfundim theksojmë se: Meqenëse në Raportin e projektligjit “Për buxhetin faktik të vitit 2012” të Ministrisë së Financave zyrtarizuar me VKM nr 506 datë 13.06.20113 “Për propozimin e projektligjit “Për buxhetin e shtetit faktik të vitit 2012 “ nuk është trajtuar çështja e detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta rekomandojmë që në periudhat në vijim të trajtohen në “Raportin e buxhetit faktik” në një kapitull të veçantë

3.13 Mbi problematikën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore

Gjatë auditimeve në disa ministri, institucione të tjera qendrore dhe vendore, kemi konstatuar pagesa të detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë për kthimin e nëpunësve civilë në vendin e punës me impakte negative financiare të konsiderueshme. Përmendim pagesat e vendimeve gjyqësore të rezultuara në Ministri / institucione të cilët kanë paguar **32 milionë lekë** për largimin padrejtësisht nga puna në kundërshtim me kërkesat e Kodit të Punës dhe të Statusit të Nëpunësit Civil të 69 punonjësve të cilëve këto institucione u detyrohen sipas vendimeve të Gjykatave, për **82.3 milionë lekë**. Sa më sipër argumentojmë MPCSSHB ka kryer pagesa në shumën **10.2 milionë lekë**, Ministria e Shëndetësisë në shumën **5.2 milionë lekë**, Ministria e Integritimit në shumën **3.6 milionë lekë**, Ministria e Financave në shumën **7.4 milionë lekë**, QSUT-ja në shumën **2.4 milionë lekë** etj.

Në të gjitha rastet, në institucionet respektive kemi rekomanduar të marrin masa për zbatimin e vendimeve gjyqësore, njëkohësisht të analizojnë gjendjen dhe të përcaktojnë përgjegjësinë ndaj personave shkaktarë përgjegjës, duke kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik shkaktuar Buxhetit të Shtetit. Nga auditimi i kryer në DPT rezultoi problematika e pagesave për punonjësit e larguar nga puna në bazë të vendimeve të Gjykatave dhe të K.SH.C për vitin 2012, të paguara pjesërisht ose plotësisht për 84 persona. Kështu, rezultojnë vendime me rikthim në pozicionin e mëparshëm 32 persona për vlerën 22,069,279 lekë, vendime vetëm për dëmshpërblim 46 persona për 10,396,110 lekë, persona dhe vendime me rikthim në pozicionin e mëparshëm por që janë dorëhequr nga pozicioni i punës për 6 persona si dhe shpenzime gjyqësore për shumën 1,083,760 lekë. Në fund të vitit 2012 rezulton të jetë një detyrim i pashlyer për shumën 167,922,788 lekë ose **167 milionë lekë efekt negativ në fondet buxhetore.**

3.14 Mbi sanksionimin me akt rregullator të ndalimit të dhënies me qira të ambienteve dhe territoreve të institucioneve shëndetësore spitalore për ushtrimin e vepimtarive të biznesit.

Nga auditimi i ushtruar në QSUT ka rezultuar dhënia me qira e ambienteve dhe territoreve spitalore **për qëllime biznesi** si lavazh, fast food, bar-kafe, restorante etj., 40 subjekteve të cilët ushtrojnë aktivitetin në rreth 5000 m². Në këtë llogaritje nuk janë përfshirë edhe subjekte të tjerë që ushtrojnë aktivitete të karakterit ambulator, të cilët janë të shumtë në numër dhe tregtojnë jashtë kushteve higjieno- sanitare. Marrë shkas sa më sipër dhe referuar faktit se:

a) kuadri rregullator ekzistues nuk përmban ndonjë kufizim apo limitim në drejtim të numrit të subjekteve apo sipërfaqeve të ambienteve dhe territoreve spitalore me qira në përdorim për qëllime biznesi;

b) ky fenomen sa vjen dhe po "**gangrenizohet**", duke rezultuar me rritjen e numrit të bizneseve nga viti në vit, duke shfrytëzuar për këtë qëllim edhe ambientet e brendshme spitalore

c) në praktikat dhe eksperiencat ndërkombëtare në lidhje me trajtimin e ambienteve dhe territoreve spitalore **një fenomen i tillë është i ndaluar**; si dhe

Me synim, arrijen e standardeve ndërkombëtare për implementimin e një shërbimi shëndetësor bashkëkohor, me shkresën nr 1241/8 date 15.05.2013 dhe shkresën nr 1241/3 date 17.05.2013 i kemi kërkuar, Ministrin të Shëndetësisë dhe Drejtorin të Përgjithshëm të QSUT-së :

1. Nxjerrjen e një Vendimi të Këshillit të Ministrave, **i cili të sanksionojë ndalimin e dhënies me qira** të ambienteve dhe territoreve të institucioneve shëndetësore spitalore për ushtrimin e veprimtarive të biznesit. Projekt vendimi duhet të përgatitet nga Ministria e Shëndetësisë në bashkëpunim me QSUT-në.

2. Në këtë projektvendim të parashikohet një dispozitë kalimtare në të cilën të përcaktohet që nga ana e QSUT-së dhe Drejtoritë Rajonale Spitalore në rrethe, të evidentohen dhe të shqyrtohen të gjitha veprimtaritë e subjekteve e të bizneseve **dhe të merren masa të menjëhershme**, të cilat të synojnë shndërrimin e këtyre ambienteve nga ambiente biznesi në ambiente të gjelbërta, në shërbim të pacienteve.

3.15 Mbi tregun informal të punës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën 01.01.2012 – 31.03. 2013 ka audituar “Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Drejtorin Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë e cila ka numrin më të madh të subjekteve që zhvillojnë aktivitet në nivel kombëtar. Qëllimi i auditimit ISHPSHSH-së ishte vlerësimi i veprimtarisë së këtij Institucioni në luftën kundër informalitetit në punë. Kjo ka qenë e domosdoshme nisur edhe nga fakti se niveli i informalitetit në subjektet e inspektuara për çdo drejtori rajonale të ISHPSHSH paraqitet në nivele të ulëta cka nuk përputhet me realitetin. Në këtë kuadër është synuar të evidentohen masat dhe reagimi i ISHPSHSH ndaj këtij fenomeni aspak të pranueshëm.

Nga të dhënat zyrtare, të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, të raportuara në mënyrë periodike në Drejtorinë e Inspektimit të MPCSSHB dhe për çdo vit në Këshillin Kombëtar të Punës, rezulton se niveli i informalitetit paraqitet shumë i ulët. Kështu, sipas të dhënave, për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 informaliteti paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emertimi	2009	2010	2011	2012
1	Numri subjekteve të inspektuara privat	11.724	14642	13956	15961
2	Punëmarrës të evidentuar në sektorin privat	128.395	148179	137447	166593
3	Punëmarrës të pa deklaruar (ilegal) në tatime	3.085	1994	1434	1285
4	Shkalla e informalitetit	(2,4%)	(1.35%)	(1.04%)	(0,80%)

Burimi: Inspektoriati Shtetëror i Punës

Pra, siç del nga të dhënat e mësipërme, shkalla e informalitetit nga viti në vit ka ardhur duke u ulur, megjithëse **është rritur numri i subjekteve** të inspektuara dhe punëmarrësve të konstatuar. Nëse kjo do të ishte gjendja reale arrijet e Ministrisë Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Institucionit të varësisë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore do të ishin madhore, duke u renditur ndër vendet me informalitet më të ulët në botë. Nga të dhënat e cituara më sipër, **del qartë se ka një regres të dukshëm** në drejtim të luftës kundër informalitetit në tregun e punës, ku pasqyrimi i tij është jo real. Kjo gjendje ka sjellë pasoja në buxhetin e shtetit, pasi nga viti në vit janë rritur financimet për përballimin e fondit të pensioneve që ka ardhur si pasojë e prishjes së ekuilibrit të raportit kontribues- përfitues, i cili ka arritur në raportin 1 përfitues me 1 kontribues.

Nga analiza e strukturës së subjekteve të inspektuara nga Drejtoritë Rajonale të ISHP-së për vitin 2012 del se janë paraqitur me një numër të vogël punëmarrësish subjekte me aktivitet

prodhues, ku në disa raste figurojnë me 1 punëmarrës. Nga të dhënat e ISSH del se një numër i madh subjektësh të biznesit të madh paraqiteshin me një ose dy punëmarrës të cilët nuk figuronin në listat e subjekteve të vetdeklaruar në institucion.

U konstatua se inspektorët nuk njohin situatën e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e juridiksionit që mbulojnë, sipas ndarjes së zonave të miratuara nga Kryeinspektori, megjithëse sipas rregullores së brendshme kanë për detyrë të kryejë kompjuterizimin e subjekteve ekonomike që ushtrojnë aktivitet në zonën që kanë në juridiksion të kontrollit, duke krijuar bangën e të dhënave për çdo subjekt që i nënshtrohet inspektimit nga ana e tij. Mungesa e këtyre të dhënave në nivel kombëtar ka bërë që drejtorite rajonale operojnë në inspektime me një numër të vogël subjektësh. Kështu, sipas të dhënave të Inspektoratit Shtetëror të Punës, rezultojnë të jenë të vetë deklaruara në Drejtoritë Rajonale të ISHP-së, gjithsej 22.077 subjekte fizike dhe juridike, ndërsa sipas evidencës së ISSH, rezultojnë gjithsej 79.085 subjekte fizike dhe juridike. Pra, ISHP-ja ka 57.008 subjekte më pak se ISSH-ja. Si rezultat i mungesës së këtyre të dhënave, mbeten pa u inspektuar pjesa më e madhe e subjekteve, ku një pjesë e tyre ka problem me sigurinë në punë. Kjo situatë është krijuar nga mos zbatimi i VKM nr. 753, datë 08.09.2010 “Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me Institucionet në varësi të Ministrisë së Financave” Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku është përcaktuar që dy institucionet të shkëmbejnë informacione për subjektet e regjistruara pranë tyre.

Nga auditimi rezultoi se shkaqet që kanë sjellë këtë gjendje të rënduar janë të shumta por ai që predominon është pajtimi me gjendjen e krijuar i të gjitha strukturave drejtuese nga MPCSSHB, Këshilli Kombëtar i Punës ku bëjnë pjesë edhe përfaqësues të sindikatave.

Me situatën e krijuar janë pajtuar edhe strukturat drejtuese të Inspektoriatit Shtetëror të Punës, të cilat nuk po bëjnë sa duhet për të ndryshuar situatën duke vënë para përgjegjësisë strukturat drejtuese të drejtorive rajonale për indiferentizmin, fshehtësinë që tregojnë në luftën kundër informalitetit në tregun e punës. Për gjendjen e informalitetit kanë paraqitur shqetësim edhe organizmat ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore ku nga studimet e kryera informaliteti paraqitet në nivele të larta.

Në strukturat drejtuese të inspektoriatit të Punës në nivel qendror dhe lokal ekziston koncepti se lufta kundra informalitetit në punë është detyrë e organeve tatimore të cilët mbledhin kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për të ulur në minimum subjektivizmin e strukturave inspektuese duhet të praktikohen inspektime me grupe të përbashkëta ku të përfshihen struktura nga Inspektoriatit Shtetëror i Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektoriatit i Ndërtimit dhe veçanërisht nga strukturat e Institutit Sigurimeve Shoqërore i cili është përfituesi direkt nga minimizimi i punës së zezë i cili me legjislacionin **ekzistues është përjashtuar nga kjo e drejtë**.

Nga KLSH në përfundim të auditimit janë rekomanduar masa të cilat synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator për minimizimin e informalitetit në tregun e punës.

3.16. Mbi auditimet e performancës

“Auditimi i Performancës është një shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj, me fokus të veçantë ekonomikitetin dhe me synim përmirësimin”. Ky është përkufizimi i përgjithshëm që jep INTOSAI në standartet e veta 3000-3100, të cilat adresojnë pikërisht këtë lloj auditimi në nivel institucionesh supreme të auditimit. Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga legjislacioni dhe mund të kryhet për të gjithë spektrin e sektorit publik. Ai dallon nga auditetstandarte financiare dhe ato të ligjshmërisë, sepse është më fleksibël në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinionëve. Nga vetë natyra e tij, ky lloj auditimi ndërthur metodat investigative me ato shkencore të kërkimit dhe përpunimit të informacionit, operon mbi baza të larmishme dijesh dhe eksperiencash, është më i hapur ndaj

gjykimeve dhe interpretimeve dhe nuk kryhet sipas një protokollit standart paraprak. Është kusht vital për cilësinë e këtij lloji auditimi, që të aplikohen perspektiva të ndryshme e për rrjedhojë dhe audituesit duhet të vijnë nga sfera të ndryshme të aktivitetit njerëzor.

Funksioni i auditimit të performancës nga institucionet supreme të auditit nisi të aplikohet në fundin e viteve '60 nga GAO amerikane. Ky lloj auditimi në Amerikë është shtrirë që prej atëherë në nivelet shtetërore dhe lokale të vendim-marrjes financiare. Shumë vende të tjera kanë sot një ekspertizë të pasur në auditet e performancës. Mund të përmenden NAO britanike, Bunderechnungshof-i gjerman e ai austriak, Algemene Rekenkamer-i hollandez apo dhe Gjykata Sllovene e Auditimit. Në secilin e prej këtyre vendeve, auditimi i performancës së institucioneve publike siguron jo vetëm rritjen dhe përmirësimin ekonomik të vendit, por është një formë e shprehjes së zbatimit të ligjit, rritjes së transparencës, përfshirjes sociale në vendim-marrje, pra tek e fundit një formë e aplikimit të demokracisë.

Të tilla audite kanë filluar të kryhen në Kontrollin e Lartë të Shtetit që nga viti 2008. Me asistencën e ekspertëve hollandezë u kryen atëkohë disa auditime pilot cilësore që fokusonin performancën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ruajtjen e ekosistemit të Liqenit të Ohrit dhe dhënien me koncension të Aeroportit të Rinasit. Por, i keq-konceptuar si auditim derivat, sipërfaqësor dhe pjesor, si pjesë rutinore e procesit të punës dhe jo si risi, punë krijuese e mirëfilltë, bashkëkohore dhe integrale, këtij auditimit iu dha rëndësia e duhur nga drejtuesit e atëhershëm. Me kalimin e kohës, kapacitetet e trajnuara në këtë drejtim u ndryshkën, numri i auditimeve të performancës u tkurr, mediokriteti i punës audituese në këtë drejtim u rrit, për t'u rikthyer në qendër të vëmendjes vetëm 4 vjet më vonë.

Me ndërrimin e filozofisë drejtuese, auditimi i performancës po shndërrohet në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Në përgjigje të kësaj fryme të re, duke e trajtuar me prioritet të lartë auditimin e performancës së institucioneve publike në Shqipëri u krijua në 1 Tetor të 2012, departamenti i ri të auditimit të performancës. Aktualisht, pjesë e këtij departamenti janë 14 punonjës më formime të larmishme, eksperiencë të pasur dhe grada shkencore. Ky departament do të jetë "shtylla moderne" e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Një strukturë që do i shtojë vlerë jo vetëm këtij institucioni, por gjithë administratës publike dhe taksapaguesve shqiptarë. Një pjesë e rëndësishme e planit strategjik të institucionit, është kontribut i këtij departamenti dhe për këtë departament.

Sinergjizimi i punës me departamentet e tjera, rritja e cilësisë dhe numrit të auditimeve të performancës me synim arritjen e parametrave të SAI-ve homologe lider në rajon e më gjerë, shtimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukture për këtë lloj auditimi, përgatitja e manualit të performancës për KLSH-në dhe asistimi në formulimin e parametrave të performancës për sektorë të administratës publike, urbanizimi i konceptit të auditimit të performancës në krejt administratën publike, por edhe më tej në mjedise akademike, media, organizma profesionale, OJF e OJQ, etj., shtimi i vlerës së fondeve publike dhe rritja e përgjegjshmërisë janë disa nga objektivat strategjike që departamenti të ri ka futur në axhendën e institucionit.

Ndër auditimet e realizuara nga ky departament përmenden:

1. Hekurudha Shqiptare

Hekurudha është duke u mbajtur në punë në kushte dhe rrethana shumë të vështira. Auditimi i kryer për gjendjen aktuale të hekurudhës reflekton situatën ekonomike dhe politike të saj. Shërbimi që i ofrohet shtetasve shqiptarë në sistemin hekurudhor në Shqipëri është i përballueshëm (tarifa të ulëta), por jo i sigurtë, jo-efiçient dhe aspak miqësor me mjedisin. Pritshmëria e përdoruesve të këtij lloji transporti është në kah të kundërt me shërbimin dhe politikat e zhvillimit të sistemit hekurudhor ofruar sot nga strukturat menaxhuese të tij. Ministria e Transporteve ka hartuar vazhdimisht politika dhe strategji për zhvillimin e sistemit hekurudhor, por që nuk kanë gjetur zbatim, pasi hartimi i tyre nuk ka qenë në raport të drejtë me fondet që janë vënë në dispozicion për t'i bërë ato të zbatueshme. Politikat e hartuara nga Ministria e

Transporteve për të krijuar një hekurudhë bashkëkohore, fleksibël dhe konkurruese në treg, përgjithësisht kanë qenë të pamundura për t'u realizuar nga Hekurudha Shqiptare me fondet në dispozicion. Burimet e akorduara për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore janë të pamjaftueshme dhe çojnë në degradimin e mëtejshëm të rrjetit, mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore kërkon më shumë fonde, asnjë masë nuk është ndërmarrë për rehabilitimin e rrjetit hekurudhor, sektori i transportit hekurudhor është i pazhvilluar dhe pa investime thelbësore për mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës. Hekurudha nuk po operon si një korporatë e veçantë dhe të marrë vendimet e saj tregtare, për shkak të varësisë së saj dyfishe, ku politik-bërja dhe vendim-marrja për zhvillime strategjike i përket Ministrisë së Transporteve, ndërkohë që fondet e akorduara janë kompetencë e Ministrisë së Financave.

2. ATSH

Veprimtarinë e saj ATSH e ushtron në bazë të Dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr. 1960, datë 09.11.1954 “Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare”. Në kushtet e zhvillimeve të reja politike dhe ekonomike të vendit pas viteve 90-të në bazë të këtij ligji, ajo e mbështet veprimtarinë vetëm në një nen e konkretisht në nenin 8 të këtij Dekreti.

ATSH ka planifikuar dhe realizuar tregues ekonomikë (të ardhurat nga shitja e produkteve) në rënie nga njëri vit në tjetrin. Në “Programet buxhetore” për vitet objekt auditimi, të hartuara nga sektori i financës, nuk i është kushtuar vëmendje objektive të politikës së programit buxhetor.

ATSH nuk i ka përdorur me efektivitet burimet e saj, kjo duke parë tendencën në rritje të zërit paga kundrejt totalit të shpenzimeve në raport me tendencën në ulje të produktit të prodhuar nga i njëjti numër gazetarësh. Kështu duke krahasuar numrin e lajmeve të prodhuar në vitin 2008 deri në vitin 2011 rezulton se janë prodhuar rreth 21 % produkte në formë lajmesh më pak me të njëjtin numër gazetarësh dhe fond page në rritje. Ky subjekt nuk llogarit koston mesatare të prodhimit të lajmit dhe as atë të transmetimit të tij. Nuk ka bërë asnjë studim tregu me vlerë për nevojën publike për shërbimet e ATSH-së, vlerësimet dhe pritshmërinë e qytetarëve ndaj produkteve të saj. Të ardhurat në total dhe ato të krijuara nga kontratat me klientët e huaj kanë pësuar rënie nga viti në vit. Konkretisht në vitet 2008-2011 me të ardhurat e krijuara, ATSH ka mbuluar mesatarisht vetëm 7% të shpenzimeve të kryera.

ATSH nuk ka bërë analiza nëse produkti i saj ka humbur treg gjatë viteve 2008-2011 nga konkurrenca, nuk ka bërë pyetësorë me konsumatorë të saj të ndërmjetëm (televizionet, gazetat, radiot, etj.) dhe fundorë (vizitorë të *ëbsite* të saj, qytetarë të thjeshtë të përzgjedhur rëndom, etj), për opinionin e tyre ndaj produktit të saj. Gjithashtu nga auditimi rezulton se ATSH nuk ka strategji të marketingut të produkteve dhe shërbimeve, si dhe nuk është hartuar asnjë plan strategjik afatmesëm dhe afatgjatë për realizimin e qëllimeve të saj në të ardhmen.

Për sa më lart KLSH ka rekomanduar:

- Duhet miratuar një ligj i ri për veprimtarinë dhe strukturën e ATSH-së. Këto ndryshime ligjore duhet të adresojnë specifikisht;
- Reformimin strukturor imediat të institucionit, duke punuar vetëm me sektorin jashtë vendit dhe për lajmet jashtë vendit. Rrjedhimisht duke **përgjysmuar** strukturën, buxhetin dhe numrin e punonjësve të saj. Ky reformim duhet ndërmarrë sa më shpejt, në mënyrë që të përfshihet në buxhetin e ri, me fillimin e vitit 2013.
- Mundësinë e kalimit të ATSH-së si një drejtori e veçantë pranë Televizionit Shqiptar, përsëri duke theksuar përgjysmimin e strukturës dhe buxhetit të saj për të rritur eficiencën. Edhe kjo mundësi duhet konsideruar ligjërisht sa më shpejt, në mënyrë që të implementohet me fillimin e vitit 2013.
- Në zbatim të ligjit të ri, në një perspektivë afatmesme ose afatgjatë, të vlerësohet mundësia e privatizimit të ATSH-së, për të rritur pavarësinë, eficiencën, cilësinë dhe konkurrueshmërinë e institucionit. Shumica e agjensive simotra në botë zotërohen privatisht ose pjesërisht privatisht.

- Në zbatim të ligjit të ri, në një perspektivë afatmesme ose afatgjatë, të vlerësohet mundësia e kailimit në një kompani sh.amediatike me financime të përbashkëta të buxhetit të shtetit dhe shoqërive private.

3. Trajtimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Fier

Mungesa e politikave të duhura të mbetjeve, në lidhje me parandalimin e tyre, grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin, si dhe mungesa e një shërbimi të përshtatshëm ka bërë që në zona të ndryshme të qytetit të Fierit, sidomos në brigjet e lumenjve, të gjenden pirgje mbeturinash të tipeve nga më të ndryshmet, duke i kthyer këto zona në të ashtuquajtura vend-depozitime të jashtëligjshme mbetjesh dhe ç'është më e keqja në zona të ndotura

Zhvillimi i vrullshëm dhe rritja e konsumit kanë çuar në krijimin e një sasive të madhe mbetjesh të depozituara. Rreth 80% e të gjitha mbetjeve vijnë si rrjedhojë e veprimtarive bujqësore, industriale dhe të bizneseve, një pjesë e madhe e të cilave janë të ripërdorshme (plastikë, metal, letër, qelq, materiale të bio-degradueshme, materiale organike). Rreth 20% e sasisë së mbetjeve të krijuara vijnë nga mbetjet shtëpiake, një pjesë e madhe e të cilave janë të ripërdorshme.

Fusha e depozitimit të mbetjeve në këtë qytet është e pa rrethuar edhe pse shumë pranë saj ndodhen shtëpi banimi të qytetarëve. Kjo mënyrë e administrimit të mbetjeve shkakton një ndotje shumë të lartë të mjedisit. Mbetjet e hedhura në fushë çlirojnë e përhapin në ajrin përreth gazra toksikë që përbëjnë problem tejet serioz për shëndetin e qytetarëve.

Vetë dampa ose fusha e mbetjeve nuk ka studim teknik e inxhinierik për sheshin e vend-hedhjes së mbetjeve urbane. Dampa ose fusha e mbetjeve nuk ka studim gjeomjedisi për sheshin e vend-hedhjes së mbetjeve urbane dhe as Raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis - VNM.

Programet e hartuara dhe të realizuara nga Bashkia Fier për edukimin publik mbi mbetjet urbane kanë qenë sporadike. Programet për edukimin publik në këtë drejtim në pjesën më të madhe të rasteve kanë pasur një tematikë më të gjerë mjedisore dhe nuk janë përqendruar vetëm në tematikën e nxehtë të menaxhimit të mbetjeve urbane në qytetin e Fierit.

4. Kontratat e shërbimit të dializës në QSUT dhe ish-Spitalin Ushtarak

Spitali Ushtarak Qendror Universitar i ka pasur dhe i ka te gjitha mundësitë financiare dhe infrastrukturore për ngritjen e një qendre për trajtimin e hemodializës, ka neglizhuar ngritjen e saj, me arsyen e mospërballimit të kostos nga buxheti i shtetit, duke vlerësuar gabim vlerën e këtij projekti dhe koston për njësi të shërbimit, me qëllimin e vetëm dhënien dhe vazhdimin e kryerjes së këtij shërbimi nga një operator ekonomik privat.

KLSH ka rekomanduar:

- Rinovimi i kontratës “Për dhënien e shërbimit të dializës për 60 pacientë”, të realizohet vetëm kur studimi ekonomik për kostot e shërbimit të konfirmojë këtë praktikë si më efiçientja dhe me efektivitet në përdorimin e fondeve publike. Një rinovim i pastudiuar pas këtij raporti do të ndikonte negativisht në performancën e përdorimit të fondeve nga ky institucion.

- Sa më shpejt të mundësohet ngritja e një grupi pune të përbashkët, me specialistë të fushës së dializës nga SUQU, QSUT dhe Ministria e Shëndetësisë, si dhe ekspertë të jashtëm të fushës ekonomike, që të analizojnë gjendjen dhe numrin e pacienteve që duhet të trajtohen me dializë, trendin e kërkesave për një periudhë të afërt dhe në funksion të kërkesës të përcaktojnë koston e saktë të këtij shërbimi

- Të bashkëpunohet me Ministrinë e Shëndetësisë, me Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, dhe të kërkohet Këshillit të Ministrave, që, në funksion të një projekti të vlerësuar drejt dhe me profesionalizëm, të japë mbështetjen e nevojshme financiare për të mundësuar krijimin e infrastrukturës së duhur për implementimin e shërbimit të hemodializës në ambientet e SUQU dhe nga vetë personeli mjekësor i SUQUT, si një mënyrë që do të rrisë ekonomikitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve për sigurimin e një shërbimi të tillë.

5. Akciza

Organet doganore dhe tatimore kanë bërë përpjekje për arritjen e objektivave të përcaktuara për realizimin e të ardhurave nga akciza. Në këtë kontekst performanca e këtyre organeve duhet të ishte më e suksesshme: për mbledhjen e të ardhurave nga akciza në mënyrë ritmike dhe sipas parashikimeve, nëpërmjet rritjes së eficiencës dhe efektivitetit të strukturave të specializuara në drejtim të investigimit, monitorimit e kontrollit ndaj subjekteve të akcizës, si dhe bashkëpunimin me organet e tjera shtetërore për rritjen e nivelit të ardhurave nga akciza.

Mungon analiza e të ardhurave të akcizës, planifikimi në strukturë sipas artikujveqë do të ndikonte në ndjekjen e realizimit të këtyre të ardhurave nga organet doganore.

Kontrollet e ushtruara nga strukturat e DPD dhe DPT lidhur me administrimin të ardhurave nga akciza duhet të ishin më rezultativesi në numër kontrollesh, ashtu dhe përsa i përket zbulimeve si dhe në zbatimin e masave shtrënguese ndaj subjekteve prodhuese dhe tregtuese të mallrave të akcizës.

Rritja e prodhimit të naftës nuk është shoqëruar me shfrytëzimin e kapacitete përpunuese të saj, gjë e cila do të rriste të ardhurat që sigurohen nga akciza e nënprodukteve të saj dhe do të ndikonte pozitivisht dhe në zbutjen e problemeve sociale të vendit.

Strukturat e MBUMK nuk ka arritur objektivat strategjikë në drejtim të zhvillimit të sektorit të vreshtarisë si burim i rëndësishëm për sigurimin e lëndëve të parë për industrinë e prodhimit të verës, alkoolit dhe të pijeve alkoolike, si edhe për shtimin e sipërfaqeve të mbjella me duhan.

Mungon studimi i plotë në strukturë për artikujt që trajtohen me akcizë, specifikuar sipas direktivave të BE-së dhe artikujt të tjerë luksi ku mund të vendosej akciza në vendin tonë.

Nga analiza e sasisë së mallrave të akcizës të importuar në periudhat para ndryshimit të shkallës tatimore me sasinë e importuar mbas ndryshimit të saj për produktet kafe e papjekur dhe e pjekur, cigare, alkool dhe pije alkoolike, rezultoi se disa subjekte importuese kanë shfrytëzuar hapësirën ligjore të krijuar në periudhën para hyrjes në fuqi të ndryshimit të shkallës tatimore të akcizës duke importuar më shumë mallra dhe ndikuar në uljen e të ardhurave nga akciza.

Mangësi në bashkëpunimin ndërmjet organeve shtetërore si DPD, DPT, MBUMK, METE që merren me administrimin dhe që ndjekin politikën e prodhimit të artikujve të akcizës kryesisht për prodhimet e vendit si karburantet, pijet alkoolike, rakia, vera, birra dhe duhani.

Diferenca ndërmjet prodhimit të evidentuar të rakisë dhe të verës nga Ministria e Bujqësisë dhe deklarimit nga subjektet në organet tatimore kanë ndikuar negativisht në vjeljen e të ardhurave nga akciza për këta artikuj.

Veprimet e ngadalta, shpesh herë kontradiktore të shkallëve të ndryshme të gjyqësorit indirekt kanë favorizuar shkeljet kryesisht me mallra të akcizës duke mos pasur ndikimin e duhur në zbatimin e dispozitave ligjore nga subjektet prodhuese dhe importuese të artikujve të akcizës.

Për sa më lart KLSH ka rekomanduar:

- Ministria e Financave të marrë masa për përgatitjen dhe dërgimin në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave të programit të të ardhurave që duhen realizuar nga akciza, të detajuar në strukturë dhe në zëra për artikujt e importit dhe të prodhimit vendas.
- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave të rrisë përgjegjësinë dhe të forcojë punën e strukturave të specializuara dhe degëve doganore të saj në drejtim të investigimit, monitorimit dhe kontrollit të subjekteve importues dhe prodhues të artikujve të akcizës, me qëllim minimizimin e fenomeneve që ndikojnë negativisht në realizimin e të ardhurave nga akciza në Buxhetin e Shtetit.
- Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës të ndërmarrë studimin dhe t'i propozojë Qeverisë zgjidhjet ligjore përmundësinë e vënies në eficiencë të industrisë përpunuese të naftës në vend duke hartuar dhe një Plan Strategjik Afatgjatë për këtë qëllim.

- Për rritur prodhimin, punësimin e për rrjedhojë të ardhurat nga akciza, Ministria e Bujqësisë të realizojë objektivat e përcaktuara në Planin Strategjik të miratuar nga Qeveria, që deri në fund të vitit 2015 të arrihet mbjellja në zonat rurale të cilat kanë kushte të përshtatshme klimatiko-tokësore, 20 mijë hektarë vreshta dhe një sipërfaqe deri në 10 mijë hektarë me duhan
- Ministria e Financave në bashkëpunim me institucionet e tjera të studiojë mundësinë e shtimit të gamës së artikujve që trajtohen me akcizë si dhe ndryshimet ligjore për nivelin e akcizës që dërgohen për miratim në Parlament të kenë efekt për periudha sa më të gjata kohore.
- Si një faktor për uljen e evazionit në të ardhurat nga akciza, të institucionalizohet dhe të forcohet niveli i bashkëpunimit ndërmjet DPD dhe institucioneve të tjera shtetërore që ndjekin politikën, nxitjen dhe evidentimin e prodhimit të artikujve të akcizës kryesisht për prodhimet e vendit si karburantet, pijet alkoolike, rakia, vera, birra dhe duhani.
- Duke qenë se sanksionet ligjore janë frenues të evazionit të mundshëm fiskal, DPD të rrisë numrin dhe impaktin e hetimeve dhe kallëzimeve penale ndaj subjekteve importues dhe prodhues të mallrave të akcizës që i shmangen detyrimeve ligjore.

* *
*

Në përfundim theksojmë që të gjitha çështjet dhe problematikat e paraqitura në këtë përmbledhëse janë trajtuar gjërësisht në Raportin në vijim si dhe në Raportet e Auditimit rezultat i auditimeve të ushtruar në 118 subjekte të audituara.

Vlen të pasqyrohet se, gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të veprimtarisë audituese për zbatimin e buxhetit të vitit 2012 deri në përgatitjen e këtij Raporti, nga ana e punonjësve të KLSH-së veçanërisht të stafit auditues, janë mbajtur parasysh dhe janë respektuar me rigorozitet përcaktimet dhe detyrimet kushtetuese dhe ligjore për institucionin e KLSH-së; kërkesat e standardeve të auditimit; të rregullores së brendshme të organizimit dhe funksionimit të KLSH-së; të kodit etik të KLSH-së dhe të ligjit për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”; gjithashtu janë zbatuar metodikat dhe manualët e auditimit, letrat dhe dokumentet e punës, si dhe akte të tjera të nxjerra për zbatim nga Kryetari i KLSH.

PJESA E PARË: “PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2012”

I. TREGUESIT E PLANIT TË BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2012

Buxheti i shtetit për vitin 2012, është bazuar në aktet ligjore të mëposhtme:

- a) Ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012”.
- b) Ligji nr. 99/2012, datë 18/10/2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 26/9/2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012”. Shpallur me Dekretin e Presidentit nr. 7803, datë 30/10/2012.
- c) Ligji nr. 126/2012, datë 20/12/2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit” nr. 6, datë 7/12/2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012” të ndryshuar. Shpallur me Dekretin e Presidentit nr. 7915, datë 07/01/2013.

Bazuar në rregullimet e mësipërme ligjore, buxheti i shtetit për vitin 2012, paraqitet:

➤ **BUXHETI**

a) Të ardhurat	332,758 milionë lekë
b) Shpenzimet	382,296 milionë lekë
c) Defiçiti	49,538 milionë lekë

Përbërja sipas buxheteve (nivelet) për vitin 2012, paraqitet:

A. BUXHETI I SHTETIT

1. Të ardhurat	263,172 milionë lekë
2. Shpenzimet	312,710 milionë lekë
3. Defiçiti (3=2-1)	- 49,538 milionë lekë

B. BUXHETI VENDOR

1. Të ardhurat	27,049 milionë lekë
Nga të cilat:	
1.1 Granti i pakushtëzuar nga Buxheti Qendror	13,876 milionë lekë
2. Shpenzimet	27,049 milionë lekë

C. BUXHETI I FONDEVE SPECIALE

C.1 Buxheti i sigurimeve shoqërore

C.1.a Skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror

1. Të ardhurat gjithsej	83,360 milionë lekë
1.a Nga kontributet	50,287 milionë lekë
1.b Transferimet nga Buxheti i Shtetit	33,073 milionë lekë
2. Shpenzimet	83,360 milionë lekë

C.1.b Skema e sigurimit suplementar

1. Të ardhurat gjithsej	5,405 milionë lekë
1.a Nga kontributet	290 milionë lekë
1.b Transferimet nga Buxheti i Shtetit	5,115 milionë lekë

2. Shpenzimet **5,405 milionë lekë**

C.2 Buxheti i sigurimeve shëndetësore

1. Të ardhurat gjithsej **28,934 milionë lekë**
 1.a Nga kontributet dhe të tjera 6,436 milionë lekë
 1.b Transferimet nga buxheti i shtetit 22,498 milionë lekë
2. Shpenzimet **28,934 milionë lekë**

C.3 Fondi për kompensimin në vlerë të pronarëve

1. Të ardhurat gjithsej **1,800 milionë lekë**
 1.a Nga kontributet dhe të tjera 1,500 milionë lekë
 1.b Transferimet nga buxheti i shtetit 300 milionë lekë
2. Shpenzimet **1,800 milionë lekë**

Kufiri i financimit të defiçitit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 49,538 milionë lekë, nga i cili 900 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit.

Në rast të mosrealizimit të ardhurave të buxhetit dhe të ardhurave nga privatizimi, huamarrja e brendshme për financimin e deficitit prej 48,638 milionë lekësh nuk ndryshon.

*- Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2012, është **87,740 milionë lekë**, i detajuar si më poshtë:*

- 1. Për huamarrjen vjetore neto, për mbështetjen buxhetore deri në 26,290 milionë lekë.*
- 2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 46,000 milionë lekë.*
- 3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 13,700 milionë lekë.*
- 4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja të papaguara, është 1,750 milionë lekë.*
- 5. Niveli i stokut të borxhit shtetëror parashikohet të arrijë deri në 792,694 milionë lekë, ndërsa niveli i garancive deri në 62,683 milionë lekë.*

II. TREGUESIT KRYESORË FISKALË TË BUXHETIT TË KONSOLIDUAR

Treguesit fiskalë të buxhetit të konsoliduar të planifikuar të vitit 2012, përfshirë të gjitha ndryshimet ligjore të bëra gjatë zbatimit të buxhetit të këtij viti, paraqiten si më poshtë:

në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Buxheti fillestar sipas ligjit nr. 10487, datë 05/12/2011	Buxheti i ndryshuar sipas aktit normativ	Plani përfundimtar me ndryshime
I.	TOTALI I TË ARDHURAVE (1+2+3)	355,759	332,758	332,758
1.	Të ardhura nga ndihmat	9,843	4,020	4,020
2.	Të ardhura tatimore	325,306	305,508	305,508
2.a	Të ardhurat nga tatimet dhe doganat	251,168	235,922	235,922
2.b	Të ardhura nga pushteti vendor	14,624	11,073	11,073
2.c	Të ardhura nga fondet speciale	59,513	58,513	58,513
3.	Të ardhura jotatimore	20,611	23,230	23,230
II.	TOTALI SHPENZIMEVE (1+2+3+4+5)	396,922	382,296	382,296
1.	Shpenzimet korrente	322,389	313,216	316,704
2.	Fondi rezervë dhe kontigjenca	4,661	4,400	644
	Nga i cili:			
2.a	- Fondi rezervë i KM	2,000	1,800	290
2.b	- Kontigjenca për ruajtjen e defiçitit	2,661	2,600	354

RAPORT PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2012

3.	Shpenzimet kapitale, nga:	69,872	64,689	64,946
3.a	- Financimi i brendshëm	27,501	27,141	27,398
3.b	- Financimi i huaj	42,371	37,548	37,548
III.	DEFICITI I PËRGJITHSHËM (2-1)	- 41,163	- 49,538	- 49,538
	<i>Financimi i deficitit (1+2)</i>	<i>41,163</i>	<i>49,538</i>	<i>49,538</i>
1.	<i>Financimi i brendshëm</i>	<i>18,815</i>	<i>27,190</i>	<i>27,190</i>
1.a	- Të ardhura nga privatizimi	300	900	900
1.b	- Huamarrje e brendshme	18,515	26,290	26,290
1.c	- Të tjera	0.0	0.0	0.0
2.	<i>Financimi i huaj</i>	<i>22,348</i>	<i>22,348</i>	<i>22,348</i>
2.a	- Hua afatgjatë e marrë	32,528	33,528	33,528
2.b	- Mbështetje buxhetore	0.0	0.0	0.0
2.c	- Ndryshimi i gjendjes së arkës	0.0	0.0	0.0
2.d	- Ripagesat	- 10,180	- 11,180	- 11,180

Burimi: Ministria e Financave

Ndërsa, realizimi i treguesve buxhetor të vitit 2012, përkatësisht të ardhurat, shpenzimet dhe deficitin i përgjithshëm, kundrejt treguesve të planit përfundimtar me ndryshime, paraqitet:

në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Plani vitit 2012 me ndryshime	Fakti i vitit 2012	Diferenca (Fakt-Plan)	Realizimi në %	Në % fakt ndaj PBB	Fakti i vitit 2011
I.	TOTALI TË ARDHURAVE (1+2+3)	332,758	330,384	- 2,376	99.3	24.54	330,475
1.	<i>Të ardhurat nga ndihmat</i>	<i>4,020</i>	<i>5,559</i>	<i>+ 1,539</i>	<i>138.3</i>	<i>0.41</i>	<i>3,811</i>
2.	<i>Të ardhurat tatimore</i>	<i>305,508</i>	<i>300,862</i>	<i>- 4,646</i>	<i>98.5</i>	<i>22.35</i>	<i>303,933</i>
2.a	Të ardhurat nga tatimet e doganat	235,922	232,591	- 3,331	98.6	17.28	235,509
2.b	Të ardhura nga pushteti vendor	11,073	10,859	- 213	98.1	0.81	11,792
2.c	Të ardhura nga fondet speciale	58,513	57,411	- 1,102	98.1	4.26	56,632
3.	<i>Të ardhurat jotatimore</i>	<i>23,230</i>	<i>23,963</i>	<i>+ 733</i>	<i>103.2</i>	<i>1.78</i>	<i>22,731</i>
II.	TOTALI I SHPENZIMEVE (1+2+3+4)	382,296	376,241	- 6,055	98.4	27.95	376,352
1.	<i>Shpenzimet korrente</i>	<i>316,704</i>	<i>314,585</i>	<i>- 2,120</i>	<i>99.3</i>	<i>23.37</i>	<i>305,673</i>
2.	<i>Fondi rezervë dhe kontigjenca</i>	<i>644</i>	<i>0.0</i>	<i>- 644</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>	<i>0.0</i>
3.	<i>Shpenzimet kapitale</i>	<i>64,946</i>	<i>61,656</i>	<i>- 3,291</i>	<i>94.9</i>	<i>4.58</i>	<i>70,679</i>
	Nga i cili:						
3.a	- Financimi i brendshëm	27,398	27,398	0.0	100.0	2.04	41,097
3.b	- Financimi i huaj	37,548	34,257	- 3,291	91.2	2.54	27,982
3.c	- Shpronësime	0.0	0.0	0.0			1,600
III.	DEFICITI I PËRGJITHSHËM (2-1)	- 49,538	- 45,857	- 3,682	92.6	3.41	- 45,877
	<i>Financimi i deficitit (1+2)</i>	<i>49,538</i>	<i>45,857</i>	<i>- 3,681</i>	<i>92.6</i>	<i>3.41</i>	<i>45,877</i>
1.	<i>Financimi i brendshëm</i>	<i>27,190</i>	<i>26,495</i>	<i>- 695</i>	<i>97.4</i>	<i>1.97</i>	<i>26,119</i>
1.a	- Të ardhura nga privatizimi	900	1,221	+ 321	135.7	0.09	438
1.b	- Huamarrje e brendshme	26,290	24,783	- 1,507	94.3	18.4	28,175
1.c	- Të tjera	0.0	491	+ 491		0.04	- 2,494
2.	<i>Financimi i huaj</i>	<i>22,348</i>	<i>19,362</i>	<i>- 2,986</i>	<i>86.6</i>	<i>1.44</i>	<i>19,758</i>
2.a	- Hua afatgjatë e marrë	33,528	32,257	- 1,271	96.2	2.40	25,229
2.b	- Ndryshimi i gjendjes së arkës	0.0	- 2,226	- 2,226		- 0.16	+ 2,142
2.c	- Ripagesat	- 11,180	- 10,669	+ 511	95.4	- 0.80	- 7,613

Burimi: Ministria e Financave

Përsa më sipër rezultojn se:

□ **Të ardhurat e përgjithshme të buxhetit të shtetit** janë realizuar në masën 99.3%, ose në terma sasiorë janë realizuar të ardhura gjithsej 330,384 milionë lekë, nga 332,758 milionë lekë të planifikuara, me një *impakt deficitar në të ardhurat e buxhetit të shtetit në shumën 2,374 milionë lekë*. Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2012, ato zenë 24.54% të tij, nga 24.72% të PBB-së të planifikuar, duke reflektuar një mosrealizim prej 0.18% të PBB-së. Krahasuar me një vit më parë, të ardhurat në vitin analizues 2012 janë pakësuar në një vlerë të pakonsiderueshme vetëm 91 milionë lekë.


□ **Shpenzimet e përgjithshme të buxhetit** u realizuan në masën 98.4%, nga 382,296 milionë lekë të planifikuara, janë shpenzuar në fakt 376,241 milionë lekë, duke reflektuar *mosshpenzim të fondeve në shumën 6,055 milionë lekë*. Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2012 ato zenë 27.95% të tij.

Krahasuar me shpenzimet e kryera gjatë vitit 2011 rezultojnë me ulje në shumën 111 milionë lekë.

□ **Defiçiti i përgjithshëm e buxhetit të shtetit** në fund të vitin 2012 rezultoi në shumën 45,857 milionë lekë, nga 49,538 milionë lekë kuota e planifikuar, ose 3,682 milionë lekë më pak. Kundrejt PBB-së të vitit 2012, ky tregues arriti në 3.41% nga 3.68% i planifikuar dhe 3.53% që rezultoi në vitin 2011.

Defiçiti i përgjithshëm buxhetor u financua me 26,495 milionë lekë nga burime të brendshme dhe 19,362 milionë lekë nga burime të huaja.

Në mënyrë grafike, treguesit fiskalë të planifikuar të buxhetit të konsoliduar të vitit 2012, kundrejt niveleve të realizuara, përkatësisht të ardhurat, shpenzimet dhe defiçiti buxhetor, paraqiten si më poshtë:



Burimi: Ministria e Financave

III. REALIZIMI I TË ARDHURAVE TË BUXHETIT TË SHETIT

Referuar treguesve fiskalë sipas buxhetit të konsoliduar të vitit 2012, është parashikuar që shuma e të ardhurave të përgjithshme prej 332,758 milionë lekë të sigurohet nga këto burime të të ardhurave:

- a) Ndihamat në vlerën 4,020 milionë lekë;
- b) Tatimet dhe doganat 235,922 milionë lekë;
- c) Pushteti vendor 11,073 milionë lekë;
- d) Kontributet e sigurimeve shoqërore 50,577 milionë lekë;
- e) Kontributet e sigurimeve shëndetësore 6,436 milionë lekë;
- f) Kompensimi në vlerë të pronarëve 1,500 milionë lekë; dhe
- g) Të ardhurat jotatimore 23,230 milionë lekë.


Plani me ndryshime dhe niveli i realizimit të të ardhurave të buxhetit të vitit 2012, në total dhe të shprehura sipas zërave, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në milionë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Plan	Fakt	Diferenca (F-P)	Përqindja realizimit	Në % ndaj/PBB
TOTALI I TË ARDHURAVE		332,758	330,384	- 2,376	99.3	24.54
I.	Të ardhura nga ndihmat	4,020	5,559	+ 1,539	138.3	0.41
II.	Të ardhura tatimore	305,508	300,862	- 4,646	98.5	22.35
II.1	<i>Nga Tatimet dhe Doganat</i>	235,922	232,591	- 3,331	98.6	17.27
1.	Tatimi mbi vlerën e shtuar	119,040	116,532	- 2,508	97.9	8.64
2.	Tatimi mbi fitimin	16,552	16,853	+ 301	101.8	1.25
3.	Akcizat	36,492	36,421	- 71	99.8	2.71
4.	Tatimi mbi të ardhurat personale	28,128	27,989	- 139	99.5	2.08
5.	Taksa nacionale dhe të tjera	29,657	28,677	- 139	99.5	2.13
6.	Taksa doganore	6,053	6,118	+ 65	101.1	0.46
II.2	<i>Nga Pushteti Vendor</i>	11,073	10,859	- 213	98.1	0.81
1.	Taksa lokale	6,580	6,210	- 315	94.4	0.46
2.	Taksë mbi pasurinë (ndërtesat)	2,690	2,506	- 184	93.2	0.19
3.	Tatimi mbi biznesin e vogël	1,803	2,143	+ 341	118.9	0.16
II.3	<i>Të ardhurat nga fondet speciale</i>	58,513	57,411	- 1,102	98.1	4.26
1.	Sigurimi shoqëror	50,577	49,533	- 1,044	97.9	36.80
2.	Sigurimi shëndetësor	6,436	6,590	+ 154	102.4	0.49
3.	Fondi i kompensimit në vlerë pronarëve	1,800	1,581	- 219	87.8	0.11
III.	Të ardhurat jotatimore	23,230	23,963	+ 733	103.2	1.78
1.	Transferimi i fitimit nga BSH	4,500	4,693	+ 193	104.3	0.35
2.	Nga institucionet buxhetore	9,150	10,276	+ 1,126	112.3	0.76
3.	Dividendi, gjoba e sekuestre	430	426	- 4	99.1	0.03
3.	Tarifat e shërbimeve	3,850	3,772	- 78	98.0	0.28
4.	Të tjera	5,300	4,797	- 503	90.5	0.36

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme, rezulton se të ardhurat në vitin 2012 janë realizuar në masën 99.3%, ose nga 332,758 milionë lekë të programuara, janë realizuar 330,384 milionë lekë, me një impakt negativ në vlerë prej 2,376 milionë lekë.

Në mënyrë grafike struktura e realizimit të të ardhurave të buxhetit paraqitet:



Burimi: Ministria e Financave


□ Analizuar të ardhurat e buxhetit të shtetit sipas zërave dhe kundrejt kuotave të planifikuara të vitit 2012, rezulton se:

III.1 Të ardhurat nga ndihmat

Për vitin 2012, të ardhurat nga ndihmat nga 4,020 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 5,559 milionë lekë ose në masën 138.3%, me një tejkalim në vlerë prej 1,539 milionë lekë. Kundrejt totalit të të ardhurave të realizuara këtë vit, ato zënë rreth 1.68% të tij, nga 1.15% të rezultuar në vitin 2011 dhe 1.42% në vitin 2009. Ndërsa kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2012 ato zenë 0.41% të tij, nga 0.29% të PBB-së që zinin në vitin 2011.

Në krahasim me një vit më parë, këto të ardhura paraqiten me rritje, përkatësisht 1,748 milionë lekë më tepër (5,559 milionë lekë – 3,811 milionë lekë).

Në mënyrë grafike ecuria e realizimit të të ardhurave nga ndihmat paraqitet:



Burimi: Ministria e Financave


III.2 Të ardhurat tatimore

Këto të ardhura janë realizuar në masën 98.5% ndaj nivelit të planifikuar, me një mosrealizim në vlerë prej 4,646 milionë lekë. Ky impakt deficitari është shkaktuar si pasojë e mosrealizimit të kuotave të planifikuara në:

- a) Të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të cilat janë realizuar në masën 98.63%, me një mosrealizim në vlerë prej 3,331 milionë lekë;
- b) Të ardhurat nga pushteti vendor në masën 98.1%, me një mosrealizim në vlerë prej 213 milionë lekë; dhe
- c) Të ardhurat nga fondet speciale ku përfshihen kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe fondi i kompensimit të pronarëve në masën 98.1%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,102 milionë lekë.

Të ardhurat tatimore zenë 91.06% të totalit të të ardhurave gjithsej të realizuara në vitin 2012, nga 91.97% të rezultuar në vitin 2011, me një ulje prej 0.91%. Krahasuar me realizimin faktik të një viti më parë, të ardhurat tatimore të realizuara në vitin 2012 paraqiten me ulje, përkatësisht, nga 303,933 milionë lekë të realizuar në vitin 2011, në 300,862 milionë lekë në vitin 2012, me një ulje në masën rreth 1% dhe në vlerë 3,071 milionë lekë më pak. Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2012 ato zenë 22.35%, nga 23.42% të PBB-së që zinin në vitin 2010, pra me një ulje prej 1.07%

Në mënyrë grafike ecuria e realizimit të të ardhurave tatimore paraqitet:



Burimi: Ministria e Financave

Zëri kryesor i të ardhurave tatimore, janë të ardhurat nga tatimet dhe doganat, të cilat në vitin 2012, nga 235,922 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në vlerën 232,591 milionë lekë, ose në masën 98.6%, me një impakt negativ në totalin e të ardhurave prej 3,331 milionë lekë. Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2012 ato zenë 17.27%, nga 18.15% të PBB-së që zinin në vitin 2011, pra me një ulje prej 0.88%.

Krahasuar me të ardhurat e realizuara në vitin 2011 në shumën 235,509 milionë lekë, ato rezultojnë me ulje në masën mbi 1.2% dhe në vlerë 2,919 milionë lekë më pak. Krahas kësaj konstatohet se, niveli i planifikimit të ardhurave nga tatimet dhe doganat për vitin 2012 në shumën 235,922 milionë lekë ndryshon në rritje me vetëm 413 milionë lekë nga realizimi faktik 2011, shumë kjo e papërfillshme, ndërkohë që të ardhurat tatimore nga tatimet dhe doganat në totalin e të ardhurave buxhetore mesatarisht kanë kontribuar me 68.7% në vitin 2010, rreth 71.26% në vitin 2011 dhe 70.4% në vitin 2012. Gjithashtu, nga këto të dhëna konstatohet një ulje e peshës specifike që zenë të ardhurat e realizuara nga tatimet dhe doganat në vitin 2012 kundrejt totalit të këtij viti, krahasuar me atë të një viti më pare, përkatësisht me 0.86 pikë përqindje më pak.

Në strukturë, të ardhurat e realizuara nga tatimet dhe doganat, paraqiten:

- Tatimi mbi vlerën e shtuar në shumën 116,532 milionë ose në masën 50.1% të totalit të të ardhurave nga tatimet dhe doganat;
- Tatimi mbi fitimin 16,853 milionë lekë ose në masën 7.25%;
- Akcizat 36,421 milionë lekë ose në masën 15.66%;
- Tatimi mbi të ardhurat personale 27,989 milionë lekë ose në masën 12.03%;
- Taksa nacionale dhe të tjera 28,677 milionë lekë ose në masën 12.33%;
- Taksa doganore 6,118 milionë lekë ose në masën 2.63% të shumës totale.

Pa mohuar aspak punën, përpjekjet dhe rezultatet e arritura gjatë vitit buxhetor 2012 nga administratat e organeve tatimore dhe doganore në drejtim të administrimit të tatim-taksave, në vijim do të paraqesim ato drejtime dhe problematika të konstatuara nga ana e audituesve të KLSH gjatë auditimeve të kryera, të cilat kërkojnë një vëmendje më të madhe për trajtimin e tyre, njëkohësisht përgjegjshmëri më të lartë nga administrata tatimore dhe doganore.

III.2.a. DPT dhe njësitë e saj vartëse.


Plani i të ardhurave tatimore neto (pa kontributet) për vitin 2012, është realizuar në masën 98.95% e nivelit të parashikuar, nga 105,190 milionë lekë të planifikuara, në 104,083 milionë lekë, me një mosrealizim në shumën 1,107 milionë lekë (sipas të dhënave të DPT).

Ndërsa po të krahasohen të ardhurat tatimore neto (pa kontributet) e realizuara në vitin 2011 me të ardhurat e realizuara në vitin 2012, kemi një rënie të të ardhurave të realizuara në vlerë 689,560 mijë lekë ose 0.66 përqind më i ulët. Por nëse do të shikonim të ardhurat tatimore (me kontributet) të realizuara për të dy vitet do të shikonim se arkëtimet e vitit 2012 janë më të larta për vlerën 897 milionë lekë, ose 0.57 % përqind më i lartë. Nga të dhënat e vëna në dispozicion nga sektori i statistikave, realizimi i të ardhurave tatimore dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për vitin 2012, paraqitet:

Rënie në të ardhurat e realizuara në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011 konstatohen tek TVSH-ja për vlerë prej 1,269 milionë lekë, ose 5.78 përqind më pak dhe Tatimi mbi Fitimin për vlerën prej 2,865 milionë lekë, ose 14.53 përqind më pak. Efekt pozitiv në rritjen e të ardhurave tatimore nga D.P.T kanë patur Taksat Nacionale 3,468 milion lekë, kjo referuar gjithmonë krahasimit me të dhënat e vitit 2011.

Po të shikohet struktura e të ardhurave vihet re se të ardhurat personale kanë sjellë 27% të të ardhurave totale kundrejt 24% të pjesës që ka sjellë TVSH pasuar më pas nga 16% të krijau nga Tatim fitimi dhe 13% nga taksa nacionale, 11% akciza dhe 9% tatime të tjera. Gjithashtu të dhënat tregojnë se të ardhurat nga tatimet indirekte zënë 33 përqind e të ardhurave (TVSH dhe Akciza), kurse tatimet direkte 67 përqind e të ardhurave. Në skemën e mëposhtme dalin qartë konstatimet e cituara më lartë.

Struktura e të ardhurave për vitin 2012 paraqitet:



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Të dhënat tregojnë se të ardhurat tatimore neto (pa kontributet) realizohen nga sektori shtetërorë në vlerën 12,591 milionë lekë, ose 12.1% përqind i të ardhurave dhe nga sektori privat në vlerën 91,492 milionë lekë, ose 87.9% përqind e të ardhurave.


Tabela. Të ardhurat sipas Drejtorive Tatimore

në mijë/lekë

		Plani 2012	Realizimi 2012	%
1	D.R. Tatimore BERAT	2.735.700	2.516.445	2%
2	D.R. Tatimore DIBRA	2.050.300	2.034.303	1%
3	D.R. Tatimore DURRËSI	14.467.300	13.377.799	9%
4	D.R. Tatimore ELBASANI	4.898.000	4.833.562	3%
5	D.R. Tatimore FIERI	5.323.300	4.863.505	3%
6	D.R. Tatimore GJIROKASTRA	2.185.000	2.084.912	1%
7	D.R. Tatimore KORÇA	4,519.300	4.315.973	3%
8	D.R. Tatimore KUKËSI	1.334.000	1.302.892	1%
9	D.R. Tatimore LEZHA	2.459.500	2.268.990	1%

10	D.R. Tatimore SARANDA	1.266.800	1.295.958	1%
11	D.R. Tatimore SHKODRA	4.093.800	4.075.151	3%
12	D.R. Tatimore TIRANA	34.957.000	37.013.318	24%
13	NJTPM	73.462.000	72.962.268	46%
14	D.R. Tatimore VLORA	4.381.000	4.252.797	3%
Totali		158.133.000	157.197.873	

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Është e dukshme që pjesa më e madhe e të ardhurave tatimore të realizuara gjatë 2012 rreth 46% janë realizuar nga NJTPM duke u pasuar nga Drejtoria tatimore Tiranë me 24% dhe Drejtoria tatimore Durrës 9%. Të gjitha drejtoritë e tjera tatimore në rrethe realizojnë të ardhura në segmentin 1-3% të të ardhurave totale.

Në se i referohemi krahasimit plan-fakt për vitin 2012 vërejmë se mosrealizimet më të mëdha i kanë DRT Durrës me **minus** 1,089,501 mijë lekë, Njësia e Tatim Paguesve të Mëdhenj Tiranë me **minus** 499,732 mijë lekë; DRT-të Fier me **minus** 459,795 mijë lekë; DRT Berat me **minus** 219,255 mijë lekë, DRT Korcë me **minus** 203,327 mijë lekë pjesa tjetër (6 DRTatimore) kanë mosrealizime por në vlera më të ulta. Tejkallim në planin e të ardhurave ka patur DRT Tiranë me **një shtesë** 2,056,318 mijë lekë, ndërsa DRT Saranë dhe Shkodër kanë tejkallime në vlera të ulta respektivisht 29,158 mijë dhe 18,649 mijë lekë.

1. Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto)

Po të shikojmë të dhënat për realizimin e të ardhurave nga TVSH në total dhe pastaj në një analizë më të hollësishme sipas drejtorive rajonale tatimore do të shikonim se të ardhurat e planifikuara nga TVSH për vitin 2012 nuk janë realizuar me 168,417 mijë lekë ose -0,68% referuar nivelit të të ardhurave të realizuara nga TVSH për 2012 (24,928 milionë lekë plani janë realizuar në fakt 24,760 milionë lekë). Analiza jonë është bazuar në Tatimi Vleres se Shtuar (neto) e cila rezulton nga diferenca e TVSh bruto me rimbursimet e kryera.

	Viti 2011	Viti 2012	diferenca
Tatimi Vleres se Shtuar (bruto)	33,037,822	31,767,902	(1,269,919)
- Tatimi Vleres se Shtuar (neto)	26,279,640	24,759,583	(1,520,057)
- Rimbursimi kryer	6,758,181	7,008,319	250,138


Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Po të krahasojmë këto të ardhura me ato të realizuara në fakt për vitin 2011 rënia është me 1,520,057 mijë lekë ose me -5.78%. Ndërsa po të shikojmë shifrat e vitit 2011 dhe 2012 për secilën nga DRT do të evidentonim se pjesa më e madhe e këtyre drejtorive kanë rënie të të ardhurave të realizuara nga TVSh nga një vit më parë përveç DRT Sarandë, Lezhë, Korçë dhe Dibër. Rënie më të ndjeshme krahasuar me një vit më parë kanë NJTPM me 605,249 mijë lekë ose -3,63 % më pas DRT Durrës me 251,084 mijë lekë dhe ndjekur nga DRT Tiranë 239,903 mijë lekë ose -4.96%.

		VITI 2012		FAKTI	Diferenca 2011/2012	
		PLANI	FAKTI	2011	+ ose -	përqind
A-1	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (neto)	24,928,000	24,759,583	26,279,640	(1,520,057)	-5.78%

Burimi: Të dhënat e pasqyrës janë mare nga Sektori i Statistikës e Programimit DPT

Po të analizojmë realizimin e të ardhurave nga TVSh sipas drejtorive rajonale do të vërejmë se 65% të të ardhurave të TVSH i realizon NJTPM e ndjekur me 19% nga DRT Tiranë ndërsa të gjitha DRT e tjera kanë një peshë nga 0-3% në të ardhurat nga TVSH.



Grafiku. TVSH sipas drejtorive rajonale

Treguesit e mësipërm tregojnë se masat organizative dhe teknike të marra nga administrata tatimore në menaxhimin e TVSH-së **nuk kanë qenë efektive**. Megjithë dokumentacionin e paket të vënë në dispozicion, vihet re një raport i zhdrejtë ndërmjet rritjes së xhiros së tatueshme dhe pagesës së TVSH-së, gjë që nuk është analizuar më tej.

2. Tatimi mbi fitimin

Të ardhurat nga tatimi mbi fitimin për vitin 2012, nga 16,553 milionë lekë të planifikuara, në fakt rezultojnë 16,853 milionë lekë me një realizim prej 101.8% ose në vlerë një tejkalim prej 300 milionë lekë. Pjesa më e madhe e DR Tatimore janë me tejkalim të planit të të ardhurave për tatim fitimin, përveç DR Tatimore Dibër që ka patur mos realizim plani me 14,9% , NJTPM me një mos realizim me 5,4% dhe DR tatimor Kukës me një mos realizim me 3,9% .


Ndërsa po të krahasojmë të ardhurat e realizuar nga tatimi mbi fitimin gjatë vitit 2012 me ato të realizuara një vit më parë 2011 konstatohet një rënie e ndjeshme në vlerën 2,865 milionë lekë ose në masën 14.5% edhe këtu rënie më të madhe e ka patur të ardhurat e krijuara nga NJTPM në vlerë 2,827 milionë lekë ose 20,6%

në mijë/lekë

A-2	TATIMI MBI FITIMIN	VITI 2012			FAKTI 2011	Diferenca 2011/2012	
		PLANI	FAKTI	%		+ ose -	%
		16,553,000	16,853,214	101.8	19,718,842	(2,865,628)	85.5

Burimi: Të dhënat e pasqyrës janë mare nga Sektori i Statistikës e Programimit DPT

Po të analizojmë realizimin e të ardhurave nga tatim fitimi sipas drejtorive rajonale do të vërenim se 65% të të ardhurave të nga ky tatim i realizon NJTPM e ndjekur me 16% nga DRT Tiranë dhe DRT Durrës më 5% ndërsa DRT e tjera kanë një peshë nga 0-3% në të ardhurat



Grafiku. Tatim fitimi sipas drejtorive rajonale

Analiza më e thelluar lidhur me efektet negative në mosrealizimin e tatim mbi fitimin, ka të bëjë me rritjen e nivelit të subjekteve me humbje për 3200 subjekte me vlerë prej -42,990 milionë lekë si dhe të uljes së nivelit të fitimit të deklaruar nga subjektet sipas pasqyrave financiare natyrisht efektet e krizës kanë lënë gjurmë në rezultatin financiar të deklaruar për vitin 2012.

Gjithashtu papaftësia paguese e subjekte ka patur një ndikim në mos realizimin e këtij treguesi.

3. Akciza


Ligji nr. 61, datë 24.05.2012 për akcizën bëri kalimin i menaxhimit të vjeljes së të ardhurave nga akciza në sistemin doganor në tremujorin e katërt të vitit 2012. Pasqyra e mëposhtme është ndërtua me bazë 9 mujore. Kështu është e mundur evidentimi i performancës së D.P.Tatimeve për të njëjtën periudhë të vitit 2012 me 2011.

Të ardhurat nga akciza për vitin 2012, rezultojnë me realizim në masën 100%, nga 11,867 milionë lekë plani, në fakt janë mbledhur 11,868 milionë lekë. Megjithatë duhet theksuar se në raport me realizimin e një viti më parë, këto të ardhura janë rezultojnë me ulje në masën rreth 1.9% dhe në vlerë 222,9 milionë lekë më pak.

në mijë/lekë

A-3	AKCIZA	PERIUDHA 9 – MUJORE 2012			FAKTI 2011	Diferenca 2011/2012	
		PLANI	FAKTI	%		+ ose -	%
		11,867,000	11,868,113	100.01	12,091,038	(222,925)	98.16

Shënim: Të dhënat e pasqyrës janë marë nga Sektori i Statistikës e Programimit DPT



Grafiku. Akciza sipas drejtorive rajonale

Peshën më të madhe të akcizës e ka patur NJTPM me rreth 95% të totalit të të ardhurave nga akciza duke reflektuar natyrën e përqëndrimit të këtij tatimi në tatimpagues të mëdhenj. Vlerat e akcizës të realizuara nga 11 DR Tatimore rajonale është në vlera të atilla që nuk përbëjnë as 1% të totalit.

4. Të ardhurat personale

Të ardhurat nga ky tatim për vitin 2012 janë realizuar në masën 99.3%, nga 28,128 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 27,989 milionë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 139 milionë lekë. Sipas DRT-ve, paraqiten me realizim vetëm DRT Tiranë dhe NJTPM Tiranë, kurse drejtoritë e tjera paraqiten me mosrealizime, dhe më e theksuar në DRT Fier me rreth 101 milionë lekë më pak, DRT Vlorë 79.8 milionë lekë më pak .


në mijë/lekë

A-4	TE ARDH. PERSONALE	VITI 2012			FAKTI 2011	Diferenca 2011/2012	
		PLANI	FAKTI	%		+ ose -	Përqind
		28,128,000	27,989,208	99.5	27,967,001	22,207	100.1

Shënim: Të dhënat e pasqyrës janë marë nga Sektori i Statistikës e Programimit DPT

Niveli i realizimit të ardhurave në vitin 2012 është pothuajse i njëjtë me atë të një viti më parë. Nga krahasimi i niveleve të realizimit të DRT-ve në vitin 2012 kundrejt vitit 2011, rezulton se në 12 (dymbëdhjetë) paraqiten nën nivelin e realizimit të vitit 2011; ndërkohë që rritje nivelin të grumbullimit të të ardhurave personale paraqiten NJTPM Tiranë dhe DRT Tiranë, përkatësisht me 158 milionë lekë dhe 154 milionë lekë më tepër.

Edhe në këtë lloj tatimi peshën më të madhe të realizimit e ka patur NJTPM me rreth 41% të totalit të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhura e ndjekur nga DRT Tiranë me 31% dhe DRT Durrës me 5%. Të gjitha drejtoritë e tjera realizojnë të ardhura nga tatimi mbi të ardhura personale nga 1-3% të totalit të këtyre të ardhurave.



Grafiku. Tatimi mbi të ardhurat sipas drejtorive rajonale

Duke qënë se në këtë grup të ardhurash përfshihen nga të ardhurat mbi pagë, të ardhurat nga biznesi i vogël deri tek tatimi mbi dividendë analiza na con se në shumë nga DRT rajonale duhet bërë përpjekje për përmirësimin e punës verifikuese, bashkëpunuese me institucione të tjera, si dhe kontrolluese nga ana e tyre, me qëllim që tatimpaguesit të deklarojnë pagat reale. Gjithashtu, duhet t'i kushtohet vëmendje zbatimit korrekt të ligjit në drejtim të evidentimit dhe pagesës së detyrimit të tatimit mbi dividendin i cili zë një peshë akoma të vogël në këtë grupim.

5. Taksa nacionale dhe të tjera


Të ardhurat nga taksa nacionale për vitin 2012, rezultojnë me tejkalim në masën 5.84% mbi nivelin e planifikuar, nga 12,714 milionë lekë plani, në fakt janë mbledhur 13,457 milionë lekë, me një tejkalim në vlerë prej 743 milionë lekë më shumë. Madje, ky nivel realizimi i të ardhurave nga taksa lokale paraqitet me një rritje mjaft të konsiderueshme krahasuar me një vit më parë (9,988 milionë lekë) në masën 34.72% më tepër dhe në vlerë 3,469 milionë lekë më shumë.

në mijë/lekë

		VITI 2012			FAKTI	Diferenca 2011/2012	
		PLANI	FAKTI	%	2011	+ ose -	Përqind
A-5	TAKSAT NACIONALE	12,714,000	13,456,751	105.8	9,988,741	3,468,010	134.7

Shënim: Të dhënat e pasqyrës janë marë nga Sektori i Statistikës e Programimit

NJTPM ka realizuar 67% të totalit të këtij zëri të ardhurash, ndërsa DRT Durrës ka realizuar 16% e ndjekur nga DRT Tiranë me 10% të totalit pjesa tjetër e DRT ka nivel të ulët të realizimit të këtij grupi të ardhurash.



Grafiku. Taksa nacionale sipas drejtorive rajonale

6. Lojrat e fatit

Nga të dhënat e marra nga DPT dhe nga auditimi në Njësinë e Mbikëqyrjes të Lojrave të Fatit, rezulton se të ardhurat janë realizuar në masën 79.5%, nga 6,000 milionë lekë kuota e planifikuar janë realizuar në fakt 4,772 milionë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 1,228 milionë lekë.

në mijë/lekë

		VITI 2012			FAKTI	Diferenca 2012/2011	
		PLANI	FAKTI	Përqind	2011	+ ose -	Përqind
LOJRAT E FATIT		6,000,000	4,771,751	79.5	5,029,005	(257,254)	94.9%
1	D.R. Tatimore BERAT	5,000	2,193	43.9	3,500	(1,307)	62.65
2	D.R. Tatimore DIBRA	30,000	21,500	71.7	22,533	(1,033)	95.42
4	D.R. Tatimore ELBASANI	108,000	178,722	165.5	96,146	82,576	185.9
5	D.R. Tatimore FIERI	105,000	100,870	96.1	92,005	8,865	109.6

7	D.R. Tatimore KORÇA	0	13,795		0	13,795	
9	D.R. Tatimore LEZHA	7,000	2,116	30.2	3,700	(1,584)	57.19
12	D.R. Tatimore TIRANA	2,040,000	1,482,869	72.7	1,715,281	(232,413)	86.45
13	NjTPM	3,675,000	2,904,103	79.0	3,070,231	(166,128)	94.59
14	D.R. Tatimore VLORA	30,000	65,554	218.5	25,609	39,945	255.98

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Referuar vitit 2011 të ardhurat nga Lojrat e Fatit kanë pësuar rënie në masën 257,254 mijë lekë apo me 5,1% . Rëniet më të mëdha krahasuar një viti më parë janë në DRT Lezhë me 43% rënie, më pas vjen DRT Berat me rreth 37% rënie ndjekur nga DRT Tiranë me 13,5% rënie dhe NJTPM me 5% rënie duke u kompensuar nga rritja e ndjeshme e të ardhurave të realizuara nga DRT Elbasan me rreth 86% rritje e ndjekur me një rritje të lehtë të mbledhjes së këtyre të ardhurave në DRT Fier.

Në vitin 2012, janë licensuar 2 shoqëri për zhvillimin e lojërave të fatit, përkatësisht “ACT-Albania” dhe “Euro Games - 2012”, të dyja për kategorinë e lojërave të fatit “Kazino Elektronike”. Gjatë këtij viti është marrë masa e heqjes së licensës për veprimtari lojëra fati për tre subjekte dhe për pezullim veprimtarie për pesë subjekte. Gjykohet një punë e pamjaftueshme e administratës në sigurimin e të ardhurave nga ky burim i të ardhurave.

- Nga auditimi i ushtruar në njësinë e mbikqyrjes së lojërave të fatit në tremujorin e dytë të vitit 2013, u konstatuan mjaft mangësi e shkelje të legjislacionit në fuqi, si në drejtim të parregullshmërisë së dokumentacionit në lidhje me dhënien e licensave për ushtrim aktiviteti dhe hapjen e sallave të lojërave të fatit mungesës së certifikimit të makinerive paisjeve të lojërave të fatit si dhe mungesës së ushtrimit të kontrollit të plotë në terren.

Në përfundim të këtij auditimi, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr 205/10 datë 05.08.2013 i karekomanduar Ministrit të Financave, ngritjen e në taskforce të veçantë për të pasqyruar zhvillimet informale në këtë sektor nëpërmjet kryerjes së një auditimi në terne pranë subjekteve që zhvillojnë aktivitet në fushën e lojërave të fatit.

Të dhënat tregojnë se NJTPM krijon rreth 46% të të ardhurave tatimore ndërkohë që ajo ka një strukturë me 168 punonjës ndërsa 1251 punonjës të tjerë realizojnë 54% të të ardhurave tatimore pa përmendur strukturën e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me një strukturë prej 187 punonjësish.

Nga auditimi i kryer për pagesat e kryera për punonjësit e larguar nga puna në bazë të vendimeve të Gjykatave dhe të K.SH.C për vitin 2012 rezulton që të jenë paguar pjesërisht ose përfundimisht 84 persona Sipas llojit të vendimeve rezulton: Vendime me rikthim në pozicionin e mëparshëm 32 persona për vlerën 22,069,279 lekë, vendime vetëm për dëmshpërblim 46 persona për 10,396,110 lekë dhe vendime me rikthim në pozicionin e mëparshëm por që janë dorëhequr nga pozicioni i punës për 6 persona si dhe shpenzime gjyqësore për shumën 1,083,760 lekë. Duke ju referuar vendimeve të Gjykatave dhe të K.SH.C për punonjësit e larguar nga puna rezulton që në fund të vitit 2012 të jetë një detyrim i pashlyer për shumën 167,922,788 lekë e cila vazhdon të rritet.

7. Detyrimet debitorë në sektorin e tatimtaksave

Gjendja e detyrimeve debitorë në fund të vitit 2012 paraqitet e rritur në raport me fundvitin 2011. Bazuar në të dhënat e nxjerra dhe të raportuara nga DPT, *gjendja në vlerë e detyrimeve debitorë në fund të vitit 2012 rezulton 69,936 milionë lekë, nga 64,734 milionë lekë që kanë qenë më 01/01/2012; pra me një rritje në vlerë prej 5,202 milionë lekë ose në masën 8% më tepër.* Edhe numri i subjekteve debitorë rezulton me rritje në masën 25.6%. Detyrimet debitorë në vlerë më 31/12/2012, zënë 67.2% të vlerës totale të të ardhurave neto të realizuara nga organet e

tatimtaksave në vitin 2012, nga 60.2% që zinin një vit më pare, pra me një rritje prej 7 pikë përqindje.

Ndërsa, *kundrejt PBB-së të vitit 2012, vlera e detyrimeve debitoare zë rreth 5.19% të saj, nga 4.99% të PBB-së që zinte në vitin 2011, pra me një rritje prej 0.2%.*

Cilësojmë se, rritja e detyrimit tatimor do të ishte më e madhe nëse kemi parasysh efektin në ulje të shumës së borxhit që ka patur ligji i faljeve nr. 10418, datë 21/04/2011 “Për Legalizimin e Kapitalit dhe faljen e një pjese të Borxhit Tatimor dhe Doganor”.

Masat e marra për uljen e borxhit kanë rezultuar të jenë joefektive, megjithëse janë ngritur dhe funksionojnë strukturat e borxhit në DPT dhe DRT-të dhe si pasojë e masave të marra prej tyre ka një rritje të nivelit të arkëtimeve të detyrimeve nga viti 2011 në vitin 2012, respektivisht nga 11,788 milionë lekë në 14,447 milionë lekë. Megjithkëtë, në disa DRT ka rënie të nivelit të arkëtimeve si DRT Dibër, Kukës, Vlorë etj. Për më tepër, për punën e dobët të kryer nga këto DRT, nga strukturat përgjegjëse nuk i është propozuar Drejtorit të Përgjithshëm asnjë masë disiplinore për Drejtorët Rajonalë Tatimorë si dhe Drejtorët Rajonalë të Drejtorisë së Menaxhimit të Borxhit. Të tjera të meta dhe mangësi të konstatuara janë Mungesa e Regjistrit Kombëtar të Borxhit nga strukturat përkatëse të Mbledhjes së të Ardhurave; mosrakovimi i gjendjes së borxhit ndërmjet DPT me DRT-të; ndryshimi i herëpashershëm i metodologjive për evidentimin dhe përpunimin e të dhënave për nivelin e borxhit; moszbatimi nga drejtuesit e Administratës Tatimore Qendrore, Drejtori i Drejtorisë së Mbledhjes së të Ardhurave të kërkesave ligjore për vjeljen e borxhit tatimor.

Zbatimi i ligjit të faljes. Ligji i faljes nr. 10418, datë 21/04/2011 i sipërcituar për periudhën 2011–2012 ka patur një efekt në uljen e borxhit tatimor prej 26,245 milionë lekë. Gjithashtu, nga ky ligj janë përfiturar të ardhura gjithsej 607 milionë lekë. Të ardhurat janë kontabilizuar në llogari totale, së bashku me të ardhurat tatimore të zakonshme.

Nga analiza e të dhënave mbi gjendjen e detyrimeve të papaguara në fund të vitit 2012, sipas DPT-së rezulton se detyrimet e papaguara në fund të vitit 2012 janë në nivel të lartë rreth 44% nga 38.1% që ishin në vitin 2011. Analiza tregon nga 14 DRT vetëm në 7 (shtatë) prej tyre është ulur gjendja e detyrimeve në fund të vitit, konkretisht në DRT Tiranë për 2,618 milionë lekë, Vlorë 233 milionë lekë, Dibër 463 milionë lekë, Durrës 865 milionë lekë, Fier 78 milionë lekë, Gjirokastrë 37 milionë lekë dhe Shkodër 493 milionë lekë. Ndërsa në 7 (shtatë) të tjera gjendja në fund është rritur në krahasim me atë në fillim dhe rritja më e madhe konstatohet në NJTPM Tiranë në vlerën 7,307 milionë lekë, DRT-të Lezhë 1,011 milion lekë, Elbasan 549 milionë lekë, Korçë 526 milionë lekë etj

Sipas DRT-ve peshën kryesore të rritjejes së detyrimeve e zënë NTPM me 5,524 milionë lekë, DRT Durrës 2,092 milionë lekë dhe Lezhë 1,347 milionë lekë. Një gjendje më të qartë të rritjes së detyrimeve të papaguara jep edhe analiza e detyrimeve sipas llojit të tatimeve e taksave.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton që peshën kryesore të detyrimeve të papaguara e zënë:

Detyrimet e papaguara për tatimin mbi fitimin për shumën 16,060 milionë lekë, ose në masën 23% të gjithë detyrimeve.

Detyrimet e papaguara për TVSH-në për shumën 25,380 milionë lekë, ose 36% të gjithë detyrimeve.

Detyrimet e papaguara për Kontributet e Sigurimeve Shoqërore e Shëndetësore për shumën 8,542 milionë lekë, ose 12% të gjithë detyrimeve.

Detyrimet e papaguara për Akcizën për shumën 8,541 milionë lekë, ose 12% të gjithë detyrimeve.


Detyrimet e papaguara për TAP për shumën 2,248 milionë lekë, ose 3% të gjithë detyrimeve.

në milionë lekë

	Vlerë	%
1 Detyrime për Tatim Fitimin	16,060	23%
2 Detyrime për TVSH	25,380	36%
3 Detyrime për Kontributet e sigurimeve shoqërore	8,542	12%
4 Detyrime për Akcizën	8,541	12%
5 Detyrime për TAP	2,248	3%
6 Detyrime të tjera	9,165	17%

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Mosha e borxhit është një tjetër tregues i natyrës së tij.



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Borxhi i vjetër, ai mbi 2 vjet, përbën zë rreth 26% të borxhit total, gjë që tregon për një nivel të lartë të “zonës së rrishtit” të borxhit, si një borxh i paarrësueshëm. Niveli i kësaj zone ulët vetëm me marrjen paraprakisht të masave shtrënguese, në kohë dhe të sakta. *Deri më tani, këto masa rezultojnë të pamarrë në nivelin e mjaftueshëm*

Nga kontrolli i ushtruar mbi dokumentacionin e paraqitur për zbatimin e kërkesave të ligjit nr. 9920, datë 19/05/2008 “Për Procedurat Tatimore në RSh”, Kreu XI “Mbledhja me Forcë e Detyrimit Tatimor të Papaguar”, bazuar tek neni 88 “Autoriteti dhe kompetencat për mbledhjen e detyrimit tatimor të papaguar”, neni 89 “Njoftimi dhe kërkesa për të paguar”, neni 90 “Urdhri i bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit”, neni 91 “Masa e sigurimit të detyrimit tatimor”, neni 93 “Sekuestrimi i pasurisë”, neni 97 “Transferimi i detyrimit tatimor palës së tretë”, neni 98 “E drejta për të kërkuar detyrimet nga pala e tretë” dhe neni 99 “Përgjegjësia e ortakut, aksionarit dhe administratorit”, u konstatua se gjatë vitit 2012, janë aplikuar masa shtrënguese si mëposhtë:

Nr.	LLOJET E MASAVE SHTRËNGUESE	Të vendosura viti 2011		Të vendosura viti 2012	
		Numri	Shuma mijë/lekë	Numri	Shuma mijë/lekë
1.	Njoftim për pagesë			36,271	10,361,089
2.	Urdhër bllokime të llogarive bankare	14,949	22,671,090	33,314	13,522,563
3.	Njoftim i përgjithshëm për vendosje të barrës hipotekore dhe siguruese.	4,074	2,085,439	3,760	3,034,552
4.	Njoftim të tatimpaguesit për vendosjen e masave të sigurisë	2,857	1,344,397	3,170	3,066,385
5.	Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore	5,160	6,675,163	14,495	6,114,947
6.	Njoftim për vendosjen e Barrës Siguruese	4,681	4,280,994	13,227	5,386,924
7.	Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë	815	1,190,205	1,131	1,096,844
8.	Njoftim Transferimi detyrimi tatimor palës së	2	2,587	-	-

	tretë				
9.	Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit	3	110,971	-	-
10.	Njoftim për vendosje Urdhër Bllokimi në Doganë	540	3,355,872	961	3,411,360

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme konstatohet se:

1. Urdhërblokime të llogarive bankare janë shtuar në numër, nga 14,949 në 33,314, ndërkohë që ka rënë vlera e masës, nga 22,671 milion lekë në 13,522 milion lekë.
2. Njoftim i përgjithshëm për vendosje të barrës hipotekore e siguroese ka rënë në numër, nga 4,074 në 3,760, ndërkohë që në vlerë ka pësuar rritje, nga 2,085 milionë lekë në 3,034 milionë lekë.
3. Njoftim të Tatimpaguesit për vendosjen e Masave të Sigurisë janë shtuar në numër, nga 2,857 në 3,170, ndërkohë që është rritur vlera e masës, nga 1,344 milionë lekë në 3,066 milionë lekë.
4. Njoftim për vendosjen e Barrës Hipotekore janë shtuar në numër, nga 5,160 në 14,495, ndërkohë që ka rënë vlera e masës, nga 6,675 milionë lekë në 6,114 milionë lekë.
5. Njoftim për vendosjen e Barrës Siguroese janë shtuar në numër, nga 4,681 në 13,227, ndërkohë që është rritur vlera e masës, nga 4,280 milionë lekë në 5,386 milionë lekë.
6. Urdhër Sekuestrimi të Pasurisë janë shtuar në numër, nga 815 në 1,131, ndërkohë që ka rënë vlera e masës, nga 1,190 milionë lekë në 1,096 milionë lekë.
7. Njoftim Transferimi detyrimi tatimor Palës së Tretë dhe Njoftim për transferimin e detyrimit Ortakut, Aksionerit, Administratorit nuk ka patur.
8. Njoftim për vendosje Urdhër Bllokimi në Doganë janë shtuar në numër, nga 540 në 961, ndërkohë që është rritur vlera e masës, nga 3,355 milionë lekë në 3,411 milionë lekë.

Në total numri i masave shtrënguese është rritur nga 33,801 në 106,329. Vlera e masave shtrënguese është rritur nga 41,716 milionë lekë në 45,994 milionë lekë. Në totalin e masave shtrënguese peshën kryesore si në numër subjektësh dhe në vlerë e zënë masa Urdhër Bllokimi i Llogarive Bankare, që është dhe më e lehta për t'u zbatuar. Situatë e njëjtë me atë të vitit 2011.

Auditimi i të dhënave për arkëtimet e detyrimeve dhe gjendjes së borxhit në fillim dhe në fund të vitit 2012, në total dhe sipas DRT-ve, rezultojnë se ka një rënie të konsiderueshme të vlerës së arkëtuar në krahasim me vlerën e propozuar si dhe inefficencë të masave shtrënguese. Kështu, vlera e arkëtuar në raport me vlerën e propozuar rezultojnë 6.7% në vitin 2011 dhe rreth 8.7% në vitin 2012, gjë që ka ardhur kryesisht si pasojë e:

- Mungesës së kontrolleve apo vizitave në Drejtoritë Rajonale Tatimore për të shqyrtuar funksionimin e mbledhjes dhe masave shtrënguese nga zyra, detyrë kjo e përcaktuar në pikën 15.3 në Rregulloren e Brendshme të DPT-së;
- Mosvlerësimin dhe mospropozimin të masave disiplinore nga Drejtoria e Borxhit në DPT për punonjësit e DRT-ve të ngarkuar me ligj për aplikimin e masave shtrënguese ndaj subjekteve debitoare;
- Mungesës së mbajtjes së Regjistrit Kombëtar të Borxhit nga strukturat përkatëse të Drejtorisë së Mbledhjes së të Ardhurave në DPT;
- Mosrakordimit të gjendjes së borxhit nga DRT-të me DPT-në dhe mosrakordimit të nivelit të borxhit midis Drejtorisë së Kontabilitetit dhe Drejtorisë së Borxhit brenda vetë strukturave të DPT-së, etj, kjo si pasojë e mungesave në parashikimet e rregullimeve kontabël që duhet të shoqëronin skemën e faljeve dhe teknikat e këtyre procedurave për elementë të caktuar të ligjit të faljes.

8. Mbi pamundësinë për të audituar të ardhurat në DPT

Një problem tepër shqetësues dhe tejet pengues për KLSH-në për ushtrimin e detyrave të tij kushtetuese dhe ligjore që vazhdon prej vitesh dhe kërkon zgjidhje, është konflikti i

kompetencave të krijuar artificialisht ndërmjet KLSH dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. DPT, aktualisht është i vetmi institucion shtetëror që nuk i nënshtrohet plotësisht procesit të auditimit të mbledhjes së të ardhurave, siç përcaktohet në Deklaratën e Limës ose ndryshe Kushtetuta e Institucioneve Supreme të Auditimit, në Kushtetutën e Shqipërisë, Ligjin Organik të KLSH-së dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit.

DPT dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore në varësi të saj, në interpretim të gabuar të dispozitave ligjore në fuqi, kanë ndërhyrë në të drejtat dhe kompetencat që i takojnë ekskluzivisht KLSH-së, si Institucioni Suprem i Auditimit, nëpërmjet mosvënies në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar prej tij në zbatim të programeve të auditimit dhe të vendosjes së procedurave kufizuese "ekstra ligjore", nëpërmjet të cilave kërkohet miratimi paraprak nga ana e DPT-së, i programeve të auditimit të KLSH dhe dokumentacionit që do t'i vihet atij në dispozicion.

Përpjekjet e KLSH-së për zgjidhjen me mirëkuptim dhe në rrugë administrative të konfliktit të mësipërm të kompetencave kanë qenë të vazhdueshme, madje për këtë janë ndjekur të gjitha hapat e nevojshëm për arritjen e nënshkrimit të një memorandumit mirëkuptimi ndërmjet KLSH-së, DPT-së dhe Ministrisë së Financave. Ndonëse në lidhje me këtë iniciativë ndërinstucionale me mirëkuptimin dhe dakordësinë e Ministrit të Financave u arrit të përgatitej edhe një draft memorandum, DPT e ka lënë këtë çështje në heshtje të plotë institucionale.

Për pasojë, ndërmjet institucionit të KLSH dhe DPT vazhdon të jetë e pranishme situata e konfliktit të kompetencave dhe e pengimit të KLSH-së në ushtrimin e funksioneve të tij audituese. Për këtë konflikt, i jemi drejtuar Gjykatës së Apelit Tiranë dhe kemi pritshmërinë e konfirmimit prej saj të së drejtës ligjore që ka KLSH për ushtrimin e pushtetit të tij në drejtim të aksesit të plotë dhe pa kushte në dokumentacionin e konsideruar prej tij si të nevojshëm për kryerjen e auditimeve.

Në kushtet e marrjes së informacionit vetëm statistikor, nuk kemi mundur të vlerësojmë nivelin e efikasitetit dhe efektivitetin e punës së punonjësve të administratës tatimore në mbledhjen e të ardhurave apo funksionimin e sektorëve të caktuar të strukturave në bazë.

III.2.b DPD dhe njësitë e saj vartëse

Programimi dhe realizimi i të ardhurave doganore nga sistemi doganor, për vitin 2012.

KLSH për vitin 2012 në bazë të programeve të miratuara të auditimit ka ushtuar auditime ligjshmërie në 6 degë doganore, Drejtorinë e Hetimit Doganor dhe një auditim ekonomik financiar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave

Nga auditimi i programimit dhe realizimit të të ardhurave doganore, administrata doganore ka mbledhur 128.4 miliardë lekë, 1.8 përqind më pak se parashikimi për 2012, dhe vetëm 328 miliona leke me shume se një vit më parë, me rritje pothuajse zero. Sipas zërave të të ardhurave që mbledh administrata doganore, i vetmi ze me rritje është renta minerare në eksport, që është rritur mbi baza vjetore me rreth 60.2 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore.


Gjatë auditimeve në degët doganore për vitin 2012 rezultuan shkelje të legjislacionit doganor me pasojë dem ekonomik në këto degë doganore me vlerë 29 355 mijë lekë të cilat përbëhen nga detyrime doganore të pallogaritura dhe të papaguara për mos zbatim të procedurave të zhdoganimeve të kryera në importimin e disa artikujve të ndryshëm 23 403 mijë lekë; detyrime dhe penalitete të pavendosura për subjekte që operojnë me Regjim Përpunimi Aktiv 263 mijë lekë; detyrime doganore të papaguara për diferencë në peshe me ato të deklarates doganore 3 530

mijë lekë; detyrime dhe penalitete te pavendosura per mospagim te TVSH: 1 139 mijë lekë; detyrime doganore te papaguara ne zhdoganimin e automjeteve 270 mijë lekë; etj.

Të ardhurat nga akciza në doganë rezultojnë me rënie prej -0.3 përqind kundrejt planit të rishikuar pas kalimit të akcizës te administrata doganore dhe ne te njejtin nivel me nje vit me pare. Të ardhurat nga TVSH në import janë -1.2 përqind ose 1.2 miliarde leke më të ulëta se një vit më parë dhe -2.5 përqind më pak se parashikimi për periudhën 12 mujore.

Tabela 1 - Plani dhe realizimi në strukturë i të ardhurave doganore, për vitin 2012 dhe fakti 2011.


Nr.	Të Ardhurat	Nj.Mat	Viti 2012			Fakti 2011
			Plani	Fakti	%	
1	Taksa doganore	000/lekë	6,053,000	6,117,565	101	6,848,281
2	Tvsh	-"	94,112,000	91.773.284	97,5	92,925,089
3	Akciza	-"	24,625,000	24,552,520	99.7	24,584,740
4	Renta minerare	-"	5,942,000	5,889,650	99.1	3,624,537
Totali		-"	130,732,000	128.333.019	98.2	127,983,810



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

– Realizimi i të ardhurave doganore sipas zërave për vitin 2012

Fakti 2012



Plani i të ardhurave doganore në vitin 2012, ka tre nivele realizimi kështu; në krahasim me planin fillestar ai është realizuar në masën 95,4 %, me një diferencë në vlerë 6,213,250 mijë lekë, në krahasim me planin e korigjuar në muajin tetor ai është realizuar në masën 92,7 %, me një diferencë në vlerë 10,213,250 mijë lekë, dhe në krahasim me planin përfundimtar të korigjuar në muajin dhjetor ai është realizuar në masën 98,9%, me një diferencë në vlerë 1,482,250 mijë

lekë, ndërsa në krahasim me faktin e vitit 2011 ai është realizuar në masën 100,9 %, buxhetit të shtetit i janë dhënë 1,266,940 mijë lekë të ardhura doganore më shumë se një vit më parë.

Tabela 2 - Plani dhe realizimi në strukturë i të ardhurave doganore, sipas degëve doganore për vitin 2012 dhe krahasimi me vitin 2011.

në 000/ lekë

Nr	Degët Doganore	Viti 2012		Fakti 2011	% ndaj totalit	% e realizimit v. 2012	Raporti % 2012 ndaj/11
		Plani	Fakti				
a	b	1	2	3	4	5	6
1	Berat	889,739	767,349	693,601	0.6	86	111
2	Bllatë	180,807	155,209	225,296	0.1	86	69
3	Durrës	49,518,051	49,667,665	49,847,957	38,7	100	100
4	Elbasan	2,978,213	2,868,335	3,014,014	2.2	96	95
5	Fier	2,602,266	2,297,512	2,743,647	1.8	88	84
6	Gjirokastër	6,041,589	6,354,910	5,836,403	5	105	109
7	Korçë	342,338	278,831	403,163	0,2	81	69
8	Kapshticë	4,366,145	3507117	5836403	2,7	80	69
9	Kukës	739,526	734,048	621,691	0,6	99	118
10	Lezhë	1,204,175	1,169,773	1,133,526	0,9	97	103
11	Qafë Thanë	1,081,904	1,058,494	1,145,555	0,8	98	92
12	Rinas	3,045,625	2,699,659	3,379,804	2,1	89	80
13	Sarandë	413,936	327,725	437,482	0,3	79	75
14	Shkodër	4,460,878	4,006,418	4,614,302	3,1	90	87
15	Tiranë	40,127,439	40,205,262	39,091732	31,3	100	103
16	Tre Urat	48,711	42,442	44,734	0,03	87	95
17	Vlorë	12,690,658	12,192,270	9,685,712	9,5	96	126
Totali		130,732,000	128,333,019	127,983,810	100	98.2	100,9

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se; struktura e të ardhurave doganore përbëhet nga tatimi mbi vlerën e shtuar (i cili përbën bazën e saj) në masën 71,7 %, ose në vlerë 92,690,546 mijë lekë, taksimi i akcizës në masën 19 %, ose në vlerë 24,552,530 mijë lekë, taksat doganore në masën 4,7 % ose në vlerë 6,117,565 mijë lekë, renta minerare në masën 4,5 % ose në vlerë 5,889,650 mijë lekë.

Nga 17 Degë Doganore gjithsej, katër prej tyre, Durrësi 38,7 %, Tirana 31.3 %, Vlora 9,5 % dhe Gjirokastra 5 % kanë realizuar së bashku 85 % të planit vjetor të ardhurave doganore, për vitin 2012.

Kanë realizuar dhe tejkaluar planin e të ardhurave doganore, për vitin 2012 Degët e Doganave, Durrës 100 %, Gjirokastër 105 % dhe Tiranë 100 %.

Kanë ruajtur nivelin e realizimit dhe kanë tejkaluar të ardhurat faktike të vitit 2011 Degët e Doganave Berat 111 %, Durrës 100 %, Gjirokastër 109 %, Kukës 118, Lezhë 103, Tiranë 103 % dhe Vlorë 126 %.

Nuk kanë realizuar planin e të ardhurave doganore të vitit 2012 dhe nuk kanë ruajtur as nivelin e të ardhurave të realizuar në vitin 2011 Degët e Doganave, Bllatë 86-69%, Korçë 81-69%, Kapshticë 80-69 % dhe Rinas 89-80 % etj.

Analiza e të ardhurave doganore sipas zërave.

1. Të ardhurat nga taksat doganore;

Gjatë vitit 2012 ato janë realizuar në vlerë 6,117,565 mijë lekë, ose 1 % më shumë se sa parashikimi, ndërsa krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit kaluar ato janë ulur në vlerë 730,716 mijë lekë ose në masën 12 %.

Ulja e të ardhurave nga taksat doganore ka ardhur kryesisht si rezultat i uljes së nivelit mesatar të taksave doganore gjatë vitit 2012 nga 1,52 % në 1,41 % (- 0.11 %) dhe rënies së importit të mallrave të taksueshëm në vlerë 16,253,000 mijë lekë, krahasuar me të njëjtën periudhë të

vitit 2011. Si rezultat i uljes së përvitshme të nivelit të taksave doganore, të ardhurat nga kjo taks kanë ardhur në rënie të vazhdueshme, kështu në vitin 2012 krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2008, ato janë ulur në vlerë 2,542,000 mijë lekë, ose në masën 41,5 %, kjo taksë po shkon drejt fundit të zbatimit të saj, lidhur me importet nga vendet e Bashkimit Europian.

2. Të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar;

Të ardhurat nga tatimi mbi vlerën e shtuar, kanë pasur një ecuri tejet pozitive gjatë viteve 2009,2010 dhe 2011, me një rritje respektivisht në vlerë 2,438,000 mijë lekë, 9,045,000 mijë lekë dhe 6,510,000 mijë lekë.

Gjatë vitit 2012, nga 94,112,000 mijë lekë të programuara janë realizuar 91.773.284 mijë lekë ose në masën 97,5 %. Për një përcaktim sa më të sakt të faktorëve që kanë ndikuar mos realizimin e të ardhurave nga tatimi mbi vlerën e shtuar, për vitin 2012, analizuam importet e mallrave si më poshtë:

Tabela 3 në mln/lekë - Të dhënat mbi importin në vlerë të mallrave, për vitet 2011 dhe 2012
në milionë lekë

Nr	Lloji importeve	Vitet		Diferenca në vlerë	Në %, 2012 ndaj 2011	në % ndaj totalit	
		2011	2012			2011	2012
1	Imp i taksushëm	451,367	435,114	-16,253	96,4	80	78,4
2	Imp i pataksushëm	29,068	31,983	+2915	110	5,2	5,8
3	Imp për R.P.Aktiv	68,303	65,845	-2,458	96,4	12,2	11,9
4	Importe të tjera	14,764	21,577	+6,813	146	2,6	3,9
Totali importeve		563,502	554,519	-8,983	98,4	100	100

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Mos realizimi i të ardhurave doganore nga tatimi mbi vlerën e shtuar ka disa arsye, por më kryesoret janë;

- rënia e nivelit të importit të mallrave të taksushëm në vlerë 16,253,000 mijë lekë, ose në masën 21,6 %.
- rritja e volumit të importit të mallrave të pataksushëm, në vlerë 2,915,000 mijë lekë, ose në masën 10 %, si rezultat i zbatimit të politikave qeverisëse mbi importet.

3. Të ardhurat nga akciza

Në periudhën janar-dhjetor 2012 ato janë realizuar në vlerë 24,552,520 mijë lekë, me një diferencë prej 72,480 mijë lekë ose në masën 99,7 %, ndërsa krahasuar me vitin 2011 janë realizuar 32,318 mijë lekë të ardhura më pak.

Rritja e të ardhurave doganore në vlerë 4,000,000 mijë lekë nga Ministria e Financave është e lidhur ngushtë me argumentin e kalimit të administrimit të taksimit të Akcizës nga Administrata Tatimore në Administratën Doganore, më 01.10.2012.

Në këto kushte audituam realizimin e të ardhurave nga akciza në tremujorin e katër të vitit 2012 dhe e krahasuam atë me të njëjtën periudhë të vitit 2011, nga ku rezultoi se; në tremujorin e katër të vitit 2012 ishin realizuar 7,949,000 mijë lekë dhe në të njëjtën periudhë të vitit 2011 ishin realizuar 7,522,000 mijë lekë, ose më shumë 427,000 lekë, që do të thotë aspak për ngjarjen e ndodhur.

Për të arritur në një konkluzion të përafërt; krahasuam nivelin e të ardhurave të akcizës të administruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, për tremujorët e fund viteve 2011,2012, duke ju referuar vetëm detyrimeve për akcizën që kanë artikujt Cigare, Pije Alkoolike, Karaburante dhe Birrë që janë administruar nga të dyja administratat, por në vite të ndryshme.

Nga analiza e të dhënave të mësipërme konkludojmë se të ardhurat nga akciza në tremujorin e katër të vitit 2012 nuk janë realizuar sipas parashikimit për dy arsye kryesore;

Së pari, pagesa e parakohshme e mbi 2,000,000 mijë lekë akcizë nëpërmjet blerjes me shumicë të pullave fiskale, para se të bëhej transferimi i administrimit të saj nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave,
Së dyti, mos funksionimi i rregullt i industrisë përpunuese të naftës gjatë tremujorit katër ka influencuar negativisht në realizimin e të ardhurave nga akciza.

Tabela 4 - Të dhëna mbi importin e disa artikujve kryesorë të akcizës.

Nr.	Artikujt	Vitet		Raporti në % 2012 ndaj 2011
		2011	2012	
1	Cigare, në ton	3250	3631	111,7
2	Kafe, në ton	6546	6884	105,2
3	Karburante, në ton	457,250	431,858	94,5
4	Birrë, në 000/litra	31446	29674	94,4

Tabela 5 - Struktura e realizimit të të ardhurave nga akciza e ndarë për DPT dhe DPD

në mijë/lekë

Nr.	Artikujt	D.P.Tatimeve, Akcizat e 3/mujorit tetor- dhjetor 2011	Drejtoria e Përgjithshme e Doganave				
			Akcizat e 3/mujorit tetor-dhjetor 2012			Gjithsej	
			E Importuar		E brendshme		
			Detyrimi	Paguar	Paguar	Detyrimi	Paguar
1	Cigare	2,833,880	3,604,138	1,455,904	375,655	3,604,138	1,832,440
2	Pije alkoolike	229,121	204,257	78,711	56,097	260,354	134,808
3	Karburante	550,873	-	-	122,956	-	122,956
4	Birrë	64,231	161,423	66,622	66,622	228,044	133,243
Shuma		3,678,105	-	-	-	4,092,537	2,222,565

Nga analiza e të dhënave të mësipërme rezulton se; importi i artikujve cigare dhe kafe është rritur respektivisht me 11,7 dhe 5,2 %, ndërsa importi i karburanteve dhe i birrës kanë rënë pothuajse me të njëjtin nivel rreth 5,6 %.

Rënia e importit të karburanteve në sasi 25,392 ton dhe e importit të birrës në sasi 1,772 mijë litra ka ndikuar negativisht në realizimin e planit të ardhurave, për vitin 2012. Për rënieën e nivelit të importeve të këtyre artikujve nuk është paraqitur ndonjë analizë apo argument konkret, nga strukturat përkatëse.

4. Të ardhurat nga renta minerare

Të ardhurat nga renta minerar në vitin 2012 zinin 4,6 % të ardhurave doganore gjithsej.

Të ardhurat nga renta minerare në vitin 2012 nga 5,942,000 mijë lekë të programuara janë realizuar në vlerë 5,889,650 mijë lekë, ose në masën 99,1 %, ndërsa krahasuar me faktin 2011 janë arkëtuar 2,265,113 mijë lekë të ardhura më shumë.

Sipas zërave të të ardhurave që mbledhin doganat, i vetmi ze me rritje është renta minerare në eksport, që është rritur mbi baza vjetore me rreth 60.2 përqind, kryesisht si pasojë e rritjes së eksporteve të burimeve natyrore.

Këto të ardhura janë rritur më tepër falë vendosjes së taksës që përlogarit rentën edhe për mineralin e nxjerre edhe për atë të përpunuar. Kjo rritje ka ndodhur edhe falë rritjes së çmimeve të lëndëve të para në tregun ndërkombëtar. Renta minerare ka shtuar të ardhurat në buxhet, duke konsideruar faktin se bëhet fjalë për produkte, me të cilat nëntoka shqiptare është e pasur.

Shfrytëzimi i lëndëve të para në vendin tonë gjatë viteve të fundit është rritur ndjeshëm, veçanërisht për shkak të çmimeve më të larta të naftës e mineraleve në tregun ndërkombëtar. Shfrytëzimi i burimeve naftëmbajtëse të jugut është shtuar së bashku me burimet e kromit apo bakrit në veri si edhe shfrytëzimi i gurit gëlqeror si lëndë e parë për prodhimin e çimentos.

5. Realizimi i të ardhurave dytësore.

Krahas punës së kryer për realizimin e të ardhurave primare, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave ka punuar dhe për krijimin dhe administrimin e të ardhurave dytësore.

Të ardhurat dytësore 2012

Të ardhurat dytësore në vitin 2012, janë ulur në vlerë 27,305 mijë lekë, ose në masën 6 %, krahasuar me vitin 2011.

Nga të ardhurat dytësore të realizuar në vitin 2012 në vlerë 418,769 mijë lekë janë derdhur në buxhetin e shtetit 324,625 mijë lekë, ose 77,5 % e tyre, ndërsa diferenca në vlerë 94,144 mijë lekë, ose 22,5 %, është përdorur nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për shpërblime në vlerë 50,836 mijë lekë, ose 54 %, për shpenzime operative 36,979 mijë lekë, ose 39,3 %, për investime në vlerë 6,182 mijë lekë, ose 6,56 % dhe për transferta 147 mijë lekë, ose 0,155 %.

Në këto kushte kemi zbatim korrekt të kërkesave të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” neni 296, ku theksohet se; “të ardhurat që burojnë nga zbatimi i sanksioneve dhe i shitjes së objekteve të kontrabandës të konfiskuara shpërndahen; 50 %, derdhen në buxhetin e shtetit. 50 % përdoren nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, në bazë të përqindjeve të caktuara nga Ministria e Financave.

Të metat dhe mangësitë e konstatuara nga analizat e kryera sa më sipër, lidhur me realizimin e planit të ardhurave doganore për vitin 2012, rezultojnë se; ato në përgjithësi kanë ardhur kryesisht nga; *mungesa e përgjegjësisë e stafëve drejtuese të 14 Degëve Doganore (nga 17 gjithsej), që sëbashku kanë krijuar një defiçit në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerë 2,939,739 mijë lekë, duke suprimuar dhe tejkalimin e të ardhurave në vlerë 540,758 mijë lekë të krijuara nga Degët e*

Doganave Durrës, Gjirokastrë dhe Tiranë, por më keq akoma disa prej tyre nuk kanë ruajtur as nivelin e të ardhurave që ato kanë realizuar në vitin 2011.

Tabela 6 - Të ardhurat dytësore 2012

Nr.	Të ardhura	Gjithsej	Administrata Qëndrore	Degët e Doganave	në mijë/lekë	
					Fakti 2011	Raporti % v. 2012/2011
1	Qeratë e ndërtesave	24,759	269	24,490	18,872	131
2	Parkingjet dhe peshoret	85,177	0	85,177	79,550	107
3	Dyty Free	6,744	6,000	744	12,222	55
4	Gjobat	213,550	3,367	210,183	212,681	100
5	Kamat vonesat	2,727	0	2,727	18,557	15
6	Sekuestrimet	4,190	0	4,190	3,599	116
7	Të tjera	81,622	446	81,176	100,593	81
Shuma		418,769	10,082	408,687	446,074	94

Borxhi doganor

Sipas të dhënave të DPD-së, gjendja në vlerë e borxhit doganor, është rritur në vlerë dhe në numur subjektësh. *Nga 2,959 milionë lekë të rezultuar më 31/12/2011, ka arritur në 4,086 milionë lekë, me një rritje në masën 38% dhe në vlerë 1,127 milionë lekë më tepër.*

Kundrejt të ardhurave doganore të realizuara në vitin 2012, vlera e borxhit doganor zë rreth 3.18% nga 2.3% që zinte në fillim të vitit 2012. Gjendja e borxhit doganor në fillim dhe fund vitin 2012, si dhe shtesat e pakësimit gjatë vitit 2012, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 7 – Ecuria e borxhit doganor për vitin 2012

në milionë/lekë

Viti	Gjendja në fillim		Shtuar gjatë vitit		Pakësuar gjatë vitit		Gjendja në fund	
	Numri	Vlerë	Numri	Vlerë	Numri	Vlerë	Numri	Vlere
2012	1057	2,959	1501	2,186	1462	1,059	1096	4 086

Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se gjatë vitit 2012 borxhi doganor është shtuar me 1501 subjekte në vlerë 2,186 milionë lekë, është pakësuar me 1462 subjekte në vlerë 1,059 milionë lekë dhe në total paraqitet me 39 subjekte më shumë dhe në vlerë 1,127 milionë lekë më tepër, krahasuar me fundin e vitit 2011. Ndërkohë që, raporti i borxhit të shtuar me atë të pakësuar është rreth 2 herë më i lartë (2,186 milionë lekë/1,059 milionë lekë), çka tregon se edhe për periudhën analizuuese 2012 nga administrata doganore veçanërisht nga strukturat e specializuara të saj, nuk është punuar sa dhe si duhet dhe me përgjegjshmëri në drejtim të zbatimit të legjislacionit për rikuperimin e borxhit doganor dhe minimizimin e krijimit të borxhit të ri.

Në gjendjen totale të borxhit doganor të pasqyruar sa më sipër, bëjnë pjesë dhe 185 raste në vlerë 1,551 milionë lekë, borxh i krijuar nga zbatimi i skemës së shtyrjes së pagesës së TVSH-së, ndërsa 397.8 milionë lekë, ose 9,7% të totalit të borxhit e përbëjnë kamat vonesat e zbatuara nga autoritetet doganore kompetente mbi borxhin doganor të trashëguar.

Gjatë vitit 2012, borxhi doganor i trashëguar është rritur për efekt të vendimeve administrative të nxjerra nga autoritetet doganore kompetente në 714 raste në vlerë 1,430 milionë lekë, ose 65% ndaj totalit, kryesisht në Degët e Doganave Durrës në vlerën rreth 490 milionë lekë ose në masën 34%, Tiranë në vlerën 276 milionë lekë ose 19%, Rinas 150 milionë lekë ose 10,5%, Kakavijë 113.4 milionë lekë ose 7.9 % dhe Peshkopi 115.4 milionë lekë ose në masën 8%.

Borxhi doganor i krijuar gjatë vitit 2012 me të gjithë komponentët përbërës të tij është konstatuar kryesisht; nga kontrollet e ushtruara nga autoritetet doganore kompetente, Departamenti Operativ-Hetimor (drejtoria Hetimit, Antikontrabandës dhe Pas Zhdoganimit), drejtoria Auditit të Brendshëm, si dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit.

Këto struktura, si shkaqe kryesore që kanë ndikuar në rritjen e borxhit doganor kanë përcaktuar: *vlerësimin e pasaktë të mallrave të importuar, klasifikimin e gabuar të Kodit Tarifor, zhdoganimin e mallrave me fatura të falsifikuara, mosrespektimin e afateve ligjore të përshkruara në autorizimet e lëshuara për zbatimin e skemës së shtyrjes së pagesës së TVSH-së për makineritë e importuara, mungesën e mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike, mosrespektimin e afateve ligjore për Regjimin e Lejimit të Përkohshëm, si dhe vlerësimin e keq të praktikave doganore të zhdoganimit të autoveturave etj.*

Tabela 8 - Struktura e borxhit doganor në fund të vitit 2012

Nr.	Emërtimi	Numri i subjekteve	Vlera në milionë/lekë	Në % ndaj totalit
1.	Detyrime Doganore të papaguara	-	2,105	51.5
2.	Penalitete të zbatuara	-	1,465	35.9
3.	Kamat vonesa të aplikuara	-	516	12.6
Totali:		1096	4,086	100.0

Nga të dhënat e mësipërme, borxhi doganor përbëhet nga 2,105 milionë lekë detyrime doganore të papaguara, ose në masën 51,5% të totalit të borxhit, 1,465 milionë lekë gjoba të zbatuara, ose në masën 35,9% të borxhit gjithsej dhe rreth 516 milionë lekë kamat vonesa të aplikuara nga autoritetet doganore kompetente, ose në masën 12,6% të totalit të borxhit.

Në shtimin e borxhit doganor të vitit 2012, kanë ndikuar negativisht vendimet e nxjerra nga autoritetet doganore kompetente në vlerën 672.8 milionë lekë, *për mosrespektim të afateve ligjore të përcaktuara në autorizimet e nxjerra në zbatim të skemës së pagesës e TVSH-së nga*

subjektet importuese të makinerive, pajisjeve dhe energjisë elektrike". Borxhi doganor i krijuar nga mospagimi në kohë i TVSH-së së shtyrë, për importin e makinerive, pajisjeve dhe energjisë elektrik, ka ardhur nga moszbatimi korrekt nga autoritetet doganore kompetente i kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 559, datë 16.08.2006 "Për zbatimin e skemës së pagesës së TVSH-së", ndryshuar me vendimin nr. 1674, datë 24.12.2006.


Sipas degëve doganore, gjendja e borxhit në fillim dhe në fund të vitit 2012, si dhe vlera e shtuar dhe pakësuar gjatë këtij viti, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Tabela 9 - Gjendja e borxhit në fillim dhe në fund të vitit 2012, si dhe vlera e shtuar dhe pakësuar gjatë këtij viti

Nr.	Degët Doganore	Gjendja më 01/01/2012		Shtuar gjatë vitit 2012		Pakësuar gjatë vitit 2012		Gjendja më 31/12/2012	
		Subjekt	Vlerë	Subjekt	Vlerë	Subjekt	Vlerë	Subjekt	Vlerë
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8
1.	Berat	20	175,356	50	79,952	40	44,394	30	210,914
2.	Bllatë	5	16,899	19	119,323	7	3,453	17	132,769
3.	Durrës	118	665,094	291	659,547	227	270,210	182	1,054,531
4.	Elbasan	27	20,023	32	29,089	20	16,933	39	32,179
5.	Fier	21	121,605	62	66,559	27	101,039	56	87,124
6.	Gjirokastër	70	78,989	59	135,002	53	15,564	76	198,427
7.	Korçë	41	149,435	20	107,073	7	1,616	54	254,893
8.	Kapshticë	77	61,832	126	23,038	151	54,513	52	30,356
9.	Kukës	15	62,805	63	26,526	68	42,425	10	46,907
10.	Lezhë	23	26,635	8	27,160	9	14,508	22	39,286
11.	Qafë Than	10	55,145	31	17,905	28	4,371	13	68,679
12.	Rinas	3	275	19	170,598	20	20,761	2	150,112
13.	Sarandë	3	38,121	25	21,226	13	3,171	15	56,175
14.	Shkodër	34	140,885	44	35,456	51	8,599	27	167,742
15.	Tiranë	422	1,004,323	517	584,260	522	286,754	417	1,301,828
16.	Tre Urat	4	40,048	18	9,480	4	407	18	49,120
17.	Vlorë	164	301,763	117	73,385	215	170,029	66	205,119
Shuma:		1,057	2,959,232	1,501	2,185,579	1,462	1,058,747	1,096	4,086,160

në mijë/lekë

Grafiku 9.1 – Gjendja e borxhit në fillim dhe në fund të vitit 2012 për cdo degë doganore



Burimi: Drejtoria e Përgjithshme e Doganave

Nga analiza e të dhënave të mësipërme konstatohet se, Degët e Doganave Tiranë dhe Durrës së bashku përbëjnë 58% të borxhit doganorë gjithsej dhe në vlerë vlerën 2,356,359 mijë lekë;

ndërsa 15 doganat e tjera të marra së bashku kapin vlerën 1,729,801 mijë lekë, ose në masën 42% të borxhit gjithsej.

Shqetësuese paraqitet gjendja në degët doganore Korçë, Berat, Rinas, Shkodër, Tiranë, Kakavijë dhe Durrës, ku rritja e borxhit doganor në raport me të ardhurat vjetore 2012 të realizuara nga secila degë llogaritet respektivisht 90%, 27%, 5,5%, 4,2%, 3,2% dhe 3%.

Të dhënat e mësipërme tregojnë për punën e pamjaftueshme dhe me hope që kanë bërë stafet drejtuese të autoriteteve doganore kompetente, si dhe strukturat e specializuara të administratës doganore, lidhur me zbatimin e legjislacionit doganor, për administrimin dhe rikuperimin e borxhit doganor.

E theksojmë këtë mbasi ky është një fenomen i konstatuar në të gjitha kontrollet e ushtruara më parë, madje janë lënë dhe detyra për zbatim nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, por gjendja përsëri nuk ka ndryshuar. Gjithashtu, autoritetet doganore kompetente dhe strukturat e specializuara të administratës doganore nuk kanë arritur t'i zbatojnë plotësisht kërkesat e përcaktuara në nenin 245 të Kodit Doganor të RSH për rikuperimin e borxhit doganorë qoftë dhe me forcë, për arsye dhe pengesa nga më të ndryshmet, të cilat ende nuk kanë mundur t'i zgjidhin.

Disa nga shkaqet kryesore që kanë ndikuar drejtpërsëdrejti, në shtimin e borxhit doganor janë:

- Mosvlerësimi i saktë i mallrave të importuar.
- Falsifikimi i faturave, që shoqërojnë praktikat doganore të importit dhe klasifikimi tarifor i gabuar.
- Mosrespektimi i afateve ligjore të përshkruara në autorizimet e lëshuara për zbatimin e skemës së shtyrjes së pagesës së TVSH-së, për makineritë e importuara.
- Mungesa e mbikëqyrjes së regjimeve ekonomike.
- Mosrespektimi i afateve ligjore për Regjimin e Lejimit të Përkohshëm.
- Vlerësimi me mangësi i praktikave doganore të zhdoganimit të autoveturave.
- Mungesa e një programi të posaçëm pune në nivel institucional me masa konkrete, afate kohore dhe persona përgjegjës, për rikuperimin vjetor të borxhit doganor.
- Mospërfshirja në programin e të ardhurave vjetore të degëve doganore të kuotave të veçanta, për arkëtimin e detyrimeve të papaguara të borxhit doganor.
- Moszbatimi i Urdhrave Ekzekutive të nxjerra nga Autoritetet Gjyqësore të vendit në mbështetje të titujve ekzekutiv të nxjerra nga autoritetet doganore kompetente.
- Moszbatimi nga DPT e kërkesave të paraqitura nga DPD, lidhur me zbatimin e Urdhrave të Ekzekutimit të nxjerra nga Autoritetet Gjyqësore të vendit, bazuar në aktmarrëveshjen e nënshkruar ndërmjet tyre nr. 1340/3, datë 17.06.2002 dhe nr. 2248/1, datë 17.06.2002.
- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve doganore kompetente dhe sistemit bankar të nivelit të dytë.
- Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve doganore kompetente dhe Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.
- Mosangazhimi i plotë i Zyrave të Përmbartimit Gjyqësor të shtetit.
- Moszbatimi i legjislacionit doganor, për rikuperimin me forcë të borxhit doganor.

Nga auditimi i dokumenteve të paraqitura nga sektori i Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor rezulton se, Autoritetet Gjyqësore gjatë vitit 2012 kanë pajisur me Urdhra Ekzekutimi 237 Tituj Ekzekutiv të nxjerra nga autoritetet doganore kompetente në vlerë 1,361,020 mijë lekë, nga të cilat janë arkëtuar 64 raste në vlerë 167,882 mijë lekë, ose 12,3% e shumës.

Edhe gjatë vitit 2012, autoritetet doganore kompetente dhe sektori i Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor, kanë marrë disa masa për zbatimin e kërkesave të nenit 245, i ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, pika 2, “*autoritetet doganore, kur lind një borxh doganor, me qëllim që të sigurojnë pagimin e borxhit doganor, mund të marrin masat e mëposhtme*”:

a) “*Sekuestrimin e vlerave monetare, kredive, sendeve me vlerë, dokumenteve me anë të cilave bëhen pagesa, valuta të huaja të depozituara në një bankë, që i përkasin debitorit, personave të tretë ose garantuesve që kanë detyrime kundrejtë debitorit*”

Një kopje e Urdhërit të Ekzekutimit u është dërguar të gjitha bankave të nivelit të dytë për “vendosjen e masës së sekuestros dhe ekzekutimin e detyrueshëm mbi llogarinë e subjektit debitor”, në zbatim të nenit 595 të “Kodit të Procedurës Civile”, për kalimin e shumës së detyrimeve në numrin e llogarisë të autoritetit doganor kërkues, por nuk është arritur ndonjë rezultat konkretë.

Nga të dhënat dokumentare rezulton se, në asnjë rast borxhi doganor i krijuar nuk është ekzekutuar direkt nga bankat e nivelit të dytë, e cila tregon se kjo masë ligjore nuk ka funksionuar për rikuperimin e borxhit doganor gjatë vitit 2012.

b) “*Sekuestrimin e mallrave, pasurive të tundshme ose të patundëshme, që i përkasin debitorit, ose një pale të tretë ose garantuesit që ka detyrime kundrejtë debitorit*”.

Autoritetet doganore kompetente një kopje të Urdhrit të Ekzekutimit ua kanë dërguar të gjitha Zyrtarëve Vendore të Regjistrimit të Pasurive së Paluajtshme për “vënien në ekzekutim të detyrueshëm të Urdhrave të Ekzekutimit të nxjerra nga Autoritetet Gjyqësore të vendit”, lëshuar për subjektet debitore.

Në të gjitha kërkesat e dërguara nga Degët e Doganave në adresë të ZVRPP është kërkuar që niveli i sekuestimeve të arrijë deri në nivelin e borxhit doganor të llogaritur për t’u papaguar nga subjekti, në zbatim të Urdhrit të Ekzekutimit.

Në përgjigjet e dhëna nga drejtuesit e ZVRPP-ve në rrethe konstatohet se *ato nuk kanë marrë përgjegjësi për zbatimin kërkesave të dërguara nga autoritetet doganore kompetente lidhur me ekzekutimin e detyrueshëm të Urdhrave të Ekzekutimit, por theksojnë se ato duhet të zbatohen nga Zyrtarët Përmbarimore.*

Në zbatim të nenit 245, pika 3 e ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH” theksohet se, “autoritetet doganore, mund t’u kërkojnë autoriteteve kompetente edhe pezullimin e aktivitetit ekonomik të debitorit në lidhje me importimin, eksportimin dhe tranzitimin e mallrave, ose të aktiviteteve të tjera prodhuese, për ushtrimin e të cilave debitori është regjistruar pranë autoriteteve të taksave”.

Autoritetet doganore kompetente kanë kërkuar nga Administrata Doganore Qëndrore (Sektori i Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor), pezullimin në sistemin Assycuda Eorld të NIPT-ve të veprimtarive tregtare të subjekteve debitore deri në momentin e pagimit të detyrimit doganor të konfirmuar nga Dega Doganore përkatëse. Kjo është një ndër masat më efektive që mund të zbatohet Administrata Doganore, për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, por që nuk ka funksionuar për arsye se disa subjekte debitore janë tjetërsuar nëpërmjet ndryshimit të emrit, adresës, NIPT-it dhe administratorit.

Veprimet e pezullimit dhe të aktivizimit të NIPT-ve në sistemin Asycuda Eorld bëhen vetëm nëpërmjet praktikave me gjurmë shkresore, por këto praktika nuk administrohen në data basen e sektorit të Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor.

Administrata Doganore në zbatim të aktmarrëveshjes të përbashkët me nr. 2248, datë 17.06.2002 dhe nr.1340/3, datë 17.06.2002 të nënshkruar me DPT-në, i ka dërguar kësaj të fundit të gjitha kopjet e Urdhrave të Ekzekutimit të nxjerra nga Autoritetet Gjyqësore të vendit, duke kërkuar pezullimin e aktiviteteve ekonomike të subjekteve debitore deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve doganore, por ky bashkëpunim nuk ka funksionuar dhe nuk ka patur asnjë rast pozitiv. Përgjigjet e dhëna në disa raste nga organet tatimore, kanë qenë jo të plota, si: “*subjektet e kanë mbyllur aktivitetin*”, “*nuk janë aktivë*”, ose “*nuk gjenden në adresën e dhënë*”.

Në këto kushte, bashkëpunimi ndër institucional ka qenë tepër i vështirë dhe marrëveshja e lidhur pa efektivitetin e duhur.

Por, krejt ndryshe ka ndodhur me kërkesat e paraqitura nga DPT për pezullimin e NIPT-ve të subjekteve debitorë të saj në sistemin Assycuda World, të cilat janë zbatuar nga Administrata Doganore deri në momentin kur Drejtoritë Rajonale Tatimore kanë kërkuar me shkrim aktivizimin e këtyre subjekteve.

Në pikën 4, të nenit 245 të Kodit Doganor theksohet se, *“vendimet e marra nga administrata doganore për zbatimin e masave garantuese dhe/ose për rikuperimin me forcë të borxhit doganor, bëhen tituj ekzekutiv menjëherë sapo ato i njoftohen debitorit.”*

Ekzekutimi i vendimeve të sipër përmendur bëhet në bazë të dispozitave të parashikuara nga neni 511 e në vazhdim i Kodit të Procedurës Civile.

Nga auditimi i dokumenteve të paraqitur nga sektori i Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor; në fund të vitit 2012 janë regjistruar gjithsej 415 raste debitorë të mbështetur me Urdhra Ekzekutimi në vlerë 2,241,616 mijë lekë, ose sa 54,8% e vlerës së borxhit doganor gjithsej. Ndërsa, për vitin 2012 janë regjistruar 237 raste debitorë të mbështetur me Urdhra Ekzekutimi në vlerë 1,361,020 mijë lekë, ose sa 33,3% e vlerës së borxhit doganor gjithsej.

Titujt ekzekutiv të nxjerr nga administrata doganore, menjëherë sapo mbështeten me Urdhra Ekzekutimi nga Autoritetet Gjyqësore kompetente, mund të zbatohen në mënyrë të drejtëpërdrejtë nga organet e administratës doganore.

Disa nga autoritetet doganore kompetente në momentin e marrjes së informacionit që subjektet debitorë i kanë konsumuar të gjitha rrugët e ankimit administrative dhe ligjore, kanë kërkuar nga strukturat e specializuara të Drejtorisë së Antikontrabandës bashkëpunim konkret për rikuperimin me forcë të borxhit doganor.

Referuar dokumentacionit të audituar nga audituesit e KLSH, rezulton se gjatë vitit 2012 janë paraqitur në Drejtorinë e Antikontrabandës dhe Rikuperimit me Forcë të Borxhit Doganor nga autoritetet doganore kompetente, tetëmbëdhjetë (18) kërkesa për rikuperimin me forcë të borxhit doganor nga 237 Urdhra Ekzekutimi të nxjerra nga Autoritetet Gjyqësore për këtë vit, ose në masën 7,2%.

Nga 18 subjekte në vlerën 260,963 mijë lekë të kërkuara nga autoritetet doganore kompetente për rikuperim me forcë të borxhit doganor është arritur të arkëtohen 89,151 mijë lekë, ose në masën 34%, çka do të thotë se edhe kjo masë e zbatuar nga strukturat e specializuara të Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave nuk e ka dhënë efektivitetin e pritur.

Së fundi, cilësojmë se, të metat dhe mangësitë e parashtruara më sipër, kanë ardhur kryesisht nga moszbatimi i kërkesave të nenit 245, të ligjit nr. 8449, datë 27.01.1999 “Kodi Doganor i RSH”, i ndryshuar; kërkesave të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 205, datë 13.04.1999 “Për miratimin e Dispozitave Zbatuese të Kodit Doganor”, i ndryshuar; dhe kërkesave të udhëzimit nr. 4, datë 04.08.2006 i Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave “për zbatimin praktik të procedurës së evidentimit, kontabilizimit dhe vjeljes së borxhit doganor.”

III.3 Të ardhurat jotatimore

Për vitin 2012, të ardhurat jotatimore nga 23,230 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 23,963 milionë lekë ose në masën 103,2%, me një tejkalim në vlerë prej 733 milionë lekë. Impakti më i madh pozitiv në këtë kategori të ardhurash ka ardhur nga zëri “Të Ardhura nga institucione nbuxhetore”, i cili është realizuar në masën 112.3%, me një tejkalim në vlerë prej 1,126 milionë lekë.

Krahasuar me të ardhurat jotatimore të realizuara në vitin 2011, ato rezultojnë me rritje, përkatësisht nga 22,731 milionë lekë të realizuar në vitin 2011, në 23,963 milionë lekë në vitin 2012, ose në masën 5.4% më pak dhe në vlerë 1,232 milionë lekë më shumë. Këto të ardhura, nga 6.9% të totalit të të ardhurave të realizuara që zinin në vitin 2011, në vitin analizues 2012 zenë 7.25%, pra me një rritje prej 0.35 pikë përqindje.

Kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2012, këto të ardhura zenë 1.78% të tij, nga 1.75% të PBB-së që zinin në vitin 2011.

Nga shqyrtimi i strukturës së realizimit të të ardhurave jotatimore për vitin 2012 rezulton se, 2 (dy) nga zërat përbërës të tij paraqiten me realizim dhe tejkalim të kuotave të planifikuara, ndërsa 3 (tre) të tjerat me mosrealizim, dhe konkretisht:

- Të ardhurat nga “*Transferimi i fitimit nga Banka e Shqipërisë*” janë realizuar në masën 104.3%, me një tejkalim në vlerë prej 193 milionë lekë.
- Të ardhurat nga “*Institucionet buxhetore*” në masën 12.3%, me një tejkalim në vlerë prej 1,126 milionë lekë.
- Të ardhurat nga “*Dividenti*” në masën 99.1%, me vetëm 4 milionë lekë mosrealizim.
- Të ardhurat nga “*Tarifat e shërbimeve*” në masën 98% dhe në vlerë 78 milionë lekë më pak kundrejt parashikimit.
- Dhe të ardhurat nga zëri “*Të tjera*” në masën 90.5%, me një mosrealizim në vlerë prej 503 milionë lekë kundrejt parashikimit.

III.3.a Rregullshmëria e përcaktimit dhe kalimit të fitimit neto të BSH në buxhetin e shtetit.

Për auditimin e përcaktimit dhe të kalimit të fitimit neto të Bankës së Shqipërisë në buxhetin e shtetit, audituesit e KLSH janë mbështetur në:

a) Pikën 2, neni 10, të ligjit nr. 8269, datë 23/12/1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ku thuhet: “*Fitimi neto për vitin financiar që mbetet pasi bëhen zbritjet, sipas neneve 8, 9 dhe të pikës 1 të këtij neni, kalon në të ardhurat e buxhetit të shtetit brenda 4 muajsh, pra deri më datën 30 prill të vitit pasardhës*”.

b) Pikën 4.2, neni 4, të marrëveshjes të lidhur midis BSH dhe MF-ve dhe hyrë në zbatim më datë 26.03.2003, ku përcaktohet: “*Transferimi i fitimit të Bankës Shqipërisë bëhet me kërkesë të Ministrisë së Financave dhe jo më shpejt se data 7 e çdo muaji në formë paradhënie. Transferimi do të fillojë në muajin shkurt dhe do të përfundojë në muajin janar të vitit pasardhës. Masa e fitimit të derdhur, nuk do të tejkalojë vlerën 90% të fitimit të realizuar*”.

Nga KLSH është audituar i gjithë procesi i kalimit të fitimit gjatë vitit raportues 2012, që nga kalimimi i fitimit të pashpërndarë të vitit 2011, kalimi i fitimit paradhënie gjatë vitit 2012 dhe deri tek kalimi i fitimit të mbetur të vitit 2012, si pjesë e pa shpërndarë e tij. Konkretisht:

1. Përsa i takon kalimit të fitimit të pa shpërndarë të vitit 2011, është vepruar si më poshtë:

Nga auditimi i kryer në Bankën e Shqipërisë për vitin 2011, rezultoi se ky fitim është kaluar në datën 27/04/2012, brenda afateve të përcaktuara në nenin 10 të ligjit nr 8269, datë 23.12.1997 dhe është miratuar me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 12, datë 29.02.2012 “Për miratimin e bilancit financiar (pasqyrën e pozicionit financiar) dhe të shpërndarjes së fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2011”, ku në pikën 5 të tij, miratohet kalimi i të ardhurave në buxhetin e shtetit në shumën **1,203 milionë lekë**, duke prekur llogarinë nr.394100 “Fitim neto për t’ju paguar qeverisë pas miratimit të shpërndarjes së fitimit” dhe llogarinë nr.361100 “Depozitë e Qeverisë” Kalimi i fitimit në llogarinë përkatëse. Ky kalim është kryer pasi është dhënë edhe opinionimi i audituesve të jashtëm, në lidhje me pasqyrat financiare, sipas të cilëve ato janë paraqitur në përputhje me politikat kontabël.

Gjithashtu, në datën 24.01.2012 është kaluar për llogari të “Depozitës së qeverisë”, shuma prej **170 milionë lekë** si paradhënie e fitimit për muajin dhjetor 2011, duke prekur llogarinë “Paradhënie e fitimit të planifikuar”.

2. Për kalimin e paradhënies të fitimit gjatë vitit 2012, nga auditimi rezultoi se transferimi i fitimit në të ardhurat e buxhetit të shtetit, paradhënie për vitin 2012, ka rezultuar në total 4,020 milionë lekë, shumë e cila nuk e ka tejkaluar vlerën e 90% të fitimit të realizuar.

3. Për kalimin e fitimit të pashpërndarë të vitit 2012, nga auditimi rezultoi se:

Me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 19, datë 27.02.2013 “Për miratimin e pasqyrës së pozicionit financiar të Bankës së Shqipërisë dhe të shpërndarjes së fitimit të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012”, në pikën 5 të tij, ky vendim ka miratuar paraprakisht kalimin e të ardhurave në buxhetin e shtetit në shumën **prej 2,413 milionë lekësh**, si pjesë e pa shpërndarë e fitimit neto të Bankës së Shqipërisë për vitin 2012. Ndërkohë, në datën 06.03.2013 është kryer raportimi nga audituesit e jashtëm, të cilët kanë dalë në përfundimin se pasqyrat financiare të këtij institucioni paraqesin një pamje të saktë dhe të vërtetë si dhe janë hartuar në përputhje me parimet kontabël.

Banka e Shqipërisë, me shkresat e dy departamenteve përkatëse dhe të zv/gubernatorit të parë, në datën **10 prill 2013**, ka transferuar në MF-ve për llogari të “Depozitës së qeverisë” shumën prej **2,413 milionë lekë**.

Për këtë, rezulton se është respektuar afati i kalimit të fitimit, në përputhje me nenin 10, të ligjit nr 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.

Për vitin 2012, në mënyrë të përmbledhur, **fitimi neto**, kaluar nga Banka e Shqipërisë në Ministrinë e Financave, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Veprimet e kryera nga BSH në lidhje me shpërndarjen e fitimit	Datat e kryerjes së veprimit nga BSH	Shuma e derdhur në vitin 2012 për llogari të vitit 2011	Shuma totale e kaluar si paradhënie gjatë vitit 2012 (shkurt2012 -janar 2013)	Shuma e derdhur në vitin 2013 për llogari të vitit 2012
Derdhur paradhënie për muajin Dhjetor 2011	24.01.2012	170 milionë lekë		
Derdhur fitimi i pashpërndarë i vitit 2011	27.04.2012	1,203 milionë lekë		
Totali i paradhënies gjatë muajve shkurt 2012-janar 2013	Pas datës 7 të çdo muaji		4,020 milionë lekë	
Derdhur fitimi i pashpërndarë vitit 2012	10.04.2013			2,413 milionë lekë

Për vitin 2012, nga auditimi rezultoi se derdhjet e fitimit të Bankës së Shqipërisë në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”, ishin kryer në përputhje me dispozitat e mësipërme, pra çdo muaj, duke filluar në muajin shkurt e deri në janar të vitit pasardhës, është transferuar paradhënia e fitimit, jo më shpejt se data 7, në përputhje me nenin 4 të marrëveshjes të lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Financave, me nr. 865, datë 26.03.2003, pa tejkaluar vlerën 90% (ose 62.49%) të fitimit të realizuar”.

Vlerat e mësipërme, datat e kryerjes së veprimeve dhe mbylljet përfundimtare, janë konfirmuar edhe nga auditimi i kryer në lidhje me lëvizjet e llogarisë “Paradhënie nga fitimi i realizuar”, si dhe llogarisë “Fitim neto për t’ju paguar qeverisë pas miratimit të shpërndarjes së fitimit”.

Nga auditimi në Bankën e Shqipërisë

Krahas auditimit të rregullueshmërisë së transferimit të fitimit të BSH-së në favor të buxhetit të shtetit objekt auditimi ishin zbatimi i rregullueshmërisë dhe ligjshmërisë se kryerjes se

shpenzimeve të këtij institucioni. Me poshte paraqesim disa nga ceshtjet e audituara si dhe rekomandimet perkatese. Konkretisht:

1. Në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” përcaktohet se Banka e Shqipërisë është e pavarur në marrjen e vendimeve të saj në fushën e kompetencave, ligji i akordon asaj pushtet dhe pavarësi dhe sipas nenit 45 i atribuon Këshillit të saj Mbikëqyrës të drejtën për të përcaktuar nivelin e pagave dhe të shpërblimeve të Guvernatorit, Zv. Guvernatorëve dhe personelit të Bankës së Shqipërisë. Bazuar në këtë të drejtë që i jep ligji, Këshilli Mbikëqyrës ka miratuar Vendime që rregullojnë pagën bazë të punonjësve dhe nivelin e shpërblimit për anëtarët e tij dhe kryetarin e Këshillit Mbikëqyrës. Nga auditimi rezultoi rregullshmëria ligjore e pagesave të mbështetura në vendimet e cituara më sipër, ndërkohë që nga ana tjetër konstatojmë mos respektim të sensibilitetit qytetar në lidhje me përdorimin e fondeve në dispozicion, kjo referuar niveleve shumë të larta të pagesave për nivelet drejtuese, si pagë dhe shpërblime të ndryshme, të trajtimeve dhe për udhëtime e dieta, krahasuar me nivelin e pagës të punonjësve të institucioneve kushtetuese. **Për sa më sipër, kemi rekomanduar që:**

- *Të iniciohen nisma ligjore për rishikimin e Ligjit për Bankën e Shqipërisë, në frymën e minimizimit të **riskut potencial të abuzimit me pavarësinë** dhe shmangies së konfliktit të interesit që evidentohet në praktikën e përcaktimit të pagave dhe shpërblimeve për nivelet drejtuese.*

- *Të përcaktohet një kornizë e kujdesshme rregullatore në lidhje me nivelin e pagës së Guvernatorit, e cila duhet të ndjekë trendin e pagave të tregut bankar, por gjithmonë duhet të jetë në raporte të pranueshme krahasuar me pagën e Presidentit të Republikës, bazuar kjo në përvojat dhe praktikën më të mira të vendeve të ngjashme, por pa harruar përshtatshmërinë me realitetin shqiptar. Gjithashtu, të vendosen nivele të arsyeshme për shpërblimin e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës, nivele shpërblimi të cilat duke marrë në konsideratë edhe nivelin e pagës bazë të tyre nuk duhet të tejkalojnë gjithsesi pagën e Guvernatorit, apo këto paga të jenë më pak sesa paga e anëtarëve të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë.*

Në përgjigjen e kthyer nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 660/9, datë 16/08/2013 theksohet: *“Nuk ka shkelje të ligjeve të miratuara dhe Banka e Shqipërisë nuk mund të ndryshojë dhe miratojë vetë ligjin për Bankën e Shqipërisë”. Gjithashtu shton se rritja e fondit të pagave në Bankën e Shqipërisë është kryer me Vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të vitit 2009, ndërsa rritjet e mëparshme kanë pasur si pikësynim domosdoshmërinë e ruajtjes së aftësisë konkurruese të Bankës së Shqipërisë në punësimin e burimeve njerëzore cilësore, në funksion të arritjes së objektivave të saj, për të ruajtur një qëndrueshmëri afatgjatë të këtyre burimeve. Niveli i pagave të niveleve drejtuese të Bankës së Shqipërisë është disa herë më i ulët se niveli në banka apo institucione financiare që varen prej saj.*

2. Në Ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, neni 68, theksohet: *“Llogaritë dhe regjistrat e Bankës së Shqipërisë mund të kontrollohen nga kontrollorë të jashtëm të institucioneve kontrolluese të njohura në arenën ndërkombëtare dhe që caktohen nga Këshilli Mbikëqyrës”.* Për plotësimin e këtij detyrimi ligjor është vepruar me auditorin e jashtëm të pavarur “Grant Thornton” sh.p.k., i cili ka audituar llogaritë dhe ka dhënë opinion për to në datën 06.03.2013. Në opinionin e këtij auditori theksohet: *“Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të Bankës së Shqipërisë më 31.12.2012, rezultatin e saj financiar dhe fluksin e saj të parave për vitin e mbyllur në atë datë, në përputhje me politikën kontabël të përshtatura nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, siç është shpjeguar në pasqyrat financiare”.* Për të rritur mirëqeverisjen, transparencën dhe besueshmërinë e publikut vendosja e audituesit të jashtëm nga Këshilli Mbikëqyrës i cili nuk është i ndarë nga ekzekutivi për shkak të drejtimit të tij nga Guvernatori, **kemi rekomanduar:**

- *Ndryshimin e mënyrës së përzgjedhjes së audituesit të pasqyrave financiare për të shmangur konfliktin e interesit në përzgjedhjen e tij, duke ia kaluar këtë kompetencë Kuvendit të Shqipërisë, referuar edhe praktikave më të mira botërore. Kuvendi përzgjedh vetëm audituesin ndërkombëtar të pavarur dhe nuk merr përsipër pagesën e shërbimit që mbulohet nga vetë Banka e Shqipërisë.*

Në përgjigjen e kthyer nga Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 660/9, datë 16/08/2013 theksohet: “Në praktikën botërore të auditimit ka eksperiencën të ndryshme. Në Bankën e Shqipërisë përzgjedhja e auditit të jashtëm është bërë me “tender të hapur”, ku konkurrentët i nënshtrohen kriterit lidhur me aftësinë profesionale e më pas vlerësohet dhe oferta më e ulët. Materialet e auditimit nënshkruhen edhe nga zyra të tjera të kompanive fituese jashtë Shqipërisë. Gjithashtu përbërja e Këshillit Mbikqyrës në shumicën e vet përbëhet nga anëtarë të pavarur ekzekutivë, të cilët nuk janë të përfshirë në detyra administrative dhe janë personalitete me ekspertizën e duhur, gjë që përbën garanci ligjore për drejtimin dhe vendimarrjen në përputhje me standartet e kësaj fushe”.

Ne, si Institucion Suprem Auditimi mendojmë që Komisioni i Ekonomisë, Komisioni i Ligjeve dhe Kuvendi duhet të trajtojë këtë problematikë në thellësi në mënyrë që duke mos cënuar pavarësinë e këtij Institucioni të rëndësishëm dhe në kujdes të ruajtjes së qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore cilësore të tij, të bëhen ndryshimet e nevojshme ligjore në bashkëpunim dhe në respekt të Bankës së Shqipërisë dhe drejtuesve të saj, por mbi të gjitha në respekt të ndjeshmërisë qytetare.

3. Banka e Shqipërisë kryen kreditimin e qeverisë brenda kufijve të parashikuar në nenin 30 të Ligjit nr.8269 datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”. Niveli i kreditimit të verifikuar është akoma në tejkallim të limitit të financimit prej 5% të të ardhurave mesatare vjetore të 3 viteve të fundit, pavarësisht tendencës në rënie të tij. Megjithë rekomandimet e auditimeve të mëparshme dhe dakordësisë së gjetur pranë Bankës së Shqipërisë në lidhje me domosdoshmërinë e arritjes së limiteve të kreditimit të parashikuara, nuk gjetëm konkretizim të përmirësimeve të synuara, për këtë **kemi rekomanduar**

- *Prezantimin e një plani të detajuar masash dhe veprimesh efektive me afate konkrete që do të mundësonin arritjen e shpejtë të këtij limiti kreditimi referuar kushteve aktuale të zhvillimeve ekonomike të vendit*

4. Auditimi lidhur me zbatimin e kontratës së ndërtimit për “Realizimin e disa punimeve shtesë në ndërtesën e re të DE” si dhe asaj për “Realizimin e punimeve shtesë për rikonstruksionin e godinës qendrore dhe ndërtimin e kompleksit të ri të Bankës së Shqipërisë”, kemi konstatuar tejkallime të afateve të përfundimit të punimeve. Pavarësisht identifikimit të arëyeve objektive ose jo të mos realizimit të kontratave brenda afateve, jo për çdo kontratë janë bërë ndryshimet për pjesën e shtyrjes së afateve me miratimet sipas kompetencave. Ndërsa në tenderin “Realizimi i punimeve të prishjeve ndërtimore në godinën e ish-“Hotel Dajtit”, është shtyrë procedura e tenderimit për arsye të mosplotësisimit të kuorum-it. Komisioni i Prokurimit duhet të kishte marrë vendimin për shtyrjen e procedurave të prokurimit dhe ta kishte shoqëruar me procesverbalin përkatës. Lidhur në sa më sipër, **kemi rekomanduar:**

- *Për të gjitha rastet e identifikuar të kontratave të papërfunduara dhe me tejkallim të afateve, të analizohen shkaqet dhe të kontabilizohen penalitetet që duhet t’i kërkojnë sipërmarrësit për mosrealizim të punimeve në kohë apo ndërprerje që vonojnë realizimin e veprës.*

- *Duhet të vlerësohet kostoja oportune e pagesave të qerasë të cilat vazhdojnë të paguhen nga BSH, ndërkohë që për kohën e shtyrjes së kontratave kjo kosto duhet t’i ngarkohet sipërmarrësit që nuk ka realizuar në kohë projektin apo nëse janë fajtorë persona brenda BSH, të përcaktohen këto përgjegjësi që efekti të mos rëndojnë në rezultatin e bankës.*

Banka e Shqipërisë, në qëndrimin e saj ka theksuar fillimin e analizave për shqyrtimin e shkaqeve që kanë cuar në tejkalimin e afateve të mosrealizimit të kontratës së rikonstruksionit të godinës qendrore të BSH dhe rasteve të tjera të konstatuara duke sqaruar edhe trajtimin e masës së penalteteve të aplikueshme për rastet e vonesave.

III.3.b Të ardhurat nga institucionet buxhetore

Për vitin 2012, të ardhurat nga institucionet buxhetore nga 9,150 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në shumën 10,276 milionë lekë ose në masën rreth 112.3%, me një tejkalim në vlerë prej 1,126 milionë lekë. Në krahasim me të ardhurat e realizuara një vit më parë, ato paraqiten me ulje në masën rreth 0.6% dhe në vlerë 60 milionë lekë më pak (10,336 milionë lekë realizuar në vitin 2011 minus 10,276 milionë lekë në vitin analizues 2012).

Ndërsa, kundrejt PBB-së të realizuar në vitin 2012, këto të ardhura zenë 0.76% të tij, nga 0.8% të PBB-së që zinin në vitin 2011, pra me një ulje prej 0.04%.

Nga auditimet e ushtruara në 11 ministri dhe institucione të tjera qendrore për zbatimin e buxhetit të vitit 2012, në drejtimet e auditimit të përcaktuar në programet e auditimit është parashikuar pikë e veçantë auditimi, zbatimi i legjislacionit lidhur me realizimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore që krijojnë institucionet buxhetore. Në këto auditime ka rezultuar se, në përgjithësi, janë zbatuar kërkesat e vendimit të KM nr. 432, datë 28/6/2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore” me ndryshime, dhe të udhëzimeve të përbashkëta që institucionet buxhetore kanë miratuar në bashkëpunim me MF-ve. Ndërkohë, cilësojmë që në disa prej institucioneve të audituar janë konstatuar mosrealizime kundrejt programimit, të cilat kanë ndikuar në kryerjen e shpenzimeve të parashikuara për t’u mbuluar nga këto të ardhura.

Në të 11 institucionet e audituar rezultoi se, të ardhurat dytësore për periudhën e audituar të vitit 2012 janë realizuar në vlerën **1,568,400 milionë lekë** nga 826,196 milionë lekë të realizuara në këto institucione në vitin 2011, ose në masën rreth 85% më shumë se realizimi i një viti më parë. Në mënyrë analitike realizimi i të ardhurave sipas institucioneve paraqitet në tabelën më poshtë:

<i>në mijë/lekë</i>					
<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Realizimi i vitit 2011</i>	<i>Realizimi i vitit 2012</i>	<i>Periudha e Audituar</i>	<i>Në % 2012/2011</i>
1.	METE	382,433	1,022,597	Viti 2012	267.5
2.	Ministria e Mbrojtjes	173,798	233,715	Viti 2012	134.5
3.	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë	79,998	82,914	6/mujori 2012	-
4.	QSU “Nënë Tereza Tiranë	61,393	69,793	Viti 2012	113.7
5.	MPÇSSHB	56,108	69,348	Viti 2012	123.6
6.	MPPT	35,682	42,097	Viti 2012	118.0
7.	INSTAT	25,811	25,945	Viti 2012	100.5
8.	Akademia e Shkencave	6,646	14,725	9/mujori 2012	-
9.	Qendra Kombëtare e Kinematografisë	1,078	2,027	9/mujori 2012	-
10.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	2,269	1,623	9/mujori 2012	-
11.	MTKRS	36,662	3,616	3/mujori I-rë 2012	-
SHUMA:		861,878	1,568,400		

Nga të dhënat e mësipërme, të analizuara sipas institucioneve rezulton se:

1. Në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës.

Për vitin 2012, METE ka realizuar të ardhura dytësore në shumën 1,022,597 mijë lekë, nga të cilat ka përdorur 56,789 mijë lekë ose në masën 5.5% të tyre, ndërkohë që diferenca prej 965,807 mijë lekë është derdhur në buxhetin e shtetit. *Nga të ardhurat gjithsej të realizuara 382,433 mijë lekë ose 37% e tyre, janë të ardhura nga dividendi të cilat janë derdhur në masën 100% në buxhet; 208,148 mijë lekë ose në masën 20% janë të ardhura nga gjobat, kamatëvonesat, sekuestrim e zhdëmtime derdhur në masën 100% në buxhet; 178,417 mijë lekë ose 17% janë të ardhura nga ndërmarrjet publike jo fitimprurëse (taksë koncesioni) derdhur në masën 100% në buxhet; 108,874 mijë lekë ose 11% janë të ardhura nga garanci kontratash derdhur në masën 100% në buxhet; 87,222 mijë lekë ose 8.5% të ardhura nga privatizimet nga të cilat janë përdorur nga METE 56,789 mijë lekë ose në masën 65% të tyre dhe janë derdhur në buxhet 39,433 mijë lekë ose 35% e shumës; 30,836 mijë lekë ose 3% janë të ardhura nga qiratë të cilat janë derdhur 100% në buxhet; dhe diferenca prej 26,649 mijë lekë ose 3.5% e totalit janë të ardhura të tjera kryesisht nga ndërmarrjet dhe pronësia, nga shitja e mallrave dhe shërbimeve, të ardhura jo tatimore etj.*

Nga auditimi mbi krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore rezultoi se, këto të ardhura nuk janë parashikuar në mënyrë të saktë në projektbuxhet, pasi për vitin 2011 e ardhura e deklaruar nga Dividenti ka qenë 3,295,194 mijë lekë ndërsa shuma e arkëtuar nga kjo shumë në vitin 2012 rezulton vetëm 382,433 mijë lekë; gjithashtu të ardhurat që duhet të derdheshin nga qiraja në llogarinë e thesarit në zbatim të VKM nr. 529, datë 8.6.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", për vitin 2012, në shumën 56,870 mijë lekë dhe 90 mijë dollarë (9,450 mijë lekë), në fakt janë derdhur vetëm 30,836 mijë lekë.

Për sa më sipër, ***KLSH ka rekomanduar që Sektori i Financës në METE, të kontabilizojë të ardhurat e deklaruar dhe të pa arkëtuar, si kërkesa debitore dhe të kërkojë:***

- a) Vjeljen e detyrimit të Dividentit në shumën 2,912,761,350 lekë dhe**
- b) Vjeljen e detyrimit të qirasë së pa arkëtuar në shumën 26,034 mijë lekë (56,870-30,836) dhe 90 mijë dollarë (9,450 mijë lekë).**

2. Në Ministrinë e Mbrojtjes

Kjo ministri për vitin 2012, ka realizuar të ardhura dytësore në shumën 233,715 mijë lekë, nga të cilat janë përdorur 13,452 mijë lekë ose 5.7% e tyre, ndërsa diferenca prej 220,263 mijë lekë janë derdhur në buxhetin e shtetit. Nga të ardhurat e realizuara gjithsej, 167,772 mijë lekë ose në masën 72% janë të ardhura të realizuara nga shitja e materialeve të ndryshme; 13,692 mijë lekë ose 5.8% të ardhura të realizuara nga dhënie ndërtesash me qira; 4,179 mijë ose 1.8% nga dhënie pajisjesh me qira; 7,362 mijë lekë ose 3.1% nga gjobat; 3,674 mijë lekë ose 1.5% nga shërbimet mjekësore; 3,657 mijë lekë ose 1.5% nga individët; dhe diferenca prej 33,379 ose në masën 14.3 % të ardhura të tjera.

Nga analiza e realizimit të këtyre të ardhurave auditimi konstatoi se, ka paqartësi gjatë zbatimit në praktikë të VKM nr. 529, datë 08.06.2011 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", pasi në germën "a", pika 1, Kreu III-të "Tarifat dhe vlera dysheme për pasuritë shtetërore që jepen me qira ose enfiteozë", është përcaktuar se tarifa dysheme për objektet që ndodhen jashtë vijave kufizuese në Bashkinë e Tiranës është jo më pak se 20 lekë/m² në muaj, ndërkohë që kjo tarifë për Bashkitë Berat, Durrës, Fier etj. është jo më pak se 100 lekë/m² në muaj ose 5 herë më e madhe.

3. Në Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit

Për vitin 2012, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën 42,097 mijë lekë. Zëri kryesor i këtyre të ardhurave është "E ardhura nga dhënia e koncensioneve, të cilat janë të ardhura mujore të vazhdueshme. Në vitin 2011, këto të ardhura zinin 69.27% të totalit të të ardhurave dytësore të MPPT dhe në vitin 2012 në masën 76.28%. Cilësojmë se programimit të të ardhurave nga ky zë, MPPT duhet t'i kushtojë një vëmendje e posaçme, pasi ka të bëjë me balancimin e të ardhurave dhe shpenzimeve të buxhetit të shtetit, konformë nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet qartë se "Buxheti i shtetit është i balancuar në termat e arkëtimeve dhe pagesave".

Nga koncesionari i shërbimit të kontrollit teknik të automjeteve "SGS"-ja, vërehet një tendencë në rritje e të ardhurave nga shërbimi, duke arritur në 32,113 mijë lekë në vitin 2012. Këto të ardhura, janë të klasifikuara në të ardhura të taksës së kolaudimit të automjetit dhe të ardhura të shërbimit të kontrollit (kjo e ardhur realizohet edhe kur mjete nuk kolaudohet). Për një parashikim sa më të përafërt të kësaj të ardhure që zë volumn kryesor të tyre, duhet që të shfrytëzohen të dhënat e DPSHTRR-së, mbi numrin e lejeve të qarkullimit të dhëna për vitin përkatës dhe klasifikimit të këtyre lejeve.

4. Në Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza" Tiranë.

Ky institucion për vitin 2012, ka realizuar të ardhura dytësore në shumën 69,793 mijë lekë ose në masën 14% më tepër se të ardhurat e realizuara në vitin 2011. Nga të ardhurat e realizuar, 25,359 mijë lekë ose 36%, e zënë të radhurat e realizuara nga shërimi ambulator; 23,230 mijë lekë ose 33% të ardhurat nga konsultat; 12,109 mijë lekë ose 17% nga dhënia e ambjenteve me qira; 3,944 mijë lekë ose 6% të ardhurat nga parkingu; dhe 5,151 mijë lekë ose në masën 20% e zënë të ardhura të tjera.

Nga auditimi mbi përdorimin e të ardhurave u konstatua se, në kundërshtim me ligjin për kontabilitetin dhe planin kontabël, të ardhurat dytësore janë rritur artificialisht në vlerën prej 681 mijë lekë, ku ndikim ka pasur llogaritja aforfe e shpenzimit të energjisë elektrike dhe ujit për 7 kontrata të lidhura me subjekte private. Po kështu, përdorimi i tyre jashtë destinacionit, duke duke sjellë si pasojë përfitim të padrejtë të profesorëve të Universitetit të Tiranës nëpërmjet shpërblimeve, në vlerën 204 mijë lekë, vlerë e cila është rekomanduar që të arkëtohet gjatë vitit 2013.

5. Në Universitetin "Eqerem Çabej" Gjirokastër.

Për 6/mujorine parë të vitit 2012, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën 82,314 mijë lekë ose në masën 3.6% më tepër se të ardhurat e realizuara në vitin 2011. Nga të ardhurat e realizuar, 69,149 mijë lekë ose 83% e zënë të ardhurat nga tarifa e shkollimit; 2,353 mijë lekë ose 2% nga lëshimi i diplomave dhe listave të notave; 10,628 mijë lekë ose 13% nga sponsorizimet; 342 mijë lekë ose 0.47% nga qiratë; dhe 441 mijë lekë ose 0.53% nga transferta të tjera.

6. Në Ministrinë e Turizmit, Kulturës Rinisë dhe Sporteve .

Për 3 mujorin e I-rë 2012, janë realizuar të ardhura dytësore në shumën 3,616 mijë lekë, nga të cilat 1,125 mijë lekë ose në masën 31% të tyre janë realizuar nga trashëgimia kulturore; 1,729 mijë lekë ose 48% nga arti dhe kultura; dhe 762 mijë lekë ose në masën 21% nga zhvillimi i turizmit. Për këtë periudhë, kjo ministri nuk ka përfituar të ardhura nga sponsorizimet dhe nuk ka përdorur të ardhura të trashëguara nga viti i mëparshëm.

Gjithashtu, nga auditimi u konstatua se MTKRS nuk ka përfituar të ardhurat që i takojnë sipas nenit 37, të ligjit nr. 9376, datë 21.04.2005 "Për Sportin" i ndryshuar, në masë 0.2% të të ardhurave që sigurohen nga lotaritë sportive. Subjektet e Lojrave të Fatit detyrohen të derdhin pranë kësaj ministrie 0.2% të shumave të grumbulluara të cilat përdoren për zhvillimin e sportit.

Vetëm nga auditimet e kryera në subjektet që janë në fokusin e punës sonë për vitin 2012 nga moszbatimi dispozitive ligjore ka rezultuar dëm ekonomik në te ardhurat e buxhetit të shtetit vlerën 5,622 mijë lekë, përkatësisht në:

		<i>në mijë/lekë</i>
1.	QSU “Nënë Tereza”, Tiranë (mosarkëtimi të ardhurave nga dhënia me qira e ambienteve)	3,194
2.	METE (mospagesë të qirasë së ambienteve dhënë me qira)	2,236
3.	MPÇSSHB (mosarkëtim të qirasë për përdorim të pasurisë kombëtare)	139
4.	MBUMK (mosndalesë e tatimit mbi të ardhurat)	53
Totali		5,622

IV. ADMINISTRIMI I SHPENZIMEVE TË BUXHETIT TË SHTETIT

Për vitin 2012, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit, janë realizuar në masën 98.4%, nga 382,296 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në vlerën 376,241 milionë lekë, duke reflektuar mosshpenzim të fondeve kundrejt nivelit të planifikuar në shumën 6,055 milionë lekë.

Në krahasim me fondet e shpenzuara një vit më parë, ato paraqiten me ulje minimale vetëm 111 milionë lekë (376,241 milionë lekë viti 2012 – 376,352 milionë lekë viti 2011).

Kundrejt PBB-së të vitit 2012, ato përfaqësojnë 27.95% të tij, nga 29% të PBB-së që zinin në vitin 2011, me një ulje prej 1.05%.


Në mënyrë të detajuar, realizimi i zërave kryesorë të shpenzimeve të buxhetit të shtetit për vitin analizues 2012, kundrejt kuotave të rishikuara dhe ndryshuara, paraqiten si më poshtë:

		<i>në milionë/lekë</i>				
<i>Nr.</i>	<i>EMËRTIMI</i>	<i>Plani me ndryshime</i>	<i>Fakti 2012</i>	<i>Diferenca 3=2-1</i>	<i>Ne %</i>	<i>Fakt në % ndaj PBB</i>
<i>a</i>	<i>b</i>	<i>1</i>	<i>2</i>	<i>3</i>	<i>4</i>	<i>5</i>
	TOTALI I SHPENZIMEVE	382,296	376,241	- 6,055	98.4	27.95
I.	<i>Shpenzime korrente</i>	316,704	314,585	- 2,120	99.3	23.37
1.	Personeli	68,655	69,438	+ 782	101.1	5.16
1.a	Paga	59,117	60,144	+ 967	101.6	4.47
1.b	Kontributi për sigurime shoqërore	9,369	9,293	- 76	99.2	0.69
1.c	Fondi i veçantë për pagat	108	0.0	- 108	0.0	0.0
2.	Interesat	42,200	41,498	- 702	98.3	3.08
2.a	Të brendshme	34,200	34,005	- 195	99.4	2.52
2.b	Të huaja	8,000	7,492	- 508	93.7	0.56
3.	Shpenzime operative mirëmbajtje	35,165	33,470	- 1,695	95.2	2.49
4.	Subvencionet	1,873	1,884	+ 11	100.6	0.14
5.	Shpenzime për fondet speciale	120,999	120,269	- 730	99.4	8.93
5.a	Sigurime shoqërore	90,265	89,860	- 405	99.6	6.67
5.b	Sigurime shëndetësore	28,934	28,828	- 106	99.6	2.14
5.c	Kompensimi në vlerë të pronarëve	1,800	1,581	- 219	87.8	0.12
6.	Shpenzime për buxhetin vendor	27,049	27,333	+ 285	101.1	2.03
7.	Shpenzime të tjera	20,763	20,694	- 69	99.7	1.54
7.a	Pagesa e papunësisë	1,000	984	- 16	98.4	0.07
7.b	Ndihma ekonomike	18,063	18,011	- 52	99.7	1.34
7.c	Kompensim për të përndjekurit politikë	1,700	1,699	- 1	99.94	0.13
II.	Fondi rezerve i KM dhe kontigjenca	644	0.0	- 644	0.0	0.0
1.	Fondi rezervë i KM	290	0.0	- 290	0.0	0.0

Nr.	EMËRTIMI	Plani me ndryshime	Fakti 2012	Diferenca 3=2-1	Ne %	Fakt në % ndaj PBB
2.	Fondi kontigjencës	354	0.0	- 354	0.0	0.0
III.	Shpenzime Kapitale	64,946	61,656	- 3,291	94.9	4.58
1.	Financim i brendshëm	27,398	27,398	0.0	100.0	2.04
2.	Financim i huaj	37,548	34,257	- 3,291	91.2	2.54

Burimi: Ministria e Financave

Në mënyrë grafike ecuria e shpenzimeve korrente e kapitale në vite paraqitet:



Në zbatim të dispozitave kushtetuese dhe ligjore për zbatimin e buxhetit të shtetit për vitin 2011, KLSH ka audituar veprimtarinë ekonomiko financiare në 38 ministri, institucione të administratës publike dhe ente të ndryshme buxhetore përfshirë njësitë vartëse; në 10 njësi të sistemit doganor dhe tatimor përfshirë DPT dhe DPD; 9 projekte me financim të huaj; 48 njësi të qeverisjes vendore dhe 13 shoqëri aksionere dhe entitete publike, ku një vend të veçantë zë auditimi i administrimit dhe përdorimit të shpenzimeve.

Krahas sa më sipër, janë audituar dhe 9 shoqëri anonime përfshirë “Albpetrol”sh.a. materialet e auditimit të këtij të fundit u evaduan ditët e para të muajit shtator 2013, gjithashtu është në procesin e përfundimit në terren auditimi në METE “Mbi koncensionet”.

Referuar rezultateve përfundimtare të auditimit, raportojmë se, pa nënvlerësuar përpjekjet dhe arritjet pozitive të konstatuara në njësitë ekonomike të audituara lidhur me administrimin e shpenzimeve, audituesit e KLSH-së kanë konstatuar dhe evidentuar dhe mjaft parregullsi dhe shkelje ligjore të ndryshme, madje dhe **me dëm efektiv financiar në përdorimin e shpenzimeve buxhetore në vitin raportues buxhetor 2012, në vlerën 414,371 mijë lekë.** :

Shkeljet e dispozitave ligjore me pasojë dëm ekonomik në fushën e shpenzimeve gjatë vitit 2002, sipas subjekteve dhe vlerat respektive, janë konstatuar në:

a) Ministritë, institucionet e administratës së lartë publike dhe entet e ndryshme buxhetore në shumën 212,497 mijë lekë, si më poshtë:

1.	Universiteti i Tiranës	86,798 mijë lekë
2.	Ministria e Brendshme	55,417 mijë lekë
3.	Autoriteti Rrugor Shqiptar	38,039 mijë lekë
4.	MPCSSHB	14,101 mijë lekë
5.	Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokastrë	8,751 mijë lekë

RAPORT PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHETIT TË VITIT 2012

6.	Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit	3,944 mijë lekë
7.	QSU “Nënë Tereza” Tiranë	1,790 mijë lekë
8.	ISKSH	1,234 mijë lekë
9.	Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve	913 mijë lekë
10.	MPPT	696 mijë lekë
11.	Shërbimi Social Shtetëror	250 mijë lekë
12.	Ministria e Shëndetësisë	230 mijë lekë
13.	Banka e Shqipërisë	206 mijë lekë
14.	INSTAT	116 mijë lekë
15.	MBUMK	12 mijë lekë
Shuma:		212,497 mijë lekë

b) Në njësitë e sistemit doganor dhe tatimor, në shumën 1,404 mijë lekë, si më poshtë:

1.	DPD	387 mijë lekë
2.	DPT	139 mijë lekë
3.	Dega e Doganës Tre-Urat	777 mijë lekë
4.	Dega e Doganës Durrës	101 mijë lekë
Shuma:		1,404 mijë lekë

c) Në projektet me financim të huaj në vlerat 103 331 mije leke si më poshtë:

1.	Projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen”	12,808 mijë lekë
2.	Projekti “Ndërtimi i terminalit të Portit të Durrësit”	6,509 mijë lekë
3.	Projekti “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”	9,640 mijë lekë
4.	Projekti “Rehabilitimi i spitalit të Shkodrës, faza III”	5,510 mijë lekë
5.	Projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Rexhepaj”	3,959 mijë lekë
6.	Projekti “Rehabilitimi bistrice 1 e 2”	44,993 mije leke
7.	Projekti “Ndërtimi by Pass Durres dhe nyja e Vores”	18,956 mije leke
8.	Projekti “Programi rural I furnizimit me uje ”	1,015 mijë lekë
Shuma:		103,331 mijë lekë

d) Në njësitë e pushtetit vendor në shumën 97,139 mijë lekë, si më poshtë:

1.	Bashkia Durrës	29,416 mijë lekë
2.	Bashkia Kavajë	15,280 mijë lekë
3.	Bashkia Tiranë	13,952 mijë lekë
4.	Bashkia Vau i Dejës	3,139 mijë lekë
5.	Bashkia Belsh	2,267 mijë lekë
6.	Bashkia Koplik	2,052 mijë lekë
7.	Bashkia Kuçovë	1,800 mijë lekë
8.	Bashkia Fier	1,272 mijë lekë
9.	Bashkia Bulqizë	769 mijë lekë
10.	Bashkia Libohovë	650 mijë lekë
11.	Bashkia Krumë	374 mijë lekë
12.	Bashkia Krujë	348 mijë lekë
13.	Bashkia Divjakë	190 mijë lekë
14.	Bashkia Fushë Arrëz	170 mijë lekë
15.	Bashkia Roskovec	134 mijë lekë
16.	Bashkia Manëz	56 mijë lekë
17.	Bashkia Çorovodë	48 mijë lekë
18.	Bashkia Ballsh	925 mijë lekë
19.	Bashkia Patos	4,310 mijë lekë
20.	Bashkia Gjirokastër	107 mijë lekë
21.	Këshilli i Qarkut Kukës	1,087 mijë lekë
22.	Këshilli i Qarkut Gjirokastër	131 mijë lekë
23.	Komuna Gjinar, Elbasan	11,840 mijë lekë
24.	Komuna Zharrëz, Fier	1,713 mijë lekë

25. Komuna Buçimas, Pogradec	790 mijë lekë
26. Komuna Qendër, Vlorë	450 mijë lekë
27. Komuna Qendër, Bilisht	221 mijë lekë
28. Komuna Kolsh, Kukës	110 mijë lekë
29. Komuna Libofshë, Fier	50 mijë lekë
30. Komuna Ishëm Durrës	15 mijë lekë
31. Komuna Lukovë Sarandë	675 mijë lekë
32. Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve nr. 1, Tiranë	1,785 mijë lekë
33. Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve nr. 2, Tiranë	1,013 mijë lekë
Shuma:	97,139 mijë lekë

IV.1 Shpenzimet korrente.

Për vitin 2012, këto shpenzime nga 316,704 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 314,585 milionë lekë ose në masën 99.3%, me një mosshpenzim kundrejt planifikimit në vlerë prej 2,120 milionë lekë më pak.

Në krahasim me fondet e shpenzuara një vit më parë, ato paraqiten me rritje në masën 2.9% dhe në vlerë 8,912 milionë lekë (316,704 milionë lekë - 305,673 milionë lekë).

Kundrejt PBB-së të vitit 2012, ato përfaqësojnë 23.37% të tij, nga 23.55% të PBB-së që zinin në vitin 2011.

Ndonëse, pesha në përqindje që zenë shpenzimet korrente të realizuara gjatë vitit 2012 kundrejt totalit të shpenzimeve të përgjithshme të realizuara gjatë këtij viti, përkatësisht në masën 83.6%, rrezulton me rritje kundrejt të njëjtit raport të rezultuar në vitin 2011 respektivisht 81.2%, pra me një rritje prej 2.4 pikë përqindje.

Nga analiza e strukturës së shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2012, rezulton se:

- *Shpenzimet për personelin (paga, kontributi për sigurime shoqërore dhe fondi i veçantë për paga) janë realizuar dhe tejkluar në masën 101.1%, me një tejkallim ndaj kuotave të planifikuara prej 782 milionë lekë. Këto shpenzime zënë rreth 22.07% të totalit të shpenzimeve korrente, nga 22.06% që zinin një vit më parë, pra në përqindje rezultojnë në të njëjtin nivel, ndërsa në vlerë absolute rezultojnë me rritje 1,992 milionë lekë më tepër (69,438 milionë lekë realizuar në vitin 2012 nga 67,446 milionë lekë në vitin 2011).*

- *Shpenzimet për shërbimin e borxhit (interesat) janë realizuar në masën 98.3%, me një mosrealizim ndaj kuotave të planifikuara prej 702 milionë lekë, dhe në krahasim me vlerën e realizuar në vitin 2011, ato paraqiten me rritje në shumën 377 milionë lekë më tepër ose në masën rreth 0.9% (nga 41,121 milionë lekë të realizuar në vitin 2011, në vitin 2012 janë realizuar 41,498 milionë lekë). Ky zë i shpenzimeve dhe struktura e tij do të trajtohen në vijim të këtij raporti.*

- *Shpenzimet operative mirëmbajtje, nga 35,165 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në shumën 33,470 milionë lekë ose në masën 95.2%, me një mosrealizim në vlerë prej 1,695 milionë lekë. Në krahasim me shpenzimet faktike të një viti më parë, ato rezultojnë me rritje në vlerë për 475 milionë lekë ose në masën rreth 1.4% (nga 32,995 milionë lekë të realizuar në vitin 2011, në vitin 2012 janë shpenzuar 33,470 milionë lekë).*

- *Shpenzimet për subvencione, nga 1,873 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 1884 milionë lekë ose në masën 100%. Në krahasim me një vit më parë këto shpenzime rezultojnë me ulje në masën rreth 43% dhe në vlerë 1,417 milionë lekë më pak.*

- *Shpenzimet për fondet speciale (sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe kompensimi në vlerë i pronarëve), nga 120,999 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar 120,269 milionë lekë ose në masën 99.4%, me një mosrealizim në vlerë prej 730 milionë lekë. Në krahasim me realizimin e një viti më parë, ato rezultojnë me rritje, përkatësisht në shumën 6,323 milionë lekë ose në masën 5.5% më tepër (në vitin 2012 janë realizuar 120,269 milionë lekë, nga 113,946 milionë lekë të realizuar në vitin 2011).*
- *Shpenzimet për buxhetin vendor, nga 27,049 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në vlerën 27,333 milionë lekë ose në masën 101.1%, me një tejkalim në vlerë prej 285 milionë lekë. Në krahasim me realizimin e një viti më parë, ato rezultojnë me ulje në vlerë përkatësisht 786 milionë lekë dhe në përqindje 2.8% më pak (në vitin 2012 janë realizuar 27,333 milionë lekë, nga 28,119 milionë lekë të realizuar në vitin 2011).*
- *Pagesa e papunësisë dhe ndihma ekonomike janë realizuar respektivisht në masën 98.4% dhe 99.7%, me një mosrealizim në vlerë 16 milionë lekë dhe 52 milionë lekë.*
- *Ndërsa, kompensimi për të përndjekurit politikë rezultojnë pothuajse i realizuar në masën 100%, nga 1,700 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 1,699 milionë lekë. Në krahasim me realizimin e një viti më parë, ato rezultojnë me rritje, përkatësisht në shumën 199 milionë lekë ose në masën 13.3% më tepër (në vitin 2012 janë shpenzuar faktikisht 1,699 milionë lekë, nga 1,500 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011).*

□ *Në fushën e shpenzimeve korrente (përfshirë ISKSH dhe njësitë e pushtetit vendor pasi trajtohen në Kapitujt për buxhetet e pavarur), ka rezultuar se:*

IV. 1. a Shpenzimet e personelit, në fushën e pagave dhe shpërblimeve, vlera e shkeljeve me dëm ekonomik ka rezultuar **13,752 mijë lekë**, nga e cila në: *Universitetin “Eqrem Çabej” Gjirokastrë në vlerën 8,751 milionë lekë, si pasojë e pagesave për titull shkencor pa mbaruar procesi i diplomimit dhe pagesa për orë pune jashtë kohës normale; Universiteti i Tiranës në vlerën 4,359 mijë lekë si pasojë e dhënies së shpërblimeve për punonjësit e Rektoratit në kundërshtim me dispozitat ligjore; MPÇSSHB në shumën 581 mijë lekë, si pasojë e përfitimit padrejtësisht të pagës nga një Këshilltar i Ministrit, pa qenë present në punë; dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në shumën 63 mijë lekë, si pasojë e përfitimit padrejtësisht të pagesës për “master”.*

Në krahasim me zbulimet e një viti më parë, në vitin analizues 2012 rezultojnë se ka një ulje, kështu nga 15,037.5 mijë lekë në vitin 2011, në 13,752 milionë lekë në vitin 2012.

IV. 1. b Shpenzimet operative, shkeljet me pasojë dëm ekonomik vlerësohen në **9,107 mijë lekë**, nga të cilat: *në Universitetin e Tiranës në vlerën 1,991 mijë lekë, përkatësisht në vlerën 1,411 mijë lekë janë kryer shpenzime me rastin e emërimit të Dekanit të Fakultetit të mjekësisë në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe në vlerën 580 mijë lekë për shtim dreke për të huaj pa dokumente justifikuese; në MPÇSSHB në shumën 1,600 mijë lekë, përfituar padrejtësisht për udhëtime e dieta jashtë vendit, për ditë pushimi zyrtare dhe për transport; në ISKSH në shumën 1,234 mijë lekë, përfituar padrejtësisht shpërblim për studime dhe mbulim të shpenzimeve të telefonisë celulare; në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në shumën 850 mijë lekë; përfituar padrejtësisht për udhëtime e dieta brenda vendit; në Ministrinë e Shëndetësisë në shumën 230 mijë lekë, si pasojë e përdorimit jashtë destinacionit të mjeteve të urgjencës; në Bankën e Shqipërisë në shumën 206 mijë lekë, shumë e përfituar padrejtësisht për mbulimin e shpenzimeve të disa punonjësve të këtij institucioni; në INSTAT Tiranë në shumën 116 mijë lekë, si pasojë e kryerjes së shpenzimeve për pritje përcjellje, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15/05/1995 “Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i*

ndryshuar; në *MBUMK në shumën 12 mijë lekë*, përfituar padrejtësisht për udhëtime e dieta brenda vendit; në *DPD në shumën 387 mijë lekë*, përfituar padrejtësisht për udhëtime e dieta brenda vendit; në *DPT në shumën 139 mijë lekë*, përfituar padrejtësisht për udhëtime e dieta brenda vendit; në *Degën e Doganës Tre-Urat Përmet në shumën 777 mijë lekë*, përfituar padrejtësisht për udhëtime e dieta brenda vendit dhe shpenzime për karburant në kundërshtim me ligjin nr.10160, datë 15/10/2009; dhe në *Degën e Doganës Durrës në shumën 101 mijë lekë*, kryer shpenzime për karburant në kundërshtim me ligjin nr.10160, datë 15/10/2009; dhe në Projektin “Rehabilitimi i spitalit të Shkodrës, faza III” në shumën 1,464 mijë lekë, mungesë asetesh.

Në krahasim me zbulimet e një viti më parë, në vitin analizues 2012 rezulton se ka një ulje, kështu nga 10,283 mijë lekë në vitin 2011, në 9,107 mijë lekë në vitin 2012.

○ Përveç sa më sipër, mendojmë të paraqesim dhe **vlerën e dëmit ekonomik prej 76,964 mijë lekë** të konstatuar nga auditimi në *fushën e shpenzimeve gjatë vitit 2002, në 7 (shtatë) shoqëri anonime* dhe konkretisht në:

1. Autoriteti Aviacionit Civil	61,178 mijë lekë
2. Operator i Sistemit të Transmetimit	3,645 mijë lekë
3. Qendra e Trajtimit të Studentëve nr. 2, Tiranë	1,118 mijë lekë
4. Qendra e Trajtimit të Studentëve, Shkodër	823 mijë lekë
5. Posta Shqipëtare	2,400 mijë lekë
6. Ujësjiellësi Fier	7,100 mijë lekë
7. Enti Kombëtar i banesave	600 mijë lekë
Shuma:	76,964 mijë lekë

-Mbi auditimin e shoqërive aksionere

Auditimi i kryer në 9 shoqëri aksionere ka identifikuar mjaft të meta dhe parregullsi në menaxhimin e tyre. Gjatë auditimit të ushtruar në vitin 2013, në këto shoqëri aksionere, janë evidentuar problematika të lidhura me:

Dokumentacioni ligjor i shoqërive publike (Statut, rregullore e brendshme, kontrata kolektive dhe individuale të punës, dokumentet e regjistrimit etj.) nuk është në përputhje të plotë me legjislacionin në fuqi;

Këshillat Mbikëqyrëse përgjithësisht nuk kanë përbërjen e duhur, konform përcaktimeve në udhëzimet përkatëse duke patur si pasojë shpesh herë vendime të nxituara dhe të pabazuara ligjërisht, madje të shoqëruara me efekte financiare në dëm të personit juridik publik. Funksionimi i këtyre për të dëshiruar sidomos lidhur me analizat periodike mbi aktivitetin e shoqërisë apo raportimin në institucionet përkatëse;

Drejtori dhe/ose Drejtoritë nuk përmbushin kërkesat për hartimin e programeve ekonomiko-financiare të shoqërisë, nuk raportojnë periodikisht në institucionet e prore, marrin vendime duke anashkaluar Këshillat Mbikëqyrëse, nuk mbajnë përgjegjësi për mosrealizimin e treguesve ekonomiko-financiar dhe pasojat e menaxhimit jo të mirë të shoqërisë.

Në fushën e menaxhimit financiar vërehen abuzime në shpenzimet për personelin, mungesë të dokumentacionit justifikues në kryerjen e pagesave me arkë dhe bankë, dhënie sponsorizimesh të pabazuara ligjërisht, shpenzime për telefonat celular në kundërshtim me legjislacionin, abuzime në përdorimin e kursit të këmbimit të valutës, dhënie pa kriter të paradhënies, mosshlyerje në afat të detyrimeve të ndryshme, dhënie shpërblim në fund të vitit për punonjësit e shoqërisë edhe në rastet kur shoqëria ka rezultuar me humbje; mangësi në dokumentet justifikues për shpenzimet e karburantit dhe pagesat për udhëtim e dieta; probleme në procesin e rivlerësimit të aseteve të shoqërisë, mungesë transparence gjatë rekrutimit të stafit dhe mosplotësim të dosjeve të personelit;

Në fushën e prokurimeve publike, mospërcaktimi i saktë i vlerës limit të kontratës; hartimi i dokumentacionit në kundërshtim me dispozitat ligjore të fushës, zhvillimi i procedurës së prokurimit në kundërshtim me hapat proceduriale të përcaktuara nga ligji i prokurimit publik, me rregullat e prokurimeve, DST dhe urdhrat, udhëzimet dhe shkresat e dala nga institucionet që administrojnë procesin e prokurimeve publike, shqyrtimi me mangësi i ofertave të operatorëve ekonomik nga KVO-të, moszbatim të kriterëve ligjore lidhur me trajtimin e ofertave anomalisht të ulta; mosrespektim të afateve ligjore për shqyrtimin e ankesave dhe zvarritje, në ndonjë rast dhe anulim të procedurave pa argumente të forta ekonomike etj.

Mangësi të theksuara në menaxhimin e kontratave të lidhura, dhënie me qira të objekteve pronë e shoqërive, duke favorizuar subjekte private dhe duke cënuar interesat e shoqërisë etj.

Për përmirësimin e gjendjes, **kemi rekomanduar që:**

- **Shoqëritë aksionere të audituara, METE dhe ministritë respektive, të marrin masa të menjëhershme për mënjanimin e shkeljeve të disiplinës financiare në fushën e pagave dhe shpërblimeve, nëpërmjet zbatimit me rigorozitet të legjislacionit në fuqi që rregullon marrëdhëniet e punës dhe pagat; madje, nisur nga aktet e shumta ligjore e nënligjore që rregullojnë marrëdhëniet në fushën e pagave, vështirësitë në zbatimin e tyre dhe hapësirat e mundshme që ekzistojnë për interpretim apo keqinterpretim,**

- **kemi rekomanduar kryerjen medoemos të një studimi për dhënien e një zgjidhjeje të plotë dhe përfundimtare problemit të pagave dhe të shpërblimeve në shoqëritë publike.**

- **Ministritë e linjës dhe METE të krijojnë linja të llogaridhënies, të monitorojnë këshillat mbikëqyrëse dhe menaxherët ekzekutiv dhe të kërkojnë prej tyre llogaridhënie, të angazhohet në rolin e pronarit në një mënyrë tjetër duke rritur parakushtet më të mira të mundshme për shoqërinë, të emërojnë menaxherë më të mirë ekzekutiv, madje, METE të analizojë arsyet për mangësitë në shërbimet ndaj qytetarit, të zhvillojë strategji të qarta lidhur me përmirësimin e gjendjes aktuale të shoqërive aksionare; të rishikojë strukturën ligjore të tyre dhe të nxjerrë të gjitha modelet e rregulloreve të cilat do të ndihmojnë funksionimin e tyre përfshirë funksionimin e shoqërive; menaxhimin e pasurive dhe trajtimin e kërkesave të arkëtueshme; raportimin e duhur etj.**

- **Ritmi i privatizimit duhet të jetë më i shpejtë dhe i saktë për të siguruar objektivat e vëna, duke i kushtuar vëmendje forcimit të mjedisit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm si një bazë për një menaxhim të shëndoshë dhe efikas të procesit të privatizimit. Për pasuritë strategjike si nafta, privatizimi duhet të orientohet drejt partnerëve gjeostrategjikë të Shqipërisë dhe Kombit Shqiptar.**

-Problem mjaft serioz vazhdon të mbetet gjendja e shoqërisë “Albpetrol” Sha Fier gjatë auditimit është konstatuar vlera e dëmit ekonomik në fushën e shpenzimeve për vitin 2012 në shumën në **447,344 mijë lekë**, kryesisht në shpërblime dhënë në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi; ndërkohë që në fushën e të ardhurave si pasojë e mosarkëtimit të vlerës së furnizimit me naftë dhe gaz të tretëve, dëmi llogaritet në vlerën **2,199,000 mijë lekë**. Theksojmë që vlera detyrimit prej 5,374,446 milionë lekë që Shoqëria “Armo” sh.a. Fier, i ka shoqërisë “Albpetrol”sh. a. Fier i përket detyrimit të vitit 2011 dhe është raportuar në Raportin e vitit të kaluar.

Në mënyrë më të detajuar nga ky auditim ka rezultuar:

- Nuk janë zbatuar plotësisht marrëveshjet që shoqëria “Albpetrol” Sha ka lidhur me kompanitë e huaja për prodhimin dhe zhvillimin e hidrokarbureve në vendburimet ekzistuese.

KLSH për vitin 2012 ka evidentuar një dëm ekonomik në vlerën **prej 2,198 milionë lekë, që kompanitë e huaja që operojnë në bazë të marrëveshjeve të hidrokarbureve i kanë shoqërisë**

Albpetrol Sha Fier, për shlyerjen e detyrimit të naftës bruto dhe të gazit për prodhimin paraekzistues (PPE) dhe pjesën e Albpetrolit (PPA) në sasinë 42,302.12 tonë naftë dhe 6,491,741 MN m³ gaz.

- Shoqëria “Albpetrol” Sha më datën 16.09.2011, ka lidhur marrëveshje me kompaninë “Bankers Petroleum Albania Ltd”, për të zbritur nga nafta e prodhuar sasinë e holluesit të përdorur, në tejkalim të kompetencave të saj, pasi marrëveshja me këtë kompani është ratifikuar me VKM nr. 477 datë 16.07.2004 dhe bërë efektive me 20.07.2004. Zbatimi i kësaj marrëveshjeje ka sjell pasojat e mëposhtme: Kompania nuk i ka dorëzuar shoqërisë “Albpetrol” Sha sasinë prej 11,955.50 ton naftë bruto me vlerë 6,117,630 USD, pjesë e PPE dhe PPA; si dhe ka ndikuar në faktorin R, vlera e të cilit ka lidhje direkt me përfitimet e Shtetit Shqiptar, pasi, kur $R \geq 1$, fitimi ndahet 50% për “Bankers” dhe 50% për Shtetin Shqiptar.

- Nga “Albpetrol” Sha nuk është kryer dorëzimi i të gjitha aseteve, sipas marrëveshjeve të nënshkruara me kompanitë e huaja, pasi: kompanisë “Stream Oil&Gas, Ltd” nuk i është bërë dorëzimi i vendburimit Ballsh-Hekal, magjistralet Delvinë-Ballsh, Gorisht-Klos-Usojë, rrjeti i grumbullimit të gazit në vendburimin Cakran-Mollaj, si dhe rrjetet e furnizimit; Kompanisë “Sherwood International Petroleum Ltd” nuk i është bërë dorëzimi i vendburimit e puseve të Fermës, pasi shoqëria “Albpetrol” Sh.a ka qenë në proces privatizimi dhe asetet e padorëzuara kompanive janë futur në data-room-in e përgatitur nga shoqëria konsulente. Në këto kushte Albpetrol Sh.a, me shkresën nr. 531 prot, datë 20.02.2013 ka kërkuar nga METE si do të veprohet me këto asete dhe deri në datën 25.07.2013 nuk ka marrë përgjigje. Transferimi i aseteve për kompaninë “Trans Oil Group” është kryer me urdhër nr. 59, datë 03.02.2012 të Ministrit të METE, jashtë kompetenca ligjore të tij.

- Për kompaninë “Trans Oil Group”, Plani i Zhvillimit është miratuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN-ja), në kundërshtim me procedurat që parashikohen në Marrëveshjen Hidrokarbure.

- Në vendburimin e Delvinës operacionet e hidrokarbureve janë ndërprerë nga kompania “Stream Oil&Gas, Ltd”, me pretendimin se nuk ka treg për gazin, pretendim i cili përcaktohet në marrëveshjen e datës 09.09.2007, neni 3,6.1.1. Për këtë, me shkresën nr. 531 prot, datë 20.02.2013 nga “Albpetrol” Sha i është kërkuar METE si do të veprohet dhe nga kjo Ministri deri më 25.07.2013 nuk është kthyer përgjigje.

- Nga Albpetrol Sha nuk janë zbatuar procedurat ligjore në fushën e pagave dhe shpërblimeve, inventarizimin e pasurisë, dhënien me qira të objekteve, si dhe dhënien e ndihmës ekonomike, si pasojë e të cilave për vitin 2012 është krijuar një dëm ekonomik në vlerën 447,702 mijë lekë.

- Megjithëse gjendja bebitore dhe kreditore e kësaj shoqërie në fund të vitit 2012 ka rezultuar në shifra shqetësuese, nga organet drejtuese të saj, nuk është analizuar dhe shqyrtuar me përgjegjësi, si dhe nuk janë marrë masat e duhura për reduktimin e tyre. Konkretisht gjendja debitore është në vlerën 14,819,119,387 lekë, ndërsa gjendja kreditore në vlerën 7,778,460,165 lekë. Duke ju referuar të ardhurave dhe shpenzimeve, gjendja debitore përfaqëson gati dyfishin e të ardhurave mesatare vjetore, ndërsa gjendja kreditore është 1.3 herë më e lartë se niveli i shpenzimeve.

Në gjendjen debitore nuk është pasqyruar detyrimi që bankat i kanë Shoqërisë “Albpetrol” Sh.a, për subjektet që likuidimin e naftës bruto të blerë nga kjo shoqëri, e kanë likuiduar me Letër Crediti. Konkretisht në gjendjen debitore nuk është pasqyruar vlera 9,038,479.73 USD, dhe kamatë vonesën në vlerën 219,256,14 USD, vlerë të cilën Shoqëria “Albpetrol” Sh.a Fier, ka bërë kërkesë padi me nr. 2007 prot, datë 03.06.2013, në Gjykatën e Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Fier, për Tirana Bank, Dega Fier dhe shoqërinë “Crude Oil Traders Ltd”.

- Për vitin 2012 “Albpetrol” Sha ka tejkaluar në mënyrë të paargumentuar numrin mesatar të punonjësve me 920 punonjës nga ai i programuar: sipas programit 2016 punonjës, ndërsa numri mesatar faktik është 2936.

- Për vitin 2012, Shoqëria “Albpetrol” sha Fier, nuk ka zbatuar procedurat ligjore për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës, në bazë të programit të auditimit nr. 478/1, datë 29.05.2013, me ndryshime të miratuar nga Kryetari i KLSH-së me objekt: “Auditim mbi ecurinë e arkëtimit të garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “Vetro Energy PTE Ltd” për privatizimin e shoqërisë “Albpetrol”sha, Patos”, rezultoi se:

Garancia e ofertës që duhej të tërhiqej në rastin e një kandidati fitues, kur ai nuk arrin, që brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat standarte të tenderit të nënshkruajë marrëveshjen ose të dorëzojë garancinë e kontratës, të kërkuar nga marrëveshja nuk është bërë e mundur të realizohet. Garancia e ofertës ishte 10% të çmimit total, që kandidati fitues ofroi për blerjen e aksioneve të shoqërisë “Albpetrol” sha, pra 85.000.000 Euro. Auditimi konstatoi se kompania “Vetro Energy PTE Ltd.” ka sjellë një garanci oferte në shumën 85.000.000 Euro lëshuar nga American Chartered Bank, që nuk përfshihet në 50 bankat kryesore të botës (sipas kushteve të kërkuara në tender).

Duke qënë se nuk u arrit, nga kandidati fitues, që brenda afatit kohor të parashikuar në dokumentat standarte të tenderit të nënshkruajë marrëveshja, garancia e ofertës duhej të ishte arkëtuar në buxhetin e shtetit. Nga ana e METE janë bërë komunikime elektronike për procesin dhe garancinë e ofertës, por edhe pas mbylljes së procedurave të privatizimit e deri më tani nuk është arkëtuar garancia bankare në shumën 85.000.000 euro, ose rreth 11.9 miliardë lekë, duke i shkaktuar dëm ekonomik Buxhetit të Shtetit në këtë shumë.

Arkëtimi i kësaj shume duhet të vazhdojë të ndiqet me përparësi nga të gjithë institucionet përgjegjëse shtetërore duke e detyruar subjektin përkatës të respektojë kushtet e tenderit dhe të gjitha detyrimet referuar kuadrit regullator vendas e të huaj.

- Nga auditimet e kryera në shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizime Fier dhe Durrës KLSH ka identifikuar mjaft të meta dhe parregullsi në menaxhimin e tyre, madje dhe shkelje të ligjshmërisë me pasojë dëm ekonomik në vlerën 8 milionë lekë (UKD Fier), nga të cilat në fushën e prokurimeve 5.6 milionë lekë dhe në fusha të tjera 2.4 milionë lekë. Për vitin 2012, shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizime Durrës dhe Fier (UK Durrës dhe UK Fier) nuk janë zhvilluar në mënyrë të qëndrueshme. Pjesa më e madhe e treguesve kanë një rritje të lehtë ose nivele të njëjta me ato të vitit të kaluar. Këto shoqëri nuk kanë bërë përpjekje në drejtim të përmirësimit të situatës financiare. **Aktualisht me të ardhurat shoqëritë e Ujësjetllës Kanalizimeve të audituara nuk mbulojnë kostot operative dhe mirëmbajtjen.**

Mbulimi i kostove dhe eficientia e arkëtimit nuk janë realizuar objektivat strategjike dhe nuk janë në gjendje të financojnë qoftë edhe veprimtaritë e tyre kryesore operationale duke u varur nga mbështetja financiare e donatorëve dhe e subvencioneve shtetërore. Shoqëritë e UK duhet të punojnë për të siguruar pavarësinë ekonomike dhe të realizojnë të ardhura për përbalimin e shpenzimeve.

Eficientia e stafit është tregues i cili nuk ka shënuar ndonjë ndryshim krahasuar me një vit më parë. Rezultatet e performancës teknike nuk janë të kënaqshme. Treguesi me tendencën negative është norma e arkëtimit Niveli i ujit pa të ardhura vazhdon të mbetet i lartë dhe është rritur në 2012. Prandaj reduktimi i nivelet të ujit pa të ardhura mbetet një nga fushat prioritare të punës për shoqëritë e ujësjetllës kanalizimeve.

Një tregues tjetër që ka ndikim negativ në performancën e shoqërive të UK është **niveli i matjes**. Eliminimi i praktikës së faturimit aforfe, që momentalisht mbetet në nivele të larta dhe zbatimi i programeve për rritjen e numrit të matesave të instaluar në rrjetin ujësjellësve duhet të jetë në fokusin e punës së shoqërive për uljen e nivelit të ujit pa të ardhura.

Vazhdimësia e shërbimit dhe cilësia e ujit të pijshëm nuk është e duhura pjesa më e madhe e klientëve nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm me ujë vjen edhe si rezultat i ndërprerjeve për shkaqe teknike dhe si pasojë e amortizimit të rrjetit të shpërndarjes gjë e cila ndikon në cilësinë e ujit për konsum publik

Mbulimi me shërbimin e kanalizimeve është ende në nivele shumë të ulëta. Nevoja urgjente kërkon masa konkrete për të adresuar këtë problem. Një nga mënyrat e zbatuara në UK është investimi në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

Përmirësimi i këtij shërbimi kërkon akoma më shumë përpjekje për të rritur shkallën e mbulimit me këtë shërbim në vend, duke ruajtur në të njëjtën kohë shkallën e masave sanitare dhe mbrojtjen e mjedisit.

-Mbi tregun informal të punës.

Kontrolli i Lartë i Shtetit për periudhën 01.01.2012 – 31.03. 2013 ka audituar “Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore dhe Drejtorin Rajonale të ISHPSHSH-së Tiranë e cila ka numrin më të madh të subjekteve që zhvillojnë aktivitet në rang kombëtar. Qëllimi i auditimit ISHPSHSH-së ishte vlerësimi i performancës së këtij Institucioni në luftën kundër informalitetit në punë. Kjo ka qenë e domosdoshme nisur edhe nga fakti se niveli i informalitetit në subjektet e inspektuara për çdo drejtori rajonale të ISHPSHSH paraqitet në nivele të ulëta e cila nuk përputhet me realitetin. Në këtë kuadër është synuar të evidentohen masat dhe reagimi i ISHPSHSH ndaj këtij fenomeni aspak të pranueshëm.

Nga të dhënat zyrtare të Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, të raportuara në mënyrë periodike në Drejtorinë e Inspektimit të MPCSSHB dhe për çdo vit në Këshillin Kombëtar të Punës, rezulton se niveli i informalitetit paraqitet shumë i ulët. Kështu, sipas të dhënave, për vitet 2009, 2010, 2011 dhe 2012 informaliteti paraqitet sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emertimi	2009	2010	2011	2012
1	Numri subjekteve të inspektuara privat	11.724	14642	13956	15961
2	Punëmarrës të evidentuar në sektorin privat	128.395	148179	137447	166593
3	Punëmarrës të pa deklaruar (ilegal) në tatime	3.085	1994	1434	1285
4		(2,4%)	(1.35%)	(1.04%)	(0,80.5%)

Pra, siç del nga të dhënat e mësipërme, shkalla e informalitetit nga viti në vit ka ardhur duke u ulur, megjithëse **është rritur numri i subjekteve** të inspektuara dhe punëmarrësve të konstatuar. Nëse kjo do të ishte gjendja reale arritjet e Ministrisë Punës Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta dhe Institucionit të varësisë Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore do të ishin madhore, duke u renditur ndër vendet me informalitet më të ulët në botë. Nga të dhënat e cituara më sipër, **del qartë se ka një regres të dukshëm** në drejtim të luftës kundër informalitetit në tregun e punës, ku pasqyrimi i tij është jo real. Kjo gjendje ka sjellë pasojë në buxhetin e shtetit, pasi nga viti në vit janë rritur financimet për përballimin e fondit të pensioneve që ka ardhur si pasojë e prishjes së ekuilibrit të raportit kontribues- përfitues, i cili ka arritur në raportin 1 përfitues me 1 kontribues.

Nga analiza e strukturës së subjekteve të inspektuara nga Drejtoritë Rajonale të ISHP-së për vitin 2012 del se janë paraqitur me një numër të vogël punëmarrësish subjekte me aktivitet prodhues, ku në disa raste figurojnë me 1 punëmarrës. Nga të dhënat e ISSH del se një numër i madh subjektësh të biznesit të madh paraqiteshin me një ose dy punëmarrës të cilat nuk figuronin në listat e subjekteve të vetdeklaruar në institucion.

U konstatua se, inspektorët nuk njohin situatën e subjekteve që zhvillojnë aktivitet në territorin e juridiksionit që mbulojnë, sipas ndarjes së zonave të miratuara nga Kryeinspektori, megjithëse sipas rregullores së brendshme kanë për detyrë të kryejë kompjuterizimin e subjekteve ekonomike që ushtrojnë aktivitet në zonën që kanë në juridiksion të kontrollit, duke krijuar bangën e të dhënave për çdo subjekt që i nënshtrohet inspektimit nga ana e tij. Mungesa e këtyre të dhënave në nivel kombëtar ka bërë që drejtorite rajonale operojnë në inspektime me një numër të vogël subjektësh. Kështu, sipas të dhënave të Inspektoratit Shtetëror të Punës, rezultojnë të jenë të vetë deklaruara në Drejtoritë Rajonale të ISHP-së, gjithsej 22.077 subjekte fizike dhe juridike, ndërsa sipas evidencës së ISSH, rezultojnë gjithsej 79.085 subjekte fizike dhe juridike. Pra, ISHP-ja ka 57.008 subjekte më pak se ISSH-ja. Si rezultat i mungesës së këtyre të dhënave, mbeten pa u inspektuar pjesa më e madhe e subjekteve, ku një pjesë e tyre ka problem me sigurinë në punë. Kjo situatë është krijuar nga mos zbatimimi i VKM nr. 753, datë 08.09.2010 “Për bashkëpunimin e Inspektoratit Shtetëror të Punës me Institucionet në varësi të Ministrisë së Financave” Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, ku është përcaktuar që dy institucionet të shkëmbejnë informacione për subjektet e regjistruara pranë tyre.

Nga auditimi rezultoi se shkaqet që kanë sjellë këtë gjendje të rënduar janë të shumta por ai që predominon është pajtimi me gjendjen e krijuar i të gjitha strukturave drejtuese nga MPCSSHB, Këshilli Kombëtar i Punës ku bëjnë pjesë edhe përfaqësues të sindikatave.

Me situatën e krijuar janë pajtuar edhe strukturat drejtuese të Inspektoriatit Shtetëror të Punës, të cilat nuk po bëjnë sa duhet për të ndryshuar situatën duke vënë para përgjegjësisë strukturat drejtuese të drejtorive rajonale për indiferentizmin, fshehtësinë që tregojnë në luftën kundër informalitetit në tregun e punës. Për gjendjen e informalitetit kanë paraqitur shqetësim edhe organizmat ndërkombëtare si Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore ku nga studimet e kryera informaliteti paraqitet në nivele të larta.

Në strukturat drejtuese të inspektoriatit të Punës në nivel qendror dhe lokal ekziston koncepti se lufta kundër informalitetit në punë është detyrë e organeve tatimore të cilët mbledhin kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për të ulur në minimum subjektivizmin e strukturave inspektuese duhet të praktikohen inspektime me grupe të përbashkëta ku të përfshihen struktura nga Inspektoriatit Shtetëror i Punës, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Inspektoriatit i Ndërtimit dhe veçanërisht nga strukturat e Institutit Sigurimeve Shoqërore i cili është përfituesi direkt nga minimizimi i punës së zezë i cili me legjislacionin **ekzistues është përjashtuar nga kjo e drejtë.**

Nga KLSH në përfundim të auditimit janë rekomanduar masa të cilat synojnë përmirësimin e kuadrit rregullator për minimizimin e informalitetit në tregun e punës.

IV.2 Shpenzimet për fondin rezervë të KM dhe fondin e kontigjencës.

IV.2.a Mbi përdorimin e fondit rezervë të KM

Auditimi i përdorimit të këtij fondi u krye sipas rregullimeve të mëposhtme ligjore:

1. Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, në:

a) Kreun I, neni 3, pika 15, ku përcaktohet se: “Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave, është fondi që krijohet për të financuar shpenzime jo të përhershme dhe të paparashikuara në fazën e përgatitjes së buxhetit”.

- b)** Kreun II, neni 5, ku përcaktohet se: “Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave, përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave. Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës, miratohen nga Kuvendi në ligjin buxhetor vjetor *deri në në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara*”.
- 2.** Në zbatim të ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, Kreu III, neni 13 të tij, citohet: “*Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave prej 2,000,000 mijë lekë* përdoret për raste të paparashikuara të institucioneve”.
- 3.** Në zbatim të aktit normativ nr. 6, datë 12.12.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012”, nenin 9 të tij, ku përcaktohet se: Fondi Rezervë i Këshillit të Ministrave është përcaktuar në masën *1,800,200 mijë lekë*.”
- 4.** Në zbatim të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në kapitullin I “Të përgjithshme”:
- a)** Në pikën 11 përcaktohet: “Në rast se kërkesa për fonde shtesë pranohet nga Ministri i Financave, por nuk mund të plotësohet, duke respektuar të drejtat dhe limitet e përcaktuara në nenin 44 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, *Ministri i Financave mund t’i propozojë Këshillit të Ministrave plotësimin e saj nëpërmjet përdorimit të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit*”.
- b)** Në pikën 12 përcaktohet: “Në bazë të kërkesës së bërë nga *Kryetari i Komisionit Parlamentar*, përgjegjës për financat publike, *Ministri i Financave vë në dijeni me shkrim Kuvendin* për kërkesa për shtesë fondesh të miratuara nga Këshilli i Ministrave, nëpërmjet përdorimit të Fondit Rezervë”.
- 4.1** Në zbatim të udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në kapitullin II “Procedurat standarde të shpërndarjes dhe rishpërndarjes të fondeve të buxhetit të shtetit”, II/2 “detajimi i fondeve buxhetore”:
- a)** Në pikën 63 përcaktohet: “...Vendimet e gjykatave ndërkombëtare ekzekutohen nga Ministria e Financave me fondin rezervë të buxhetit, *nëse nuk ka fond të mjaftueshëm të miratuar për të*”.
- b)** Në pikën 82 përcaktohet: “Transferimi i fondeve për përdorimin e *Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit* bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe zbatohen me kërkesë të nëpunësit autorizues të njësisë qendrore dhe miratim nëpunësit të parë autorizues”;
- c)** Në pikën 88 citohet: “Fondi Rezervë i Buxhetit të shtetit përdoret vetëm për rastet e financimit të shpenzimeve, të cilat nuk njihen dhe janë të pamundura të parashikohen gjatë procesit të përgatitjes së buxhetit. Miratimi i përdorimit të tij bëhet me Vendim të Këshillit të Ministrave”.
- d)** Në pikën 89 citohet: “Kërkesa për përdorimin e këtij fondi kalon në këto faza:
- Ministrinë e linjës paraqesin tek Ministri i Financave *një projekt*, me të cilën argumentojnë: nevojat për shtesë fondesh, pamundësinë për t’u përballuar nëpërmjet rialokimit të fondeve brenda sistemit, nisur nga analiza e realizimit të buxhetit për periudhën raportuese, emergjencën e problemit dhe pamundësinë e parashikimit në procesin buxhetor etj.
Ministri i Financave, pas shqyrtimit të kërkesës dhe analizës së tyre, *jep vërejtjet dhe sugjerimet*, të cilat duhet të sqarohen dhe të plotësohen *detyrimisht* kur të përgatitet projekt-vendimi përfundimtar.

Me mendimin e ministrive të interesuara dhe atë të Ministrisë të Financave projekt-vendimi paraqitet në Këshillin e Ministrave”.

Për vitin 2012, mbështetur në legjislacionin e mësipërm audituesit e KLSH shqyrtuan 80 vendime të Këshillit të Ministrave në vlerë 1,563,138 mijë lekë, nga 1,800,200 mijë lekë fond i planifikuar për këtë qëllim, ku ka rezultuar:

1. Janë ekzekutuar 79 vendime të Këshillit të Ministrave, në vlerë 1,518,338 mijë lekë, dhe janë transferuar në institucionet përfituese 79 vendime, në vlerë 1,510,339 mijë lekë.
2. Nuk është zbatuar VKM nr. 932, datë 26.12.2012 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për Ministrinë e Drejtësisë, në favor të Avokaturës së Shtetit, për mbulimin e pagesës së shpenzimeve të konsulentit ndërkombëtar për konfliktin me shoqërinë "CEZ shpërndarje sh.a.", me vlerë prej 44,800 mijë lekë.
3. Ka ndryshim në vlerë në VKM nr. 692, datë 12.10.2012 “Për një shtesë fondi për Bashkinë e Tiranës, për dekorimin e qytetit të Tiranës me rastin e 100 vjetorit të pavarësisë”, ku nga 15,996 mijë lekë është realizuar 7,997 mijë lekë, në masën 50% të fondit të miratuar.
4. Në një vendim dhe pikërisht VKM nr. 877, datë 12.12.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 708, datë 24.10.2012, për një shtesë fondi për vitin 2012, për mbulimin e shpenzimeve të realizimit të projektit “Dekori i 100 vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë”, është marrë për dy institucione, përkatësisht për Ministrinë e Punëve të Jashtme, në vlerë 2,840 mijë lekë dhe për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në vlerë 45,616 mijë lekë.

Shumat e Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, aprovuar me legjislacionin e mësipërm dhe realizimi i tij për vitin 2012, paraqiten si më poshtë:

në mijë/lekë

Shuma sipas Ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011	Shuma sipas Aktit Normativ nr. 6, datë 12.12.2012	Shuma e VKM të marra për vitin 2012	Shuma e realizuar	Shuma e ekzekutuar	Diferenca e ngelur pa u përdorur
2,000,000	1,800,200	1,563,138	1,518,338	1,510,339	289,861

Të analizuar sipas institucioneve dhe ministrive përfituese, përdorimi i Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, për vitin 2012, paraqitet si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i institucioneve përfituese	Kodi sipas thesarit	Nr. i vendimeve		Vlera në mijë/lekë			Në % ndaj totalit
			Aprov.	Realizuar	Aprovuar	Realizuar	Egzekutuar	
1.	Ministria e Brendshme	16	7	7	140,748	140,748	140,748	9.3
2.	Ministria e Financave	10	7	7	64,006	64,006	64,006	4.2
3.	Këshilli i Ministrave	03	2	2	130,000	130,000	130,000	8.6
4.	Ministria Shëndetësisë	13	13	13	30,233	30,233	30,233	2.0
5.	MTKRS	12	25	25	491,209	491,209	483,209	32.0
6.	Ministria e Drejtësisë	14	8	7	230,014	185,214	185,214	12.3
7.	Ministria e Arsimit	11	1	1	16,794	16,794	16,794	1.1
8.	Ministria e Jashtme	15	7	7	50,292	50,292	50,292	3.3
9.	Ministria e Mbrojtjes	17	1	1	90,000	90,000	90,000	6.0
10.	MBUMK	05	1	1	201,857	201,857	201,857	13.4
11.	Presidenca	01	1	1	13,000	13,000	13,000	0.9
12.	KQZ	73	1	1	5,000	5,000	5,000	0.3
13.	INSTAT	50	1	1	28,000	28,000	28,000	1.9
14.	DSHQ	87	2	2	54,138	54,138	54,138	3.6
14.	Të tjera (57,20,66,56)		4	4	17,848	17,848	17,848	1.1
TOTALI:			81	80	1,563,138	5,518,338	1,510,339	100

Siç konstatohet nga tabela e mësipërme, pjesën më të madhe të fondit rezervë e ka përfituar MTKRS në vlerë 483,209 mijë lekë, ose në masën 32% të tij, Ministria e Drejtësisë në vlerë 185,214 mijë lekë, ose 12.3% të këtij fondi, Ministria e Brendshme në vlerë 140,748 mijë lekë, ose 9.3% të këtij fondi dhe MBUMK 201,857 mijë lekë, ose 13.4% të tij dhe kështu me radhë.

Përdorimi i këtij fondi është bërë për të gjithë zërat e buxhetit si shpenzime për paga e shtesa, shpenzimet korrente ashtu edhe për investime, siç paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Zërat e shpenzimeve	Shuma në mijë lekë	Në % ndaj totalit
I.	Shpenzime personeli	62,072	4.1
600	Shpenzime për pagat	53,431	3.5
601	Shpenzime për sig shoqërore	8,641	0.6
II.	Shpenzime të tjera korrente	1,190,929	78.9
602	Shpenzime operative dhe mirembajtje	806,654	53.4
603	Suensionet	2,500	0.2
604	Transferta të brendshme	341,050	22.6
605	Transferta të jashtme	28,443	1.9
606	Transferta të individët	12,282	0.8
III.	Investime	257,339	17.0
230	Projektme	25,364	1.6
231	Shpenzime për investime	231,975	15.4
Shuma:		1,510,339	100.0

Nga auditimi i të gjitha dosjeve dhe praktikave të Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit rezultoi se edhe këtë vit *janë konstatuar mangësi në marrjen e vendimeve*, si: vendime të marra pa relacion shpjegues, pa preventivat përkatëse të shpenzimeve dhe pa miratimin e Ministrisë së Financave. *Në vendimet e marra për MTKRS-në, në disa raste janë anuluar, një pjesë janë marrë në kohë të shkurtër, madje data e vendimit është e njëjtë me datën e memos së bërë nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit për t'ju drejtuar Ministrit për vërejtjet apo parregullsitë në projekt-vendimet e dërguara. Këto mangësi e shkelje tregojnë se nuk është ndjekur procedura e marrjes së këtyre vendimeve sipas përcaktimeve ligjore të sipërcituara.*

Më hollësisht mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në vendimet e Këshillit të Ministrave të mara në vitin 2012, janë:

a) Në 26 raste, në vlerë 281,642 mijë lekë, ose 18.6% e vlerës së këtij fondi, dosjet e vendimeve të Këshillit të Ministrave, nuk kanë një relacion shpjegues shpenzimesh nga institucionet përfituese për përdorimin e këtij fondi, në kundërshtim me udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit, dhe konkretisht: në 5 dosje vendimesh të aprovuar për Ministrinë e Brendshme, nga 7 vendime gjithsej, në vlerë 70,696 mijë lekë; në 3 dosje vendimesh të aprovuar për MPJ-në, nga 6 vendime gjithsej, në vlerë 8,252 mijë lekë; në 13 dosje vendimesh të aprovuar për MTKRS-në, nga 25 vendime gjithsej, në vlerë 124,387 mijë lekë; në 2 dosje vendimesh të aprovuar për Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, nga 2 vendime gjithsej, në vlerë 54,138 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për MASH, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 16,794 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për Qendrën Kombëtare e Kinematografisë, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 5,475 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 1,900 mijë lekë.

b) Në 19 raste, në vlerë 219,276 mijë lekë, ose 27% e vlerës së këtij fondi, dosjet e vendimeve të Këshillit të Ministrave, nuk kanë preventiv shpenzimesh nga institucionet përfituese për përdorimin e këtij fondi, në kundërshtim me udhëzimin vjetor të zbatimit të buxhetit, dhe konkretisht: në 5 dosje vendimesh të aprovuar për Ministrinë e Brendshme, nga 7 vendime gjithsej, në vlerë 70,696 mijë lekë; në 3 dosje vendimesh, të aprovuar për MPJ-në, nga 6 vendime gjithsej, në vlerë 8,252 mijë lekë; në 8 dosje vendimesh të aprovuar për MTKRS-në, nga 25 vendime gjithsej, në vlerë 93,034 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për MASH, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 16,794 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për INSTAT-in, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 28,000 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për DSHQ-në, nga 2 vendime marrë për të gjithsej, në vlerë 2,500 mijë lekë.

c. Në 27 dosje vendimesh, në shumën 422,443 mijë lekë, ose 25 % vlerës së këtij fondi, nuk kanë të bashkëlidhur miratimin e Ministrisë së Financave, dhe konkretisht: në 5 dosje vendimesh të aprovuar për Ministrinë e Brendshme, nga 7 vendime gjithsej, në vlerë 70,696 mijë lekë; në 3 dosje vendimesh të aprovuar për MPJ-në, nga 7 vendime gjithsej, në vlerë 8,612 mijë lekë; në 13 dosje vendimesh të aprovuar për MTKRS-në, nga 25 vendime gjithsej, në vlerë 262,083 mijë lekë; në 2 dosje vendimesh të aprovuar për DSHQ-në, nga 2 vendime gjithsej, në vlerë 54,138 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për MASH, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 16,794 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për QKK-së, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 5,475 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për në Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivave, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 1,900 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për Avokatin e Popullit, nga 1 vendim i marrë gjithsej në vlerë 2,745 mijë lekë.

d) Në 7 raste, në shumën 310,865 mijë lekë, ose 20.6% e vlerës së këtij fondi, fondi rezervë është përdorur si “shtesë buxheti” për Ministrinë e Linjës, Kryeministrinë apo Institucione të tjera, fonde këto të cilat, duhet të parashikoheshin në përputhje me procedurat dhe kriteret ligjore të planifikimit të buxhetit, dhe të miratoheshin me ligjin vjetor të buxhetit, dhe konkretisht: në 2 dosje vendimesh të aprovuar për DSHQ-në, në vlerë 54,138 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për MPJ-në, në vlerë 25,200 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për Kryeministrinë, në vlerë 80,000 mijë lekë; në 1 dosje vendimi, të aprovuar për MTKRS-në, në vlerë 3,527 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për Ministrinë e Drejtësisë, në vlerë 123,000 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për MF-ve, në vlerë 25,000 mijë lekë.

Lidhur me vendimin e marrë për MF-ve në vlerë 25,000 mijë lekë, kjo ministri ka paraqitur observacionin shpjegon se ky fond është bërë shtesë në shpenzimet korrente për nevoja të auditimit kompleks të “Bankers Petroleum”, me qellim që rezultatet e këtij auditimi të përdorshin për të hartuar një diagnozë pragmatike mbi efikasitetin e politikave tatimore dhe administrimit tatimor shqiptar mbi naftën e gazin natyror. Nevojat për këtë auditim lindën gjatë vitit 2012, pra nuk ishin parashikuar në planin e buxhetit të MF-ve dhe në pamundësi për t'u përballuar nga fondet e vetë Ministrisë, iu akorduan nga fondi rezerve i buxhetit të shtetit.

e) Në 8 vendime të KM-ve, në vlerë 250,393 mijë lekë, ose 16.6% të vlerës totale, MF-ve është shprehur kundër përdorimit të këtij fondi, si në 3 dosje vendimi të aprovuar për MTKRS-në në vlerë 88,215 mijë lekë; në 2 dosje vendimi të aprovuar për MPJ-në, në vlerë 28,040 mijë lekë, në 1 dosje vendimi të aprovuar për Kryeministrinë, në vlerë 80,000 mijë lekë; në 2 dosje vendimesh të aprovuar për DSHQ-në, në vlerë 54,138 mijë lekë.

f) Në 24 raste vendimesh, në vlerë 255,157 mijë lekë, ose 16.8% të vlerës totale, MF-ve ka dhënë mendim për rishikim të projektvendimeve për efektet financiare, të hartimit të preventivave dhe përllëgaritjes së fondit të kërkuar, apo mungesë të bazës ligjore, si në 13 vendime të aprovuar për Ministrinë e Shëndetësisë, në vlerë 30,233 mijë lekë; në 3 dosje vendimesh të aprovuar për MPJ-në nga 6 vendime gjithsej, në vlerë 41,680 mijë lekë; në 6 dosje vendimesh të aprovuar për MTKRS-në, nga 25 vendime gjithsej, në vlerë 107,084 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për Kryeministrinë, në vlerë 50,000 mijë lekë; në 1 dosje vendimi të aprovuar për MBUMK-në, në vlerë 28,000 mijë lekë.

Për mangësitë e konstatuara në dosjet e vendimeve, Institucionet radhiten përsa vijon:

1. MTKRS, me 13 vendime pa relacion shpjegues, në vlerë 124,387 mijë lekë; 8 vendime pa preventiv shpenzimesh në vlerë 93,034 mijë lekë; 13 vendime pa miratimin e MF-ve, në vlerë 262,083 mijë lekë; 1 vendim si shtesë buxheti, në vlerë 3,527 mijë lekë; 2 vendime ku MF-ve është shprehur kundër në përdorimin e këtij fondi, në vlerë 84,688 mijë lekë; dhe 7 vendime janë rishikuar nga MF-ve, në vlerë 111,611 mijë lekë.

2. Ministrinë e Brendshme, me 5 vendime pa relacion shpjegues, në vlerë 70,696 mijë lekë; 5 vendime pa preventiv shpenzimesh në vlerë 70,696 mijë lekë, dhe 5 vendime pa miratimin e MF-ve, në vlerë 70,696 mijë lekë.

3. Ministria e Punëve të Jashtme me 3 vendime pa relacion shpjegues, në vlerë 8,252 mijë lekë; 3 vendime pa preventiv shpenzimesh në vlerë 8,252 mijë lekë; 3 vendime pa miratimin e MF-ve, në vlerë 8,612 mijë lekë; 1 vendim si shtesë buxheti në vlerë 25,000 lekë; 1 vendim ku MF-ve është kundër në përdorimin e këtij fondi, në vlerë 2,840 mijë lekë; dhe 3 vendime janë rishikuar nga MF-ve, në vlerë 41,680 mijë lekë.

4. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare me 2 vendime pa relacion shpjegues, në vlerë 54,138 mijë lekë; 1 vendim pa preventiv shpenzimesh, në vlerë 2,500 mijë lekë; 2 vendime pa miratimin e MF-ve, në vlerë 54,138 mijë lekë; dhe 2 vendime si shtesë buxheti në vlerë 54,138 mijë lekë.

5. Ministria Drejtësisë me 2 vendime pa preventiv shpenzimesh në vlerë 133,950 mijë lekë; 1 vendim pa miratimin e MF-ve, në vlerë 123,000 mijë lekë; dhe 1 vendim si shtesë buxheti, në vlerë 123,000 mijë lekë.

6. Këshilli i Ministrave me 1 vendim si shtesë buxheti, në vlerë 50,000 mijë lekë; 1 vendim ku MF-ve është shprehur kundër në përdorimin e këtij fondi, në vlerë 80,000 mijë lekë; dhe 1 vendim është rishikuar nga MF-ve, në vlerë 50,000 mijë lekë; dhe kështu me radhë.

Sqarimet e paraqitura nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit në MF-ve për aktverifikimin nr. 2, datë 12.07.2013 dhe projekt-raportit e KLSH-së, janë marrë parasysh dhe është reflektuar nga audituesit e KLSH, si dhe nuk paraqiten në këtë raport.

IV.2.b Mbi ligjshmërinë e përdorimit të fondit të kontigjencës.

Përsa i përket përdorimit të këtij fondi, auditimi u krye sipas rregullimeve të mëposhtme ligjore:

a) Në zbatim të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” përkatësisht:

- Në pikën 16, ku përcaktohet se: “Fondi Kontigjencës është fond i pashpërndarë, që krijohet për të mbuluar risqet e mundshme për të ardhurat dhe shpenzimet gjatë zbatimit të buxhetit”.

- Në Kreu II, neni 5, ku përcaktohet se: “Fondi Kontigjencës përdoret sipas përcaktimit në ligjin e buxhetit vjetor, për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese. Fondi Rezervë dhe Fondi i Kontigjencës, miratohen nga Kuvendi në ligjin buxhetor vjetor deri në në masën 3% të vlerës totale të fondeve të miratuara”.

b) Në zbatim të ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, në Kreun III, neni 13 të tij, ku citojmë: “Fondi i kontingjencës prej 7,091,500 mijë lekë, i ndarë:

- Për ruajtjen e deficitit prej 2,661,000 mijë lekë përdoret me vendime të Këshillit të Ministrave;

- Për rritjen e pagave prej 1,000,000 mijë lekë, shpërndahet nga Ministri i Financave sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave;

- Për rritjen e pensioneve prej 1,500,000 mijë lekë, shpërndahet nga Ministri i Financave sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave;

- Fondi i veçantë i pagave prej 1,930,500 mijë lekë, shpërndahet nga Ministri i Financave”.

c) Në zbatim të aktit normativ nr. 6, datë 12.12.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012”, në nenin 9 të tij, ku përcaktohet: “Fondi i Kontingjencës është përcaktuar në masën 6,000,000 mijë lekë, i ndarë:

- Për ruajtjen e deficitit (kapitulli 70) në masën 2,600,000 mijë lekë;

- Për rritjen e pagave (kapitulli 81) në masën 755,000 mijë lekë;

- Për rritjen pensioneve (kapitulli 81) në masën 1,500,000 mijë lekë;

- Fondi i veçantë i pagave (kapitulli 81) në masën 1,145,000 mijë lekë”.

d) Në zbatim të udhëzimit nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, në kapitullin I “Të përgjithshme” në:

- *Kapitullim II* “Procedurat standarde të shpërndarjes dhe rishpërndarjes të fondeve të buxhetit të shtetit”, II/2 “detajimi i fondeve buxhetore”:

- Pikën 60/a ku përcaktohet: “Fondet buxhetore, të cilat nuk shpenzohen në strukturën ku ato miratohen (Fondin Rezervë të Këshillit të Ministrave, Fondin e Kontigjencës, Fondi Rezervë për rritjen e pagave dhe pensioneve, Fondi i veçantë etj.) bëhen të vlefshme në sistemin informatikë financiar të qeverisë nga strukturat përgjegjëse për buxhetin në Ministrinë e Financave”.

- Pikën 82 ku përcaktohet: “Transferimi i fondeve për përdorimin e *Fondit Rezervë të Buxhetit të Shtetit, Fondit të Kontigjencës dhe Fondit Rezervë për rritjen e pagave dhe pensioneve*, transferimet e pashpërndara të tyre bëhen me vendim të Këshillit të Ministrave dhe zbatohen me kërkesë të nëpunësit autorizues të njësisë qendrore dhe miratim nëpunësit të parë autorizues”, ndërsa përdorimi i *Fondit të veçantë* bëhet me kërkesë të nëpunësit të parë autorizues të njësisë së qeverisjes qendrore dhe miratim të Ministrisë së Financave”.

- Pikën 90 ku përcaktohet: “Fondi i Kontigjencës përdoret sipas përcaktimit në ligjin vjetor të buxhetit për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve ekzistuese”. Duke u mbështetur në bazën ligjore të mësipërme, Fondi i Kontigjencës rezulton i përdorur me 13 Vendime të Këshillit të Ministrave, **në vlerë 5,258,396 mijë lekë** dhe me 13 shkresat e Ministrisë së Financave, Drejtorisë së Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit, *drejtuar institucioneve* kërkuese të këtij fondi, për mbulimin e rritjes së pagave dhe të pagesës sociale, në vlerë 754,800 mijë lekë.

Gjithsej fondi i përdorur në vlerë është **5,537,257 mijë lekë**, ose 92.3% e shumës së planifikuar. Shumat e fondit të kontigjencës dhe fondeve të tjera, aprovuar me legjislacionin e mësipërm dhe realizimi i tyre për vitin 2012, janë si më poshtë:

Struktura Buxhetore	Shuma sipas ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011	Shuma sipas Aktit Normativ nr.6, 12.12.2012	Shuma e alokuar institucioneve sipas VKM	në mijë/lekë
				Diferenca e ngelur pa u përdorur
Për ruajtjen e deficitit 70	2,661,000	2,600,000	2,245,872	354,128
Për rritjen e pagave 81	1,000,000	754,800	754,537	263
Për rritjen e pensioneve 81	1,500,000	1,500,000	1,500,000	-
Për fondin e veçantë 81	1,930,500	1,145,000	1,036,848	108,152
Shuma:	7,091,500	5,999,800	5,537,257	462,543

Për përdorimin e këtij fondi u audituan:

1. Dosjet e 13 Vendimeve të KM-ve, në vlerë 3,745,872 mijë lekë, nga të cilat:

a) Për 11 Vendime të KM-ve, në vlerë 245,872 mijë lekë, të cilat janë marrë “Për kompesimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetra tek njësitë e qeverisjes vendore.

Këto vendime janë marrë në bazë të Urdhërit të MF-ve nr.1, datë 06.01.2012; kërkesave të njësisë të qeverisjes vendore, shkresave të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, Drejtorisë së Mardhënieve Fiskale Ndërqeveritare, drejtuar për ekzekutim vendimi *degëve të thesarit në rrethe* dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, me vendimet e mëposhtme:

- VKM nr. 21, datë 11.01.2012, në vlerë 30,024 mijë lekë, për 9 bashki dhe 9 komuna;
- VKM nr. 84, datë 07.02.2012, në vlerë 16,486 mijë lekë, për 3 bashki dhe 7 komuna;
- VKM nr. 156, datë 29.02.2012, në vlerë 15,220 mijë lekë, për 7 bashki dhe 10 komuna;
- VKM nr. 216, datë 28.03.2012, në vlerë 15,778 mijë lekë, për 5 bashki dhe 13 komuna;
- VKM nr. 309, datë 09.05.2012, në vlerë 22,129 mijë lekë, për 6 bashki dhe 13 komuna;
- VKM nr. 392, datë 02.07.2012, në vlerë 19,643 mijë lekë, për 13 bashki dhe 17 komuna;
- VKM nr. 466, datë 18.07.2012, në vlerë 36,319 mijë lekë, për 5 bashki dhe 13 komuna;

- VKM nr. 579, datë 29.08.2012, në vlerë 16,156 mijë lekë, për 9 bashki dhe 12 komuna;
- VKM nr. 796, datë 14.11.2012, në vlerë 37,081 mijë lekë, për 8 bashki dhe 31 komuna;
- VKM nr. 899 datë 12.12.2012, në vlerë 32,504 mijë lekë, për 9 bashki dhe 29 komuna;
- VKM nr. 908, datë 19.12.2012, në vlerë 4,532 mijë lekë, për 3 bashki dhe 7 komuna.

Këto shpenzime, duhej të përfshiheshin në fondet buxhetore të vitit 2012, pavarësisht sqarimeve të Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit në MF-ve. *Ky fond duhej të përdorej për mbulimin e deficitit nga mosrealizimi i të ardhurave, pra për mbulimin e të ardhurave të pa realizuara ose për financimin e investimeve të planifikuara, që për efekt të mungesës së likuiditetit, nuk mbulohen me financim.*

b) Me propozim të MF-ve **1 (një) Vendim i KM-ve, në vlerë 1,500,000 mijë lekë** është marrë për rritjen e pensioneve, dhe pikërisht VKM nr. 387, datë 27.06.2012 “Për rritjen e pensioneve”,

c) Një Vendim tjetër i KM-ve, në vlerë 2,000,000 mijë lekë, është marrë për dhënie hua afat shkurtër KESH-sh.a., dhe pikërisht VKM nr. 81, datë 13.02.2012 “Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2012, miratuar për METE për KESH sh.a., në formën e një huaje afatshkurtër dhe për miratimin e kushteve të huasë”.

Nga auditimi rezultoi se kjo hua afat shkurtër (6/mujore) është alokuar, por kushtet e aktmarrëveshjes së datës 16.02.2012, neni 4, 5 dhe 6 i saj, nuk janë plotësuar, pra:

- Nuk është kthyer huaja e marrë në datën 16.08.2012, deri në momentin e kryerjes së auditimit korrik 2013. Ndonëse, MF-ve me shkresën nr. 12551, datë 02.08.2012, i është drejtuar z. Engjëll Zeqo, Drejtor i Përgjithshëm i KESH sh.a. dhe nënshkruesi i marrëveshjes së huasë për pagesën e kredisë, duke i kujtuar shumën e huasë dhe shumën interesit të huasë brenda datës 16.08.2012. Pra detyrimi për t’u derdhur në këtë datë rezulton në vlerë 2,005,000 mijë lekë.

Cilësojmë se në fund të vitit 2012, MF-ve nuk ka bërë njoftim me shkrim, drejtuar KESH sh.a. me të cilën të njoftohet për detyrimin e saj të pa derdhur dhe për llogaritjen e interesave dhe kamat vonesat, me përqindjen e Yield-it Mesatar të Bonove të Thesarit, të rezultuar në ankandin e fundit të vitit. *Për sa më lart, KLSH ka vlerësuar që njoftim/kërkesa KESH-it me të gjitha llogaritjet e detyrimeve, pra në vlerë të llogaritur prej 2,141,433 mijë lekë (hua 2,000,000 mijë lekë + interesi 5,000 mijë lekë + penalitet 139,433 mijë lekë), nga MF-ve duhej t’i dërgohej deri më datë 16.08.2013,*

2. Përdorimi i fondit me shkresat e MF-ve , në vlerë 1,791,385 mijë lekë, respektivisht:

a) Shkresat e Drejtorisë së Menaxhimit dhe Monitorimit të Buxhetit, drejtuar 14 institucioneve kërkuese të këtij fondi, për mbulimin e rritjes së pagave dhe të pagesës sociale në zbatim të nenit 11, të ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, të udhëzimit nr.2/1, datë 15.02.2012 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012”, si dhe në shkresat e institucioneve përfituese, në vlerë **754,537 mijë lekë**.

Kjo shumë alokuar këtyre institucioneve, ka kaluar në vlerë **642,103 mijë lekë**, e ndarë për mbulimin e rritjes së pagës (llogaria ekonomike 600) dhe për mbulimin e rritjes së sigurimeve shoqërore (llogaria ekonomike 601), në vlerë **112,434 mijë lekë**.

b) Përdorimi i fondit të veçantë të institucioneve, në vlerë 1,036,848 mijë lekë është bërë me kërkesa të njëjësive të qeverisjes qendrore, të nënshkruar nga nëpunësi i parë autorizues dhe të miratuara nga Ministria e Financave.

*Referuar Ligjit Organik të Buxhetit, Kreu II, neni 5, ku përcaktohet se Fondi i Kontigjencës dhe Fondi Rezervë i Buxhetit të Shtetit, miratohen nga Kuvendi në ligjin buxhetor vjetor deri në masën **3%** të vlerës totale të fondeve të miratuara, në vitin raportues 2012 është miratuar në masën **2%** të kësaj vlere dhe është realizuar në masën **1.9%** të vlerës totale.*

IV.3 Shpenzimet kapitale për vitin 2012.

Për vitin 2012, shpenzimet kapitale të buxhetit u realizuan në masën 94.9% të kuotave të parashikuara, me një mosshpenzim të fondeve buxhetore prej 3,291 milionë lekë, e cila vjen për efekt të mosrealizimeve të investimeve me financim të huaj.

Në krahasim me realizimin e këtyre shpenzimeve në vitin 2011, ato rezultojnë me ulje të konsiderueshme në masën 12.8% dhe në vlerë 9,023 milionë lekë më pak.

Kundrejt PBB-së të rezultuar në vitin 2012, shpenzimet kapitale faktike zenë 4.58% të tij, nga 5.45% që zinin në vitin 2011, me një ulje prej 0.87%.


Më poshtë paraqesim nivelin e planifikuar dhe atë faktik të shpenzimeve kapitale:

<i>në milionë/lekë</i>							
Nr.	EMERTIMI	Plani me ndryshime 2012	Fakti 2012	Diferenca fakt-plan	Në %	Fakti 2012/PBB	Fakti 2011
I.	Shpenzime kapitale	64,946	61,656	- 3,291	94.9	4.58	70,679
1.	Financimi brendshëm	27,398	27,398	0.0	100.0	2.04	41,097
2.	Financimi huaj	37,458	34,257	- 3,291	91.2	2.54	27,982
3.	Shpronësime	0.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1,600

Në këto të dhëna të raportuara, krahas mosrealizimit në masën 5.1% kundrejt planit me ndryshime dhe në vlerë 3,291, milionë lekë më pak; konstatohet dhe një ulje e ndjeshme të shpenzimeve kapitale kundrejt realizimit të një viti më parë.

Nga analiza e realizimit të shpenzimeve kapitale në strukturë, rezulton se financimi i investimeve të brendshme, është realizuar në masën 100%, por në krahasim me një vit më parë këto investime rezultojnë me ulje të konsiderueshme në përqindje dhe në vlerë; ndërkohë që investimet me financim të huaj pavarësisht mosrealizimit, rezultojnë me rritje të ndjeshme kundrejt një viti më parë, sin ë përqindje dhe në vlerë. Financimi i huaj kundrejt kuotave të planifikuara të viti 2012, rezulton i realizuar në masën 91.2%, me një mosrealizim në shumën 3,291 milionë lekë.

Ecuria e shpenzimeve kapitale për periudhën 2005-2012, paraqitet grafikisht si më poshtë:



Burimi: Ministria e Financave

IV.3.a Shpenzimet për investime me financim të brendshëm.

Për vitin 2012, shpenzimet për investime kapitale me financim të brendshëm, janë realizuar në masën 100%, dhe në vlerë 27,398 milionë lekë aq sa plani me ndryshime.

Në krahasim me fondet e shpenzuara një vit më parë, ato paraqiten me ulje të ndjeshme në masën rreth 33.3% dhe në vlerë 13,699 milionë lekë më pak (nga 41,097 milionë lekë shpenzuar në vitin 2011, në 27,398 milionë lekë në vitin 2012).

Kundrejt PBB-së të vitit 2012, ato përfaqësojnë 2.04% të tij, nga 3.17% të PBB-së që zinin në vitin 2011, pra me një ulje prej 1.13 pikë përqindje.

Për vitin vitin 2012, KLSH në nivel qendror ka audituar zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e prokurimit të fondeve publike me burim të brendshëm financimi në 38 ministri, institucione dhe njësi të vartësisë së tyre.

Nga auditimi, ka rezultuar se në përgjithësi ka rritje të përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit të nëpunësve të administratës në institucionet e audituar, për zbatimin e kërkesave dhe procedurave të përcaktuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e prokurimit elektronik, megjithatë duhen pasqyruar disa nga parregullsitë apo shkeljet e këtyre dispozitave, me qëllim mospërsëritjen e tyre në vitet e ardhshme.

Subjektet e audituar nga KLSH kanë zhvilluar gjithsej 288 procedura prokurimi, me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 9,769,531 mijë lekë. Nga tenderët e zhvilluar, janë audituar 231 procedura prokurimi me një vlerë limit kontrate të parashikuar prej 8,431,067 mijë lekë ose 80 % e numrit dhe 86 % e vlerës. Për tenderët e audituar kanë tërhequr dokumentet 1074 operatorë ekonomik, janë shpallur fitues 248 prej tyre dhe janë lidhur 248 kontrata në vlerë 7.300,259 mijë lekë. Si rezultat i konkurrencës së realizuar është ulur vlera e kontratave të lidhura në shumën 1,130,808 mijë lekë ose në masën rreth 13.4%.

Nga tenderat e audituar, rreth 61% të tyre e zënë tenderët e hapur, rreth 16% tenderët me negociim pa shpallje paraprake të kontratës, 12% tenderët me procedurë kërkesë për propozim dhe 11% procedura të tjera prokurimi.

Nga të 231 tenderat e audituar, në 199 prej tyre janë konstatuar 400 shkelje të procedurave të prokurimit, duke shkaktuar një **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit në shumën 191,040 mijë lekë** (përfshihet në vlerën totale të dëmit ekonomik të trajtuar).

Nga 400 shkeljet e konstatuara, 239 prej tyre ose në masën 59% janë kryer në fazën e përgatitjes së tenderëve, 65 shkelje ose 16% e tyre në fazën e zhvillimit të tenderit dhe 96 shkelje të tjera ose 25% e tyre janë konstatuar në fazën e lidhjes, zbatimit të kontratave dhe arkivimit të dokumenteve.

Të analizuara këto mangësi dhe shkelje, sipas fazave të zhvillimit të procedurës së prokurimit ku ato janë konstatuar, rezulton:

1. Në fazën e përgatitjes së dokumenteve të tenderit, 239 rastet e shkeljeve të procedurave të prokurimit të evidentuara, kanë të bëjnë me:

- a) në 109 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në metodën e përllogaritjes së vlerës në kontratat publike nga entet prokuruese;
- b) në 44 raste është shkelur procedura e prokurimit në respektimin e kufirit monetar dhe në mënyrën e informimit dhe të komunikimit me ofertuesit;
- c) në 86 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në përgatitjen e dokumenteve të tenderit dhe në paraqitjen dhe pranimin e ofertave.

Cilësojmë se, rastet e mësipërme të konstatuar nga audituesit e KLSH-së janë rrjedhojë e veprimeve që bien ndesh me kërkesat e ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin Publik”, të ndryshuar dhe me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, pasi në dosjet përkatëse nuk disponohen dokumente që justifikojnë përllogaritjen e vlerës së kontratës, ose përllogaritjet e bëra janë të fryra dhe nuk pasqyrojnë realitetin e tregut. Në shumë raste dokumentet e tenderit përgatiten me mangësi, në përcaktimin e specifikimeve teknike, duke u bërë shkak që tenderët të shtyhen apo të anulohen, sidomos në përcaktimin e procedurës së prokurimit.

Shkeljet e cilësuar më lart janë konstatuar respektivisht në: QSU “Nënë Tereza” Tiranë në 93 raste; Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit në 33 raste; Bankën e Shqipërisë 29 raste; Ministrinë e Financave 18 raste; Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve 10 raste; ISKSH Tiranë 10 raste; MBUMK 7 raste; MASH 6 raste; Ministrinë e Mbrojtjes 3 raste; Universitetin “Eqerem Çabej” Gjirokastër 3 raste; Autoritetin Rrugor Shqipëtar 3 raste, Avokatin e Prokurimeve 2 raste; Ministrinë e Integritit 2 raste dhe në Universitetin e Tiranës në 9 raste.

2. Në fazën e zhvillimit të procedurave të prokurimit, 65 rastet e shkeljeve të procedurave të prokurimit, i përkasin:

a) në 38 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në hapjen, vlerësimin dhe kualifikimin e ofertuesve;

b) në 7 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në s’kualifikimin e padrejtë të ofertave;

c) në 19 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në fazën e njoftimit të fituesit.

Këto shkelje të procedurave janë konstatuar përkatësisht në: MBUMK në 11 raste; Ministrinë e Brendshme në 8 raste; Autoritetin Rrugor Shqiptar 9 raste; QSU “Nënë Tereza” Tiranë 8 raste; Bankën e Shqipërisë 6 raste; Ministrinë e Financave 5 raste; Avokatin e Prokurimeve 5 raste; Ministrinë e Mbrojtjes 3 raste; Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit 3 raste; në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve në 2 raste dhe në Universitetin e Tiranës në 4 raste.

3. Në fazën e lidhjes, zbatimit të kontratave dhe arkivimit të dokumenteve të tenderit, 96 rastet e shkeljeve të procedurave të prokurimit, i përkasin:

a) në 57 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në hartimin dhe lidhjen e kontratave;

b) në 8 raste janë shkelur procedurat e prokurimit në zbatimin e kontratave.

c) në 31 raste në inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të prokurimeve;

Këto shkelje janë konstatuar përkatësisht në: Bankën e Shqipërisë në 18 raste; QSU “Nënë Tereza” Tiranë 16 raste; Ministrinë e Financave 15 raste; Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve 10 raste; MASH 9 raste; ILKDP 4 raste; Autoritetin Rrugor Shqiptar 4 raste; INSTAT 4 raste; Universitetin “Eqerem Çabej” Gjirokastër 3 raste; Administratën e Kryeministrit 3 raste; Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit 2 raste; Ministrinë e Shëndetësisë 1 rast dhe në Universitetin e Tiranës në 7 raste.

Sipas subjekteve ku është konstatuar vlera e dëmit ekonomik të sipërcituar rezulton:

1.	Universiteti I Tiranës	80,448 mijë lekë
2.	Ministria e Brendshme	55,417 mijë lekë
3.	Autoriteti Rrugor Shqiptar	38,039 mijë lekë
4.	MPÇSSHB	11,920 mijë lekë
5.	AKT Inovacionit	2,730 mijë lekë
6.	QSU “Nënë Tereza” Tiranë	1,790 mijë lekë
7.	MPPT	696 mijë lekë
Shuma:		191,040 mijë lekë

Për të gjitha rastet e dëmeve ekonomike të konstatuara, *KLSH ka përcaktuar personat shkaktarë dhe përgjegjës, si dhe ka rekomanduar masat përkatëse administrative e disiplinore, duke kërkuar dhe zhvendosjen në masën 100% të dëmit ekonomik të shkaktuar*

IV.3.b Shpenzimet me burim të huaj financimi

Për vitin 2012, shpenzimet me burim të huaj financimi, nga 37,548 milionë lekë të planifikuara, janë realizuar në shumën 34,257 milionë lekë ose në masën 91.2%, me një mosrealizim të fondeve të planifikuara në shumën 3,291 milionë lekë.

Në krahasim me fondet e shpenzuara një vit më parë, ato paraqiten me rritje të konsiderueshme në masën rreth 22.4% dhe në vlerë 6,275 milionë lekë më tepër (nga 27,982 milionë lekë shpenzuar në vitin 2011, në 34,257 milionë lekë në vitin 2012).

Kundrejt PBB-së të vitit 2012, ato përfaqësojnë 2.54% të tij nga 2.16% të PBB-së që zinin në vitin 2011, me një rritje prej 0.38%.

Për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2012, KLSH ka ushtruar dhe evaduar auditimet në 10 Projekte me financime të huaja, me një vlerë totale të tyre të disbursuar në vitin analizues rreth 51.5 milionë Euro dhe 1 milionë USD. Krahas përpjekjeve dhe përmirësimit të punës të njëjësive të projekteve për zbatimin e tyre në përputhje me marrëveshjet e financimit janë konstatuar dhe evidentuar disa parregullsi dhe shkelje të legjislacionit, me pasojë **dëm ekonomik në 9 projekte në vlerën gjithsej 103,331 mijë lekë (510,096 euro dhe 161,228 USD, e 15,150 mijë leke)**, nga të cilat: në fushën e prokurimit 54,343 mijë lekë, të tatim taksave 47,524 mijë lekë dhe shpenzime të ndryshme 1,464 mijë lekë.

Në mënyrë të përmblodhur problematika e evidentuar ka të bëjë me:

1. Projekti "Rehabilitimi i hidrocentraleve Bistrica 1 dhe 2": - ritme të ulta dhe mosrespektim i afatit të disbursimeve; vonesa në realizimin e objektivave dhe komponentëve të projektit, të shoqëruara jo vetëm me efekte negative financiare, por dhe mos arritjen në afat të përfitimeve të parashikuara nga projektet mungesa të fondeve të nevojshme për mbulimin e kostove lokale, taksës doganore dhe TVSH etj. Vlera e dëmit ekonomik të shkaktuar si pasojë e mosderdhjes së detyrimit për të ardhurat e përfituara llogaritet në **320,953 euro, e konvertuar në lekë 44,933 mijë lekë**.

2. Projekti "Zhvillimi i sektorit privat": - përdorim të fondeve të maturuara të interesave të kredisë për kryerjen e shpenzimeve për pagesat e Bordit Teknik; ritme të ulta të disbursimit; kanë përfituar subjekte të cilat nuk kanë qenë përcaktuar si fitues në marrëveshje; nuk është i plotë dokumentacioni i financimeve; nuk janë pasqyruar në manual efektet e investimeve ne ruajtje të mjedisit etj.

3. Projekti "Ndërtimi i terminalit të Portit të Durrësit": - nuk janë nxjerrë përgjegjësitë për mbikëqyrësit e punimeve, pasi janë certifikuar punime të pakryera; nuk janë marrë masa për zbatimin e pjesës së dytë të projektit "Rehabilitimi i moleve 7 e 8"; nuk janë siguruar burimet financiare për punimet shtesë të certifikuara dhe të regjistruara si të papaguara; nuk janë paraqitur raportet periodike për projektin; nuk janë marrë masa për shtyrjen me marrëveshje të afatit të punimeve; nuk është bërë inventarizimi dhe kuadrimi i vlerave të kontabilitetit në shumën 979,794 milionë lekë etj. Vlera e dëmit ekonomik të shkaktuar në fushën e prokurimit (pagesa kontraktorit për punime të pakryera) llogaritet në **46,493 euro, e konvertuar në lekë 6,509 mijë lekë**.

4. Projekti "Ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen": nuk janë përfshirë në prioritetet e investimeve, të zgjerimit të segmentit rrugor Milot-Rrëshen me dy korsi të tjera sipas standardeve të parashikuara në ndërtimin e aksit rrugor Durrës-Kukës-Morinë dhe vlera e demit ekonomik shkaktuar në fushën e prokurimit ka rezultuar në shumën **123,157 usd, e konvertuar në lekë 12,808 mijë lekë**.

5. Projekti "Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale": - nuk janë zbatuar standardet teknike në shtresat e asfaltit dhe të mureve të betonit; nuk është pjesë e dosjes së prokurimit përlllogaritja e përcaktimit të vlerës së kontratës dhe lista e subjekteve që tërheqin dokumentet e tenderit; marrja në dorëzim e mallrave objekt i kredive, nuk është bërë me komision kolaudimi përkatës; nuk janë kaluar në inventarin e Autoritetit Rrugor Shqiptar rrugët e përfunduara e marra në dorëzim etj. Vlera e dëmit ekonomik të shkaktuar në fushën e prokurimit (likuidime-pagesa të punimeve të pakryera nga subjektet kontraktore) llogaritet në **6,035 mijë lekë**.

6. Projekti "Rehabilitimi i spitalit të Shkodrës, faza III": - nuk është marrë leja mjedisore dhe leja e ndërtimit, për godinën e re të spitalit: nuk është marrë certifikata e vërtetimit të pronësisë; nuk janë marrë masa për shtyrjen e afatit të përfundimit të projektit; nuk janë instaluar pajisjet e

ndryshme sipas kontratave përkatëse; në komisionet e kolaudimit të mallrave nuk ka pasur ekspertë të fushës; nuk janë realizuar procedurat e prokurimit për blerje pajisje mjekësore dhe pajisje guzhine të parashikuara për vitin 2011; nuk është marrë në dorëzim Godina e rikonstruktuar të ish-spitalit të Pediatrisë; janë evidentuar punime në proces të likuiduara por të porealizuara në vlerën 23,640 euro; nuk janë realizuar brenda afateve disbursimet e fondeve etj. Gjithashtu, Vlera e dëmit ekonomik të shkaktuar llogaritet ***në lekë 5,510 mijë lekë***, nga të cilat në fushën e prokurimit gjatë zbatimit të procedurave në shumën 4,046 mijë lekë dhe keqmenaxhimi i aseteve 1,464 mijë lekë.

7. Projekti "Ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash Rexhepaj": - nuk janë kryer rakordimet për kompensimin e vlerave të zërit kosto lokale, paguar më tepër në shumën 1,001,974 lekë dhe TVSH paguar më pak në vlerën 9,084,803 lekë; nuk janë rimbjellje me akacie sipërfaqet e përcaktuara në projekt, për mbrojtjen e themeleve të urave nga rrëshqitjet e dherave; nuk janë marrë masa për njoftimin e organeve ligjore, për dëmtimet e shkaktuara në parmacët e urave dhe në elementë të tjerë të aksit rrugor Durrës-Kukës-Morinë; nuk janë sistemuar rrugët lidhëse të rrugës së vjetër me autostradën, me qëllim shmangien e aksidenteve në këtë segment rrugor. Vlera e dëmit ekonomik të shkaktuar në fushën e prokurimit (pagesa të punimeve të porealizuara) llogaritet ***në 38,071 USD, e konvertuar në lekë 3,959 mijë lekë***.

8. Projekti "Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale": - nuk ka pasur ritmet e parashikuara të disbursimeve; mangësi në plotësimin e transaksioneve financiare me dokumentet e nevojshme mbështetëse; për segmentet rrugore të përfunduara nuk është përgatitur dokumentacioni i plotë, për t'i kaluar në asete të Autoritetit Rrugor Shqiptar; Fondi Shqiptar i Zhvillimit nuk ka marrë masa për realizimin e studimeve gjeologjike për përcaktimin e planeve të rrëshqitjes dhe nevojave për investime për riparimin e tyre; janë konstatuar mangësi në plotësimin me dokumentacion të dosjeve teknike; nuk janë riparuar dëmtimet e segmentit rrugor Sheshi i Trageteve -Lekbibaj, etj. Vlera e dëmit ekonomik të rezultuar nga auditimi ***është 3,605 mijë lekë***, shumë e cila përfaqëson pagesa kontraktorëve për punime të pakryera dhe punime të realizuara në kundërshtim me specifikimet teknike.

9. Projekti "Ndërtimi i By-Pass Durrës dhe Nyja e Vorës": Njësia e Zbatimit të Projektit, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, si dhe Ministria e Financave, nuk kanë marrë masa për të bërë të mundur përfundimin e projektit brenda afatit të shtyrë të realizimit, si dhe nuk kanë përmbushur detyrimin mbi sigurimin e sipërfaqes së tokës që është e nevojshme për zbatimin e projekteve dhe realizimin në afat të procesit të shpronësimeve; Njësia e Zbatimit të Projektit dhe Autoriteti Rrugor Shqiptar, nuk kanë plotësuar të gjithë dokumentacionin e duhur për projektet dhe procedurat e prokurimit; Njësia e Zbatimit të Projektit nuk ka monitoruar siç duhet punimet e kontraktorit për procese zingjir në shtrimin e rrugës, si dhe për përfundimin e ndarëseve të trafikut, sinjalistikës përkatëse dhe mbjelljen e shkurreve dekorative sipas përcaktimeve në preventivin përkatës në mes të trafik ndarëseve etj. Dëmi e ekonomik i kërkuar për shpërblim nga ky auditim ka rezultuar ***135,400 euro, e konvertuar në lekë 18,956 mijë lekë***, nga të cilat 116,892 euro penalitete për mos plotësim të kushteve të kontratës së konsulentit, për përfitime të padrejta të kontraktorit në kundërshtim me kushtet e kontratës, pagesa të pajustificuara me vëllimin e punës etj, si dhe 18,508 euro tatim i pambajtur për të ardhurat e konsulentit.

10. Projekti "Programi rural i furnizimit me ujë": - Fondi Shqiptar i Zhvillimit nuk ka zbatuar tarifat e shpenzimeve për udhëtim e dieta brenda vendit, në përputhje me legjislacionin përkatës; nuk ka plotësuar me dokumentacionin e nevojshëm teknik dosjet e zbatimit të kontratave etj. Pas përfundimit të auditimit, është kërkuar arkëtimi i vlerës ***prej 7,250 euro, e konvertuar në 1,015 mijë lekë*** dëm ekonomik, si rezultat i përfitimeve të padrejta të kontraktorit për punime të porealizuara.

Për mënjanimin e mangësive, parregullsive dhe shkeljeve të konstatuara, ***KLSH ka rekomanduar gjithsej 88 masa organizative, 31 masa për shpërblim dëmi, 3 masa administrative dhe 14 masa disiplinore, dhe më një rast është bërë kallëzim penal për personat shkaktarë përgjegjës.***

Masat organizative janë rekomanduar kryesisht për përmirësimin e punës dhe korrektimin e mangësive në projektet të cilat janë në proces ose në përfundim të realizimit, si dhe për njësitë e menaxhimit që të mos përsëriten në zbatimin e projekteve të ardhshme. Këto rekomandime kanë të bëjnë kryesisht me: njësitë e menaxhimit dhe/ose entet zbatuese që të përmbushin detyrimin për zbatimin e afateve të disbursimit, për të shmangur rritjen e kostove nga zbatimi i tarifës së angazhimit dhe interesin e kredisë së disbursuar; sigurimin e fondeve të nevojshme për mbulimin e kostove lokale, taksës doganore dhe TVSH, për investimet e përfituara nga projektet, detyrime të cilat sipas marrëveshjeve përballohen nga huamarrësi; kryerjen e vazhdueshme të monitorimit të zbatimit të projekteve dhe të raportimeve periodike me synim realizimin në afat të objektivave dhe komponentëve të projektit; zbatimin e penalteteve në rastet e mosrealizimit në afat të detyrimeve kontraktore gjatë projektit; shqyrtimi në vazhdimësi i veprimtarisë së subjekteve mbikëqyrëse, për të ndërhyrë në kohën e duhur në dobi të projektit; në funksion të rritjes së sigurisë rrugore, projektet të shoqërohen me zgjidhjet e nevojshme dhe koston e tyre për numrin e korsive; sigurimin e të gjitha lejeve të nevojshme nga autoritetet lokale para fillimit të projektit; vënien në eficiencë të plotë të makinerive dhe pajisjeve të financuara nga projektet; marrjen e masave mjedisore në lidhje me sigurimin e qëndrueshmërisë së veprave rrugore nëpërmjet mbjelljes së pemëve; regjistrimin e plotë kontabël dhe inventarizimin e projekteve të përfunduara për të siguruar dhe mirëmbajtjen e tyre; shmangien e pagesave të bordeve nga fondet e kredive të marra, me synim rritjen e efektivitetit të investimeve etj.

Krahas masave organizative, ***KLSH ka kërkuar marrjen e masave për shpërblimin e dëmit në 31 raste për 9 projekte në shumën 510,096 euro, 161,228 USD dhe 15150 mijë lekë.*** Ndëshkimi i personave përgjegjës për mangësitë dhe problematikën e evidentuar gjatë auditimit të projekteve me financim të huaj me masa disiplinore nga më të ndryshme, nga drejtues projektesh dhe deri nëpunës të thjeshtë, krahas nxjerrjes së përgjegjësive për periudhën e audituar, ka shërbyer dhe si masë parandaluese për shmangien e mangësive në të ardhmen. Kështu është kërkuar masa, "vërejtje për largim nga puna për Drejtorin e Investimeve në KESH sh.a. për zbatimin projektit të rehabilitimit të Hidrocentraleve Bistrica 1 dhe 2; "zgjidhje e kontratës së punësimit" për ish drejtorin e Njesisë së Zbatimit të Projektit dhe përgjegjës të sektorit për projektin "Ndërtimi i terminalit të trageteve në portin e Durrësit"; "largim nga puna" për drejtorin e spitalit rajonal të Shkodrës etj.

Duke pasur në qendër të vëmendjes thellimin e luftës kundër korrupsionit dhe ndryshimin e klimës së pandëshkueshmërisë, evidentimi dhe ngarkimi me përgjegjësi i nëpunësve publikë për mangësitë e evidentuara nuk ka ngelur vetëm në kuadrin e rekomandimit të masave disiplinore.

Gjatë auditimit të Projektit "Rehabilitimi Spitalit të Shkodrës, faza e III-të" ka rezultuar se tre persona: dy drejtues të lartë dhe një nëpunës i Spitalit Rajonal Shkodër, kanë konsumuar veprën penale të shpërdorimit të detyrës dhe janë kallëzuar në prokurori për favorizim të furnizuesit, në zbatim të nenit 248 të Kodit Penal. Si rezultat i veprimeve dhe mosveprimeve të tyre është nënshkruar kontratë në mungesë të dokumentacionit të nevojshëm; kontrata të lidhura në kundërshtim me dispozitat ligjore dhe nënligjore përkatëse; kanë ndryshuar specifikimet teknike të ofertave të shpalluar fituese; me pasojë dëm ekonomik në shumën 4,046 mijë lekë, si dhe kanë rezultuar mungesa inventari në vlerën 1,464 mijë lekë.

V. DEFICITI I PËRGJITHSHËM BUXHETOR DHE FINANCIMI I TIJ

Bazuar në Ligjin “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012” me ndryshime është përcaktuar:

- Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 49 538 milionë lekë, nga i cili 900 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit.

Në tabelën e mëposhtme paraqiten kuotat e planifikuara me ndryshimet, realizimi faktik i deficitit buxhetor dhe burimet e financimin të tij:

në milionë/lekë

Nr.	E M E R T I M I	Plani me ndryshime 2012	Fakti 2012	Diferenca (fakt-plan me ndryshime)	Në përqindje	Në % Fakti 2012/ PBB
I.	DEFIÇITI	- 49,538	- 45,857	3,682	92.6	3.41
1.	FINANCIMI I DEFIÇITIT	49,538	45,857	- 3,681	92.6	3.41
	I Brendshëm	27,190	26,495	- 695	97.4	1.97
A.	Të ardhura nga privatizimi	900	1,221	321	135.7	0.09
B.	Hua-martje e brendshme	26,290	24,783	- 1,507	94.3	1.84
C.	Të tjera		491	491		0.04
2.	I Huaj	22,348	19,362	- 2,986	86.6	1.44
A.	Hua afatgjatë (e marre)	33,528	32,257	- 1,271	96.2	2.40
B.	Ndryshimi i gjendjes së arkës		- 2,226	- 2,226		-0.17
C.	Ripagesat	- 11,180	- 10,669	511	95.4	-0.79


Burimi: Ministria e Financave

Deficiti i përgjithshëm i buxhetit të shtetit për vitin 2012 rezultoi në vlerë 45,857 milionë lekë nga 49,538 milionë lekë të kuotave të planifikuara ose në masën 92.6%, me një ulje prej 3,682 milionë lekë.

Kundrejt PBB-së ky tregues për vitin 2012 arriti në 3.41% dhe në masën 1.97% të PBB-së u financua nga burime të brendshme ose me 26,495 milionë lekë dhe në masën 1.44% të PBB-së u financua nëpërmjet huave afatgjata ose me 19,362 milionë lekë.

Kundrejt kuotave të planifikuara huamarrja e brendshme për financim deficitit rezulton me realizim në masën 94.3 % ose 1.84% të PBB-së, ndërsa financimi i huaj rezulton në masën 86.6% kundrejt kuotave të planifikuara dhe 1.44% të PBB-së

Më poshtë paraqesim dinamikën e deficitit buxhetor në vite.



Burimi: Ministria e Financave

Nga analiza e kryer për nivelin e deficitit rezulton përqëndrimi i shpenzimeve buxhetore kryesisht në muajt e fundit të vitit me impakt rritjen e kërkesës së huamarrjes për mbulimin e shpenzimeve.

V.1 **Mbi saktësinë dhe mbajtjen e llogarisë “Depozitë e Qeverisë”.**

Për këtë çështje, auditimi nga audituesit e KLSH u krye duke u mbështetur në:

Udhëzimin nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”; udhëzimin e Ministrisë së Financave “Mbi Procesimin e transaksioneve të fundvitit”, kapitulli 4.5 dhe kapitulli 4.6 i tij; dhe në *Akt-marëveshjen* e lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe MF-ve, në nenin 2 të saj “Mbajtja dhe rregjistrimi i veprimeve të llogarisë “Depozitë e Qeverisë”, dhe konkretisht në pikën 2.9 të akt-marëveshjes të lidhur midis MF-ve, Drejtorisë së Thesarit dhe Bankës së Shqipërisë, ku përcaktohet se çdo muaj dhe në fund të vitit, Ministria e Financës brenda datës 27 të muajit pasardhës, i kërkon Bankës së Shqipërisë, konfirmimin për llogarinë “Depozitë e qeverisë” në lekë, duke e shoqëruar shkresën me tabelat përmbledhëse të të ardhurave dhe shpenzimeve të kësaj llogarie. Në pikën 2.10 të akt-marëveshjes thuhet se, Banka e Shqipërisë, brenda 3 ditëve pune nga data e marrjes së këtyre të dhënave bën konfirmimin e tyre me shkrim, në të kundërt, ato konsiderohen të mirëqena. Nga auditimi rezultoi se:

Nga verifikimi i korrespondencës çdo muaj midis Ministrisë së Financave dhe Bankës së Shqipërisë dhe në fund të vitit 2012, u konstatua se:

- Në dosje kishte për 11 muajt e vitit 2012 dhe në fund të këtij viti, akt- rakordime midis Sektorit të Transaksioneve, Sektorit të Borxhit të Brendshëm dhe Sektorit të Borxhit të Jashtëm. Kishte çdo muaj rakordime midis Departamentit të Operacioneve Monetare të Bankës së Shqipërisë dhe Drejtorisë së Thesarit të Ministrisë së Financave.

Me shkresën nr. 331, datë 10.01.2013 “Për rakordimin e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” (2111008) për periudhën 01.01.2012-31.12.2012”, MF-ve nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit - Drejtorisë Operacionale, i drejtohej Bankës së Shqipërisë - Departamentit të Operacioneve Monetare, për të konfirmuar gjendjen e kësaj llogarie në fund të vitit 2012.

Të gjitha shkresat mujore ishin të shoqëruara me gjendjen e llogarisë “Depozitë e Qeverisë në lekë”, “Depozitë e Qeverisë në euro” dhe “Depozitë e Qeverisë në dollarë”, të cikluara nga specialisti përkatës i mbajtjes së kësaj llogarie.

Theksojmë se për çdo muaj të vitit 2012, shkresat e Ministrisë së Financave me gjendjen e kësaj llogarie dhe kërkesa për konfirmim, dërguar Bankës së Shqipërisë, si dhe përgjigja për konfirmim e BSH-së, janë bërë me vonesë nga 3 deri në 48 ditë për muajin qershor të vitit 2012.

Të ardhurat, shpenzimet dhe gjendja e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” më 31/12/2012, sipas të dhënave të Drejtorisë së Thesarit të MF dhe asaj të Drejtorisë Operacionale të BSH-së, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në mijë/lekë

Nr.	EMËRTIMI	Gjendja sipas BSH-së	Gjendja sipas Drejtorisë së Thesarit	Diferenca (MF-BSH)
I.	TË ARDHURAT	114,837,537.88	114,532,078.99	- 305,458.89
1.	<i>Fitimi i Bankës së Shqipërisë (7101)</i>	<i>4,692,915.15</i>	<i>4,692,915.15</i>	-
2.	<i>Transferim Financim i Huaj (1060)</i>	<i>1,545,468.56</i>	<i>1,545,468.56</i>	-
3.	<i>Nën/Huaja:</i>	<i>1,713,747.82</i>	<i>1,713,747.82</i>	-
-	<i>Principiali (2500)</i>	<i>1,325,052.94</i>	<i>1,325,052.94</i>	-
-	<i>Interesa (7600)</i>	<i>388,694.88</i>	<i>1,325,052.94</i>	-
4.	<i>Nga hua e dhënë me garanci shtetërore</i>		<i>14,855.90</i>	<i>14,855.90</i>

Nr.	EMËRTIMI	Gjendja sipas BSH-së	Gjendja sipas Drejtorisë së Thesarit	Diferenca (MF-BSH)
5.	<i>Arkëtime nga Borxhi i Brendshëm</i>	24,713,615.50	24,713,615.50	-
-	Bono thesari neto	8,912,788.70	8,912,788.70	-
-	Obligacione me afat 2-vjeçar	1,601,450.00	1,601,450.00	-
-	Obligacione me afat 3-vjeçar	3,237,850.00	3,237,850.00	-
-	Obligacione me afat 5-vjeçar	5,979,426.80	5,979,426.80	-
-	Obligacione me afat 7-vjeçar	4,982,100.00	4,982,100.00	-
6.	<i>Transferte e përkoh për nevojat e likujdit.</i>	2,415,096.79	2,415,096.79	-
7.	<i>Interesa depozitë me afat</i>	21,085.11	21,085.11	-
8.	<i>Të ardhura nga rrugë, vepra ujore</i>	2,082,150.00	2,082,150.00	-
9	<i>Dif.të ardh. dhe shp. të bank.. niv. II</i>	73,830,640.75	73,468,777.35	- 361,863.40
10	<i>Kthim bankave të nivelit të dytë</i>	284,164.17	284,164.17	-
11	<i>Kontribut për përmbajtje natyrore</i>	14,092.07	32,359.84	-
12	<i>Gjendja e llogar. e trash. nga 2011</i>	2,879,538.13	2,879,538.13	-
13	<i>Depozitë garanci për Oracle</i>	- 500,000.00	- 500,000.00	-
14	<i>Të tjera</i>	1,145,023.83	1,186,572.44	41,548.61
II.	SHPENZIMET	114,840,906.93	114,535,448.04	- 305,458.89
1.	<i>Borxhi i Jashtëm</i>	18,467,279.15	18,161,820.26	- 305,458.89
-	Principiali instit. financiare (1761)	11,042,871.67	0,669,476.41	- 373,395.26
-	Interesa (6611)	7,424,407.48	7,335,403.51	- 89,003.97
-	Komisione (6028)	-	156,940.34	156,940.34
2.	<i>Inter. të borxh. të brend. (6500, 6520)</i>	34,005,185.32	34,005,185.32	-
3.	<i>Transf. për ISSH dhe ISKSH (6042)</i>	53,250,810.89	53,063,810.89	- 187,000.00
4.	<i>Transferte nga viti 2011</i>	-	187,000.00	187,000.00
5.	<i>Transferta për shpronësimet</i>	1,400,000.00	1,400,000.00	-
6.	<i>Transferta për kompesimin e pronave</i>	1,580,856.79	1,580,856.79	-
7.	<i>Transferte të përdjekurit politikë (6040)</i>	1,698,933.65	1,698,933.65	-
III.	Gjendja e llogarisë (5311) (I-II)	4,437,841.13	4,437,841.13	-
1.	<i>Në Lekë</i>	3,260,297.58	3,260,297.58	-
2.	<i>Në Euro</i>	1,070,590.98	1,070,590.98	-
3.	<i>Në Dollarë</i>	106,952.57	106,952.57	-

Burimi: Ministria e Financave

Për këtë vit, megjithëse gjendja e llogarisë “Depozitë e Qeverisë” në total nga të dy institucionet është e njëjtë, ka diferencë të rezultuar midis zërave të ndryshëm të evidentuara në të ardhura, apo shpenzimet, diferencë që rezultojnë nga mënyra e ndryshme e mbajtjes dhe kontabilizimit të kësaj llogarie midis tyre por që kuadrojnë midis tyre.

V.2 Mbi zbatimin e ligjshmërisë për arkëtimet dhe pagesat e kryera nëpërmjet llogarisë “Depozitë e Qeverisë”.

Auditimi mbi transaksionet e Buxhetit të Shtetit në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”, u krye në mbështetje të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dhe të udhëzimit të MF-ve nr. 4, datë 27.01.2012, “Mbi zbatimin e buxhetit të shtetit”, kapitulli 4.5 “Mbyllja e buxhetit të vitit”, pikat 4, 5, 6, 7 dhe 8.

Nga auditimi me zgjedhje i dokumentacionit dhe dosjeve që prekin këtë llogari, u konstatua si më poshtë:

Nga kontrolli i mbylljes së kësaj llogarie (dokumentet e dhjetorit) rezultoi se, data e fundit e transaksioneve ishte data 31.12.2012.

Kontabilizimi i veprimeve çdo muaj, është bërë për të gjitha llojet e të ardhurave dhe shpenzimeve në mënyrë analitike, në ditarë më vete për lëvizjet e kësaj llogarie në lekë, euro dhe dollarë. Për çdo veprim në llogarinë “Depozitë e Qeverisë”, bashkangjitur është vendosur konferma bankare e shoqëruar me dokumentacionin justifikues përkatës.

Nga Banka e Shqipërisë për çdo transaksion të llogarisë “Depozitë e Qeverisë”, është vëlosur dokumenti bazë konferma bankare, por tek nxjerrja ditore e kësaj llogarie e firmosur dhe e

vulosur nga Banka e Shqipërisë, kreu i saj titullohet “llogaria kryesore e qeverisë për vitin 2008”, ndërkohë dokumentacioni shoqërues i përmbledhëseve ditore është i vitit 2012. Kjo parregullsi është verejtur edhe vitet e kaluara dhe nuk është sistemuar as këtë vit.

U audituan dhe u verifikuan me përmbledhësen e dhjetorit apo fund vitit, zërat e të adhurave dhe shpenzimeve të kësaj llogarie si Borxhit të Jashtëm, Fitimi i Bankës së Shqipërisë, Bonot e Thesarit dhe Oblikacionet 2, 3, 5 dhe 7/vjeçare dhe rezultuan të rregjistruara në regull.

Nga auditimi i pagesave si: Transferta për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, transferata për shpronësimet, transferata për kompensimin e pronave, transferata për të përndjekurit politikë, rezultoi::

a) “Transferta për ISSH dhe ISKSH (6042)”, në vlerë 53,250,810.89 mijë lekë, është kryer për këtë vit nga kjo llogari me 166 pagesa. Auditimi u krye në mbështetje të kapitullit 5, të udhëzimit nr. 4, datë 27.01.2011 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2011”, në të cilin përcaktohet se: “...Në Bankën e Shqipërisë funksionon një llogari speciale për manaxhimin e transaksioneve të pagesave të buxhetit të ISSH. Ministri i Financave cakton personat e autorizuar për të vepruar me këtë llogari. Transfertat e likuiditeteve në këtë llogari do të kryhen nga Llogaria e Unifikuar e Thesarit në Bankën e Shqipërisë periodikisht, *mbështetur në kërkesën e ISSH-së për furnizim të llogarisë me likuiditete dhe deri në kufirin e likuiditeteve disponibël për ISSH, të derdhura si kontribut i sigurimit shoqëror. Detajimi i transfertës së buxhetit të shtetit për Institutin e Sigurimeve Shoqërore dhe Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor, bëhet nga vetë institucioni dhe depozitohet në Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit.*”

Shumat e kaluara me shkresat respektive ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së Qeverisë” nga të dy institucionet.

b) “Transferta për kompesimin e pronave” në vlerë 1,580,856.79 mijë lekë, ka kaluar nëpërmjet llogarisë “Depozita e qeverisë”, me 8 pagesa.

Likujdimi i kësaj shume është bërë në zbatim të nenit 6, të ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, nenit 14 të ligjit nr.10186, datë 05.11.2009 “Për rregullimin e pronës mbi truallin shtetëror në zonat me përparësi turizmin”, të ligjit nr.10239, datë 25.02.2010 “Për krijimin e Fondeve Speciale të kompesimit të pronave”, sipas vendimit të veçantë të KM-ve nr. 1453, datë 05.11.2008; nr. 1655 datë 24.12.2008; nr. 204, datë 19.02.2009; nr. 616, datë 11.06.2009; nr.1039, datë 14.10.2009; nr. 389, datë 19.05.2010; nr.120 datë 17.02.2011; nr. 900, datë 06.12.2011; dhe shkresës së Agjensisë së Legalizimit Urbanizimit dhe Integritimit të Zonave Ndërtimore Informale nr. 440, datë 17.01.2012 dhe nr. 4019, datë 12.07.2012.

Shumat e kaluara me këto shkresa ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së qeverisë” nga të dy institucionet.

c) “Transferta për të përndjekurit politikë” në vlerë 1,700,000 mijë lekë për vitin 2012, janë bërë me 21 transferata, kaluar nëpërmjet llogarisë “Depozita e qeverisë” vetëm me shkresat e Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit nr. 240, datë 09.01.2012, në vlerë 500,000 mijë lekë; nr. 127, datë 28.08.2012, në vlerë 200,000 mijë lekë; dhe nr. 4318, datë 23.03.2012, në vlerë 1,000,000 mijë lekë.

Likujdimi i kësaj shume është bërë në përputhje me ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për Buxhetin e vitit 2012”; ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 “Për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politik të regjimit komunist”; VKM-në “Për miratimin e dëmshpërblimit financiar për ish të dënuarit politik të regjimit komunist”; udhëzimit të MF-ve nr. 41, datë 09.10.2009 “Për përdorimin e fondeve për dëmshpërblimin e ish të dënuarve politik të regjimit komunist” dhe shkresës MF-ve nr.240, datë 09.01.2012, nr. 4318, datë 23.03.2012 dhe nr. 127, datë

28.08.2012. *Shumat e kaluara me këto shkresa ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së qeverisë” nga të dy institucionet.*

d) *“Transferta për të shpronësuarit” në vlerë 1,400,000 mijë lekë, ka kaluar nëpërmjet llogarisë “Depozitë e qeverisë” në datën 17.02.2012, dhe është realizuar në bazë të VKM nr. 911, datë 30.12.2011 “Për një shtesë fondi në llogarinë Speciale të Shpronësimeve”, ndryshuar me VKM nr. 909 datë 28.12.2011 “Për një shtesë fondesh në buxhetin e vitit 2011”, miratuar për MPÇSSHB për ISSH-në”, si dhe në bazë të shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit nr.2415/5, datë 03.02.2012 “Për zbatimin e VKM nr. 911, datë 30.12.2011”. Shumat e kaluara me këto shkresa ishin të barabarta me nxjerrjen e evidencës së shpenzimeve të “Depozitës së Qeverisë” nga të dy institucionet.*

V.3 Mbi rakordimin e bankave të nivelit të dytë me Bankën e Shqipërisë dhe me Degët e Thesarit.

Auditimi për rakordimin e Bankave të nivelit të dytë me Bankën e Shqipërisë dhe Degët e Thesarit në Rrethe, u mbështet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, në nenin 38 të tij, ku përcaktohet: “Ministri i Financave nxjerr urdhra, udhëzime dhe rregullore në bazë dhe për zbatimin e këtij ligji”; gjithashtu, në udhëzimin e MF-ve nr.2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Transaksionet financiare të buxhetit të njëjësive të qeverisjes së përgjithshme, regjistrohen në sistemin online të MF-ve, me bazë Oracle E-Bussines Suite, nga Degët e Thesarit dhe procesohen automatikisht për **pagesat** elektronike me Bankën e Shqipërisë, ndërsa **për të ardhurat**, regjistrimi në sistemin online nuk ka përfunduar. Posta ditore ngarkohet elektronikisht në sistemin e MF-ve nga Banka e Shqipërisë për kryerjen e pagesave elektronike dhe nga bankat e nivelit të dytë për të ardhurat tatimore jotatimore dhe të hyra të tjera.

Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit, në ditët e para të muajit janar 2013, u ka kërkuar 15 Bankave të nivelit të dytë konfirmim për gjëndjen e llogarive të të ardhurave të buxhetit për vitin 2012”; po kështu BSH-së (Drejtorisë Operacionale) konfirmimin dhe përmbledhësen e raportimit për të ardhurat e bankave të nivelit të dytë, në vlerë 296,533,931.35 mijë lekë

Më datën 11.01.2013, Drejtorja e Përgjithshme e Thesarit e MF-ve, i është drejtuar Bankës së Shqipërisë mbi rakordimin e të dhënave (të ardhura, shpenzime) të raportuara nga bankat e niveli të dytë dhe të rakorduara me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit. Në rast mospërputhje bëhen sistemimet deri në datën 13.01.2013. *Ky afat nuk është realizuar*, pasi diferenca e rezultuar prej 12,048 lekë e Bankës Credins është sistemuar në datën 21.01.2013.

Banka e Shqipërisë me shkresën nr. 12/1, datë 12.01.2013, ka kthyer përgjigje për kërkesën e MF-ve të dërguar me shkresë nr.445, datë 11.01.2011, të shoqëruar me pasqyrën për të 15 bankat, për raportimin e të ardhurave të realizuar nga Bankat e nivelit të dytë në Bankën e Shqipërisë dhe raportimit të tyre në MF-ve.

Në mënyrë të përmbledhur raportimet për të ardhurat e bankave të nivelit të dytë në Bankën e Shqipërisë dhe në Degët e Thesarit, për vitin 2012, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në mijë lekë

Bankat e nivelit të dytë	Raportuar në BSH	Raportuar në degët e thesarit	Diferenca e raportimeve DTH-BSH
Reiffeisen Bank	79,132,417.51	79,132,417.51	
Banka Kombëtare Tregëtare	44,529,482.31	44,529,482.31	
Banka e Bashkuar Shqiptare	739,260.07	739,260.07	
Banka Credins	43,048,989.92	43,048,989.92	
Alfa Bank	15,268,483.11	15,268,483.11	
Intesa Sanpaulo Bank	32,484,715.44	32,484,715.44	
Emporiki Bank	6,361,957.40	6,361,957.40	

Banka Kombëtare Greke	5,115,960.04	5,115,960.04	
Pro Credit Bank	15,182,279.40	15,182,279.40	12.00
First Investment Bank	1,538,862.77	1,538,862.77	
vVeneto bank	3,303,295.00	3,303,295.00	
Banka Ndërkomb. Tregëtare	524,840.06	524,840.06	
Banka Popullore	18,170,990.19	18,170,990.19	
Tirana Bank	24,254,723.69	24,254,723.69	
Union Bank	6,877,674.43	6,877,674.43	
Shuma	296,533,919.35	296,533,931.35	12.00

Burimi: Ministria e Financave

Në përfundim, nga rakordimi i Bankave të nivelit të dytë me Bankën e Shqipërisë dhe me Degët e Thesarit në Rrethe, diferenca e rezultuar prej 12,048 lekë e Bankës Credins, është sistemuar në llogarinë “Depozitë e qeverisë” në datën 21.01.2013.

VI. MBI BORXHIN E BRENDSHËM DHE TË JASHTËM SHTETËROR

Bazuar në Ligjin nr. 126/2012 , datë 20.12.2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 6, datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012”, kufijtë e rritjes së borxhit shtetëror janë përcaktuar si më poshtë vijon:

- Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2012, është **87 740** milionë lekë, i detajuar si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto, deri në 26 290 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 46 000 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 13 700 milionë lekë.
4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja të papaguara, është 1 750 milionë lekë.
5. Niveli i stokut të borxhit shtetëror parashikohet të arrijë deri në 792 694 milionë lekë, ndërsa niveli i stokut të garancive deri në 62 683 milionë lekë.

Treguesi faktik i **Borxhit Publik për vitin 2012**, rezultoi **në vlerën 828,276 milionë lekë ose 61.53 % të PBB-së**, dhe përbëhet nga:

A. Borxhi publik i qeverisjes qendrore, në vlerën 827,987 milionë lekë, nga 772,525 milionë lekë që rezultoi në fund të vitit 2011 ose e shprehur në përqindje kundrejt PBB-së rezultoi përkatësisht 61.51 % nga 59.53 % që rezultoi në fund të vitit 2011, pra me një rritje prej 1.98% të PBB-së. Ky borxh i rezultuar në vitin 2012, përbëhet nga:

A.1. Borxhi i brendshëm, i cili rezulton në vlerën 470,358 milionë lekë ose 34.94 % të PBB-së, nga 438,582 milionë lekë ose 33.80% e PBB-së që rezultoi në vitin 2011. Për vitin 2012, në krahasim me vitin 2011, ky tregues kundrejt PBB-së rezulton me një rritje prej 1.14 pikë përqindje të PBB-së.

A.2. Borxhi i jashtëm, i cili rezulton në vlerën 357,629 milionë lekë ose 26.57% të PBB-së nga 333,943 milionë lekë ose 25.73% e PBB-së që rezultoi në vitin 2011. Për vitin 2012, krahasuar me vitin 2011, ky tregues rezulton me një rritje prej 0.84 pikë përqindje.

B. Borxhi i qeverisjes vendore, rezultoi në vlerën 288 milionë lekë ose 0.021% e PBB-së nga 0.016% të PBB-së që rezultoi në vitin 2011.


Niveli faktik i stokut të borxhit shtetëror arriti në 774,534 milionë lekë ndërsa i garancive arriti në 53453 milionë lekë, pra brënda përcaktimit ligjor.

Në raportin që shoqëron Projektligjin e buxhetit faktik është paraqitur raporti për Borxhin

Shtetëror, ndërkohë që ky raport në Projekt-ligj është titulluar: Mbi menaxhimin e borxhit publik” dhe në reference të nenit nr. 58 të Ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH përcaktohet që: “Borxhi publik përbëhet nga borxhi shtetëror dhe borxhi vendor”.

Po kështu, në këtë raport nuk është relatuar fakti i tejkalimit gjatë tremujorit të IV-rt 2012 të kufirit ligjor 60% të PBB-së.

Më poshtë japim dinamikën e stokut të borxhit në vite e shprehur në terma kundrejt PBB-së:



Burimi: Ministria e Financave

Nga auditimi u konstatua se me Ligjin nr 114/2012, datë 07.12.2012 “Për një ndryshim në ligjin 9936, datë 26.08.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” dekretuar më 17.12.2012, i dhe hyrë në fuqi më 3 Janar 2013, është ndryshuar kufiri ligjor i borxhit publik prej 60% të PBB-së, duke lënë në këtë mënyrë borxhin publik pa një tavan të përcaktuar dhe duke i hapur rrugë kapërcimit të këtij taveni në periudhat në vazhdim.

Në ligjin e sipërcituarm, në nenin nr. 1 përcaktohet që: “Paragrafi i fundit i nenit 58 shfuqizohet” dhe në nenin 2 përcaktohet se: “Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në fletoren zyrtare”, që në fakt mban datën 19 dhjetor 2012.

Ndërkohë që në ligjin nr. 9936 date 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH” neni 58 “**Kufijtë e borxhit publik**”, paragrafi i fundit cilësohet: “Borxhi total publik, përfshirë garancitë, nuk duhet të tejkalojë limitin 60 për qind të produktit të brendshëm bruto”.

- Nga auditimi i kryer u konstatua shkelje e kufirit ligjor të totalit të borxhit publik i përcaktuar në ligjin organik të buxhetit, i cili përcakton kufirin maksimal 60% të PBB-së. Në periudhën tetor, nëntor dhe dhjetor 2012, stoku i borxhit publik ka tejkaluar kufirin ligjor prej 60% të PBB-së, referuar vlerës së PBB-së e cila ka qenë zyrtarisht në fuqi gjatë periudhës 1 gusht 2012 – 22 janar 2013 në vlerën prej **1,360.9 miliardë lekë** (kjo vlerë është e zyrtarizuar në VKM nr.54, datë 1.08.2012 “Disa ndryshime në vendimin nr.60, datë 18.01.2012 “Për miratimin e Kuadrit Makroekonomik e Fiskal 2011-2013”).

	në milionë lekë		
	Tetor	Nëntor	Dhjetor
Borxhi publik stoku në milionë/lekë:	818,218	822,366	828,275

Burimi: Ministria e Financave

Bazuar në vlerat e stokut të borxhit publik për tremujorin e fundit 2012, treguesi i Borxhit Publik kundrejt PBB-së rezulton përkatesisht në muajin tetor 60.1%, muajin nëntor 60.4% dhe dhjetor 60.9% të PBB-së.

Sa më sipër nga audituesit e KLSH-së është kërkuar informacion në lidhje me evidentimin dhe informimin e këtij problemi strukturave përkatëse, për marrjen e masave bazuar në kuadrin rregullator ligjor. Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Borxhit në MF-ve u paraqiten disa informacione dhe memot përkatëse drejtuar titullarit të Ministrisë lidhur me analizat e nivelit të borxhit, risqet e huamarrjes dhe evidentimin e faktit për tejkalimin e nivelit 60% të PBB-së.

Për vitin 2012 shitesat e rritjes së borxhit shtetëror në kuotat e planifikuara dhe ato faktike rezultojnë si më poshtë vijon:

në milionë/lekë

Nr.	PËRSHKRIMI	Plani	Fakti	Diferenca (P-F)
I.	TOTALI I BORXHIT	87,740	58,444	29,296
1.	Huamarrje vjetore neto	26,290	24,770	1,520
2.	Huamarrje financim projekte të huaja	46,000	27,418	18,582
3.	Garancitë e shtetit në dobi të palëve të treta përfituese Nga e cila:	13,700	5,136	8,564
3.a	Garanci të huaja	6,700	- 1,870	8,570
3.b	Garanci të brendshme	7,000	7,006	0,006
4.	Borxh i riskeduluar	1,750	1,120	630

Burimi: Ministria e Financave

Sikurse konstatohet, rritja e kuotave faktike të borxhit shtetëror kundrejt kuotave të planifikuara rezulton në shumën 58,444 milionë lekë, kundrejt 87,740 milionë lekë të planifikuara ose rreth 67% të kuotave të planifikuara. Pra, rritja e shitesave të borxhit shtetëror është brënda kuotave të planifikuara.

VI.1 Borxhi i brendshëm dhe shërbimi i tij

Bazuar në ligjin nr. 126/2012 , datë 20.12.2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 6, datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012”, kufijtë e rritjes së borxhit shtetëror janë përcaktuar si më poshtë vijon:

Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2012, është **87 740 milionë lekë**, i detajuar si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto, deri në 26 290 milionë lekë.
2. Kufiri i financimit të deficitit të buxhetit të shtetit nga burime të brendshme dhe të huaja është 49 538 milionë lekë, nga i cili 900 milionë lekë financohen nga të ardhurat e privatizimit.

Në rast të mosrealizimit të ardhurave të buxhetit dhe të ardhurave nga privatizimi, huamarrja e brendshme për financimin e deficitit prej 48 638 milionë lekësh nuk ndryshon.

Treguesit e planifikuar dhe ata faktikë të borxhit të brendshëm, rezultojnë me poshtë vijon:

në milionë/lekë

Nr.	PËRSHKRIMI	Plan	Fakt	Diferenca (P-f)
I.	Borxhi i brendshëm	33,290	31,776	1,514
1.	Huamarrje financim tregu i brendshëm	26,290	24,770	1,520
2.	Garanci në tregun e brendshëm	7,000	7,006	-0.006

Burimi: Ministria e Financave

Në tabelën e mëposhtme paraqesim në mënyrë të detajuar kompozimin e stokut faktik të borxhit të brendshëm shtetëror në vite dhe rritjen per vitin 2012:


në milionë/lekë

Nr.	Emërtimi	2008	2009	2010	2011	2012	Diferenca 2012/2011
1.	Instrumenta afatshkurtër Bono thesari	224,224	237,469	231,436	241,385	250,352	8,967
2.	Instrumenta afatgjatë Obligacione	144,740	153,162	170,385	188,539	204,343	15,804
3.	Kredi direkte Detyrime në obligacione të BKT	3,000	-	-	-	-	-
4.	Obligacioni i rivlerësimit të valutës	23,540	18,870	-	-	-	-
5.	Garanci për tregun e brendshëm	4,952	5,527	5,551	8,657	15,663	7,005
TOTALI:		400,456	415,028	407,372	438,582	470,358	31,776

Burimi: Ministria e Financave

Nga shqyrtimi i të dhënave të mësipërme rezulton se për vitin 2012 ka rritje të stokut të borxhit të brendshëm në 31,776 milionë lekë. Nga analiza e portofolit të borxhit të brendshëm rezulton se kjo rritje vjen: 15,804 milionë lekë për efekt të rritjes së borxhit me instrumente afatgjatë, 8,967 milionë lekë nga ato afatshkurtër dhe 7,005 milionë garancitë e emetuara në favor të KESH sha.

Nga pikëpamja strukturore stoku i borxhit të brendshëm paraqitet:



Burimi: Ministria e Financave

Sikurse konstatohet, përbërja e portofolit të borxhit të brendshëm përbëhet në masën rreth 53% nga instrumente financiar afatshkurtër, 43% nga instrumente afatgjatë (obligacione), ndërsa 3% garancitë e brendshme.

Shtesa e rritjes së stokut të brendshëm për vitin 2012 është për shkak të huamarrjes së brendshme për financimin e deficitit, e cila në masën 36% përbëhet nga huaja me instrumente afatshkurtër dhe që përfaqësojnë 0.7% të PBB-së dhe 64% nga huamarrja me instrumente afatgjatë ose rreth 1.17% të PBB-së.

VI.1.a Përcaktimi i nevojave për huamarrje, llogaritja e nevojave për sasinë e bonove të thesarit dhe obligacioneve që emetohen gjatë vitit 2012.

Mbështetur në treguesin e kufirit maksimal të lejuar të deficitit buxhetor dhe financimit të tij me financim të brendshëm, të përcaktuar në ligjin vjetor të buxhetit për vitin 2012, nga Sektori i Borxhit të Brendshëm janë parashikuar nevojat për huamarrje të brendshme. Instrumentet e MF-

ve për mbulimin e nevojave për huamarrje të brendshme kanë qenë emetimi i bonove të thesarit 3, 6, 12 mujore dhe emetimi i obligacioneve 2, 3, 5 dhe 7/vjeçare.

Nga ky Sektor për nevojat të huamarrjes është hartuar kalendarit për huamarrje për bono thesari dhe për obligacione. Referuar njoftimeve zyrtare të MF-ve bërë Bankës së Shqipërisë (njoftimit shkresor ose elektronik) për kalendarin e emetimit të instrumenteve të huamarrjes së brendshme rezultoi se nga MF-ve janë respektuar neni 3.1 i Marrëveshjes midis Bankës së Shqipërisë dhe MF-ve “Për Obligacionet” të nënshkruar me datën 28.09.2007 dhe neni 2 i marrëveshjes datë 05.09.2006 midis MF-ve dhe Bankës së Shqipërisë “Për emetimin nga ana e Republikës së Shqipërisë, të bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe mbajtjen e regjistrit në dy nivele”, lidhur me njoftimet zyrtare çdo tre muaj dhe njoftimet për ndryshim të kalendarit gjatë vitit ushtrimor referuar vendimmarrjeve dhënë grupit të auditimi për vitin 2012.

Nga shqyrtimi i informacionit të dhënë dhe të shpallur nga Banka e Shqipërisë që njofton pjesëmarrësit e huamarrjes, rezultoi se, asnjë ankand i obligacioneve nuk ka qenë ankand i jashtëzakonshëm. Referuar kalendarit të planifikimit të *ankandëve për obligacione*, ishin planifikuar për vitin 2012, për t’u zhvilluar 12 ankande obligacionesh 2/vjeçare (çdo muaj), në fakt janë realizuar 12; ankande obligacionesh 3/vjeçare planifikuar të zhvilloheshin 4, janë zhvilluar po 4; ankande të obligacioneve 5/vjeçare me kupon fiks dhe të ndryshueshëm planifikuar nga 4 për secilin dhe janë realizuar 5, ku një ankand është i rihapur. *Ankandi i rihapur nuk ka qenë parashikuar në kalendar. Ai ka qenë pjesë e njoftimit nga MF-ve për zhvillim ankandi, por njoftimi nuk është kryer si një ankand i jashtëzakonshëm.*

Rihapja e ankandëve të obligacioneve është realizuar radhë nga Ministria e Financave, si instrument në huamarrjen e brendshme afatgjatë, mbasi dhe në marrëveshjen e përbashkët MF-BSH është parashikuar e drejta e rihapjes nga Ministria e Financave.

Kalendarit i nevojave për bono thesari referuar njoftimeve zyrtare në Bankën e Shqipërisë është hartuar për periudhën janar - dhjetor të vitit 2012 për çdo parashikim ankandi në mënyrë të njëpasnjëshme dhe për çdo lloj emetimi bono thesari 3/mujor, 6/mujor dhe 12/mujor. Pjesë e këtij kalendarit është dhe parashikimi për emetim të obligacioneve 2/vjeçare, 3/vjeçare, 5/vjeçare dhe 7/vjeçare.

Nga auditimi i dokumentacionit të ankandëve të vënë në dispozicion dhe mbështetur në shkresat përkatëse të MF, rezultoi se janë bërë ndryshime të shumta. Kështu kalendarit për 3/mujorin e parë 2012, është ndryshuar 4 herë (shkresat nr.23306/1 datë 18.01.2012, nr.2130 datë 10.02.2012; nr.2333 datë 15.02.2012, nr.284 datë 23.02.2012 dhe nr.3855 datë 13.03.2012); për 3/mujorin e dytë kalendarit ka ndryshuar 6 herë (disponohen shkresat respektive); për 3/mujorin e tretë kalendarit ka ndryshuar 3 herë (sipas shkresave respektive); dhe 3/mujorin e katërt ka ndryshuar 2 herë (sipas shkresave respektive).

Gjatë vitit 2012, janë evidentuar raste të ndryshimeve të kalendarit të huamarrjes, për shumatat e emetuara sipas njoftimeve të MF-ve, pas procesit të zhvillimit të ankandëve (konstatuar tek ankandet e obligacioneve dhe trajtuar tek rubrika “Rregullshmëria e zhvillimit të ankandëve të obligacioneve”).

Nga Drejtori i Drejtorisë së Huamarrjes në bashkëpunim me Drejtorin e Përgjithshëm të Borxhit dhe Nëpunësin e Parë Autorizues, gjatë vitit 2012 janë paraqitur mendime në formën e vendimmarrjeve për ndryshimin e huamarrjes së brendshme të këtij viti, ku ndër to paraqesim vetëm disa, si:

- Ndryshim i huamarrjes si rezultat i Vendimmarrjes së Bankës së Shqipërisë për ndryshim në portofolin e saj në letrat me vlerë të Qeverisë (janar – mars 2012).
- Ndryshim i huamarrjes për ankandin 12 mujor me bono thesari të datës 14.02.2012, rritja e shumës së huamarrjes si pasojë e mungesës së likuiditetit në thesar.

- Ndryshim i huamarrjes për ankandin e obligacionit 2/vjeçar të datës 22.02.2012, rritja e shumës së huamarrjes për plotësimin e nevojave për likuiditet për pagesat e fillimit të muajit mars 2012.
- Ndryshim i huamarrjes në ankandin 12 mujor të datës 31 maj dhe 14 qershor 2012 me rritje të shumave si rezultat i hedhjes në treg i likuiditeteve shtesë së Bankës së Shqipërisë, për të rritur pjesëmarrjen e bankave të nivelit të dytë në ankandet e titujve të qeverisë, dhe si pasojë e nevojave në rritje për likuiditetet e nevojshme të Drejtorisë së Thesarit.

Ministria e Financave vendos të hedhe në treg pas disa viteve instrumentin obligacion me afat maturimi 7/vjeçar (datë 14.06.2012), me qëllim zgjatjen e afatit të maturimit dhe më pas ndërmerret me vendim ndryshimin me rritje, të shumave të saj për emetim, si rezultat i mos realizimit të ankandit të bonove të thesarit 12 mujore të datës 12.06.2012 etj.

Referuar ndryshimeve të shumta të ankandit, KLSH ka arritur në përfundimin se huamarrja e brendshme e planifikuar në fillim viti 2012 sipas instrumenteve përkatës, ka qenë e ndryshueshme gjatë vitit, kjo dhe për faktin kryesor të mungesës së likuiditetit. Këtë e pasqyrojnë edhe të dhënat mbi huamarrjen e brendshme faktike të rezultuar për çdo muaj të vitit 2012 (të dhëna të marra nga rakordimi midis Sektorit të Transaksioneve Qendrore dhe Sektorit të Borxhit të Brendshëm) si më poshtë vijon:

në mijë/lekë

Huamarrja për çdo muaj të vitit 2012	Financimi i deficitit me huamarrje të brendshme gjithsej sipas instrumentit të huamarrjes			
	Gjithsej	Bono thesari neto	Euro bono neto	Obligacione neto
Janar 2012	2,215,033.00	3,913,933	0.0	-1,698,900.00
Shkurt 2012	5,027,601.82	7,745,101.82	0.0	-2,717,500.00
Mars 2012	8,231,326.23	9,383,499.42	0.0	-1,152,173.19
Prill 2012	12,005,649.93	11,728,673.12	0.0	276,976.81
Maj 2012	13,568,059.96	11,858,783.16	0.0	1,709,276.80
Qershor 2012	14,627,870.34	9,718,593.53	0.0	4,909,276.81
Korrik 2012	14,990,534.10	6,406,384.15	1,442,973.15	7,141,176.80
Gusht 2012	18,401,081.44	5,751,782.62	3,406,722.02	9,242,576.80
Shtator 2012	17,987,363.78	2,087,414.96	3,406,722.02	12,493,226.80
Tetor 2012	17,441,193.49	1,165,444.67	3,406,722.02	12,869,026.80
Nëntor 2012	18,532,746.17	325,197.36	3,406,722.02	14,800,826.8
Dhjetor 2012	24,713,615.50	4,025,598.77	4,887,189.93	15,800,826.80

Nga nevojat e domosdoshme për likuiditete të fund vitit si rezultat edhe i mosrealizimit të të ardhurave në mënyrë progresive, është rritur huamarrja për financim deficiti, tendencë kjo që referuar të dhënave të mësipërme ka nisur nga muaji prill dhe vijuar deri në muajin nëntor 2012, madje, në këtë muaj rezultoi tejkalmi i limitit vjetor nga 18,515 miliardë lekë i planifikuar vjetor, në 18,532.7 miliardë lekë. Kurse, referuar limitit mujor të rezultuar nga realizimi i treguesve fiskalë mujore (plan fakt) për vitin 2012, ky tejkalm është relatuar që në muajin mars 2012. Fakti i mosrealizimit të të ardhurave dhe fakti se shkurtimi i mundshëm i shpenzimeve nuk arrinte në nivelin e mosrealizimit të të ardhurave, çuan në domosdoshmërinë e rritjes së nivelit të deficitit, për rrjedhojë dhe të financimit të tij me borxh të brendshëm, ku ky limit sipas aktit normativ të fund vitit arriti në nivelin e 26,290 milionë lekë, nivel që rezultoi i pa tejkalar nga financimi neto i paraqitur në tabelë në dhjetor të vitit 2012.

Në ligjin nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në Republikën e Shqipërisë”, neni 50: “Përfaqësimi i Ministrit të Financave”, është përcaktuar kompetenca për çdo zyrtar në rolin e ministrit gjatë mungesës së tij. Theksojmë se ky nen për huamarrjen e brendshme gjatë vitit 2012 është zbatuar.

Në auditimin e vitit 2011, KLSH ka rekomanduar bërjen e ndryshimeve në marrëveshjen ekzistuese (marrëveshjen për obligacionet), me synim dhe qëllim, auditimin dhe transparencën e vendimmarrjes së Ministrisë së Financave në huamarrjen e brendshme vjetore, si dhe argumentet e ndryshimit të saj gjatë vitit referuar situatave të paraqitura dhe nevojave për likuiditete.

Gjatë auditimit të kryer në vitin 2013, u konstatua se rekomandimet e lëna nga KLSH nuk janë reflektuar në marrëveshjen përkatëse. Nga Banka e Shqipërisë është përgatitur Draft-Marrëveshja e përmirësuar, i është dërguar MF-ve me shkresë zyrtare dhe se konsiderohet e gatshme për t'u nënshkruar, por një gjë e tillë nuk është bërë nga palët.

Cilësojmë se, nga MF-ve nuk ka reagim zyrtar për këtë draft-marrëveshje, megjithëse kanë kaluar 3 muaj nga data e dërgimit nga Banka e Shqipërisë.

Duke marrë shkas dhe nga fakti se në draft-udhëzimin për "Për emetimin nga Qeveria e Republikës së Shqipërisë, të obligacioneve në formë regjistri", nuk janë përfshirë dy rekomandimet e lëna nga KLSH për përmirësim të marrëveshjes ekzistuese. Sa më sipër nga KLSH u rekomanduan perseri për Ministrinë e Financave.

Sipas parashikimeve të bëra në kalendarin e bonove të thesarit të hartuar, shuma për emetim për gjithë vitin 2012 ka qenë e planifikuar 374,300 milionë lekë kundrejt 352,500 milionë lekë në vitin 2011, kundrejt 345,534 milionë lekë në vitin 2010 dhe 404.097 milionë lekë në 2009; ndërsa sasia e planifikuar e huamarrjes me instrumentin e obligacioneve ka qenë në nivelin 76,300 milionë lekë në vitin 2012 kundrejt 60,800 milionë lekë në vitin 2011, kundrejt 50,200 milionë lekë në vitin 2010 dhe 57,550 milionë lekë në vitin 2009. Pra, tendenca për vitin 2012 ka qenë një rritje e huamarrjes e afatshkurtër (nën 1 vit) dhe huamarrjes afatgjatë (obligacioneve) në krahasim me tre vitet e fundit. Kjo huamarrje e planifikuar ka ndryshuar gjatë vitit 2012 sipas strukturës si më poshtë vijon:

Huamarrja për vitin 2012				
<i>në milionë lekë</i>				
<u>Bono thesari</u>	<u>Sipas kalendarit</u>	<u>Të ofruara</u> (Shpallura nga MF)		<u>Të emetuara</u>
		Para ankandit	pas ankandit	
3/mujore	39,400	39,400	38,290	36,498
6/mujore	123,900	84,500	83,657	83,365
12/mujore	211,000	215,000	213,825	212,112
Totali bono thesari	374,300	338,900	335,772	331,975
<u>Obligacione</u>	<u>Sipas kalendarit</u>	<u>Të ofruara</u> (Shpallura nga MF)		<u>Të emetuara</u>
		Para ankandit	pas ankandit	
2/vjeçare	39,800	39,800	39,800	37,001
3/vjeçare	8,500	8,500	8,500	7,788
5/vjeçare	22,500	24,000	23,832	23,732
7/ vjeçare	5,000	5,500	5,500	4,982
Totali i obligacioneve	75,800	77,800	77,632	73,503

Burimi: Ministria e Financave

Shënim: tek ankandet e obligacioneve 5 vjeçare shuma e shpallur është më e madhe se kalendarit për shkak të rihapjes së ankandëve të mëparëshme të cilat nuk kanë qenë të planifikuara në kalendar.

Ndryshimi i strukturës së bonove të thesarit dhe obligacioneve në përqindje paraqitet në tabelë si më poshtë vijon:

<u>Bono thesari</u>	<u>Sipas kalendarit</u>	<i>në përqindje</i>	
		<u>Të ofruara</u>	<u>Të emetuara</u>
3/mujore	10.5	11.6	11.0
6/mujore	33.1	24.9	25.11
12/mujore	56.4	63.5	63.89
Totali bono thesari	100.0	100.0	100.0
Obligacione			
2/vjeçare	52.51	51.15	50.36
3/vjeçare	11.21	10.90	10.59
5/vjeçare	29.68	30.85	32.28
7/vjeçare	6.60	7.10	6.77
Totali i obligacioneve	100.0	100.0	100.0

Burimi: Ministria e Financave

Sa më sipër rezulton, se në shumat e kërkuara nga MF-ve për bono thesari 6/mujore, 12/mujore (referuar njoftimeve të bëra nga MF-ve për çdo ankand), është ndryshuar struktura për huamarrje, krahasuar kjo me planifikimin e nevojave të paraqitura në kalendarin e huamarrjes të publikuar dhe dërguar për njoftim Bankës së Shqipërisë. Edhe emetimi ka ndryshuar në disa raste, kjo për vetë faktin e plotësimit të nevojave të shpallura me ofertën e tregut. Në disa nga këto raste për ankandet e kryera në një datë, janë përdorur kompensimi i shumave të shpallura për ankandet përkatëse me kërkesat e ofruara, kjo në përputhje në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe MF-ve.

Nga studimi i tregut të zhvilluar të obligacioneve për vitin 2012, rezulton se ka pasur raste, që shumat e kërkuara nga MF-ve në ankandet përkatëse nuk janë plotësuar me ofertën e tregut dhe kjo në ankandin e obligacioneve 2/vjeçare të organizuar në muajt janar, shkurt, gusht, shtator, tetor; dhe në ankandet e obligacionit 3/vjeçare të organizuar në muajt janar, prill, korrik, kurse për ankandin e obligacioneve 7/vjeçare të organizuar në muajin shtator shuma e pranuar është më e vogël se shuma e shpallur.

Nga shuma e emetuar e obligacioneve për vitin 2012 prej 73,503 milionë lekë, janë maturuar obligacione me vlerë 57,700 milionë lekë dhe diferenca prej 15,803.8 milionë lekë në vlerë nominale dhe me çmim blerje 15,800.8 milionë lekë, ka shërbyer si e ardhur në Depozitën e Qeverisë për kryerjen e likuiditeteve të saj (financim deficiti).

Gjithashtu, nga shuma totale e emetimit të bonove të thesarit për vitin 2012 prej 321,087 milionë lekë me çmim blerje janë maturuar bono thesari në shumën 312,174.9 milionë lekë, pra për financim deficiti ka shërbyer diferenca prej 8,912.8 milionë lekë.

Gjatë vitit 2012 janë emetuar dhe bono në Euro. Në financim deficiti ankandet e bonove në euro paraqiten me 4,887.1 milionë lekë, pasi shuma e emetuar është më e madhe se shuma e maturuar.

MF-ve për huamarrjen e brendshme ka bërë njoftimin për publikimin e të dhënave për ankandet e huamarrjes së brendshme (njoftim ankandi bono thesari dhe obligacioni). Për këtë ka dalë urdhri i nënshkruar nga Ministri i Financave me nr. 24100, datë 27.12.2011 “Për publikimin e njoftimeve për ankand”. Nga verifikimi rezultoi se në zbatim të urdhrin të mësipërm është bërë publikimi për çdo njoftim ankandi për letrat me vlerë të qeverisë të zhvilluar gjatë vitit 2012. Gjithashtu, në nëntor të vitit 2012 ka një shtesë në urdhrin e mësipërm ku përcaktohen personat dhe drejtoria përgjegjëse për monitorimin e publikimeve për ankandet, kjo në zbatim të rekomandimit të lënë nga KLSH në autitimin e një viti më parë.

Gjatë vitit 2012 MF-ve ka kryer një fushatë publiciteti për titujt e qeverisë, si me fletë palosje, postera, faqe ëeb e Ministrisë, që kanë dhënë rezultat në rritjen e pjesëmarrësve individ në ankandet e realizuara për këto tituj.

VI.1.b Mbi rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit të organizuara nga Banka e Shqipërisë.

Procesi i organizimit dhe zhvillimit të ankandëve të bonove të thesarit për vitin 2012, është bazuar në marrëveshjen midis Bankës së Shqipërisë dhe MF-ve lidhur më datë 05.09.2006 “Për emetimin nga ana e RSH, të bonove të thesarit në formë regjistrimi dhe mbajtjen e regjistrit në dy nivele”, ku përfshihen dhe tre ndryshimet e bëra më 04.04.2008, 14.12.2009 dhe 01.12.2010. Për vitin 2012, shuma fillestare e shpallur e bonove të thesarit nga MF-ve në total është 338,900,000,000 lekë në vlerë nominale dhe është realizuar në vlerën 331,975,515,000 lekë, pra në masën 98%. Struktura e bonove të thesarit të kërkuara ka qenë e ndryshme nga ajo e ofruar dhe e shpallur, kjo edhe si pasojë se, në bazë të nenit 15 të marrëveshjes të lidhur midis Bankës së Shqipërisë dhe MF-ve të sipërcituar, struktura e bonove të thesarit ka pësuar ndryshime gjatë vitit, duke kompensuar ankandet ku nuk ka pasur kërkesë nga tregu me ankandet ku kërkesa ka qenë e lartë. Në këtë kuadër, rezultoi se ka një ulje të shumave të shpallura për ankandet 3 dhe 6/mujore, duke i kompensuar ato me shumën në ankandet 12 mujore.

Gjatë vitit janë realizuar 12 ankande 3/mujore në vlerën totale të shpallur 39,400,000,000 lekë dhe janë pranuar 36,498,425,000 lekë. Yieldi maksimal i pranuar për këto ankande varion në kufijtë 5.35% deri 5.05%. Gjithashtu, janë realizuar 12 ankande 6/mujore me vlerë totale të shpallur 84,500,000,000 mijë lekë dhe vlerë të pranuar 83,365,030,000 lekë, me yield maksimal të pranuar në kufijtë 6.3% deri në 6.08%. Për sa i takon ankandëve me afat 1/vjeçar, janë realizuar 25 të tillë, me vlerë totale të shpallur 215,000,000,000 lekë dhe vlerë të pranuar 212,112,060,000 lekë, me yield maksimal të pranuar në kufijtë 7.3% deri në 5.5%.

Në vitin 2012 janë zhvilluar dhe tre ankande në euro, secili prej tyre me afat maturimi 12 mujor. Në këto ankande kanë marrë pjesë kryesisht bankat e nivelit të dytë dhe një numër i vogël individësh. Ankandi i parë në euro është zhvilluar në datën 24.07.2012 dhe shuma e shpallur ka qenë 15,000,000 euro, ndërsa shuma e pranuar 11,107,900 euro. Yield-i maksimal i pranuar ka qenë 6.38%. Ky ankand është realizuar pjesërisht, pasi shuma e kërkuar ka qenë më e ulët se shuma e shpallur. Ndërsa, dy ankandet e tjera në euro janë realizuar plotësisht, pasi kërkesa nga tregu ka qenë shumë e lartë, pra shuma e kërkuar ka qenë më e madhe se ajo e shpallur. Ankandi i dytë në euro është zhvilluar në datën 21.08.2012. Shuma e shpallur dhe e pranuar ka qenë 15,000,000 Euro. Yield-i maksimal i pranuar ka qenë 5.54%. Ankandi i tretë në euro është zhvilluar në datën 24.12.2012, me shumë të shpallur dhe të pranuar 20,000,000 euro. Yield-i maksimal i pranuar në këtë ankand ka qenë 5.3%. Ndryshe nga viti i mëparshëm, vihet re një kërkesë në rritje nga tregu për ankandet në euro të bonove të thesarit, për pasojë realizimi i dy ankandëve të fundit, ka qenë i plotë.

Gjatë vitit 2012, nuk janë zhvilluar ankande të jashtëzakonshëm, ndërkohë që realizimi i ankandëve të tjera në përgjithësi ka qenë i plotë. Ankandet 6/mujore dhe 12/mujore, janë realizuar plotësisht në pjesën më të madhe të tyre, ndërsa në ankandet 3/mujore ka pasur ankande që janë realizuar pjesërisht, si për shembull ankandi nr.1523 i realizuar në masën 79.6% apo ankandi nr.1563 i cili është realizuar në masën 68.47%. Realizimi i pjesshëm ka ardhur si pasojë e kërkesës së pakët nga tregu për këto ankande, pra shuma e kërkuar ka qenë më e ulët se shuma e shpallur.

Për sa i takon ecurisë së yield-it në tregun e bonove të thesarit, konstatohet se yield-i i tyre ka qenë më i lartë në 6/mujorin e parë të vitit 2012 dhe më pas ka ardhur duke u ulur deri në fund të tij. Vlerat më të larta të yield-it janë arritur gjatë muajve mars-qershor. Konkretisht, vlera maksimale e yield-it për bonot me afat 3/mujor ka qenë 5.35%, për ato me afat 6/mujor ka qenë

6.3%, ndërsa për bonot me afat 1/vjeçar ka qenë 7.45%. Nga krahasimi me dy vitet e mëparshme, rezulton se në tregun e bonove të thesarit ka një rënie të vlerës së yield-eve të pranuar nga viti në vit, si më poshtë:

Bonot e thesarit sipas afatit të maturimit	3/mujore	6/mujore	12/mujore
Yieldi maksimal i pranuar për vitin 2010	6.23%	7.42%	8.93%
Yieldi maksimal i pranuar për vitin 2011	5.75%	6.9%	7.74%
Yieldi maksimal i pranuar për vitin 2012	5.35%	6.3%	7.45%

Pjesëmarrja e Bankës së Shqipërisë në ankandet e zhvilluara gjatë vitit 2012, ka qenë në vlerën 96,844,000,000 lekë për investimin e fondeve të saj, duke pësuar ulje në krahasim me fondet e investuara në vitin 2011 ku shuma e investuar ka qenë 130,722,000,000 lekë. Gjithashtu gjatë vitit 2012 janë investuar edhe 14,670,000,000 lekë për fondin e pensionit të Bankës së Shqipërisë.

Nga auditimi i kryer mbi të drejtën për blerjen e bonove të thesarit me afat 1/vjeçar nga Banka e Shqipërisë, rezultoi se ajo ka marrë pjesë në tregun primar të bonove me afat maturimi 1/vjeçar, vetëm me fonde të cilat janë riinvestim, pra fonde të ardhura pas investimeve në tregun sekondar. Banka e Shqipërisë nuk ka marrë pjesë në ankandet e zhvilluara në euro.

Ankandet e zgjedhur për t'u audituar janë përzgjedhur kryesisht në bazë të vlerës më të lartë të shpallur dhe në periudhat me normë yield-i më të lartë. Nga 48 ankande të zhvilluara gjatë vitit 2012, u përzgjedhën 33 ankande me vlerë totale të shpallur prej 254,900,000,000 lekësh nga një total prej 338,900,000,000 lekësh.

Nga auditimi u konstatua se është respektuar neni 2 i marrëveshjes të përbashkët të sipërcituar, sipas së cilës MF-ve, jo më vonë se 15 ditë para fillimit të 3/mujorit përkatës, njofton me shkrim Bankën e Shqipërisë dhe nëpërmjet saj pjesëmarrësit në tregun primar, për programin kohor të emetimit të llojeve të ndryshme të bonove të thesarit nga qeveria shqiptare, ku jepen në mënyrë të detajuar shumat e emetimit sipas afateve të maturimit. Por, këto programe kanë pësuar shumë ndryshime gjatë 3/mujorit, në varësi të kërkesës për likuiditet dhe ndryshe nga viti 2011, në to janë përfshirë edhe ankandet në euro të zhvilluara gjatë vitit 2012.

Gjithashtu, nga auditimi i rregullshmërisë së ankandëve të përzgjedhura, u konstatua se zhvillimi i tyre ka qenë në përputhje me kriteret e marrëveshjes së përbashkët.

VI.1.c Mbi rregullshmërinë e zhvillimit të ankandëve të obligacioneve të organizuara nga Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2012 referuar ankandëve të shpallura nga MF-ve, në Bankën e Shqipërisë janë zhvilluar ankande të obligacioneve me afat maturimi 2/vjeçar, 3/vjeçar, 5/vjeçar dhe 7/vjeçar (ka pasur një ndërprerje prej disa vitesh). Organizimi i fundit i obligacioneve 7 vjeçare është bërë në vitin 2008.

Shuma e shpallur nga MF-ve referuar njoftimeve të saj për çdo rast zhvillimi ankandi obligacioni, ka qenë në vlerën totale 77,800,300 mijë lekë (me vlerë nominale dhe çmim blerje) për 30 ankande. Kjo shumë është e ndarë sipas llojit të obligacioneve si më poshtë:

- Shuma e shpallur prej 39,800,000 mijë lekë për 12 ankande obligacionesh me afat maturimi **2/vjeçar (me kupon fiks)**.
- Shuma e shpallur prej 8,500,000 mijë lekë për 4 ankande obligacionesh me afat maturimi **3/vjeçar (me kupon fiks)**.
- Shuma e shpallur prej 5,000,000 mijë lekë për 5 ankande obligacionesh me afat maturimi **5/vjeçar (me kupon fiks)**, ku një ankand është rihapur.
- Shuma e shpallur prej 19,000,000 mijë lekë për 5 ankande obligacionesh me afat maturimi **5/vjeçar (me kupon të ndryshueshëm)**, ku një ankand është rihapur.

- Shuma e shpallur prej 2,500,000 mijë lekë për 2 ankande obligacionesh me afat maturimi **7/vjeçar (me kupon fiks)**.
- Shuma e shpallur prej 3,000,000 mijë lekë për 2 ankande obligacionesh me afat maturimi **7/vjeçar (me kupon të ndryshueshëm)**.

Referuar informacionit të dhënë dhe njoftimit shkresor ose elektronik të MF-ve për secilin ankand obligacionesh, asnjë nga këto ankande nuk ka qenë ankand i jashtëzakonshëm. Shuma e shpallur e specifikuar si më sipër ka ndryshuar strukturë gjatë zhvillimit të ankandeve specifike (2, 3, 5, 7/vjeçare), sidomos për ato ankande që janë zhvilluar në një ditë dhe konkretisht:

a) Ka ndryshuar shuma e shpallur për ankandet e obligacioneve me afat maturimi 5 vjeçar me nr. 10 (me kupon fiks) dhe nr. 23 (me kupon të ndryshueshëm) të zhvilluar në një ditë, datë 4.05.2012. Kjo shumë mbas zhvillimit të ankandit ka shkuar për ankandin nr. 10 në vlerën *812,320 milionë lekë kundrejt 1,000,000 milionë lekëve* në fillim të ankandit dhe për ankandin nr. 23 në nivelin *4,520 milionë lekë kundrejt 4,500 milionë lekë të shpallur*. Tejkalimi në ankandin nr. 23 **me 20 milionë lekë, është në kundërshtim me nenin 14, pika 2 të Marrëveshjes bazë midis Bankës së Shqipërisë dhe MF-ve “Për Obligacionet”** e ndryshuar, në të cilën theksohet se: *“Ministria e Financave në marrjen e këtij vendimi mban parasysht shumën e shpallur për emetimin e obligacioneve. Në varësi të nevojave të huamarrjes dhe kostos së saj, Ministria mund të zvogëlojë ose të anulojë shumën e ofruar dhe të shpallur”*.

Referuar këtij citimi, marrëveshja nuk ofron mundësi për rritje të shumave të shpallura prej saj para zhvillimit të ankandit. Ky konstatim ka rezultuar nga grupi i auditimit dhe gjatë huamarrjes për vitin 2011 dhe referuar komenteve dhe argumenteve të bëra nga MF-ve është propozuar që në marrëveshjen bazë të parashikohet dhe një e drejtë e tillë (kompensimi i shumave të shpallura për ankandet e zhvilluara në një ditë për efekte të nevojave të huamarrjes, propozim i pranuar nga të dy palët në parim, por i pa reflektuar në marrëveshje).

b) Shuma e shpallur, ka ndryshuar mbas ankandit dhe për ankandet 5/vjeçare të rihapura me nr. 9/1 dhe 22/1 (kupon fiks dhe të ndryshueshëm) të zhvilluara në një ditë, më datë 1.03.2012 dhe konkretisht *300 milionë lekë kundrejt 500 milionë lekë* në fillim të ankandit për ankandin 9/1; kurse për ankandin 22/1 nga *1,000 milionë lekë kjo shumë ka shkuar në 1,168 milionë lekë*. Tejkalimi në ankandin nr.9/1 dhe 22/1 respektivisht **me 200 milionë lekë dhe me 168 milionë lekë, bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 14, pika 2 të Marrëveshjes bazë midis Bankës së Shqipërisë dhe MF-ve “Për Obligacionet” të ndryshuar**.

c) Referuar kalendarit të emetimit të letrave me vlerë të qeverisë, të dërguar në Bankën e Shqipërisë nga MF-ve, ka rezultuar që ky kalendar ka ndryshuar në vazhdimësi. Gjithashtu ka rezultuar që ndryshimi në kalendar për shifrën e shpallur për emetim në ankand, është bërë aktualisht në ditën e zhvillimit të ankandit, siç është rasti i ndryshimeve të kalendarit të paraqitur me shkresën nr. 4131 datë 20.03.2012 ndryshuar me shkresën nr. 4131/1 datë 02.04.2012, ku shuma për ankandin e obligacioneve 3/vjeçar me nr. 23 të datës 2.04.2012 nga 2,500 milionë lekë, me shkresën e ndryshimit është bërë 3,000 milionë lekë. *Ky ndryshim ka rezultuar brenda datës 2 prill 2012, në një ditë me njoftimin për zhvillimin e ankandit, në një kohë që tregu për shumatat e planifikuara të huamarrjes së qeverisë duhet të njoftohej më parë. Ky veprim bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 3, pika 1 të Marrëveshjes midis Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë me nr. prot. 7083 datë 28.09.2007.*

d) Po kështu, në ankandin 7/vjeçar me kupon fiks dhe të ndryshueshëm të zhvilluar me datën 14.06.2012 sipas njoftimit të MF-ve për zhvillim ankandi të bërë më datën 12.06.2012 shumatat e shpallura për emetim janë respektivisht 1,000 milionë lekë për ankandin nr. 2 (kupon fiks) dhe 1,500 milionë lekë për ankandin nr. 1 (kupon i ndryshueshëm), në një kohë që sipas njoftimit në kalendarin e programimit të huamarrjes këto shumatat janë respektivisht të planifikuara për secilin ankand 700 milionë lekë dhe 1,300 milionë lekë.

e) Nga auditimi rezultoi se ankandi 3/vjeçar me nr. 22 zhvilluar me datë 4.01.2012, njoftimi i MF-ve për rrjedhojë dhe njoftimi i Bankës së Shqipërisë për zhvillimin e ankandit është bërë me datën 3.01. 2012, *pra një ditë para zhvillimit të ankandit, veprim që bie në kundërshtim me kërkesat e nenit 3, pika 4 të marrëveshjes së mësipërme në të cilën theksohet se: “Njoftimi për datën e zhvillimit të ankandit në çdo rast duhet të vijë në Bankën e Shqipërisë, jo më pak se dy ditë pune përpara zhvillimit të tij .”*

f) Referuar kalendarit të planifikimit të ankandeve rezultoi se, për vitin 2012 për ankandet e obligacioneve 5/vjeçare me kupon fiks dhe të ndryshueshëm janë planifikuar nga 4 ankande për secilin (të zhvilluar në një ditë) dhe janë realizuar 5, ku një ankand është i rihapur. *Ankandi i rihapur nuk është parashikuar në kalendar. Ai ka qenë pjesë e njoftimit nga Ministria e Financave për zhvillim ankandi, por njoftimi nuk është kryer si një ankand i jashtëzakonshëm. Lidhur me rihapjen e ankandeve të obligacioneve, si instrument në huamarrjen e brendshme afatgjatë, në marrëveshjen e përbashkët nuk janë të parashikuara rastet kur Ministria e Financave i rihap ato, por vetëm e drejta e rihapjes së tyre.* Ky fakt është konstatuar dhe trajtuar nga KLSH edhe gjatë vitit 2011 dhe është lënë rekomandimi përkatës, *i cili në parim është pranuar nga Banka e Shqipërisë, e cila në procesin e zhvillimit të ankandeve është vetëm në rolin e agjentit të qeverisë në huamarrjen e brendshme dhe jo pjesë e vendimmarrjes së saj.* Kurse nga Ministria e Financave nuk ka ndryshime në marrëveshjen në fuqi për rastet kur ajo parashikon rihapjen e ankandeve të obligacioneve.

Theksojmë se ankandet e obligacioneve jo gjithnjë kanë qenë të plota, pra jo gjithnjë shuma e shpallur është plotësuar me kërkesat e pranuar. Nga krahasueshmëria e shumave të shpallura për emetim dhe shumave të pranuar, rezulton se në total janë shpallur për emetim 77,800,000 mijë lekë dhe kjo shumë e shpallur ka ndryshuar në shumën 77,600,300 mijë lekë dhe mbas përfundimit të ankandeve të obligacioneve janë pranuar për emetim 73,503,500 mijë lekë kundrejt 61,921,170 mijë lekë që ka qenë shuma e emetuar gjatë vitit 2011. Kjo ka ndodhur për efekte të kërkesës së tregut më të vogël se sa shuma e shpallur ose të s’kualifikimit të kërkesave me përqindje kuponi të lartë në krahasim me kuponin indikativ të shpallur nga MF-ve në 12 ankande obligacionesh nga 30 gjithsej, ku 5 raste janë në ankandet e obligacioneve 2/vjeçare, 3 raste në ankandin e obligacioneve 3/vjeçare, 3 raste në ankandin e obligacioneve 5/vjeçare me kupon fiks dhe 1 rast në ankandin e obligacioneve 7/vjeçar me kupon fiks.

Referuar pjesëmarrësve me kërkesa jo konkurruese (persona fizikë), rezultojnë se është shtuar numri i tyre referuar vitit 2011 dhe në vlerë, ato zënë vetëm 0,76 për individë jo konkurrues dhe 6.67 % për individë prestigjiozë të vlerës totale të pranuar (emetuar) të obligacioneve kundrejt 0.18% në vitin 2011. Pjesëmarrja me kërkesa konkurruese e personave fizik ka një ulje në krahasim me vitin 2011, ku përqindja ishte 0.1% dhe në vitin 2012 kjo përqindje ka qenë në nivelin 0,02%. Në rastet e mësipërme janë zbatuar kërkesat e nenit 15.2 të marrëveshjes (në fuqi), kur shuma e kërkesave jo konkurruese nuk plotëson masën 20%, diferenca e pa plotësuar ofrohet për kërkesat konkurruese.

Ndryshimi i kalendarit të ankandeve për tremujorin e parë, të dytë, të tretë dhe të katërt, referuar shkresave përkatëse respektivisht 4 herë, 7 herë, 3 herë dhe 2 herë, tregon për një ndryshim të vazhdueshëm të planifikimit të nevojave të huamarrjes dhe për rrjedhojë të një situate paqëndrueshmërie të likuiditeteve të depozitës së qeverisë.

VI.1.d Analizë mbi zhvillimin e tregut të bonove të thesarit dhe obligacioneve, efektet në nivelin e Yield-it, tendencat krahasuar me nivelin e repove dhe interesave të depozitave.

Për vitin 2012, nga MF-ve janë emetuar bono thesari me vlerë nominale në shumën **338,900 milionë lekë** (shuma e ofruar nga kjo ministri), kundrejt **344,400 milionë lekë** në vitin 2011. Nga zhvillimi i ankandeve në tregun primar, blerjet e bonove të thesarit rezultojnë në shumën **331,975.5 milionë lekë** (emetimi i realizuar), referuar **341,201.2 milionë lekë** në vitin 2011 dhe

ku shuma e kërkuar në tregun primar për bono thesari në vitin 2012 është **387,633.8 milionë lekë**. Shuma e pa realizuar e bonove të thesarit ka rezultuar si rezultat i kërkesave më të vogla se sa oferta në shumë ankande bono thesari.. Kjo gjë ka çuar në kompensimin e strukturës së shpallur për lloj ankandi (3/mujor, 6/mujor apo vjetor) kur këto ankande zhvillohen në një ditë. Kështu, kompensimi ka ndodhur në 8 ankande, ku në 4 ankande 3/mujore dhe 12/mujore të zhvilluar në një ditë dhe 4 ankande 6/mujore dhe 12/mujore të zhvilluar në të njëjtën ditë. Referuar kërkesave të ofruara nga tregu në këto ankande kërkesa e ofruar për marrje pjesë në ankandet 12/mujore ka qenë më e lartë. *Kompensimi i shumave në ankandet e bonove të thesarit është në përputhje me përcaktimet në marrëveshjen “Për bonot e thesarit”.*

Gjithashtu, gjatë zhvillimit të ankandëve ka rezultuar dhe refuzimi i kërkesës nga MF-ve për efekte të yield-it të lartë

Gjatë vitit 2012, bonot e thesarit të emetuara në fakt prej **331,975.5** milionë lekë, rezultojnë në një nivel më të ulët se emetimi i realizuar gjatë 5 viteve të fundit (2007, 2008, 2009, 2010, 2011). Për vitin 2012 janë kryer dhe 3 ankande bono thesari në euro me afat maturimi 12/mujor. Shuma e emetuar për këto ankande është *6,383 milionë lekë*.

Huazimi neto gjithsej (bono thesari+obligacione) për vitin 2012 me çmim blerje është 15,722.29 milionë lekë, kundrejt huazimit neto për vitin 2011 prej 28,105.5 milionë lekë.

Huazimi neto në vitin 2012 me çmim blerje për bono thesari në lekë është 4,025.59 milionë lekë kundrejt 12,095.9 milionë lekë në vitin 2011; ndërsa huazimi neto për obligacione është 11,696.7 milionë lekë kundrejt 18,154.2 milionë lekë në vitin 2011.

Pra, për vitin 2012 zgjedhja e instrumentit financiar me afat maturimi më të gjatë (bonot e thesarit 3/mujore janë më pak në numër dhe shumë emetimi kundrejt bonove 6/mujore dhe sidomos 12/mujore), ka bërë që huamarrja me instrumentin e bonove të thesarit të shërbejë jo vetëm për maturimin e bonove të thesarit gjatë vitit 2012, por dhe për financim deficiti, ashtu siç konfirmojmë dhe për huamarrjen e obligacioneve.

Portofoli i bonove të thesarit në vlerë nominale në fund të vitit 2012 është 259,521.1 milionë lekë, kundrejt 255,414.2 milionë lekë në vitin 2011. Kjo sasi është më e lartë nga portofoli i viteve 2010, 2009, 2008, 2007. Pra në vitin 2012 ka një tendencë rritjeje drejt huamarrjes me afate më të gjata brenda huamarrjes me bono thesari.

Struktura e bonove të thesarit, referuar totalit të bonove të thesarit të emetuara në lekë prej 331,975.5 milionë lekë me vlerë nominale dhe çmim blerje prej 315,025.7 milionë lekë, sipas afatit të maturimit të tyre paraqitet si më poshtë:

- *Me afat maturimi 3/mujor.* Për vitin 2012, janë zhvilluar 12 ankande me vlerë nominale **36,498.4 milionë** lekë ose 11 % ndaj totalit, ku për vitin 2011 ankandet 3/mujore paraqiten në një numër prej 12 ankande dhe me vlerë **48,068,8 milionë** lekë ose 11.7% ndaj totalit. Pra, për vitin 2012 bonot e thesarit me afat maturimi 3/mujor rezultojnë me një ulje prej 0.7% në krahasim me vitin 2011, dhe kjo ulje thellohet më shumë duke u krahasuar me vitet e mëparshme.

- *Me afat maturimi 6/mujor.* Për vitin 2012, janë zhvilluar 12 ankande me vlerë nominale 83,365 milionë lekë ose 25.1% ndaj totalit, ku për vitin 2011 ankandet 6/mujore kanë qenë në numër 14 ankande, me një vlerë prej 93,788.51 milionë lekë ose 27.49% ndaj totalit. Nga krahasueshmëria rezulton se ankandet 6/mujore paraqiten me ulje në vlerë dhe në përqindje ndaj totalit, krahasuar me një vit më parë. Kjo gjendje është paraqitur për këto ankande dhe për vitet e mëparshme.

- *Me afat maturimi 12/mujor.* Për vitin 2012, janë zhvilluar 25 ankande me vlerë nominale 212,112.1 milionë lekë ose 63.9% ndaj totalit, ku për vitin 2011 numri i ankandëve ka qenë 25 me një vlerë prej 202,797.8 milionë lekë ose 59.44% ndaj totalit. Pra, ankandet e bonove të thesarit 12/mujore për vitin 2012 paraqiten me rritje në përqindje dhe në vlerë absolute në krahasim me vitin 2011. Po kështu dhe në krahasim me vitin e mëparshme këto ankande kanë ardhur duke u rritur nga viti në vit.

- *Ankandet në Euro.* Për vitin 2012, janë zhvilluar 3 ankande bono thesari në euro me afat maturimi 12/mujor në vlerën 6,383 milionë lekë kundrejt shumës së emetimit të ankandeve në euro me vlerë nominale prej 3,690.7 milionë lekë në vitin 2011.

- *Tregu primar i obligacioneve.*

Gjatë vitit 2012, nga MF-ve në financimin e borxhit të brendshëm është përdorur dhe instrumenti i obligacioneve, i cili ka qenë instrument me afat maturimi 2, 3, 5 dhe 7/vjeçar. Shuma totale e obligacioneve të emetuara për këtë vit është 73,503.5 milionë lekë me vlerë nominale, kundrejt 61,921.2 milionë lekë emetim në vitin 2011. Emetimi i obligacioneve me afat maturimi 2/vjeçar ka qenë 37,001 milionë lekë për 12 ankande, kundrejt 39,740.8 milion lekë në vitin 2011. Blerja e obligacioneve 2/vjeçare ka qenë më pak se shuma e shpallur për emetim nga Ministria e Financave. Kjo ka ndodhur për faktin se kërkesa e tregut ka qenë më e vogël se shuma për emetim në ankandet 2/vjeçare të zhvilluara në janar, shkurt dhe tetor. Gjatë vitit 2012, janë maturuar obligacione 2/vjeçare në shumën 35,400 milionë lekë, pra shuma e maturimit është më e vogël se emetimi i tyre. Diferenca maturim emetim prej 1,601.45 milion lekë, është përdorur për financim deficitit.

- *Emetimi i obligacioneve 3 vjeçare,* në vitin 2012 paraqitet me rritje në krahasim me vitin 2011. Shuma e shpallur për emetim nga MF-ve është në vlerën 8,500 milionë lekë dhe shuma e emetuar është 7,787.85 milionë lekë, kundrejt shumës së emetuar gjatë vitit 2011 prej 5,623.6 milionë lekë. Edhe këto ankande nuk janë realizuar në masën 100% për efekt të kërkesës më të vogël të tregut në ankandin e zhvilluar në muajt janar, prill dhe korrik. Këto ankande janë realizuar vetëm 4 herë gjatë vitit 2012.

Gjatë vitit 2012, janë maturuar obligacione me afat maturimi 3/vjeçar në shumën 4,550 milionë lekë.

- *Për vitin 2012 janë emetuar 10 ankande obligacionesh me afat maturimi 5 vjeçar,* ku nga këto me interes të ndryshueshëm 5 ankande dhe 5 ankande me interes fiks, në shumën e emetuar prej 23,732.1 milionë lekë, kundrejt shumës së shpallur prej 24,000 milionë lekë. Shuma e shpallur nga MF-ve ka ndryshuar mbas ankandit për 4 ankande (2 ankande me kupon fiks dhe 2 ankande me kupon të ndryshueshëm) dhe në total kjo shumë e shpallur ka arritur në nivelin e vlerës 23,800.3 milionë lekë. Ankandet e obligacioneve 5/vjeçare janë emetuar më shumë se ankandet 5/vjeçare të organizuara në vitin 2011. Gjatë vitit 2012, është maturuar shuma 21,750 milionë lekë dhe diferenca emetim maturim prej 1,982 milionë lekë (për ankandet fiks dhe të ndryshueshëm) është financim i deficitit .

Gjithashtu, për vitin 2012 janë organizuar 4 ankande *obligacionesh 7/vjeçare* (2 fiks dhe 2 të ndryshueshëm) dhe shuma e emetimit të tyre 4,982.1 milionë lekë.

Në tregun e letrave me vlerë (në lekë dhe valutë) pjesëmarrësit kryesorë në ankandet e bonove të thesarit mbeten Banka e Shqipërisë, e cila ka investuar për këtë vit 34.9% kundrejt 37.9% në vitin 2011 të totalit të bonove të thesarit dhe në totalin e emetimit në tregun primar (bono dhe obligacione) kjo përqindje shkon tek 28.7%, pra pjesëmarrja e saj është më e vogël se një vit më parë. Megjithatë, përsëri Banka e Shqipërisë dominon tregun e letrave me vlerë të qeverisë në tregun primar. Me përqindje të lartë pas Bankës së Shqipërisë paraqitet BKT me 9.32%, Raiffeisen Bank 7.45%, Agjencia e Sigurimit të Depozitave 5.62%, Alfa Bank 3.79 %, Intesa San Paulo 3.55%, Tirana Bank 3.52% etj. Gjatë vitit 2012 është rritur përqindja e pjesëmarrësve me kërkesa jo konkurruese. Pjesëmarrja e tyre ka arritur 20.71% kundrejt 17.74% në vitin 2011, kurse individ me kërkesa konkurruese 0.52% kundrejt 0.30% në vitin 2011. Gjithashtu, gjatë vitit 2012 ka një pjesëmarrje dhe me individë prestigjiozë (sipas klasifikimit mbi bazën e shumave të pjesëmarrjes të cilët kanë zënë në vitin 2012 rreth 0.65%. Pjesëmarrja e individëve gjatë vitit 2012 paraqitet në nivele më të larta se një vit më parë.

Në tregun e obligacioneve pjesëmarrësit kryesorë janë: - Raiffeisen Bank e cila mbizotëron tregun e obligacioneve me 34.2% , Intesa San Paulo 23.78%, BKT me 19.57%, Union Bank

4.78%, Banka Societa Generale 5.43% etj. Gjatë vitit 2012, ka një rënie në përqindje të konsiderueshme pjesëmarrja e bankës Raiffeisen Bank në tregun e letrave me vlerë.

Për vitin 2012 karakteristikë ka qenë niveli i yield-it, i cili vazhdon të jetë më i lartë se niveli mesatar i depozitave bankare. Gjatë këtij viti, këto nivele janë paraqitur me ndryshueshmëri për të tre llojet e bonove të thesarit. Lulatjet nga ankandi në ankand kanë rezultuar referuar raportit kërkesë-ofertë dhe domosdoshmërisë së marrjes së huamarrjes së brendshme. Nga MF-ve në disa raste është refuzuar kërkesa e blerjes së bonove të thesarit dhe blerja e tyre është realizuar nën shumën e shpallur të saj për arsyen e nivelit të lartë të yield-it të paraqitur nga blerësit. Nivelet e yield-eve gjatë vitit 2012 kanë qenë më të ulët se sa në fillim viti për bonot e thesarit 3/mujore, 6/mujore dhe 12/mujore. Por, nëse ulja e nivelit të yield-it për bonot e thesarit 3/mujore ka shkuar për çdo ankand drejt uljes me një stabilitet të normës gjatë 6/mujorit të parë, për bonot e thesarit 6/mujore ka pasur një ulje ngritje në periudhën maj-qershor dhe më pas norma e yield-it ka ardhur në ulje të vazhdueshme deri në fund të vitit. Kurse për bonot e thesarit 12/mujore niveli i yield-it ka qenë i pa stabilizuar gjatë 6/mujorit të parë (pra kjo normë është ngritur dhe ulur disa herë me disa pikë përqindje nga ankandi në ankand) dhe pas periudhës së fundit të muajit qershor niveli i yield-it ka ardhur në mënyrë të vazhdueshme duke u ulur .

Përsa i përket nivelit të interesit të depozitave edhe ky ka ardhur duke u ulur, por në ndryshim me bonot e thesarit të cilat kanë ardhur duke u ulur në vazhdimësi pa lulatje, në 6/mujorin e dytë niveli i interesit të depozitave ka ardhur duke u ulur, por kjo ulje është paraqitur me lulatje ulje ngritje gjatë gjithë vitit. Megjithatë vazhdon të ekzistojë diferenca midis niveleve të interesave të ankandëve të bonove të thesarit dhe nivelit të depozitave, ku këto të fundit vazhdojnë të jenë më të ulta për të gjitha llojet. Niveli mesatar i interesave të depozitave bankare dhe niveli mesatar i yield-it për vitin 2012 (marrë këto të dhëna nga raportet statistikore të Bankës së Shqipërisë) i krahasuar me vitin 2011 paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Muaji	3-mujore				6-mujore				12-mujore			
	Niveli yield-it		Niveli interes. depoz. bankare		Niveli yield-it		Niveli interes. depoz. bankare		Niveli yield-it		Niveli interes. depoz. bankare	
	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011	2012	2011
Janar	-	-	4.16	4.21	6.23	6.32	4.76	5.10	7.07	6.83	5.80	5.98
Shkurt	5.08	5.21	3.98	4.25	6.10	6.38	4.61	4.86	7.11	6.95	5.62	5.89
Mars	5.29	5.35	3.84	4.14	6.20	6.72	4.59	4.82	7.33	7.27	5.68	5.80
Prill	-	-	3.90	4.21	6.20	6.84	4.54	4.83	7.35	7.41	5.57	5.90
Maj	5.30	5.47	3.85	4.13	6.20	6.82	4.63	4.94	7.36	7.36	5.70	5.87
Qershor	5.26	5.65	3.79	4.15	6.25	6.80	4.38	4.77	7.37	7.54	5.50	5.71
Korrik	-	-	3.82	4.39	6.24	6.82	4.34	4.85	7.34	7.69	5.33	6.82
Gusht	5.15	5.61	3.66	4.21	6.23	6.78	4.40	4.84	7.19	7.68	5.06	5.87
Shtator	5.08	5.62	3.79	4.41	6.17	6.77	4.40	4.87	6.93	7.68	5.19	5.92
Tetor	-	-	3.74	4.23	6.13	6.49	4.47	4.89	6.78	7.50	5.24	5.89
Nendor	5.03	5.49	3.54	4.14	6.06	6.44	4.39	4.84	6.46	7.40	5.25	5.85
Dhjetor	5.03	5.31	3.78	4.06	5.65	6.23	4.30	4.77	6.37	6.95	5.17	5.82

Nga tabela e mësipërme rezulton se gjatë vitit 2012 nivelet e yield-eve paraqiten me lulatjeje në ngritje dhe ulje të nivelit të tyre në 6 muajt e parë dhe pastaj tendencë ulje në 6/mujorin e dytë. Tek depozitat bankare karakteristike ka qenë lulatja me ngritje dhe ulje e nivelit të interesit gjatë vitit.

Për të dhënë një ide më të plotë, përqindjet e interesave për periudhën fillim viti dhe fund viti paraqiten si më poshtë vijon:

në përqindje

Emërtimi	Diferenca e interesave fillim-fund viti 2012					
	Bono thesari			Depozita bankare		
	Fillim 2012	Fund 2012	Diferenca + / -	Fillim 2012	Fund 2012	Diferenca + / -
3/mujore	5.31	5.03	-0.28	4.16	3.78	-0.38
6/mujore	6.23	5.65	-0.58	4.76	4.30	-0.46
12/mujore	7.07	6.37	-0.70	5.80	5.17	-0.63

Nga kjo tabelë konstatohet edhe njëherë fakti se interesat e bonove vazhdojnë të kenë përqindje më të lartë se depozitat, megjithëse ulja e përqindjes së interesit ka qenë më e madhe tek bonot e thesarit (6/mujore dhe 12/mujore) se sa tek depozitat.

Tendenca në vite e këtyre interesave pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Norma e interesit	Viti							
	2005	2006	2007	2008	2009	2010	2011	2012
Norma e depozit. 3/muj.	3.83	3.88	4.12	5.13	5.05	4.64	4.22	3.83
Norma bon. thes. 3/muj.	5.42	6.25	6.32	6.27	6.30	5.29	5.31	5.15
Norma e depozit. 6/muj.	4.60	4.53	4.83	5.72	5.74	5.38	4.87	4.50
Norma bon. thes. 6/muj.	6.91	7.18	7.41	7.45	7.52	6.41	6.23	6.14
Norma e depoz. 12/muj	5.08	5.23	5.67	6.93	6.78	6.40	5.87	5.38
Norma bon. thes.12/muj	6.91	7.88	8.26	8.56	9.14	7.09	6.95	7.05

Në të dhënat e mësipërme të siguruar në Bankën e Shqipërisë, normat e depozitave paraqesin norma mesatare të ponderuar vjetore të depozitave dhe normat e bonove paraqesin normat mesatare të ponderuara të interesit të ofertave të pranuar për periudhën e fundit të vitit. Banka e Shqipërisë (me vendime të Këshillit Mbikëqyrës) për zhvillimin e ankandëve të repove (ankande të shitjes dhe të blerjes të likuiditeteve të lira të sistemin bankar) ka marrë vendimet përkatëse për përcaktimin e normës së interesit të tyre. Kjo normë ka qenë në nivelet më të ulëta se gjatë vitit 2011 dhe sidomos në 6/mujorin e dytë, ku me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 46, datë 25.07.2012, kjo normë interesi u ul në nivelin e 4% që është përqindja e interesit të repove më e ultë në katër vitet e fundit.

Për të dhënë një imazh më të plotë për treguesit e sistemit bankar në drejtim të huamarrjes së brendshme, për vitin 2012, në tabelën e mëposhtme paraqitet se si kanë shkuar gjatë këtij viti treguesi i nivelit mesatar të yield-it të bonove të thesarit në krahasueshmëri me normat mujore të repove:

Muajt e vitit	Niveli mesatar i yield -it të bonove thesari në %			Normat mujore të repove në %		
	Viti 2012	Viti 2011	Viti 2010	Viti 2012	Viti 2011	Viti 2010
Janar	6.65	6.57	8.23	4.50	5	5.25
Shkurt	6.09	6.18	7.53	4.50	5	5.25
Mars	6.27	6.45	7.42	4.25	5.25	5.25
Prill	6.78	7.12	7.26	4.25	5.25	5.25
Maj	6.28	6.55	7.02	4.25	5.25	5.25
Qershor	6.29	6.66	6.96	4.25	5.25	5.25
Korrik	6.79	7.25	6.97	4.00	5.25	5.25
Gusht	6.19	6.69	6.87	4.00	5.25	5
Shtator	6.06	6.69	6.77	4.00	5.25	5
Tetor	6.46	6.99	7.25	4.00	5	5
Nëntor	5.85	6.44	6.58	4.00	5	5

Dhjetor	5.68	6.16	6.26	4.00	4.75	5
---------	-------------	------	------	-------------	------	---

Sa më sipër, megjithëse norma e interesit mesatare e bonove të thesarit është më e ulët krahasuar me vitin 2011, përsëri ajo paraqitet me diferencë të konsiderueshme me normat e interesit të repove për çdo muaj. Gjithashtu, referuar tabelës së mësipërme rezulton se normat e repove janë me ndryshime të konsiderueshme me një vit më parë. Ulja gjatë vitit 2012, ka bërë që niveli i normës së repove të jetë më i ulët në 4-5 vitet e fundit. Kjo ulje ka pasur ndikimin e vet dhe në uljen e interesit të bonove të thesarit 3, 6, 12/mujore të huazuara gjatë vitit 2012.

- Zbatimi i kritereve të përcaktuara në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” të ndryshuar, për akordimin prej saj të kredisë së drejtpërdrejtë për financimin e deficitit buxhetor.

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2012, MF-ve nuk ka kërkuar kredi të drejtpërdrejtë nga Banka e Shqipërisë. Nga verifikimi i kryer në lëvizjet e llogarisë nr.151100 “Kredi për Qeverinë” pranë Bankës së Shqipërisë, bazuar në nxjerrjen e kësaj llogarie për periudhën nga 03.01.2009 deri më 31.12.2012, rezulton se teprica e saj përfundimtare është zero dhe nuk është akorduar asnjë kredi direkt për Qeverinë në vitin 2012.

- Gjendja e stokut të bonove të thesarit të financuara në total nga Banka e Shqipërisë në tregun primar dhe sekondar, referuar portofolit të bonove në fund të vitit 2012, ka qenë në shumën 64,580,550,000 lekë, duke qëndruar pothuajse në nivel të njëjtë me një vit më parë.

Në nenin 32 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, përcaktohet se: “Blerja nga ana e Bankës së Shqipërisë për llogari të saj të letrave me vlerë të borxhit të emetuara nga qeveria e Republikës së Shqipërisë në treg të hapur ose në tregun sekondar, duhet të trajtohet si kredi ose hua e Bankës së Shqipërisë për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë dhe në këtë mënyrë do të jetë subjekt i kufijve të parashikuar në nenin 30 të këtij ligji...” dhe ku në nenin 30, pika 4, përcaktohet se: “Në asnjë rast shuma kryesore e kredisë ose huas së disbursuar dhe pjesa e padisbursuar e kredisë ose huas së Bankës së Shqipërisë dhënë Qeverisë së Republikës së Shqipërisë nuk duhet të kalojë vlerën 5% të mesatares vjetore të të ardhurave të buxhetit të Qeverisë së Shqipërisë për tre vitet e fundit financiare paraardhës...” ose 8%, që sipas pikës 5, neni 30, mund të përdoret vetëm nëse nuk bie ndesh me objektivin kryesor të politikës monetare për ruajtjen e stabilitetit të çmimeve.

Limiti 5% i kreditimit, sipas të dhënave të publikuara nga MF-ve, rezulton të jetë 17,178,400,000 lekë. Referuar rekomandimit të lënë nga KLSH në auditimet e viteve të mëparshme, konstatohet tendenca në rënie e stokut të letrave me vlerë, por sërish ky nivel tejkalon kufijtë e kreditimit të përcaktuara në ligjin nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”.

VI.1.e Mbi borxhin e garantuar dhe garancitë në tregun e brendshëm.

Bazuar në ligjin nr. 126/2012, datë 20.12.2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 6, datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012” është përcaktuar si më poshtë vijon:

- Rritja vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 13,700 milionë lekë. Shtesa e rritjes faktike për vitin 2012 krahasuar me kuotat e planifikuara rezultojnë në rreth 5,136 milionë lekë dhe kjo kryesisht për shkak të garancive në tregun e brendshëm. Përsa i përket stokut të borxhit të garantuar konstatohet një rritje prej rreth 7 miliardë lekë kjo për efekt kryesisht të garancive në tregun e brendshëm.

Tendenca e stokut të borxhit të garantuar të brendshëm dhe të jashtëm rezulton si më poshtë vijon:

EMERTIMI	2008	2009	2010	2011	2012
Borxhi i brendshëm i garantuar	4,952	5,527	5,551	8,657	15,663
Borxhi i jashtëm i garantuar	31,596	40,247	39,875	39,659	37,790
Produkti i Brendshëm Bruto	1,089,293	1,148,082	1,222,462	1,297,710	1,346,169
BB garantuar/PBB	0.45	0.48	0.45	0.66	1.16
BBjashtëm garantuar/PBB	2.9	3.50	3.26	3.056	2.8

Burimi: Ministria e Financave

Stoku i borxhit të brendshëm të garantuar për vitin 2012 rezulton në vlerën 15,663 milionë lekë dhe përfaqëson rreth 1.2% të PBB-së. Për vitin 2012, rezulton një rritje e stokut të garancive në rreth 0.55 të PBB-së. Në total garancitë e shtetit në dobi të palëve të treta përfituese rezultojnë në rreth 4% të PBB-së.

Për sa i përket Garancive të brendshme të lëshuara nga qeveria gjatë vitit 2012, rezultojnë të bazuar në kuadrin rregullator si më poshtë vijon:

1. Akti Normativ nr. 5, datë 26.09.2012 ”Per disa ndryshime në ligjin nr.10847, datë 05.12.2011 ”Per buxhetin e vitit 2012”.
2. VKM nr. 693, datë 10.10.2012 ”Per miratimin e Garancisë Qeveritare që lëshohet në favor të RBAL sh.a. Albania dhe Intesa Sanpaolo Bank sh.a. Albania, në kuadër të kontratave përkatëse ndërmjet këtyre bankave dhe KESH sh.a.”
3. VKM nr. 777, datë 16.11.2012 “Për disa ndryshime në Vendimin nr.693, datë 10.10.2012 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e Garancisë Qeveritare që lëshohet në favor të RBAL sh.a. Albania dhe Intesa Sanpaolo Bank sh.a. Albania, në kuadër të kontratave përkatëse ndërmjet këtyre bankave dhe KESH sh.a.”; I cili miraton garancinë qeveritare të lëshuar në favor të Raiffeisen Bank sha.Albania në shumën 50 milionë Euro.

-Mbi huamarrjen vendore.

Bazuar në ligjin “Per menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, borxhi vendor është pjesë përbërëse e Borxhit Publik. Borxhi i qeverisjes vendore, për vitin 2012 rezultoi në vlerën rreth 288 milionë lekë ose 0.021% e PBB-së nga 0.016% të PBB-së që rezultoi në vitin 2011.

Huamarrja Vendore për vitin 2012 ka pasur ecurinë si më poshtë:

- Për disbursimet është zbatuar urdheri i Ministrit të Financave nr. 86, datë 15.12.2011, për një disbursim vjetor jo më të lartë se 2.5% i shpenzimeve buxhetore të vitit 2009.

Për vitin 2012 huamarrja vjetore pagesat dhe stoku në fund të vitit 2012, paraqitet si më poshtë vijon:

Bashkia	Stoku me: 31.12.2011	Disbursime gjatë 2012	Principal i Paguar gjatë 2012	Stoku me: 31.12.2012
Korçë	63,983,191.00	23,800,000.00	5,361,522.00	82,421,669.00
Pogradec	33,716,721.00	-	2,567,364.69	31,149,356.31

në lekë

RAPORT PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2012

Vlorë	55,224,859.00	34,750,000.00	7,083,939.00	82,890,920.00
Petrelë	9,000,000.00	3,000,000.00	1,500,003.00	10,499,997.00
Elbasan	48,257,544.49	24,919,597.99	6,059,709.18	67,117,433.30
Lezhë	7,695,250.62	8,240,984.92	2,131,518.54	13,804,717.00
Totali:	217,877,566.11	94,710,582.91	24,704,056.41	287,884,092.61

Burimi: Ministria e Financave

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se, për 2012 janë disbursuar 94,710 mijë lekë dhe shërbimi rezulton në vlerën 24,704 mijë lekë. Gjatë viti 2010 u miratuan në total 6 marrëveshje në vlerën 1,568 milionë lekë dhe për vitet 2011 dhe 2012 nuk janë miratuar hua të reja për qeverisjen vendore. Këto marrëveshje huaje janë miratuar për t'u maturuar sipas periudhave respektive si më poshte dhe disbursimi i tyre në vite rezulton:

Bashkia/Komuna	Vlera e Huasë (në mijë)	Maturimi (vite)	Disbursuar 2010 (në mijë)	Disbursuar 2011 (në mijë)	Disbursime (31.12.2012) (në lekë)
Lezha	120,000.00	6	-	8,241.00	8,240,984.92
Petrela	15,000.00	6	6,000.00	3,000.00	3,000,000.00
Pogradeci	113,000.00	10	18,000.00	18,000.00	-
Korca	100,000.00	10	45,000.00	23,800.00	23,800,000.00
Vlora	420,000.00	10	59,702.00	0.00	34,750,000.00
Elbasani	800,000.00	10	19,203.00	32,033.00	24,919,597.99
Totali:	1,568,000.00		147,905.00	85,073.00	94,710,582.91

Burimi: Ministria e Financave

Sikurse konstatohet, vlera e huasë për të cilën Njesitë e Qeverisjes Vendore kanë lidhur marrëveshje huaje është 1,568 milionë lekë, ndërsa ritmi i dibursimeve të këtyre kredive është në nivele tepër të ulta. Deri në fund të vitit 2012 është disbursuar rreth 328 milionë lekë (148+85+95) ose rreth 20% e totalit të huave të nënshkuara.

Një mënyrë e tillë e disbursimit të fondeve sjell për pasojë që njësitë përfituese të kredive të mos realizojnë qëllimin për të cilin ata e kanë marrë që është përmbushja e nevojave për investime. Nga ana tjetër kjo shoqërohet edhe me zgjatje pa fund të investimeve dhe uljen e efektivitetit të tyre.

-Mbi shpenzimet për shërbimin e borxhit të brendshëm.

Per vitin 2012 shpenzimet për shërbimin e borxhit të brendshëm u planifikuan në shumën 38,700 milionë lekë. Shërbimi i borxhit të brendshëm për vitin 2012 rezulton në rreth 2.5 % të PBB-së. Shpenzimet e shërbimit të borxhit të brendshëm kundrejt kuotave të planifikuara rezultojnë:


në milionë/lekë

Nr	Emërtimi	Plani	Fakti	Diferenca	Realizimi %	Në % ndaj PBB-së
1.	Interesat e borxhit të brendshëm	34,200	34,005	195	99.4	2.5

Burimi: Ministria e Financave

Sikurse konstatohet shërbimi i borxhit të brendshëm është realizuar në nivelin e kuotave të planifikuara, duke rezultuar me një mos shpenzim prej 195 milionë lekë.

Më poshtë paraqisim tendencën e stokut të borxhit, si dhe shpenzimet e shërbimit të tij në vite:



o Në lidhje me saktësinë e regjistrimit dhe ligjshmërinë e veprimeve për kryerjen e pagesave për shërbimin ndaj borxhit të brendshëm, në mbështetje të nenit 46 të ligjit nr, 9665, datë 18.12.2006 "Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në RSH", nga MF-ve është mbajtur regjistri i borxhit të brendshëm dhe përditësimi i tij . Nga auditimi rezultoi se të dhënat e rregjistrimit përputhen me të dhënat e huamarrjes së brendshme dhe maturimit të saj për periudhat e mësipërme. Gjithashtu nga specialisti i Drejtorisë së Regjistrimit dhe Pagesave janë mbajtur aktrakordimet me Sektorin e Transaksioneve Qendrore për pagesat e borxhit të brendshëm për çdo muaj të vitit. Nga këto aktrakordime nuk pasqyrohen deviacione. Rakordim me të dhënat e borxhit është bërë dhe me Bankën e Shqipërisë, Drejtorinë e Operacioneve Monetare.

VI.2 BORXHI I JASHTËM SHTETËROR DHE SHËRBIMI I TIJ.

Bazuar në ligjin nr. 126/2012 , datë 20.12.2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 6, datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012” kufijtë e rritjes së borxhit shtetëror janë përcaktuar si më poshtë vijon:

- Kufiri për rritjen vjetore të totalit ekzistues të borxhit të shtetit dhe atij të garantuar të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, për vitin 2012, është **87 740** milionë lekë, i detajuar si më poshtë:

1. Për huamarrjen vjetore neto, deri në 26 290 milionë lekë.
2. Për huamarrjen neto për financimin e projekteve të huaja, deri në 46 000 milionë lekë.
3. Për rritjen vjetore të garancive të shtetit, në dobi të palëve të treta përfituese, është 13 700 milionë lekë.
4. Kufiri për rritjen vjetore të stokut të borxhit, si rezultat i riskedulimit të borxheve të vjetra të huaja të papaguara, është 1 750 milionë lekë.

Nga auditimi i rritjes së shtesave faktike të borxhit të jashtëjm të qeverisë kundrejt kuotave të planifikuara rezulton:

<i>në milionë/lekë</i>				
Nr.	PËRSHKRIMI	Plani	Fakti	Diferenca P-F
	TOTALI I BORXHIT TË JASHTËM	54,450	26,668	27,782
1.	Huamarrje financim projekte të huaja	46,000	27,418	18,582
2.	Garancitë e shtetit në dobi të paleve të treta përfituese	6,700	-1,870	8,570
3.	Borxh i riskedulluar	1,750	1,120	630

Burimi: *Ministria e Financave*

Nga analiza e kategorive të borxhit të jashtëm rezulton se shtesa e borxhit për efekt të financimit të projekteve rezulton 27,418 milionë lekë, duke reflektuar një mosrealizim të parashikimeve prej 18,582 milionë lekë. Konstatohet se ky mosrealizim vjen si rezultat i mosrealizimit të disbursimeve të kredive aktive, të cilat në fillim të vitit u parashikuan të disbursohen në rreth

34.5 miliardë lekë, në fakt janë realizuar rreth 7 miliardë lekë më pak pra 27.5 miliardë lekë. Parashikimet e kredive hipotetike u planifikuan në shumën rreth 11 miliardë lekë. Vlerësimet e krusit të këmbimit në këto parashikime kane rezultuar në rreth 2 miliardë lekë Ndërsa, në total parashikimi i kredive rezultoi në shumën 16.5 miliardë lekë më shumë.

Nga auditimi i saktësisë së raportit të paraqitur për Projekt-ligjin e Buxhetit faktik të vitit 2012 rezultojnë diferenca të stokut të borxhit të jashtëm midis tabelës nr. 2 i cili paraqet Stokun e Borxhit të jashtëm dhe që është llogaritur nga të dhënat e stokut të paraqitur në Euro me tabelën nr. 10 në të cilën jepet stoku i borxhit të jashtëm i shprehur në Lekë dhe i rezultuar nga kursi i këmbimit sipas monedhave të portofolit të borxhit të jashtëm, dhe konkretisht rezultojnë diferenca për stokun e BJ (kredite e drejtpërdrejta për vitin 2011 rezulton diferencë në vlerën **36 milionë lekë** dhe për vitin 2012 diferenca rezulton **323 milionë lekë**, ndërsa për borxhin e jashtëm të garantuar nuk rezultojnë diferenca.

Konkretisht situata paraqitet:

<i>EMERTIMI</i>	<i>Stoku sipas kursit të këmbimit të BJ të shprehur në Euro</i>	<i>Stoku sipas kursit të këmbimit monedhave të portofolit të BJ</i>	<i>Diferenca</i>	<i>Stoku sipas Kursit të këmbimit të BJ të shprehur në Euro</i>	<i>Stoku sipas kursit të këmbimit monedhave të portofolit të BJ</i>	<i>Diferenca</i>
	2011	2011		2012	2012	
1	2	3	4=3-2	5	6	7=6-5
Stoku i Borxhit të Jashtëm Shtetëror	294,284	294,319	+ 35	319,839	320,16	+ 323
Garancitë e Jashtme	39,659	39,659	0	37,790	37,790	0.0
STOKU TOTAL:	333,943	333,978	+ 35	357,629	357,952	+ 323

Burimi: Ministria e Financave

Ne sqarimin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit, diferencat e stokut të borxhit të jashtëm në fund të vitit 2011 ndërmjet tabelës 2 dhe tabelës 10 të **efektit të kursit të këmbimit**, janë gjeneruar si pasoje e metodologjise se perdorur gjate analizes, e cila merr si pike referimi stokun e dates 31.12.2011 te marre nga nga Back Office në **muajin janar 2012**.

Në disbursimet për financimin e projekteve vlerën më të mëdha e përfaqësojnë projektet në sektorin e transportit në vlerën 193 milionë Euro, në sektorin e energjisë rreth 18 milionë euro, sektorin e shëndetësisë rreth 11 milionë euro, të ujesjelles kanalizime rreth 25 milionë euro etj.

Persa i përket garancive gjate vitit 2012, borxhi neto rezulton në 270.7 milionë Euro nga 285.4 milionë Euro në vitin 2011, duke rezultuar me ulje në 14.8 milionë Euro.

Gjatë vitit 2012 rezulton të jenë tërëzuar rreth 10 milionë Euro, nga i cili rreth 9 milionë Euro nga EBRD, 1.2 milionë nga Italia (kreditor) etj. Për riskedulimet konstatohet ulje e borxhit neto nga 79.5 milionë Euro në 2011 në 73.26 milionë Euro në 2012.

Gjatë vitit 2012 u bënë efektive marrëveshjet me një sërë vendesh të cilët reflektojnë një rritje borxhi prej rreth 8 milione Euro konkretisht me Malin e zi, Kroacine, Maqedonine, Slovenine dhe Bosnje Hercegovinen.

Nga shqyrtimi i strukture së portofolit të borxhit të jashtëm sipas monedhave, ajo rezulton në pjesën më të madhe në EURO në 57.37%. Ndërsa, pjesa e përket kontraktimit në terma konkensionale për vitin 2012 rezulton se borxhi jo konkensional rezultoi në masën 51.69% të totalit ndaj atij jokonkensional me 48.31%, duke rezultuar me një trend rrites në favor të këtij të fundit krahasuar me një vit më parë. Borxhi i kontraktuar në terma jokonkensionale u rrit me 2.26 pike% kundrejt vitit 2011.

Nga pikpamja strukturore e borxhit të jashtëm sipas kreditorëve për vitin 2012, në masën rreth 55.4% janë borxh shumëpalësh, rreth 20-21% borxhe dypalëshe dhe me kreditorët private dhe pjesa tjetër prej 2.86% përfaqëson borxh të riskeduluar.

VI.2.a Mbi shpenzimet për shërbimin e borxhit të jashtëm.

Bazuar në ligjin nr. 10487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2012”, të ndryshuar, shërbimi i borxhit të jashtëm është planifikuar në total në vlerën 19,180 milionë lekë.

Të dhënat faktike të shpenzimeve të shërbimit të borxhit paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në milionë/lekë

Nr.	Emërtimi	Plani	Fakti	Diferenca	Realizimi %	% PBB
1.	Principal	11,180	10,669	511	95.4	0.79
2.	Interesa	8,000	7,492	508	93.7	0.56
Totali:		19,180	18,161	1,019	94.68	1.35


Burimi: Ministria e Financave

Nga këto të dhëna, konstatohet se shpenzimet për shërbimin e borxhit të jashtëm për vitin 2012 rezultojnë 18,161 miliona leke nga 14,481 milionë lekë që rezultuan në vitin 2011 dhe kundrejt 12,533 milionë lekë që rezultuan gjatë vitit 2010.

Kuotat e planifikuara të shpenzimeve për pagesat e principalit janë realizuar në rreth 95.4% dhe të interesave të jashtme në 93.7%, duke reflektuar mosshpenzim të fondeve të planifikuara përkatësisht në rreth 511 milionë lekë për shpenzimet e principalit dhe 508 milionë lekë për interesat.

Sikurse konstatohet shpenzimet për pagesat e shërbimit të borxhit të jashtëm zenë rreth 1.35% të PBB-së të vitit 2012. Nga një analizë në dinamike e këtij treguesi rezultojnë trende rritëse për të dy kategoritë e shërbimit të borxhit, si për interesat dhe për principal.

Me poshtë paraqesim tendencën e shërbimit të borxhit të jashtëm në vite:



VI.2.b Mbi rregullshmërinë e evidentimit të marrëveshjeve të nënshkrimit dhe subjekteve që kanë marrë garanci për vitin 2012 si dhe shlyerja e detyrimeve të tyre.

Nga auditimi rezultoi se, gjatë vitit 2012 janë lidhur 17 marrëveshje të reja nënshkrimit (6 marrëveshje kredie + 11 marrëveshje grand). Këto marrëveshje nënshkrimit rezultuan të lidhura midis Ministrisë së Financave dhe nënshkrimit, mbështetur në marrëveshjet bazë të lidhura

midis Qeverisë së Shqipërisë dhe kreditorit, kryesisht në Infrastrukturën e ujësjellës kanalizimeve në projekte si: “Infrastruktura Ujore Bashkiake II dhe I”, “Asistencë teknike për projektin e ujësjellësit Durrës”, financim për “Sektorin e rrugëve në Shqipëri (asistencë teknike), rifinancim në projektin e KESH sh.a. “Siguria e Digave”, Financim i IPA-s në sistemin e kanalizimeve dytësore në UK Korça IV.

Përfituesit dhe financimi i fondeve për marrëveshjet e nënshpues për vitin 2012, janë si më poshtë vijon:

Përfituesit e nënshpues	Fondi mbi bazën e të cilit është lidhur marrëveshja e nënshpues	
	Kredi	Grant
Ujësjetles Kanalizime Berat-Kuçove - Infrastruktura bashkiake II	4,700,000 Euro	4,606,000 Euro
Ujësjetles Kanalizime Sarande, - Infrastruktura bashkiake II	500,000 Euro	4,410,000 Euro
- Infrastruktura bashkiake I		245,000 Euro
Ujësjetles Kanalizime Lushnje , - Infrastruktura bashkiake II	1,800,000 Euro	2,156,000 Euro
Ujësjetles Kanalizime Fier, -Infrastruktura bashkiake II	500,000Euro	3,920,000 Euro
Ujësjetles Kanalizime Lezhe, -Infrastruktura bashkiake I		245,000 Euro 10,000,000 Euro
Bashkia Kamëz ”-Infrastruktura bashkiake II	6,500,000 Euro	5,390,000 Euro
Ujësjetles Kanalizime Korçe - “Ndërtimi i rjetit të kanalizimeve sekondare për qytetin e Korçës” Korça IV (financim i IPA-s)		4,018,000 Euro
Kesh – sha- “Siguria e digave ”	15.500,000 Euro	
Autiriteti Rrugor Shqiptar Sektorin e rrugëve në Shqipërisë		500,000 Euro
Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjetles Kanalizime (DPUK)		950,000 Euro
Shuma:	29,500,000 Euro	36,440,000 Euro
Totali i financimit:	Euro (kredi + grant)	65,940,000.00

Burimi: Ministria e Financave

Gjatë vitit 2012 vazhdon hedhja e të dhënave në programin DAMFAST, e marrëveshjeve të nënshpues që rrjedhin nga kredi të lidhura, para vitit 2010. Vitet 2011 dhe 2012 janë hedhur paralelisht me nënshkrimin e marrëveshjeve. Ky proces është në përfundim.

Nga hedhja e këtyre të dhënave njëkohësisht janë bërë rakordimet përkatëse për saktësinë e të dhënave, ku aktualisht kanë rezultuar pasaktësi kryesisht në hedhjen e kamat vonesave nga mospagesat për detyrimet e principalit dhe interesave sipas përcaktimit në marrëveshjet përkatëse, ku për çdo rast të identifikuar është njoftuar huamarrësi. Nga informacioni i vënë në dispozicion nga sektori i nënshpues gjatë vitit 2012 ka vetëm një rast identifikimi dhe njoftimi dhe gjatë 4/mujorit të parë të vitit 2013 ka 11 raste të tilla. Në shkresat e njoftimit MF-ve njëkohësisht i ka kërkuar huamarrësve bilancet kontabël të mbyllur për vitin 2012. Në rastin konkret të ujësjellësëve, pasi këto kanë pasur probleme në paraqitjen e saktë të detyrimeve në bilancet e tyre, për efekt të mungesës së dokumentacionit vënë në dispozicion nga Drejtoritë e Zbatimit të Projekteve.

Gjatë auditimit u audituan procedurat e evidentimit dhe regjistrimit të marrëveshjeve të reja të nënshpues të lidhura gjatë vitit 2012 nga ku rezultoi se: ato janë regjistruar në sistem të mbajtur me programin DAMFAS. Gjithashtu, marrëveshjet e nënshpues janë të regjistruara dhe në programin Exsel nga sektori i nënshpues, garancisë dhe huamarrjes lokale.

Nga auditimi për kryerjen e pagesave për principal dhe interesa të kryera, kjo e krahasuar dhe me njoftimet zyrtare të MF-ve për kryerje pagesash, rezultoi se për vitin 2012 janë kryer

arkëtimet për principal dhe interesa nga marrëveshjet e nënshpirt, në vlerën gjithsej 1,177,961.89 mijë lekë, kundrejt planit prej 2,741,351.62 mijë lekë (në këtë plan janë përfshirë dhe detyrimet për vitin 2012).

Arkëtimi i detyrimeve për vitin 2012 rezultoi në nivelin 42.97% kundrejt nivelit prej 70 % të arkëtimeve nga nënshpirta për vitin 2011; gjë që tregon se ka një përkeqësim të performancës dhe për rrjedhojë të gjendjes financiare të përfituesve të nënshpirt gjatë vitit 2012. Në shumën e arkëtimeve prej 1,177,961.89 mijë lekë, 255,084 mijë lekë janë arkëtime për detyrime të prapambetura deri në fund të vitit 2011 nga disa projekte të KESH sh.a. dhe nga Bashkia Tiranë për projektin “Rrugët Bashkiake”, kështu që, niveli i likuidimit të detyrimeve në nënshpirta për vitin 2012 ulet nga 42% në 33.7%.

Për vitin 2012 treguesit e planifikuar dhe të realizuar të të ardhurave nga nënshpirta paraqiten si më poshtë vijon:

në mijë/lekë

Emërtimi	Plani i detyrimeve për vitin 2012	Fakti i arkëtimeve të realizuara për detyrimet gjatë vitit 2012			Likuiduar detyrime të prapambetura gjatë vitit 2013
		Gjithsej	Arkët. në Dep.Qev gjatë v. 2012 v.2011		
			Për detyrime të vitit 2012	Për dety.prp. deri në vitin 2011	
Principal	2,117,662.13	887,809.64	678,771.20	209,038.44	15,066.00.00
Interesa	623,689.49	290,152.25	244,106.45	46,045.80	10,268.30
Garanci	-	535785.97	-	535,785.97	140,430.00
Gjithsej:	2,741,351.62	1,713,747.86	922,877.65	790,870.21	165,764.30

Burimi: Ministria e Financave

Referuar të dhënave të mësipërme, shuma prej 165,764.30 mijë lekë në kolonën “Likuiduar gjatë vitit 2013” përfaqëson arkëtimet në “Depozitën e qeverisë” për detyrimet nga marrëveshjet e nënshpirta dhe garancive për principal, interesa për projektet:

- a) Rrugët bashkiake BERZH të Bashkisë Tiranë pagesë interesi;
- b) Projekti UK Elbasan KFW pagesë interesi;
- c) Projekti UK Korçë KFW pagesë principal;
- d) UK Berat – Kuçovë KFW pagesë interesi;
- e) Pagesë principal garancie Kredia me BERZH nr.23830.

Nga auditimi rezultoi se këto pagesa janë kryer në janar, shkurt dhe prill të vitit 2013 dhe për këto arkëtime është kryer aktrakordimi me Sektorin e Transaksioneve Qendrore për muajt përkatës.

Për arkëtimet e bëra në “Depozitën e qeverisë” për vitin 2012 referuar detyrimeve të rrjedhura dhe të paguara për principal dhe interesa, është realizuar akt-rakordimi midis Sektorit të Menaxhimit të Llogarive Unike, Llogarive Speciale të Financimit të Huaj dhe Sektorit të Nënshpirt, Garancive dhe Huamarrjes Lokale, për çdo muaj të vitit 2012. Nga auditimi rezultoi se ky rakordim nuk paraqitet me deviacione me shifrat e paraqitura në pasqyrat e detyrimeve për principal dhe interes dhe totalit të arkëtimeve nga nënshpirta dhe garancitë të pasqyruara në llogarinë e arkëtimeve në depozitën e qeverisë.

Ndërsa, nga auditimi i pagesave për interesa dhe principale të marrëveshjeve të nënshpirta sipas afatit, si dhe shumës për t’u paguar rezultoi se:

- Nga MF-vee sipas procedurës së caktuar i bëhet njoftim në mënyrë shkresore subjektit huamarrës, duke përcaktuar dhe shumën për pagesë. Nga ana e një pjese të huamarrësve janë kryer pagesat sipas afateve dhe shumave për principale dhe interesa. Në fund të vitit 2012 kanë mbetur pa u paguar detyrimet për projektet, **në shumën prej 5,600,003 mijë lekë, bashkëlidhur**

këtij raporti, ku jepen të detajuara detyrimet për çdo operator huamarres dhe ata të garantuar.

Cilësojmë se, nga detyrimet e papaguara deri në fund të vitit 2012 prej 5,600,003 mijë lekë, janë likuiduar në 6/mujorin e parë të vitit 2013 shuma 165,764.30 mijë lekë. Pra, detyrimi i mbetur nga detyrimet deri në fund të vitit 2012, më 30 Qershor 2013 është në vlerën 5,434,239.46 mijë lekë. Kursi i këmbimit të përdorur për efekt llogaritjesh dhe kthimit të shumave në lekë është ai i fund vitit, ku Euro është llogaritur me 139.59 lekë dhe USD me 105.85 lekë.

Mbështetur në nenin nr. 43, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 “Për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në RSH”, në të cilën theksohet se: “Ministri i Financave duhet të ndërmarrë të gjitha masat e përcaktuara në këtë ligj, në ligjet e tjera në fuqi dhe në marrëveshjen e mirëkuptimit, për të përfituar nga huamarrësi çdo pagesë të bërë sipas garancisë, duke përfshirë dhe kostot që lidhen me të”. Aktualisht për marrëveshjet e garancive që janë aktive, *nuk ka marrëveshje mirëkuptimi*, pasi ato janë të lidhura para daljes së ligjit të mësipërm. Kështu që marrëdhëniet dhe dokumentacioni që kërkohet në mënyrë të herë pas herë nga MF-ve për efekte të kryerjes së pagesave dhe likuidimit të tyre në mënyrë të detajuar nuk është i sanksionuar në akt-nënligjor. Marrëveshjet e mirëkuptimit nuk janë lidhur dhe për marrëveshjet e reja të garancive, që rezultojnë mbas daljes së ligjit. Madje, për vitin 2012 nuk ka pasur marrëveshje garancie të lidhur për borxhin e jashtëm. Kështu për marrëveshjet aktuale të garancisë vazhdon e njëjta situatë.

Për KESH sh.a., referuar informacionit të dhënë nga Sektori i Nënhuave dhe Garancive dhe bazuar në bilancet e paraqitura nga KESH, si dhe analizës së tyre, rezulton se kjo kompani është në kushtet e një situate kritike financiare, pasi:

1. Ka mungese të theksuar likuiditeti;
2. CEZ Shpërndarje nuk paguan detyrimet e veta kundrejt KESH sh.a.;
3. Bankat e nivelit të dytë nuk ofrojnë me asnjë mundësi financimi pa Letër Garanci nga Qeveria.

Detyrimet që rrjedhin vetëm nga marrëveshjet e nenhuave bashke me kamat-vonesat deri me 30.12.2012 të KESH sh.a llogariten në shumën **1,362,299.77** mijë lekë dhe për këto detyrime janë bërë dhe njoftimet përkatëse. Gjithashtu, referuar letërkëmbimeve midis KESH sh.a. dhe MF-ve ka rezultuar se KESH ka kërkuar në mënyrë të vazhdueshme ndihmën dhe mbështetjen financiare të Ministrisë së Financave. Mos likuidimi i vazhdueshëm i CEZ Shpërndarje e ka çuar situatën e KESH në një gjendje kolapsi financiar, ku borxhi në fund të vitit 2012 sipas shkresës nr. 5747, datë 27.12.2012 të vetë KESH është në shifrat e 31.8 miliardë lekë. Shtojmë se KESH sh.a. i ka vënë MF-ve në dispozicion në mënyrë të vazhdueshme gjendjen e detyrimeve nga nënhatë dhe garancitë, gjendjen përkatëse të tij të llogarive bankare, si dhe urdhrat e bllokimit të llogarive të tij nga përmbarimi, pikërisht nga niveli i lartë i mospagesave të detyrimeve kontraktore dhe gjyqësore

○ *Për detyrimet e ujësjellësve dhe gjendjen e tyre.*

Për sa i përket Ndërmarrjeve të Ujësjellësve vazhdon të jetë e njëjta situatë si në vitin 2011. Për vitin 2012, si rrjedhojë e mosndryshimit të gjendjes financiare të tyre, është rritur niveli i detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuave.

Për këtë arsye, referuar korrespondencës shkresore, nga MF-ve, i është kërkuar në mënyrë zyrtare të gjithë Ujësjellësve për të dërguar informacionin financiar (bilancin dhe pasqyrat financiare të auditura) për vitin 2012, madje janë bërë dhe takime me qellim saktësimin e të dhënave për tepicën e huave dhe për shumën e detyrimeve të papaguara nga ndërmarrjet dhe të paraqitur në bilancet e tyre kontabël.

Referuar informacionit të audituar rezultoi se ujësjellësit të cilët paraqesin problematikë me dokumentacionin e praqitur nga PIU i projektit dhe për rrjedhojë nuk njohin detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuave me Ministrinë e Financave, janë si më poshtë:

1. Ujësjellës Kanalizime Sarandë (financim i BEI)
2. Ujësjellës Kanalizime Lezhë (financim i BEI)
3. Ujësjellës Kanalizime Durrës (financim i BEI)

Kurse, Ujësjellës Kanalizime Korçë (BEI), që është vetë PIU, i njeh detyrimet por nuk i ka paguar për vetë faktin e pretendimit se MPPT në kuadër të marrëveshjes bazë duhet t'i jepte kontribut UK Korçë prej 300 mijë Euro në vit që nga viti 2009 – 2015.

Ndërkohë që Ujësjellës Kanalizime Sarandë, Ujësjellës Kanalizime Lezhë dhe Ujësjellës Kanalizime Durrës, janë me financim dhe nga IDA, si dhe paraqesin të njëjtin problem, dokumentacionin e praqitur nga PIU dhe për rrjedhojë mos njohje të detyrimeve. Madje, këta tre ujësjellës nuk i rakordojnë llogaritë e detyrimeve në bilanc me ato që rezultojnë në borxhin e MF-ve, problem ky i identifikuar nga vitet e kaluara dhe që vazhdon ende të jetë i pazgjidhur.

Edhe Ujësjellës Kanalizime Vlorë pretendon për mungesën e dokumentacionit nga PIU dhe për rrjedhojë mosnjohje të detyrimeve për marrëveshjen e nënhuasë me MF-ve datë 28.12.2007. Ky ujësjellës nuk ka praqitur të dhëna financiare megjithë kërkesën e Ministrisë së Financave.

Nisur nga pretendimet e këtyre ndërmarrjeve, referuar Marrëveshjeve të nënhuasë, nga MF-ve i është kërkuar Njësisë së Zbatimit të këtyre Projekteve, që të venë në dispozicion dokumentet e kërkuara nga Ujësjellësit. Ndërkohë, që MF-ve në mënyrë shkresore e të vazhdueshme ka kontaktuar me PIU-n për problematikat e ngritura nga këto ujësjellës në lidhje me mungesën e dokumentacioneve që vërtetojnë punimet, dokumente të nevojshëm për kontabilizim e aseteve dhe për rrjedhojë njohjen e detyrimeve që rrjedhin.

Nga analiza financiare që ka bërë MF-ve për secilin ujësjellës për të parë aftësitë e tyre likuiduese, është konkluduar se gjendjet e tyre financiare nuk krijojnë mundësi pagese.

Në lidhje me problemet e ngritura nga ndërmarrjet e UK Kavajë, Lushnjë, Berat, Kuçovë, Pogradec dhe Elbasan, të cilat janë me financim nga KFW, rezulton se:

1. Gjendja e tyre financiare është e rëndë, për shkak të mosarkëtimit të faturave të ujit.
2. Çmimi i shitjes së ujit është i ulët dhe ky çmim vendoset nga Enti Rregullator i Ujit.
3. Detyrimet që këto ndërmarrje kanë ndaj KESH sh.a. janë të mëdha.

Me përjashtim të UK Fier dhe UK Korçë, të gjithë Ujësjellësit e tjerë paraqiten problematik në shlyerjen e detyrimeve. Ndërsa, UK Lezhë ka bërë shlyerje të pjesshme të detyrimeve për vitin 2012, për Marrëveshjen e Nënhuasë me IDA.

Për sa më sipër dhe në zbatim të ligjit për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huas në RSH, nga MF-ve nuk ka një përcaktim të veprimeve konkrete që duhet të merret në të ardhmen për çdo subjekt të përfitimit të nënhuasë me detyrime të pa paguara. Theksojmë se për vitin 2012 janë lidhur marrëveshje të reja nënhuaje me disa nga ujësjellësit që në këtë periudhë kanë vazhduar të jenë debitorë për detyrimet që rrjedhin nga marrëveshjet ekzistuese të nënhuasë, si UK-të Sarandë, Lushnjë, Berat, Kuçovë dhe Fier. Për këto marrëveshje janë bërë analiza të riskut në të cilat janë përcaktuar risku i mospagesave në vazhdim prej këtyre ndërmarrjeve, referuar detyrimeve që rrjedhin nga marrëveshjet e nënhuave, *megjithatë marrëveshjet janë lidhur.*

Problemt e mësipërme janë konstatuar dhe janë trajtuar nga KLSH edhe gjatë auditimit të buxhetit faktik të vitit 2011, madje janë lënë rekomandimet përkatëse për ujësjellësit me probleme, si për detyrimet e shumta të pa likuiduara, për problematikat që ato paraqesin në drejtim të menaxhimit si subjekte me humbje të vazhdueshme, mungesës së vazhdueshme të mosrealizimit të arkëtimit, si dhe dokumentimit dhe inventarizimit të aktiveve të përfituara nga projektet e financuara me kredi apo grant gjatë gjithë këtyre viteve.

Bazuar dhe në faktin se mungon baza ligjore për ndërhyrje në llogaritë bankare të ujësjellësve dhe në kushtet që duhet të shikohet mundësia e riskedulimit të kredive në mënyrë që të lehtësohen në pagesa këto subjekte, KLSH i ka kërkuar MF-ve të iniciohen inspektime financiare, por ky rekomandim që nuk ka gjetur zbatim deri më sot, megjithëse ka qenë rekomandim i pranuar për t'u zbatuar nga strukturat drejtuese të Ministrisë së Financave.

Jemi të bindur se konkluzionet e nxjerra nga inspektimi përveç zbulimit dhe evidentimit të mangësive dhe dobësive në punë të drejtuesve të ujësjellësve, do të saktësonin dhe veprimet konkrete në drejtim të mirëmenaxhimit të fondeve publike që zotërojnë këto ndërmarrje.

o ***Ecuria e disbursimeve për projektet që funksionojnë me marrëveshje nënhuaje dhe garanci.***

Mbështetur në informacionit e dhënë nga Drejtoria e Regjistrimit dhe Shërbimit të Borxhit në drejtim të monitorimit të projekteve të cilat janë të lidhura me marrëveshje nënhuaje dhe garancie, në vijim pasqyrojmë marrëveshjet me problematika në drejtim të ecurisë së tyre si më poshtë vijon :

- Të gjitha kreditë e garantuara te cilat janë ne proces disbursimi kane pasur disbursime gjate vitit 2012.

- Dy kreditë e KFW-se të akorduara për projektin “Furnizimi me energji i Shqipërisë se Jugut”, nuk kane pasur disbursim gjate vitit 2012, pasi referuar informacionit, pritet certifikimi i komponentit "Rehabilitimi i HEC-it Bistrica II", certifikim që do te bëhet pas periudhës se garancisë se defekteve (gusht 2014). Këto dy kredi nuk kanë pasur disbursim edhe gjatë vitit 2011.

- Kredia me KFW-në për projektin “Linja 400 kë Shqipëri-Kosovë”, nuk ka pasur disbursime gjate vitit 2012, pasi nuk ka filluar procesi i ri tenderimit. Problem ky i identifikuar edhe gjatë vitit 2011.

- Kredia me KFW-në për projektin “Linja Unazore 110-kV e Shqipërisë se Jugut”, nuk ka pasur disbursime, si rrjedhojë e vonesave te krijuara nga problemet ne tenderim, te cilat tashme janë zgjidhur dhe pritet te nënshkruhet kontrata për linjën 110 kV Babicë –Sarandë dhe linjën 110 kV Memaliaj-Ersekë-Korçë.

Sqarojmë se, kreditë e lidhura me KFW janë kredi për të cilat paguhen komisione angazhimi mbas bërjes efektive të kredisë dhe pavarësisht se këto detyrime janë paguar korrektësisht nga huamarrësi (aktualisht OST) janë përsëri fonde të paguara si pasojë e mosmenaxhimit të fondeve të vëna në dispozicion mbas nënshkrimit të marrëveshjes dhe rënies dakord për plotësimin e kushteve të saja. Për katër marrëveshjet e mësipërme pagesat për komisionet e angazhimit për secilën prej tyre dhe për çdo vit nga data e bërjes efektive paraqiten në tabelën mëposhtme:

Emërimi i projektit	Njësia	Pagesa viti 2010	Pagesa viti 2011	Pagesa viti 2012
Projekti “Linja 400 kV Tirane-Prishtine”	Euro	77,583.33	105,000	105,000
Projekti “Linja Unazore 110-kV e Shqiperise se Jugut	Euro	69,732.64	94,375	94,375
Projekti linja 110kV “Furnizimi me energji i Shqiperise se Jugut”/10750	Euro	13,437.50	26,875	26,875
Projekti linja 110kV “Furnizimi me energji i Shqiperise se Jugut”/500 mije	Euro	625.00	1,250	1,250
Shuma e pagesave për komisione angazhimi	Euro	161,378	227,500	227,500

(Të dhënat marrë nga sistemi evidencë MF)

- Për kreditë me KFW-në për projektin “Infrastruktura ujore Bashkiake II Berat, Fier, Kamza, Kucova, Lushnja dhe Saranda” dhe “Infrastruktura Ujore Bashkiake”, kreditë 12/04/KFW vlera 12 milionë Euro dhe 12/05/KFW vlera 2 milionë Euro, të cilat janë bërë efektive me 15 prill

2012, nuk ka pasur disbursime, pasi pritet që Bashkitë pjesëmarrëse në projekt të plotësojnë kushtet e vendosura në Marrëveshjen e Veçante. Këto projekte janë bërë efektive në vitin 2012.

Janë paguar komisione vetëm për kreditinë 12/04/KFW si me poshte:

- Për vitin 2012 në vlerën 135,833.33 Euro, kurse për vitin 2013 (6/mujori i parë) në vlerën 15,000.00 Euro. Pra ecuria e disbursimeve ndikon direkt në komisionet e angazhimit, kështu që mos ecuria e projekteve shton koston e projekteve, duke rritur kështu pagesat për komisionet e angazhimit.

Nga MF-ve, në marrëveshjet e nënshkruara, nuk ka të parashikuar klauzola për përfituesit, për rastet e zgjatjes pa argument të disbursimeve për kreditë e KFW-së, si rezultat i vonësive të zbatimit të kushteve për implementim të saj dhe që shkaktojnë për rrjedhojë rritjen e kostos së projektit, pavarësisht se në një periudhë të dytë (pas 10 vjetësh) këto detyrime paguhen nga vetë huamarrësit.

Mbi zbatimin e detyrimit ligjor për hartimin dhe miratimin e strategjise së borxhit publik.

Në nenin 6, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 për huamarrjen shtetërore, borxhin shtetëror dhe garancitë shtetërore të huasë në RSH, theksohet se:

- “Ministri i Financave përgatit strategjinë afatmesme për vlerësimin e portofolit të borxhit dhe të ecurisë së tij. Kjo strategji rishikohet dhe paraqitet për miratim në Këshillin e Ministrave së bashku me parashikimet e buxhetit afatmesëm”.

Nga auditimi rezultoi se është përgatitur strategjia e borxhit publik për vitin 2012-2014. Përsa i përket objektivave të strategjise së borxhit publik në lidhje me objektivin e strategjise së raportit të borxhit në lekë dhe atë në monedhë të huaj ku targeti ishte vendosur në raportin 53% me 47%, në fakt ky tregues rezultoi në raportin 57% borxh në monedhë vendase dhe 43% borxh i huaj. Në këtë raport ka ndikuar mosberja efektive e garancise pjesore të riskut me kompaninë CEZ Shperndarje në shumën 60 miliona Euro ose 8.4 miliardë leke.

Shtesa e huamarrjes, përveç financimit të projekteve do të realizohet në tregun e brendshëm dhe nga tregu i huaj i politikave të zhvillimit me Bankën Botërore.

Në lidhje me këto objektiv rezultoi se, shtesa e huamarrjes ka rezultuar në rreth 64% me obligacione dhe 36% me bonothesari.

Nga shqyrtimi i strategjise rezultoi se, është parashikuar levrimi i kredive të Bankës Botërore për politikën e zhvillimit, të cilat nuk u realizuan.

Përsa i përket objektivave të vendosura për treguesit e riskut ato janë vendosur si vijon:

- Treguesi Duration i portofolit të borxhit të brendshëm do të luhatet 0,57 – 0,59 (në vite) dhe ditët mesatare në maturim rreth 346 ditë për instrumentat në tregun e brendshëm dhe 470 - 480 ditë me përfshirjen e financimit të huaj nga Banka Botërore.

Në fakt ka rezultuar në 0.67 vjet në fund të dhjetorit të vitit 2012, duke shënuar vlerat më të larta në periudhën maj-shtator në 0.70-0.71, pasi në këtë periudhë u shtuan instrumentet afatshkurtër në portofolin e borxhit.

- Përsa i përket treguesit të ditëve mesatare në maturim, gjatë vitit 2012 ky tregues ka qenë në nivelet (350-398) dhe tendenca në rritje e këtij treguesi në 6/mujorin e dytë gjatë të cilit ka njohur dhe vlera më të madha është për efekt të emetimit të instrumenteve afatgjate. Ky tregues për 2012 është mesatarisht 386 ditë.

Pasqyrojmë se përpunimi i të dhënave të borxhit të brendshëm kryhet manualisht, ndërsa ai i borxhit të jashtëm kryhet me programin “DAMFAS”.

Për këtë Drejtoria e Përgjithshme e Borxhit ka kërkuar kryerjen e investimit, blerjen e programit DAMFAS 6 dhe për vitin 2013 u akordua ky fond, por me pas ky fond është shkurtuar dhe i është transferuar një objekti tjetër investimi “Rikonstruksioni i Ministrisë së Financave”, çka

tregon që nga ana e kësaj ministrie nuk konsiderohet prioritet financimi për krijimin e një sistemi të integruar të regjistrimit dhe menaxhimit të borxhit.

Për këtë, ***KLSH i ka rekomanduar MF-ve:***

-Financimin me prioritet të investimit të këtij programi, me synim krijimin e sitemit të integruar të regjistrimit, si të borxhit të brenshëm dhe të jashtëm.

VI.2.c. Mbi zbatimin e planit të buxhetit të shtetit, bazuar në ligjin “për buxhetin e shtetit të vitit 2012 dhe ndryshimet gjatë vitit.

Për vitin 2012, buxheti i shtetit është miratuar me ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, ndryshuar me Aktin Normativ nr. 5, datë 26.09.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” dhe me Aktin Normativ nr. 6, datë 12.12.2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. nr.10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”.

Në mbështetje të nenit 24 dhe 27 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondeve speciale, referuar programit buxhetor afatmesëm 2012-2014, MF-ve ka nxjerrë udhëzime ku përcakton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të PBA 2012- 2014, përgatitur në bazë të vlerësimit të kuadrit makroekonomik dhe fiskal dhe të miratuar me vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave.

Drejtoria e Analizave, Politikave dhe Programimit Buxhetor ka ndjekur hap pas hapi problematikën e konstatuar në draft dokumentin e PBA-ve dhe draft dokumentin e Buxhetit Vjetor të ministrive të linjës, duke kërkuar korrigjimin dhe plotësimin e tyre sipas përcaktimeve dhe formularëve tip të miratuar në udhëzimet e miratuar, duke tërhequr vëmendjen për mostejkalimin e afateve.

Në përfundim të këtij procesi me shkresën nr. 20213, datë 25.10.2011 MF-ve i ka dërguar Këshillit të Ministrave projektligjin për buxhetin të shtetit të vitit 2012. Ky draft në bazë të dokumentacionit të audituar nuk rezulton të jetë dërguar për mendim dhe sugjerim Ministrisë së Drejtësisë, në kundërshtim me procedurat e përcaktuara në lidhje me miratimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga Këshilli i Ministrave. Konstatojmë se ky draft nuk i është dërguar me shkresë përcjellëse Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, në një kohë ku në nenin 25, të ligjit nr. 9665, datë 18.12.2006 përcaktohet detyrimi i marrjes paraprakisht të opinionit të Bankës së Shqipërisë “këshillime për borxhin” kusht ky shumë i rëndësishëm, në kushtet kur borxhi publik konsiderohet prioritet, referuar dhe situatës së krizës ekonomike në eurozonë.

Referuar nenit 29, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, projektbuxheti duhej të miratohej nga Këshilli i Ministrave brenda datës 25 Tetor 2011, ndërkohë që ky projektligj i është dërguar Këshillit të Ministrave në ditën kur ky i fundit kishte afatin maksimal të miratimit të këtij ligji. Në realitet miratimi i këtij projekti nga Këshilli i Ministrave është bërë me vendimin e tij nr. 747, datë 04.11.2011, për rrjedhojë është tejkualuar afati ligjor data 1 nëntor, brenda të cilit Kryeministri në emër të Këshillit të Ministrave i paraqet Kuvendit, buxhetin vjetor.

Drafti i mësipërm është miratuar me ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” **dhe dekretuar me Dekretin e Presidentit nr. 7185, datë 14.12.2011.**

Në bazë të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, treguesit e buxhetit vjetor të shtetit, referuar nenit 46 të tij, ndryshohen sipas propozimit të paraqitur nga Këshilli i Ministrave në Kuvend, mbas një analize të realizimit të buxhetit faktik dhe domosdoshmërinë e ndryshimit të tij, të paraqitur nga Ministri i Financave, procedura këto që duhet të përfundojnë brenda muajit korrik. Për vitin 2012, drafti i projektligjit për buxhetin e rishikuar është dërguar nga Ministria e Financave në Këshillin e Ministrave me shkresën nr.14405/1, datë 19.09.2012 dhe ky draft është ndryshuar në Këshill të Ministrave. Për këtë, Ministria e Financave me shkresën nr. 14.405/3 datë 28.09.2012 ka dërguar zbardhjen e Aktit Normativ i cili ka reflektuar ndryshimet e propozuara në Këshillin e

Ministrave. Akti Normativ është miratuar me ligjin nr. 99/2012 “Për miratimin e Aktit Normativ, me fuqinë e ligjit, nr.5, datë 26.09.2012, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012” dhe **dekretuar me Dekretin nr. 7803, datë 30.10.2012.** Ligji i buxhetit për vitin 2012 është ndryshuar dhe me ligjin nr.126/2012, datë 22.12.2012 “Për miratimin e Aktit Normativ me fuqinë e ligjit nr. 6, datë 12.12.2012, të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10487, datë 05.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, i cili është dekretuar nga Presidenti **me dekretin nr.7915, datë 7.01.2013.** Draft ligji është dërguar në Këshill të Ministrave me shkresën nr. 19393, datë 11.12.2012. Referuar relacionit shoqëruar të projekt-aktit normativ, argumentet e ndryshimit të buxhetit janë kryesisht vlerësimi i situatës makroekonomike, duke korrigjuar nivelin e të ardhurave referuar kësaj situatë, për rrjedhojë reduktimi i shpenzimeve. Draft-ligji i paraqitur nga Ministria e Financave për kufirin e financimit të deficitit është më i vogël se sa propozimi i miratuar nga Këshilli i Ministrave (shtesa rezulton tek niveli i shpenzimeve). *Ndryshimi i ligjit të fillim vitit, ku janë pakësuar si të ardhurat e parashikuara për t’u arkëtuar ashtu dhe financimi i shpenzimeve për rrjedhojë të planifikimeve optimiste dhe jo reale të të ardhurave, tregojnë se institucionet përgjegjëse të realizimit të të ardhurave, vazhdojnë planifikimet optimiste dhe jo reale të realizimit të tyre, fenomen i konstatuar në vitet e fundit, por shumë i dukshëm për vitin 2012.* Referuar raporteve të konsoliduara dhe nga analiza e raportimit të realizimit të treguesve buxhetorë të konsoliduar të institucioneve qendrore, rezultoi se:

- *Nga analiza e raporteve të konsoliduara të ministrive për realizimin e financimit të huaj,* konstatohen institucione të cilët kanë të planifikuar financim të huaj dhe paraqiten me mosrealizim, si më poshtë vijon:

- Institucione të tjera Qeveritare ku fondi i planifikuar i financimit të huaj ka qenë në shumën 20 milionë lekë dhe ku realizimi është 0.

- MTKRS planifikuar në fillim viti 400 milionë lekë, me planifikim përfundimtar 50 milionë lekë dhe realizimi 0.

Me nivel realizimi të ulët të financimit të huaj paraqiten METE në masën 47.43%, MASH 38.49%, MPCSSHB 76.78%, Fondi i Zhvillimit Shqiptar 88.46% etj.

Në drejtim të planifikimit dhe zbatimit të shpenzimeve buxhetore jo nga të gjitha ministrinë dhe institucionet janë zbatuar kriteret për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të shtetit të përcaktuara këto kriteret dhe procedura në udhëzimet përkatëse të dala nga MF-ve për vitin 2012 “Për përgatitjen e buxhetit të shtetit dhe fondet speciale”. Për këtë, nga MF-ve është kryer monitorimi i drafteve të dërguar për realizimin e fondeve sipas politikave të programeve, produkteve të tyre, përqindjes së realizimit të produkteve dhe kostove përkatëse sipas formularëve përkatës të miratuar në këto udhëzime. Nga kontrolli rezultoi se nga Drejtoria e Menaxhimit dhe Raportimit të Buxhetit ka mbikëqyrje dhe vlerësime për raportet e paraqitura nga institucionet përkatëse, monitorim ky që i shërben procesit të planifikimit për vitin pasardhës. Nëpërmjet këtij monitorimi janë evidentuar një sërë të metash, që nga mënyra e planifikimit të programeve, përcaktimi i kostove të tyre etj.

- *Nga studimi mbi procesin e rakordimeve në nivel institucional dhe zbatimit të kompetencave për transferimet e kryera, rezultoi sa më poshtë vijon:*

1. Janë kryer rakordimet e të gjitha niveleve dhe për të gjitha fondet buxhetore në nivel titulli, kapitulli, artikulli, distrikti, lokal. Në këtë proces rakordimi u konstatua:

- a. Rakordimet midis Ministrisë së Financave dhe Institucioneve Qendrore, për vitin 2012 janë kryer brenda afateve.

b. Në drejtim të saktësisë së rakordimit, ndërmjet raporteve të monitorimit dhe treguesve të ministrive rakordimi për planin ishte i saktë; kurse për faktin ka mospërputhje midis raporteve të monitorimit dhe faktit të konsoliduar të ministrive.

c. Janë zbatuar kompetencat e transferimit referuar parashikimeve në nenin 44 të ligjit.

Është respektuar kufiri prej 10% për fond të rishpërndarë kundrejt totalit të fondit të programuar dhe miratuar.

- Referuar të dhënave të nxjerra nga sistemi mbi përdorimin e të ardhurave jashtë limitit nga institucionet buxhetore ku krijimi dhe përdorimi i tyre bëhet në bazë të përcaktimit në udhëzimin e zbatimit të buxhetit (ku përcaktohet se kush janë të ardhurat jashtë limitit dhe si përdoren ato) si dhe në bazë të marrëveshjeve të lidhura midis institucionit dhe sponsorizuesit apo donatorit) rezultoi se, për vitin 2012 ka një numër të madh institucioneve që rezultojnë me përdorim të ardhurash jashtë limitit, përkatësisht 26 institucione në një shumë totale prej 9,130,754,174.88 lekë. Shumë kjo e konsiderueshme e përdorur mbi planin. Referuar këtij konstatimi nga grupi i auditimit u shqyrtuan raportet e monitorimit për të verifikuar që në këto raporte këto fonde a ishin të shoqëruara me realizim produktesh. U konstatua se raportet e monitorimit nuk përmbanin informacione të tilla të cilat janë të domosdoshme për arsye se, nga MF-ve duhet të ndiqen shpenzimet për të parë koston e produkteve dhe faktin tjetër që me këto fonde kryen shpenzime suplementare administrative apo këto shkojnë në drejtim të realizimit të produkteve shtesë apo të reja të institucionit. Ndër ministrinë kryesore që paraqiten me përdorim të të ardhurave jashtë limitit janë: vetë MF-ve, MASH, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Shëndetësisë, Drejtoria e Përgjithshme e RTV, Ministria e Brendshme, Ministria e Punëve të Jashtme, MPPT, METE etj. Mos dhënia e këtij informacioni në raportet e monitorimit për ministrinë përkatëse deformon rezultatet e realizimit të shpenzimeve dhe të produkteve si dhe kostove përkatëse për produkt.

Më poshtë paraqesim shpjegimet e bëra nga Ministria e Financave për përdorimin e të ardhurave jashtë limitit të përcaktuara në udhëzimet e Ministrisë të Financave.

Për MASH, të ardhurat jashtë limitit janë kryesisht të ardhurat e arsimit të lartë, të cilat në zbatim të ligjit dhe udhëzimit të zbatimit të buxhetit përdoren nga vete institucioni bazuar në udhëzimet përkatëse të Keshillave Administrative dhe nuk përfshihen në realizimin e produkteve.

Për Ministrinë e Financave (Drejtoria e Përgjithshme e Doganave) realizon të ardhura nga vendosja e gjobave, 50 përqind e të cilave, në zbatim të nenit 296 të ligjit nr.8449, datë 27.01.1999 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë", kalojnë në buxhetin e shtetit dhe 50% mbeten në përdorim të institucionit. Në zbatim të Udhezimit nr 4464/1 datë 23.09.1999, të Ministrisë të Financave pjesa e të ardhurave që i mbetet institucionit përdoren për përmirësimin e kushteve të punës së punonjësve dhe për shpërblime, të cilat shpërndahen sipas përcaktimeve të udhëzimit të Ministrisë të Financave nr. 48 datë 08.12.2009).

Për Ministrinë e Drejtësisë: të ardhurat jashtë limitit në programin e rregjistrimit të pasurive dhe rehabilitimit të ish të përndjekurve (në vlera relativisht të vogla), janë kryesisht sponsorizime dhe donacione nga donatore të huaja, të cilat përdoren me destinacion të përcaktuar prej tyre. Në programin e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave ku këto të ardhura kanë edhe një vlerë relativisht të lartë, ato janë përfshirë dhe paraqitur në raportin e monitorimit të kësaj ministrie, me një produkt me vete.

Për Ministrinë e Shëndetësisë: të ardhurat jashtë limitit janë kryesisht të ardhurat e spitaleve, të cilat në zbatim të ligjit dhe udhëzimit të zbatimit të buxhetit, përdoren nga vete spitali në bazë të udhëzimit të Keshillit Administrativ të ISKSH-se dhe nuk përfshihen në realizimin e produkteve; ndërsa të ardhurat e tjera janë sponsorizime, kryesisht nga UNICEF, që përdoren me destinacion të përcaktuar prej tij dhe gjithashtu nuk mund të përfshihen në koston e produkteve të planifikuara.

Për Drejtorinë e Përgjithshme të RTV, vepron në bazë të ligjit nr. 8410, datë 30.09.1998 dhe VKM-se nr. 440, datë 01.06.2000 dhe nga buxheti i shtetit merr mbështetje financiare në

artikullin 604, transferata te brendeshme. Te ardhurat e klasifikuara si te ardhura jashte limitit jane te ardhurat nga tarifa e aparatit marres radioteleviziv, te cilat mblidhen nga kompania CEZ çdo muaj ne momentin e pageses se energjise elektrike.

Për Ministrinë e Brendëshme: në programin “Planifikim, menaxhim, administrim”, përfshihen te ardhurat qe realizon Shtepia e Pushimit Durres, te cilat, ne baze te udhezimit plotesues 2/1 date 15.02.2012 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2012”, jane klasifikuar si te ardhura jashte limitit, qe nuk mbarten ne vitin pasardhes. Ne programin 01330, “Menaxhimi dhe Zhvillimi i Administrates Publike”, te ardhurat jashte limitit jane sponsorizimet e ndryshme, qe jepen per shkollen e trajnimit te administrates publike. Ne programin 01160 “Prefekturat dhe Funksonet e Deleguara te Pushtetit Vendor”, te ardhurat jashte limitit jane sponsorizimet, per mbledhjet dhe trajnimet qe bejne punonjesit e tyre. Ne programin 03140, “Policia e Shtetit”, te ardhurat jashte limitit jane kryesisht te ardhurat qe realizohen nga sherbimi i karrotrecit, te cilat ne baze te udhezimit plotesues 2/1 date 15.02.2012 “Per zbatimin e buxhetit te vitit 2012”, jane percaktuar si te ardhura jashte limitit qe nuk mbarten ne vitin pasardhes. Ne programin 10910, “Emergjencat Civile”, te ardhurat jashte limitit, jane donacionet e ndryshme, qe jane dhene per permbytjet ne Qarkun e Shkodres.

Për Ministrinë e Punëve të Jashtme, te ardhurat jashte limitit (kapitulli 06) jane perdorur ne zbatim të ligjit nr.7928, datë 27.4.1995, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”, si dhe ne zbatim te Udhëzimit nr.17 datë 13.05.2008, per rimbursimin e TVSH-se per trupin diplomatik të akredituar në vendin tone. Kjo ministri nuk i ka përfshire si produkte pasi nuk jane produkte te saj, por eshte nje procedure qe ministria e kryen per llogari te Drejtorise se Tatimeve.

Për MPPT, nga të ardhurat jashte limitit te realizuara gjate vitit 2012, ka shpenzuar rreth 237.8 milione leke. Pjesa me e madhe e ketyre shpenzimeve, rreth 200.6 milione leke, ne programin “Strehimi dhe Urbanistika”, ka si burim te ardhurat nga “Taksa e ndikimit ne infrastrukture” dhe nga “Penalitetet e shtesave ne legalizim”, qe ne baze te ligjit nr. 9482, date 3.04.2006 “Per legalizimin dhe integrimin e ndertimeve pa leje”, te ndryshuar, i kalojne njesive te pushtetit vendor, ku eshte kryer ky ndertim. Shumat e tjera te shpenzimeve te kryera kane si burim sponsorizimet e ndryshme te marra nga Instituti i Transportit, per rreth 6.7 milione leke, Porti Detar Sarande rreth 28.5 milione lekë dhe Drejtoria e Pergjithshme e Ujesjelles Kanalizimeve rreth 1.8 milionë lekë.”

o *Nga auditimi në MPÇSSHB*

Nga MF-ve me shkresën nr. 5040/1, datë 2.03.2011 janë dërguar tavanet për PBA 2012- 2014 në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 147, datë 2.03.2011 “Për miratimin e tavanëve përgatitore të shpenzimeve buxhetore për PBA 2012-2014. Nga MPÇSSHB në drejtim të hartimit të programit buxhetor Afatmesëm me urdhër të ministrit nr.27 datë 25.02.2011 janë ngritur ekipet e programeve në të cilin marrin pjesë si drejtuesit e politikave të programeve pjesë e strukturës së ministrisë ashtu dhe drejtuesit e menaxhimit të fondeve të institucioneve që janë pjesë e programeve. Programi Buxhetor Afatmesëm i ministrisë është dërguar në Ministri të Financave me shkresën 370/14, datë 29.08.2011, *brenda afateve të përcaktuara në ligj*. Ai është përgatitur referuar kërkesave të paraqitura nga institucionet përkatëse menaxhuese të fondeve të programeve dhe këto të konfirmuara nga drejtuesit e programeve dhe Sekretari i Përgjithshëm. Për vitin 2012 ministria paraqitet me 6 programe buxhetore të cilat janë të konfirmuar nga drejtuesit përkatës. Në programin buxhetor të vitit 2012 janë përfshirë dhe nevojat për dy institucionet e reja të krijuara gjatë vitit 2010 dhe të paraqitura me probleme për fonde gjatë vitit 2011 (Qendra Kombëtare e Trajnimit të Viktimave të Dhunës në Familje dhe Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve. Bashkëlidhur projektbuxhetit janë vendosur dhe formularët e investimeve aneksi 5 A si dhe formulari F2 (formulari i propozimit të projektit

të investimit.) referuar shqyrtimit për mënyrën e plotësimit të këtyre formularëve ka mangësi në dhënien e informacionit të plotë dhe gjithëpërfshirës në plotësimin e tyre.

Kostot e vendosura në formularë janë më të mëdha se sa tavanet e miratuara nga EKB për zonat përkatëse, duke mos dhënë asnjë argument për këto devijime (në një kohë që çmimet e tregut për blerje ambientesh kanë rënë për efekt të raportit ofertë kërkesë). *Kjo ka qenë dhe një arsye që nga Ministria e Financave nuk janë miratuar dhe alokuar fondet përkatëse pasi nuk janë të argumentuara.*

E njëjta situatë paraqitet dhe me formularin për Rikonstruksionin e Godinës së MPÇSSHB i paraqitur si fisha (F2) në projektbuxhetin e vitit 2011 ku informacioni jepet në total jo për ato rikonstruksione që aktualisht do t'i bëhen ministrisë (si fasada, shtesë kati, rikonstruksione salle mbledhje dhe ambiente të brendshme).

Nga shqyrtimi i informacionit të marrë nga audituesit e KLSH rezultoi se: në qytetin e Lezhës, zhvillojnë aktivitetin e tyre, 3 institucione të varësisë së MPÇSSHB të cilat janë: Zyra Rajonale e Punësimit, Zyra Rajonale e Ndihmës Ekonomike dhe Inspektorati Rajonal i Punës. Te tre këto institucione e zhvillojnë aktivitetin e tyre në ambiente me qira. Nga ana e MPÇSSHB, duke filluar që nga viti 2004 dhe deri në vitin 2012, është kërkuar në PBA, për blerje ambienti, por nga ana e MF-ve nuk na është akorduar fonde për këtë qëllim. Janë bërë përpjekje sipas informacionit të ministrisë me METE për gjetjen e ambienteve shtetërore në qytetin e Lezhës, por kjo pa rezultat (kjo nuk është dokumentuar me dokumente).

Përsa më sipër, KLSH është e mendimit se nga strukturat e ministrisë (drejtuesit e programeve si dhe nga menaxhuesit e fondeve të këtyre institucioneve) nuk është punuar në mënyrë zyrtare dhe të argumentuar për realizimin e nevojës së argumentuar të këtij investimi.

Për vitin 2012 në zbatim të ligjit nr. 10487, datë 05.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", MF-ve me shkresën nr. 23402/131 datë 05.01.2012, ka akorduar fondin për MPÇSSHB në masën 53,485,759 mijë lekë, ku fondet për programet për sigurimet shoqërore dhe mbrojtjen sociale zënë përkatësisht 60% dhe 37% të fondeve të të gjithë ministrisë. Investimet kapitale për vitin 2012 janë në shumën 286,400 mijë lekë ku 150.000 mijë lekë janë financim i huaj. Këto fonde, kanë ndryshuar me ligjin për rialokimin e fondeve të vitit 2012 dhe me aktin Normativ nr.6, datë 12.12.2012, gjithashtu fondet e ministrisë janë pakësuar (ngurtësuar) dhe në zbatim të urdhrit nr. 50, datë 5.09.2012 të Ministrit të Financave dhe referuar reagimit të MPÇSSHB ky ngurtësim është realizuar vetëm nga fondet e aparatit të ministrisë të akorduara nga programi 10430 "Mbrojtja sociale". Gjatë vitit 2012 janë kryer një numër i konsiderueshëm i transferimeve për sa i përket fondeve. Edhe për vitin 2012 gjendja e fondeve për Shërbimet dhe pagesat që kryen në funksion të ligjit SHSSH ka qenë në nivelet më të ulta se sa nevojat, çka ka çuar në atë që për nevoja të shtëpive të foshnjave dhe të të moshuarve janë transferuar 35,000,000 lekë, referuar kërkesës së ministrisë. Gjithashtu, me VKM në këtë ministri kanë rezultuar shtesa të rëndësishme të fondeve si për shlyerjen e një pjese të detyrimeve të prapambetura për pagesat e alblekomit dhe energjisë elektrike për personat me aftësi të kufizuar (rialokim fondesh), shtesë fondesh për rritje të pagave etj.

Nga Drejtoria e Planifikimit të Buxhetit Analizës dhe Statistikës janë kryer rakordimet me institucionet vartëse dhe me Ministrinë e Financave si për planin ashtu dhe për faktin brenda afateve të përcaktuara nga Ministri i Financave "Për mbylljen e buxhetit të vitit 2012".

Referuar treguesve të PBA të kërkuar nga MPÇSSHB të cilët janë të ndryshëm nga tavanet e vendosura nga MF, si dhe krahasuar me këto tregues me fondet e çelura në fillim viti dhe me ndryshimet përkatëse, rezulton se, kjo ministri për vitin 2012 ka pasur mangësi të konsiderueshme të fondeve për programin "mbrojtja sociale". Kjo ka bërë që gjatë vitit 2012 të jenë paraqitur probleme në mungesën e fondeve në fund viti për shtresat që përfitojnë nga mbrojtja sociale dhe kryesisht nga PAK. Kështu, për Bashkinë Vlorë për vitin 2012 nga Shërbimi Social Shtetëror është planifikuar dhe çelur shuma prej 414,354 mijë lekë për persona me aftësi të kufizuar (PAK). Aktualisht kërkesa nga kjo bashki për vitin 2012 ka qenë në masën

462,578.4 mijë lekë. Pra, me një diferencë të pa mbuluar prej 48,224 mijë lekë. Kjo situatë është për të gjitha bashkitë dhe komunat. Pra buxheti i shtetit ka çelur më pak fonde se sa kanë qenë nevojat e bashkive dhe komunave. Argumenti për këtë është se në nenin 34, të ligjit nr. 9355, datë 10.03.2005 “Për ndihmën dhe mbrojtjen shoqërore” thuhet se: - burimet e financimit të ndihmës dhe pagesës së personave me aftësi të kufizuar përbëhet nga:

- a. fondet e buxhetit qendror të shtetit, dhe
- b. fondet nga taksat dhe tarifatat vendore.

Nga qeverisjet vendore deri më sot nuk ka angazhime fondesh për këtë problem. Pikërisht kjo ka çuar në mos mbulimin e nevojave për këtë kategori.

Auditimi KLSH gjatë auditimit të fondeve buxhetore, konstatoi se nuk ka rregulla të përcaktuara për financimet nga njësitë vendore ose për rastet e financimeve në ato komuna kur këto nuk kanë mundësi reale. *Megjithatë regjistrimi i të dhënave në sistem si për ndihmën ekonomike dhe për personat me aftësi të kufizuar do të krijonte mundësinë e një kontrolli dhe mbikëqyrje të çeljes dhe përdorimit të këtyre fondeve, duke shmangur kështu në një farë mënyre dhe keqmenaxhimin e këtyre fondeve. Krijimi i sistemeve dhe data bazeve referuar informacionit të dhënë nga ministria është pjesë e projekteve që do të implementohen me fondet e BB.*

Referuar realizimit të produkteve raportuar në raportin e monitorimit dërguar në MF-ve me shkresën nr. 801, datë 28/01/2013, ka rezultuar se:

- a. Në programin “Planifikim, Menaxhim, Administrimit”, paraqitet me mosrealizim produkti “Përmirësimi i standardeve të IT (mungesë fondesh);
- b. Programet “sigurimet shoqërore” për 3 produkte dhe Mbrojtja sociale” për 1 produkt, për vetë karakteristikat e tyre rezultojnë me realizim 100% të fondeve për rrjedhojë dhe të produkteve, por aktualisht shumica e pa financuar në vitin 2012 është rimbursuar nga buxheti i shtetit në 2/mujorin e parë të vitit 2013 me fondet e këtij viti në masën prej 2,329,332,914 lekë.
- c. Në programin “tregu i punës” rezultojnë të realizuar pjesërisht 3 produkte të programit (numri i të ndërmjetësuarve, të punësuar nga nxitja e punësimit, të trajnuar me certifikatë). Në këto raporte një nga arsyet e mosrealizimit janë mungesa e fondeve për ristrukturimet e ndryshme etj. Raportet e monitorimit janë hartuar dhe dërguar në Ministrinë e Financave në mënyrë progresive dhe brenda afateve të përcaktuara në udhëzimin e zbatimit të buxhetit.

Në Ministrinë e Mbrojtjes: Nga raporti i Monitorimit të Ministrisë Mbrojtjes për shpenzimet korrente rezultoi se, plani i buxhetit me ndryshimet e bëra gjatë vitit 2012 në vlerë është 19,865,000 mijë/ lekë, realizuar 19,820,000 mijë/lekë, me një diferencë 45,000 mijë/lekë, ose në masën 99.8%.

Në vijim paraqesim të dhënat mbi ndryshimet në buxhetin e Ministrisë Mbrojtjes në vitin 2012:

Programet	në milionë/lekë		
	Buxheti fillestar 2012	Buxheti me ndryshime 2012	Diferenca
Planifikim, menaxhim, administrim	1,153,3	1,186,0	+32.7
Forcat e Luftimit	7,882,5	7,857,0	-25.5
Arsimi Ushtarak	979,1	904,0	-75.1
Mbështetja Shëndetësore	696,6	780,0	+83.4
Mbështetja e Luftimit	3,972,3	3,951,0	-21.3
Mbështetja Sociale për Ushtarakët	4,500,0	4,500,0	0.0
Bashkëpunimi Civilo-Ushatarak	726,4	687,0	-39.4
Totali i Ministrisë:	19,910.2	19,865.0	-45.2

Burimi: Ministria e Financave

Nga të dhënat e mësipërme konstatohet se, buxheti me ndryshime ndryshon me buxhetin fillestar në shumën rreth -45.2 milionë lekë. Disa programe kanë ndryshuar në rritje të kuotave të shpenzimit si: “Mbështetja shëndetësore” dhe “Planifikim, menaxhim, administrim”; ndërsa disa

të tjerë si “Arsimi ushtarak”, “Bashkëpunimi Civilo-Ushatarak”, “Forcat e luftimit” dhe “Mbështetja e luftimit”, kanë ndryshuar në ulje të kuotave vjetore.

Për shpenzimet kapitale rezultojnë se, plani i buxhetit me ndryshimet e bëra gjatë vitit është 3,000 mijë/lekë dhe realizuar 2,989 mijë/lekë, me një diferencë prej 11 mijë/lekë, ose në masën 99.6%.

Për të shtatë programet e kësaj Ministrie situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë vitit, përfshirë ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, si dhe realizimi faktik 2012, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në milionë/lekë

Programet	Buxheti me ndryshime Viti 2012	Realizimi i Buxheti Viti 2012	Diferenca
Planifikim, menaxhim, administrim	1,186,0	1,186,0	0.0
Forcat e Luftimit	7,857,0	7,828,0	29
Arsimi Ushtarak	904,0	902,0	-2
Mbështetja Shëndetësore	780,0	780,0	0.0
Mbështetja e Luftimit	3,951,0	3,939,0	-12
Mbështetja Sociale për Ushtarakët	4,500,0	4,500,0	0.0
Bashkëpunimi Civilo-Ushatarak	687,0	685,0	-2
Totali i Ministrisë:	19,865,0	19,820,0	-45

Burimi: Ministria e Financave

Sa më sipër, për tre programe të kësaj ministrie, përqindja e realizimit të shpenzimeve për vitin 2012 rezultojnë në nivelin 100%; ndërsa për katër programe të tjerë përqindja e realizimit variojnë nga 99.6%-99.8%.

Nga vlerësimi i bërë nga audituesit e KLSH mbi monitorimin e kryer nga Drejtoria e Monitorimit dhe Zbatimit të Buxhetit në MF-ve, u konstatua se janë bërë vlerësime dhe komente për *Monitorimin e Buxhetit në Ministrinë e Mbrojtjes për vitin 2012*, përsa vijon:

a. *Raporti i monitorimit duhet të ketë më shumë analize të shkaqeve që kanë sjellë mosrealizim të produkteve.*

b. *Nuk ka një analizë të kostos për njësi të një sërë artikujve, kur është e mundur të bëhet një analizë e tillë.*

c. *Në këtë raport monitorimi nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes nuk është përfshirë fakti i Kap. 06, të ardhura jashtë limitit, që rezultojnë rreth 5,479 mijë/lekë.*

Si përfundim, nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes nuk janë kryer analiza të plota mbi shkaqet që kanë sjellë mosrealizim të produkteve.

- Në këtë Ministri nuk janë kryer analiza të kostos për njësi për një sërë artikujsh ku ekzistonte mundësia e kryerjes së ketyre analizash të kostove për njësi

Në tabelën e mëposhtme paraqesim të dhënat faktike të raportit të Ministrisë së Mbrojtjes krahasuar me të dhënat e thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese:

në milionë/lekë

Programet	Shpenzime korente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.
Planif. Menaxh.Adm.	1,186.0	1,186.0	0.0	0.0	0.0	0.0	1,186.0	1,186.0	0.0
Forcat e Luftimit	4,967.0	4,967.0	0.0	2,861.0	2,861.0	0.0	7,828.0	7,828.0	0.0
Arsimi Ushtarak	804.0	804.0	0.0	98.0	98.0	0.0	902.0	902.0	0.0
Mbështetja Shëndet.	780.0	485.7	0.0	0.0	0.0	0.0	780.0	780.0	0.0
Mbështetja e Luftimit	3,909.0	3,909.0	0.0	30.0	30.0	0.0	3,939.0	3,939.0	0.0
Mbështetja Sociale për Ushtarakët	4,500.0	4,500.0	0.0	0.0	0.0	0.0	4,500.0	4,500.0	0.0
Bashk.Civilo-Ushta.	685.0	685.0	0.0	0.0	0.0	0.0	685.0	685.0	0.0
Totali i Ministrisë:	16,831.0	16,831.0	0.0	2,989.0	2,989.0	0.0	19,820.0	19,820.0	0.0

Sa më sipër, të dhënat e paraqitura nga Ministria e Mbrojtjes, për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për vitin 2012, përputhen me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit për këtë vit.

o Në MBUMK: Për të gjashtë programet e kësaj Ministrie, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim për vitin 2012, përfshirë këtu buxhetin fillestar, buxhetin sipas aktit normativ dhe buxhetin me ndryshimet e ndodhura gjatë vitit, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në milionë/lekë

Programet	Buxheti fillestar Viti 2012	Buxheti sipas aktit normativ	Buxheti me ndryshime	Diferenca
Planifikim, menaxhim, administrim	242.4	231.4	435.1	+203.7
Siguria ushqimore, mbrojtja e konsumatorit	2,022.6	1,563.6	1,568.4	+4.8
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	2,131.6	1,989.6	2,004.3	+14.7
Zhvillimi rural	2,134.2	1,690.4	1,691.9	+1.5
Këshillimi dhe informacioni bujqësor	241.5	234.5	236.4	+1.9
Menaxh. i qëndrueshem i tokës bujqësore	9.0	7.7	7.7	0.0
Totali i Ministrisë:	6,781.3	5,717.3	5,943.9	+226.6

Sipas zërave përbërës të shpenzimeve, situata në fund të vitit 2012, në përqindje realizimi, paraqitet:

Nr.	Emërtimi i Programit	Shpenzime korrente (në %)	Shpenzimet kapitale (në %)
1.	Programi “Planifikim, menaxhim administrim”	97.0%	62.0%
2.	Programi “Siguria ushqimore, mbrojtja e konsumatorit”	98.1%	109.1%
3.	Programi “Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes”	99.7%	94.4%
4.	Programi “Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin”	98.1%	89.8%
5.	Programi “Këshillimi dhe informacioni bujqësor”	94.1%	93.4%
6.	Programi “Menaxhimi i qëndrueshem i tokës bujqësore”	91.7%	0.0%
Totali i Ministrisë:		98.1%	95.6%

Burimi: Ministria e Financave

Sa më sipër, me përjashtim të programit “Menaxhim i qëndrueshëm i tokës bujqësore” dhe programit “Këshillimi dhe informacioni bujqësor” ku përqindja e realizimit të shpenzimeve rezulton përkatësisht në masën 91.7% dhe 94.1%, të gjithë programet e tjerë paraqiten me realizim nga 97% në 99.7% dhe në total 98.1% të fondit të shpenzimeve korrente të akorduara.

Nuk mund të thuhet e njëjta gjë për realizimin e investimeve, megjithëse në rang ministrie rezultojnë me realizim në masën 95.6%, për programe të veçanta realizimi ka qenë në nivele të ulta dhe shumë të ulta, si programi “Zhvillimi rural duke mbeshtetur prodhimin” realizuar në masën 89.8% dhe Programi “Planifikim, menaxhim administrim” në masën 62%.

Ndërsa, në tabelën e mëposhtme paraqesim të dhënat faktike të raportit të MBUMK krahasuar me të dhënat e thesarit, për të njëjtën periudhë raportuese:

Programet	Shpenzime korrente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.	Ministria	Thesari	Dif.
Planif. Menaxh. Adm.	417.1	417.1	0.0	3.1	3.1	0.0	420.2	420.2	0.0
Siguria ushqimore, mbrojtja e konsumat.	1,225	1,225	0.0	349.8	318.1	31.7	1,574.5	1,543.1	31.7
Infrastruktura e kullimit dhe ujitjes	775.3	775.3	0.0	1,158	1,110.2	47.8	1,933.3	1,885.5	47.8
Zhvillimi rural duke									

RAPORT PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË SHTETIT TË VITIT 2012

mbeshtetur prodhimin bujqesor, agroindustrial dhe marketingun	1,213.6	1,213.6	0.0	408.9	412.1	3.2	1,622.4	1,282.5	340
Keshillimi dhe informacioni bujqesor	190.7	190.7	0.0	31.5	31.5	0.0	222.2	222.2	0.0
Menaxh. i qendruesh. tokes bujqesore	7.1	7.1	0.0	0.0	0.0	0.0	7.1	7.1	0.0
Totali i Ministrisë:	3,828.5	3,828.8	0.0	1951.2	1875.4	75.8	5,779.7	5,704.2	75.8
Të ardh. jasht limitit		2.7			0.4			3.1	

Nga tabela e mësipërme, të dhenat e paraqitura nga MBUMK, për përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për vitin 2012, nuk përputhen plotësisht me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit. Këto diferenca ekzistojnë tek financimi i huaj.

Nga shqyrtimi i tabelave shoqëruese rezulton se, në programin “Planifikim, menaxhim dhe administrim”, në raportin e paraqitur nga ministria në lidhje me statusin e produkteve raportohet për realizim plotësisht të ketyre produkteve, në tabelat shoqëruese të tij ky status raportohet në realizimin pjesërisht të ketyre produkteve.

Në raportin e monitorimit, komentet e realizimit të produkteve duhet të paraqiten të lidhura edhe me realizimin e objektivave të politikës së programit; gjithashtu duhet të paraqiten edhe komentet mbi zbatimin e projekteve të Fondit për Zhvillimin e Rajoneve.

○ **Në Ministrinë e Shëndetësisë.** Për vitin 2012, kjo ministri administroi dhe menaxhoi fondet publike sipas katër programeve të miratuara, e konkretisht:

Programi “Planifikim, menaxhim, administrim”

Programi “Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor”

Programi “Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor”

Programi “Shërbime të shëndetit publik”.

Në fund të vitit 2012, situata në lidhje me realizimin e shpenzimeve të buxhetit në përqindje, krahasuar me planin vjetor me ndryshime, paraqitet si me poshtë:

Programet e Miratuara	Realizimi në % kundrejt buxhetit vjetor
Programi “Planifikim, menaxhim administrim”	95.2 %
Programi “Shërbime të kujdesit shëndetësor parësor”	98.4 %
Programi “Shërbime të kujdesit shëndetësor dytësor”	99.0 %
Programi “Shërbime të shëndetit publik”	97.6 %
Totali i Ministrisë:	98.7 %

Përqindja e realizimit të shpenzimeve në total për të katër programet e kësaj ministrie varion në intervalin 95.2%- 99.0 %, ndë në nivel ministrie në masën 98.7%.

Për të katër programet e kësaj ministrie, situata në lidhje me ndryshimet në planifikim gjatë vitit 2012, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Programet	Buxheti fillestar 2012	Buxheti sipas aktit normativ	Buxheti me ndryshime	në milionë/lekë
				Diferenca buxheti me ndryshime-akti normativ
Planifikim menaxhim administrim	226.8	220.8	253.7	+32.9
Shërbime të kujd. shëndetësor parësor	9969.5	10048.7	9980.1	-68.6
Shërbime të kujd. shëndetësor dytësor	16416.6	16834.7	16908.1	+74.1

Sherbime te shendetit publik	2501.6	2385.9	2441.3	+54.4
Totali i Ministrisë:	29 114.4	29 490.2	29 583.2	+92.8

Ndryshimet në planin e buxhetit, janë kryesisht nga shtesa e fondeve për përdorimin e fondit të veçante dhe nga rritja e pagave. Në programin e planifikimit, menaxhimit dhe administrimit shtesat e fondeve janë edhe për të semuret që janë përballuar nga fondi rezerve i Këshillit të Ministrave. Ndërsa ndryshimet në planin e buxhetit për programin e shërbimit përsosor dhe dytesor vijnë edhe nga një rishpërndarje e fondeve midis këtyre programeve me vendim të Këshillit të Ministrave.

Krahasimi i të dhënave faktike, të raportit të Ministrisë me të dhënat e thesarit, për të njëjten periudhë raportuese, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

në milionë/lekë

Programet	Shpenzime korrente			Shpenzime kapitale			Totali i shpenzimeve		
	Ministri	Thesari	Dif.	Ministri	Thesari	Dif.	Ministri	Thesari	Dif.
Planif. Menaxh. administrim	238.4	238.4	0.0	3.1	3.1	0.0	241.5	241.5	0.0
Sherb. Kujd. Shend. Përsosor	9,117.5	9,117.5	0.0	777.2	717.7	59.5	9,894.7	9,835.2	59.5
Sherb. Kujd. Shend. Dytesor	14,449.6	14,449.6	0.0	2,337.8	2,417.8	-80	16,787.4	16,867.4	-80
Sherbime te shendetit publik	2,358.3	2,358.3	0.0	25.9	25.9	0.0	2,384.2	2384.2	0.0
Totali i Ministrisë:	26,163.8	26,163.8	0.0	3,144.0	3,164.5	-20.5	29,307.8	29,328.3	-20.5

Siç shikohet nga tabela e mësipërme, të dhënat e paraqitura nga Ministria e Shëndetësisë për shpenzimet korrente, në përgatitjen e raportit të monitorimit të shpenzimeve për vitin 2012, *perputhen me të dhënat e nxjerra nga sistemi i thesarit, ndërsa për shpenzimet kapitale nuk perputhen për dy programe.* Diferencat janë për projektet me financim të huaj dhe duhet të rakordohen nga Ministria e Shëndetësisë me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit, në Ministrinë e Financave.

Gjithashtu, nga monitorimi janë kostatuar të meta e mangësi për të cilat janë dhënë komentet si më poshtë:

- *Raporti i monitorimit, duhet të kishte një analizë të kostos për njësi të një sërë produktesh, ku është e mundur të bëhet një analizë e tillë.*
- *Në disa programe edhe kur sasia e realizimit të produktit është me e vogël se ajo e planifikuar statusi i realizimit të produktit konsiderohet i realizuar plotësisht, pa dhënë shpjegimin e duhur për diferencën e konstatuar (fakt-plan)*
- *Në disa programe numri i produkteve të evidentuara në këtë material si produkte të planifikuara nuk është i njëjte me atë të paraqitur në raportet e periudhave të mëparshme.*
- *Investimet me financim të huaj, për faktin e vitit 2012, duhet të rakordohen me Drejtorinë e Përgjithshme të Thesarit në Ministrinë e Financave.*

Nga auditimi i kryer mbi raportet e monitorimit ka rezultuar se në raportin “Mbi monitorimin e realizimit të shpenzimeve të vitit 2012”, i cili është pjesë e raportit që Ministria e Financave ka dërguar në Këshillin e Ministrave “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit 2012” rezultojnë standarde të ndryshme të përmbajtjes së Raporteve të monitorimit siç është rasti i monitorimit për Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit në të cilin është bërë një analizë plan fakt buxheti sipas programeve dhe nuk është kryer analizë në termat e objektivave arritjeve, dhe produkteve si kuresë është vepruar në arstin e MASH atj. Po kështu treguesit e realizimit të shpenzimeve të Ministrive të linjës nuk përmbajnë shpenzimet faktike të financuara nga të ardhurat jashtë limitit apo edhe nga financimi i huaj dhe për rrjedhojë këto raporte nuk rakordojnë me raportet të konsoliduara të Ministrisë së Financave për shpenzimet faktike, duke u nisur dhe nga fakti se përdorimi i të ardhurave jashtë limitit ka zënë një shumë të

konsiderueshme gjatë vitit 2012, rreth 9 miliardë lekë në total ministrish, shumë e cila ndikon në performancën e institucioneve dhe në mospërputhjet e konsiderueshme midis planit dhe faktit.

Sa më sipër KLSH ka rekomanduar: - Të përcaktohet standardi i përmbajtjes së raporteve të monitorimit që Ministria e Financave paraqet për Ministrinë e linjës në raportin “Mbi monitorimin e realizimit të shpenzimeve të vitit 2012”, i cili është pjesë e raportit që Ministria e Financave ka dërguar në Këshillin e Ministrave “Për miratimin e buxhetit faktik të vitit”

- Nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit për të bërë transparencën e shpenzimeve, t’i kërkohet Ministrive të linjës që në raportet e monitorimit në një rubrikë të veçantë të trajtohen shpenzimet faktike të kryera për të ardhurat jashtë limitit sipas programeve dhe artikujve shoqëruar me analizën përkatëse për burimin dhe qëllimet e përdorimit, krahas dhe realizimit me tabelë të veçantë dhe të financimit të huaj.

Për këtë rekomandim Ministria e Financave ka shprehur dakordësinë në shkresën nr. 5167/21 datë 06.09.2013.

-Mbi evidentimin e detyrimeve kontraktuale ndaj te treteve në sektorin publik.

KLSH gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese është fokusuar në evidentimin e mënyrës së buxhetimit të punëve mallrave dhe shërbimeve mënyrë kjo e cila ka sjellë për pasojë rritjen e detyrimeve të buxhetit të shtetit ndaj operatorëve ekonomikë.

Në raportin që KLSH paraqiti në Kuvend “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011” ka trajtuar fenomenin e detyrimeve të buxhetit të shtetit ndaj kontraktorëve dhe ka rekomanduar: “Në kushtet aktuale sugjerojmë saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së këtyre borxheve, përcaktimi i masave për t’i dhënë mundësi dhe për të lehtësuar sa të jetë e mundur kompanitë private nga kosto e kredive që ato mund të kenë marrë për përmirësimin e situatës së tyre financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për ristrukturimin e kredive dhe ndërkohë mbledhjen e borxheve të këqija.

Gjithashtu duhet kërkuar nga sistemi bankar të inkurajojë dhënien e kredive. Madje, vlen të përmendet fakti se disa sipërmarrje private po marrin kredi informale, veprim i cili ka pasoja të dëmshme për ekonominë dhe vetë biznesin.

Edhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë për vitin 2012 KLSH ka patur në qendër të vëmëndjes evidentimin e këtij problemi dhe dhënjen e rekomandimeve për eliminimin e këtij fenomeni në drejtimet e mëposhtme:

- Procedimin nga Ministria e Financave **për evidentimin** e këtyre detyrimeve.
- Përcaktimin e **përdorimit të të ardhurave të privatizimit** për mbylljen e këtyre detyrimeve .
- Marrjen e masave për regjistrimin në sistemin e thesarit kontratat në shtrirje sipas viteve të parashikuara për financimin e tyre”. Ky rregjistrim jo vetëm do të sigurojë informacion të drejtë dhe të plotë për angazhimet financiare bazuar në kontratat shumëvjeçare, por do të mundësojë përdorimin e këtij informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit për nevojat e planifikimit të PBA-së.

KLSH në vite ka evidentuar problemin e **financimit** të kontratave të lidhura në mënyrë pjesore hapjen e projekteve të reja pa mbyllur ato në vazhdim duke nxjerrë në pah problematikat që kanë të bëjnë me shtimin gjithmonë e më shumë të detyrimeve të buxhetit të shtetit ndaj palëve të treta.

Më poshtë po japim disa argumente me shifra referuar gjendjes së konstatuar nga auditimi në disa institucione buxhetore:

Nga auditimi i kryer në Autoritetin Rrugor Shqiptar ka rezultuar se deri më datë **31.10.2012**, periudhë objekt auditimi, për 95 kontrata të lidhura, të cilat datojnë që nga viti 2007 e në

vazhdim, në vlerë totale në rreth prej **53,8 miliarde lekë** janë paraqitur për financim për punime të kryera në vlerë të përgjithshme rreth **37 miliarde leke** dhe janë financuar deri më 31.10.2012 gjithsej rreth **21,8 miliarde leke**, me një detyrim për financim ndaj sipërmarrësve **për punime të kryera** në vlerë rreth **15, 2 miliarde leke** dhe me një detyrim kontraktual që përfaqësojnë punime të papërfunduara dhe të përfunduara, në shumën **rreth 32 miliarde leke**.

Ky detyrim për financim të punimeve të kryera, ka ardhur duke u rritur në masën rreth **3,3miliarde leke** krahasuar me detyrimin sipas Raportit Përfundimtar të auditimit të mëparshëm deri më 31.12.2011, i cili ka qenë në shumën rreth **11,8 miliarde leke**.

Vlen të theksohet se në disa objekte edhe pse punimet **kanë përfunduar** sipërmarrësve nuk u është shlyer detyrimi nga ARRSH-ja, e konkretisht në 39 objekte me vlerë kontraktuale rreth 15,4 miliarde leke janë situacionuar rreth 15,1 miliarde leke dhe janë financuar gjithsej rreth 10,8 miliarde leke dhe **vlera e mbetur për financim është rreth 4,3 miliarde leke**.

U konstatua se për 92 kontrata supervizioni shuma totale e të cilave paraqitet në vlerën rreth 540 milione leke, nga të cilat janë financuar deri më 31.10.2012 gjithsej 284,4 milione leke, pra me një detyrim kontraktual për financim ndaj supervisorëve në shumën rreth **255,6 milione leke**.

Në rastin e kontratave të lidhur për “Studime e projekttime” vlera e kontratave të lidhura që nga viti 2007 është në shumën rreth 2,6 miliarde leke, nga të cilat janë financuar deri më 31.10.2012 gjithsej 1,14 miliarde leke me një detyrim kontraktual për financim ndaj projektuesve në shumën rreth **1,47 miliarde lekë**.

Ky detyrim, në vlerë të konsiderueshme për buxhetin e shtetit është krijuar nga prokurimi i fondeve për projektet e infrastrukturës rrugore me vlerën e plotë të tyre, por i pa shoqëruar me financimin pjesor (vjetor) nga buxheti i shtetit për të mbuluar punimet e kryera në përputhje me grafikun e punimeve të përcaktuar në kontratat e lidhura, të cilat janë në vlerë të plotë të realizimit të objekteve dhe në to nuk është parashikuar mënyra e kryerjes së pagesave e shtrirë në disa vite buxhetore në varësi të fondit që do të çelet, pavarësisht realizimit të grafikut të punimeve.

Edhe pse një pjesë e sipërmarrësve të punimeve, kanë realizuar punimet sipas detyrimeve të përcaktuara në kontratat e lidhura, ARRSH dhe MPPT, në buxhetet e tyre nuk kanë parashikuar fondet e nevojshme për mbulimin e këtyre punimeve.

Megjithëse prokurimi i fondeve për projektet e infrastrukturës rrugore në vlerën e plotë të tyre vlerësohet pozitivisht, mos financimi në kohe i punimeve të kryera në përputhje me grafikun e punimeve të përcaktuar në kontratat e lidhura ndikon negativisht në:

- Zgjatjen e zbatimit të objektit tej afateve të përcaktuara në kontratat e lidhura, pasi për ato objekte të cilat janë kryer, një pjesë e punimeve duhet të presin vitet e ardhshme buxhetore për t'u financuar, ndërkohë që për mungesë të fondeve sipërmarrësit nuk avancojnë në punime sipas grafikut ;
- Rritjen e detyrimeve ndaj këtyre sipërmarrësve, pasi për vlerën e punimeve të kryera dhe të pa likuiduara, atyre u lind e drejta sipas përcaktimeve në kontratat e lidhura të kërkojnë penalitetet për vonesa në likuidim;
- Në planifikimin e fondeve buxhetore, pasi detyrimet e mbartura nga viti në vit rriten në shumën të konsiderueshme dhe krijojnë vështirësi për t'u paguar njëherësh nga buxheti i shtetit, si dhe rritja e detyrimeve mund të sjellë rritje të kostos së borxhit të brendshëm të shtetit ;
- Krijimin e premisave për evazion fiskal në rastin kur sipërmarrësit avancojnë me punime dhe nuk dorëzojnë situacione për shkak të mosfinancimit të tyre ;
- Braktisjen e punimeve nga shoqëritë sipërmarrëse për shkak të mosfinancimit të tyre në kohë ;


- Investimet e kryera, të situacionuara dhe të marra në dorëzim nuk evidentoheshin në pasqyrat financiare të ARRSH.

-Në drejtim të detyrimeve të prapambetura për furnizimet dhe shërbimet e kryera në QSUT .

Nga auditimi u konstatua se QSUT nga viti në vit trashëgon një borxh me trend në rritje **ndërkohë që buxheti vjetor pothuajse është në nivelet e këtij borxhi**. Sa më sipër argumentojme:

Bazuar në bilancet kontabël të QSUT-së, gjendja rezulton:

Në fund të vitit 2010 ky borxh rezultoi në shumën 1 046.3 milion lekë, në fund të vitit 2011 ky nivel borxhi arriti në rreth 1 564 milionë leke ndërsa në fund të vitit 2012 rezultoi në rreth 2 295 milionë lekë.



Një mënyrë e tillë e menaxhimit të fondeve në kushtet e pamjaftueshmërisë së tyre sjell nga ana tjetër edhe kryerjen e likuidimeve ndaj operatorëve privat në mënyrë selektive, për rrjedhojë rezultonin operatorë me detyrime të pashlyera që nga vitit 2008 e në vijim.

Nga ana tjetër kontratat e lidhura me operatorët ekonomikë përmbajnë edhe sanksionet të cilat shteti duhet të paguajë ndaj operatorëve ekonomike në rastet kur autoriteti kontraktor nuk paguan në kohë detyrimet, gjë e cila nuk është zbatuar.

Sa më sipër kemi rekomanduar në QSUT:

Me synim uljen e nivelit të borxhit i cili nga viti në vit ka rezultuar me një tendencë në rritje, nga ana e strukturave të QSUT-së të në bashkëpunim dhe me Institutin e Sigurimeve të Kujdesit Shëndetësor të analizohet gjendja e borxhit, të percaktohet një plan masash, të cilat do të synojnë dhënjën e rrugëzgjdhjeve për alokimin e fondeve me prioritet shlyerjen e detyrimeve të prapambetura dhe uljen e borxhit të trashëguar.

Gjendja e krijuar si dhe plani i masave të paraqitet për shqyrtim Bordit Drejtues i cili është organi më i lartë i drejtimit të QSUT-se dhe që kryesohet nga Ministri i Shëndetësisë.

Me qëllim shmangjen e fenomenit të kryerjes së likuidimeve selektive, preferenciale apo klienteliste të përcaktohen kriteret të cilat do të jenë referuese për likuidimin e kontratave ndaj operatorëve ekonomikë.

Mbi detyrimet e konstatuara në Bashkinë Tiranë.

Nga auditimi i kryer ka rezultuar se financimi i projekteve është bërë i tillë që realizimi i tyre të shtrihet në më shumë se 2-3 vite buxhetore.

Për më tepër, nuk ka një analizë të borxhit të krijuar në çdo vit si rezultat i kufizimit të aftësisë paguese dhe faktorët që kanë ndikuar në krijimin e kësaj vështirësie financiare, kur në bilancin e Aparatit të Bashkisë Tiranë, rezulton se në fund të vitit 2012, ishte akumuluar **një borxh në vlerë prej 1,029,644,000 lekë**, nga të cilat 641,059,000 lekë për mallra dhe shërbime dhe 379,585,000 lekë për investime.

Ndërkohë që, shuma prej 609,000,000 lekë, është mbartur nga data 31.07.2011, e krijuar nga administrata e mëparshme.

- Nga auditimi që u ushtrua në Ministrinë e Financave në lidhje me evidentimin e detyrimeve kontraktuale të cilat përfaqësojnë detyrime të buxhetit të shtetit për kontratat e lidhura, rezultoi se nga kërkesa e bërë për këte qëllim Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit, për vlerën e detyrimeve të buxhetit për kontratat e lidhura nga ministrinë e linjes dhe kryesisht për: - MPPT (programi Rrugë nacionale dhe utesjellesa të cilat presupozohen të jenë vlera të konsiderueshme) rezultoi se sipas relacionit të Drejtorit të DPB theksohet se ky informacion nuk disponohet i saktë, megjithatë grupit të auditimit iu paraqiten të dhënat e mëposhtme:

Ministria e Linjës	Vlera e kontratave të lidhura	Vlera e financimit deri më 31.12.2012	Vlera e mbetur për financim
Ministria Punëve Publike e Transportit	67,768,296,587	24,072,164,413	43,696,132,174
Rrjeti rrugëve nacionale	63,383,316,587	22,080,153,413	41,303,163,174
Ujësjetllës Kanalizime (buxheti)	4,384,980,000	1,992,011,000	2,392,969,000

Po kështu grupit të auditimit iu paraqiten dokumentet e PBA-se 2013-2015 dhe komentet e DPB në lidhje me këtë çështje si më poshtë (citimi i komenteve):

“Sipas një llogaritje paraprake nga DMIP rezulton se për programin e rrugëve ka një vlerë shumë të lartë për detyrimet e projekteve në vazhdim nga vitet e mëparshme ose të çelura gjatë këtij viti (pa llogaritur kosto lokale dhe TVSH për projektet me financim të huaj). Duke përfshirë edhe fondet e çelura në buxhetin 2012 vlera e detyrimit është rreth 43 miliardë lekë, megjithatë presim nga MPPT të konfirmojë vlerën e saktë”.

Problematika kryesore ka të bëjë me faktin se paralelisht me kërkesën për fonde shitesë është dhe çelja e projekteve të reja me vlera financimi 26.2 milionë lekë për vitin 2013, rreth 4 milionë lekë për 2014 dhe 82.15 milionë lekë për 2015. Detyrimet totale nga çelja e këtyre projekteve janë rreth 78 miliard lekë. Rikujtojmë se vlera e detyrimeve e përmendur më sipër është më shumë se 40 mld lekë, ndërsa tavanin e financimit të brendshëm për vitet 2013-2015 është 12.3 miliard lekë. Duke analizuar këto të dhëna vëmë re se edhe nëse gjithë fondet e financimit të brendshëm përdoren për shlyerjen e detyrimeve që sjellin projektet në vazhdim, në fund të vitit 2015 vlera e detyrimeve do të jetë rreth 108 miliard lekë.

Sipas informacionit të paraqitur nga DP Buxhetit theksohet se, tavanet e financimit të brendshëm prej 12,3 miliardë leke, për periudhën 2013-2015, janë paraprake dhe kanë ndryshuar, kështu vetëm për vitin 2013, për sektorin rrugëve janë planifikuar rreth 17.5 miliardë lekë.

Referuar detyrimit që kanë Njesitë e Qeverisjes së Përgjithshme për të paraqitur Kontratat në thesar për regjistrim brenda tre diteve nga lidhja e tyre (Udhëzimi standard i zbatimit të buxhetit) konstatohet se Drejtoria e Thesarit nuk disponon vlerën e sakte të detyrimeve kontraktuale të akumuluar. Realisht sistemi i Thesarit është dizenuar dhe regjistron aktualisht kontratat si angazhime dhe ato shumë vjeçare. Nga auditimi i kryer në disa degë thesari në rrethë rezultoi se, për kontratat shumëvjeçare, regjistrimi në sistemin informatik të thesarit, kryhet për vlerën totale dhe për vitin korrent në shumën e fondit të alokuar. U konstatua se për vitin buxhetor 2013 rregjistrohej vlera e mbetur e kontratës, duke mos evidentuar financimet e parashikuara që do të realizohen në vite. Pra sistemi i thesarit mundeson evidentimin e kontratatave dhe paraqitjen si detyrim për financim në vitin e ardhshëm buxhetor.

Në përfundim theksojmë që megjithëse ky fenomen ka qënë prezent si një çështje mjaft problematike në menaxhimin e fondeve buxhetore të njëjësive shpenzuese, në Raportin e projektvendimit “Për buxhetin faktik të vitit 2012” të Ministrisë së Financave zyrtarizuar me

VKM nr 506 datë 13.06.20113 “Për propozimin e projektligjit “Për buxhetin e shtetit faktik të vitit 2012 “ nuk është trajtuar çështja e detyrimeve te prapambetura ndaj palëve të treta.

VII PËR PËRGATITJEN DHE SAKTËSINË E RAPORTIT VJETOR TË KONSOLIDUAR TË ZBATIMIT TË BUXHETIT

Në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 62 e 63 përcaktohet që:

Neni 62. Ministri i Financave paraqet brenda muajit maj për miratim në Këshillin e Ministrave raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit të shoqëruar me një informacion për arritjen e objektivave, situatën e menaxhimit dhe kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm. Një kopje e raportit i dërgohet Kontrollit të Lartë të Shtetit.

Neni 63. Këshilli i Ministrave brenda muajit qershor dërgon në Kuvend raportin vjetor të konsoliduar të zbatimit të buxhetit i cili përmban:

1. Llogaritë e konsoliduara vjetore të për transaksionet financiare të shtetit.
2. Raportin për zbatimin e buxhetit vjetor në nivelin e fondeve të miratuara.
3. Raportin për borxhin publik dhe përbërjen e tij.
4. Raportin për përdorimin e fondit rezervë dhe kontigjencës.
5. Informacion për arritjen e objektivave situatën e menaxhimit dhe të kontrollit të brendshëm financiar dhe auditimit të brendshëm.

Nga verifikimi i kryer gjate auditimit ne Ministrinë e Financave mbi zbatimin e nenit 62 rezultoi se, me shkresën **nr. 8862, datë 31.05.2012** është dërguar ky raport në Këshillin e Ministrave dhe në Kontrollin e Lartë të Shtetit.

Bazuar sa më sipër është nxjerrë VKM nr. 506, datë 13.06.2013 “Për propozimin e projektligjit “Për miratimin e buxhetit faktik të shtetit të vitit 2012”, relacioni përkatës teksti i projektligjit së bashku me materialet që e shoqërojnë atë:

1. Raport vjetor i konsoliduar i buxhetit të shtetit të vitit 2012 dhe analizë per situatën makroekonomike dhe buxhetore për vitin 2012.
2. Mbi realizimin e disa treguesve kryesore qe lidhen me borxhin shtetëror për periudhën 01.01.2012-31.12.2012 .
3. Mbi përdorimin e fondit rezervë të Këshillit të Ministrave për vitin 2012.
4. Informacion për kontrollin e brendshëm financiar dhe auditimin e brendshëm.

Të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit faktik në vitin 2012, deficitin si dhe burimet e financimit të tij, referuar projektligjit te paraqitur, rezultojnë si vijon:

I. BUXHETI I SHTETIT	
- Të ardhurat gjithsej	274,260 milionë lekë
- Shpenzimet gjithsej	306,298 milionë lekë
II. BUXHETI I SIGURIMEVE SHOQËRORE	
- Të ardhurat	89,221 milionë lekë
- Shpenzimet	89,860 milionë lekë
III. BUXHETI I SIGURIMEVE SHËNDËTËSORE	
- Të ardhurat	15,648 milionë lekë
- Shpenzimet	28,828 milionë lekë
IV. DEFICITI BUXHETOR	
- <i>Financimi i deficitit buxhetor</i>	-45,857 milionë lekë
Nga i cili:	45,857 milionë lekë
I brendshëm	
A) Me instrumente financiare	26,495 milionë lekë
	24,783 milionë lekë

1. Kredi marrje nga pushtetit Qendror	24,714 milionë lekë
- Bono Thesari	8,913 milionë lekë
- Obligacione të Qeverisë 2, 3, 5, 7/vjeçare	15,801 milionë lekë
2. Kredimarrje nga pushteti vendor	69 milionë lekë
b) Të ardhura nga privatizimi	1,221 milionë lekë
c) Të tjera	491 milionë lekë
- Ndryshimi gjendjes arkës	-2,390 milionë lekë
- Të tjera	2,880 milionë lekë
2. Financimi i jashtëm neto	19,362 milionë lekë

- Llogaritë e konsoliduara vjetore dhe përmbledhësja e tyre.

Nga auditimi u konstatua se, për vitin 2012, njësitë e qeverisjes së përgjithshme, për përgatitjen e pasqyrave financiare, janë mbështetur në legjislacionin e mëposhtëm:

a. Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ndryshuar me ligjin nr. 9477, datë 09.02.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004”.

b. Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në:

- Nenin 6 “Ministri i Financave”, pika 1/d “Ministri i financave është përgjegjës për miratimin e udhëzimeve e të manualeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin në njësitë e sektorit publik, që mbulojnë në mënyrë të veçantë, procedurat standarde për një kontabilizim të plotë, të vërtetë, të saktë dhe në kohën e duhur të të gjitha transaksioneve të njërive të sektorit publik.

- Nenin 26 “Roli i Njesisë Qendrore të Harmonizimit Financiar dhe kontrollit”, pika 1/a “Kjo njësi është përgjegjëse për përgatitjen e ligjeve, të udhëzimeve dhe manualeve për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Nenin 33 “Periudha kalimtare për zbatimin e këtij ligji”, “Deri në nxjerrjen e akteve nënligjore, që përcakton ky ligj, zbatohen aktet nënligjore ekzistuese, deri në masën që nuk bien ndesh me këtë ligj, por jo më vonë se një vit nga data e hyrjes në fuqi e këtij ligji”.

c. VKM nr. 248, datë 10.04.1998 “Për miratimin e Planit Kontabël të Organeve të Pushtetit Lokal, Institucioneve Shtetërore Qendrore dhe Lokale dhe njërive që varen prej tyre”, ndryshuar me VKM nr. 25, datë 20.01.2001 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 248, datë 10.04.1998 të Këshillit të Ministrave”.

d. Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.14, datë 28.02.2006 “Për përgatitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare vjetore të vitit 2006, për institucionet qendrore, organet e pushtetit vendor dhe njërive që varen prej tyre, si dhe të njërive të menaxhimit dhe zbatimit të projekteve e me marrëveshje me donatorë të huaj”, ndryshuar me udhëzimin nr. 26, datë 27.02.2007 dhe me udhëzimin nr.10, datë 27.02.2008, “Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 14, datë 28.12.2006 dhe të udhëzimit nr. 26, datë 27.02.2007”.

Nga auditimi u konstatua se dhe për këtë vit, nuk ka udhëzim të ri për mbylljen dhe raportimin e llogarisë vjetore nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, megjithëse afati i fundit i udhëzimit të ri, në përshtatje me ligjin nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ishte më 01.01.2012, pra për mbylljen dhe raportimin e pasqyrave financiare të këtij viti duhet të ishte vepruar me udhëzim të ri.

Edhe për procesimin e transaksioneve të fundvitit, i cili dërgohet me udhëzimin e zbatimit të buxhetit vjetor, *nuk është nxjerrë udhëzim i ri*, por është vepruar me udhëzimin e një viti më parë, duke u dërguar Degëve të thesarit në rrethe, *shkresën nr. 24128, datë 27.12.2011, “Procesimi i transaksioneve të fundvitit”*, me të cilën përcaktohen datat e mbylljes dhe rakordimit të transaksioneve, e cila është e njëjtë si një vit më parë, ndryshojnë vetëm ato data që bien ditët e pushimit javor. Po me këtë shkresë udhëzohen se përveç sistemimeve, rakordimeve

të të dhënave të vitit 2010, 2011 dhe 2012, do të regjistrojnë në këtë sistem gjendjen e asetëve, të inventarëve, të të drejtave dhe detyrimeve dhe pas rakordimit me njësitë e qeverisjes së përgjithshme, do të printojnë gjendjen financiare nga sistemi, gjendje e cila do të konfirmohet nga njësia e qeverisjes së përgjithshme dhe Dega përkatëse e Thesarit.

Edhe këtë vit, përmbledhësja e pasqyrave financiare fizike të njësive të qeverisjes së përgjithshme (bilancet vjetore, apo përmbledhëset e tyre), nuk është nxjerrë, ndonëse në vitin 2010 është bërë ristrukturimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, duke krijuar Drejtorinë e Administrimit të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë dhe Drejtorinë Operacionale e cila ka në përbërje sektorin e raportimit financiar. Metodologjia e kontabilitetit është në përgjegjësi të Njesisë Qendrore të Harmonizimit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm. Kjo drejtori për këtë funksion ka vetëm një specialist.

Prodhimi i pasqyrave financiare nga Sistemi Informatik Financiar i Qeverisë, nuk paraqet të dhëna të plota dhe raportet në sistem paraqesin atë informacion, i cili është regjistruar deri tani sipas manualeve të përdorimit të sistemit, të hartuara në përputhje me metodologjinë kontabile në fuqi. Raporti i gjendjes pasurore, pra Aktivi dhe Pasivi i bilancit është konfiguruar në sistem dhe nuk është plotësuar me të gjitha të dhënat e pasqyrave financiare, (konfirmuar kjo nga Drejtoria e Thesarit). Drejtoria e Administrimit të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë, përcjell tek Degët e Thesarit, procedurat teknike të hedhjes së *aseteve fikse, inventarëve, debitorëve dhe kreditorëve dhe Degët e Thesarit kanë realizuar hedhjen e të dhënave (migration data), të paraqitura nga njësitë shpenzuese në sistem dhe pas konfirmimit “degë thesari- njësi shpenzuese” të pasqyrave financiare të gjeneruar nga sistemi, duket të procesohen automatikisht përmbledhësja e pasqyrave financiare.*

Për përgatitjen, konsolidimin e pasqyrave financiare të qeverisjes së përgjithshme dhe konsolidimin e përmbledhësës së tyre është arritur të kryhet nga sistemi, por për shkak të implikimeve e konfigurimeve në mirëmbajtje, ka mos rakordime midis të dhënave fizike me të dhënat që nxjerr sistemi, gjë që bën të domosdoshëm magazinën e të dhënave, e cila pritet të ndërtohet dhe implementohet në kuadër të projektit SETS pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit, duke bërë të mundur aksesimin e raporteve edhe nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme.

Përmbledhësja e pasqyrave financiare, ka mosrakordime, të cilat duhen rregulluar e dizenuar në bazë të një manuali të ri teknik, ku të kihen parasysh diferencat dhe mosrakordime në disa llogari si: 231 “Shpenzime për Investime”, sepse në sistem janë regjistruar vetëm shumat e investimeve për të cilat njësitë shpenzuese kanë pasur fonde për vitin ushtrimor; në llogaritë e klasës 6 të sistemit informatikë; në llogaritë e klasës 7, sepse në pasqyra financiare në sistemin informatikë, arkëtimet e raportuara nga sistemi bankar janë në modulën Cash; në llogarinë 520 “Llogari në bankë”, paraqitet në pasqyrat financiare fizike e pa kuadruar me gjendjen financiare të gjeneruar nga sistemi, për institucionet e Doganave dhe Tatimeve, pasi në këtë llogari përfshihen edhe të ardhurat tatimore që derdhen në buxhet; në llogarinë 532 “vlera të tjera” që pasqyrojnë gjendjen e letrave me vlerë, llogari e cila nuk është e pasqyruar në llogaritë e sistemit informatik; në llogaritë 531 “Gjendje arke”, 468 “Debitorë të ndryshëm”, 12 “Rezultati mbartur” - humbje ose fitim, 85 “Rezultati Ushtrimor”, 116 “Të ardhura nga shitja e Aktiveve të Qëndrueshme”, si dhe llogaria 115 “Caktime nga rezultati i vitit për investime”.

Në bilancin e gjeneruar nga sistemi, llogaria e borxhit, nuk ka të pasqyruar gjendjen e stokut të mëparshëm para se të përdorej sistemi. Pra, për pasqyrimin e borxhit të mëparshëm, për fondet speciale/ekstrabuxhetore, duhet të ketë llogari të veçantë në sistemin informatik.

Në sqarimiin e bërë nga Drejtoria e Administrimit të Sistemit Informatik Financiar të Qeverisë (SIFQ), regjistrimi i Stokut të borxhit në SIFQ, do të realizohet me përfundimin e krijimit të interface-it midis SIFQ dhe sistemit të borxhit DEMFAS, pas instalimit të këtij të fundit

VIII. ADMINISTRIMI I BUXHETIT TË PUSHTETIT VENDOR

Bazuar në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, ndryshuar me ligjin nr. 99/2012, datë 18/10/2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 26/9/2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012” dhe ligjin nr. 126/2012, datë 20/12/2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit” nr. 6, datë 7/12/2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012” të ndryshuar, buxheti vendor i vitit 2012 paraqitet:

1.	Të ardhurat	27,049 milionë lekë
	Nga të cilat:	
1.1	Granti i pakushtëzuar nga Buxheti Qendror	13,876 milionë lekë
2.	Shpenzimet	27,049 milionë lekë

Burimi: Ministria e Financave

Për vitin 2012:

1. Të ardhurat nga vetë pushteti vendor janë planifikuar në vlerën 11,073 milionë lekë, përkatësisht nga 27,049 milionë lekë shuma totale e të ardhurave të planifikuara për pushtetin vendor dhe diferenca përfaqëson Grantin e pakushtëzuar nga buxheti qendror.

Nga shuma e planifikuar janë realizuar 10,859 milionë lekë ose në masën 98.1% kundrejt tij, me një impakt deficitar në vlerë prej 213 milionë lekë. Krahasuar me të ardhurat e realizuara në vitin 2011, përkatësisht në shumën 11,792 milionë lekë, ato paraqiten me ulje në vlerë prej 933 milionë lekë më pak.

Kundrejt PBB-së të vitit 2012, të ardhurat nga vetë pushteti vendor zënë 0.81%, nga 0.90% të PBB-së që zinin në vitin 2011.

Sipas llojit të të ardhurave vendore, tre zërat kryesorë, paraqiten si më poshtë:

- Taksa lokale, rezulton me mosrealizim në masën 5.6% kundrejt planit, nga 6,580 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 6,210 milionë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 370 milionë lekë.

- Taksa mbi pasurinë (ndërtesat) paraqitet me mosrealizim në masën 6.8%, nga 2,690 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 2,506 milionë lekë, me një mosrealizim në vlerë prej 184 milionë lekë.


- Të ardhurat nga tatimi mbi biznesin e vogël paraqiten me tejkalim në masën 18.9%, nga 1,803 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 2,143 milionë lekë, me një tejkalim në vlerë prej 341 milionë lekë.

2. Shpenzimet faktike rezultojnë në shumën 27,333 milionë lekë nga 27,049 milionë lekë të planifikuara ose në masën 101.1% kundrejt planifikimit, me një tejkalim të shpenzimeve në vlerë prej 285 milionë lekë. Burimet e mbulimit të shpenzimeve të planifikuara në shumën 27,049 milionë lekë kanë qenë: - të ardhurat nga taksat dhe tarifatat vendore në shumën 11,073 milionë lekë; Fondi i Pakushtëzuar në shumën 11,575 milionë lekë; Fondi i Zhvillimit të Infrastrukturës Rurale 2,301 milionë lekë; buxheti lokal (të ardhurat e veta jotatimore) 2,000 milionë lekë; dhe buxheti lokal (të ardhura nga taksat e ndara) 100 milionë lekë.

Krahasuar me nivelin e shpenzimeve të realizuara në vitin 2011 (28,119 milionë lekë), ato rezultojnë në masën 2.8% më të ulta, e barabartë me 786 milionë lekë fond shpenzimesh në pak.

Kundrejt PPB-së të rezultuar në vitin 2012, ato zenë 2.03% të tij, nga 2.16% të PBB-së që zinin në vitin 2011.

Ecuria e realizimit të të ardhurave dhe shpenzimeve në pushtetin vendor paraqitet:



Burimi: Ministria e Financave

Për llogari të zbatimit të buxhetit të pushtetit vendor të vitit 2012, KLSH ka ushtruar auditim në 48 njësi të pushtetit vendor, përkatësisht në 26 bashki, 3 prefektura, 3 këshilla qarqesh, 13 komuna, dhe 3 drejtori të përgjithshme të punëtorëve Tiranë. Gjatë auditimeve të ushtruar, krahas punës së bërë janë konstatuar dhe mjaft të meta dhe parregullsi, të cilat kanë ndikuar në mosrealizimin e të ardhurave vendore.

Ndër mangësitë, parregullsitë dhe shkeljet me pasojë dëm ekonomik paraqesim:

VIII.1. Në fushën e të ardhurave.

1. Në mjaft njësi vendore të audituara, referuar vendimeve të Këshillave Bashkiakë dhe të Komunave të tyre për paketën fiskale, u konstatua se planifikimi i të ardhurave nga aplikimi i disa taksave dhe tarifave vendore është bërë i paargumentuar për mënyrën e llogaritjes së treguesit fiskal, siç janë:

- a) xhiroja nga subjektet e biznesit të vogël;
- b) taksa për zënie e hapësirave publike, e cila nuk shoqërohet me një dokumentacion të saktë mbi sipërfaqen që subjektet disponojnë;
- c) taksa për sipërfaqet ndihmëse në funksion të aktivitetit;
- d) taksa e ndërtesave si në subjektet e biznesit të madh dhe të vogël, ku mungon dokumenti kryesorë (certifikatë nga ZVRPP, gentplani);
- e) taksa për reklamat, si në subjektet e biznesit të madh dhe të vogël, pasi nuk ka një inventar të saktë mbi numrin e subjekteve që kanë detyrimin ligjor për pagimin e kësaj takse;
- f) tarifa e ndriçimit, gjelbërimit, pastrimit e parkingut etj.

Për pasojë, parashikimi dhe planifikimi i të ardhurave nga tarifatat dhe taksat vendore në përgjithësi është bërë me rezervë nën mundësitë reale, si në *Bashkitë: Fushë Krujë, Konispol, Manzë, Bulqizë, Këlcyrë, Bilisht dhe Komunën Libofshë*. Krahas sa më sipër, në disa njësi vendore ka rezultuar mospërfshirja në planifikim e disa lloj taksave dhe tarifave, ku cilësojmë se vetëm për katër bashki si: Çorovodë, Divjakë, Sukth dhe Kavajë, kjo vlerë llogaritet në 53,074 mijë lekë më pak.

Madje, ka njësi vendore si *Bashkia Krumë*, ku është konstatuar planifikimi i këtyre të ardhurave nën nivelin e realizimit të vitit paraardhës, ndërkohë që numri i bizneseve që ushtronin aktivitet gjatë vitin 2012 rezultonte me rritje .

Gjithashtu, u evidentuan raste si në *Komunën Zharëz Fier*, ku planifikimi i të ardhurave nga tarifatat dhe taksat mund të konsiderohet formal, pasi për tre vitet e fundit ishte planifikuar e njëjta vlerë.

2. Mbi dokumentimin e taksave dhe tarifave vendore.

Në disa njësi vendore, Zyrat e Taksave nuk kanë mbajtur dhe azhornuar regjistrat për taksat dhe tarifatat vendore sipas të dhënave për vendndodhjen, numrin e identifikimit, llojin e aktivitetit, detyrimin financiar të ndarë sipas kësteve për biznesin e vogël, si dhe detyrimet për taksat dhe tarifatat vendore. Gjithashtu, nuk janë plotësuar kartelat analitike për çdo subjekt, për të përcaktuar detyrimet përkatëse analitike, sipas kërkesave të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar, ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, i ndryshuar.

Madje, në *Bashkitë: Çorovodë, Vau i Dejës dhe Bulqizë*, nuk janë mbajtur fare regjistrat mbi taksapaguesit për taksat dhe tarifatat vendore. Kurse, në disa njësi vendore të tjera, ndonëse këto regjistra janë mbajtur, në dosjet individuale të subjekteve në disa raste mungonte dokumenti i pronësisë së ambientit, gentplani i vendosjes së objektit dhe regjistrimi në QKR. Dosjet nuk ishin të inventarizuara dhe në to nuk ishte vendosur, dokumenti i pagesës së tatimit, akt-konstatimet apo akt-verifikimet për mbylljen e aktivitetit, fatura e blerjes së kasave fiskale etj., ku për t’u përmendur *Bashkitë: Divjakë, Belsh, Fushë Krujë, Kavajë dhe Koplík*.

*Pothuajse në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore, pavarësisht vendosjes së kasave fiskale dhe rimbursimit të tyre, u konstatua se mjaft subjekte nuk i përdorin ato, për pasojë nuk ka rritje të xhiros apo detyrimeve fiskale, ç’ka bën që vendosja e tyre të mos i shërbejë qëllimit të miradministrimit të taksave dhe tarifave, si në *Bashkitë Fier, Divjakë, Belsh, Bulqizë* etj.*

Gjithashtu, në të gjitha njësitë vendore, bashki e komuna nuk është pasqyruar në kontabilitet, në fund të vitit lista e debitorëve për detyrimet tatimore, për rrjedhojë nuk ndiqet në vazhdimësi detyrimi dhe shlyerja e tij nga çdo taksapagues sipas kontabilitetit, por mbahen nga zyrat e tatim taksave në mënyrë “extrakontabël” (nga jashtë kontabilitetit)

3. Mbi bashkëpunimin dhe rakordimin me organet tatimore dhe agjentët tatimorë.

Nga auditimet e kryera në njësitë e pushtetit vendor është konstatuar mungesë rakordimi dhe bashkëpunimi me Drejtoritë Rajonale të Tatim taksave, Zyrate të Gjendjes Civile, Zyrate Rajonale të Regjistrimit të Pasurive dhe Zyrat e Kadastrave, gjë që ka ndikuar negativisht në planifikimin dhe realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifatat.

Ndër njësitë vendore paraqesim:

- *Bashkinë Divjakë*, lidhur me planifikimin e taksës së tokës bujqësore dhe taksën e ndërtesave të banimit, ku nuk u konstatua asnjë lloj bashkëpunimi me Zyrën e Kadastrës të Bashkisë dhe Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, për pasojë nuk njihet gjendja për fondin e tokës, si sipërfaqja në ha, numri i tapive të ndara, sa familje nuk paguajnë etj., siç përcaktohet në nenin 24, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore”.

- *Bashkinë Koplík*, ku nuk kish një regjistër të numrit të familjeve që kanë tokë në pronësi dhe nuk disponohej akt-verifikimi me ZVRPP-në Koplík.

- *Bashkinë Sukth*, e cila nuk kish planifikuar dhe realizuar të ardhura nga toka bujqësore me pretendimin se: “në këtë Bashki nuk janë regjistruar si prona dhe nuk është marrë certifikata e pronësisë nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës”, në kundërshtim me pikat 1 dhe 2 të nenit 23 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006. Po kështu, *Bashkia Këlcyrë*, nuk kish

planifikuar dhe realizuar të ardhura nga toka bujqësore me pretendimin se: “në këtë Bashki nuk janë regjistruar si prona dhe nuk është marrë certifikata e pronësisë nga ZVRPP”, kur në fakt Bashkia dispononte formularin 6, akt i marrjes së tokës në pronësi.

- *Bashkinë Vau Dejës*, ku të ardhurat nga taksa e tokës paraqiten me mosrealizim, si pasojë e mospajisjes me certifikatën e tokës në pronësi edhe moskoordinimin e punës midis sektorëve për mbledhjen e kësaj takse, sidomos me Zyrën e Gjendjes Civile.

- *Bashkinë Leskovik*, ku të ardhurat nga taksa e tokës janë në nivel mjaft të ulët, pasi nga zyra e taksave të Bashkisë nuk janë rakorduar të dhënat e plota me ZAMT në Qark.

4. Mbi kontrollin fiskal dhe masat ndëshkimore ndaj subjekteve të parregullta.

Njësitë e qeverisjes vendore vetë kanë konstatuar subjekte tatimore të cilët ushtrojnë aktivitet të pa licencuar dhe nuk likuidojnë detyrimet tatimore ndaj njësiteve vendore. Por, nga një pjesë e mirë e këtyre njësiteve vendore nuk zbatohen procedurat ligjore për licensimin e subjekteve dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore. Në shumë raste për vjeljen e detyrimeve tatimore ndaj subjekteve debitoare nuk janë ndërmarrë veprimet e nevojshme si: - urdhrat e bllokimit të llogarive në bankat, vendosja e barrës siguroese në Drejtorinë Rajonale të Transportit (për mjetet), apo Zyrën Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, nuk i është dërguar lista e subjekteve debitorë zyrtarisht Policisë së Bashkisë, si dhe në mjaft njësi vendore nuk është bërë llogaritja e kamat vonesave.

*Megjithëse për debitorët e taksave vendore deri në fund të vitit 2010 janë falur nga amnistia fiskale, ndërkohë pothuajse në të gjitha bashkitë dhe komunat gjatë viteve 2011-2012 janë krijuar debitorë të tjerë në vlerën **mbi 71,398 mijë lekë**, ku përmendim:*

- *Bashkitë:* - *Durrës*, në vlerën 20,550 mijë lekë; *Vau Dejës* 102 subjekte debitoare në vlerën 15,371 mijë lekë; *Divjakë* në vlerën 9,362 mijë lekë; *Fier* 192 subjekte debitoare në vlerën 5,978 mijë lekë; *Çorovodë* në vlerën 5,703 mijë lekë; *Bilisht* në vlerën 2,776 mijë lekë; *Bulqizë* 31 subjekte në vlerën 2,264 mijë lekë; *Kuçovë* 99 subjekte në vlerën 2,006 mijë lekë; *Krumë* 38 subjekte në vlerën 1,979 mijë lekë; *Koplik* 37 subjekte në vlerën 1,047 mijë lekë; *Manzë* në vlerën 1,643 mijë lekë; *Këlcyrë* 45 subjekte në vlerën 876 mijë lekë; *Belsh* 34 subjekte në vlerën 756 mijë lekë; dhe *Roskovec* në vlerën 295 mijë lekë; si dhe *Komuna Dëshnicë Përmet* 12 subjekte në vlerën 736 mijë lekë dhe *Komuna Bilisht Qendër* 6 subjekte debitoare në vlerën 34 mijë lekë.

5. Mbi realizimin dhe arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore më kryesore.

a) “*Taksa e tokës bujqësore*”, nuk është realizuar në shumën 21.975 mijë lekë përkatësisht në Bashkitë: *Divjakë* në vlerën 7,004 mijë lekë; *Fushë Krujë* 6,170 mijë lekë; *Komuna Zharrës* 4,027 mijë lekë; *Manzë* 1,654 mijë lekë; *Vau i Dejës* 998 mijë lekë; *Belsh* 884 mijë lekë; *Krumë* 880 mijë lekë; *Koplik* 336 mijë lekë; dhe *Leskovik* 22 mijë lekë.

b) “*Tarifa e pastrimit*”, nuk është realizuar përkatësisht nga Bashkitë: *Vau i Dejës* në vlerën 1,937 mijë lekë; *Këlcyrë* 564 mijë lekë; *Divjakë* 530 mijë lekë; *Manzë* 333 mijë lekë; *Sukth* 320 mijë lekë; *Leskovik* 170 mijë lekë; dhe *Komuna Xarrë* në vlerën 103 mijë lekë.

c) “*Taksa për ndërtesën*”, nuk është realizuar përkatësisht nga Bashkitë: *Fier* në vlerën 4,923 mijë lekë; *Fushë Krujë* 3,393 mijë lekë; *Kavajë* 3,000 mijë lekë; *Sukth* 2,321 mijë lekë; *Divjakë* 1,763 mijë lekë; *Koplik* 1,104 mijë lekë; *Manzë* 602 mijë lekë; *Këlcyrë* 412 mijë lekë; *Vau i Dejës* 340 mijë lekë; *Belsh* 248 mijë lekë; si dhe *Komunat Dishnicë* 76 mijë lekë dhe *Xarrë* 8 mijë lekë.

d) “*Tarifa e ndriçimit*”, nuk është realizuar nga Bashkitë: *Divjakë* në vlerën 646 mijë lekë; *Sukth* 165 mijë lekë; *Leskovik* 50 mijë lekë; dhe *Manzë* 12 mijë lekë.

e) “*Taksa e ndikimit në infrastrukturë*”, veçojmë *Bashkinë Fier* e cila ka të miratuar planin urbanistik dhe për vitin 2012 ka parashikuar 235,921 mijë lekë të ardhura nga taksa e ndikimit në

infrastruktura, kurse në fakt janë realizuar 107,261 mijë lekë ose në masën 55%, me një mosrealizim prej 128,660 mijë lekë, shkaktuar kryesisht nga mosdhënia e lejeve të ndërtimit për vitin analizues..

Cilësojmë se, si pasojë e moskrijimit të strukturave për grumbullimin e taksave vendore nga popullata, në Bashkitë e kategorisë I-rë, nuk mbledhen taksa e ndërtesave, tarifa e pastrimit, gjelbërimit, ujit të pijshëm, etj. Për t'u përmendur Bashkia Fier, e cila është e organizuar në 4 Njësi administrative (Rajone) dhe ku ka rezultuar se nuk paguajnë taksa mbi 3000 familje apo 30% e popullatës me një impakt negativ në buxhetin e kësaj Bashkie prej 7,5000,000 lekë/vit. Shtojmë se, fenomeni i mospagesës së taksave të pastrimit dhe të ndërtesave nga popullata, konstatohet pothuajse në të gjitha bashkitë.

f) Gjatë kontrolleve të ushtruara për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2012 në fushën e të ardhurave vendore, janë konstatuar dhe evidentuar shkelje të dispozitave ligjore në fuqi me pasojë dëm ekonomik në vlerën **96,972 mijë lekë**, si më poshtë vijon:

f.1) Në fushën e urbanistikës, vlera e shkeljeve llogaritet në **81,421 mijë lekë**, konstatuar në Bashkitë: Fier në vlerën 61,050 mijë lekë, Bashkinë Lezhë 15,609 mijë lekë, Vau i Dejës 4,735 mijë lekë dhe Manëz 27 mijë lekë, vlera këto që përfaqësojnë mospagesën të taksës së ndikimit në infrastrukturë.

f.2) Në fushën e administrimit të aseteve për dhënien me qira, vlera e shkeljeve rezulton 6,961 mijë lekë, konstatuar në: Drejtorinë e Përgjithshme të Punëtorëve të Qytetit nr.1 Tiranë, në vlerën 2,503 mijë lekë; Bashkitë Gjirokastrë, 490 mijë lekë, Vau i Dejës dhe Belsh respektivisht 23 mijë lekë dhe 22 mijë lekë; si dhe Komunitat Lukovë Sarandë 1,652 mijë lekë, Kolsh Kukës në vlerën 910 mijë lekë, Zharrez Fier 21 mijë lekë dhe Buçimas Pogradec në vlerën 1,340 mijë lekë, e cila përfaqëson mospagesën e vlerës së sipërfaqes pyjore dhënë me qira 5 kompanive celulare.

f.3) Në fushën e administrimit dhe grumbullimit të taksave dhe tarifave vendore, vlera e shkeljeve arrin në 8,590 mijë lekë si në Bashkitë: Sukth, në vlerën 3,131 mijë lekë; Fushë Krujë 2,460 mijë lekë; Belsh 1,189 mijë lekë; Libohovë 527 mijë lekë; Bilisht 160 mijë lekë; Kavajë 72 mijë lekë; dhe Roskovec 10 mijë lekë; si dhe në Komunitat: Libofshë dhe Zharrëz Fier, respektivisht 126 mijë lekë dhe 107 mijë lekë; dhe Kolsh Kukës 100 mijë lekë.

- Përveç sa më sipër, në Bashkinë Tiranë, si pasojë e mosgrumbullimit të të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, vlera e evazionit fiskal llogaritet në 708 mijë lekë, nga e cila 588 mijë lekë, përfaqësojnë mosvjeljen e gjobave dhe transportin me karotrec të automjeteve të bllokuara nga Policia Bashkiake, si dhe 120 mijë lekë paguar më tepër TVSH.

VIII.2 Në fushën e shpenzimeve

Në auditimet e ushtruara në fushën e shpenzimeve për llogari të zbatimit të buxhetit të vitit 2012, krahas punës së mirë dhe përpjekjeve të bëra nga administrata vendore, e pasqyruar kjo në raportet e auditimit të KLSH, janë konstatuar dhe mjaft parregullsi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi, me një dëm ekonomik në vlerë prej 97,138 mijë lekë, nga të cilat rreth 90% e tyre janë konstatuar në fushën e prokurimeve)

Duke i pasqyruar sipas natyrës se shkeljeve, ka rezultuar:

a) Në fushën e pagave dhe shpërblimeve, vlera e shkeljeve të disiplinës financiare me dëm ekonomik rezulton 4,657 mijë lekë. Sipas subjekteve ku janë konstatuar këto shkeljet paraqesim:

- Bashkitë: Fier në vlerën 848 mijë lekë, pagesa tepër për paga; Koplik 583 mijë lekë; Patos 542 mijë lekë; Krumë 324 mijë lekë; Belsh 215 mijë lekë; Kuçovë 139 mijë lekë; Manëz 56 mijë lekë; dhe Çorovodë 48 mijë lekë; Këshillin e Qarkut Kukës dhe Gjirokastrë respektivisht 1087 mijë lekë dhe 131 mijë lekë, pagesa tepër për paga; Bashkia Ballsh 147 mijë lekë, si dhe

Komunat Buçimas Pogradec, Ishëm Durrës dhe Qendër Vlorë, respektivisht 344 mijë lekë, 15 mijë lekë dhe 178 mijë lekë, pagesa tepër për paga.

b) Në fushën e shpenzimeve operative, vlera e shkeljeve ka rezultuar 5,807 mijë lekë, dhe konkretisht në:

b.1) Bashkitë: Tiranë në vlerën 1,358 mijë lekë, nga e cila 214 mijë lekë paguar tepër për udhëtim e dieta dhe 1,144 mijë lekë paguar në mënyrë të kundërligjshme për pritje përcjellje; Ballsh në vlerën 777 mijë lekë, nga e cila 315 mijë lekë paguar në mënyrë të kundërligjshme për pritje përcjellje dhe 462 mijë lekë paguar për aktivitet kulturor pa u pajisur me dokumentacionin e nevojshëm; Bulqizë në vlerën 398 mijë lekë, paguar padrejtësisht për pritje përcjellje; Koplík 331 mijë lekë, nga e cila 148 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular dhe 183 mijë lekë paguar tepër për udhëtim e dieta; Divjakë 190 mijë lekë, nga e cila 85 mijë lekë paguar karburant pa u pajisur me dokument justifikues dhe 105 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular; Belsh 162 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular; Gjirokastër 107 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular, Kuçovë 151 mijë lekë, nga e cila 66 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular dhe 85 mijë lekë pagesa pa u pajisur me dokumentacionin justifikues; Roskovec 134 mijë lekë, nga e cila 124 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular dhe 10 mijë lekë paguar tepër për udhëtim e dieta; Vau i Dejës 57 mijë lekë, nga e cila 32 mijë lekë paguar karburant pa u pajisur me dokument justifikues dhe 25 mijë lekë paguar tepër për udhëtim e dieta; dhe Krumë në vlerën 50 mijë lekë, paguar padrejtësisht për aktivitete kulturore.

b.2) Komunat Buçimas Pogradec në vlerën 446 mijë lekë, nga e cila 270 mijë lekë për telefonin celular dhe 176 mijë lekë paguar padrejtësisht për pritje përcjellje; Qendër Bilisht 221 mijë lekë, nga e cila 209 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular dhe 12 mijë lekë paguar tepër për udhëtim e dieta; Qendër Vlorë 216 mijë lekë, nga e cila 160 mijë lekë paguar medie televizive pa u pajisur me dokument justifikues dhe 56 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular; Kolsh Kukës 110 mijë lekë paguar padrejtësisht për pritje përcjellje; Libofshë 50 mijë lekë pagesa tepër për telefonin celular; Zharëz Fier 36 mijë lekë pagesa pa u pajisur me dokumentacionin justifikues; si dhe Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve nr. 2 Tiranë, në vlerën 1,013 mijë lekë përfituar më tepër se çmimi real për blerjen e artikujve solar dhe bitum.

c) Në fushën e prokurimeve, vlera e shkeljeve rezulton 86,182 mijë lekë (a+b).

Për zbatimin e buxhetit të vitit 2012, nga Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme, në subjektet e audituara nga 285 Procedura Prokurimi të zhvilluara me vlerë 4,161,588,000 lekë, janë audituar 115 procedura prokurimi me vlerë 2,993,373,000 lekë, përkatësisht 40% të numrit dhe 72% të vlerës së prokuruar. Nga auditimi i këtyre procedurave u konstatuan dhe rezultuan me shkelje 112 procedura prokurimi me një efekt financiar prej 86,182 mijë lekë, shkaktuar si pasojë e shkeljeve të rregullave të prokurimit publik, në drejtimet e mëposhtme:

- Moslllogaritje të vlerës së kontratës, në kundërshtim me nenin 28 të Ligjit Prokurimit Publik në 47 procedura prokurimi.

- Moszbatim të nenit 12 të LPP “Organizimi i prokurimit publik”, në 13 procedura prokurimi.

- Hartimin e dokumenteve të tenderave, në kundërshtim me kërkesat e nenin 41 “Dokumentet e tenderit”, të LPP, në 33 procedura prokurimi.

- Hartimin dhe përcaktimin e specifikimeve teknike, jo në përputhje me kërkesat e nenit 23 “Specifikimet teknike”, të LPP, në 24 procedura prokurimi.

- Në kualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomikë, në 55 procedura prokurimi.

- Në skualifikimin e padrejtë të operatorëve ekonomikë, në kundërshtim me nenin 47 “Skualifikimi i ofertuesve”, të LPP, në 61 procedura prokurimi.

- Në hapjen dhe shqyrtimin e ofertave konkurruese, në kundërshtim me kërkesat e neneve 52 dhe 53 të LPP, në 32 procedura prokurimi,

- Në shqyrtimin e ofertave konkurruese, jo në përputhje me kërkesat e nenit 56 “Oferta anomalish e ulët”, të LPP , në 15 procedura prokurimi
- Në mbikëqyrjen dhe zbatimin e kontratave në 15 procedura prokurimi.
- Në mosarkivimin e dosjeve në 15 procedura prokurimi.

Sipas subjekteve të audituar ku është konstatuar dhe evidentuar dëmi ekonomik, llojet e shkeljeve dhe vlerat respektive, rezulton:

c.1) Nga 11 autoritete kontraktore janë kualifikuar dhe nxjerrë fitues padrejtësisht operatorë ekonomikë me vlerë më të lartë, duke shkaktuar një dëm prej 63,775 mijë lekë, dhe konkretisht në Bashkitë: Durrës në vlerën 29,416 mijë lekë; Kavajë 15,280 mijë lekë; Vau i Dejës 1,296 mijë lekë; Koplik 1,042 mijë lekë; Kuçovë 291 mijë lekë; Fier 127 mijë lekë; Bulqizë 371 mijë lekë; Libohovë 650 mijë lekë; Komunitat Gjinat Elbasan 11,840 mijë lekë dhe Zharëz Fier 1,677 mijë lekë; si dhe Drejtoria e Përgjithshme Punëtorëve nr. 1 Tiranë në vlerën 1,785 mijë lekë.

c.2) Nga 10 operatorë teknikë, zbatues punimesh, janë raportuar punime ndërtimi më tepër se sa realizimi në fakt, duke përfituar padrejtësisht vlerën prej 22,407 mijë lekë, përkatësisht në Bashkitë: Tiranë në vlerën 12,594 mijë lekë, paguar më tepër për TVSH edhe pajisjet; Vau-Dejës 1,786 mijë lekë; Belsh 1,890 mijë lekë; Kuçovë 887 mijë lekë; Krujë 348 mijë lekë; Fier 297 mijë lekë; Fush-Arrëz 170 mijë lekë; Koplik 96 mijë lekë; Bashkia Patos, në vlerën 3,768 mijë lekë, sa llogaritur penalitete për mos dorëzimi objekt ndërtimor në afat; Komuna Lukovë Sarandë dhe Qendër Vlorë, respektivisht, në vlerën 515 mijë lekë dhe 56 mijë lekë .

d) Të tjera në vlerën 492 mijë lekë, e cila përfaqëson diferenca e mallrave dhe materialeve në magazinë, respektivisht, në Komunën Kuçovë në vlerën 332 mijë lekë dhe Lukovë Sarandë 160 mijë lekë.

Së fundi, cilësojmë se në Bashkinë Tiranë, financimi i projekteve është bërë i tillë që realizimi i tyre të shtrihet në më shumë se 2-3 vite buxhetore. Për më tepër, nuk ka një analizë të borxhit të krijuar në çdo vit si rezultat i kufizimit të aftësisë paguese dhe faktorët që kanë ndikuar në krijimin e kësaj vështirësie financiare, kur në bilancin e Aparatit të Bashkisë Tiranë, rezulton se në fund të vitit 2012, ishte akumuluar një borxh në vlerë prej 1,029,644,000 lekë, nga të cilat 641,059,000 lekë për mallra dhe shërbime dhe 379,585,000 lekë për investime. Sipas të dhënave të paraqitura rezulton se më datën 31.07.2011 kanë qënë 609,000,000 lekë fatura të palikujduara respektivisht, për shpenzime operative në vlerën 84,000,000 lekë dhe 525,000,000 për investime.

IX. ADMINISTRIMI I BUXHETIT TË SIGURIMEVE SHOQËRORE DHE SHËNDETËSORE

Miratimi i buxhetit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore është bërë me ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, ligjin nr. 99/2012, datë 18/10/2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit nr. 5, datë 26/9/2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012” shpallur me Dekretin e Presidentit nr. 7803, datë 30/10/2012. Gjithashtu janë bërë ndryshime me ligjin nr. 126/2012, datë 20/12/2012 “Për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit” nr. 6, datë 7/12/2012 të Këshillit të Ministrave “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10487, datë 5/12/2011 “Për buxhetin e vitit 2012” të ndryshuar, shpallur me Dekretin e Presidentit nr. 7915, datë 07/01/2013. Referuar këtyre dispozitave ligjore, pas ndryshimeve përfundimtare, programi financiar për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, paraqitet si më poshtë vijon:

1. Për sigurimet shoqërore

Të ardhurat gjithsej	Shpenzimet gjithsej
Janë programuar në shumën 88,765 milionë lekë , nga të cilat nga mbledhja e kontributeve 50,577 milionë lekë dhe transferta e buxhetit të shtetit 38,188 milionë lekë.	Janë programuar në vlerën 88,765 milionë lekë , nga të cilat për skemën e sigurimit të detyrueshëm 83,360 milionë lekë dhe skemën e sigurimit suplementare 5,405 milionë lekë. Këto shpenzime janë planifikuar të përballohen me të ardhurat e programuara si më sipër

2. Për sigurimet shëndetësore

Të ardhurat gjithsej	Shpenzimet gjithsej
Janë programuar në shumën 28,934 milionë lekë , nga të cilat nga mbledhja e kontributeve 6,436 milionë lekë, transferta e buxhetit të shtetit 22,498 milionë lekë.	Janë programuar në vlerën 28,934 milionë lekë , nga të cilat për financimin e shërbimit spitalor 13,371 milionë lekë; financimin e kujdesit shëndetësor parësor 6,650 milionë lekë; rimbursimin e barnave 7,446 milionë lekë; financimin e spitalit të Durrësit 685 milionë lekë; investime 100 milionë lekë; dhe shpenzime administrative 682 milionë lekë. Këto shpenzime janë planifikuar të përballohen me të ardhurat e programuara si më sipër.

Sipas të dhënave të raportuara nga Ministria e Financave (tabela fiskale sipas buxhetit të konsoliduar), niveli i realizimit të vitit 2012, paraqitet:

1.1 Për Sigurimet Shoqërore

Të ardhurat gjithsej janë realizuar në masën 97.9%, me një mosrealizim prej 1,044 milionë lekë, ndërsa transferta nga buxheti i shtetit në shumën 39,688 milionë lekë. Ndërsa, shpenzimet janë realizuar në masën 99.6%, me një mosrealizim prej 405 milionë lekë.

2.1 Për Sigurimet Shëndetësore

Të ardhurat janë realizuar në masën 102.4%, me një tejkalim prej 154 milionë lekë; ndërsa, shpenzimet në masën 99.6%, me një mosrealizim prej 106 milionë lekë.

Në totalin e të ardhurave tatimore gjithsej, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore zenë rreth 17.7% të totalit të të ardhurave tatimore dhe 51% të totalit të të ardhurave tatimore të realizuar nga DPT.

Plani i të ardhurave të vitit 2012 nga kontributet është realizuar në masën 100.3%, me një tejkalim në vlerë prej 172 milion lekë. Këto të ardhura, në krahasim me faktin e vitit 2011 (realizimi faktik 51,527 milion lekë) rezulton me rritje në shumën 1,588 milionë lekë, ose në masën 3% më shumë.

Në totalin e të ardhurave nga kontributet, pesha specifike e të ardhurave të realizuara nga kontributet shtet dhe kontributet privat, në vitin 2011 dhe vitin 2012, mbetet në të njëjtin raport 49% me 51%, si më poshtë:

		<i>në milionë/lekë</i>		
KONTRIBUTE SIPAS SEKTORËVE	VITI 2011		VITI 2012	
Sektori shtetëror (kontribute)	25,341	49%	25,768	49%
Sektori privat (kontribute)	26,185	51%	27,346	51%
Totali	51,526		53,114	

Të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore në vitin 2012 në shumën 53,114 milionë lekë, janë realizuar nga: sektori shtetëror në vlerën 25,768 milionë lekë ose 49% e të ardhurave, për një numër mesatar kontribuesish prej 159,160 dhe me një nivel mesatar pagese për kontribues prej 162 mijë lekë/vit dhe nga sektori privat në vlerën 27,346 milionë lekë ose 51% e të ardhurave, për një numër mesatar kontribuesish prej 267,982 dhe me një nivel pagese për kontribues prej 102 mijë lekë/vit. Ndërkohë, numrin mesatar mujor i kontribuesve sipas viteve 2011 dhe 2012, praqitet si më poshtë:

EMERTIMI	VITI 2011		VITI 2012	
Ndërmarrjet buxhetore	139,387		138,614	
Ndërmarrjet shtetërore	21,712		20,546	
Subjekte private	254,258		267,982	
Gjithsej:	415,357		427,142	

Nga këto të dhëna, konstatohet pakësimi i kontribuesve nga ndërmarrjet buxhetore dhe shtetërore në vitin 2012 kundrejt vitit 2011 dhe një rritje në masën 5.4% të kontribuesve nga subjektet private dhe në numër prej 13,724 kontribues më tepër në vitin 2012 krahasuar me vitin 2011. Vlen për t'u cilësuar se në auditimet e kryera dhe të evaduar nga KLSH në ISSH dhe në ISKSH për llogari të buxhetit të vitit 2012, ndonëse në raste dhe në vlera të vogla, shkeljet e dispozitave ligjore në fuqi me pasojë **dëm ekonomik rezultojnë në vlerën 1,234 mijë lekë, tërësisht në ISKSH** (e raportuar si gjetje në pjesën e “Administrimi i shpenzimeve të buxhetit të shtetit”).

IX.1 Buxheti i sigurimeve shoqërore

Buxheti i Sigurimeve Shoqërore në tërësi hartohet mbi bazën e programeve dhe metodikave të përcaktuara me ligj dhe me udhëzimet përkatëse të nxjerra nga MF-ve. Gjithashtu, ndryshimet gjatë vitit në shtesë dhe pakësim të të ardhurave dhe shpenzimeve, bëhen në mbështetje të akteve ligjore në fuqi dhe akteve nënligjore të dala enkas për çdo ndryshim.

1. Të ardhurat e fondit të Sigurimeve Shoqërore të detyrueshme dhe suplementare me buxhetin fillestar 2012, janë përcaktuar në shumën **51,577 milionë lekë**, nga e cila

Sigurime të detyrueshme	51,287 milionë lekë
Sigurime suplementare	290 milionë lekë

2. Shpenzimet për ISSH-në janë përcaktuar 89,765 milionë lekë, nga e cila:

Sigurimi shoqëror i detyrueshëm dhe programet	84,360 milionë lekë
Sigurimet suplementare e trajtimet	5,405 milionë lekë

3. Balancimi i buxhetit të të ardhurave me shpenzimet (deficiti) mbulohen me financime buxhetore të formës së kontributeve, financimeve programore dhe subvencioneve, të cilat për vitin 2012 janë përcaktuar në shumën **38, 188 milionë lekë.**

Ky program, gjatë vitit ka ndryshuar në shtesë dhe pakësim, si më poshtë: me VKM-në nr. 387, datë 27.06.2012 “Për rritjen e pensioneve”, programi buxhetor i ISSH për vitin 2012 është shtuar

me 1,500 milionë leke, nga te cilat 1,484 milionë lekë për financimin e rritjes së pensioneve dhe 16 milionë lekë për pagesën e komisioneve të shërbimit për Postën Shqiptare, me Aktin Normativ nr. 6, datë 12.12.2012 “Për disa ndryshime në ligjin nr.10487, datë 5.12.2011, “Për buxhetin e vitit 2012”, shpenzimet fillestare janë pakësuar me 1,000 milionë lekë, ndërsa financimet buxhetore janë mbajtur të pa ndryshuara për arsye se edhe programi i të ardhurave është pakësuar me 1,000 milionë lekë, me VKM-në nr. 974, datë 19.12.2012 “Për dhënie asistence ekonomike të menjëhershme personave që përfitojnë pension” buxheti i shpenzimeve të zbatuara nga ISSH për vitin 2012 është shtuar me 1,170 milionë lekë, e cila do të përdoret 1,157.4 milionë lekë për asistencën e menjëhershme të pensionistëve dhe 12.6 milionë lekë për mbulimin e komisioneve të shërbimit të pagesave dhe për shpenzimet e administrimit të tyre.

Pas këtyre ndryshimeve, buxheti përfundimtar për ISSH për vitin 2012, paraqitet:

Të ardhurat e fondit të Sigurimeve Shoqërore të detyrueshme dhe suplementare	50,577 milionë lekë
Shpenzimet për ISSH-në	90,256 milionë lekë
Deficiti i të ardhurave me shpenzimet i cili mbulohet nga buxheti	39,688 milionë lekë

Ky buxhet përfundimtar, i ndarë sipas zërave kryesore, paraqitet:

Nr.	Emërtimi	Plani fillestar	Plani me ndryshime sipas VKM-ve	Plani me ndryshime sipas aktit normative	Plani përfundimtar me ndryshime
I.	SKEMA E DETYRUESHME				
a.	TE ARDHURA	84,360	0.0	-700	85,160
	- Nga kontributet	51,287	0.0	-1,000	50,287
	- Transferte nga buxheti	33,073	1,500	300	34,873
b.	SHPENZIMET	84,360	1,500	-700	85,160
II.	SKEMA SUPLEMENTARE				
a.	TE ARDHURA	5,405	0.0	-300	5,105
	Nga kontributet	290	0.0	0.0	290
	Transferte nga buxheti	5,115	0.0	-300	4,815
b.	SHPENZIMET	5,405	0.0	-300	5,105
III.	GJITHSEJ				
a.	TE ARDHURA	89,765	0.0	-1,000	90,265
	Nga kontributet	51,577	0.0	-1,000	50,577
	Transferte nga buxheti	38,188	1,500	0.0	39,688
b.	SHPENZIMET	89,765	1,500	-1,000	90,265

Ndryshimet në buxhetin e sigurimeve shoqërore të këtij viti kanë sjellë si pasojë ndryshime edhe nga detajimi fillestar i fondeve por brënda limiteve të miratuara, si më poshtë:

	SHPENZIMET	PLAN
I.	SHPENZIME PER PERFITIME	74,184.8
1.	Shpenzime për Semundje	379.4
2.	Shpenzime për Barrelindje	2,083.5
3.	Shpensimet për Pensione	71,707.9
4.	Shpenzime për Pensione Qytet	58,338.8
5.	Shpenzime për Pensione Fshat	13,369.1
6.	Shpensimet për Aksidente e Sëmundje Profesionale	14.0

II.	PER PROGRAMET E TJERA	9,158.9
1.	Pensione Speciale e te Posaçme	88.6
2.	Shperblime te Invalideve te Luftes dhe Vetereaneve	377.9
3.	Shtese nga Statusi i Invalidit te Punes	50.7
4.	Kompensime	8,641.6
5.	Kompensime per Pensione Qytet	7,456.3
6.	Kompensime per Pensione Fshat	1,185.3
III.	SHPENZIME ADMINISTRATIVE	1,816.0
1.	Paga, Shperblime dhe Shpenzime te tjera Personeli	886.8
2.	Kontribute per Sigurime Shoqerore e Shendetesore	136.6
3.	Mallra dhe Sherbime te tjera	691.3
4.	Per Rritjen e Aktiveve te Qendrushme te Trupezuara	101.3
IV.	SHPENZIME PER SKEMA SUPLEMENTARE	5,105.3
1.	Sigurime suplementare te ushtarakeve MM	3,000
2.	Sigurime suplementare MÇPS e trajtime	2,105
TOTALI:		90,265.0

Më poshtë pasqyrojmë rezultatet e auditimit të kryer mbi zbatimin e planit për të ardhurat, shpenzimet, rezultatit financiar të sistemit të sigurimeve shoqërore në tërësi dhe deficitin e pensioneve në veçanti

A.1 Mbi të Ardhurat

Mbledhja e të ardhurave të planifikuara për vitin 2012 në shumën 51,557 milionë lekë, do të bëhet nga: *Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve për shumën 48,604 milionë lekë dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për shumën 2,973 milionë lekë.*

Të ardhurat e ngarkuara për t'u mbledhur nga DPT, përfaqësojnë fondin e sigurimeve shoqërore nga kontributet e detyrueshme, ndërsa të ardhurat e ngarkuara për t'u mbledhur nga ISSH përfaqësojnë kontributet e sigurimeve shoqërore për personat e vetëpunësuar në bujqësi. Po kështu, ISSH-se i është ngarkuar edhe mbledhja e të ardhurave për sigurimet shëndetësore të fermerëve të planifikuar në shumën 190 milionë lekë. Në total, programi i të ardhurave të vitit 2012 për t'u realizuar nga ISSH është 3,163 milionë lekë.

Në zbatim të Aktit Normativ nr. 6, datë 12.12.2012 "Për disa ndryshime në ligjin nr.10487, datë 5.12.2011 "Për buxhetin e vitit 2012", plani i të ardhurave nga kontributet e sigurimeve shoqërore që mbledhen nga DPT, ka ndryshuar duke u ulur me 1,000 milionë lekë, konkretisht: nga 51,577 milionë lekë të planifikuara në fillim të vitit është ndryshuar duke u ulur në 50,577 milionë lekë. *Nga këto 47,604 milionë lekë është lënë limiti për t'u mbledhur nga DPT dhe 2,973 milionë lekë limiti i lënë ISSH-së.*

Shumës prej 50,577 milionë lekë i shtohet edhe shuma prej 190 milionë lekë që ISSH është e ngarkuar të arkëtojë për llogari të ISKSH, pra ISSH sipas dispozitave ligjore të sipërcituar duhet të grumbullojë ***për vitin 2012 gjithsej 50,767 milionë lekë.***

Bazuar në bilancin financiar të ISSH-së, të ardhurat gjithsej për vitin 2012, ku përfshihen kontributet e sigurimit shoqëror, kontributet e sigurimeve shëndetësore të fermerëve dhe të ardhurat e tjera, nga 50,767 milionë lekë të planifikuara janë realizuar 49,322 milionë lekë ose në masën 97.2%, ***me një mosrealizim prej 1,445 milionë lekë***

Të ndara sipas përgjegjësisë, rezulton si më poshtë:

1. Për DPT, nga 47,604 milionë lekë të ardhura të programuara, janë realizuar 46,438 mijë lekë ose në masën 97.6%, ***me një mosrealizim prej 1,166 milionë lekë.***

2. Për ISSH, nga 3,163 milionë lekë të ardhura të programuara, janë realizuar 2,884 milionë lekë ose në masën 91.2%, **me një mosrealizim prej 279 milionë lekë.**

A.1.1 Zbatimi i Programit të të ardhurave nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Që nga viti 2005 mbledhja dhe administrimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të personave publik, juridike e fizike (kontributet e detyrueshme) dhe mbledhja e borxheve të periudhave të mëparshme e të atyre në vazhdim, ka kaluar në DPT. Marrëdhëniet midis ISSH dhe DPT rregullohen me VKM-në nr. 1114, date 30.7.2008 “Për disa çështje në zbatim të ligjeve nr.7703, date 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në RSH”, i ndryshuar, me ligjin nr.9136, date 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në RSH”, me udhëzimet e Ministrit të Financave për buxhetet vjetore dhe në bazë marrëveshjeve të lidhura midis palëve.

Programi i të ardhurave nga kontributet si dhe ndarja e tij në muaj është hartuar nga MF-ve dhe DPT. ISSH-ja është njoftuar për planin e të ardhurave të ndare sipas muajve, me shkresën e MF-ve nr.112, date 5.1.2012 “Detajimi i planit të të ardhurave, për vitin 2012” dhe shkresën nr.112/3, date 17.1.2012 “Ridetajimi i planit të të ardhurave, për vitin 2012”. Më poshtë paraqesim planin e të ardhurave dhe realizimin e tyre për vitin 2012, nga çdo Drejtori Rajonale Tatimore, si vijon:

Nr.	Rajonet	DPT dhe Drejtoritë Rajonale Tatimore			
		Plan	Fakt	Në %	Diferenca
1.	BERAT	1,488,000	1,350,349	91	-137,651
2.	DIBER	1,127,300	1,081,618	96	-45,682
3.	DURRES	3,437,800	3,380,179	98	-57,621
4.	ELBASAN	2,530,700	2,374,686	94	-156,014
5.	FIER	2,740,300	2,461,541	90	-278,759
6.	GJIROKASTER	1,108,600	1,026,497	93	-82,103
7.	KORCE	2,261,400	2,110,599	93	-150,801
8.	KUKES	790,300	747,654	95	-42,646
9.	LEZHE	1,335,800	1,204,704	90	-131,096
10.	SHKODER	2,357,900	2,226,404	94	-131,496
11.	TIRANE	25,970,700	25,679,447	99	-291,253
12.	VLORE	2,455,200	2,324,457	95	-130,743
Gjithsej DRT-të:		47,604,000	45,968,135	97	-1,635,865
DPT të tjera:		-	470,084		470,084
TOTALI		47,604,000	46,438,219	97.6	-1,165,781

Nga të dhënat e mësipërme, plani me ndryshime 47,604 milionë lekë është realizuar 97,6%, me një mosrealizim prej **1,166 milionë lekë.**

Ky nivel mosrealizimi është shkaktuar kryesisht nga mosrealizimi i numrit të programuar të kontribuuesve dhe gjendja e debitorëve të mbartura dhe të krijuar gjatë vitit 2012, në organet tatimore, si rrjedhojë e mospagesës së kontributeve. Kështu

- 1.** Numri i kontribuuesve të subjekteve që janë në përgjegjësi të DPT në vitin 2012, është realizuar 427,150 kontribues nga 456,157 kontribues që ishin të programuar, **me një diferencë prej 29,007 kontribues të cilët mungojnë dhe nuk janë të regjistruar si debitorë.** Kjo diferencë është konstatuar vetëm në numrin e kontribuuesve në sektorin privat, pasi numri i kontribuuesve në sektorin publik është realizuar në masën 100% dhe në numër janë 159,161 kontribues.

2. Ne fund te vitit 2012, gjendja debitore si pasoje e kontributeve te paarketuara te mbartura para vitit 2005 ne ISSH është në shumen 382.7 milione lekë dhe pas vitit 2005 deri *ne mbyllje te vitit ushtrimor 2012 rezulton 8,054 milionë lekë.*

Të dhënat për numrin e subjekteve dhe numrin e kontribuesve, të ndara sipas DRT-ve të marra nga evidenca e DPT te administruar ne ISSH, për sektorin privat, janë si me poshtë:

Nr.	DRSSH	Numri i subjekteve Juridike	Numri i kontribuesve	Numri mesatar /subjekt	Numri i subjekteve Fizike	Numri i kontribuesve	Numri mesatar /subjekt
1	BERAT	456	3,599	7.9	3,698	4,222	1.1
2	DIBER	301	2,548	8.5	1,199	1,293	1.1
3	DURRES	1,649	16,973	10.3	5,706	7,164	1.3
4	ELBASAN	866	5,543	6.4	5,314	6,110	1.1
5	FIER	1,275	8,386	6.6	6,820	7,775	1.1
6	GJIROKASTER	419	2,902	6.9	1,637	1,826	1.1
7	KORÇE	746	6,569	8.8	4,728	5,202	1.1
8	KUKES	152	1,112	7.3	403	506	1.3
9	LEZHE	577	3,792	6.6	2,069	2,485	1.2
10	SHKODER	949	8,934	9.4	3,635	4,075	1.1
11	TIRANE	6,962	120,212	17.3	20,835	32,547	1.6
12	VLORE	1,347	8,062	6.0	5,324	6,152	1.2
	Shuma:	15,699	188,632	12.0	61,368	79,357	1.3

Siç shihet nga të dhënat e mësipërme, për vitin 2012 janë 15,699 subjekte juridike qe paguajnë kontribute për 188,632 persona ose mesatarisht 12 punonjës për subjekt; ndërsa 61,368 janë subjekte fizike qe paguajnë kontribute për 79,357 persona ose afërsisht 1,3 punonjës për subjekt.

Nga auditimi i kryer i cili u bazua ne te dhënat mujore te dërguara nga DRT-të, dhe konkretisht ne listat mujore te derdhjeve te kontributeve te subjekteve te biznesit te madh dhe listat tremujore e derdhjeve te kontributeve te sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore te subjekteve te biznesit te vogël, rezultoi se:

- *Ne 15,699 subjekte pagues te biznesit te madh në shkallë vendi*, numri i kontribues/paguesve për këto është 188,632 persona. Numri i subjekteve qe kane një te punësuar është 2,870 ose 18.28% ndaj totalit te subjekteve. Numri i subjekteve me dy persona e lart te punësuar është 12,676 ose 81.7% ndaj totalit te subjekteve.

- *Ne 15,699 subjekte pagues te biznesit te madh*, numri i subjekteve qe paguajnë kontribute në kufijtë e pagës minimale është 3,377 ose 21.5% ndaj totalit te tyre. Numri i te punësuarve ne këto subjekte qe sigurohen me pagën minimale është 35,392 persona, ose 18.76% ndaj numrit gjithsej te kontributpaguesve.

- *Ne 61,368 subjekte pagues te biznesit te vogël ne shkallë vendi*, numri i kontribues/paguesve për këto subjekte është 79,390 persona. Numri i subjekteve me një te punësuar është 37,572 ose 61.2% ndaj totalit te subjekteve. Numri i subjekteve me dy persona e lart te punësuar, eshte 23,796 ose 38.77% ndaj totalit te subjekteve.

- *Numri i subjekteve fizike qe paguajnë kontribute ne kufijtë e pagës minimale është 42,044 ose 68.5% ndaj totalit te tyre që janë subjekte pa punëmarrës.* Numri i te punësuarve ne këto subjekte qe sigurohen në kufirin e pagës minimale është 56,542 persona ose 71.2% ndaj numrit gjithsej te kontribut/paguesve. *(Vlen te theksojmë se, ne te treguesit e mësipërm nuk janë përfshiredhe trajtuar subjektet e pa regjistruara dhe të pa licencuara, pasi ato janë të pa evidentuara nga DPT).*

Treguesit e mësipërm, kanë ndryshime nga njëri rajoni në tjetrin dhe shkalla e informalitetit është e ndryshme, kjo tregon për diferencime në punën që kryhet për eliminimin e tregut informal të punës nga DPT. *Informaliteti financiar që vjen nga diferenca midis pagës që derdhen kontributet, me pagën reale mujore që marrin të punësuarit, është i vështirë për t'u evidentuar saktësisht nga auditimi, pasi nuk disponohen të dhëna analitike për numrin e kontribuesve sipas pagës faktike nga DPT. Por mjafton të analizojmë vetëm rritjen e pagës minimale, do të konstatohet një evazion fiskal i konsiderueshëm.* Konkretisht, të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore që mblihen nga DPT, sipas evidencës financiare të DPT në vitin 2012 ndaj vitit 2011, janë rritur me 3% ose 1,587 milionë lekë më shumë (53,114 milionë lekë - 51,527 milionë lekë). Ndërkohe që, me VKM, paga minimale në vitin 2012 është rritur me 4,76% (22 mijë lekë - 21 mijë lekë : 21 mijë lekë), pra krahasuar me vitin 2011 efekti financiar është me pak për 1.7% ose në vlerën rreth 865 milion leke. Pra, ky tregues nxjerr në dukje evazionin nga mos derdhja e kontributeve mbi bazën e pagës faktike.

Duke qëndruar në këtë kontekst, nga auditimi që ju bë të dhënave në listepagesa dhe në evidencat përmbledhëse të biznesit të vogël dhe biznesit të madh, del qartë se në shumë subjekte, pagat referuese që zbatohen për të punësuarit në përgjithësi janë me të ulta se pagat faktike mujore që këta të punësuar marrin në fakt, me konkretisht përmendim disa rajone:

Në subjektet e biznesit të madh:

Kanë numrin më të madh të subjekteve me 1 kontribues rajonet: Lezhë me 27.2%, Durrës me 21.34%, Fier me 20%, Shkodër me 20% dhe Elbasan me 19.86%.

Kanë numrin më të madh të subjekteve që paguajnë punonjësit e tyre me pagën minimale, rajonet: Berat me 81% të subjekteve, Korçë me 74%, Dibër me 64.8%, Lezhë me 58.8%, Shkodër me 58.6%, Gjirokastër me 54.4% dhe Durrës me 51% të numrit të subjekteve.

Paguhen me pagë minimale në një masë më të madhe punonjësit e rajoneve: Berat me 77.5% të punonjësve, Shkodër me 68%, Gjirokastër me 56% dhe Korçë me 55.8% të punonjësve.

Në subjektet e biznesit të vogël:

Kanë vetëm një kontribues me përqindje të konsiderueshme rajonet: Berat me 96% të subjekteve, Shkodër me 90%, Gjirokastër me 80% të subjekteve, Dibër dhe Lezhë me 78.5% të subjekteve, si dhe Korçë me 72.3% të subjekteve.

Sa më sipër, del konkluzioni se: Informaliteti financiar që vjen nga mosrealizimi i numrit të programuar të kontribuesve të sektorit privat dhe nga diferenca midis pagës që derdhen kontributet, me pagën reale mujore që marrin të punësuarit në sektorin privat, kanë sjell një nivel të lartë të evazionit fiskal, me pasoje krijimin e një deficitit të konsiderueshëm në skemën e sigurimeve shoqërore.

Situata e debitorëve

Në fund të vitit 2012, gjëndja debitore si pasojë e mosderdhjes së kontributeve e shtrirë në kohë dhe të kamatevonesave rezulton në total 8,922.7 milionë lekë. Kjo shumë përbëhet nga: *Kontributet e paarketuara para vitit 2005 dhe të mbartura në ISSH në shumen 382.7 milionë lekë dhe Kontributet e paarketuara pas vitit 2005 të krijuara nga DPT në shumen 8,054 milionë lekë.*

Nga auditimi u konstatua se:

1. *Kontributet e paarketuara para vitit 2005 të mbartura në ISSH, gjatë vitit 2012, në zbatim të ligjit, nr.10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor” dhe të pikës 6, të VKM nr.477, date 30.6.2010 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.1114, datë 30.7.2008”, ISSH ka bashkëpunuar me DPT për venien nën arketim të subjekteve aktive debitore të mbartura para viti 2005 në ISSH, duke transferuar në*

organet tatimore 27 subjekte debitorë që i përkasin DRSSH Shkodër, Berat, Gjirokastrë dhe Lezhë, për shumën 2,869 mijë lekë.

Po kështu, në zbatim të shkresës së ISSH, nr.7677, datë 7.11.2012 “Për zbatimin e detyrave të lëna nga KLSH për subjektet debitorë dhe detyrimet e tyre të prapambetura”, DRSSH-të gjatë periudhës nëntor-dhjetor 2012, kanë bërë riinventarizimin e të gjithë subjekteve debitorë dhe të detyrimeve të tyre të prapambetura.

Nga rivleresimi i detyrimeve dhe dokumentacionit rezultoi se, janë pakësuar gjithsej 551 subjekte debitorë së bashku me detyrimet e tyre të prapambetura në shumën totale prej 150,776 mijë lekë. Për pasojë, gjendja e detyrimeve në fund të vitit 2012 në ISSH të mbartura para vitit 2005 është në shumën 382,731 mijë lekë, si me poshtë:

në mijë/lekë

Nr.	Emertimi	Numri i Subjekteve	Gjithsej	Nga keto:	
				Kontribut	Kamatë
1.	Gjendja më 1.1.2012	838	536,399	505,002	31,397
2.	Shtesat e periudhës	0.0	0.0	0.0	0.0
3.	Pakesimet e periudhës	579	153,668	153,296	372
4.	Gjendja me 31.12.2012	259	382,731	351,706	31,025

Me gjithë punën e mirë të bërë gjatë vitit 2012 për pakësimin e detyrimeve të prapambetura, ISSH duhet të përfitojë edhe nga ligji nr.10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”, i cili i ka shtrirë efektin e zbatimit deri në dhjetor të vitit 2013, si dhe të bashkëpunojë me DPT për:

- *Te evidentuar dhe grupuar numrin e subjekteve debitorë dhe te detyrimeve të tyre të mbetura në llogaritë e organeve të sigurimeve shoqërore para vitit 2005, si dhe transferimin e atyre subjekteve debitorë aktivë në organet tatimore, me qëllim sistemimin përfundimtar dhe arkëtimin e detyrimeve të cilat sa do pak, ndikojnë direkt në rritje të deficitit vjetor pasi këto detyrime planifikohen si të ardhura nga kontributet për çdo vit buxhetor.*

2. Kontributet e paarketuara pas vitit 2005 të krijuara nga DPT.

Në zbatim të pikës 7, të VKM nr. 477, datë 30.06.2010, DPT ka dërguar në ISSH, totalin e detyrimeve si pasojë e kontributeve të sigurimeve shoqërore shëndetësore të pa paguara në afat të cilat në mënyrë të përmbledhur paraqiten në pasqyrën e më poshtme:

Njësia në numër dhe mijë/lekë

Nr	Emertimi	Situata me 28.02.2012		Situata me 31.12.2012		Diferencat	
		Numri i subjekteve debitorë	DEBIA deri 28.02.2012	Numri i subjekteve debitorë	DEBIA deri 31.12.2012	Krahasuese ndermjet 31.12.2012 dhe 28.02.2012	
						Numer	Në mijë/leke
1.	Biznesi i Madh	17,206	6,638,308	14,714	6,577,184	(2,492)	(61,124)
2.	Biznesi i Vogël	28,756	1,763,202	25,535	1,476,846	(3,221)	(286,356)
	Shuma:	45,962	8,401,510	40,249	8,054,030	(5,713)	(347,480)

Siç tregohet në tabelë, numri i subjekteve debitorë dhe vlera e detyrimeve në fund të vitit 2012 ka ulje krahasuar me fillimin e vitit për 5,713 subjekte, ose në shumën 347,480 mijë lekë. Por, duke analizuar më hollësisht numrin e subjekteve debitorë, shumën e detyrimeve, si dhe shumën e detyrimeve të pakësuar si pasojë e zbatimit të procedurave të ligjit nr.10418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor”, rezultoi se:

- Gjate vitit 2012 nga ligji i sipërcituar për faljen, detyrimet debitorë janë zbritur 667,579 mijë lekë, nga e cila 469,999 mijë leke nga biznesi i madh dhe 197,580 mijë leke nga biznesi i vogël.

Duke marrë në konsiderate këtë shumë, rezulton se, edhe për vitin 2012 detyrimet debitorë të kontributeve të subjekteve të jenë shtuar me 320,089 mijë lekë. Konkretisht, nga 8,401,510 mijë leke gjendje debitorë në fillim të vitit, pas zbritjes së shumë së falur prej 667,579 mijë lekë, mbetet detyrimi i mbartur prej 7,733,931 mijë lekë; ndërsa në fund të vitit, numri i subjekteve debitorë është rreth 40,249 subjekte, të cilat kanë detyrimet për kontribute të pa derdhura në shumën 8,054,030 mijë lekë. Pra, konstatohet se gjatë vitit 2012 është krijuar një detyrim i ri prej 320,089 mijë lekë.

- Këto detyrime që përfaqësojnë kontribute dhe interesa të papaguara, zënë rreth 8.9% të totalit të të ardhurave të planifikuara të vitit 2012 të miratuara me ligj (8,054 milionë lekë : 90,265 milionë lekë), d.m.th një vlerë mjaft e lartë që ka ndikuar në thellimin e deficitit buxhetor.

Nga auditimi u konstatua se, gjendja e debitorëve të akumuluar nga viti 2005, ka ardhur nga puna e dobët e DPT, si dhe nga mungesa e theksuar e shkëmbimit të informacioneve zyrtare midis DPT dhe ISSH. Kjo mungesë bashkëpunimi vërehet sidomos në mos dërgimin apo mosplotësimin e listëpagesave nga DRT-të në DRSSH-të ose në disa raste informacioni shkresor i ardhur nga DPT është me mangësi dhe jo i detajuar, duke krijuar vështirësi për evidentimin dhe pasqyrimin real të subjekteve debitorë dhe detyrimeve të tyre të prapambetura, në kundërshtim me VKM nr. 1114, datë 30.07.2008, të ndryshuar dhe akt-marrëveshjen e përbashkët nr. 4620/2, datë 10.11.2011 të lidhur midis ISSH dhe DPT.

Konkretisht, në zbatim të kësaj baze ligjore, DPT dhe degët e saj, duhet të dërgojnë çdo muaj në strukturat përkatëse të Sigurimeve Shoqërore, të dhënat për kontributet dhe interesat e paguara, deri në datën 10 të muajit vijues pas muajit në të cilin janë kryer pagesat në llogaritë bankare, zyrtarisht dhe në format elektronik; formularin përmbledhës të listëpagesave sipas subjekteve deri në datën 25 të muajit vijues pas muajit në të cilin është realizuar pagesa e kontributit, zyrtarisht dhe në format elektronik; listepagesat origjinale, sipas formatit të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave, deri në datën 28 të muajit vijues pas muajit në të cilin është paraqitur deklarata; listepagesat në format elektronik dhe përmbledhësen për deklarimin e të dhënave të listëpagesës, sipas afateve dhe përcaktimeve në udhëzimin e Ministrit të Financave; si dhe të dhënat statistikore për numrin e subjekteve aktive, numrin e kontribuesve dhe shumën e kontributeve mujore e progresive, sipas formatit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Sa më sipër, *problemi me shqetësues është mosdorëzimi i listëpagesave tremujore të biznesit të vogël, dhe më problematike janë DRT-të Dibër, Durrës dhe Tiranë, të cilat deri në fund të vitit 2012, kishin dorëzuar në organet e sigurimeve shoqërore listëpagesat e tremujorit të dytë të këtij viti (qershor 2012), duke krijuar një diferencë prej 6 muajsh dhe duke krijuar vështirësi serioze në shërbimin ndaj paguesve të kontributeve si dhe në krijimin e sistemit të të dhënave elektronike*

Ndërsa me problem të mosdorëzimit të listëpagesave mujore të biznesit të madh janë DRT-të Durrës, Fier, Kukës dhe Tiranë, të cilat i kanë dorëzuar listëpagesat e subjekteve të biznesit të madh me rreth 5 muaj vonesë.

Numri i lartë i subjekteve debitorë dhe i kontribuesve që ato përfaqësojnë, janë një problem shqetësues jo vetëm për mosmbledhjen e të ardhurave të konsiderueshme me pasojë krijimin e deficitit dhe subvencionimin e tij nga buxheti i shtetit, por sepse ato mbartin edhe një problem të madh social, në fushën e përfitimeve nga ligji i sigurimeve shoqërore, pasi si rezultat i mospagesave të kontributeve për një numër të madh personash, të punësuar në këto subjekte, këto shtetas nuk mund të përfitojnë nga skema e sigurimeve shoqërore asnjë lloj pensioni. Po kështu, mungesa e listëpagesave sjell vështirësi në përcaktimin e masës së pensioneve të pleqërisë.

Për eliminimin e pasojave dhe përmirësimin e punës, KLSH ka rekomanduar marrjen e masave të menjëhershme nga MF-ve, DPT dhe ISSH, për disa rregullime të akteve ligjore e

nënligjore ne përgjithësi qe rregullojnë veprimtarinë e sigurimeve shoqërore, gjithashtu, hartimi i një udhëzimi të Ministrisë të Financave, ku të përcaktohet mënyra e raportimit dhe evidentimin të kontributeve ne përgjithësi dhe në veçanti mënyra e raportimit të të dhënave mujore dhe progresive për detyrimet e kontributeve të paguara në afat dhe për kamat vonesat e tyre, apo të kontributeve të paguara pjesërisht, për çdo subjekt privat si dhe sanksione me të ashpra për mosdorëzim të listepagesave brenda afateve.

a.2) Zbatimi i Programit të të ardhurave në përgjegjësi të ISSH.

Të ardhurat nga kontributet që mblihen në përgjegjësi të ISSH janë programuar 3,163 milionë lekë dhe përfaqësojnë të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi dhe nga sigurimi vullnetar. Gjate vitit 2012, këto të ardhura janë realizuar në vlerën 2,884 milionë lekë ose në masën 91.2%, me një mosrealizim prej 279 milionë lekë.

o *Zbatimi i programit të të ardhurave nga të vetëpunësuarit në bujqësi.*

Bazuar në strukturën organizative të ISSH, miratuar me vendim të KA, zbatimi i programit të të ardhurave nga personat e vetëpunësuar në bujqësi është i organizuar në 12 DRSSH-të të cilat kanë në përbërje një koordinator të kontributeve të fermerëve si dhe inspektor të kontributeve në komunat e vendit. Për të nxitur përgjegjësitë individuale për realizimin e të ardhurave, KA ka përcaktuar një formë shpërblimi të tyre që kombinon një pagë baze minimale dhe një sistem koeficientesh që lidhin pagën me realizimin e të ardhurave.

Programimi i të ardhurave për vitin 2012 është bazuar në bilancin e popullsisë agrare, hartimi i të cilave është mbështetur në metodologjinë e përcaktuar në rregulloren e kontributeve nr 2, datë 2.12.2008, të miratuar nga KA; në eksperiencën e viteve të mëparshme dhe duke pasur parasysh ligjin nr.10 418, datë 21.4.2011 “Për legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjesë të borxhit tatimor e doganor”, i cili ka shtrirë efektet e zbatimit deri me datë 31.03.2012 dhe favorizon të vetëpunësuarit në bujqësi (lejon pagesat e kontributeve pa kamatëvonesa).

Mbi këtë bazë të ardhurat nga kontributet e fermerëve u programuan në shumën 2,550 milionë leke, nga të cilat 2,360 milionë leke sigurim shoqëror dhe 190 milionë leke sigurim shëndetësor. Për vitin 2012, numri fizik i kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi, u realizua për 72,815 persona, por në krahasim me vitin 2011 rezultojnë 22,481 persona më pak, ndërsa të ardhurat nga 2,550 milionë lekë janë realizuar 2,164 milionë lekë.

Bazuar në evidencën e ISSH, *numri fizik i kontribuesve të vetëpunësuar në bujqësi në vitin 2012, krahasuar me vitet 2010 dhe 2011, ka tendencë uljeje, kështu nga 113,809 në vitin 2010, në vitin 2011 u ul në 95,296 kontribues dhe në vitin 2012 arriti në 72,815 kontribues, me një pakësim të numrit prej 40,994 kontribues në vitin 2012 kundrejt vitit 2010 dhe 22,481 kontribues më pak në vitin 2012 kundrejt vitit 2011.*

Po kështu, edhe të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi nga 2,550 milionë lekë të programuara për vitin 2012, janë realizuar 2,164 mijë lekë ose në masën 84.9%, me një mosrealizim prej 386 milionë lekë. Nga të 12 drejtoritë rajonale, vetëm DRSSH Gjirokastër ka realizuar dhe tejkaluar nivelin e programuar të të ardhurave në masën 100.4%. Ndërsa, ndër DRSSH-të me mosrealizimin më të madh përmendim: DRSSH Elbasan me 75.5% ose 78 milionë lekë më pak; Fier me 85.1% ose 51 mijë lekë më pak; Korçë me 85.7% ose 49 milionë lekë më pak; Durrës me 73.9% ose 41 milionë më pak se sa programimi; Berat me 73.9% ose 37 milionë lekë më pak; Shkodër me 87.7% ose me 26.6 milionë lekë më pak etj.

Ndër faktorët objektiv që kanë influencuar në mosrealizimin e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarëve në bujqësi, paraqesim:

- Largimin e një pjese të popullsisë nga zonat rurale në drejtim të zonave urbane, gjë që ka bërë të ulët numrin e të vetëpunësuarëve në bujqësi, që plotësojnë kushte për t’u siguruar si të tillë.

- Problemi i mentalitetit të fermerëve që i shmangen sigurimit dhe kjo më e theksuar tek moshat e reja.

- Tërheqja nga skema e një kategorie të caktuar personash ku dominojnë personat që kanë plotësuar vjetërsinë e nevojshme prej 35 vitesh punë, të cilët në shkallë vendi janë 46,222 persona, ose mbi 25%. Në këtë kategori përfshihen edhe personat me moshë afër pensionit të cilët nuk paraqesin interes për sigurim, sepse edhe sikur të vazhdojnë të sigurohen edhe mbi 35 vjet, nuk përfitojnë pension me te larte.

Faktor tjetër, është edhe numri i regjistruar i popullsisë agrare (bujqve), i cili ka ndikim të konsiderueshëm në mbledhjen e kontributeve, konkretisht:

- Sipas dispozitave të ligjit për sigurimet shoqërore në RSH, sigurimi shoqëror në sektorin bujqësor është i detyrueshëm dhe shtrihet për çdo person që zhvillon aktivitet bujqësor e blegtoral nga moshën 16 deri në moshën e pensionit. Nisur nga kjo, analizuar të dhënat e bilancit të popullsisë agrare të kryer nga ISSH për vitin 2012, nga ku sipas të dhënave të nxjerra nga inspektorët e Sigurimeve Shoqërore sipas komunave, **popullsia banuese aktive në zonat rurale është 1,155,937 individë gjithsej** (këto të dhëna janë të përafërta me të dhënat e INSTAT). Të dhënat e Shërbimit Social Shtetëror evidentojnë se trajtohen me ndihmë ekonomike, në zonat rurale gjithsej 422,995 individë dhe nga këta 171,124 individë raportohen në moshë pune që trajtohen me ndihmë ekonomike. Keta persona në moshe pune, me zbatim të VKM nr. 1114, datë 30.07. 2008 të sipërcituar, janë të përjashtuar nga pagesa e kontributit të detyrueshëm.

Bazuar në këto të dhëna, 131,925 persona janë të punësuar në sektore të tjera, 117,980 janë nxënës e studente, 426,239 janë persona në moshe pune por që punojnë jashtë shtetit, si dhe evidentohen 124,532 persona që banojnë në fshat, janë në moshe pune por nuk kanë toke të mjaftueshme për të zhvilluar aktivitet bujqësor

Pra, duke ju referuar këtyre të dhënave, ***numri i personave të vetëpunësuar që duhet të paguajnë kontribute është 184,137 persona (1,155,937-800,676-171,124); ndërsa numri fizik sipas këtij bilanci që kanë paguar kontribute si persona të vetëpunësuar në bujqësi për vitin 2012 është 72,428 persona ose nuk kanë paguar kontribut 111,709 persona.***

Duke patur parasysh kontributin mesatar vjetor sipas tarifës së kontributeve të vitit 2012 e ponderuar zone fushore – zone malore, shuma e kontributeve të drejtpërdrejta të papaguara për 111,709 persona llogaritet në vlerën 2,319 milionë leke. Bazuar në ligjin për sigurimet shoqërore në RSH, shteti derdhet në fondin e sigurimeve shoqërore, diferencën e kontributit midis shumës së derdhur nga personat e vetëpunësuar në bujqësi me kontributin minimal vjetor në qytet. Në këto kushte, shuma e kontributeve të pa derdhura në fondin e sigurimeve shoqërore nga buxheti i shtetit për llogaritet 3,011 milionë leke.

Pra, efekti financiar vjetor në deficitin e degës së pensioneve për llogaritet në 5,330 milionë leke, dhe nga kjo shumë vetëm nga numri fizik prej 111,709 persona që nuk kanë paguar kontribut është 2, 319 milionë leke.

Nisur nga rezervat e shumta të konstatuara në derdhjen e kontributeve për të vetëpunësuarit në bujqësi, **KLSH ka kërkuar ndërhyrjen dhe marrjen e masave të menjëhershme për disa rregullime të akteve ligjore dhe nënligjore**, si më poshtë:

1. Për stimulimin e pjesëmarrjes në skemën e kontributeve edhe të personave të vetëpunësuar në bujqësi të cilat kanë një historik kontributësh me ish kooperativat bujqësore dhe kanë plotësuar periudhën e sigurimit mbi 35 vjet si dhe kanë plotësuar mbi 50% të kësaj kohe në marrëdhënie pune me shtetin, kërkohej domosdoshmeria e ndryshimeve ligjore në lidhje me llogaritjen e pensionit të pleqerisë, për të kombinuar interesin midis periudhës së pagesës së kundërtributeve dhe masës së përfitimit pas mbushjes së moshës së pensionit, me qëllim që çdo person që punon në bujqësi të paguaj kontribute gjatë gjithë kohës që është ekonomikisht aktiv.

2. Treguesit e programit të të ardhurave në lidhje me popullsinë aktive në fshat të bazohen në të dhënat zyrtare të INSTAT dhe në bilancin e popullsisë rurale që duhet të hartohet nga ISSH çdo vit dhe të miratohet nga Keshilli Administrativ i ISSH.

3. Për ristrukturimin e reduktimit të deficitit financiar të degës së pensioneve të hartohet një Vendim i Keshillit të Ministrave, në të cilin të përcaktohet rritja graduale e masës së kontributit të personave të vetpunësuar në bujqësi deri në mbylljen e subveicioneve kontributive nga buxheti i shtetit.

4. ISSH, duhet të bashkëpunojë me institucionet qendrore dhe vendore që kanë lidhje direkte apo indirekte me fshatin dhe fermerët si: MBUMK dhe Njesite Vendore, me qëllim evidentimin dhe thithjen e kontributeve nga fermerët që punojnë e zhvillojnë aktivitetet edhe mbi baze të projekteve bujqësore të subvencionuara nga buxheti i shtetit.

- Zbatimi i Programi i të ardhurave nga sigurimi vullnetar.

Në zbatim të nenit 3 të ligjit nr. 7703, datë 1.5.1993, i ndryshuar, në ISSH është organizuar shërbimi për mbledhjen e kontributeve vullnetare. Objekt i kësaj skeme janë ata persona që kanë një historik pune me sigurimet shoqërore, por që për shkak të ndryshme kanë ndërprerë marrëdhëniet me sigurimin e detyrueshem.

Bazuar në strukturën organizative të ISSH, ky nënprogram drejtohet nga sektori i sigurimit vullnetar në ISSH si dhe nga inspektorët e sigurimit vullnetar pranë DRSSH-ve.

Bazë për programimin e të ardhurave janë rezultatet e viteve të mëparshme, numri i personave të futur në skeme, kontributi mesatar vjetor dhe rritja e kontributit mesatar vjetor.

Mbi këto baze programi i të ardhurave nga sigurimi vullnetar për vitin 2012 është përcaktuar 381 milionë leke dhe numri i të siguruarve 8,200 persona

Për vitin 2012 të ardhurat nga kontributet vullnetare janë realizuar në masën 93.9%, me një mosrealizim prej 23.3 milionë lekë, dhe në krahasim me vitet 2010 dhe 2011, këto ardhura paraqiten me tendencë uljeje. Kështu nga 357.7 milionë lekë të realizuara në vitin 2012, në vitin 2010 janë realizuar 368.6 milionë lekë dhe në vitin 2011 rreth 376.8 milionë lekë, pra në vitin 2012 janë realizuar 10.9 milionë lekë më pak se në vitin 2010 dhe 19.1 milionë lekë më pak se në vitin 2011.

Kanë realizuar dhe tejkaluar të ardhurat e programuara për vitin 2012, Drejtoritë Rajonale: Tiranë me 104.4% duke realizuar 7,156 mijë lekë më shumë; Lezhë me 107.5% ose 687 mijë lekë më shumë; Berat me 101.2% ose 271 mijë lekë më shumë dhe Gjirokastrë me 100.4% ose 62 mijë lekë më shumë.

Ndërsa ndër Drejtoritë me mosrealizim të të ardhurave paraqesim DRSSH Durrës me 73.3% dhe mosrealizim mbi 10 milionë lekë; Shkodër me 76% dhe mosrealizim 3.6 milionë lekë; Fier me 77.2% dhe mosrealizim 7.6 milionë lekë etj.

Cilësojmë se, mosrealizimi i të ardhurave ka ardhur në mënyrë të drejtpërdrejt nga mosrealizimi i numrit të personave të siguruar. Bazuar në të dhënat statistikore të ISSH, për vitin 2012 numri fizik i kontribuesve të siguruar vullnetarisht u realizua 4,484 persona por në krahasim me vitin 2011 rezultojnë 793 persona më pak. Në këtë ulje 398 ishin persona vendas dhe 395 emigrantë. Ka një numër të konsiderueshëm emigrantësh, të përhershëm apo sezonalë, që nuk kthehen në atdhe. Gjithashtu, duhet evidentuar mungesa e një bashkëpunimi me personat e siguruar, për të vazhduar sigurimin vullnetar, deri në plotësimin e kushteve për përfitim, si dhe puna e pamjaftueshme e sektorit të sigurimit vullnetar në ISSH, e cila duhet të jetë më efektive, duke koordinuar punën në zyrë me komunikimin direkt me qytetaret për ndërgjegjësim e tyre etj.

II. Mbi Shpenzimet

ISSH, gjate vitit 2012 ka zbatuar tre programe baze te transfertave ne buxhetet familjar, si dhe programin e shpenzimeve te administrimit te sistemit te Sigurimeve Shoqërore. Tre programet baze te përfitimeve jane ndare ne 20 nenprograme nëpërmjet te cilave, gjate ketij viti, janë transferuar ne buxhetet familjare 88,141 milionë leke ose 4,476 milionë leke me shume se një vit me pare.

Administrimi i këtyre shpenzimeve kryhet ne baze te ligjit për sigurimet shoqerore ne RSH dhe te akteve te tjera ligjore e nenligjore qe rregullojnë fushen e pensioneve suplementare shtetërore, përfitimeve suplementare te ushtarakeve, te profesorëve etj.

Programi i shpenzimeve i ndryshuar dhe realizimi, sipas skemave e degëve te sigurimit për vitin 2012, paraqitet si më poshtë:

		<i>në milionë/lekë</i>			
	SHPENZIMET	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
I.	SHPENZIME PER PERFITIME	74,184.8	74,100.2	-84.6	99.9
1.	Shpenzime per Semundje	379.4	381.2	+1.8	100.5
2.	Shpenzime per Barrelindje	2,083.5	2,076.0	-7.5	99.6
3.	Shpenzime per pensione	71,707.9	71,631.6	-76.3	99.9
3.a	Shpenzime per Pensione Qytet	58,338.8	58,305.2	-33.6	99.9
3.b	Shpenzime per Pensione Fshat	13,369.1	13,326.4	-42.7	99.7
4.	Per Aksidente dhe Semundje Profesionale	14.0	11.4	-2.6	81.7
II.	PER PROGRAMET E TJERA	9,158.9	9,062.0	-96.9	98.9
	Pensione Speciale e te Posaçme	88.6	81.4	-7.2	91.9
	Shperblime te Invalidëve dhe Veteraneve	377.9	363.1	-14.8	96.1
	Nga Statusi i Invalidit te Punes	50.7	45.4	-5.3	89.4
	Kompensime	8,641.6	8,572.1	-69.6	99.2
III.	SHPENZIME ADMINISTRATIVE	1,816.0	1,718.3	-97.7	94.6
IV.	SHPENZ. PER SKEMAT SUPLEMENTARE	5,105.3	4,979.2	-126.1	97.5
	TOTALI I SHPENZIMEVE (I+II+III+IV)	90,265.0	89,859.7	-405.3	99.6

Burimi: ISSH

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se:

- Ne total, programi përfundimtar i shpenzimeve i miratuara me ligjin për buxhetin e viti 2012, nga 90,265 milionë leke te programuara është realizuar ne shumën 89,859.7 milionë leke, me një mosrealizim prej 405.3 milionë ose në masën 99.6 %.

Te ndara sipas programeve, shpenzimet e vitit 2012 janë realizuar si me poshtë:

- Shpenzimet per skemen e detyrueshme, ku perfshihen shpenzimet per perfitime qe akordohen nga ligji i sigurimeve shoqerore, jane realizuar ne masen 99.9% me nje mosrealizim ne shumen 85 milione leke,

- Shpenzimet per programe te veçanta te Qeverise jane realizuar ne masen 98.9%, me nje mosrealizim ne shumen 96.9 milione leke,

-Shpenzimat per skemat suplementare janë realizuar në masën 97.8%, me një mosrealizim prej 126.1 milionë lekë.

- Shpenzimet administrative, nga 1,816 milionë leke te programuara janë shpenzuar 1,718.3 milionë leke, me një mos realizim prej 97.7 milionë leke ose masën 94.6%.

Nga auditimi i audituesve të KLSH të zërave të shpenzimeve për të katër programet ë sipërcituar, rezulton se:

- o Shpenzimet per skemën e detyrueshme:

Bazuar ne nenet 66-68 te ligjit nr 7703, date 1.5.1993, në shpenzimet e skemës së detyrueshme, përfshihen shpenzimet për pensione, sëmundje, barre lindje, shpenzimet per sëmundje profesionale dhe aksidente ne pune. Per vitin 2012, nga 74,184.8 milionë lekë fonde te programuara janë shpenzuar në fakt 74,100.2 milion lekë, pra me pak 84.6 milion lekë ose në masën 99.9%. Krahasuar me faktin e vitit 2011, ato rezultojnë me rritje në shumën **4,363** milionë lekë ose 6.3% më shumë, shtese kjo qe lidhet me politikat e rritjes se pensioneve per vitin 2012 dhe efektet mbetëse te rritjes se shpenzimeve per shkak te rritjes se pensioneve ne vitin 2011 (trajtuar me poshte ne piken e deficitit te pensioneve).

Realizimi i këtyre shpenzimeve sipas zërave për vitin 2012, paraqiten si më poshtë:

		<i>në milionë/lekë</i>			
	Shpenzimet sipas zërave	Plan	Fakt	Diferenca	në %
I.	Sshpenzimet për përfitime	74,184.8	74,100.2	-84.6	99.9
1.	Shpenzime per Semundje	379.4	381.2	+1.8	100.5
2.	Shpenzime per Barre lindje	2,083.5	2,076.0	-7.5	99.6
	Shpenzime per Barre lindje Qytet	1,456.5	1,451.8	-4.7	99.7
	Shpenzime per Barre lindje Fshat	521.0	520.5	-0.5	99.9
	Shpenzime per Shperblim Lindje	106.0	103.7	-2.3	97.8
3.	Shpenzime per pensione	71,707.9	71,631.6	-76.3	99.9
3.a	Shpenzime per Pensione Qytet	58,338.8	58,305.2	-33.6	99.9
	Pensione Pleqerie	46,760.1	46,737.7	-22.4	99.9
	Pensione Invaliditeti	7,552.3	7,554.6	+2.3	100.0
	Pensione Familjare	3,894.6	3,883.7	-10.9	99.7
	Pagesa ne rast vdekjeje	131.8	129.2	-2.6	98.1
3.b	Shpenzime per Pensione Fshat	13,369.1	13,326.4	-42.8	99.7
	Pensione Pleqerie	12,486.2	12,462.6	-23.6	99.8
	Pensione Invaliditeti	473.7	465.3	-8.4	98.2
	Pensione Familjare	366.9	356.6	-10.3	97.2
	Pagesa ne rast vdekjeje	42.3	41.8	0.5	98.9
4.	Per Aksidente dhe Sem. Profesionale	14.0	11.4	-2.6	81.7

Burimi: ISSH

Nga të dhënat e mësipërme rezulton se:

1. Shpenzimet për zërin “Paaftësi e përkohshme në punë”, janë programuar në vlerën 379.4 milion lekë dhe janë realizuar 381.2 milionë leke, me një tejkalim në vlerën prej 1.8 milionë lekë dhe krahasuar me vitin 2011 janë realizuar më shumë në vlerën 17.3 milion lekë ose 4.3%. Pra, efektet kryesore te rritjes se shpenzimeve, vijnë nga rritja e numrit te personave te trajtuar me kete lloj përfitimi, per shkak semundshmerie.

2. Shpenzimet për “Paaftësi e përkohshme dhe dëme për shkak aksidenti”, janë programuar në vlerën 14 milion lekë, dhe janë realizuar në shumën 11.4 milionë lekë ose në masën 81.7%, me një mosrealizim prej 2.6 milionë lekë. Krahasuar me realizimin e viti 2011, këto shpenzime paraqiten në një nivel më të ulët në vlerë prej 0.2 milionë lekë.

-Shpenzimet për “**Barrë lindje**” janë programuar në vlerën 2,083.5 milionë lekë, janë realizuar më pak në vlerën 7.5 milionë lekë; ndërkohe qe krahasuar me nje vit me pare evidentohet një shtese e shpenzimeve per 185 milionë leke ose rreth 9.8% më shumë, çka evidenton rritjen e përfitimit te personave te siguruar, si dhe rritjen e numrit te perfituesve.

Ne lidhje me shpenzimet e mësipërme, ISSH duhet te jete me e kujdesshme, sidomos për shpenzimet për barre lindje ne qytet ne lidhje me forcimin e kontrollit i brendshëm, pasi nga

struktura e auditimit te brendshëm janë konstatuar shkelje te dispozitave ligjore ne këtë fushe, sidomos ne sigurimin e paslindjes me qellim perfitimin e raportit mjekësor.

3. Shpenzimet për “**Pensione**” janë programuar në vlerën 71,707.9 milion lekë dhe në fakt janë shpenzuar në vlerën 71.631.6 milionë lekë, ose në masën 99%, pra me mosrealizim në vlerë 76.3 milionë lekë; ndërsa në krahasim me realizimin e vitit 2011, programi i vitit 2012 është rritur në vlerën 4,240 milionë lekë.

Sa i perket rritjes se ketyre te shpenzimeve ne vitin 2012 ne krahasim me 2012, per pensionet e qytetit, evidentohet fakti se shume perfitues qe punojnë si te vetëpunësuar ne bujqësi, per arsye te mbushjes të më shumë se 50% te vjetërsisë ne pune ne marrëdhënie sigurimi, sipas ligjit nr. 7703, date 1.5.1993, i ndryshuar, perfitojne pensione qyteti.

Në vijim paraqesim evidencën e numrit te perfituesve sipas viteve, ku evidentohet pakësimi i numrit te pensioneve rurale, si vijon:

në mijë/lekë

Numri i pensioneve te pleqerise	Vitet				
	2008	2009	2010	2011	2012
Pensionet e pleqerise					
- Pleqërie urbane	283,584	285,630	285,875	288,533	296,076
- Pleqërie rurale	142,863	142,742	142,015	140,776	137,771
Shuma:	426,447	428,372	427,890	429,309	433,847
Shtese e numrit					
- Pleqërie urbane		2,046	245	2,658	7,543
- Pleqërie rurale		-121	-727	-1,239	-3,005

Burimi: ISSH

Ne lidhje me këto shpenzime, ISSH duhet te bashkëpunoj me MF-ve, MPCPSSH dhe me njësite e qeverisjes vendore ne lidhje me programimin e shpenzimeve sipas zërave dhe nënzërave, duke përllorë edhe efektet e uljes se numrit te pensioneve rurale.

3.a.1 Në të dhënat e mësipërme konstatohet një tejkalim ne zërin pensionet e invaliditetit për 2.3 milionë leke. Marrë shkas nga ky tejkalim edhe pse nuk është ne vlera te mëdha, auditimi u përqendrua ne arsyet e shtimit te këtyre shpenzimeve, nga ku rezultoi:

Pensionet e invaliditetit caktohen ne baze te nenit 35-39 te ligjit nr 7703, date 1.5.1993, i ndryshuar. Shkalla e invaliditetit përcaktohet nga Komisionet Mjekësore të Caktimit të Aftësisë për Pune. Këto komisione funksionojnë ne dy nivele, Komisionet Mjekësore te Caktimit te Aftësisë për Pune (KMCAP), Rajonale dhe KMCAP, Eprore.

Vendimet e këtyre komisioneve janë përcaktuese ne shkallen e invaliditetit dhe për përcaktimin e nivelit te këtyre shpenzimeve.

Bazuar ne të dhënat e ISSH dhe ne regjistrat e KMCAP-ve, Eprore, gjate vitit 2012 sektoret e ekspertizës ne këto komisione kane shqyrtuar dhe marre vendime per 1,824 te sëmure apo invalidë. Nga keto, rreth 300 jane te mbartura ne ISSH qe nga viti 2011 te cilet jane komisionuar ne vitin 2012. Nga 1,824 te semure e invalidë te komisionuar, 500 (ose 27.4%) prej tyre jane raste te reja invaliditeti dhe 1,324 (ose 72.6%) prej tyre janë raste rikontrolli (pensione te lidhura). Nga keto, 1,044 ose 57.2% janë rekurse te ardhura nga KMCAP-të e Rajoneve me kërkesë te invalidëve dhe 684 ose 37.5% jane vendime me divergjence (anëtarët e komisioneve nuk kane qene ne te njëjtin mendim dhe i kane dërguar per zgjidhje ne KMCAP Eprore), si dhe 96 ose 5.3% jane raste te dërguara me kërkesë te Auditimit te Brendshëm.

Nga auditimi i dokumentacionit te mbajtur per përfituesit invalid dhe regjistrave te KMCAP-ve, Eprore, u konstatua se:

- Nga 500 raste te reja te ardhura ne KMCAP Epror si rekurse apo divergjenca te dërguara për zgjidhje, 243 raste ose 48.6% e rasteve te reja jane deklaruar invalide. Krahasuar me vitet e

meparshme, evidentohet nje shtim i konsiderueshem i rasteve qe kane fituar grupin e invaliditetit ne kempin epror, krahasuar me vitet e mëparshme.

- Nga 684 vendime te komisioneve te rajoneve te derguara per rishqyrtim per shkak te mos marjes se nje vendimi kolegjial (me divergjence), 421 ose 61.5% e rasteve jane deklaruar invalide dhe kane perfituar pension invaliditeti.

- Nga 1,044 rekurse kane fituar me shume nga vendimet e rretheve 585 raste ose 56% e rekurseve kane perfituar pension invaliditeti, nga 53.9% ne vitin 2011.

- Ne strukturen e ISSH, funksionon edhe njesia e vleresimit te dokumentacionit dhe kontrollit te invaliditetit. Nga te dhenat dhe kontrollet e ushtruara nga kjo njesi jane derguar per verifikim ne KMCAP eprore 96 raste dhe nga KMCAP-et Eprore jane mbyllur 37 pensione invaliditeti, 59 raste jane deklaruar pa grup dhe jane deklaruar invalide, vazhdojne te perfitojne pensionin e invaliditetit.

- Pra, për vitin 2012, nga KMCAP-et Eprore, jane dhene 1,067 grupe invaliditeti ose 58.5% e te komisionuarve, ndërkohë qe ne vitet 2010-2006 numri i përfituesve varion nga 12.3% ne 35.6%. Përsa më sipër dhe të dhënave të detajuara të parashtruara në Raportin Përfundimtar të Auditimit dërguar ISSH, arrihet në përfundimin se, vendimmarrjet e KMCAP-ve Rajonale dhe Eprore për përfitim te invaliditetit janë konstatuar mjaft probleme, te cilat kane sjell raste te shumta te informalitetit ne dhënien e pensioneve te invaliditetit, me pasoje shtimin e padrejte te shpenzimeve per të. Rastet me te shumta te informalitetit ne dhënien e këtyre pensioneve, janë evidentuar ne vendimmarrjet e KMCAP-ve Eprore te specialiteteve Kirurgji, N/kirurgji dhe pathollogji.

Për eliminimin e informalitetit dhe përmirësimin e punës se këtyre KMCAP, duhet të merren masa te menjëhershme për bërjen e propozimeve për përmirësime ligjore, konkretisht:

Ne zbatim te Ligjit nr. 7703, date 11.05.1993, i ndryshuar, te hartohet dhe te dërgohet ne KM për miratim një Projektvendim ku të përcaktohen: “Kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes se anëtareve te KMCAP-et Eprore (me ane te konkurseve apo te shorteve), si dhe rregullat e organizimit dhe funksionimit te këtyre komisioneve”.

○ *Shpenzimet për programe të veçanta shtetërore (programe te tjera).*

Këto shpenzime janë parashikuar në vlerën 9,158.9 milionë lekë dhe në fakt janë realizuar në vlerën 9,062 milionë lekë, më pak se parashikimi në vlerën 96.9 milionë lekë ose në masën 98.9%. Edhe ne nenzerat e shpenzimeve nuk evidentohen tejkalime ndaj programit, ndërkohë evidentohet një ulje e përvitshme e përfitimeve nga statusi i veteranit te luftës.

Realizimi i zërave te shpenzimeve te këtij programi paraqitet si me poshtë:

EMËRTIMI	Plan	Fakt	Diferenca	Në %
PER PROGRAMET E TJERA	9,158.9	9,062.0	-96.9	98.9
Pensione Speciale e te Posaçme	88.6	81.4	-7.2	91.9
Shperbl. te Inv te Luftes dhe Veteran	377.9	363.1	-14.8	96.1
Shtese nga Statusi i Invaliditit te Punes	50.7	45.4	-5.2	89.4
Kompensime	8,641.6	8,572.1	-69.5	99.2
Kompensime per Pensione Qytet	7,456.3	7,407.7	-48.6	99.3
Energji Elektrike	2,387.7	2,382.4	-5.3	99.8
Buken	698.9	689.5	-9.4	98.7
Ngarkese	269.7	259.2	-10.5	96.1
Kompensim per te ardhurat	4,100.1	4,076.6	-23.5	99.4
Kompensime per Pensione Fshat	1,185.3	1,164.4	-20.9	98.2
Energji Elektrike	379.7	365.4	-14.3	96.2
Buken	21.3	19.2	-2.1	90.2

në milionë/leke

Ngarkese	30.5	27.9	-2.6	91.5
Kompensim per te ardhurat	753.8	751.9	-1.9	99.7

Burimi: ISSH

o *Shpenzimet Administrative:*

Janë programuar në vlerën 1,816 milionë lekë dhe janë realizuar në vlerën 1,718.3 milionë lekë, me një mosrealizim prej 95.4 milionë leke, ose në masën 94.6%. Me perjeshtim të zërit mallra dhe shërbime, të gjithë zërat e tjerë paraqiten me mosrealizime. Me mosrealizime janë të gjithë zërat e shpenzimeve si përdorimi i fondit të pagave ashtu edhe shpenzimet për blerje mallra e shërbime. Shpenzimet administrative për vitin 2012 zënë 1.95% të shpenzimeve të drejtpërdrejta nga 5 % që është parashikuar të jete sipas ligjit nr 7703, datë 1.5.1993. Sipas zerave realizimi këtyre shpenzimeve është, si me poshte:

në milionë/lekë

Llog.	Emërtimi	Plan	Fakt	Ndryshimi	Në %
Shpenzime administrative		1,816.0	1,718.33	(95.47)	94.62
600	Paga,shperblime, personeli	886.8	855.43	(31.40)	96.46
	Paga personeli i perhershëm	693.1	676.47	(16.66)	97.60
	Paga te personelit te perkohshëm	86.0	85.4	(0.6)	99.3
	Shperblime personeli	85.6	73.1	(12.5)	85.4
	Shpenzime te tjera personeli	22.1	20.5	(1.6)	92.6
601	Kontribute per sigurime	136.6	132.5	(4.1)	97.0
602	Malra dhe shërbime te tjera	694.1	695.15	1.00	100.00
	<i>Komisione te pageses (posta)</i>	515.3	499.3	(16.0)	96.9
231	Shpenzime per investime	98.4	35.23	(63.16)	35.81

Burimi: ISSH

Bazuar në të dhënat e bilancit financiar si dhe nga analiza e shpenzimeve administrative evidentohet se në total dhe për çdo zë shpenzimet administrative janë mbajtur në kontroll në të gjithë zërat. Peshën kryesore specifike e zënë shpenzimet për paga personeli dhe për komisionet e shërbimeve që ISSH i paguan postës shqiptare.

Marrëdhëniet ISSH me Postën shqiptare rregullohen me Akt-Marrëveshjes nr. 4537 prot, datë 21.08.2008 të lidhur ndërmjet të dy institucioneve. Dhe në bazë të kësaj marrëveshjeje Posta Shqiptare kryhen shërbimin e pagesës së pensioneve për llogari të ISSH kundrejt pagesës së komisioneve të shërbimit. Niveli i komisioneve që ISSH i paguan Postës Shqiptare është përcaktuar me vendim të KA të ISSH. Konkretisht, për pensionet, që paguhet në qytet është përcaktuar në masën 0,5% të pensionit dhe për pensionet që paguhet në fshat në masën 0.85% të pensionit.

Për shkak të rritjes së vlerës së pensioneve dhe rritjes së volumit të perfitimeve, nga viti në vit vlera e komisioneve që paguan ISSH për postën është rritur në vlera të konsiderueshme. Kështu në vitin 2006, shumën e shpenzimeve për komisione të pagesave që ka përfituar Posta për shërbimin ishte 294,5 milionë leke, ndërsa në vitin 2012 këto pagesa janë rritur në vlerën e 499.3 milionë leke, me një shtesë rreth 200 milionë leke. Mirëpo numri i personave dhe pensionistëve që u është kryer shërbimi që nga viti 2006 deri në vitin 2012 është rritur vetëm me rreth 10%.

Pra, kemi një rritje të shpenzimeve për komisione duke krijuar në mënyrë të panatyrshme një deficit në dem të buxhetit të shtetit, pasi ky deficit mbulohet me subvencion buxhetor.

Për këtë, ***KLSH i ka rekomanduar ISSH-së që në bashkëpunim me MF-ve*** duhet të ndërmarre reforme për rritjen e cilësisë dhe uljen e kostos së këtij shërbimi, konkretisht :

- *Liberalizimin e këtij shërbimi duke e shtrire atë edhe në bankat e nivelit të dyte.*
- *Uljen e nivelit të komisioneve dhe për pasojë uljen e subvencionit të buxhetit,*
- *Rritjen e cilësisë së këtij shërbimi për t'i ardhur në ndihmë kësaj kategorie me probleme sociale, duke evituar abuzimet, konfuzionin dhe radhët e gjata në sportelet e postes, nëpërmjet përfshirjes së vlerës së komisioneve të shërbimit në vlerën e pensionit të çdo pensionisti, dhe bankat t'ua mbaj këtë vlerë në formë komisioni për shërbimin që u kryhen për çdo pagesë të tërhequr nga sportelet e bankës apo bankomatet e saj.*

o *Shpenzime “Për programe e skema suplementare”*

Këto shpenzime janë programuar në vlerën 5,105.9 milionë lekë dhe janë realizuar në vlerën 4979.2 milion lekë, ose në masën 97.4% me një kursim prej 126.1 milionë lekë. Në këto skeme evidentohen 10 lloje përfitimesh, shpenzimet e të cilave kryesisht financohen nga buxheti i shtetit, realizimi i të cilave paraqitet, si me poshtë:

në milionë/lekë

<i>Emërtimi</i>	<i>Plan</i>	<i>Fakt</i>	<i>Diferencë</i>	<i>në %</i>
SHPENZIME PER SKEMA SUPLEMENTARE	5,105.3	4,979.2	-126.1	97.5
Sigurime suplementare të ushtarakeve MM	3,335.5	3,352.5	17.0	100.5
Sigurime suplementare të policisë së shtetit	337.2	284.7	-52.5	84.4
Përfitime nga statusi i deshmorëve të atdheut	24.7	22.8	-1.9	92.5
Përfitime për pilotet fluturues në pension	24.0	20.5	-3.5	85.5
Përfitime për detaret e nendeteseve në pension	10.2	3.7	-6.5	36.5
Përfitime për punonjësit e ndermarrjeve ushtarake	134.4	114.1	-20.3	84.9
Sigurime suplementare shtetërore	584.5	563.3	-21.2	96.4
Përfitime për trajtimin e veçante të minatoreve	456.0	439.8	-16.2	96.5
Pagesa të tjera (shpenzime varimi)	155.7	146.1	-9.6	93.9
Përfitime nga statusi i profesorit	43.1	31.5	-11.6	73.2

Burimi: ISSH

Mosrealizimet e këtyre shpenzimeve, janë pasojë e mosrealizimit të numrit të personave të parashikuar për t'u trajtuar sidomos për rastet e pensioneve suplementare dhe pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi të ushtarakeve apo edhe të rasteve kur nuk janë bërë rishqyrtimet e pensioneve për shkak të mos dërgimit të dokumenteve lidhur me pagën referuese, formularë të cilat dërgohen nga ministritë e linjës.

Ne përfundim, programi i shpenzimeve nga 90,265 milionë leke të programuar është realizuar 89,859.7 milionë leke ose në masën 99.6%, me një mosrealizim në shumën 405 milionë leke. Mosrealizimi i shpenzimeve ka sjelle si pasojë zbutjen e deficitit të krijuar nga mosrealizimi i të ardhurave.

o *Rritja e shpenzimeve nga rritja e inflacionit dhe nga rritja e numrit të përfituesve:*

- Megjithatë shpenzimet e planifikuara për vitin 2012 nuk janë realizuar në total, ato kanë pasur një rritje të lehtë, si pasojë e rritjes së inflacionit të këtij viti, në të katër programet. Rritja ka ardhur nga efektet financiare mbetëse të rritjes së pensioneve në vitin 2011, dhe efektet financiare të rritjes së pensioneve për vitin 2012 si pasojë e rritjes së inflacionit.

Konkretisht, krahasuar me një vit më parë, transfertat e përgjithshme në buxhetet familjare u shtuan me 4,476.4 milionë leke më shumë ose në masën 5.4% më tepër, si me poshtë vijon:

në milionë/lekë

Llojet e perfitimeve	Transferta ne buxhetet familiare		Shtesa e transferetes	
	2012	2011	Në vlere	Në %
Pershkrimi i zerave te shpenzimeve				
Shpenzime per semundje	381.2	363.9	17.3	4.8
Shpenzime shkak aksidenti	11.5	11.6	-0.1	-0.8
Shpenzime per barreindje	2076	1,890.7	185.0	9.8
Shpenzime per pensione	71,631.6	67,470.5	4,161.1	6.2
<i>Pensione per moshe madhore</i>	59,371.4	55,877.7	3,493.6	6.3
<i>Pension pa-aftesie (invaliditeti)</i>	8,019.9	7,339.1	680.7	9.3
<i>Pension mbijetese.(familjare)</i>	4,240.3	4,253.6	-13.3	-0.3
Per programe te vecanta	9,062.0	9,038.2	23.8	0.3
Shpenzime per skema suplementare	4,979.2	4,889.9	89.3	1.8
Totali:	88,141.2	83,664.8	4,476.4	5.4

Megjithëse rritja e këtyre shpenzimeve është për arsye objektive, theksojmë se rritja e pensioneve ne vitin 2012 nuk ka ardhur ne raport te drejte me rritjen e inflacionit te këtij viti, pasi pensionet janë rritur 5.4%, ndërsa inflacioni sipas te dhënave zyrtare te INSTAT është 3 deri ne 4%. Kjo rritje nuk është shoqëruar me masa administrative dhe ligjore per rritjen e te ardhurave nga kontributet e drejtpërdrejta. *Efektet e rritjes se shpenzimeve për pensione me tepër se niveli i inflacionit janë mbuluar me subvencione buxhetore, te cilat janë rritur nga viti ne vit, çka thellon deficitin financiar te sistemit te sigurimeve shoqërore.*

2. Përveç rritjes me tepër se inflacioni ka pasur shtese te shpenzimeve edhe nga rritja e numrit te përfituesve ne skemat e pensioneve ne vitin 2012 kundrejt vitit 2011, si më poshtë:

Ne skemën e detyrueshme

Perfituesit	2011	2012	Ne %
Pensionistë urbane	390,956	399,959	102.3
Pleqërie	288,533	296,076	102.6
Invaliditeti	52,023	55,245	106.2
Familjarë	50,400	48,638	96.5
Pensionistë ruralë	157,719	154,143	97.7
Pleqërie	140,776	137,771	97.9
Invaliditeti	6,662	6,853	102.9
Familjarë	10,281	9,519	92.6
Totali:	548,675	554,102	101.0

Në skemat suplementare

Perfituesit	2011	2012	Ne %
Sigurimi shtetëror suplementar	1,506	1,419	106.1
Sigurimi suplementar ushtarak	20,377	18,298	111.4
Trajtimi i veçantë i punonjësve të nëntokës	3,698	3,770	98.1
Për statusin "Dëshmor i Atdheut"	378	421	89.8
Trajtimi i veçantë për pilotët fluturues në pension	264	277	95.3
Trajtimi i veçantë i punonj. të industrisë ushtarake	712	760	93.7
Sigurime suplementare të policisë së shtetit	1,896	1,578	120.2
Trajtim i veçantë për detarët e nëndetësve në pension	68	80	85.0
Për statusin "Profesor"	549	518	106.0
Totali:	29,448	27,121	108.6

Burimi: ISSH

Rritja e numrit te përftuesve ka impakte pozitive, pasi ndikon ne rritjen e transfertave ne buxhetet familjare dhe te te ardhurave te pensionisteve, por ndërkohe kjo rritje ndikon ne përkeqësimin e rezultatit financiar te degës se pensioneve, sepse rrit ndjeshem subvencionet per mbulimin e shpenzimeve, pasi nuk është shoqëruar me rritje te numrit te kontribuuesve, por

numri i tyre vazhdon të mbetet i ulët dhe ndër to, sidomos i ulët është numri i kontribuuesve në fshat ku pjesëmarrja e forcave të punës në skemën e sigurimeve shoqërore është në nivele të ulta.

III. Fondit Rezerve i Sigurimeve Shoqërore

Krijimi i fondit rezerve të ISH është përcaktuar në nenin 71 të ligjit nr.7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar. Ky fond krijohet për të mbuluar të paktën 3 muaj shpenzimet për pensione.

Në zbatim të këtij neni, fondit rezerve për vitin 2012 duhej të përlogaritej dhe të krijohej në vlerën 17,928 miliona leke (shpenzimet mujore për pensione në shumën 5,976 miliona leke shumezuar me 3 muaj). Ndërsa në fakt, bazuar në bilancin financiar të vitit 2012, gjendja e fondit rezerve në fund të vitit rezultoi të jetë 3,888,5 milionë leke ose rreth 21.7% e normativës ligjore. *Kjo gjendje e fondit rezerve, aktualisht mbulon 65% të pagesave të pensioneve për një muaj.*

Rregullorja financiare të ISSH, nr. 5, datë 26.05.2009, miratuar me vendim të KA nr 3, datë 25.5.2009, lejon investimin e fondit rezerve në mënyrë të sigurtë dhe me rrezikshmëri minimale të mundshme. Veprimet financiare lidhur me fondin rezerve kryhen nga llogaria e posaçme bankare, vetëm me disponim të Drejtorit të Përgjithshëm. Fondet e përfituara nga investimi përkatës kthehen përsëri në llogarinë e posaçme bankare të fondit rezerve të investuar, për t'u riinvestuar në rastin me të parë.

Në zbatim të kësaj baze ligjore i gjithë fondit rezerve i Sigurimeve Shoqërore, në shumën 3,888,5 milionë leke, është i investuar për blerjen e bonove të thesarit. Investimi i mjeteve financiare në objektin e blerjes së bonove të thesarit është bërë sipas propozimit të ISSH për pjesëmarrje në ankandet e shpallura, dhe me miratim të Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit në MF-ve.

Nga auditimi i KLSH, u konstatua se:

Megjithëse nga fondit rezervë i investuar janë krijuar të ardhura, këto të ardhura nuk kanë kaluar në shtesë të fondit rezerve, si një ndër burimet e mundshme për shtimin e saj, në përputhje me, ligjin nr.7703, datë 11.05.1993, i ndryshuar, por sipas ligjit për buxhetin vjetor 2012, këto të ardhura janë planifikuar për të mbuluar pagesat vjetore sepse dega e pensioneve është deficitare.

Gjithashtu, çdo vit planifikohen fonde për të mbuluar rritjen vjetore të pensioneve, por nuk planifikohen fonde për rritjen e fondit rezerve për shkuar në nivelin e normativës ligjore.

Ndërsa, mbështetur në nenin 59 të ligjit nr 7705, datë 11.5.2003 i cili përcakton se, **“fondi i pensioneve garantohet nga buxheti”**, arrihet në konkluzionin se do të ishte e tepërt krijimi i fondit rezerve prej 3 muaj pagesash, por nisur dhe nga rasti konkret që fondit rezerve aktual mbulon 65% të pagesave të pensioneve të një muaj, ky fond mund të krijohej në nivelin minimal të një muaji pagesash, pasi kështu tepërcat të mos përdoren për investimin e këtij fondi por për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

VI. Rezultati financiar i sistemit të Sigurimeve Shoqërore dhe i Degës së Pensioneve

VI.1 Rezultati Financiar i sistemit të Sigurimit Shoqëror.

Bazuar në realizimin faktik të të ardhurave dhe shpenzimeve të pasqyruar në treguesit e bilancit të konsoliduar të ISSH, rezultati financiar i ISSH për vitin 2012 të detajuar, paraqitet si më poshtë:

<i>ne milione leke</i>			
Emertimi	Plani i ndryshuar	Realizimi	ne %
kontribute te detyrueshme	47,314	45,732.4	96.7
kontribute suplementare	290	718.7	247.8
kontribute te bujkut	2,360	1,928.9	81.7
kontribute vullnetare	381	357.6	93.9
te ardhura tjera	232	506.0	218.1
Totali i te ardhurave	50,577	49,243.6	97.4
Transferta nga buxheti i shtetit	39,688	39,688.0	100.0
Shpenzime per perfitime	74,185	74,100.2	99.9
Shpenzime per programe tjera	9,139	9,062.0	98.9
Shpenzime administrative	1,815	1,718.3	94.6
Shpenzime perskema suplementare	5,105	4,979.2	97.5
Totali i shpenzimeve	90,265	89,859.7	99.6
Ndihshimi i gjerdjeve te materialeve	0	5.7	
Rezultati financiar	0	933.8	

-Të ardhurat ne fondin e sigurimeve shoqërore u realizuan 49,243.7 milionë leke, nga 50,577 milionë leke te programuara, me një diference prej 1,333.7 milionë leke ose 97.4%.

Për vitin 2012, është realizuar tërheqja e plote e transfertes shtetërore për fondin e sigurimeve shoqërore, e rakorduar dhe shoqëruar me dokumentacionin përkatës, ne shumën prej 39,688 milione leke, nga te cilat 39,668 milionë leke kane kaluar ne llogarite e ISSH brenda dates 31.12.2012, ndërsa 20 milionë leke ne datën 3.1.2013.

Kështu te ardhurat ne total janë ne 88,931.7 milion leke.

Duhet vene ne dukje, megjithëse trasferta buxhetore për balancimin e buxhetit te sigurimeve shoqërore është e konsiderueshme dhe ka ardhur nga viti ne vit ne rritje; ajo nuk ka mundur te mbulojne deficitin financiar faktik te fondit sigurimeve shoqërore për këtë vit, si pasojë e mosrealizimit te te ardhurave te programuara.

- Shpenzimet për sigurimet shoqërore te detyrueshme, suplementare, trajtimet dhe programet e veçanta si dhe shpenzimet e administrimit ne total janë realizuar ne masën 99.6% ose nga 90,265 milionë leke te programuara, u realizuan 89,859.7 milione leke, me nje mosrealizim prej 405.3 milionë lekesh,

Konkretisht, deficitin ne total i skemës se sigurimeve shoqërore për vitin 2012 është 928.1 milion leke (88,931.6 milion leke – 89,859.7 milionë).

Pra buxheti i shtetit, përveç transfertes buxhetore prej 39,688 milionë leke qe i ka dhenë ISSH për balancimin e buxhetit te sigurimeve shoqërore, duhet te mbuloi me subvencionet shtese përsëri edhe deficitin e krijuar gjate vitit ushtrimor 2012 prej 928.1 milion leke. Deficiti i krijuar gjate vitit ushtrimor nuk është financiar nga buxheti, por është mbuluar nga fondet e veta te pa përdorura te ISSH dhe nga fondet e sigurimeve shëndetësore te fermerëve, te pa transferuar gjate vitit ne ISKSH.

IV.2 Rezultati Financiar (Deficiti) i Degës së Pensioneve.

Bazuar ne nenin 67 te ligjit nr 7703, date 1.5.1993, i ndryshuar, shpenzimet për skemën e Sigurimeve Shoqërore financohen nga fondi i Sigurimeve Shoqërore i cili krijohet nga kontributet, te ardhurat e tjera, financimet dhe subvencionet buxhetore shtetërore.

Sigurimi i Shoqëror i Detyrueshëm (ne këtë sigurim nuk përfshihet: sigurimi suplementar, pensionet e posaçme dhe programet e tjera kompesuese), jep përfitime për 4 degë të sigurimeve shoqërore, siç janë; dega e sëmundjeve, dega e barrëlindjeve, dega e pensioneve (pleqërie, invaliditeti dhe familjare) dhe dega e aksidenteve në punë e sëmundjet profesionale.

Gjate procesit te hartimit te projekt-buxhetit te vitit 2012 por edhe te buxheteve faktike te viteve te mëparshme dega e pensioneve ka rezultuar me deficit, pasi te ardhurat jane me te vogla se shpenzimet qe duhen për te mbuluar pagesat e pensioneve. Për te balancuar buxhetin e degës se pensioneve, ky deficit mbulohet për çdo vit nga trasfertat buxhetore te miratuara me ligjin për buxhetet vjetore. Po kështu, për mbulimin apo zbutjen e deficiteve korrente qe mund te dalin

gjate zbatimit te buxhetit vjetor, sipas nenin 4 te ligjit nr. 10487, date 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, teprica e të ardhurave te degëve te tjera transferohet për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve.

Ne këtë kontekst, shpenzimet për degën e pensioneve znë 79.7% te volumit total te shpenzimeve te sistemit te sigurimeve shoqërore dhe ne veçanti mbi 96.6% te shpenzimeve te sigurimit shoqëror te detyrueshëm. Për me tepër, për vitin 2012 rezultati financiar i ISSH, paraqitet me deficit me shume se i planifikuari, pasi janë tejkaluar shpenzimet mbi te ardhurat ne shumën 928.1 milionë leke, deficit ky, i cili ka thelluar edhe me shume humbjen e degës se pensioneve. Gjithashtu, duke e krahasuar rezultatin financiar te kësaj dege për disa vite, rezulton se deficitin e degës se pensioneve është thelluar nga viti ne vit dhe bazuar ne treguesit e buxhetit afatmesëm, parashikohet te thellohet edhe ne tre vitet e ardhshme, duke bere domosdoshmërinë e marrjes se masave konkrete dhe reformimin e sistemit te Sigurimeve Shoqërorë.

Pikërisht, marr shkas nga volumi i shpenzimeve te degës se pensioneve e sidomos nga rritjen e deficitit, auditimi u përqendrua duke analizuar, hollësisht, deficitin e degës se pensioneve dhe arsyet e rritjes se tij, si me poshtë:

- Përfitimet (shpenzimet për sigurimin shoqëror te detyrueshëm) që parashikon ligji nr 7703, date 1.5.1993, financohen (mbulohen) nga:

a) Kontributet e drejtpërdrejta:

Këto të ardhura, perfaqesojne, kontributet e personave te siguruar dhe te punëdhënësve te tyre te sektorit publik dhe sektorit privat. Këto kontribute, llogariten dhe paguhen ne baze te pagës mujore bruto dhe kane si tavan 5 fishin e pagës minimale qe përcaktohet çdo vit me VKM.

b) Kontributet nga buxheti i shtetit.

Këto të ardhura, perfaqesojne:

- Kontributet: për personat qe nuk mund te paguajnë kontribucione, kategori këto te përcaktuara ne dispozita ligjore te veçanta si, punonjësit qe marrin një pagese nga sigurimi i papunësisë, shtetasit qe mbulohen nga skema përfitimesh ose trajtimesh te caktuara me akte ligjore e nënligjore, për personat që kryejnë shërbimin e detyrueshëm ushtarak, për gratë për aq vite sa kanë kryer shkollën e lartë me shkëputje nga puna, për punëtorët e nëntokës nën trajtim financiar të veçantë, për punëtorët e Industrisë Ushtarake nën trajtim financiar të veçantë, për personat që trajtohen me pagesë, për shkak se u shërbejnë paraplegjikëve, për personat që trajtohen me pagesë deri në një vit si të ardhur për papunësinë, për shkak të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës, për personat që trajtohen me pagesë kalimtare etj.

- Subveconet e buxhetit te shtetit për mbulimin e diferencës midis shumës se kontributit minimal dhe shumës vjetore te kontributit te përcaktuar me VKM për personat e vetëpunësuar ne bujqësi, sipas nenit nr. 4 te ligjit për buxhetin e vitit 2012, ku përcaktohet se: “Këshilli i Ministrave ka të drejtë të përcaktojë një kontribut të veçantë minimal për personat e vetëpunësuar në bujqësi dhe për kategoritë specifike të personave të vetëpunësuar. Diferenca ndërmjet kontributeve të veçanta me kontributin minimal mbulohet nga transferata e Buxhetit të Shtetit, por jo më shumë se kufijtë e transfertave të përcaktuara në këtë ligj”.

-Te ardhurat e tjera, duke përfshirë gjobat, te ardhurat nga veprimtaritë administrative te sigurimit shoqëror , dhuratat, trashëgimit, etj.

- Subvencionet te buxhetit te shtetit për te mbështetur shpenzimet shtese, si pasoje e indeksimit qe behet sipas këtij ligji, miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe qe përcakton ky ligj dhe, subvencione te buxhetit te shtetit për mbulimit te shpenzimeve, kur te ardhurat nuk mjaftojne.

▪ **Kontributet e buxhetit te shtetit për kategoritë e veçanta:**

Sipas nenit 9 të për sigurimet shoqërore në RSH, buxheti i shtetit paguan ne fondin e pensioneve, kontributet për kategori të veçanta personash te sipercituar, për te bërë të mundur që periudha e trajtimit me përfitim, për këta persona, të njihet si periudhë sigurimi per efekt pensioni.

Llogaritjet e kontributit bëhen bazuar ne pagën referuese ose me pagën minimale dhe bazuar me normat e caktuara ne tabelën e mësipërme. Procedurat e llogaritjes e te derdhjes, janë te përcaktuar ne dispozitat ligjore te veçanta për çdo kategori dhe ne Udhëzimin e Ministrisë te Financave nr 2, date 6.2.2012 “Për zbatimin e buxhetit”.

Për vitin 2012, numri i personave te mbuluar me kontribute te buxhetit te shtetit është 33,394 persona, ku rreth 50% te këtij numrit e përbejnë ushtaraket, punonjës te ndërmarrjeve ushtarake dhe ish punonjës te nentokës te cilët janë trajtuar dhe vazhdojnë te trajtohen me perfitim duke filluar nga mosha 42 vjeç deri ne moshen 60-65 vjeç. Gjithashtu, keta persona jane edhe përfitues mujore, pasi marrin trajtim financiar apo pension te parakohshëm, për vjetërsi shërbimi ne përputhje me aktet ligjore e ne ligjore te veçanta. Kështu, bashkimi i te gjitha perfitimeve qe financohen nga buxheti i shtetit sjell një efekt financiare te trefishte per buxhetin e shtetit per këta kategori personash. Sepse këto persona nuk kontribuojnë drejtpërdrejt për te plotësuar periudhën e sigurimit te përcaktuar me ligj, por buxheti i shtetit paguan për ata kontribute sipas pagës minimale ose sipas pagës referuese qe kane pasur para se te dilnin ne pension te parakohshem dhe ne momentin e plotësimit te moshës ata trajtohen me pension pleqërie, e cila per kategorinë e ushtarakeve, është ne nivelin e pensionit maksimal.

Veç sa sipër, rreth 11 mije nga personat e trajtuar si me lart përfitojnë edhe pension suplementar, duke e rritur edhe me tej barrën e financimit.

Ne tabelen e mëposhtme jepen kontributet qe ka financuar buxheti i shtetit per vitin 2012, per keto kategori të veçanta te përfituesve, si vijon:

në mije/leke

a. Kontribute per ushtaret	25
b. Persona ne pagese papunesie	691
c. Police ne reforme e pension parakohshem	135
d. Pagese kalimtare	25
e. Gra te pensionuara ne vitin planifikues	171
f. Te tjera kategori minatore+pun.ind.ushtarake,parapl.	208
g) Kontribute per usht.pension parakohshem	1,500
Totali:	2,755,
Diference kontributi per tevetepunesuarit ne bujqesi	5,233
Shuma	7,988

Në lidhje me trajtimin dhe me përfitimet e këtyre kategorive, duhet te behet kujdes për mos zgjerimin e tyre me kategori te tjera, si dhe duhen gjetur rrugët dhe mundësitë e reduktimit të këtyre shpenzime (përfitimeve). Jo vetëm për faktin e kursimit te fondeve, por edhe te zbutjes se nivelit te përfitimit krahasuar me pensionet minimale, pasi kjo kategori përfiton pension rreh 4 here me te larte se pensoini maksimal, çka krijon disbalancim te forcave te punes ne privilegjim te kësaj kategorie dhe ne diskrimin te kategorive te tjerave.

- *Mbi rezultatin financiar sipas degëve te sigurimit, ne veçanti te degës se pensioneve.*

Bazuar ne nenin 66 dhe 68, pika 2, te ligjit 7703, date 1.5.1993, i ndryshuar, me te ardhurat nga kontributet e secilës degë do të përballohen shpenzimet e çdo dege. Diferenca e shpenzimeve me te ardhurat nga kontributet, (rezultati financiar) sipas degëve është si më poshtë:

në milionë/lekë

Deget	2009	2010	2011	2012
Sëmundje	407	126	122	118
Barrë lindje	2,479	1,573	1,453	1,123
Pensione	-9,814	-14,988	-16,267	-22,437
Aksidente në punë dhe sëm. profesionale	511	444	474	488
Totali:	-6,418	-12,845	-14,218	-20,707

Siç shihet nga tabela, deficitin e degës së pensioneve në vitin 2012 rezultojnë në shumën 22,437 milionë leke; ndërsa rezultojnë me tejkalim të të ardhurave mbi shpenzimet dega e sëmundjeve për 118 milionë leke, dega e barrëlindjeve për 1,123 milionë leke dhe dega e aksidenteve dhe sëmundjeve profesionale për 488 milionë leke. Në total, të tre degët kanë një tepricë të ardhurash prej 1,729 milionë leke.


Sipas nenin 68 pika 2 të ligjit të sigurimeve shoqërore dhe nenit 4 të ligjit për buxhetin e shtetit, tepricat e degëve të sigurimeve shoqërore dalë pas zbritjes së kontributeve të përcaktuar në nenin 8, përdoren për mbulimin e deficitit të degës së pensioneve, konkretisht:

Deget	në milione/leke			
	2009	2010	2011	2012
Sëmundje	13	0.0	0.0	0.0
Barrëlindje	1,557	1,078	792	565
Aksidente në punë dhe sëmundje profesionale	505	440	469	484
TOTALI	2,074	1,519	1,261	1,049
Deficiti i degës së pensioneve 2	-6,418	-12,845	-14,218	-20,707
Deficiti i degës së pensioneve 2 / GDP	-0.56	-1.05	-1.10	-1.49

Përfundimisht, deficitin faktik të vitit 2012 në degën e pensioneve i cili mbulohet me subvencione buxhetore është 20,707 milionë leke. Dhe vetëm në vitin ushtrimor 2012 ky deficit është tejkaluar me 928.1 milion leke mbi deficitin fillestar të miratuar me ligjin për buxhetin e shtetit të vitit 2012, i cili ishte planifikuar në shumën 19,779 milion leke.

Deficiti i degës së pensioneve nga viti në vit është rritur me rritjen e shpjeguar, dhe vetëm për vitin 2012 krahasuar me Prodhimin e Brendshëm Bruto është rritur me 1,54% të tij, i cili sipas pasqyrës fiskale të Ministrisë së Financave është 1,346,169 milion leke (20,707 milionë leke: 1,346,169 milionë leke x 100) dhe krahasuar me vitin 2009 ky deficit është rritur me rreth 14.3 miliardë leke.

Parashikimin e tendencës në rritje të deficitit të degës së pensioneve ndaj PBB-së, për tre vitet e ardhshme, në mënyrë grafike, paraqitet si me poshtë:



Në mbyllje, paraqesim shkaqet kryesore të përkeqësimit të qendrueshmerisë financiare të skemës së sigurimeve shoqërore, të cilat kanë krijuar një deficit tepër të madh të degës së pensioneve, dhe konkretisht:

1. Mosrealizimi i të ardhurave të programuara nga shmangia e pagesës së kontributeve nga të punësuarit në subjektet juridike fizike, ka sjell një nivel mjaft të ulët të numrit të kontribuuesve që mbledhen nga DPT. Nga ky evazion fiskal plani vjetor fillestar i të ardhurave prej 48,604 milion leke është realizuar 95.55 % duke krijuar një deficit prej 2,166 milionë leke. Ky deficit

diktoi daljen e aktit normative te KM, me te cilin plani i te ardhurave ne fundit te vitit 2012 u ndyshua duke u ulur ne 47,604 milionë leke, **per pasoje deficiti i planifikuar u reduktua ne 1,166 milione leke**. Ky deficit kaq i madh është krijuar nga mosmbledhja e të ardhurave:

- Nga 15,699 subjekte paguese te biznesit te madh në shkallë vendi, 2,870 prej tyre ose 18.28%, kane nje te punesuar. Numri i te punesuarve ne keto subjekte qe sigurohen me pagen minimale eshte 35,392 persona, ose 18.76% ndaj numrit gjithsej te kontributpaguesve.

- Nga 61,368 subjekte pagues te biznesit te vogel ne shkalle vendi, 37,572 prej tyre ose 61.2% kane nje te punësuar. Numri i te punësuarve ne keto subjekte qe sigurohen në kufirin e pages minimale është 56,542 persona ose 71.2% ndaj numrit gjithsej te kontributpaguesve.

(Ne te dhenat e mesiperme nuk janë perfshire subjektet e pa regjistruara dhe te pa licencuar te cilat janë 100% informale dhe perbejne nje rezerve te madhe ne mbledhjen e te ardhurave).

Pra, mos mbledhja e kontributeve si dhe mossigurimi ne nivelin e pages faktike te te punësuarit krijon një rezerve te madhe te ardhurash, për pasoje ndikon ndjeshëm ne deficitin e degës se pensioneve.

2. Gjendja e detyrimeve te kontributeve te pa paguara nga subjektet juridik e fizik ne fund te vitin 2012 është 8,054 milionë leke dhe vetëm këtë vit janë shtuar këto detyrime me 320 milione leke. Këto detyrime qe perfaqesojne, kontributet dhe interesa te papaguara zenë rreth 8.9% te totalit te te ardhurave te planifikuar te vitit 2012 dhe vetëm detyrimet e krijuar ne këtë vit zënë, rreth 34% te deficitit te krijuar ne vitin 2012 (320,089 mije leke : 928.100 mije leke).

3. Të ardhurat nga të vetëpunësuarit në bujqësi qe mblidhen nga ISSH janë programuar 2,550,000 mijë lekë dhe janë realizuar 2,163,686 mijë lekë ose 84.9%, me një mosrealizim prej 386,314 mijë lekë. Faktorët që kanë influencuar në mosrealizimin e të ardhurave nga kontributet e të vetëpunësuarve në bujqësi, janë: largimi i një pjese të popullsisë nga zonat rurale në drejtim të zonave urbane, dhe tërheqje nga skema e 46,222 persona ose mbi 25%, që kanë plotësuar vjetërsinë e nevojshme prej 35 vitesh punë te cilët nuk paraqesin interes për sigurim, sepse nga sigurimi mbi 35 vjet, nuk përfitojnë shtese pensioni. ***Pra nga sigurimi i këtyre do te kishin një shtese te ardhurash duke ndikuar pozitivisht ne deficitit te degës se pensioneve.***

4. Numri mjaft i larte i personave qe nuk përfshihen ne skemen e Sigurimeve Shoqërore ne fshat, konkretisht, duke ju referuar te dhënave te ISSH, numri fizik i personave qe nuk kane paguar kontribute si persona te vetpunesuar ne bujqësi per viti 2012 është rreth 111,709 persona, ***duke krijuar një evazion te llogaritur ne shumën 2, 319 milionë leke, dhe për pasoje nje rezerve te madhe te ardhurash për mbulimin e deficitit te degës se pensioneve .***

5. Të ardhurat nga sigurimi vullnetar janë realizuar 93.9%, me një mosrealizim prej 23,331 mijë lekë. Ky mosrealizim ka ardhur ne mënyre te drejtpërdrejtë nga mosrealizimi i numrit te personave te siguruar. Bazuar ne te dhënat statistikore te ISSH, për vitin 2012 numri fizik i kontribuuesve të siguruar vullnetarisht u realizua 4,484 persona, por në krahasim me vitin 2011 rezultojnë 793 persona më pak, ***çka përben një rezervë tjetër te ardhurash qe ndikon deri diku ne mbulimin e deficitit te degës se pensioneve .***

6. Problemet ne lidhje me lejet e barrlindjeve, ku ne disa raste eshte konstatuar se sigurimi behet paslindjes, me qellim perfitimin e raportit mjeksor, duke shtuar ***ne menyre te padrejte shpenzimet, per pasoje ndikojne ne thellimin e deficitit te degës se pensioneve.***

7. Problemet e konstatuara ne vendimmarrjet e KMCA, Rajonale dhe Eprore per dhenien e invaliditetit, kane sjell raste te shumta te informalitetit ne dhenien e pensioneve te kesaj kategorie, ***me pasoje shtimin e padrejte te shpenzimeve per invaliditetit, duke thelluar keshtu me shume deficitin e degës se pensioneve.***

8. Ne vitin 2012 shuma e shpenzimeve për komisione të pagesave të përfituar nga Posta Shqiptare për shërbimin e pagesave të pensioneve janë në vlerën në 499.3 milionë leke. Këto shpenzime krahasuar me vitin 2006 janë rritur me rreth 200 milionë leke ose 70% më tepër. Ndërsa numri i personave dhe pensionistëve që u kryhet shërbimi që nga viti 2006 deri në vitin 2012 është rritur vetëm me rreth 10%. ***Pra, kemi një rritje të pa drejte të këtyre shpenzimeve duke thelluar në mënyrë të panatyrshme deficitin e degës së pensioneve.***

9. Si pasojë e rritjes së inflacionit, gjatë vitit 2012, shpenzimet për pensione u shtuan për 4,476.4 milionë leke ose 5.4 %, më shumë se viti. Por rritja e pensioneve, nuk ka ardhur në raport të drejtë me rritjen e inflacionit të këtij viti, pasi pensionet janë rritur 5.4%, ndërsa inflacioni sipas të dhënave zyrtare të INSTAT është 3 deri në 4%. ***Kjo rritje nuk është shoqëruar me rritje të të ardhurave nga kontributet e drejtpërdrejta, për pasojë efektet e rritjes mbi nivelin e inflacionit janë mbuluar me subvencione buxhetore, të cilat janë rritur nga viti në vit, çka ka thelluar deficitin e degës së pensioneve.***

10. Gjatë vitit 2012, ka pasur shtesë të shpenzimeve edhe nga rritja e numrit të përfituesve në skemat e pensioneve në krahasim me vitin 2011, por kjo rritje nuk është shoqëruar me rritje të numrit të kontribuesve. Kjo rritje ka impakte pozitive, pasi ndikon në rritjen e transfertave në buxhetet familjare dhe të të ardhurave të pensionistëve, ***por nderkohe ndikon në përkeqësimin e rezultatit financiar të degës së pensioneve, sepse rrit ndjeshëm subvencionet për mbulimin e shpenzimeve.***

11. Për vitin 2012, numri i personave të mbuluar me kontribute të buxhetit të shtetit për kategoritë veçanta personash është 33,394 persona dhe rreth 50% të këtij numri e përbejnë ushtarakët dhe ish punonjësit e nentokës. Kjo kategori trajtohet me përfitim, duke filluar nga moshë 42 vjeç deri në moshën 60-65 vjeç. Bashkimi i të gjitha përfitimeve që financohen nga buxheti i shtetit për këto kategori sjell një efekt financiar të trefishtë apo të katërfishtë për buxhetin e shtetit, çka ndikon në deficitin e degës së pensioneve si dhe krijon disbalancime të theksuara në masën e përfitimit të pensionit me midis kategorive të tjera.

Deficiti aktual mjaft i lartë në degën e pensioneve me tendencë në rritje në vitet e ardhshme, dikton nevojën e ndërmarrjes së një reforme të plotë për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore në lidhje me:

- **Nivelin i personave të siguruar,** pasi shkalla e mbulimit të popullsisë me elementet e sigurimit shoqëror është e ulët, ngaqë pjesëmarrja me kontribute është rreth 65% e të gjithë forcave aktuale të punës.
- **Formulën aktuale të pensionit,** pasi formula nuk ofron nxitje të mjaftueshme për pjesëmarrje me kontribute, për arsye se pensioni maksimal është i limituar sa dy herë e pensionit minimal edhe pse paga më e lartë është pesë herë më e madhe se paga më e ulët.
- **Evazionin fiskal,** i cili është shumë i lartë si pasojë e informalitetit dhe të deklarimit të të ardhurave më të vogla se sa janë në realitet, çka sjell pakësimin e bazës kontributeve si dhe nuk nxit apo motivon punonjësit me të ardhura mesatare apo me të ardhura të larta për të deklaruar e paguar kontribute sipas të ardhurave faktike që marrin.
- **Me mënyrën dhe rregullat e indeksimit të pensioneve,** pasi shkalla e zëvendësimit të pagës me pensionin në momentin kur personat dalin në pension pleqërie është e ulët për punonjësit me paga mesatare dhe me paga të larta. Rritja e pensioneve dhe e pagave nga rritja e inflacionit në vlerë absolute nuk vjen në raport të drejtë, për pasojë përfitimet për pensione rriten me pak dhe kontributet nga pagat rriten me shumë.

- **Trajtimet e favorshme për banorët ruralë**, pasi konstatohen trajtime mjaft të favorshëm si ne sistemin e kontributeve ashtu edhe te pensioneve (përfitimeve), për banorët ruralë, sepse buxheti i shtetit financon rreth 55% te kontributeve për këta banore.
- **Skemat shtetërore te veçanta dhe suplementare**, pasi konstatohen, mbulime me subvencione buxhetore edhe për skemat shtetërore të veçanta dhe suplementare, shpenzimet për përfitime te cilat vazhdojnë te rriten nga viti ne vit.
- **Sistemin e pensioneve**, pasi dega e pensioneve është me deficit i cili ka arritur ne rreth 1.5% të PBB-së etj. etj.

IX.2 BUXHETI I SIGURIMEVE SHËNDETËSORE

Miratimi i buxhetit të sigurimeve shëndetësore është bërë me legjislacionin e sipërcituar, si ligji i buxhetit të shtetit të vitit 2012 dhe ligjet nr. 99/2012, datë 18/10/2012 dhe nr. 126/2012, datë 20/12/2012, për miratimin e aktit normativ me fuqinë e ligjit.

Referuar dispozitave ligjore të mësipërme, pas ndryshimeve përfundimtare, programi financiar për sigurimet shëndetësore, paraqitet si më poshtë:

- a) *Të ardhurat gjithsej*, janë programuar në shumën 28,934 milionë lekë, nga të cilat nga mbledhja e kontributeve 6,436 milionë lekë, transferata e buxhetit të shtetit 22,498 milionë lekë.
- b) *Shpenzimet gjithsej*, janë programuar në vlerën 28,934 milionë lekë, nga të cilat për financimin e shërbimit spitalor 13,371 milionë lekë; financimin e kujdesit shëndetësor parësor 6,650 milionë lekë; rimbursimin e barnave 7,446 milionë lekë; financimin e spitalit Durrës 685 milionë lekë; investime 100 milionë lekë; dhe shpenzime administrative 682 milionë lekë. Këto shpenzime janë planifikuar të përballohen me të ardhurat e programuara si më sipër.

Treguesit përfundimtarë të të ardhurave dhe shpenzimeve për ISKSH për vitin 2012, paraqiten në tabelën e mëposhtme:

në milionë/lekë

TË ARDHURAT				SHPENZIMET		
1.	Nga kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	6,436	22.2%	Rimbursimi i barnave	7,446	25.7%
1.a	Të ardhura nga DPT	6,056		Financimi i kujdesit shëndetësor parësor	6,650	23%
1.b	Të ardhura nga ISSH	190		Financimi i shërbimit spitalor	13,371	46.2%
1.c	Të ardhura nga IKSH	190		Financimi i spitalit Durrës	685	2.37%
2.	Transferime nga buxheti i shtetit Nga të cilat:	22,498	77.8%	Investime	100	0.36%
2.a	Për kujdesin parësor	9,127		Shpenzime administrative	682	2.37%
2.b	Për kujdesin spitalor (me thesar)	13,371				
TOTALI:		28,934	100%	TOTALI:	28,934	100%

Burimi: ISKSH

Përsa më sipër, në planifikimin e të ardhurave peshën më të madhe specifike e zenë transfertat e buxhetit të shtetit në masën 77.8% dhe diferencën prej 22.2% të ardhurat nga kontributet. Këto të fundit në shumën gjithsej 6,436 milionë lekë janë programuar të sigurohet: - nga DPT në shumën 6,056 milionë lekë, nga ISSH 190 milionë lekë dhe ISKSH 190 milionë lekë.

Në lidhje me transfertën e buxhetit të shtetit ajo është e ndarë, përkatësisht:

- shuma 13,371 milionë lekë për shërbimin e kujdesit spitalor, dhe
- shuma 9,127 milionë lekë për shërbimin e kujdesit parësor.

Kurse, në planifikimin e shpenzimeve buxhetore, peshën më të madhe specifike e zenë shpenzimet për shërbimet spitalore në masën 46.2%, ndjekur nga ato për rimbursimin e barnave në masën 25.7% dhe shpenzimet për kujdesin shëndetësor parësor në masën 23%.

□ Rialokimi dhe reflektimi i ndryshimeve brenda zërave.

Gjatë vitit 2012, treguesit buxhetorë kanë reflektuar disa ndryshime, si vijon:

1. Me VKM nr. 890, datë 21.12.2012, është miratuar “*rishpërndarja e fondeve buxhetore brenda programeve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë, në buxhetin e vitit 2012*”, sipas të cilës:

- Është pakësuar artikulli 604 (transfera korrente e brendshme në programin buxhetor 07220 “Shërbime të kujdesit parësor”), për 70 milionë lekë;
- Është shtuar artikulli 604 (transfera korrente e brendshme në programin buxhetor 07330 “Shërbime të kujdesit dytësor”, për 70 milionë lekë; me destinacion për Spitalin Fier, për mbulimin e shpenzimeve të dializës.

Mbi këtë bazë, me vendimin e Këshillit Administrativ nr. 101, datë 27.12.2012 janë bërë korrigjimet përkatëse në buxhetin e ISKSH-së, për vitin 2012, si vijon:

a) Në zërat e të ardhurave janë realizuar ndryshimet përsa i përket transfertës së buxhetit të shtetit (shtesa e pakësime të balancuara për 70 milionë lekë):

- Është pakësuar artikulli 604 programi 07220 “Shërbime të kujdesit parësor” për 70 milionë lekë.; dhe është shtuar artikulli 604, programi 07330 “Shërbime të kujdesit dytësor” për 70 milionë lekë.

b) Në zërat e shpenzimeve janë realizuar ndryshimet (shtesa e pakësime të balancuara për 505 milionë lekë):

- Është shtuar plani i shpenzimeve të rimbursimit për 435 milionë lekë; po kështu plani i shpenzimeve për spitalet që financohen nga thesari për 70 milionë lekë.
- Është pakësuar plani i shpenzimeve të kujdesit parësor (QSH) për 390 milionë lekë, po kështu është pakësuar plani i shpenzimeve administrative për 25 milionë lekë, si dhe plani i shpenzimeve për investime të ISKSH për 90 milionë lekë.

Nga analiza e tendencave të buxhetit të ISKSH, nga auditimi rezultoi se, në vitin 2012 në krahasim me programin e vitit 2011, buxheti i ISKSH-së është rritur në vlerë absolute për 1,167 milionë lekë, ose në masën 4.2%, ndërsa krahasuar me faktin e vitit 2011, buxheti është rritur me 7.6%.

Detajimi i zërave të buxhetit për çdo DRSKSH dhe DSKSH është kryer me shkresën nr. 366/1 prot, datë 14.2.2012, kurse procedurat e zbatimit të tij janë mbështetur në Udhëzimin e ISKSH nr. 1, datë 14.2.2012 «Për zbatimin e buxhetit të ISKSH». Në përgjigje të këtyre shkresave, çdo DRSKSH dhe DSKSH ka detajuar buxhetin për çdo muaj dhe këtë sistem treguesish ia ka referuar Drejtorisë Ekonomike të këtij institucioni.

Për sa sipër, në mënyrë të përmbledhur e përfundimtare ndryshimet në zërat e buxhetit (ISKSH +Spitalet), sipas akteve respektive paraqiten si vijon:

në mijë/lekë

Emërtimi	Buxheti fillestar VKA nr.1, datë 13.02.2012	Ndryshimet gjatë vitit 2012: VKA nr.101 dt. 27.12.2012 dhe VKM nr. 890, dt.21.12.2012	Buxhet përfundimtar 2012	Realizimi faktik buxhet 2012
A. Të ardhurat gjithsej:	28,934,000	0.0	28,934,000	29,030,573
1. Nga kontributet e sigurimeve shëndetësore	6,246,000	0.0	6,246,000	6,467,034
2. Transferta e buxhetit të shtetit gjithsej, nga kjo:	22,498,000	0	22,498,000	22,439,331
2.1 Kujdesi parësor	9,127,000	- 70,000	9,057,000	9,057,000
2.2 Kujdesi spitalor	13,371,000	70,000	13,441,000	13,382,331
3. Të ardhura të tjera	190,000	0.0	190,000	124,208
B. Shpenzimet gjithsej:	28,934,000	0.0	28,934,000	28,828,476
1. Rimbursimi barnave	7,446,000	435,000	7,881,000	7,880,269
2. Kujdesi parësor (QSH)	6,650,000	-390,000	6,260,000	6,246,328
3. Shpenzime administrative ISKSH	682,000	-25,000	657,000	631,782
4. Investime ISKSH	100,000	-90,000	10,000	2,766
5. Financimi i Spitalit të Durrësit	685,000	0.0	685,000	685,000
6. Financimi i Spitaleve nga degët e thesarit	13,371,000	70,000	13,441,000	13,382,331
C. Diferenca (A-B):	0.0	0.0	0.0	202,097

Burimi: Drejtoria Ekonomike, ISKSH.

Në mbështetje të nenit 5, të ligjit nr. 10 487, datë 5.12.2011 “Për buxhetin e vitit 2012”, buxheti i Shërbimit të Kujdesit Spitalor, edhe për vitin 2012 ka vazhduar të detajohet dhe përdoret me Vendim të Këshillit të Ministrave, si dhe të lëvrohet nëpërmjet degëve të thesarit nëpër rrethe.

Plani vjetor i të ardhurave dhe shpenzimeve me ndryshime të vitit 2012 dhe realizimin e tij vetëm për ISKSH (pa spitalet), në strukturë paraqitet si vijon:

në mijë/lekë

Buxheti per vitin 2012	Plani vjetor 2012 me ndryshime	Realizimi	Diferenca	Realizimi në %	Pesha specifike (fakt) në %
I. Të ardhurat gjithsej	15,493,000	15,648,242	-155,242	101.0	100.0
1. Kontributi sigurimeve shendetesore	6,246,000	6,467,034	-221,034	103.5	41.3
2. Kontributi i Buxhetit te shtetit	9,057,000	9,057,000	0.0	100.0	57.9
3. Te ardhura te tjera	177,250	112,755	64,495	63.6	0.7
4. Sigurimi vullnetar	12,750	11,453	1,297	89.8	0.1
5. Fond Rezervë	0.0	0.0			
II. Shpenzimet gjithsej	15,493,000	15,446,146	46,854	99.7	100.0
1. Rimbursimi i barnave (likuidimi)	7,881,000	7,880,269	731	100.0	51.0
2. Shpenzime kujdesi parësor	6,260,000	6,246,328	13,672	99.8	40.4
- Buxhet fiks (80%)	5,241,759	5,230,811	10,948	99.8	
- Buxhet për aktivitet (10%)	618,691	616,990	1,701	99.7	
- Bonus (10%)	399,550	398,527	1,023	99.7	
3. Shpenzimet administrative	657,000	631,782	25,218	96.2	4.1
- Paga (600)	451,119	432,732	18,387	95.9	
- Sigurime (601)	70,960	69,534	1,426	98.0	
- Mallra e shërbime (602)	128,379	123,082	5,297	95.9	
- Shpërblimi e fond i veçantë për	6,542	6,434	108	98.4	

administratën					
4. Investime	10,000	2,766	7,234	27.7	0.1
Ndertim Montime	6,600	1,024	5,576	15.5	
Pajisje per zyrtar	2,430	412	2,018	17.0	
Softëare	500	413	87	82.6	
Autovetura	470	918	-448	195.2	
5. Shpenzime per Spitalin Durres	685,000	685,000	0.0	100.0	4.4
<i>Financim:</i>	685,000	685,000	0.0	100.0	
- paga (600)	387,000	387,000	0.0	100.0	
- sigurime (601)	62,000	62,000	0.0	100.0	
- mallra e shërbime (602)	236,000	236,000	0.0	100.0	
III. Diferenca te ardhura - shpenzime	0.0	202,097	-202,097		
Spitalet me thesar					
- Pagat	6,493,758	6,476,307		99.7	
- Sigurimet shoqërore dhe shëndetësore	1,057,660	1,048,270		99.1	
- Mallra e shërbime	5,889,582	5,857,754		99.5	
- Rezerva	0.0	0.0			
Shuma spitalet me thesar:	13,441,000	13,382,331	58,669	99.6	
TOTALI ISKSH+SPITALET:	28,934,000	28,828,477	105,523	99.6	

Burimi: Drejtoria Ekonomike, ISKSH.

-Analiza e të ardhurave

Te ardhurat e ISKSH në total janë realizuar në vlerën 15,648.2 milionë lekë, ose në masën 101%, me një tejkalim në vlerë prej 155.2 milionë lekë me shumë se programimi.

Realizimi i të ardhurave të buxhetit ISKSH-së (me ndryshimet), paraqitet si vijon

në mijë/lekë

TË ARDHURAT	Programimi	Fakti	Realizimi në %	Pesha specifike në fakt
Kontributi i Shtetit	9,057,000	9,057,000	100.0	57.9%
Kontributi i Sigurimeve Shëndetësore	6,246,000	6,467,034	103.5	41.3 %
Te ardhura te tjera	190,000	124,208	65.3	0.8 %
Totali:	15,493,000	15,648,242	101.0	100%


Burimi: Drejtoria Ekonomike, ISKSH.

Ne krahasim me vitin 2011 të ardhurat faktike në total janë rritur 12% , ose në vlerë absolute rreth 1,683 milionë lekë.


Në shifër relative të ardhurat nga kontributet e sigurimeve shëndetësore rezultojnë me rritje në masën 7.2%, ndërsa kontributi i shtetit ka pësuar një rritje prej 15.9%,.

Në shifër absolute, të ardhurat nga kontributet kanë pësuar rritje 437.4 milionë lekë, ndërsa kontributi i shtetit ka pësuar një rritje prej 1,245 milionë lekë.

Në mënyrë grafike, realizimi i të ardhurave për vitin 2012 krahasuar me vitin 2011, paraqitet si më poshtë:



Në strukturën e të ardhurave të vitit 2012, peshën specifike më të lartë e zënë të ardhurat nga kontributi i shtetit me 58%, me një rritje prej 2.1% krahasuar me vitin 2011. Kontributet e sigurimeve shëndetësore zënë rreth 41%, ndërsa grupimi i të ardhurave të tjera zë rreth 1%.



Shuma e kontributeve të sigurimeve shëndetësore, të transferuara në llogarinë e ISKSH-së për vitin 2012 është 6,467 milionë lekë, nga të cilat 6,381 milionë lekë të ardhura të siguruara nga DPT dhe 86 milionë leke nga kontributi i fermerëve.

Në bazë të konstatimeve të ISKSH që bazohen në evidencat e siguruara nga DPT, rezultojnë se për vitin 2012, nga DPT janë arkëtuar kontribute të sigurimeve shëndetësore rreth 6,694 milionë lekë, ose 313 milionë lekë më shumë se sa vleftat që janë transferuar në llogaritë e ISKSH. KLSH konstaton se problematike vijon të mbetet detyrimi i prapambetur i ISSH ndaj ISKSH-së, i pa likuiduar nga viti 2011.

Përsa u përket të ardhurave nga kontributet shëndetësore të fermerëve, të cilat arkëtohen nga strukturat përkatëse të ISSH-së në rrethe e rajone, ato janë realizuar ose në masën rreth 45% dhe në vlerë janë transferuar në llogaritë e ISKSH-së gjithsej 86 milionë lekë, nga 190 milionë lekë të programuara. Në këtë nivel të ulët të realizimit të këtij treguesi, ka ndikuar fluksi më i madh i sigurimit të fermerëve gjatë muajit dhjetor, dhe rrjedhimisht transferimi i shumave përkatëse në llogaritë e ISKSH bëhet gjatë muajit Janar.


Në mënyrë të përmbledhur, gjendja e marrëdhënieve të detyrimeve ISSH – ISKSH për TSA, rakorduar me datën 16.2.2013, paraqitet si vijon:

- Detyrimi kontributeve nga viti 2011 (çelje me 1.1.2012)	669,233 mijë lekë
- Sigurime shëndeti akumuluar gjatë vitit:	6,676,372 mijë lekë
- Sigurim shëndetësor i transferuar për llogari të vitit 2012:	6,381,100 mijë lekë
- Gjendje (mbetje me 31.12.2012)	964,505 mijë lekë

Transferta nga buxheti i shtetit

Sipas programimit fillestar dhe ndryshimeve të mëvonshme, të bëra deri në fund të vitit 2012, janë arkëtuar nga ISKSH janë arkëtuar nga ky burim 9,057 milionë lekë. Transferimet janë bërë çdo muaj, bazuar në raportimet përkatëse të ISKSH, në zbatim të Udhëzimeve të Ministrisë së Financave.

Krahasimi i realizimit të të ardhurave ndaj planit, për vitin 2012, grafikisht paraqitet si vijon:



Përsa më sipër, të ardhurat e tjera përbëjnë 1% të totalit të të ardhurave të ISKSH për vitin 2012. Janë arkëtuar gjithsej 124.2 milionë lekë nga 190 milionë lekë të programuara, pra 65.8 milionë lekë me pak se programimi. Nga analiza rezulton se 39.4% e këtyre të ardhurave ose 48.9 milionë lekë, janë realizuar nga bashkëpagesa, 30.8% ose 38.3 milionë lekë nga dëmet ekonomike dhe kushtet penale të vendosura nga strukturat e kontrollit të ISKSH-së, në subjektet me kontrate (mjekë të qendrave shëndetësore, subjektet farmaceutike), 11.5% ose 14.3 milionë lekë nga interesat bankare, dhe pjesa tjetër nga shitja e shtypshkrimeve, kryesisht libreza kontributesh.

Vetëm 9.2% ose 11.4 milionë lekë janë arkëtuar nga sigurimet shëndetësore vullnetare. Shuma e këtyre të ardhurave në total për vitin 2012 është pothuajse në të njëjtat nivele me të ardhurat e realizuara gjatë vitit 2011.

-Analiza e shpenzimeve sipas natyrës.


Sa më sipër, shpenzimet vitin 2012, janë realizuar në vlerën 15,446.1 milionë lekë, ose në masën 99.7% kundrejt vlerës së programit, me një mosrealim nga parashikimi në shimën 46.8 milionë lekë.

Në tabelën e mëposhtme paraqesim të dhënat përmbledhëse për shpenzimet e ISKSH kapitalet me thesar, përsa vijon:

Shpenzimet	Programimi (Në mijë/lekë)	Fakti (Në mijë/lekë)	Realizimit (në %)	Pesha specifike e kuotave faktike
Shpenzime rimbursimi	7,881,000	7,880,269	100.0	51%
Shpenzime për parësorin	6,260,000	6,246,328	99.8	41%
Shpenzime administrative	657,000	631,782	96.2	4 %
Investime	10,000	2,766	27.7	0.0%
Shpenzime për Spitalin Durrës	685,000	685,000	100.0	4 %
TOTALI	15,493,000	15,446,146	99.7	100.0%


Nga analiza e këtyre të dhënave rezulton se, peshën kryesore në strukturën e shpenzimeve të zënë shpenzimet për rimbursimin e barnave me 51% të totalit ose në vlerë absolute janë shpenzuar 7,880 milionë lekë. Kujdesi parësor, apo financimi i qendrave shëndetësore renditet në vend të dytë me 41% të totalit ose me 6,246 milionë lekë; ndërsa shpenzimet e spitalit të Durrësit dhe ato të administratës së ISKSH zënë respektivisht nga 4%, kurse investimet zënë një vlerë të papërfillshme. Kjo situatë paraqitet duke analizuar vetëm të dhënat për atë pjesë të buxhetit që financohet direkt nga ISKSH.

E shprehur në trajtë grafike, strukturimi i shpenzimeve të buxhetit faktik të financuar direkt nga ISKSH-ja, paraqitet si vijon:



Në lidhje me realizimin faktik të shpenzimeve, rezultojnë me realizim në nivelin 100% shpenzimet për rimbursimin e barnave dhe financimin e Spitalit të Durrësit, ndërsa në zërat e tjerë të shpenzimeve konstatohen mosrealizime, dhe konkretisht në masën 27.7% investimet, 96.2% shpenzimet administrative dhe 99.8% shpenzimet për financimin e shërbimit të kujdesit parësor.

Në trajtë grafike, ballafaqimi i treguesve të programuar dhe atyre të realizuar për shpenzimet e vitit 2012 është:




Tendencat midis viteve:

Shpenzimet faktike gjatë vitit 2012 në krahasim me faktin e vitit 2011 janë rritur në vlerën 1,388 milionë lekë, ose niveli i realizimit është **109.9 %**, pasi nga 14,057.8 milionë lekë të shpenzuara gjatë vitit 2011, evidentohet se në vitin 2012 janë shpenzuar 15,446 milionë lekë.

Rritjen më të lartë e kanë pësuar:

- shpenzimet për rimbursimin e barnave me 997 milionë lekë, ose **14.5%** më shumë,

- shpenzimet për kujdesin shëndetësor parësor në total janë rritur me 343 milionë lekë ose **5.8%**, nga të cilat buxheti fiks është rritur me 217 milion lekë ose 4.3%, buxheti për aktivitet është rritur me 43 milion lekë ose 7.4 %, buxheti për bonus është rritur me 83 milion leke ose 26.3%.
-shpenzimet për spitalin e Durrësit janë rritur me **2.3 %** ose 15 milionë lekë.



1. Shpenzimet e Rimbursimit të Barnave:

Gjatë vitit 2012, shpenzimet e rimbursimit kanë qenë në nivelet e programuara pas rishikimit të buxhetit, ose nga 7,881 milionë lekë të planifikuara, janë likuiduar 7,880 milionë lekë. Në krahasim me vitin 2011, shpenzimet e rimbursimit të likuiduara janë rritur në vlerë absolute për 997 milionë lekë. Shuma prej 7,880 milionë përfaqëson vlerën e faturave të likuiduara nga njësitë e ISKSH, kurse vlera e faturave të pranuar është më e madhe, rreth 7,921 milionë lekë dhe diferenca prej 41 milionë lekë (7,921 milionë -7,880 milionë lekë), përfaqëson vlerën e rimbursimeve të likuiduara gjatë muajit janar 2013.

Nga auditimi u konstatua, se ritmet e pranimit dhe likuidimit të listë-treguesve në krahasim me vitin 2011 paraqiten me rritje. Kështu, nëse për vitin 2011 niveli mesatar i pranimit dhe i likuidimit rezultonte 576 milionë lekë rimbursime / muaj, gjatë vitit 2012 kjo shifër ka rezultuar mesatarisht 656.6 milionë lekë në muaj. Analizuar sipas periudhave 6/mujore, rezulton se ritmet mesatare mujore të pranimit të listë-treguesve kanë qenë pothuajse të njëjta, ose kanë variuar nga 656 milionë lekë në 6/mujorin e parë, në 663 milionë lekë në 6/mujorin e dytë. Nga strukturat periferike të ISKSH janë likuiduar normalisht çdo muaj detyrimet ndaj subjekteve farmaceutike, duke zbatuar detyrimin e përcaktuar në kontratën dypalëshe, ndërsa detyrimi i palikujduar paraqet vetëm detyrimin për rimbursimin e ditëve të fundit të vitit, i cili është likuiduar gjatë muajit janar 2013.

Shpenzimet e rimbursimit kanë zënë 51% të totalit të shpenzimeve faktike të ISKSH-së për vitin 2012, me një rritje si peshë specifike prej 2 % ndaj faktit të vitit 2011.

2. Shpenzimet për Shërbimin e Kujdesit Shëndetësor Parësor:

Gjate vitit 2012 janë konstatuar përmirësime në shërbimin shëndetësor parësor në drejtim të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj pacienteve, menaxhimit, administrimit dhe monitorimit të qendrave shëndetësore.

Nga ISKSH janë përballuar nevojat e qendrave shëndetësore për paga, sigurime shoqërore dhe mallra e shërbime, veçanërisht për mbulimin e nevojave për barnat që përdoren nga këto qendra. Referuar të dhënave, rezulton se treguesi i performancës është realizuar në nivel mbi 90%, nga 291 qendra shëndetësore, që ushtrojnë aktivitetin në 10 rajone; ndërsa treguesit e bonusit janë realizuar mbi 55% nga mbi 217 QSH, që veprojnë në 7 rajone.

Shpenzimet për financimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor zënë 41% të totalit të shpenzimeve faktike të ISKSH-se për vitin 2012.

3. Shpenzimet në Kujdesin Parësor, janë realizuar në total 6,246 milionë lekë, ndërkohë që plani përfundimtar i korigjuar ka qenë 6,260 milionë lekë, me një mosrealizim prej 14 milionë lekë. Kjo për arsye se buxheti për aktivitetet, që lidhet me realizimin e numrit të planifikuar të vizitave në shkallë vendi u realizua në nivelin 93% krahasuar me planin fillestar, ndërsa buxheti për bonus-et, që lidhet me treguesit e cilësisë, u realizua rreth 60% të planit fillestar. Kurse, realizimi i treguesve të Ofrimit të Paketës së Shërbimeve dhe Indikatorëve të Performancës në Kujdesin Shëndetësor (Parësor), për vitin 2012, sipas ISKSH paraqiten si vijon:


- Monitorimi i ofrimit të paketës së shërbimeve shëndetësore të kontraktuara nga QSH / (në kujdesin parësor):

a) Shtrirja e skemës:

Gjatë vitit 2012 janë futur në skemën e sigurimeve të kujdesit shëndetësor, nëpërmjet pajisjes me librezë shëndeti 146 mijë persona, ndërsa kanë përfutur mesatarisht gjatë vitit rreth 310 mijë persona.

b) Numri i personave që kanë përdorur shërbimet shëndetësore në kujdesin parësor:


Për vitin 2012 janë paraqitur për herë të parë për vizitë tek mjeku në QSH rreth 1,379,488 persona ose 301 mijë persona më shumë se në vitin e kaluar. Trendi i personave të paraqitur për vizitë në QSH gjatë viteve 2008- 2012, shprehet grafikisht më poshtë:



Nga analiza e këtyre të dhënave rezulton se për vitin 2012 janë paraqitur për herë të parë në vizitë tek Mjeku i QSH, rreth 20% më shumë pacientë se në vitin 2011.

c) Numri i vizitave të kryera nga Qendrat Shëndetësore (QSH) të Kujdesit Parësor:

Nga 421 qendrat shëndetësore të kontraktuara në kujdesin parësor për vitin 2012, janë kryer 5 milionë e 973 mijë vizita, nga të cilat: - 5.6 milionë vizita janë kryer nga mjeku i përgjithshëm dhe i familjes dhe 407 mijë vizita nga mjekët specialistë të QSH të Specialiteteve në Tiranë, Ky trend i numrit të vizitave të mjekëve të QSH të kujdesit parësor gjatë viteve 2008 – 2012 paraqitet në grafikun vijues:



Nga sa sipër, konstatohet se, për vitin 2012 nga mjekët e QSH në kujdesin parësor janë kryer 3.6% më shumë vizita se në vitin 2011, ose 218 mijë vizita më shumë.

Nga QSH në qytet (102 të tilla) janë kryer 3.9 milionë vizita, ndërsa në QSH fshat janë realizuar 1.8 milionë vizita, pra 66% janë realizuar në qytet dhe 34% në fshat. Në mënyrë grafike shpërndarja e vizitave qytet-fshat paraqitet si më poshtë,



- Nga auditimi i treguesve të buxhetit për Shërbimin Shëndetësor Parësor, të detajuar sipas rajoneve, konstatohet se ekziston një shpërndarje dispropocionale midis markimit të mjekëve të përgjithshëm e të familjes me personelin infermier e ndihmës, si pasojë e mungesës së përcaktimit të kritereve për këtë çështje, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe strukturave të tjera përgjegjëse. Konkretisht, vërehet se:

Në përcaktimin e numrit të personelit mjekësor dhe ngarkesën e mjekut të përgjithshëm e të familjes, krahas tarifave të shërbimeve shëndetësore, ekzistojnë rregullime sipas tre urdhrave të lëshuar nga Ministri i Shëndetësisë, konkretisht urdhri nr. 165, datë 17.7.1995 “Për ngarkesën e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes dhe tarifën e shërbimit shëndetësor”, që specifikon ngarkesë banorë/mjek të përgjithshëm e të familjes në qytet dhe në fshat; urdhri nr. 185, datë 4.8.1995 “Për një shtesë në urdhrin e mësipërm “Për ngarkesën e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes dhe tarifën e shërbimit shëndetësor”, që bën shtesë të treguesit për fëmijë; dhe urdhrin nr. 33, datë 14.2.1996 “Për një shtesë në urdhrin e Ministrit të Shëndetësisë nr. 165, datë 17.7.1995 “Për ngarkesën e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes dhe tarifën e shërbimit shëndetësor”, i ndryshuar, që bën shtesë kur mjeku i përgjithshëm është invalid i grupit III ose IV dhe ngarkesa e tij llogaritet në pjesëtim me orët e punës.

Si konkluzion: Nga auditimi i zërave të buxhetit të shërbimit shëndetësor parësor, konstatohet se raporti mjek i përgjithshëm ose i familjes, me personelin ndihmës ka luhatje të mëdha nga një DRSKSH në tjetrën dhe brenda një DRSKSH nga njëra QSH në tjetrën.

Në shkallë vendi, numri i mjekëve të përgjithshëm e të familjes gjithsej është 1684, kurse numri i personelit tjetër arrin në 7,353 punonjës gjithsej, ose i takon mesatarisht **4,37 punonjës të personelit mbështetës (PM) për 1 mjek** të përgjithshëm e të familjes (MPF). Kurse, në shkallë DRSKSH-je, raporti i personelit tjetër ndaj numrit të MP në QSH luhatet ndjeshëm, që nga niveli 3,4 (pra nën mesataren e vendit prej 4,37 PM/MPF) deri në 10,7 punonjës mbështetës për 1 mjek pra mbi 2 herë më të lartë se mesatarja e vendit).

Madje, në zona dhe QSH të ndryshme Brenda çdo DRSKSH-je ka devijacione të dukshme.

4. Shpenzimet Administrative:

Në vitin 2012, shpenzimet administrative faktike të ISKSH-së kapin vlerën 631.8 milionë lekë, ose 96.2% të programit vjetor të rishikuar, kjo e barabartë me 33.6 milionë lekë më shumë se në vitin 2011. Realizimi për çdo zë të shpenzimeve administrative paraqitet, për pagat e shpërblimet e punonjësve me rastin e festave të fundvitit 96.9%, për sigurime shoqërore e shëndetësore 96.6%, për mallra e shërbime 93.2%.

Nga auditimi u konstatua se të gjitha Drejtoritë Rajonale dhe aparati i Drejtorisë Qendrore si njësi shpenzuese, kanë ruajtur kufijtë e planifikuar të shpenzimeve sipas zërave.

5. Shpenzimet per Investime:

Plani fillestar i investimeve nga ana e ISKSH ishte parashikuar në vlerën e 100 milionë lekeve, por me rishikimin e këtij plani, ai u reduktua në 10 milionë lekë, duke parashikuar të realizohen vetëm 10% e tyre ose në shumën 10 milionë lekë. Nga kjo shumë për vitin 2012 u realizuan vetëm 2.7 milionë lekë ose në masën 27.7%, për rikonstrukcione të objekteve në Durrës e Tropojë dhe në Drejtorinë Qendrore etj.

6. Shpenzimet per Spitalin e Durrësit:

Për vitin 2012, ky spital është financuar sipas parashikimit në buxhetin e vitit në vlerën 685 milionë lekë, me një rritje ndaj vitit 2011 prej 2,3%, ose 15.5 milionë lekë më shumë. Financimi është bërë për të mbuluar tre zërat kryesorë të shpenzimeve korrente, konkretisht 387 milionë lekë për pagat, 62 milionë lekë për sigurimet shoqërore e shëndetësore dhe 236 milionë lekë për mallra e shërbime. Brenda fondeve të dhëna, Spitali i Durrësit ka aplikuar rritje të pagës mesatare prej 2-5% , me efekt financiar nga data 15 Korrik, sipas miratimit të Këshillit Administrativ (KA).

-Buxheti për shërbimin spitalor.

Ky buxhet për vitin 2012 u miratua me VKM nr. 15, datë 11.01.2012 “Për disa ndryshime në vendimin e KM nr. 140, datë 17.02.2010 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”. Gjatë vitit ky buxhet pësoi dy ndryshime me vendime të KM. Kështu, në muajin nëntor 2012, KM vendosi të shtojë shumën e buxhetit të shërbimit spitalor për 70 milionë lekë, duke pakësuar shpenzimet në kujdesin parësor po për 70 milionë lekë. Nga ana e KA gjatë vitit është shpërndarë pjesa e buxhetit rezervë të spitaleve në shumën totale 78.8 milionë lekë, rezervë e cila plotësoi kërkesat e spitaleve për mbulimin e efekteve financiare nga rritja e pagave dhe një pjesë të nevojave të spitalit Fier për shpenzimet e dializës dhe të spitalit Vlorë për ekzekutim të vendimeve gjyqësore për dëmtim shëndeti.

Në total, fondi për mbulimin e shpenzimeve të shërbimit spitalor sipas buxhetit të rishikuar është 13,441 milionë lekë. Sipas situacionit përfundimtar, janë shpenzuar 13,382 milionë lekë, ose në masën 99.6% e fondit të programuar. Nga shuma totale, për zërin paga janë shpenzuar 6,476 milionë lekë, për sigurime shoqërore e shëndetësore 1,048 milionë lekë dhe për mallra e shërbime 5,858 milionë lekë. Referuar këtyre shifrave rezulton se, në totalin e shpenzimeve korrente pagat zënë 48.4%, sigurimet shoqërore 7.8% dhe shpenzimet për mallra e shërbime 43.8%.

o Treguesit e efektivitetit dhe performancës së Spitaleve:

Në vitin 2012, ISKSH-ja ka lidhur kontratat përkatëse me 24 spitale të nivelit bashkiak, 11 spitale nivel qarku dhe 4 spitale të nivelit universitar. Në VKM-në nr. 15, datë 11.1.2012 “Për disa ndryshime në vendimin nr. 140, datë 17.2.2010 të KM “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, të ndryshuar, është përcaktuar që:

“Spitalet janë të detyruara të llogarisin shpenzimet faktike të çdo shërbimi, në përputhje me standardet e caktuara nga Ministria e Shëndetësisë. Shpenzimet mujore dhe progresive raportohen nga spitalet në ISKSH, e cila bën monitorimin e tyre”.

Në zbatim të këtij vendimi, tek spitalet e kontraktuar me ISKSH, (përveç QSUT e materniteteve) është instaluar softi për llogaritjen e kostove të kartelave për pacientet e shtruar në shërbimet spitalore. Ky soft lejon përpunimin e të dhënave të kartelës së pacientëve në mënyre elektronike, futjen e të dhënave të tjera mbi pagën e stafit mjekësor e ndihmës, si dhe shpenzime të tjera të nevojshme për të mundësuar llogaritjen e shpenzimeve reale për një pacient.

Treguesit e aktivitetit dhe të performancës tekniko-ekonomike të spitaleve gjatë vitit 2012, paraqiten si më poshtë:

Kosto mesatare / rast (në mijë lekë):

- Kostoja mesatare/ rast në *spitalet nivel Bashkie është 47 mijë lekë.*
- Kostoja mesatare/rast në *spitalet nivel Qarku është 36.9 mijë lekë.*
- Kostoja mesatare/rast në *spitalet nivel Universitar është 56.9 mijë lekë.*

Indikatorët e performancës:

a) Shfrytëzimi i shtratit (% mesatare):

26.17% në spitalet nivel bashkie,
38.87% në spitalet nivel qarku

b) Ditë qëndrimi mesatare/pacient:

Spitale në nivel Bashkie	5.4 ditë qëndrimi
Spitale në nivel Qarku	4.64 ditë qëndrimi
Materniteti nr. 1	3.14 ditë qëndrimi
Materniteti nr. 2	3.63 ditë qëndrimi
SUSM Tiranë	10.7 ditë qëndrimi
QSUT Tiranë	6.19 ditë qëndrimi

c) Pacientë të shtruar nga shërbimi i urgjencës :

Spital në nivel Qarku	71.3%
Spital në nivel Bashkie	74.8%
Materniteti «Mbretëresha Geraldinë »	41.7%
Materniteti «Koço Gliozheni»	63%
SUSM «Shefqet Ndroqi» Tiranë	51%
QSU «Nene Tereza» Tiranë (nuk ka të dhëna të raportuara).	


Përfundimi: *Nga auditimi i KLSH dhe nga strukturat e ISKSH theksohet se, ndërsa kostoja e shërbimit spitalor rritet vit pas viti, aktiviteti spitalor është në rënie, për pasojë treguesit e këtij aktiviteti përkeqësohen.*

Për sa më sipër, nevojiten patjetër ndërhyrje në politikat shëndetësore për të vënë në eficiencë aktivitetin spitalorë për t'i shërbyer sa më mirë pacientit, në veçanti të siguruarit.

-Gjendja e likuiditeteve dhe fondi rezervë.

Në fund të vitit 2012, në llogaritë bankare të Drejtorisë Qendrore dhe drejtorive rajonale, rezultoi një gjendje likuiditetesh prej 3,475.2 milionë lekë, ose 203.4 milionë lekë më shumë nga fillimi i vitit. Nga kjo vlerë, 3,064.1 milionë lekë janë në llogarinë speciale të fondit rezervë që administrohet në Bankën e Shqipërisë. Ky fond, zë rreth 10% të totalit të shpenzimeve të planifikuara të skemës për vitin 2013, duke ruajtur në këtë mënyrë edhe përcaktimin e nenit 24 (pika 1 germa b, paragrafi i fundit) të ligjit nr. 10383, datë 24.02.2011 “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në RSH”, ku thuhet: “Fondi rezervë nuk duhet të kalojë 10 për qind të shpenzimeve vjetore të Fondit”;

Ecuria e fondit rezervë në vite, në milionë lekë, paraqitet në grafikun e mëposhtëm:



Pra, siç shihet fondi rezervë krahasuar me vitin 2005, është pothuaj trefishuar në fund të vitit 2012, ku nga 1,105 milionë lekë ka arritur në 3,064 milionë lekë. Një tregues i tillë tregon për mirëmenaxhim të shpenzimeve që mbulon skema. Pakësimi i këtij fondi në vitin 2006 ishte pasojë e kalimit të një pjese të rezultatit financiar për mbulimin pjesor të deficitit të krijuar gjatë vitit 2005, i cili u përdor së bashku me financimin shtesë që dha buxheti i shtetit për likuidimin e faturave të rimbursimit, deficit i cili ishte në rreth 1 miliardë lekë.

Krijimi dhe përdorimi i fondit rezervë.

Mbajtja e fondit rezerve të sigurimeve shoqërore është detyrim që buron nga nenet 32-34, të ligjit 7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet e Kujdesit Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

- Në fund të vitit 2011, gjendja e fondit rezervë ishte në vlerën 3,064,123,353.90 lekë, nga 2,989,538,573.95 lekë që ishte ky fond në vitin 2010.

- Gjatë vitit 2012, nuk janë kryer veprime me fondin rezervë dhe rezultati financiar i vitit 2011 në shumën 308,479,328.38 lekë nuk është kaluar në fond rezervë.

Konkluzioni: Nuk kanë gjetur zbatim të plotë kërkesat e Vendimit të Këshillit Administrativ nr. 100, datë 27.12.2012 “Për një ndryshim në vendimin e KA nr. 17, datë 14.05.2012 për miratimin e rezultatit financiar të ISKSH për vitin 2011”, sipas të cilës është përcaktuar që,

“rezultati financiar pozitiv i vitit 2011, prej 308,479,328.38 lekë, të transferohet në fondin rezervë pas likuidimit të shumës së kontributeve të sigurimeve shëndetësore të prapambetura nga ana e ISSH-së në llogaritë likuiduese të ISKSH-së.

Nga verifikimi i të dhënave përkatëse dhe aktrakordimeve të mbajtura midis ISSH dhe ISKSH, rezulton se, nga ISSH nuk janë transferuar në llogaritë bankare të ISKSH gjithë detyrimet e prapambetura, për rreth 680 milionë lekë.

- Për vitin 2012 nuk janë kryer veprimet për përdorimin e Fondit Rezervë.

Megjithatë, nga auditimi i KLSH konstatohet se ISKSH i ka hartuar pasqyrat financiare të vitit 2012 dhe i ka dërguar ato pranë MF-ve, duke respektuar afatin ligjor të vendosur për dorëzimin e tyre. Gjendja dhe lëvizja e fondit rezervë për periudhën 1 janar – 31 dhjetor 2012 paraqitet në tabelën e mëpohtme:

Emërtimi	Lekë
Fondi rezervë në fillim të periudhës	2,095,179,283.81
Shtohet teprica e vitit 2008	629,611,570.72
Gjendja me 31.12.2009	2,724,790,854.53
Gjendja me 1.1.2010	2,724,790,854.53
Gjendja me 1.1.2011	2,989,538,573.95
Gjendja me 1.1.2012	3,064,123,353.90
Gjendja me 1.1.2013	3,064,123,353.90

IX.3 Rekomandimet e dërguara nga KLSH nw ISH dhe ISKSH e zbatimi i tyre

<i>Teksti i Rekomandimit</i>	<i>Veprimet e ndërmarra nga strukturat respektive</i>
	<u><i>Përgjigjet e ISSH lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH dërguar me shkresën nr 8184 datë 26.09.2013</i></u>
<u><i>Rekomandimin nr. 1</i></u> Një performancë e lartë në administrimin e sigurimeve shoqërore do të kontribojë në mbështetjen më të madhe për të zgjeruar aksesin për mbulimin e duhur dhe të qëndrueshëm me sigurim social, kjo do të na çoj më tej drejt vizionit të sigurisë dinamike sociale dhe që siguria sociale të arrihet nga të gjithë. Mundësitë për të ndërmarrë reforma, zgjedhja e skemës ose ndryshimeve më të përshtatshme teorikisht janë të shumta, por suksesi apo mosmarrja e rezultateve të pritura prej tyre varet nga sasia dhe masat që merren për sigurimin e mjeteve financiare që do të financojnë sistemin. Reformat e pensioneve, pavarësisht nga ndryshimet që kanë midis tyre, shtrihen dhe realizohen përmes kontribuesve dhe përfituesve, prandaj çdo reformë strukturore do të mbajë mirë parasysh axhustimet parametrike që do të jenë të nevojshme për të mbajtur në balancë skemën e pensioneve publike. Deficiti mjaft i lartë i krijuar në degën e pensioneve	<u><i>Për rekomandimin nr. 1</i></u> ISSH ka përgatitur disa propozime për ndryshime ligjore që përmirësojnë treguesit e paraqitur në këtë pikë si dhe disa studime aktuariale për reformën e mundshme në sistemin e pensioneve. Këto materiale janë dërguar në Ministrinë e Financave dhe në kuadër të reformimit së pritshem të sistemit do të mbahen parasysh dhe do të insistohet të përfshihen në të.

<p>në shumën 20,707 milionë lekë i cili kundrejt, Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB) është 1, 49%, por dhe tendenca në rritje të këtij deficiti, na obligon te kërkojmë të ndërmerret një reforme e plote ligjore, për të gjithë sistemin e sigurimeve shoqërore në lidhje me:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nivelin i personave të siguruar, pasi shkalla e mbulimit të popullsisë me elementet e sigurimit shoqëror janë të ulta, vihet re një pjesëmarrje në kontribute të rreth 65 % të forcave aktuale të punës. - Formulën aktuale të pensionit, gjykohet lehtësisht se formula aktuale nuk ofron nxitje të mjaftueshme për pjesëmarrje, me arsye të thjeshtë se pensioni maksimal është i limituar sa dy herë e pensionit minimal edhe pse paga më e lartë është pesë herë më e madhe se paga më e ulët. - Evazionin fiskal, pasi evazioni është shumë i lartë si pasojë e informalitetit dhe të deklarimit të të ardhurat më të vogla se sa janë në realitet, çka sjell pakësimin e bazës kontributive si dhe nuk nxit apo motivon punonjësit me të ardhura mesatare apo të larta për të deklaruar e paguar kontribute sipas të ardhurave faktike që marrin. - Me mënyrën dhe rregullat e indeksimit të pensioneve, pasi shkalla e zëvendësimit të pagës me pensionin në momentin kur punonjësit dalin në pension pleqërie është e ulët për punonjësit me paga mesatare dhe paga të larta. Sepse rritja e pensioneve dhe e pagave nga rritja e inflacionit në vlerë absolute nuk vjen në raport të drejtë, për pasojë përfitimet për pensione rriten me pak dhe kontributet nga pagat rriten më shumë. - Trajtimet e favorshme për banorët ruralë, pasi konstatohen, trajtim mjaft i favorshëm si në sistemin e kontributeve ashtu edhe të pensioneve (përfitimeve) për banorët ruralë, ku buxheti i shtetit financon rreth 55 % e kontributeve për këta banorë. - Skemat shtetërore të veçanta dhe suplementare, pasi konstatohen, mbulime me subvencione buxhetore edhe për skemat shtetërore të veçanta dhe suplementare, shpenzimet për përfitimet e të cilave vazhdojnë të rriten nga viti në vit. - Sistemin e pensioneve, pasi dega e pensioneve është me deficit i cili ka kaluar mbi 1% të PBB, edhe pse 55 % e kontributeve rurale financohen nga buxheti i shtetit. 	
<p><u>Rekomandimi nr. 2</u></p> <p>Në zbatim të ligjit, nr.10418, datë 21.4.2011 “Për</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 2</u></p> <p>ISSH ka hartuar një grupim të të gjithë</p>

<p>legalizimin e kapitalit dhe faljen e një pjese të borxhit tatimor e doganor” i cili i ka shtrirë efektin e zbatimit deri në dhjetor të vitit 2013, të bashkëpunohet, me Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për :</p> <p>- Evidentimin dhe grupimin e subjekteve debitorë dhe të detyrimeve të tyre të mbetura në llogaritë e organeve të sigurimeve shoqërore para vitit 2005, si dhe transferimin e atyre subjekteve debitor aktivë në organet tatimore, me qëllim sistemimin përfundimtar dhe arkëtimin e detyrimeve, trajtuar, hollësisht në faqet 21-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit</p>	<p>subjekteve debitorë aktivë para vitit 2005 me gjithë dokumentacionin përkatës dhe janë transferuar në organet tatimore. Gjithashtu, janë evidentuar të gjithë subjektet debitorë jo aktivë dhe detyrimet e tyre të prapambetura për tu analizuar në Këshillin Administrativ si detyrime në pamundësi arkëtimi.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 3</u></p> <p>Të bashkëpunohet me Ministrinë e Financave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, për:</p> <p>- Hartimin e një udhëzimi të Ministrisë së Financave, ku të përcaktohet, mënyra e raportimit dhe evidentimit të kontributeve në përgjithësi, dhe në veçanti mënyra e raportimit të të dhënave mujore progresive për detyrimet e kontributeve të paguara në afat dhe për kamat vonesat e tyre, apo të kontributeve të paguara pjesërisht, për çdo subjekt privat si dhe të përcaktohen sanksione më të ashpra për mosdorëzim e listëpagesave brenda afateve</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 3</u></p> <p>ISSH ka ndryshuar pikën përkatëse në Vendimin nr. 1114, datë 30.07.2008 (i ndryshuar) e Këshillit të Ministrave, në të cilën është vendosur detyrimi për nxjerrjen e një udhëzimi për këtë qëllim. Do të diskutohet me Ministrinë e Financave dhe DPT për hartimin e një udhëzimit të Ministrit të Financave për të saktësuar më mirë mënyrën e evidentimit dhe raportimit të kontributeve të paguara, të paguara dhe të paguara pjesërisht dhe për dorëzimin e listëpagesave të subjekteve që kanë paguar të gjithë detyrimin apo pjesërisht. Përgatitja e një draft udhëzimi për të diskutuar me sa më sipër.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 4</u></p> <p>Për stimulimin e pjesëmarrjes në skemën e kontributeve të personave, të vetëpunësuar në bujqësi, të cilët kanë plotësuar periudhën e sigurimit mbi 35 vjet dhe nuk kanë mbushur moshën e pleqërisë, të kërkohen ndryshime ligjore në lidhje, me llogaritjen e pensionit të pleqërisë, për të kombinuar interesin midis periudhës së pagesës së kontributeve dhe masës së përfitimit pas mbushjes së moshës së pensionit, me qëllim që çdo person që punon në bujqësi të paguaj kontribute gjatë gjithë kohës që është ekonomikisht aktive.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 4</u></p> <p>Nga ana e ISSH janë përgatitur disa propozime dhe do të përgatiten propozime të tjera për ndryshime ligjore për këtë çështje dhe do të prezantohen në kuadër të reformës së sistemit</p>

<p><u>Rekomandimi nr. 5</u></p> <p>Treguesit e programit të të ardhurave në lidhje me popullsinë aktive në fshat, të bazohen: Në të dhënat zyrtare të INSTAT dhe në bilancin e popullsisë rurale e cila të hartohet nga ISSH për çdo vit dhe të miratohet nga Këshilli Administrativ i ISSH-së.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 5</u></p> <p>Do të ribëhet bilanci i popullsisë aktive në fshat bazuar edhe në të dhënat e Censurit të fundit të INSTAT dhe do të paraqitet në Këshillin Administrativ</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 6</u></p> <p>Të bashkëpunohet me institucionet qendrore dhe vendore që kanë lidhje direkt apo indirekte me fshatin dhe fermerët si, Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Njësiti Vendore, me qëllim evidentimin dhe thithjen e kontributeve nga fermerët që punojnë e zhvillojnë aktivitete edhe mbi baze e projekteve bujqësore të subvencionuara nga buxheti i shtetit, trajtuar, hollësisht në faqet 26-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 6</u></p> <p>Do të bashkëpunohet ngushtë me Ministrinë e Bujqësisë për zbatimin e udhëzimeve që janë në fuqi që të gjithë fermerët që përfitojnë ndihmë financiare nga buxheti i shtetit apo donacione të tjera për zhvillimin e aktiviteteve bujqësore të jenë të siguruar, Në këto udhëzime është shprehur qartë që një nga dokumentat që duhet të paraqiten për të përfituar financim është edhe pagimi i kontributeve të sigurimeve shoqërore</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 7</u></p> <p>Për ristrukturimin dhe reduktimit e deficitit financiar të degës së pensioneve që vjen nga masa e lartë e subveconeve kotributive që paguan buxheti i shtetit për të vetëpunësuarit në bujqesi, të bashkëpunohet me Ministrinë e Financave për: Hartimin dhe miratimin e një Projektvendimi të Këshillit të Ministrave në të cilin të percaktohet rritja graduale e masës së kontributit të personave të vetëpunësuar në bujqesi deri në mbylljen e subveconeve kotributive nga buxheti i shtetit.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 7</u></p> <p>Do të përgatitet një projekt vendim i Këshillit të Ministrave për përcaktimin e rritjes së masës së kontributit dhe afatet kur do të realizohet rritja me qëllim barazimin e masës së kontributit të sigurimeve shoqërore të të vetëpunësuarve në bujqesi me të vetëpunësuarit në sektorin urban.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 8</u></p> <p>Të bashkëpunohet me personat e siguruar vullnetarisht, për të vazhduar sigurimin e tyre vullnetar. Të gjetën rrugët e stimulimit, duke koordinuar punën në zyrë me komunikimin direkt me qytetaret e tjerë për ndërgjegjësim e tyre për këtë sigurim.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 8</u></p> <p>Do të realizohen fushata sensibilizuese për të vazhduar sigurimin vullnetar të personave që janë pjesëmarrës në këtë skeme si dhe futjen në skemë të kontribuesve të rinj nëpërmjet takimeve, posterave, publicitetit si dhe emisioneve televizive në studio të televizioneve kombëtare dhe lokale.</p>

<p><u>Rekomandimi nr. 9</u></p> <p>Për eliminimin e informalitetit në dhënie të pensioneve të invaliditetit: Të hartohet dhe miratohet një Projektvendim i Këshillit të Ministrave, në të cilin të përcaktohen, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së anëtarëve të KMCAP-et Eprore (me anë të konkurseve apo të shorteve)</p> <p>Të përmirësohen rregullat e organizimit dhe funksionimit të këtyre komisioneve.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 9</u></p> <p>Nga ana e ISSH në bashkëpunim me MPCSSHB është hartuar një projekt vendim për caktimin e anëtarëve të KMCSP-eve Eprore nëpërmjet shortit dhe është dërguar për miratim pranë Këshillit të Ministrave.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 10</u></p> <p>Në bashkëpunim me Ministrinë e Financave të ndërmerret reformë për rritjen e cilësisë dhe uljen e kostos së shërbimit të pagesave, që kryet nga Posta Shqiptare, në lidhje me: Liberalizimin e këtij shërbimi duke e shtirë atë edhe në bankat e nivelit të dytë, Uljen e nivelit të komisioneve dhe për pasojë uljen e subvencionit të buxhetit të Shtetit, Rritjen e cilësisë së këtij shërbimi për të ardhur në ndihmë kësaj kategorie me probleme sociale, duke evituar abuzimet, konfuzionin dhe radhët e gjata në sportelet e postës, nëpërmjet përfshirjes së vlerës së komisioneve të shërbimit në vlerën e pensionit të çdo pensionisti, dhe bankat t'ua mbajnë këtë vlerë në formë komisioni për shërbimin që u kryhen për çdo pagesë të tërhequr nga sportelet e bankës apo bankomatet e saj.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 10</u></p> <p>Në zbatim të këtij rekomandimi ISSH ka stimuluar pensionistët për të drejtuar kërkesat si vazhdon intensivisht transferimin e pagesave të pensioneve nga posta në bankat e nivelit të dytë. Ndërsa deri në muajin gusht autorizimi i kalimit të shërbimit të pagesave nga Posta në Banka bëhej me miratim të ISSH, aktualisht me shkresën nr 7812, datë 17.09.2013 janë autorizuar të gjithë rajonet që sipas kërkesës së përfituesit të autorizojnë kalimin e pagesave nga Posta në drejtim të bankave të nivelit të dytë, masë e cila ka lehtësuar dhe përshpejtuar shërbimin. Kjo masë do të ndikojë gradualisht edhe në uljen e nivelit të komisioneve pasi komisioni i pagesës në banka është 20% më i ulët.</p> <p>Në kuadër të informatizimit të të gjithë procedurave të sigurimeve shoqërore ISSH ka të hedhur në portalin elektronik të pagesave dhe të gatshëm për pagesa online mbi 200 000 pensione dhe po komunikon me Postën Shqiptare që ajo nga ana e saj të ngrejë dhe konsolidojë infrastrukturën për realizimin e këtij shërbimi pasi aktualisht nga ana e saj pagesat online zbatohen për rreth 145 000 pensione. Kjo masë përmirëson cilësinë e shërbimit dhe të administrimit monetar e pagesave si dhe përbën një bazë për të rishqyrtuar edhe kostot e shërbimit. Kjo detyrë është në vazhdim.</p>

<p><u>Rekomandimi nr. 11</u></p> <p>Të kërkohej në Ministrinë e Financave dhe në Këshillin e Ministrave: Rritja e pensioneve në të ardhmen, si pasojë e rritjes së inflacionit, të jetë në raport të drejtë me këtë rritje dhe të shoqërohet me rritjen e të ardhurave nga kontributet e drejtpërdrejta. Rritja e numrit të përfituesve në skemat e pensioneve në të ardhmen të shoqërohet me rritje të numrit të kontribuesve. Në kategoritë e veçanta të personave që trajtohen me përfitime të cilat i kanë këto përfitime rreth 4 herë më të larta se, pensionet maksimale, të mos përfshihen edhe kategori të tjera si dhe të gjenden mundësitë e reduktimit të këtyre shpenzime (përfitimeve).</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 11</u></p> <p>Nga ana jonë janë bërë kërkesa në Ministrinë e Financave për saktësimin e listës së personave subjekt i skemës suplementare në VKM përkatëse si dhe propozime për ndryshime ligjore për kufizime të përfitimeve suplementare në masën e përfitimit dhe moshë. Gjatë diskutimeve për projekt buxhetin e vitit 2014 nga ana jonë është kërkuar që rritja e pensionit të jetë në nivelin e inflacionit.</p>
<p>Teksti i Rekomandimit</p>	<p>Veprimet e ndërmara nga strukturat respektive</p>
	<p><u>Përgjigjet e ISKSH lidhur me masat e marra për zbatimin e rekomandimeve të KLSH. Drejtoria e ISKSH me shkresën nr. 794, datë 10/7/2013 ka informuar KLSH për programimin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguar nga KLSH, në të cilin përcaktohen drejtoritë përkatëse dhe afatet për zbatimin e tyre.</u></p>
<p><u>Rekomandimi nr. 1</u></p> <p>Nga KLSH janë dërguar përfundimet e auditimit të ushtruar në vitin 2013 me shkresën nr. 321/6, datë 30/6/2013. Nga KLSH, ISKSH-së i janë dërguar për ndjekje dhe zbatim 3 propozime për ndryshime ligjore, 22 masa organizative dhe 2 për shpërblim dëmi, të cilat <u>janë konfirmuar nga ISKSH</u>. Ndër to paraqesim:</p> <p>Nga auditimi i treguesve të buxhetit për Shërbimin Shëndetësor Parësor, të detajuar sipas rajoneve, konstatohet se ekziston një shpërndarje disproporcionale midis ngarkesave dhe numrit të mjekëve të përgjithshëm e të familjes në raport me personelin infermier e ndihmës, si pasojë e mungesës së përcaktimit të kriterëve për këtë çështje, nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë dhe strukturave të tjera përgjegjëse.</p> <p>Kështu, raporti mjek i përgjithshëm ose i familjes me personelin ndihmës ka luhatur të mëdha nga një DRSKSH në tjetrën dhe brenda një DRSKSH-je nga njëra Qendër Shëndetësore (QSH) në tjetrën. Më konkretisht:</p> <p>a. Në shkallë vendi, numri i mjekëve të përgjithshëm e të</p>	<p><u>Për rekomandimin 1</u></p> <p>Në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë dhe bordet e Qendrave Shëndetësore do të merren masat për të përcaktuar dhe miratuar kriteret, duke unifikuar rregullat mbi bazën e të cilave të caktohen strukturat e shërbimeve dhe të burimeve njëzore në QSH.</p>

<p>familjes (MPF) gjithsej është 1684, kurse numri i personelit tjetër arrin në 7353 punonjës gjithsej, ose i takon mesatarisht 4.37 punonjës të personelit mbështetës (PM) për 1 mjek të përgjithshëm e të familjes (MPF).</p> <p>b. Në shkallë DRSKSH-je, raporti i personelit tjetër ndaj numrit të MP në QSH luhetet ndjeshëm, nga niveli 3.4 (pra nën mesataren e vendit prej 4.37 PM/MPF) deri në 10.7 punonjës mbështetës për 1 mjek (d.m.th mbi 2 herë më të lartë se sa mesatarja e vendit).</p> <p>c. Në zona dhe QSH të ndryshme brenda çdo DRSKSH-je rezultojnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në DRSKSH Dibër raporti paraqitet 520 PM/65 MPF, ose 8 punonjës me 1 MPF; ndërkohë që ndërmjet QSH-ve të ndryshme ky indikator ka luhetje e devijime të ndjeshme, deri në 1 me 23 në QSH Shupenzë. - Në DRSKSH Gjirokastër raporti është 398 PM/65 MPF, ose 6.12 punonjës me 1 MPF; ndërkohë që ndërmjet QSH-ve të ndryshme ky indikator rezultojnë deri në 1 me 16 si QSH Buz. - Në DRSKSH Tropojë raporti është 140 PM/13 MPF, ose 10.7 punonjës me 1 MPF; ndërsa midis QSH-ve të ndryshme raporti paraqitet: nga 1 me 10 në QSH Qytet deri në 1 me 16 në QSH Fierzë 1 me 16. - Në DRSKSH Shkodër raporti është 663 PM/127 MPF, ose 5.22 punonjës me 1 MPF; kurse ndërmjet QSH-ve të ndryshme raporti paraqitet: deri në 1 me 23 në QSH Iballë. <p>Po kështu në DRSKSH-të e tjera. Për këtë, kemi ka rekomanduar:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Në bashkëpunim me MSH-së dhe bordet e qendrave shëndetësore në nivel DSHP/ASHR, të merren masat përkatëse për të përcaktuar dhe miratuar kritere dhe unifikuar rregullat mbi bazën e të cilave të caktohen strukturat e shërbimeve e të burimeve njerëzore në QSH-re, pasi nga auditimi i buxhetit të shërbimit shëndetësor parësor, ka rezultuar se efektet e kostove të personelit mbi buxhetin e veprimtarisë së ISKSH-së janë të ndjeshme dhe se raporti mjek i përgjithshëm ose i familjes me personelin ndihmës ka luhetje të mëdha nga një DRSKSH në tjetrën dhe brenda një DRSKSH-je nga njëra QSH në tjetrën. <p>Këto kritere të mbajnë parasysh të dhënat e gjendjes civile mbi rajonet, të dhënat e CENSUS-it 2011, shpërndarjen gjeografike e territoriale të popullsisë, hartat e sëmundshmërisë etj.</p>	
<p><u>Rekomandimi nr. 2</u></p> <p>Në auditimin e kryer në vlerësimin e përmbajtjes së kontratave të lidhur me farmacitë (F/2012), dhe Agjencitë Farmaceutike (A/2012), është konstatuar se në kapitullin 6 “Sanksionet dhe procedurat e ankimimit”, dhe për Qendrat Shëndetësore (Q/2012) në nenin 12 të kontratës “Sanksionet dhe</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 2</u></p> <p>Me qëllim përmirësimit e kontratave lidhur me subjektet farmaceutike dhe Qendrat Shëndetësore, në bashkëpunim me grupet e interesit të merren masa për rishikimin e përmbajtjeve të kontratave tip kryesisht duke permisuar sanksionet për subjekte që</p>

<p>procedurat e ankimimit”, trajtohen qëndrimet për rastet e moszbatimit të detyrimeve kontraktuale nga ana e operatorëve ekonomikë. Këto sanksione nuk janë harmonizuar me gjithë legjislacionin në fuqi, veçanërisht me legjislacionin tatimor dhe detyrimet e ligjit “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Për rastet e moszbatimit të kriterëve dhe kushteve të kontratës, në disa prej tyre janë parashikuar sanksione (penalitete), që janë të lehta e të pa argumentuara në raport me pasojat mbi shëndetin ose skemën e kujdesit shëndetësor, gjë që sjell një risk të vujueshëm të ISKSH. Për këtë, kemi rekomanduar :</p> <ul style="list-style-type: none"> - Nga ISKSH të ngrihet një grup pune në bashkëpunim me grupet e interesit (farmacistë e grosistë), që të rishikojë në mënyrë tërësore kontratat tip, në drejtim të përmirësimit të tyre, kryesisht të trajtimit ekonomiko-financiar dhe përgjegjësisë ligjore për subjektet që abuzojnë me skemën dhe nuk përmbushin detyrimet kontraktore (parashikimi dhe forcimi i penaliteteve dhe masave të tjera ndëshkuese në kapitullin “Sanksionet dhe procedurat e ankimimit”), në përputhje me legjislacionin në fuqi. 	<p>abuzojnë me skemën dhe nuk përmbushin detyrimet kontraktore dhe procedurat e ankimimit</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 3</u></p> <p>Nga auditimi i kryer për mënyrën e llogaritjes dhe vlerësimit të kostos së shërbimit shëndetësor, në zbatim të VKM nr. 140, datë 17.02.2010 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”, me ndryshimet e mëvonshme, u konstatua se, Ministria e Shëndetësisë nuk ka përcaktuar dhe publikuar një udhëzim të veçantë për përcaktimin e “Standardeve të shërbimit spitalor”, si bazë për llogaritjen e kostove të çdo shërbimi, detyrim që sipas VKM duhej përmbushur brenda vitit 2010, duke sjellë si pasojë që financimi i shërbimeve të kontraktuara të vijojë sipas buxhetit historik. Për këtë, kemi rekomanduar.</p> <p>Këshilli Administrativ i ISKSH të kërkojë nga Ministria e Shëndetësisë, përcaktimin e “standardeve të shërbimit spitalor” për çdo diagnozë të veçantë, që do të shërbejnë jo vetëm për disiplinimin e shërbimeve, por edhe trajtimin e të sëmurëve me medikamente sipas protokolleve të miratuara, si detyrim që buron nga VKM nr. 140, datë 17.02.2010 “Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor”.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 3</u></p> <p>Nëpërmjet Këshillit Administrativ t’i kërkohet Ministrisë Shëndetësisë hartimi i “standarteve të shërbimit spitalor” për çdo diagnozë të veçantë me qëllim që të sigurohet jo vetëm disiplinimi i shërbimeve,por edhe trajtimi i të sëmurëve me medikamente sipas protokolleve të miratuara, si detyrim që buron nga VKM nr.140 dt.17.02.2010 “Pë financimin e shërbimeve shëndetsore spitalore nga skeme e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetsor”</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 4</u></p> <p>Nga auditimi ka rezultuar se nuk kanë gjetur zbatim të plotë kërkesat e Vendimit të Këshillit Administrativ nr. 100, datë 27.12.2012 “Për një ndryshim në vendimin e KA nr. 17, datë 14.05.2012 për miratimin e rezulttit</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 4</u></p> <p>Të kërkohet terheqja e të gjitha detyrimeve të prapambetura nga ISSH që nuk janë transferuar në llogaritë bankare të ISKSH dhe të merren masa për kalimin në fondin rezerve të rezulttit</p>

<p>financiar të ISKSH për vitin 2011”, sipas të cilës është përcaktuar që, “rezultati financiar pozitiv i vitit 2011, prej 308,479,328.38 lekë, të transferohet në fondin rezervë pas likuidimit të shumës së kontributeve të sigurimeve shëndetësore të prapambetura nga ana e ISSH-së në llogaritë likuiduese të ISKSH-së. Për këtë, kemi rekomanduar</p> <p>- Në kushtet që nuk janë kryer veprimet përfundimtare për mbylljen e rezultatit financiar të vitit 2012, për të cilat duhet të shprehet dhe me vendim të veçantë Këshilli Administrativ, si dhe në zbatim të përgjegjësive që burojnë nga ligji i ri për krijimin e Fondit të Kujdesit Shëndetësor, të kërkohet tërheqja e gjithë detyrimeve të prapambetura nga ISSH që nuk janë transferuar në llogaritë bankare të ISKSH, që sipas akt-rakordimeve rezultojnë detyrime rreth 680 milionë lekë dhe të merren masat për kalimin në fondin rezervë të rezultatit financiar të vitit 2011 dhe 2012, në masën e parashikuar nga ligji të ri për kujdesin shëndetësor në RSH. Brenda muajit gusht 2013</p>	<p>financiar të vitit 2011 dhe 2012, në masën e parashikuar nga ligji i ri për kujdesin shëndetësor në RSH.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 5</u></p> <p>Nga auditimi i kryer në fondet buxhetore të vitit 2012, konstatohet se fondet për rimbursimin e barnave kanë tendencë të rriten nga viti në vit. Kështu, për vitin 2012, shpenzimet për rimbursimin e barnave janë realizuar në vlerën 7,921,666 mijë lekë dhe krahasuar me faktin e vitit të mëparshëm këto shpenzime janë rritur në vlerën prej 1,012,984 mijë lekë. Auditimi i KLSH dhe inspektimet e ISKSH, ndër shkaqet kryesore që kanë çuar në këtë rritje, përveç arsyeve objektive, evidentojnë:</p> <ol style="list-style-type: none"> lëshimin e recetave nga mjekët e përgjithshëm e të familjes (MPF) dhe trajtimin e diagnozave të pacientëve me alternativa më të kushtueshme të listës së barnave dhe jo me alternativat e para që kanë kosto më të ulët; pacientët e trajtuar më parë nga shërbimi spitalor me barna të alternativave të para, mbas daljes nga spitali, kanë vijuar trajtimin e mëvonshëm nga mjekët e familjes me barna të rimbursueshme sipas alternativave më të kushtueshme, duke rritur kështu artificialisht koston e rimbursimit për këto kategori. <p>Për këtë, rekomandojmë që:</p> <ol style="list-style-type: none"> Nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të analizohet zbatimi i detyrimeve të pikës nr. 11 dhe 12, të nenit 5, të kontratës së lidhur midis Qendrave Shëndetësore dhe DRSKSH mbi detyrimet e MPF, ku specifikohet se: “Për mjekimin me rimbursim të të sëmurëve, MPF të mbështeten në kufizimet e listës së barnave, aktet e ISKSH dhe protokollet e përdorimit të barnave”. Në kontratën tip DRSKSH - QSH 2012, të gjejnë pasqyrim masat për mjekët e përgjithshëm e të familjes, për rastet e përsëritura të shkeljeve, duke i shkallëzuar dhe thelluar këto masa disiplinore për rastet e 	<p><u>Për rekomandimi nr. 5</u></p> <p>Me qëllim ruajtjen dhe disiplinimin e fondeve për rimbursimin e barnave të analizohet zbatimi i detyrimeve që rrjedhin nga pikat nr.11 dhe 12 të nenit 5 të kontratave le lidhura midis QSH dhe DRSKSH-ve duke evidentuar përgjegjësitë si dhe duke shkallëzuar e thelluar masat ndershkimore për rastet abuzive të përsëritura nga MPF.</p>

<p>përsëritura.</p>	
<p><u><i>Rekomandimi nr. 6</i></u></p> <p>Nga auditimi u konstatua se në spitalet rurale - rajonale ka mungesa në plotësimin e organikave me mjekë të specialiteteve, si kirurgë, kardiologë, okulistë, etj. Në mungesë të tyre, pacientët e këtyre zonave drejtohen në spitalet terciare në qytetet e mëdha, veçanërisht në spitalet terciare Tiranë, Durrës etj., ku edhe marrin shërbimin spitalor dhe për trajtimin e tyre kryhen shpenzime, direkte e indirekte, që evidentohen në shpenzimet e spitalit ku kryhet ky trajtim. Kjo mënyrë veprimi, sjell si pasojë trajtimin shëndetësor të paplanifikuar dhe njëkohësisht rritjen artificiale të shpenzimeve të spitaleve terciare nga njëra anë dhe kursimin e shpenzimeve në spitalet rurale-rajonale, ku këta pacientë kanë vendbanimin. Për këtë, kemi rekomanduar që: Drejtorja Spitalore (DS) dhe Drejtorja e Informacionit dhe Analizës Statistike (DIAS) e ISKSH, në bashkëpunim me Drejtoritë e Spitaleve terciare dhe rajonale, të marrin masa që të krijojnë data-base të veçanta për të gjithë rastet e trajtimit shëndetësor në spitalet terciare për pacientët që vijnë nga spitalet rajonale, në mënyrë që të evidentohen shpenzimet operative direkte e indirekte, duke rakorduar nivelin e këtyre shpenzimeve të kryera efektivisht nga spitali rajonal.</p>	<p><u><i>Për rekomandimin nr. 6</i></u></p> <p>Me qëllim shmangjen e ardhjes se pacienteve nga spitalet rurale në drejtim të spitaleve terciare kryesisht për disa shërbime Drejtorja Spitalore, Drejtorja e Informacionit dhe Analizës Statistike në bashkëpunim me drejtoritë e spitaleve terciare dhe rajonale, të marrin masa për krijimin e nje data-base-i të vecante për te gjitha rastet e trajtimit shëndetsor ne spitalet terciare per pacientet që vijnë nga spitalet rajonale.</p>
<p><u><i>Rekomandimi nr. 7</i></u></p> <p>Mungesa e standardeve të miratuara dhe protokolleve të mjekimit për çdo diagnozë spitalore, si dhe ndryshueshmëria e skemave të mjekimit kanë vështirësuar procesin e llogaritjes së kostove në shërbimin spitalor. Si rrjedhojë, kostot e shërbimit, për diagnoza dhe shërbime të njëjta, sipas rajoneve apo rretheve, rezultojnë me diferenca të konsiderueshme në Shërbimin Patologjik. Për këtë, rekomandojmë që: Për këto ndryshime të ndjeshme midis rajoneve, të kryhen analiza të plota, të nxirren konkluzione dhe të evidentohen shkaqet e mundshme objektive apo subjektive, në perceptimin e gabuar të kostove e ngarkesave, si dhe kalkulimin dhe monitorimin e drejtë të këtyre kostove dhe shpenzimeve për rast dhe për diagnozë, krahas nxjerrjes së përgjegjësive në rastet e veprimeve abuzive.</p>	<p><u><i>Për rekomandimin nr. 7</i></u></p> <p>Të bëhet analiza e kostove të shërbimit për diagnoza dhe shërbime te njejta spitalore ,te nxirren konkluzione dhe te evidentohen shkaqet objektive dhe subjektive per keto diferenca ne keto kosto si dhe te percaktohen rrugët per permisimin e monitorimit tyre.</p>

<p><u>Rekomandimi nr. 8</u></p> <p>Referuar konstatimit të auditimit se, për mbulimin e shpenzimeve të telefonave celularë, në institucion ka vazhduar aplikimi i kuotave të pandryshuara edhe pas miratimit të VKM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridikë, publikë”, i cili ka shfuqizuar pikën 16 të VKM nr. 343, datë 11.07.2002, i ndryshuar, rezulton se, nuk janë korrigjuar tarifatat e mbulimit të shpenzimeve sipas VKM nr. 864, por është vazhduar me kuotat e miratuara në bazë të VKM nr. 343, i shfuqizuar. Ky limit efektiv për periudhën objekt auditimi ka qenë respektivisht 5,000 lekë në muaj, nga 4,000 lekë/muaj që parashikohet në VKM nr 864, datë 23.07.2010 dhe për pasojë është paguar padrejtësisht shuma 154,000 lekë. Për këtë, kemi rekomanduar</p> <p>- Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, të ndërpresin pagesën për mbulimin e shpenzimeve të telefonisë celulare në bazë të VKM nr. 343, datë 11.07.2002 e shfuqizuar me VKM nr. 864, datë 23.7.2010 dhe të paraqesin projektvendim në Këshillin Administrativ të ISKSH për shfuqizimin e kufirit të shpenzimeve të telefonisë celulare në shumën 5,000 lekë në muaj miratuar me vendimin e KA nr. 36, datë 19.12.2002.</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 8</u></p> <p>Drejtoria Ekonomike dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore të paraqesin projektvendim në KA të ISKSH për shfuqizimin e kufirit të shpenzimeve të telefonisë celulare 5.000 lekë, parashikuar në VKM nr. 343 dt.11.07.2002, vendim i cili është shfuqizuar me VKM nr .864 dt.23.07.2010</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 9</u></p> <p>Referuar konstatimit të auditimit se, janë kryer pagesa për kualifikimet pasuniversitare (postmaster) për 9 punonjës (nga këto 7 drejtorë të drejtorive dhe 2 këshilltarë), në bazë të Vendimit të Këshillit Administrativ nr. 24, datë 14.5.2012 “Për një shtesë në rregulloren e personelit, në kapitullin pagat”, sipas vlerësimeve të një Komisioni të Posaçëm që ka vlerësuar përputhjen e kualifikimit me pozicionin në organikë. Për këtë kemi rekomanduar:</p> <p>- ISKSH të marrë masat përkatëse për shfuqizimin e Vendimit të Këshillit Administrativ nr. 24, datë 14.5.2012 “Për një shtesë në rregulloren e personelit, në kapitullin pagat” dhe akteve të dala në zbatim të tij, duke e sjellë atë në përputhje me VKM nr. 449, datë 11.07.2012 “Për një ndryshim në VKM nr. 545, datë 11.08.2011 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e Ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa Institucione të pavarura, Institucionet në varësi të Këshillit të Ministrave, Kryeministrit, Institucione në varësi të Ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit”, të ndryshuar”.</p>	<p><u>Për rekomandimin nr. 9</u></p> <p>Të merren masat për shfuqizimin e e VKA nr.24 datë 14.05.2012 “Për një shtesë në rregulloren e personelit,në kapitullin pagat” dhe akteve të dala në zbatim të tij ku trajtohet pagesa për kualifikimet pasuniversitare (postmaster).</p>

Në mbyllje të pjesës së parë “Raport për zbatimin e buxhetit të vitit 2012” paraqesim të dhënat përmbledhëse për shkëljet me pasojë dëm ekonomik në total shuma 15,170.7 milionë lekë dhe të dhënat për detyrimet debitore në fund të vitit 2012 në total vlera 82,564 milionë lekë dhe konkretisht:

I. Vlera e shkëljeve me dëm ekonomik në të ardhurat dhe shpenzimet e buxhetit të shtetit, në shumën **15,170.7 milionë lekë** e detajuar paraqitet :

- Vlera e dëmit ekonomik në të ardhurat e buxhetit të shtetit në vlerën 133.3 milionë lekë
- Vlera e dëmit ekonomik i në shpenzimet e buxhetit të shtetit në vlerën 414.3 milionë lekë
- Vlera e demit ekonomik te shkaktuar në shoqëritë anonime në total 14,623.1 milionë lekë
- nga e cila :

a) Vlera prej 2,199 milionë lekë e Albpetrol sh.a. Fier per mosarkëtim të ardhurash si pasojë e mosbatimit të detyrimeve kontraktore. Per kete KLSH ka kerkuar rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative, arkëtimin e vlerës prej 2,199 milionë lekë për shlyerjen e detyrimit të furnizimit me nafte dhe gaz nga 3 (tre) kompani që operojnë në fushën e naftës dhe të gazit.

b) Vlera prej 524.1 milione leke e demit ekonomik te evidentuar ne shoqëritë anonime në fushën shpenzimeve.


c) Vlera prej 11,900 milione leke e demit ekonomik shkaktuar buxhetit te shtetit nga mos arkëtimi i garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “Vetro Energy PTE Ltd” per privatizimin e shoqërisë “Albpetrol”sha, Patos”.

Theksojmë që vlera e detyrimit prej prej 5,374 milionë lekë që Shoqëria “Armo” sh.a. Fier, i ka shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Fier që i përket detyrimit të vitit 2011 nuk është përfshirë në vlerën e dëmit ekonomik të cilësuar më sipër pasi është e raportuar në Raportin e vitit të kaluar.

Per kete vlere KLSH ka kërkuar arkëtimin në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative të vlerës prej 5,374 milionë lekë që Shoqëria “Armo” sh.a. Fier, i ka shoqërisë “Albpetrol” sh.a. Fier. Madje, për këtë detyrim, është bërë kërkesë padi në gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë datë 25/06/2013, me paditës shoqëria “Albpetrol” sh.a. Fier dhe i paditur Shoqëria “Armo” sh.a. Fier.

II. Vlera e detyrimeve debitore në shumën **82,564 milionë lekë**.

Vlerat e mësipërme sipas fushave dhe sektorëve ku janë konstatuar paraqiten në aneksin nr. 2 bashkëlidhur këtij raport.



PJESA E DYTË

MENDIME PËR RAPORTIN E KM PËR SHPENZIMET E VITIT TË KALUAR FINANCIAR, PARA SE TË MIRATOHET NGA KUVENDI

Referuar të dhënave të raportuara të realizimit të treguesve të vitit 2012 në nivel makroekonomik dhe nga analizimi i tyre, arrijmë në konkluzionin se ekonomia shqiptare ndonëse me ritme më të ngadalta se një vit më parë, mundi t'i përballojë efekteve të krizës ekonomike që ka përfshirë vendet e Eurozonës dhe të sigurojë një rritje pozitive të zhvillimit ekonomik të vëndit.

Në kontekstin e mjedisit të pafavorshëm në të cilin u realizua buxheti i vitit 2012 si pasojë e ndikimit të elementëve të krizës botërore, KLSH vlerëson pozitivisht punën e bërë nga Qeveria, Ministria e Financave, Ministritë, Institucionet e tjera qëndrore dhe vendore, si dhe entet publike të audituara, për përmbushjen e objektivave dhe realizimin e detyrave të marra përsipër për zbatimin e buxhetit të vitit 2012.

Krahas masave për zhvillimin ekonomik dhe politikat makroekonomike të ndjekura, duhen paqyruar dhe përpjekjet dhe politika monetare e ndjekur nga Banka e Shqipërisë për kontrollin e inflacionit dhe ruajtjen e stabilitetit financiar.

Pavarësisht punës së bërë për ruajtjen e ekuilibrave të treguesve makroekonomikë dhe fiskalë, duhet pasqyruar dhe kërkon vëmendje të veçantë dhe të mirëstudjuar mbajtja nën kontroll e rritjes së mëtejshëm të nivelit të borxhit publik kundrejt PBB-së, nivel i cili në fund të vitit 2012 rezultoi me tejkalim me 1.53 pikë përqindje mbi kufirin e përcaktuar me Ligjin Organik të Buxhetit prej 60%, madje është thelluar më tej gjatë vitit në vazhdim 2013.

Duhet theksuar se me miratimin e rishikimit të buxhetit gjatë vitit 2012, u bë i mundur realizimi në nivel të pranueshëm i treguesve fiskalë të këtij viti, duke kombinuar ritmin e realizimit të të ardhurave buxhetore me pakësimin e shpenzimeve.

Në shifra konkrete, sipas të dhënave të siguruara gjatë auditimeve të ushtruar në MF-ve dhe BSH, treguesit kryesorë makroekonomikë dhe ata fiskalë të buxhetit të shtetit të vitit 2012, paraqiten:

- Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) si një nga treguesit kryesorë (me çmimet korrente) ka arritur në kuotën e 1,346,169 milionë lekë.

Politika monetare e ndjekur nga BSH ka bërë të mundur përmbushjen e objektivit kryesor të saj, mbajtjen nën kontroll të inflacionit, brenda kufirit për një inflacion vjetor 2-4%. Në vitin 2012, niveli mesatar vjetor i inflacionit ka rezultuar 2 %, pothuajse i përafërt me atë të një viti më parë, duke ndihmuar favorshëm mjedisin ekonomik të vëndit tonë.

Për vitin 2012, shpenzimet e përgjithshme të buxhetit të shtetit janë realizuar *në masën 98.4%*, me një *mosshpenzim në vlerë prej 6,055 milionë lekë* ndaj planifikimit, kurse kundrejt realizimit të një viti më parë, paraqiten *me një ulje të papërfillshme në shumën 111 milionë lekë më pak (nga 376,352 milionë lekë të shpenzuar në vitin 2011, në 376,241 milionë lekë në vitin 2012)*.

Në strukturë, *shpenzimet korrente dhe kapitale*, janë realizuar në masën 99.3% dhe 94.9% dhe ato zenë përkatësisht: 83.6% dhe 16.4% të totalit të shpenzimeve të përgjithshme të buxhetit të

shtetit të realizuar në vitin 2012, nga 81.2% dhe 18.8% që zinin në vitin 2011, ka tregun që në vitin raportues janë rritur shpenzimet korrente me 2.4 pikë përqindje dhe janë ulur shpenzimet kapitale në po këtë masë.

Gjithashtu, konstatohet se, *shpenzimet korrente janë realizuar në një përqindje më të madhe se sa niveli i realizimit të shpenzimeve kapitale.*

Në krahasim me një vit më parë rezultoi se, fondet e shpenzuara në zërin “Shpenzime korrente” në vitin 2012, paraqiten me rritje në masën 2.9%, nga 305,673 milionë lekë në vitin 2011, në 34,585 milionë lekë në vitin 2012, ndërkohë që fondet e përdorura për shpenzimet kapitale në vitin 2012 kundrejt vitit 2011, paraqiten me ulje në masën 12.7%, nga 70,679 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011 në 61,656 milionë lekë në vitin 2012.

Analizuar sipas zërave të shpenzimeve korrente rezultoi se:

1. Shpenzimet për personelin zënë rreth 22.07% të totalit të shpenzimeve korrente dhe kundrejt PBB-së të vitit 2012 zënë 5.16%, nga 5.2% të PBB-së të rezultuar në vitin 2011.

Shpenzimet për paga të realizuara në vitin 2012, kundrejt atyre të realizuara një vit më parë, rezultojnë me rritje në masën 2.98%, nga 58,398 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, në 60,144 milionë lekë në vitin 2012, me një rritje në vlerë prej 1,746 milionë lekë.

2. Shpenzimet operative mirëmbajtje, zënë rreth 10.72% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2012, nga 10.79% që përfaqësonin në vitin 2011. Megjithatë, fondet e shpenzuara në vitin 2012 kundrejt atyre të realizuara një vit më parë, paraqiten me rritje në masën 1.44%, nga 32,995 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, në 33,470 milionë lekë në vitin 2012, me një rritje në vlerë prej 475 milionë lekë.

3. Shpenzimet për interesat zënë rreth 13.19% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2012, nga 13.45% që zinin një vit më parë. fondet e përdorura për interesat në vitin 2012 kundrejt atyre të realizuara një vit më parë, paraqiten me një rritje të pakët në masën 0.91%, nga 41,121 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, në 41,498 milionë lekë në vitin 2012, me një rritje në vlerë prej 377 milionë lekë.

4. Shpenzimet për subvencione, zënë rreth 0.6% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2012, nga 1.07% që zinin një vit më parë. Kundrejt kuotës së planifikuar, ato janë realizuar në masën 0.6%, me një tejkalim në vlerë prej 11 milionë lekë.

Referuar raporteve të konsoliduara rezultoi se fondet e subvencioneve kanë ndryshuar me tendencë rritjeje nga buxheti fillestar, kështu nga 1,600 milionë lekë në fillim viti në 1,873 milionë lekë plani me ndryshime, me një rritje prej 273 milionë lekë ose në masën mbi 17%.

Kjo rritje konstatohet kryesisht në Ministrinë e Financave ku nuk ka pasur të pasqyruar subvencion në planin e fillimit të vitit. Nga auditimi rezultoi se, me vendime të KM, MF-ve i është çelur fond subvencion (artikull 603) për “Kompensimin e vlerës së taksës së biznesit të vogël, të përdorur për rimbursimin e pajisjeve fiskale dhe taksimetrave tek njësitë e qeverisjes vendore”.

5. Shpenzimet për fonde speciale (sigurimet shoqërore, shëndetësore dhe fondi i kompensimit në vlerë të pronarëve), zënë rreth 38.23% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2012, nga 37.27% që zinin në vitin 2011. Në strukturë, rritja më e madhe e shpenzimeve në vitin 2012 kundrejt vitit 2011, konstatohet në sigurimet shoqërore, ku nga 85,317 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, në vitin 2012 janë shpenzuar 89,860 milionë lekë, ose në masën 5.32% më tepër dhe në vlerë 4,543 milionë lekë më shumë.

6. *Shpenzimet për buxhetin vendor* zënë rreth 8.68% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2012, nga 9.2% që zinin në vitin 2011, pra me një ulje prej 0.52%. Në vitin 2012, këto shpenzime zënë 2.03% të PBB-së të këtij viti, nga 2.17% të PBB-së që zinin në vitin 2011, pra konstatohet një ulje prej 0.14%. Shpenzimet për buxhetin vendor të realizuara në vitin 2012, krahasuar me ato të realizuara në vitin 2010, rezultojnë me ulje në masën rreth 2.8% dhe në vlerë 786 milionë lekë më pak.

7. *Shpenzime të tjera sociale (pagesa e papunësisë, ndihma ekonomike dhe fondi i kompensimit për ish të përndjekurit politikë)* zënë rreth 6.58% të totalit të shpenzimeve korrente të realizuara në vitin 2012, nga 6.13% që zinin në vitin 2011, pra me një rritje prej 0.45%. Në vitin 2012, këto shpenzime zënë 1.54% të PBB-së të këtij viti, nga 1.44% të PBB-së që zinin në vitin 2011. Në total këto shpenzime janë realizuar në masën 99.7%, me një mosrealizim në vlerë prej 69 milionë lekë, kurse në strukturë, shpenzimet për pagesën e papunësisë, ndihmën ekonomike dhe fondin e kompensimit për ish të përndjekurit politikë, janë realizuar respektivisht 98.4%, 99.7% dhe 99%, dhe në vlerë përkatësisht 16 milionë lekë, 52 milionë lekë dhe 1 milion lekë, më pak se sa kuotat e planifikuara.

Shpenzimet për pagesën e papunësisë rezultojnë me rritje në vitin 2012 kundrejt vitit 2011, më konkretisht nga 876 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, në vitin 2012 janë shpenzuar 984 milionë lekë, me një rritje në masën 12.3% dhe në vlerë 108 milionë lekë më tepër. Po kështu, *shpenzimet për ndihmën ekonomike rezultojnë me rritje*, më konkretisht nga 16,369 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, në vitin 2012 janë shpenzuar 18,011 milionë lekë, me një rritje në masën 10% dhe në vlerë 1,642 milionë lekë më tepër.

Gjithashtu, shpenzimet për kompensimin e ish të përndjekurve politikë rezultojnë me rritje në vitin 2012 kundrejt vitit 2011, më konkretisht nga 1,500 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, në vitin 2012 janë shpenzuar 1,699 milionë lekë, me një rritje në masën 13.3% dhe në vlerë 199 milionë lekë më tepër. Pavarësisht tendencës në rritje të buxhetimit të kësaj kategorie shpenzimesh nga njëri vit në tjetrin, theksojmë që nevojat dhe detyrimet ligjore e morale për këtë shtresë sociale kërkojnë planifikimin e shifrave shumë më të larta se deri më tani.

- *Shpenzimet kapitale (me financim të brendshëm dhe të jashtëm)*, zënë rreth 16.4% të totalit të përgjithshëm të shpenzimeve të realizuara në vitin 2012, nga 18.78% që zinin në vitin 2011. Në strukturë, *shpenzimet kapitale me financim të brendshëm* janë realizuar në masën 100%, ndërsa ato me financim të huaj në masën 91.2% he në vlerë 3,291 milionë lekë më pak. Krahasuar me vitin 2011, *ka ulje të ndjeshme të fondeve të shpenzimeve kapitale me financim të brendshëm, konkretisht 13,699 milionë lekë më pak*, nga 41,097 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, gjatë vitit 2012 janë shpenzuar 27,398 milionë lekë, ndërsa e kundërta konstatohen me *shpenzimet kapitale me financim të huaj*, nga 27,982 milionë lekë të shpenzuara në vitin 2011, në vitin 2012 janë shpenzuar 34,257 milionë lekë, pra me një rritje në vlerë prej 6,959 milionë lekë.

Kundrejt PBB-së të vitit 2012, shpenzimet kapitale me financim të brendshëm dhe të huaj zënë përkatësisht 2.03% dhe 2.54%, nga 3.05% dhe 2.15% të PBB-së të rezultuar në vitin 2011.

- *Deficiti i përgjithshëm i buxhetit* në fund të vitit 2012 rezultoi në vlerën 45,857 milionë lekë nga 49,538 milionë lekë të programuara me ndryshime ose në masën 92.6%. Kundrejt PBB-së të vitit 2012, niveli i deficitit këtë vit arriti në 3.41%, nga 3.53% të rezultuar në vitin 2011, me një ulje prej 0.12 pikë përqindje.

* *Borxhi publik në total*, në fund të vitit 2012 rezultoi në vlerën 828,275 milionë lekë ose në masën 61.53% kundrejt PBB-së të këtij viti nga 772,743 milionë lekë që rezultoi në vitin 2011 dhe që përfaqësonte 59.55 % të PBB-së.

* *Stoku i borxhit të brendshëm* në fund të vitit 2012 rezultoi me rritje kundrejt vitit 2011 në shumën 31,776 milionë lekë, nga 438,582 milionë lekë në vitin 2011, në 470,358 milionë lekë në vitin 2012 ose në masën 7.24% më shumë. Në raport me PBB-në e vitit 2012, ky stok ze 34.94% të tij, nga 33.80% të PBB-së që zinte një vit më parë, me një rritje prej 1.14%.

Ndërsa, *stoku i borxhit të jashtëm shtetëror* në fund të vitit 2012 arriti në 357,629 milionë lekë ose në masën 26.57% të PBB-së të këtij viti, kundrejt 333,943 milionë lekë rezultuar në fund të vitit 2011, ose në masën 25.73% të PBB-së të këtij viti, me një rritje në vitin 2012 kundrejt vitit 2011 në shumën 23,686 milionë lekë ose në masën 7.09% më tepër.

Krahas sa më sipër, me synim miradministrimin dhe rritjen e performancës së përdorimit të fondeve publike për shpenzime, gjatë vitit të ardhshëm buxhetor sugjerojmë:

KLSH ka dhënë një sërë rekomandimesh me impakt

- Konsolidimin dhe mirëfunksionimin e strukturave të menaxhimit financiar dhe kontrollit në përgjithësi, në përputhje me kërkesat e legjislacionit të miratuar për sistemin e menaxhimit financiar dhe kontrollin e brendshëm dhe në përputhje me kërkesat e parashtruara nga BE për vendin tonë në kuadër të Kontrollit të Brendshëm Financiar të Sektorit Publik (KBFSP).

Krahas njërive në nivel qendror, vëmëndje e veçantë t'i kushtohet ngritjes dhe funksionimit të këtyre strukturave në njësitë e pushtetit vendor, si dhe plotësimin dhe mirfunksionimin e kontrollit të brendshëm.

Gjithashtu, kërkohet përmirësimi cilësor i veprimtarisë së strukturave të auditimit të brendshëm, pasi audituesit e KLSH gjatë ushtrimit të detyrës kushtetuese ligjore për mbikëqyrjen e veprimtarisë së këtyre strukturave, kanë konstatuar disa të meta dhe mangësi kryesisht në drejtim të zbatimit të legjislacionit në fuqi dhe manualit të auditimit të brendshëm.

- Referuar strukturës së shpenzimeve dhe gjetjeve të KLSH të pasqyruara në këtë raport, ka vend për të riparë kuotimin dhe përdorimin e fondeve të shpenzimeve brenda zërave të shpenzimeve korrente. Madje, ka vend për rishikim dhe brenda vetë zërave kryesorë të shpenzimeve dhe të disa nënzërave të artikullit “Mallra dhe shërbime” (llog. 602).

- Në lidhje me shpenzimet për interesa, ato priren drejt rritjes, sidomos në kushtet e bërjes efektive të kredive apo huave të marra, ndaj kërkohet përcaktimi i masave më të efektshme në pagesën e tyre, sidomos në reduktimin e deficitit buxhetor dhe zgjatjen e afateve të maturimit.

- Përdorimin më me efektivitet të fondeve për investime publike, nëpërmjet rritjes së përgjegjshmërisë të nëpunësve të të gjitha hallkave të angazhuara në të gjitha fazat e realizimit të këtyre investimeve, si programim, hartimin dhe zbatimin e procedurave të prokurimit public përfshirë fazën e ndjekjes së zbatimit të investimeve. Vëmëndje e veçantë i duhet kushtuar procesit të përzgjedhjes dhe kualifikimit profesional të stafit teknik administrative të ngarkuar me këtë detyrë, si dhe rritjen e shkallës së përgjegjësisë dhe të integritetit profesional dhe moral të punonjësve pranë institucioneve të ngritur me ligj për monitorimin dhe respektimin e dispozitave ligjore në fuqi në fushën e prokurimit publik të fondeve publike për investime.

▪ Krahas masave që duhen marrë për mbajtjen në kontroll të nivelit të planifikuar të deficitit buxhetor të vitit 2014 dhe rishikimin të nivelit të borxhit publik kundrejt PBB-së duke parashikuar masa konkrete dhe rezultate për uljen e tij nga vitit në vit me objektiv uljen e nivelit faktik në masën 60%; shqetësim të madh përbëjnë për ekonominë tonë borxhet që Buxheti i Shtetit ka kundrejt sipërmarrësve private. KLSH gjatë ushtrimit të veprimtarisë audituese është fokusuar në evidentimin e e mënyrës së buxhetimit të punëve mallrave dhe shërbimeve mënyrë kjo e cila ka sjellë për pasojë rritjen e detyrimeve të buxhetit të shtetit ndaj operatorëve ekonomikë. Përsa i përket detyrimeve të prapambetura ndaj të tretëve në raportin që KLSH paraqiti në Kuvend “Për zbatimin e buxhetit të shtetit të vitit 2011” ka trajtuar fenomenin e detyrimeve të buxhetit të shtetit ndaj kontraktorëve dhe ka rekomanduar: “Në kushtet aktuale sugjerojmë saktësimin dhe shqyrtimin me realizëm të gjendjes së këtyre borxheve, përcaktimi i masave për t’i dhënë mundësi dhe për të lehtësuar sa të jetë e mundur kompanitë private nga kosto e kredive që ato mund të kenë marrë për përmirësimin e situatës së tyre financiare, nëpërmjet ndërhyrjes për ristrukturimin e kredive dhe ndërkohë mbledhjen e borxheve të këqija. Gjithashtu duhet kërkuar nga sistemi bankar të inkurajojë dhënien e kredive. Madje, vlen të përmendet fakti se disa sipërmarrje private po marrin kredi informale, veprim i cili ka pasoja të dëmshme për ekonominë dhe vetë biznesin.

Edhe gjatë ushtrimit të veprimtarisë për vitin 2012 KLSH ka patur në qendër të vëmendjes evidentimin e këtij problemi dhe rekomandojmë marrjen e masave për eliminimin e këtij fenomeni në drejtimet e mëposhtme:

- 1- Procedimin nga Ministria e Financave për evidentimin (inventarizimin) e këtyre detyrimeve
- 2- Përcaktimin e përdorimit të të ardhurave të privatizimit për mbylljen e këtyre detyrimeve
- 3- Marrjen e masave për regjistrimin në sistemin e thesarit kontratat në shtrirje sipas viteve të parashikuara për financimin e tyre”. Ky rregjistrim jo vetëm do të sigurojë informacion të drejtë dhe të plotë për angazhimet financiare bazuar në kontratat shumëvjeçare, por do të mundësojë përdorimin e këtij informacioni nga Drejtoria e Përgjithshme e Buxhetit për nevojat e planifikimit të PBA-së.

Marre shkas nga konstatimi që në Raportin e projektvendimit “Për buxhetin faktik të vitit 2012” të Ministrisë së Financave zyrtarizuar me VKM nr 506 datë 13.06.20113 “Për propozimin e projektligjit “Për buxhetin e shtetit faktik të vitit 2012 “ nuk është trajtuar çështja e detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta rekomandojmë që në periudhat në vijim të trajtohen në “Raportin e buxhetit faktik” në një kapitull të veçantë.

- Në programin buxhetor të vitit 2014, duhen vlerësuar realisht gjendja e sektorëve të ekonomisë dhe mbi bazën e prioriteteve të programit qeveritar u duhet dhënë përparësi me fonde buxhetore sektorëve jetikë të ekonomisë, si shëndetësi, arsim, investimet në infrastrukturë dhe shërbimet sociale; madje me kujdes duhet trajtuar dhe mbështetur sektorët që punojnë për eksport si bujqësia, industria minerale, prodhimi agroindustrial, industria që punon me material porositësi etj.
- *Ritmi i privatizimit duhet të jetë më i shpejtë dhe i saktë për të siguruar objektivat e vëna, duke i kushtuar vëmendje forcimit të mjedisit të përgjithshëm të kontrollit të brendshëm si një bazë për një menaxhim të shëndoshë dhe efikas të procesit të privatizimit. **Për pasuritë strategjike si nafta, privatizimi duhet të orientohet drejt partnerëve gjeostrategjikë të Shqipërisë dhe Kombit Shqiptar.***

PJESA E TRETË

MBI MENAXHIMIN FINANCIAR DHE KONTROLLIN, SI DHE AUDITIMIN E BRENDSHËM.

Në vendimin e KM nr. 640, datë 11/6/2009 “Për miratimin e Letërpolitikave për kontrollin e brendshëm financiar dhe të planit të veprimit 2011-2014”, MF ngarkohej me detyrën për udhëheqjen e procesit për zbatimin e letërpolitikave. Në zbatim të këtij vendimi, NJQH/AB në MF, ka hartuar dhe miratuar drejtimet dhe çështjet që duhet të realizonte, performanca e të cilave, paraqitet përsa vijon:

Referuar detyrimeve të përcaktuara në këtë vendim dhe në planin e veprimit të hartuar për këtë qëllim, ndërkohë duke konsideruar dhe informacionin e paraqitur nga NJQH/AB; auditimi i ushtruar nga KLSH konstatoi se:

Objektivi për matjen e performancës:

Ministria e Financave (NJQH/MFK) do të përgatitë një dokument strategjik trajnimi lidhur me zbatimin e ligjit të ri për MFK-në dhe të manualit përkatës.

Objektiv i realizuar dhe në proces zbatimi. Me Urdhërin e Ministrit të Financave nr.11841, datë 10.06.2011 miratohet "Plani 5/vjeçar për zbatimin e një sistemi modern të menaxhimit financiar dhe kontrollit (2011-2016)". Ky dokument u hartua nga NJQH/MFK me asistencën ndërkombetare të ekspertëve të SIGMA/OECD. Në zbatim të planit 5/vjeçar, u miratua projekti pilot: “Mbi përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Fondeve Publike”, me fokus asistencë direkte në MPPT, dhe Autoritetin Rrugor Shqiptar (ARSH), sipas marreveshjes së veçante ndërmjet Keshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Mbreterisë së Suedisë “Mbi përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të Fondeve Publike (Faza I), të miratuar me VKM-në nr.698, datë 10.10.2012, i cili është në proces implementimi.

Objektivi për matjen e performancës:

Ngritja e kapaciteteve të administratës publike për zbatimin e një kuadri të ri për MFK-në nëpërmjet realizimit të trajnimeve për titullarët dhe drejtuesit e niveleve operacionale në sektorin publik në fushën e përgjegjshmërisë menaxheriale, kontroll dhe menaxhim financiar, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut dhe gjurmët e auditimit

Për arritjen e këtij objektivi në planin e veprimit parashikohet: Trajnimi i Njesive publike mbi procesin e buxhetimit do të mbulohet nga Fondi i Besimit IPS; Fonde të tjera do të kërkohen për trajnimin rreth çështjeve të MFK-së, të të gjithë zyrtarëve drejtues dhe të punonjësve të financave për një periudhë 3/vjeçare, duke nisur nga Janari 2011.

Objektiv në proces zbatimi. NJQH/MFK në bashkëpunim me ekspertët e Administratës Suedeze të Transportit (STA) dhe Autoritetit Kombëtar për Menaxhimin Financiar në Suedi (ESV), në vijueshmëri të punës së projektit “Mbeshtetje për Ministrinë e Financave lidhur me përmirësimin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit të fondeve publike”, të financuar nga SIDA, ka organizuar trajnime për menaxhimin e riskut në institucionet pilot “Autoriteti Rrugor Shqiptar” dhe “Ministria e Punëve Publike dhe Transportit”.

Gjate vitit 2012, NJQH/MFK ka organizuar (bazuar dhe në kërkesat e vete institucioneve publike), seminare ndërgjegjësuese dhe informuese mbi rrisitë e kuadrit ligjor të MFK-së dhe mbi

forcimin e përgjegjshmërisë menaxheriale, për institucionet qendrore, strukturat e vartësise dhe institucionet vendore. Përmendim, organizimin në fillim të vitit 2012 të dy seminareve të rëndësishme me Nepunesit Autorizues dhe Zbatues për interpretimin e udhëzimeve standarde të planifikimit dhe zbatimit të buxhetit.

Në bashkëpunim me Institutin e Trajnimit të Administratës Publike janë organizuar trajnime me nivelin e lartë dhe të mesëm menaxherial të institucioneve qendrore. Fokusi i trajnimit ishin “Konceptet për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, “Menaxhimi i Riskut” dhe “Procedurat për përgatitjen e hartës së proceseve dhe të gjurmës së auditimit” .

Objektiv për matjen e performancës:

Raportimi vjetor tek Këshilli i Ministrave, Kuvendi dhe Kontrolli i Lartë i Shtetit mbi proceset që lidhen me ndryshimet në KBFP.

Objektiv i realizuar. U hartua Raporti Vjetor mbi Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm në Njesitë e Qeverisjes së Përgjithshme për periudhën 1 Janar – 31 Dhjetor 2012. Në zbatim të nenit 18 të ligjit “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” u përgatit në bashkëpunim me NJQH/AB, Raporti Vjetor i 2012 për Funkcionimin e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm për NJQP. Raporti është dërguar në Këshillin e Ministrave së bashku me raportin faktik vjetor të buxhetit sipas ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008.

Objektivi për matjen e performancës:

Zgjerimi Gradual i Sistemit të Thesarit tek ministritë e linjës dhe njësitë e qeverisjes vendore. Decentralizimi i kontabilitetit dhe kontrolleve financiare nga Sistemi i Thesarit tek Njesitë që janë të lidhura on-line me Thesarin.

Njesite përgjegjëse dhe afatet: Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit dhe Ministria e Financave. Duke filluar në vitin 2010 dhe shtrihet për një periudhë 10/vjeçare. Po kështu, në aneksin nr. 3 të VKM është parashikuar faza III, dhe konkretisht: **Faza III (2011 – 2014): Shpërndarja e Sistemit të Thesarit në njesitë e tjera qeverisëse.** Planifikimi i riorganizimit të degëve të thesarit dhe të njesive të tjera, mbështetur në proceset e biznesit të propozuara. Përfshirja në pilotim e një game më të gjerë njesish, duke synuar kryesisht: Testimin e ndërlidhjes dhe të impaktit nga nivele të shumëllojshme në një shkallë më të gjerë; Testimin e operacioneve të modelit të propozuar të procesit të biznesit, në të gjithë shkallën e organizimit vertikal, përgjatë të gjitha niveleve administrative.

Objektiv në proces zbatimi: Ministria e Financave ka filluar implementimin e projektit për Zgjerimin e Sistemit të Thesarit, SETS (Support for Extension of the Treasury System) në muajin prill të vitit 2011. Njesia implementuese është Agjencia Austriake për Zhvillim. Gjatë vitit 2011-2012 u përgatiten termat funksionale dhe teknike të referencës për konfigurimet e nevojshme të SIFQ, me qëllim realizimin e aksesimit të SIFQ nga 5 institucione pilot. Nga auditimi rezultoi se, nga nëntori 2012 pesë (5) institucione pilot (Këshilli i Ministrave, Ministria e Financave, Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit dhe Autoriteti Kombëtar i Rrugëve) janë lidhur direkt me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë.

Para kalimit live me sistemin u përgatit dhe u dërgua për zbatim Udhezimi Specifik për Zbatimin e Buxhetit të Shtetit për Institucionet Buxhetore që Operojnë live me SIFQ nr.26, datë 20.11.2012

Gjithashtu është përgatitur Udhezuesi i Përdoruesit të SIFQ për institucionet on-line me sistemin, në të cilin udhëzohet përdorimi i sistemit në modulën e kontratave, të të pagueshmeve, të librit të madh, të buxhetit dhe të aseteve fikse.

Këto institucione ekzekutojnë transaksionet direkt në një system të vetëm, duke zbatuar te njejtat rregulla te kontrollit te brendshem te ekzekutimit te buxhetit. Aktualisht ato dergojne ne Degen perkatese te Thesarit dokumentat justifikues te transaksioneve, me qellim qe te realizohet nga thesari kontrolli i saktetise se kontabilizimit te transaksioneve para miratimit perfundimtar te tyre dhe postimit ne librin e madh te kontabilitetit. Dergimi fizik i ketij dokumentacioni do te vazhdoje per nje periudhe kohore derisa te filloje implementimi i arkives elektronike per te bashkengjitur elektronikisht dokumentat justifikuese transaksionit perkates.

Nepermjet perdorimit on-line te SIFQ ketyre institucioneve i'u mundesohet rregjistrimi i detajimit fillestar te buxhetit (Ministrive te Linjes dhe Institucioneve Qendrore), **rregjistrimi i vlerave te prokurimit duke siguruar mosperdorimin e fondeve buxhetore per motive te ndryshme nga te cilat ato jane miratuar, rregjistrimin e kontratave** (rregjistrimi i kontrates nuk mund te realizohet nese ne system nuk eshte rregjistruar me pare vlera e prokurimit per ate kontrate), rregjistrimin e urdher shpenzimit (standarde/pa kontrate dhe urdher shpenzim te lidhur me kontrate), rregjistrimin e transaksioneve te brendshme ne librin e madh te kontabilitetit, ekzekutimin e raporteve operationale nga modulet perkatese dhe ato finaciare nga libri i madh i kontabilitetit.

Ne te ardhmen eshte planifikuar qe dhjetë (10) deri në pesëmbëdhjetë (15) ministri linje dhe institucione të tjera buxhetore, përfshirë Bashkinë e Tiranës, gradualisht do të lidhen me Sistemin Informatik Financiar të Qeverisë deri në prill 2015. Kjo gjë do të kërkojë trajnimin e 60 deri në 140 zyrtarëve të tjerë të administratës publike në lidhje me sistemin informatik financiar të qeverisë. Me anë të këtij zgjerimi/veprimi pjesa më e madhe e buxhetit të shtetit do të administrohet direkt nëpërmjet Sistemit Informatik Financiar te qeverisë.

Objektiv per matjen e performances:

Kalimi tek IPSAS. Faza e parë do të konsistojë në implementimin e IPSAS me bazë cash-in si standard tranzitor, IPSAS 6 dhe 24. Është parashikuar që këtij procesi do t'i duhen gjashtë vjet për t'u vënë në zbatim në një numër të kufizuar ministrish dhe njësisish të qeverisjes vendore.

Si do te arrihet objektivi: Për të ndërmarrë këtë proces nevojitet mbështetje e mëtëjshme teknike nga ana e donatorëve të huaj.

Ecuria e procesit: Në sqarimet e ministrisë referuar informacionit të kërkuar për kete objektivi, nga NJQH/MFK eshte theksuar: *Ne kuadrin e tranzitimit nga baza e modifikuar e kontabiliteti ne bazen e te drejtave te konstatuara (IPSAS) siç eshte parashikuar ne Planin e veprimit, eshte kerkuar asistence teknike nderkombetare ne kuadrin e implementimit te Trust Fund 2, i cili nuk eshte bere i vlefshem. Me pas Ministria e Financave ka aplikuar perseri ne kuadrin e IPA 2013.*

Per sa kohe qe nuk ka asistence nderkombetare si dhe vendim perfundimtar nga BE, vendi yne do te vijojte te zbatoje rregullat ekzistuese per NJQH dhe Sistemin e Thesarit. Bazuar ne nenin 61 të ligjit “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në republikën e Shqipërisë “Sistemi i thesarit mban kontabilitetin e shtetit dhe është pjesë e kontabilitetit publik. Ai është përgjegjës për mbajtjen e llogarive të shtetit dhe përgatitjen e raporteve periodike dhe vjetore të zbatimit të buxhetit”.

Qe ketej rrjedh qe Sistemi i Thesarit eshte pergjegjes vetem per rregjistrimin e shpenzimeve dhe te ardhurave te shtetit (momenti i njohjes se te cilave ne kontabilitet percaktohet ne nenin 61) dhe jo per raportimin ne Kuvend te bilancit pasuror te shtetit, pavaresisht se AMoFTS eshte ndertuar ne menyre te tille qe te plotesoje kerkesat e standardeve nderkombetare (vizioni i AMoFTS eshte per implementim me shume se 10/vjeçar).

Nga Ministria e Financave është kryer aplikimi për IPA 2013 për përfitimin e një projekti: “Për përmirësimin e metodologjisë se kontabilitetit dhe vlerësimit te MFK-së në institucionet publike.

Ne perfundim të auditimit të ushtruar në MF-ve, KLSH ka vlerësuar punën e bërë nga NJQH/MFK, pasi kjo njësi është kryer një punë voluminoze për evidentimin e perputhshmerise se statusit te nepunesve ne 1433 njesi te qeverisjes se pergjithshme me kerkesat e nenit 12 te ligjit nr.10296, date 08.07.2010 “Per Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” dhe ligjin nr. 90, date 27.09.2012 “Per Organizimin e Administrates Shteterore”. Ne kete kuader, dhe pas konkludimit te mbledhjes se bordit te Menaxhimit te KBFP me date 31.10.2012, Titullareve te NJQP-ve iu kerkua permbushja e detyrimeve ligjore mbi Nepunesit Zbatues brenda nje afati prej 3 muajsh, sipas rekomandimit te KLSH. Në praktikat shpresore dërguar Titullarëve të institucioneve është kërkuar:

- a) Zevendesimi i Nepunesve Zbatues qe nuk plotesojne kriterin e arsimit sipas nenit 12 te ligjit nr.10296, ne te gjitha bashkite dhe komunat me probleme. Perbejne perjashtim nepunesit ne moshe pensioni dhe nepunesit me arsim bachelor qe jane ne vazhdim masteri.
- b) Rishikimi i vartesis se Nepunesit Zbatues ne funksion te ligjit “Për Menaxhimin financiar dhe Kontrollin”
- c) Rishikimi/riemertimi i struktures organizative te organit qendror dhe strukturave te vartesis lidhur me ripozicionimin e Nepunesit Zbatues sipas nenit 16, pika 2 dhe nenit 18, pika 3 te ligjit nr. 90, date 27.09.2012 “Per Organizimin dhe Funksionimin e Administrates Shteterore”.

Gjithashtu, në shkresat njërive të qeverisjes së përgjithshme, është dhënë orientimi që Drejtoria e Financave te jete ne vartesi direkte te Nepunesit Autorizues te njesise dhe ne vartesi te saj te dallohen qarte 3 funksionet si:

- (i) planifikimi i buxhetit dhe monitorimi, hartimi i rregullave te brendshme te menaxhimit financiar, gjurmet e auditimit;
- (ii) kontrolli financiar paraprak gjate zbatimit te buxhetit, kontabiliteti dhe raportimi financiar;
- (iii) marredheniet me thesarin, menaxhimi i debitoreve dhe kreditoreve te institucionit.

Nga ky monitorim rezultoi se në 33% të institucioneve dhe ne vlere numerike në total, *kane rezultuar 482 institucione nga te cilët 314 institucione qendrore dhe 168 institucione vendore, që nuk përmbushnin kriteret ligjore për caktimin e Nëpunësit Zbatues.* Pas këtyre rezultateve dhe korrespondencave për përmirësimin e situatës deri ne qershor të vitit 2013 referuar informacionit te paraqitur nga NJQH/MFK, *progresi i procesit rezulton me 13% të institucioneve te njësive të qeverisjes së përgjithshme.*

Gjatë gjithë vitit 2012, KLSH në pjesën dërmuese të subjekteve të audituar ka ushtruar dhe auditim për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në 59 subjekte gjithsej, nga të cilat: në 24 institucione qendrore dhe 35 njësi të pushtetit vendor; ndërsa për vlerësimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm në 25 subjekte publike gjithsej, nga të cilat 14 institucione qendrore dhe 11 njësi të pushtetit vendor, sipas anenksit nr. 3 bashkëlidhur këtij raporti.

Konstatimet e pasqyruara në raportet përfundimtarë të auditimit të evaduar për llogari të buxhetit të vitit 2012, sipas subjekteve të audituar dhe problematikës së evidentuar, paraqiten përsa vijon:

I. Për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimin financiar dhe kontrollin:

Në zbatim të nenit 7 të Ligjit Organik të KLSH dhe në zbatim të kërkesave të ligjit nr. 10 296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, KLSH ka mbikëqyrjen dhe vlerësimin e kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar në 59 subjekte gjithsej si në administratën e institucioneve më të larta shtetërore, në ministri dhe institucione të pavarura, në prefektura, këshill qarqesh, bashki, komuna etj., nga ku ka rezultuar se:

- Në zbatim të nenit 65 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” ka nisur puna për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të pesë komponentët e tij. Për sa mësipër, KLSH në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” ka programuar dhe vlerësuar organizimin dhe funksionimin e menaxhimit financiar në të pesë këta komponentë si: ***mjedisi kontrollit, menaxhimi i riskut, aktivitetet e kontrollit, informimi komunikimi dhe monitorimi***. Konkretisht:

2. Mjedisi i Kontrollit të Brendshëm

Në përgjithësi në institucionet e audituar, funksionimi i kontrollit të brendshëm nga lart poshtë ka qenë relativisht i mirë. Ky kontroll i ka kushtuar një vëmendje të veçantë, vlerësimi të risqeve për subjektin dhe mbështetet në aplikimin e testeve substanciale dhe procedurave analitike të rishikimit. Strukturat përgjegjëse të këtyre institucioneve kanë dijeni për ligjin nr. 10296, datë 08. 07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe për aktet e tjera nënligjore dalë në zbatim të tij. Megjithatë, në subjekte të veçanta u konstatuan të meta dhe mangësi si:

2.1 Në Ministrinë e Brendshme, u konstatua se njësia: - disponon rregulloren e brendshme ku përcaktohen rregullat e etikës, të konfliktit të interesit, marrëdhëniet midis menaxherëve, marrëdhëniet me të tretë etj., por *këto rregulla nuk janë përshtatur me detyrimet që rrjedhin nga ligji për MFK-në; në rregulloren e brendshme nuk jepen përshkrime pune për çdo pozicion pune në të cilat të përfshihen detyrat individuale që duhen kryer, kërkesat lidhur me kualifikimet e nevojshme dhe linjat e raportimit; vlerësimet vjetore të punonjësve, megjithëse janë bërë nga eprorët direkt, nuk ka vlerësime periodike të tyre në përputhje me kërkesat e ligjit për MFK-në. rrjedhin nga ligji nr. 10 296, datë 08. 07.2010 për MFK.*

2.2 Në Ministrinë e Punëve të Jashtme u konstatua se, nga njësia *nuk është hartuar “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm”, në kundërshtim me nenin 18, të ligjit nr. 10296, datë 08. 07.2010 për MFK-në; struktura organizative është miratuar me urdhrin e Kryeministrit nr. 39, datë 29.03.2012 por, njësia nuk ka një rregullore të brendshme që të pasqyrojë ndryshimet e kësaj strukture dhe kërkesat e ligjit për MFK-në.*

2.3 Në MBUMK, u konstatua se në njësitë e varësisë *nuk kishin hartuar e paraqitur në MBUMK raporte për gjendjen e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, siç përcaktohet në nenin 9, pika 3, të ligjit për MFK-në.*

2.4 Në MPÇSSH, u konstatua se emërimi i nëpunësit zbatues, *nuk është bërë në përputhje me kërkesat e ligjit për MFK-në, pasi nuk është në varësi të Sekretarit të Përgjithshëm i cili është nëpunësi autorizues.*

2.5 Në Gjykatën e Lartë, u konstatua se nëpunësi zbatues është caktuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit për MFK-në, pasi mbahet nga Përgjegjësja e Sektorit të Financës e cila ka varësi direkte nga Drejtori i Drejtorisë Ekonomike, Personelit dhe Shërbimeve, si menaxheri më i lartë për financat dhe *jo nga nëpunësi autorizues; njësia nuk ka hartuar “Deklaratën për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm”, në kundërshtim me nenin 18, të ligjit për MFK-në; si dhe nuk ka hartuar një rregullore të re të brendshme ku të përfshiheshin edhe detyrimet që rrjedhin nga ligji për MFK-në dhe të përshtatej me ndryshime strukturore që janë bërë.*

2.6 Në Avokatin e Popullit rezultoi se njësia, ka rregullore të brendshme të organizimit dhe funksionimit, por *në këtë rregullore nuk reflektohen detyrimet që burojnë nga ligji nr. 10 296, datë 08. 07.2010 për MFK-në.*

2.7 Në Prokurorinë e Përgjithshme, njësia: - *nuk disponon një Plan Strategjik i cili nënkupton hartimin e një strategjie disavjeçare (1+4 vite) ku të përcaktohen politikat, drejtimet dhe prioritetet kryesore; nuk ka një rregullore për zbatimin e rregullave të etikës për punonjësit që trajtohen me statusin e nëpunësit civil dhe nuk ka përcaktuar ndonjë procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën dhe për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara, por*

disponon kodin e etikës profesionale të Prokurorëve; *nuk ka përcaktuar rregulla të brendshme që trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre, si dhe nuk ka bërë vlerësime periodike të punonjësve* lidhur me detyrat që ata kryejnë.

2.8 Në Aparatin e Këshillit të Ministrave, u konstatua se;

a) *Për vendosjen e objektivave për vitin 2012*, stafi i njësisë ka funksionuar dhe ka realizuar detyrat e tij, bazuar në përshkrimin e punës në shërbimin civil, të përcaktuar nga çdo strukturë e veçantë ku është përcaktuar qëllimi i punës, detyrat kryesore për organizimin e punës, menaxhimin e personelit dhe të burimeve të tjera, *por akoma nuk ka rregullore të brendshme të organizimit dhe funksionimit* ku të jenë përcaktuar objektivat kryesore të punës, detyrat funksionale dhe përgjegjësia e strukturave përkatëse të administratës; njësia ka krijuar Ekipet e Menaxhimit të Programeve (EMP), *por duhet të kishte krijuar dhe Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS), dhe koordinatorin e tij;*

b) *Për politikën dhe praktikën e menaxhimit të burimeve njerëzore, rezultoi se për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve, punonjësit kanë kryer trajnime, por vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e punonjësve të saj.*

2.9 Në Akademinë e Shkencave, *nuk është hartuar “Deklarata për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm”,* çka bie në kundërshtim me nenin 18, të ligjit për MFK-në; po kështu *nuk është hartuar një rregullore e re ku të përfshihen edhe detyrimet që rrjedhin nga ligji për MFK-në, duke arsyetuar me rregulloren të brendshme të organizimit dhe funksionimit të Akademisë.*

2.10 Në Agjencinë e Prokurimit Publik, njësia ka mangësi për sa i përket vendosjes së objektivave, pasi megjithëse në analizën vjetore janë përcaktuar qëllimet strategjike dhe prioritetet e institucionit, *njësia nuk disponon një Plan Strategjik e cili nënkupton hartimin e një strategjie disavjeçare ku të përcaktohen politikën, drejtimet dhe prioritetet kryesore të njësisë; njësia respekton rregullat dhe parimet e etikës në administratën publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, por nuk ka hartuar Kodin e Etikës Profesionale për punonjësit e saj dhe nuk ka përcaktuar procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën apo për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara; njësia ka krijuar ekipin e menaxhimit të programit (EMP), por nuk ka krijuar grupin e Menaxhimit Strategjik, pasi është institucion në varësi të Kryeministrit; Titullari i delegon me shkrim kompetencat drejtorëve, por nuk ka rregulla të brendshme të miratuara të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tij; njësia ka kryer trajnime, veçanërisht për punonjësit e rinj nëpërmjet ITAP-it apo në subjekte të tjera, por vetë nuk ka programe specifike për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve të tij.*

2.11 Në Institutin e Statistikave, njësia respekton rregullat dhe parimet e etikës në administratën publike, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”, *por nuk ka hartuar Kodin e Etikës Profesionale për punonjësit e tij dhe nuk ka përcaktuar procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën apo për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara; nuk ka rregulla të brendshme të miratuara të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tyre; ka mangësi për sa u takon politikave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, pasi nuk ka bërë vlerësime periodike të punonjësve* lidhur me detyrat që ata kryejnë; njësia ka kryer trajnime, veçanërisht për punonjësit, por vetë njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve; gjithashtu ka mangësi për sa u takon politikave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, pasi *nuk ka përcaktuar modalitete për vlerësimin e punës së punonjësve dhe as kritere bazë të vlerësimit, si dhe nuk janë bërë vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që ata kryejnë.*

2.12 Në Autoritetin Rrugor Shqiptar, njësia në Deklaratën për cilësinë e sistemit të kontrollit të brendshëm që ka dërguar në MPPT për vitin 2012, ka cilësuar se *nuk është përmbushur në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit të MFK-së sistemi i kontrollit të brendshëm* sidomos ai i

menaxhimit të riskut, mjedisit të kontrollit, informimit dhe komunikimit; nga njësitë e varësisë nuk janë hartuar dhe dërguar në ARSH raporte për gjendjen e funksionimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 9, pika 3 e ligjit për MFK-në; njësia nuk ka Deklaratë Misioni të miratuar në përputhje me kërkesat e ligjit të MFK-në, por në përgjigjen e saj ARSH është shprehur se kjo gjen shprehje në Rregulloren e Brendshme të institucionit të miratuar nga ministri në vitin 2007, pavarësisht se kjo rregullore nuk është përshtatur me kërkesat e ligjit për MFK-në; njësia nuk ka një plan strategjik të saj dhe shprehet se i mbështet prioritetet e saj në Planin Kombëtar të Transportit, neni 106 i MSA, Strategjia Sektoriale dhe Programin e Qeverisë, por nuk ka një dokument që të përmbajë strategjinë, prioritetet plan veprimet etj., në kundërshtim me nenin 9 të ligjit për MFK-në; njësia nuk ka një plan-veprimi të miratuar që të pasqyrojë të gjitha aktivitetet sipas drejtorive, ku të përcaktohen detyrat dhe përgjegjësitë e të gjithë punonjësve dhe afati kohor i realizimit të tyre; për rregullat e etikës personale dhe profesionale njësia nuk ka hartuar Kodin e Etikës Profesionale për punonjësit e tij dhe nuk ka përcaktuar rastet e konfliktit të interesit dhe deklarimin e tij, konformë kërkesave të ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike”; titullari i njësisë ka nxjerrë urdhër me shkrim për delegimin e firmës dhe të detyrave kur ai mungon, por nuk ka rregulla të brendshme të miratuara të cilat trajtojnë delegimin e detyrave dhe mënyrën e dokumentimit të tij; njësia nuk ka rregulla të brendshme ku të përcaktohen qartë nëse menaxherët e njësisë ndërmarrin hapat e duhura në rastet e shkeljeve të normave ligjore, të rregulloreve, apo procedurave nga punonjësit, si dhe nuk janë parashikuar masat disiplinore në rast të shkeljes së kodit të etikës dhe disiplinës në punë të punonjësve; për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale, njësia nuk ka programe specifike për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve.

2.13 Në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, si nëpunëse zbatuese njësia ka caktuar përgjegjësen e financës dhe *jo personin përgjegjës që përgjigjet direkt para nëpunësit autorizues*, në kundërshtim me nenin 4, pika 24 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010, duke sjellë si pasojë që punonjësi i financës të jetë në konflikt interesi me kryerjen e kësaj detyre; *nuk është përgatitur “Deklarata Vjetore mbi Funksionet e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm dhe Menaxhimin Financiar për vitet 2011 dhe 2012*, në kundërshtim me kërkesat e nenit 18, të ligjit për MFK; *nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të emetuara nga MF-ve dhe rrjedhimisht, nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme*, në kundërshtim me nenin 16, pikat 2 e 3 të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 dhe me kapitullin e III-të të Manualit për “Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”; *nuk janë hartuar dhe miratuar Rregullat dhe procedurat për mbrojtjen e asetëve*, për ruajtjen, administrimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësisë, në kundërshtim me nenin 8, germa “ç” të ligjit për MFK; *nuk është hartuar Kodi Etik*, pavarësisht se e gjithë administrata dhe personeli mjekësor janë në kontakt të vazhdueshëm me pacientët dhe publikun, në kundërshtim me Statutin e QSUT nr. 2369, datë 25.06.2007; njësia *nuk disponon një rregullore të brendshme të organizimit dhe funksionimit*, të aprovuar nga Bordi Drejtues, dhe deri më tani është punuar me një draft rregullore, e cila nuk u përgjigjet kërkesave aktuale të zhvillimit të sistemit shëndetësor dhe *nuk i përmbush kërkesat e ligjit për MFK-në, duke mosreflektuar asnjë nga detyrimet që burojnë prej tij*, si përgjegjshmëria menaxheriale, linjat e raportimit, rastet e delegimit të të drejtave dhe detyrave, procedurat standarde të menaxhimit të aktiveve, procedurat e brendshme antikorrupsion dhe sinjalizimit të parregullsive etj.

2.14 Në Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, nga njësia nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore, bazuar në gjurmët standarde të miratuara nga MF-ve dhe rrjedhimisht nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme, veprim ky që bie ndesh me kërkesat e nenit 16, pika 2 dhe 3 të ligjit për MFK-në, me kërkesat e urdhërit të Ministrisë të Financave nr. 92, datë 29.12.2011 “Për gjurmët standarde të auditimit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”, si dhe të detyrimeve të përcaktuara në kapitullin III, të Manualit

për MFK-në, të miratuar nga Ministri i Financave; nga njësia *nuk ishte ngritur Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS)* për periudhën e auditimit, në cilësinë e një Komiteti që duhet të evidentojë të metat, mangësitë dhe menaxhimin e risqeve, në pajtim me detyrimet e neneve 8, 10 dhe 27, të ligjit për MFK-në; si dhe *nuk është hartuar dhe nuk është miratuar Kodi i Etikës Profesionale për punonjësit*, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003 “Për rregullat e etikës në administratën publike” dhe nuk ka përcaktuar procedurë për të raportuar shkeljet e legjislacionit mbi etikën apo për marrjen e masave për shkeljet e konstatuara.

1.15 Në *Qendrën Kombëtare të Kinematografisë*, njësia ka rregullore të brendshme të organizimit dhe funksionimit ku ërcaktohen qartë detyrimet funksionale dhe detyrimet e secilit, por *nuk janë parashikuar masat disiplinore në rast të shkeljeve të kodit të etikës dhe disiplinës në punë të punonjësve*; ka mangësi përsa u takon politikave dhe praktikave të menaxhimit të burimeve njerëzore, pasi *nuk ka të përcaktuar modalitete për vlerësimin e punës së punonjësve dhe as kritere bazë të vlerësimit dhe nuk janë bërë vlerësime periodike*.

1.16 Në *Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare*, nga njësia *nuk është plotësuar deklarata vjetore mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar; nuk janë hartuar gjurmët e auditimit të detajuara për procedurat kryesore bazuar në gjurmët standarde të hartuara nga Ministria e Financave; nuk ka hartuar kodin e etikës profesionale*; ka rregullore të brendshme me detyra të detajuara për çdo post pune, por kjo rregullore daton nga viti 2008 dhe *nuk është përshtatur dhe nuk reflekton detyrimet që rrjedhin nga ligji për MFK-në*.

1.17 Në *Universitetin “Egerem Çabej” Gjirokastër*, është emëruar si nëpunës autorizues Kancelari i Universitetit dhe *jo Titullari i institucionit që është punonjësi i nivelit më të lartë menaxhues*, në kundërshtim me nenin 19, të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në SH; njësia *nuk ka bërë vetëvlerësim dhe raport për cilësinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm*, në kundërshtim me nenin 18, të ligjit për MFK-në; si dhe njësia ka rregullore të brendshme të organizimit dhe funksionimit, por *nuk ka përcaktuar detyra specifike për çdo vend pune*.

1.19. Në *Njësitë e Qeverisjes Vendore:*

a) Në *Bashkitë Koplík, Divjakë, Çorovodë dhe Konispol*, nuk ka nisur procesi i ngritjes së sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 dhe të UMF nr. 6082, datë 06.03.2011.

b) Në *Bashkitë Bilisht, Bulqizë, Fushë-Krujë, Vau i Dejës, Kuçovë, Libofshë, Këshilli i Qarkut Kukës, Prefekturën Berat dhe në Komunat Dishnicë e Levan*, nuk janë hartuar politikat për miratimin dhe monitorimin e objektivave për planet strategjike dhe vjetore, përfshirë edhe strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan – veprimeve për arritjen e objektivave të njësive që ato drejtojnë.

c) Në *Bashkitë, Kavajë, Fier, Kuçovë, Çorovodë, Manëz dhe Komunën Levan*, nuk është hartuar e miratuar kodi i etikës për punonjësit e tyre, si dhe në *Bashkitë Kavajë dhe Divjakë*, si dhe *Komunën Levan*, nuk është ngritur sistemi i deklarimit sipas niveleve dhe afateve përkatëse.

d) Në *Bashkitë Fier, Kuçovë, Konispol dhe Komuna Bilisht*, në rregulloret e brendshme nuk pasqyrohen përshkrimet dhe përgjegjësitë për çdo punonjës, si dhe mungojnë linjat e raportimit në funksion MFK. Po kështu në *Bashkitë Manëz, Çorovodë dhe Komuna Karbunarë*, në rregulloret e brendshme, nuk janë përshtatur me kërkesat e ligjit për MFK, pasi *nuk përfshihen detyrimet që ato kanë ndaj ZMMT, Zyrës së Urbanistikës, Zyrës së Shërbimit për Administrim e Menaxhim, vënia në efikasitet dhe aseteve etj.*

e) Në *Bashkitë Fier e Libohovë dhe në Komunën Karbunarë*, nuk është miratuar një sistem i rregullave specifike dhe i procedurave për ruajtjen, mbrojtjen e nxjerrjen jashtë përdorimit të aktiveve të njësive të përcaktuara në manualin e MFK-së, por në veprimtarinë e përditshme u referohen dispozitave ligjore të shfuqizuara.

f) Në *Bashkinë Kavajë* janë hartuar planet strategjike, por në këto plane nuk janë përfshirë procedurat antikorruption.

2. Menxhimi i riskut.

Pavarësisht nga puna e bërë për menaxhimin e riskut për identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ngjarjet apo situatat e mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të tyre, në disa nga subjektet e audituar u konstatuan mangësi si:

2.1 Në Administratën e Presidencës dhe të Këshillit të Ministrave, nuk ka një strategji risku të dokumentuar dhe të miratuar, në kundërshtim me Kreun III të Manualit për MKF, ku përcaktohet “*Titullarët e njësive të qeverisjes qendrore janë përgjegjës për miratimin e strategjive për menaxhimin e risqeve për sistemin efektiv të menaxhimit të risqeve brenda njësisë së tyre*”. Po kështu, në Prokurorinë e Përgjithshme, Ministrinë e Brendshme, MPCSSHB dhe Institutin e Statistikave.

2.2 Në Avokatin e Popullit dhe Akademinë e Shkencave, njësitë nuk kanë përmbushur detyrimin për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, si dhe nuk janë hartuar strategjitë për menaxhimin e risqeve, në kundërshtim me kërkesat e neneve 8/a, 9/4, 10, 11, 11/2, 12/3 dhe 21 të ligjit nr. 10296, datë 08. 07.2010 për MFK-në.

2.3 Në Ministrinë e Shëndetësisë, njësia ka caktuar koordinatorin e riskut dhe nuk ka ekspertizë të mirëfilltë të analizës së riskut, në kundërshtim me kërkesat e nenit 10 të ligjit për MFK-në.

2.4 Në Gjykatën e Lartë dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, nuk është hartuar regjistri i identifikimit të risqeve, në kundërshtim me kërkesat e nenit 10, të ligjit për MFK-në dhe Grupi për Menaxhimin Strategjik nuk ka caktuar koordinatorin e riskut. Ndërsa, në Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare, njësia nuk ka hartuar regjistrin e risqeve për identifikimin dhe kontrollin e riskut duke vënë në rrezik arritjen e objektivave të veprimtarisë, si dhe nuk ka hartuar strategjinë për menaxhimin e riskut dhe nuk ka ngritur Grupin e Menaxhimit Strategjik (GMS).

2.5 Në Autoritetin Rrugor Shqiptar, njësia nuk ka procedurë të shkruar për menaxhimin e riskut, identifikimin, analizën dhe kontrollin e risqeve të cilat mund të venë në rrezik arritjet e ARSH.

2.6 Në Agjencinë e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit, rezultoi se është hartuar një regjistër i identifikimit dhe kontrollit të risqeve dhe adresohen personat përgjegjës për çdo risk, por nuk ka një përditësim të tij dhe dërgimin e regjistrit të risqeve në NJQHMFK të MF-ve, konformë përcaktimeve të Kreut III, “Identifikimi i risqeve” të Manualit për MFK-në; gjithashtu në momentin e auditimit nuk kishte hartuar Strategjinë për menaxhimin e risqeve.

2.7 Në Qendrën Spitalore Universitare “Nënë Tereza” Tiranë, nuk janë përmbushur detyrimet në kuadër të përgjegjshmërisë menaxheriale për identifikimin dhe krijimin e Regjistrit të Risqeve, monitorimin e kontrolleve të risqeve që venë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive, në kundërshtim me kërkesat e neneve 9. 4/c, 10, 11/2, 12/3 dhe 21 të ligjit për MFK; si dhe nuk ka hartuar Strategjinë për Menaxhimin e Risqeve, në kundërshtim me nenet 8/a, 10, 11, e 12 të ligjit për MFK-në.

2.8 Në Qendrën Kombëtare të Kinematografisë, njësia nuk kishte një procedurë të caktuar për menaxhimin e riskut dhe nuk ishte caktuar me shkresë të veçantë koordinatori i riskut.

2. Në Njësitë e Qeverisjes Vendore:

a) Në Bashkitë Bilisht, Bulqizë, Fushë-Krujë, Vau i Dejës, Kuçovë, Libofshë, Këshillin e Qarkut Kukës, Prefekturën Berat dhe Komunat Dishnicë e Levan, nuk janë hartuar politikat për miratimin dhe monitorimin e objektivave për planet strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan veprimeve për arritjen e objektivave të njësive që ato drejtojnë, si dhe nuk janë ngritur grupet e menaxhimit strategjik që kryesohen nga menaxheri kryesor.

b) Në disa njësi të tjera vendore, nuk janë zbatuar afatet ligjore për dorëzimin e vet vlerësimeve, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual, si dhe nuk janë hartuar dhe depozituar në Ministrinë e Financave deklaratat vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, jo më vonë se fundi i muajit prill, në kundërshtim me kërkesat e nenit 18, të ligjit për MFK-së etj.

3. Aktivitetet e kontrollit.

Në përgjithësi strukturat aktuale i përgjigjen mbulimit të të gjitha funksioneve të parashikuara, pa krijuar konflikt interesi dhe pa mbivendosur detyrat. Proceset kryesore të punëve operacionale dhe financiare janë të shkruara dhe të përcaktuar në strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme. Megjithatë në subjekte të veçanta u konstatuan parregullsi e konkretisht:

3.1 Në Avokatin e Popullit dhe Ministrinë e Punëve të Jashtme, njësitë nuk kanë hartuar gjurmën e auditimit të detajuar për procedurat kryesore, bazuar në gjurmën standarde të miratuar nga MF-ve dhe rrjedhimisht nuk ka miratim dhe arkivim të kësaj gjurme, në kundërshtim me kërkesat e nenit nr. 16, pikat 2 e 3, të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 për MFK-në.

3.2 Në MPCSSHB, aktivitetet e kontrollit rezultojnë të dobëta në fusha të veçanta si pagat dhe pagesat, prokurimet, kontabiliteti dhe raportimi financiar etj. si dhe delegimi i detyrave në nivele të ndryshme të menaxhimit nuk rezultojnë në nivelin e duhur dhe nuk është rregulluar me akte administrative të brendshme.

3.3 Në Autoritetin Rrugor Shqiptar, nuk janë parashikuar rregulla të brendshme mbi zbatimin e sistemit të firmës së dyfishtë apo që i njëjti punonjës të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy ose më shumë detyrave që kanë të bëjnë me zbatimin dhe regjistrimin e operacioneve financiare.

3.4 Në Oendrën Kombëtare të Kinematografisë, të gjitha transaksionet financiare bëhen në përputhje me udhëzimet dhe rregullat e përcaktuara nga Ministria e Financave, por nuk janë parashikuar rregulla të brendshme mbi zbatimin e sistemit të firmës së dyfishtë apo që i njëjti punonjës të mos përfshihet njëherësh në zbatimin e dy ose më shumë detyrave që kanë të bëjnë me zbatimin dhe regjistrimin e operacioneve financiare.

4. Informimi, Komunikimi dhe Monitorimi

Në përgjithësi Titullarët e njësive publike kanë vënë në funksionim sisteme informacioni dhe komunikimi që ofrojnë siguri, për identifikimin, mbledhjen dhe përhapjen e informacionit të besueshëm dhe të përshtatshëm, brenda afateve të duhura dhe që bëjnë të mundur që çdo punonjës të marrë përsipër përgjegjësitë. Ka një komunikim efektiv, si virtual, ashtu edhe horizontal, në të gjitha nivelet e hierarkisë në njësi. Funksionon një sistem i përshtatshëm informacioni që ka si qëllim shpërndarjen e udhëzimeve dhe të urdhrave të qarta dhe të sakta për rolin e çdo punonjësi. Dokumentacioni i të gjitha veprimeve, proceseve dhe transaksioneve qarkullon dhe siguron gjurmën e auditimit etj.

Megjithatë në subjekte të veçanta u konstatuan parregullsi e konkretisht:

4.1 Në Ministrinë e Punëve të Jashtme, njësia është e pajisur me sistemin e IT-së për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) dhe për ripërfitimin e të dhënave në rast aksidenti sistemit, por referuar pyetësorit të vetëvlerësimit rezultoi se sistemi i IT ka nevojë për një ristrukturim rrënjësor.

4.2 Në Ministrinë e Integritetit, administrata është e pajisur me sistemin e IT-së me një procedurë të përshtatshme për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) dhe për ripërfitimin e të dhënave në rast aksidenti të sistemit dhe të testimit të këtyre procedurave në praktikë, por referuar pyetësorit të vetëvlerësimit, rezultoi se ky aspekt është vlerësuar mjaftueshëm. Në këtë institucion nga Sektori i IT-së të dhënat ruhen, por jo të gjithë të dhënat janë të ruajtura në backup, ndërsa për dokumentacionin financiar ai ruhet në bazë të raporteve mujore dhe progresive.

4.3 Në Agjencinë e Prokurimit Publik, njësia është e pajisur me sistemin e IT-së për hedhjen e të dhënave në një sistem rezervë (back-up) dhe për ripërfitimin e të dhënave në rast aksidentit sistemit dhe për zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve ka kryer trajnime periodike me ITAP apo me struktura të tjera, por vetë njësia nuk ka program specifik për trajnimin e punonjësve të saj.

4.4 Në Autoritetin Rrugor Shqiptar, nuk funksionon sistemi i IT, funksionon komunikimi me postë të brendshme elektronike por ai nuk përdoret vazhdimisht nga punonjësit. Nuk funksionon komunikimi me internet me institucionet e varësisë dhe me itranet brenda institucionit.

4.5 Në *Drejtorinë e Shërbimeve Qeveritare*, njësia nuk ka një rregullore pune për komunikimet elektronike dhe në kuadër të implementimit të informatizimit të veprimtarisë mungojnë raportet për shqyrtimin dhe përpunimin e informacionit.

4.6 Në *Qendrën Kombëtare të Kinematografisë*, lidhur me pajisjen e sistemeve të IT-së, me një procedurë të përshtatshme për lidhjen e të dhënave me një sistem rezervë (back-up) dhe për ripërfitimin e të dhënave në rast aksidenti të sistemit dhe të testimit të këtyre procedurave në praktikë, rezultoi se nuk ekzistojnë sisteme back-up, të cilat administrohen nga Drejtoria e teknologjisë së Informacionit.

Së fundi, cilësojmë se, në përgjithësi *Titullarët e njësive publike kanë marrë masat e duhura për ngritjen e sistemeve të monitorimit dhe menaxhimit financiar dhe kontrollit që sigurojnë përditësimin sa herë që ndryshojnë kushtet*. Ata informohen në vazhdimësi nga Drejtorët dhe përgjegjësit e sektorëve mbi aktivitetet e strukturave që ata drejtojnë me anë të informacioneve, evidencave dhe raportimeve mujore, tremujore e vjetore, në përputhje me detyrimet e përcaktuara në rregulloret e brendshme të tyre.

II. Mbikëqyrja (vlerësimi) i veprimtarisë së auditimit të brendshëm.

Auditimi i brendshëm përkufizohet si një aktivitet për vlerësimin e pavarur të veprimtarisë brënda një entiteti. Ai është i lidhur kryesisht me shqyrtimin e praktikave kontabël, financiare dhe të aktivitetit me synimin e dhënies së një garancie të arsyeshme mbi arritjen e objektivave institucional. Auditimi i brendshëm është një lloj kontrolli i cili funksionon me matjen dhe vlerësimin e efektivitetit të llojeve të tjera të kontrolleve. Auditimi i brendshëm merret kryesisht me aspektet kontabël dhe ato financiare por ai gjithashtu duhet të merren edhe me çështje të një natyre operative të lidhura me efektivitetin dhe eficientën e operacioneve apo pajtueshmërinë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi të aktiviteteve të drejtimit. Disa nga objektivat e auditimit të brendshëm mund të përmblihen

- Për të verifikuar saktësinë, kujdesin dhe autenticitetin e të dhënave të kontabilitetit financiar dhe atyre statistikore të prezantuara drejtimit të entitetit
- Për të konfirmuar se detyrimet e lindura në entitet gjatë aktivitetit të tij janë të vlefshme dhe legjitime.
- Për të komentuar mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe kontrolluar sistemin e kontrollit në fuqi duke ofruar sugjerime mbi mënyra dhe mjete që përmirësojnë këto sisteme.
- Për të mundësuar zbulimin e hershëm dhe parandalimin e mashtrimeve.
- Për të identifikuar autoritetet përgjegjëse për blerjen e aseteve dhe sende të tjera si dhe nxjerrjen jashtë përdorimit të tyre
- Për të siguruar që praktikat standarde të kontabilitetit janë ndjekur në mënyrë rigoroze
- Për të ndihmuar drejtimin në administrimin efikas të operacioneve me vendosjen e procedurave në përputhje me politikat e aktivitetit.

Auditimit të jashtëm bazuar në Ligjin Organik të tij nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, në nenin 7, germa “e”, i kërkohet të realizojë, “Mbikëqyrjen e veprimtarisë së institucioneve të kontroll revizionit të brendshëm shtetëror”. Pra në misionin e tij *Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit* ka detyrë ligjore mbikëqyrjen (vlerësimin) e sistemeve të auditimit të brendshëm në vendin tonë. Duke e konsideruar fuqizimin dhe modernizimin e sistemeve të auditimit të brendshëm të një rëndësie primare në mbështetjen e drejtimit për arritjen e objektivave për një qeverisje sa më efektive dhe eficiente, gjatë vitit 2012 kemi realizuar auditimin e veprimtarisë së kryer nga 24 struktura të Auditimit të Brendshëm në nivel qendror krahasuar me 19 struktura të audituara një vit më parë.

- Mbi organizimin dhe funksionimin e auditimit të brendshëm në sektorin publik

Drejtimi dhe menaxhimi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm në sektorin publik bazuar në nenin 16 të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.9.2010 realizohet nëpërmjet Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm (NJQH/AB) të Ministrisë së Financave. *Për vitin 2012, NJQH/AB në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji për auditimin e brendshëm publik dhe nga rregullorja e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Ministrisë së Financave ka organizuar punën e saj për zhvillimin dhe koordinimin e veprimtarisë së auditimit të brendshëm publik në të gjitha nivelet e qeverisjes qendrore e vendore. Bazuar në raportet vjetore të Strukturave të Auditimit të Brendshëm (SAB) ka analizuar të dhënat e rezultateve të veprimtarisë së tyre, ka përcaktuar sfidat me të cilat përballlet sistemi dhe në përfundim ka hartuar Raportin e Veprimtarisë së Auditimit të Brendshëm Publik i cili është miratuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm me Vendimin nr. 6, datë 20.02.2013 dhe i është paraqitur Ministrit. Ky Raport i është dërguar Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave me shkresën e Ministrit të Financave nr. 4216, datë 15.03.2013.*

Gjatë auditimit u analizua raporti i veprimtarisë së njësive qendrore dhe materialet e dosjeve të vëna në dispozicion duke konkluduar se janë bërë përpjekje pozitive në drejtim të përmirësimit të kuadrit rregullator (VKM nr. 212 datë 30.03.2012 “Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik” dhe udhëzimeve e urdhrave të Ministrit të Financave që kanë orientuar SAB-et për kryerjen e auditimeve në përputhje me Manualin e Auditimit të Brendshëm dhe me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit, etj.)

Kemi konstatuar se një mbikëqyrje më e kujdesshme e veprimtarisë së SAB dhe një shqyrtim me sy kritik i raporteve vjetore të paraqitura prej tyre do të evidentonte thellësinë e dobësive të sistemit, përgjithësimi i të cilave dhe formulimi i rekomandimeve të përshtatshme referuara atyre do të ndikonin pozitivisht që drejtuesit e subjekteve publike përgjegjës për auditimin e brendshëm publik të merrnin masat e duhura për organizimin dhe funksionimin e gjithë sistemit.

II.1 Gjendja e strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik për periudhën që auditohet. Kapacitetet administrative dhe cilësia e angazhimeve në misionet e angazhimeve për dhënie sigurie dhe këshillimi.

Strukturat e auditimit të brendshëm në sektorin publik për vitin 2012 janë organizuar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010 dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore të nxjerra në zbatim të tij. Nga të dhënat që disponon NJQH/AB, për vitin 2012, konstatohet se kanë funksionuar 109 SAB-e nga 123 SAB-e të konstatuara për vitin 2011, pra kemi konstatuar 14 njësi audituese më pak se viti i kaluar. Numri i njësive të auditimit ka ardhur duke u ulur si rrjedhojë e ristrukturimit të brendshëm. Në zbatim të nenit 17, të ligjit 9720, datë 23.04.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010, Këshilli i Ministrave me propozim të Ministrit të Financave ka nxjerrë VKM nr. 212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kritereve për ngritjen e njësive të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Po kështu Këshilli i Ministrave me vendimin nr. 474, datë 16.06.2011, ka përcaktuar standardet dhe procedurat për hartimin dhe miratimin e strukturave organizative të institucioneve të administratës publike.

Pakësimet e SAB-eve evidentohen në institucionet e vartësisë dhe në njësitë e pushtetit vendor, respektivisht nga 6 dhe 8 njësi auditimi. Pavarësisht nga pakësimi i SAB-eve në vitin 2012 krahasuar me një vit më parë, bazuar në kërkesat e VKM nr. 212, datë 30.03.2012 dhe në VKM

nr.474, datë 16.06.2011, është konstatuar se disa nga strukturat e njësive të AB-ve, nuk janë riorganizuar dhe plotësuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në këto dispozita ligjore. Nga të dhënat që kanë paraqitur njësitë e auditimit të brendshëm në shkallë sistemi në NJQH/AB rezulton se:

Në disa njësi të qeverisjes së përgjithshme, që nuk kanë njësi vartëse funksioni i auditimit të brendshëm (AB) kryhet nga një auditues i vetëm, fakt që bie në kundërshtim me pikën 2 të VKM nr. 212, datë 30.03.2012, ku përcaktohet se: “Njësia e auditimit të brendshëm detyrimisht duhet të përbëhet nga minimumi 3 auditues, përfshirë drejtuesin e njësisë”. Po kështu, pavarësisht se këto struktura kanë në përbërje të tyre 1 punonjës, 11 prej tyre janë organizuar si “zyra”, 5 prej tyre janë organizuar si “sektor” dhe 1 njësi është organizuar si “drejtori”. Kjo mënyrë organizimi dhe funksionimi i SAB jo vetëm bie në kundërshtim edhe me kërkesat e VKM nr. 474, datë 16.06.2011 “Për përcaktimin e standardeve e të procedurës që duhet të ndiqet gjatë hartimit dhe miratimit të strukturave organizative të institucioneve të administratës publike”, ku përcaktohet se, një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën 3 punonjës dhe një drejtori mund të krijohet në se ka në përbërje të saj të paktën 5 punonjës. Emërtimi i punonjësve të vetëm si Drejtor, Përgjegjës sektori apo Përgjegjës zyre pa patur asnjë punonjës vartësie, ka krijuar efekte negative për buxhetin e shtetit e për rrjedhojë NJQH/AB duhej të kishte përgjithësuar këto raste dhe të kishte rekomanduar marrjen e masave të duhura. Të dhënat sipas njësive, numrit të audituesve dhe nivelit të strukturës së njësisë së auditimit paraqiten në tabelën e mëposhtme.

Nr	Njësia Audituese	Numri i Audituesve	Niveli i strukturës
1	Bashkia Bilisht	1	Drejtori
2	Bashkia Pogradec	1	Sektor
3	AMF	1	Sektor
4	Këshilli i Qarkut Peshkopi	1	Sektor
5	Bashkia Bulqizë	1	Sektor
6	Bashkia Krujë	1	Sektor
7	Bashkia Lezhë	1	Sektor
8	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	1	Zyrë
9	Komuna Kashar	1	Zyrë
10	Bashkia Gjirokastrë	1	Zyrë
11	Bashkia Burrel	1	Zyrë
12	Bashkia Sukth	1	Zyrë
13	Këshilli i Qarkut Lezhë	1	Zyrë
14	Bashkia Shëngjin	1	Zyrë
15	Bashkia Gramsh	1	Zyrë
16	Bashkia Ballsh	1	Zyrë
17	Bashkia Delvinë	1	Zyrë
18	Bashkia Orikum	1	Zyrë
19	Qendra Spitalore Shkodër	1	Specialist
20	Qendra Spitalore Vlorë	1	Specialist
21	U.K Korçë	1	Specialist
22	Universiteti politeknik Tiranë	1	Specialist
23	Ndërmarrja Nr. 1 Bashkia Tiranë	1	Specialist
24	Bashkia Tepelenë	1	Specialist
25	Bashkia Rrëshen	1	Specialist
26	Bashkia Koplík	1	Specialist

Burimi: Të dhënat janë marrë nga evidencat e NJQH/AB dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Analiza e plotësisë dhe përbërjes së strukturave audituese konstatoi se aktualisht janë të punësuar 391 auditues të brëndshëm. Theksuam më lartë se për vitin 2012 numri i njëjësive audituese krahasuar me vitin 2011 është pakësuar me 14 njësi (- 12%), ndërkohë që ishin planifikuar 406 auditues të brëndshëm ose 14 më tepër se numri faktik i tyre (392) në vitin 2011. Ndërkohë strukturat e njëjësive audituese rezultuan të kishin 391 auditues ose 15 më pak se plani dhe krahasuar me vitin e kaluar 1 punonjës më pak. Në numrin e përgjithshëm të audituesve të brëndshëm konstatohen ende punonjës që nuk janë kualifikuar dhe çertifikuar për këtë fushë, në sistem punojnë 71 auditues të paçertifikuar. Nga vlerësimi i të dhënave statistikore konstatohet se edhe për vitin 2011 nga 392 punonjës në sistemin e auditit të brëndshëm ishin 72 auditues të paçertifikuar.

Analiza e përbërjes profesionale të stafit auditues tregon se nga 391 punonjës auditues, 330 auditues ose 84 % janë specialistët të fushave ekonomike, 42 auditues janë të profesionit juristë ose 11 % e tyre dhe vetëm 19 auditues ose 5 %, u përkasin specialiteteve të tjera teknike. Nga shqyrtimi i të dhënave që kanë paraqitur njësitë e AB në NJQH/AB rezulton se, nga njësitë audituese janë rekrutuar edhe punonjës me profesione që nuk përshtaten me vendin e punës. Rekrutimi dhe **punësimi i 11 audituesve në profesione që nuk përshtaten me vendin e punës është në kundërshtim** me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007, ndryshuar me ligjin nr.10318, datë 16.09.2010, për të cilën ngarkohen me përgjegjësi titullarët e institucioneve të mësipërme **por NJQH/AB, nëpërmjet mbikëqyrjes dhe vlerësimit të fakteve të raportuara nga SAB, me përgjithësim dhe rekomandime efikase pranë strukturave vendimmarrëse bazuar në kërkesat e nenit 16 të ligjit të mësipërm, mund të kishte ndikuar në përmirësimin e gjendjes.**

Një nga kriteret e punësimit si auditues i brendshëm është dhe eksperiencia profesionale në auditim *ose në fusha , si financat, kontabilitet apo fusha të tjera të lidhura* . Sipas të dhënave të raportuara nga strukturat audituese, rezulton se nga 391 auditues të punësuar në SAB, 158 prej tyre ose 40 % kanë eksperiencë pune në auditim deri në 5 vjet dhe 233 prej tyre kanë eksperiencë pune mbi 5 vjet si auditues. Sipas të dhënave që kanë paraqitur njësitë e auditimit të qeverisjes së përgjithshme, konstatohet se, janë rekrutuar auditues pa eksperiencë pune në auditim. Përtej këtyre shifrave, konstatohet se, janë rekrutuar në SAB edhe drejtues pa eksperiencën e nevojshme në punë dhe të paçertifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik. Nga verifikimi i të dhënave të paraqitura nga njësitë audituese, për kohën e rekrutimit, u konstatua se NJQH/AB, nuk disponon të dhëna apo evidenca ku të evidentohet data e punësimit, si një tregues i veçantë që ka të bëjë me zbatimin e kriterëve të nenit 11, germa “ç” ku është përcaktuar: *“respektimi i kriterëve të marrjes në punë të audituesve, të hartuara në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Auditimit”, si dhe me ndryshimet e nenit 19, germa b dhe c të pikës 2 ku është përcaktuar se; audituesi të ketë jo më pak se 5 vjet përvojë pune në auditim ose në fusha , si financat, kontabilitet apo fusha të tjera të lidhura siç përcaktohet në shkronjën "a" të këtij paragrafi; c. kandidatët e përzgjedhur për pozicionin "Drejtor i njësisë së auditimit të brendshëm" duhet të jenë pajisur me dëshminë "Auditues i brendshëm në sektorin publik" dhe të kenë një përvojë pune 5-vjeçaresi auditues.*

Në kundërshtim me kreun e I-rë dhe pikën 49, të VKM nr. 474, datë 16.06.2011, nuk është bërë përshtatja e strukturave organizative të këtyre njëjësive sipas standardeve të përcaktuara, pavarësisht se ka kaluar afati 6 muaj nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, pasi aktualisht në disa njësi të qeverisjes së përgjithshme janë ngritur sektorë të AB me më pak se 3 punonjës, në kundërshtim me pikën 20, të vendimit të mësipërm ku është përcaktuar se: *“Një sektor mund të krijohet si njësi organizative e veçantë kur në të janë të paktën një pozicion shef sektori dhe dy vartës. Një sektor mund të krijohet edhe pa pozicionin e shefit, nëse është në kuadër të një drejtorie dhe ka të paktën dy nëpunës*

Nga auditimi i kryer për respektimin e VKM nr. 212, datë 30.03.2012, u konstatua se në disa njësi të qeverisjes së përgjithshme funksioni i AB kryhet nga një auditues i vetëm, në kundërshtim me pikën 1/b të VKM nr. 212, datë 30.03.2012, ndërkohë që këto njësi auditohen nga organi epror i tyre.

Nr	Njësia Audituese	Numri i Audituesve sipas organikës	Njësia qendrore që e auditon
1	ATK	1	Ministria e Financave
2	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	1	METE
3	Qendra Spitalore Vlorë	1	Ministria e Shëndetësisë
4	AZHBR	2	MBUMK
5	Drejtoria e Përgjithshme e Hekurudhave	3	Ministria e Transporteve
6	ANTA	4	METE
7	Porti Detar Shëngjin	1	Ministria e P.P.Transporteve
8	Porti Detar Vlorë	1	Ministria e P.P.Transporteve
9	Autoriteti Aviacionit Civil	1	Ministria e P.P.Transporteve
10	Ujësjetës Kanalizime Korçë	1	Ministria e P.P.Transporteve
11	AMF	1	Ministria e Financave
13	Autoriteti Portual Durrës	3	Ministria e P.P.Transporteve
Totali		20	

Burimi: Të dhënat janë marrë nga evidencat e NJQH/AB dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Bazuar në sa më sipër **kemi rekomanduar që:**

- Për të pakësuar dhe kufizuar sa të jetë e mundur njësitë audituese me 1 auditues është e nevojshme përmirësimi i strukturës audituese të organeve eprore dhe pakësimin e audituesve në njësitë që kanë aktivitet të pakët.

Nga auditimi i raporteve periodike dhe atyre vjetore të paraqitura nga njësitë audituese të pushtetit vendor në NJQH/AB, rezulton të jenë audituar vetëm pagat, në disa raste edhe shpenzimet operative dhe asnjëherë nuk janë audituar fondet publike për investime, ndërtime, apo blerje mallra, fakte këto që tregojnë se disa prej njësive audituese kanë lënë vetëm rekomandime të padobishme dhe formale duke mos dhënë asnjë produkt, madje nuk justifikojnë as pagën e tyre. Në këto kushte **kemi rekomanduar**

- Marrjen e masave për ristrukturimin e njësive audituese duke patur për objektiv kryerjen e auditimit nga institucioni apo njësia qendrore, nëpërmjet të cilit jo vetë do të kursehen fondet buxhetore por edhe auditimi do të jetë më efektiv, në drejtim të përmirësimit të gjendjes.

Nga të dhënat e audituara është konstatuar një proporcion i zhdrejtë midis pakësimit të numrit të njësive audituese dhe numrit të audituesve të paçertifikuar, ndërkohë që të dhënat statistikore që disponon NJQH/AB tregojnë se gjatë vitit 2012 ka vazhduar certifikimi i 296 punonjësve të administratës publike. Konstatohet se prej fillimit të procesit të certifikimit deri në datën 31.12.2012 janë kualifikuar dhe kanë marrë certifikatën e audituesit gjithsej 1,505 punonjës, nga këta punësuar sipas organikave respektive në të gjitha njësitë e auditimit gjithsej 320 punonjës. Nga të dhënat tregojnë se nga NJQH/AB janë çertifikuar 3,7 herë më tepër, ndërkohë që gjatë vitit 2012 njësitë e auditimit të brendshëm kanë patur në strukturat e tyre 71 auditues të paçertifikuar. Gjatë vitit 2013, NJQH/AB ka çertifikuar edhe 296 auditues të tjerë të brendshëm publik, ku përfshihen edhe 71 audituesit e paçertifikuar rezultuar në fund të vitit 2012. Pra, verifikohet një gjendje potenciale me rreth 1,100 auditues për t'u punësuar. **Në këto kushte rekrutimi i punonjësve të paçertifikuar, nga titullarët e institucioneve, është në kundërshtim**

me nenin 19 pika 2, germa “a” e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 , ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

II.2. Mbi hartimin dhe miratimin e planeve vjetore dhe strategjike nga ana e strukturave të auditimit të brendshëm. Vlerësimi i funksionimit të kontrollit të brendshëm të subjekteve nën auditim.

Plani strategjik 2012-2016 dhe plani vjetor i konsoliduar “Për veprimtarinë e auditimit të brendshëm publik”, përgatitet si një dokument përgjithësues mbi bazën e informacioneve të grumbulluara nga 95 njësi të Auditimit të Brendshëm në sektorin publik, kundrejt 133 njësive që funksiononin në fund të vitit 2011. Qëllimi i Planit Strategjik dhe planit vjetor 2012 është “Përcaktimi i drejtimeve kryesore mbi bazën e të cilave do të zhvillohet veprimtaria e strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik”. Plani strategjik thuhet është hartuar mbi bazën e risqeve. Vlerësimi i riskut për çdo subjekt që auditohet lidhet me natyrën dhe kompleksitetin e aktivitetit të subjekteve. Mbi bazën e këtyre të dhënave NJQH/AB ka pasqyruar në mënyrë ekzakte pa u thelluar në analiza, sistemet kryesore të identifikuar për t’u audituar në planin strategjik e konkretisht

Nr	Lloji i sistemeve	Niveli i riskut
1	Sistemi i prokurimeve	I Lartë
2	Sistemi i investimeve publike dhe të ardhurave	I Lartë
3	Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore	I Lartë
4	Sistemet e Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit	I Lartë
5	Sistemi i pagave	Mesatar

Nga auditimi i mënyrës së përcaktimit të nivelit të risqeve, u konstatua se, në të gjitha informacionet e paraqitura për hartimin e programit strategjik dhe mënyrën e identifikimit të nivelit të risqeve nuk tregohen indikatorët e përdorur, si psh *shkalla e ndryshimeve të njësisë dhe e sistemeve të drejtimit (% e ndryshimeve të stafit drejtues dhe sidomos të punonjësve zbatues) si dhe niveli i materialitetit sipas transaksioneve (niveli i fondeve publike që përfiton çdo njësi publike sipas klasifikimit paga, mallra, shërbime etj).*

Duke i vlerësuar këto të dhëna dhe të dhëna të tjera, kemi konstatuar se, asnjë prej njësive auditese nuk ka marrë në konsideratë elementët që përcaktojnë nivelin e riskut. Gjithashtu edhe NJQH/AB nuk ka marrë masa që këto tregues të jenë bazë në përcaktimin e riskut, konform “Manualit të Auditimit” Kapitullit II “Programi i veprimtarisë së auditimit të brendshëm” pika 2.1 “Plani strategjik i auditimit”, ndër të cilat është e rëndësishme që të identifikohen burimet kryesore të të ardhurave dhe shpenzimet e organizatës

Programi strategjik 2012-2016 dhe Plani Vjetor 2012 i AB është miratuar nga Komiteti i Auditimit të Brendshëm me Vendimin nr.2, datë 28.12.2011 dhe nga Ministri i Financave është miratuar në datën 29.12.2011 me shkresën nr. 24306. Sipas Planit Strategjik 2012-2016 sistemi i auditimit në fund të vitit 2011 përbëhet nga 133 struktura të auditimit të brendshëm të ngritura në njësitë e qeverisjes në nivelin qendror dhe vendor, në të cilin janë angazhuar 406 auditues të brendshëm. Plani vjetor 2012 i konsoliduar “Për veprimtarinë e auditimit të brendshëm publik” është hartuar mbi bazën e informacionit që kanë dërguar, ose 75 % e njësive të auditimit të brendshëm. Mosparaqitja e të dhënave nga 34 subjekte ngarkon me përgjegjësi kryesisht SAB

por nuk mund të mos tërhiqet vëmendje NJQH/AB, e cila nuk ka marrë masa për realizuar plotësisht funksionet e saj për:

-Zhvillimin, administrimin dhe zbatimin e strategjisë harmonizuese në fushën e auditimit të brendshëm publik, si dhe monitoron këtë veprimtari në nivel kombëtar;

-Përcaktimin dhe zhvillimin e një sistemi bashkëkohor për raportimin e rezultateve për të gjithë veprimtarinë e auditimit të brendshëm në sektorin publik, në funksion të hartimit të raporteve periodike edhe atë vjetor.

Mosparaqitja e programeve strategjike nga 34 njësi audituese, ka sjellë si pasojë që; programi strategjik 2012-2016 dhe programi vjetor të mos hartohet i plotë duke mos pasqyruar saktësisht numrin e plotë të subjekteve që auditohen por edhe burimet njerëzore që nevojiten për mbulimin me auditim të të gjitha njësive që përdorin fonde publike dhe i nënshtrohen auditimit si dhe ka bërë që NJQH/AB të mos disponoi të dhëna të plota apo argumenta për të justifikuar parregullsitë në hartimin e programeve, në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, neni 18, paragrafi 2 ku janë përcaktuar detyrat e njësive të auditimit të brendshëm “për hartimin e planit vjetor dhe strategjik të veprimtarisë së auditimit të brendshëm dhe bashkëpunimin me NJQH/AB”.

Analiza e të dhënave për burimet e auditimit dhe kapacitetet audituese që kanë paraqitur njësitë e AB, tregojnë disproporcione midis planifikimit të auditimeve edhe kapaciteteve audituese kjo lidhur me përdorimin maksimal të kohës së planifikuar për punë dhe shfrytëzimin e aftësive profesionale të audituesve. Për vitin 2012, sipas programit strategjik 2012-2016 janë programuar për t’u audituar gjithsej **2,391 objekte**, ndërsa sipas programit për vitin ushtrimor 2012 janë planifikuar për t’u audituar nga njësitë e Auditimit të Brendshëm 2,313 subjekte, ose 96.5 %, e numrit të përcaktuar në programin strategjik 4 vjeçar. Sipas programit të vitit 2012 janë parashikuar të kryhen 1,381 auditime të sistemit dhe 932 auditime të fushave apo nën/sistemeve.

NJQH/AB, ka parashikuar dhe ka llogaritur një kohë mesatare auditimi prej 31 ditë punë efektive dhe kosto mesatare vjetore për 1 auditues, është llogaritur në shumën prej **1,309 mijë lekë**. *Nisur nga ky fakt mbajtja e këtyre strukturave rezulton të jetë me kosto tepër të lartë për buxhetin e shtetit.*

Sipas të dhënave të programit strategjik, krahas auditimit sipas frekuencës së programuar një herë në dy vjet, prioritet tjetër në auditim është edhe auditimi i subjekteve që kanë mbi dy vjet pa u audituar pasi rezultojnë 145 subjekte që kanë mbi 2 vjet pa u audituar. Gjithashtu nga shqyrtimi i planit strategjik dhe atij të vitit 2012, që SAB-të kanë paraqitur në NJQH/AB, konstatohet se, ka mbivendosje në planifikimin e auditimeve midis njësive qendrore dhe atyre të vartësisë, pa marrë në konsideratë auditimet që kryhen nga KLSH.

II.3 Evidentimi i rezultateve të auditimeve, plotësimi në afat dhe me saktësi i evidencave periodike.

Dokumentimi i rezultateve të auditimit nga Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të brendshëm, në zbatim të manualit të auditimit është bërë mbi bazën e të dhënave statistikore të dërguara nga çdo njësi audituese. Kështu për vitin 2012, janë hartuar raporte të plota dhe me të dhëna statistikore si për realizimin e programit në sasi, sipas llojit të auditimeve ashtu edhe me gjetjet respektivisht për çdo njësi audituese, si dhe rekomandimet për përmirësimin e gjendjes, duke veçuar gjetjet sipas prioriteteve me impakte të lartë të mesëm dhe të ulët.

Sipas të dhënave rezultojnë se, për vitin 2012 njësitë e auditimit të brendshëm në auditimet e kryera kanë dhënë gjithsej 7,650 rekomandime ose 2,126 rekomandime më tepër se viti i mëparshëm. Sipas të dhënave që disponon NJQH/AB për vitin 2012 nga 7,650 rekomandime të dhëna janë zbatuar gjithsej **43,2 %**, e tyre. Duhet theksuar se, për vitin 2011 nga 5,524 rekomandime të dhëna janë zbatuar 3,494 ose në masën **63,2 %**. Pra niveli i zbatimit të rekomandimeve për vitin 2012 krahasuar me vitin 2011 **paraqitet 20 % më i ulët**. Në mënyrë më hollësisht paraqiten të dhënat në tabelën e mëposhtme

Nr	INSTITUCIONI	Totali Rekomandimeve	Rekomandim e të zbatuara	në %	Numri i audituesve	Numri i auditimeve të kryera në fakt	Ngarkesa për 1 auditues
1	Ministria e Financave	345	236	68	9	55	6,1
2	Ministria e Ekonomisë	332	39	12	10	42	4,2
3	Ministria e Bujqësisë	221	92	42	5	36	7,2
4	Ministria e Transporteve	223	78	35	6	34	5,7
5	Ministria e Punës	158	8	5	5	46	9,2
6	Ministria e Shëndetësisë	89	44	49	10	48	4,8
7	Ministria e Drejtësisë	77	77	100	5	22	4,4
8	Ministria e Mbrojtjes	29	23	79	13	19	1,5
9	Ministria e Brendshme	714	98	14	13	67	5,2
10	Ministria e P. Jashtme	54	50	93	5	9	1,8
11	Ministria e Arsimit	45	29	64	5	52	10,4
12	MTKRS	8	0	0	4	46	11,5
13	Ministria Mjedisit	8	4	50	5	16	3,2
14	D.P.Doganave	69	0	0	8	12	1,5
15	D.P.Tatimeve	67	15	22	6	38	6,3
16	KESH	51	13	25	6	12	2
17	D.P.Policisë	354	72	20	5	22	4,4
18	Prefektura Fier	339	0	0	4	22	5,5
19	Prefektura Tiranë	116	0	0	4	18	4,5
20	N/Prefektura Sarandë	263	30	11	2	11	5,5
21	Bashkia Tiranë	428	110	26	10	32	3,2
	Shuma	3,990	1,018	25,5	140	659	4,7
87	Njësitë e tjera	3,660	2,293	62,6	251	1,687	6,7
108	Totali	7,650	3,311	43,2	391	2,346	6

Burimi: Të dhënat janë marrë nga evidencat e NJQH/AB dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga të dhënat e kësaj table rezultojnë se, në 21 subjekte të cilësuar më sipër janë angazhuar 140 auditues të cilët kanë kryer 659 auditime, ose mesatarisht 9,4 auditime për 1 auditues. Në auditimet e kryera, kanë lënë gjithsej 3,990 rekomandime, nga të cilat janë zbatuar 1,018 prej tyre ose 25,5% e totalit, çka tregon për një nivel tepër të ulët të zbatimit të rekomandimeve. Në njësi të veçanta kjo dukuri është tepër shqetësuese, pasi në 20% të SAB-ve që zënë 31% të numrit të auditimeve janë angazhuar 36% e audituesve, të cilët kanë realizuar 28% të auditimeve, kanë lënë 52% të rekomandimeve të raportuara, nga të cilat janë zbatuar **vetëm 25,5 % e tyre**.

Si konkluzion, ndryshimi i zbatimit të rekomandimeve midis dy viteve, dhe niveli tepër i ulët i zbatimit të tyre për vitin 2012, ngarkesa tepër e ulët e angazhimit të 1 audituesi në kryerjen e misionëve të auditimit dhe raporti i zhdrejtë midis numrit të audituesve, auditimeve të kryera dhe rekomandimeve të lëna në raport me realizimin e tyre duhej të merrej në analizë nga NJQH/AB për të konkluduar nëse kjo zbatueshmëri e ulët ka të bëjë me nivel të dobët të strukturave audituese në përcaktimin e gjetjeve edhe në formulimin e rekomandimeve, apo në mos

vlerësimin e duhur nga niveli i drejtimit të njësive të qeverisjes. Gjithsesi u konstatua që ky nivel i ulët i zbatimit të tyre **nuk është artikuluar dhe komunikuar përpara Komitetit të Auditimit të Brendshëm, Ministrisë të Financave dhe Këshillit të Ministrave**, konform nenit 13, të ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik

Nga auditimet e kryera nga KLSH dhe nga të dhënat që disponohen rezulton se rekomandimet e dhëna nga SAB nuk zbatohen. Në njësi të veçanta gjendja paraqitet tepër alarmante, pasi;

- Në **MTKRS** nga 46 auditime të kryera janë lënë 8 rekomandime, nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre.

-Në **D.P.Doganave**, nga 12 auditime të kryera janë lënë 69 rekomandime, nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre;

-Në **Prefekturën Fier**, nga 22 auditime të kryera janë lënë 339 rekomandime nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre;

-Në **Prefekturën Tiranë**, nga 18 auditime të kryera, janë lënë 116 rekomandime nga të cilat nuk është zbatuar asnjë prej tyre;

-Në **METE**, nga 22 auditime të kryera janë lënë 332 rekomandime nga të cilat janë zbatuar 39 prej tyre, ose 12 %.

-Në **MPÇSSHB**, nga 46 auditime të kryera, janë lënë 158 rekomandime nga të cilat janë zbatuar 8 prej tyre, ose 5 %.

-Në **Ministrinë e Brendshme**, nga 67 auditime të kryera janë lënë 714 rekomandime nga të cilat janë zbatuar 98 prej tyre, ose 14 %.

-Në **N/Prefekturën Sarandë**, nga 11 auditime të kryera janë lënë 263 rekomandime nga të cilat janë zbatuar 30 prej tyre, ose 11 %, etj.

II.4. Mbi rregullshmërinë e përgatitjes së raporteve periodike dhe atij vjetor lidhur me veprimtarinë e strukturave të auditimit të brendshëm në sektorin publik.

NJQH/AB në zbatim të detyrimit ligjor ka përgatitur dhe paraqitur në Komitetin e Auditimit të Brendshëm Raportin e Konsoliduar “Për veprimtarinë e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik për vitin 2012” dhe pas miratimit të tij nga ky komitet, e ka paraqitur këtë Raport tek Ministri i Financave dhe në Këshillin e Ministrave. Në raport janë paraqitur të dhënat e mbledhura nga aktiviteti njësi të qeverisjes vendore lidhur me evidentimin e dobësive të sistemit të menaxhimit financiar në procesin e zbatimit të buxhetit, në implementimin e legjislacionit për prokurimin publik, në zbatimin e legjislacionit tatimor, etj në rreth 4,698 raste me impakt negativ financiar.

Gjatë auditimit u analizuan të dhënat e paraqitura në pasqyrën nr. 3 “Gjetjet të ndara sipas sistemeve nga NJAB-të për periudhën janar-dhjetor 2012” dhe pasi u krahasuan ato me raportet e paraqitura nga njësitë e auditimit të brendshëm, u konstatuan parregullsi si në drejtim të saktësisë së të dhënave ashtu edhe në klasifikimin e gjetjeve sipas sistemeve gjithashtu u vu re konfuzion në lidhje me përkufizimin “shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik” dhe “impakt negativ financiar”. Në mënyrë më të hollësishme evidenca e gjetjeve dhe zbulimeve me për vitin 2012 dhe e krahasuar me vitin 2011 paraqiten në tabelën e mëposhtme.

në 000/lekë

Viti	Nr i gjetjeve	Vlera totale	Në burime njerëzore	Në zbatimin e prog.buxh	Në sistemin e pagesave	Në prokurime	Në sistemin e kontabiliteti	Të tjera
2011	3,177	1,523,150	5,148	79,290	387,714	109,666	157,061	784,270
2012	4,698	3,199,964	97,588	90,672	284,706	53,778	1,183,452	1,489,767

Burimi: Të dhënat janë marrë nga evidencat e NJQH/AB dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga auditimi i kryer në të dhënat statistikore me emërtimin “Impakt negativ financiar”, konstatohet se, janë evidentuar gjetje në sistemin e procedurave organizative për “Menaxhimin e burimeve njerëzore” në 470 raste në vlerën prej 97,588 mijë lekë, në “Programimin e dhe zbatimin e buxhetit” 330 raste në vlerën 90,673 mijë lekë; në “Sistemin e pagesave” 900 raste në vlerën 284,707 mijë lekë, në “Sistemin e prokurimeve” 316 raste me vlerë 53,778 mijë lekë, në sistemin e “Kontrollit dhe raportimit financiar” 759 raste në vlerën 1,183,452 mijë lekë dhe në “Sisteme të tjera” 1,923 raste në vlerën prej 1,489,767 mijë lekë. Për asnjërën nga gjetjet e cilësuar më sipër nuk është përcaktuar se, për sa nga këto vlera është kërkuar zhdëmtimi i tyre nga përfituesit, apo nga shkaktarët me përgjegjësi direkte apo indirekte. Duke shqyrtuar disa prej gjetjeve të paraqitura nga SAB-të e veçanta konstatohet se, në gjetjet e emërtuara “impakt negativ”, peshën specifike më të madhe e kanë subjektet e pasqyruara në tabelën e mëposhtme.

në 000/lekë

Njësitë Audituese	Vlera totale	Në burime njerëzore	Në zbatimin e prog.buxh	Në sistemin e pagesave	Në prokurime	Në sistemin e kontabiliteti	Të tjera
Min. e Financave	191,640	64,239	539	112439	-	10,033	4,090
ISSH	307,112	-	-	-	-	16,239	264,382
D.P.Hekurudhave	966,946	6,894	12,000	3,843	-	-	944,209
Bashkia Korçë	1,114,114	759	-	15,110	-	1,090,859	7,416
Prefektura Elbasan	50,951	1,006	-	-	-	-	49,945
Albpetroli sha Fier	75,767	-	-	873	-	-	74,894
Bashkia Lushnjë	1,266	-	1,266	-	-	-	-
Etj.	-	-	-	-	-	-	-

Burimi: Të dhënat janë marrë nga evidencat e NJQH/AB dhe përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Mangësi që vinë si rrjedhojë e pasaktësive dhe pasqyrimin të padrejtë të gjetjeve me impakt negativ financiar konstatohen edhe në shumë SAB të tjera të cilat kanë raportuar veprimtarinë e tyre pranë NJQH/AB për vitin 2012. Gjithashtu duhet theksuar se NJQH/AB, nuk ka bërë ndonjë verifikim të të dhënave që paraqesin SAB-të, me qëllim që të standardizohen gjetjet me impakt negativ financiar sipas sistemeve. Për këto veprime mbajnë përgjegjësi SAB-të përkatëse për paraqitjen dhe raportimin jo të padrejtë të gjetjeve, të veprimeve kontabile të gabuara, etj, duke i klasifikuar si gjetje me impakt negativ financiar. Gjithashtu NJQH/AB, duhej të përcaktonte dhe të zhvillonte një sistem bashkëkohor për të gjithë raportimin e rezultateve të auditimit të brendshëm në sektorin publik në funksion të hartimit të raporteve periodike dhe vjetore, si dhe të bënte përgjithësime në shkallë vendi për standardizimin dhe raportimin e gjetjeve sipas natyrës me qëllim që SAB-të të pasqyrojnë realisht gjetjet me dëm ekonomik për buxhetin e shtetit dhe zhdëmtimin e tyre.

Nga auditimi për rregullshmërinë e përgatitjes së raporteve të auditimit dhe saktësisë së gjetjeve të evidentuara, konstatohen mjaft parregullsi e raportime të gabuara të cilat ulin besueshmërinë e tyre e konkretisht:

1. Në njësinë e Auditimit të Bashkisë Korçë, rezultoi se; në sistemin e pagesave është konstatuar një vlerë totale prej 15,110 mijë lekë, e cila përfaqëson detyrime debitore në shumën 1,998 mijë lekë, detyrime kreditore në shumën 1,869 mijë lekë, paga të papaguara në vlerën 831 mijë lekë, aktive të qëndrueshme të pa kontabilizuara në vlerën prej 8,708 mijë lekë, etj. Nga vlerësimi i këtyre të dhënave, konstatohet se, këto gjetje nuk sjellin impakt negativ financiar, por tregojnë gjendjen financiare të institucionit në një periudhë të caktuar ushtrimore dhe nuk përbëjnë impakt negativ financiar. Gjetjet në sistemin e kontabilitetit dhe raportimit financiar janë pasqyruar në vlerën prej 1,090,859 mijë lekë, e cila është paraqitur me emërtimin “Llogaria 231

*me gjendje të viteve të kaluara, pa sistemuar investime të përfunduara të marra në dorëzim” në vlerën prej 1,053,212 mijë lekë, vlerë e cila nuk paraqet impakt negativ financiar, por parregullsi që lidhen me kontabilizimin dhe pasqyrimin e tyre në AQT. Po kështu në mënyrë të padrejtë konsiderohet impakt negativ dhe rrit vlerën e zbulimeve edhe gjetja prej 6,290 mijë lekë e cila përfaqëson tepriçë kreditore e llogarisë 116 “*gjendje nga vitet e kaluara, e cila padrejtësisht është mbyllur me llogarinë 101*”. Pra edhe në këtë rast kemi të bëjmë me një kontabilizim të gabuar, që në mënyrë të padrejtë klasifikohet si gjetje me impakt negativ për fondet publike. Veprimet e mësipërme të pasqyruara në mënyrë të padrejtë si gjetje me impakt negativ, kanë rritur artificialisht jo vetëm gjetjet me impakt negativ financiar të Bashkisë Korçë, por kanë rritur në mënyrë fiktive edhe evidencën përmbledhëse të zbulimeve në vlerën prej **1,105,857 mijë lekë**.*

2. Në Hekurudhën Shqiptare sh.a. rezultoi se, nga shuma totale e raportuar si gjetje me impakt negativ financiar në vlerën prej 966,946 mijë lekë, shuma prej **943,633 mijë lekë** ose 98 %, përfaqëson diferenca, mungesa, dëmtime e vjedhje të mbartura përpara viteve 2000 kur Hekurudha Shqiptare kaloi nga ndërmarrje shtetërore në SH.A, vlerë kjo e pasqyruar në bilancet e veprimtarisë vit pas viti, e për rrjedhojë nuk mund të raportohet si gjetje me impakt negativ financiar. Mungesa, dëmtime e vjedhje të pasurisë shtetërore të shkaktuara para viteve 2000 trashëgojnë shumë nga njësitë e qeverisjes së përgjithshme, të cilat kërkojnë marrjen e disa masave organizative dhe ligjore nga strukturat qendrore të shtetit për sistemimin e tyre në përputhje me dispozitat ligjore dhe rregullat për kontabilitetin dhe *nuk mund të raportohen si gjetje me impakt negativ financiar.*

3. Në Bashkinë Lushnjë, njësia e auditimit ka raportuar si gjetje me impakt negativ financiar vlerën prej 1,266 mijë lekë në auditimin e kryer në ndërmarrjen e Pasurisë Publike. Nga kjo shumë *nuk duhej raportuar si gjetje me impakt negativ financiar shuma prej 1,144 mijë lekë, pasi kjo vlerë përfaqëson gjetje nga auditimi i kryer nga KLSH-së dhe është rekomanduar për zhdëmtim me shkresën nr. 2280 datë 16.08.2011.*

Mangësi të kësaj natyre, që vinë si rrjedhojë e pasaktësive dhe pasqyrimin të padrejtë të gjetjeve me impakt negativ financiar, konstatohen edhe në shumë SAB të tjera.

4. Në Njësitë e Qeverisjes Vendore u konstatua se; në ASB të **Këshillit të Qarkut Kukës** në disa raste nuk ishin hartuar projektraporte dhe raporte auditimi dhe nuk ka shkresë për dërgimin e raportit Përfundimtar të Auditimit; në SAB të **Prefekturës Korçë** në materialet e auditimit nuk janë përcaktuar dispozitat që janë shkelur; në SAB e **Bashkisë Durrës**, nuk janë rekomanduar masa organizative për përmirësimin e gjendjes, por janë përcaktuar vetëm detyrimet ligjore si dhe në SAB të bashkisë Fier në auditimet e kryera nuk janë zhvilluar takimet përmbyllëse me subjektet dhe në Raportet Finale të Auditimit nuk pasqyrohen metodat, teknikat e auditimit, gjetjet, si dhe mungojnë rekomandimet; në Bashkisë **Bulqizë** për auditimet e kryera nuk hartohej shkresë për dërgimin e raportit Përfundimtar të Auditimit e për rrjedhojë subjektet e audituara nuk kanë kthyer përgjigje.

II. 5. Mbi vlerësimin e veprimtarisë së strukturave audituese në subjektet e audituara, në përputhje me standardet dhe kërkesat e manualit, me metodikat dhe udhëzimet e miratuara nga ministri i financave.

Në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” dhe të Rregullores së Brendshme, Njësia e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm, në zbatim të kompetencave që i jep ligji, ka programuar dhe ushtruar auditime për “Vlerësimin e veprimtarisë së njësisive të auditimit të brendshëm”, me qëllim “*Sigurimin e objektivave për funksionimin e veprimtarisë së njësisive të auditimit të brendshëm, në përmbushjen e standardeve të auditimit, konform rregullave dhe*

procedurave të Manualit të Auditimit të Brendshëm, si dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësimin e cilësisë e standardeve të përgjithshme të punës në të ardhmen”.

Për ushtrimin e kompetencave në zbatim të nenit 16, të ligjit, nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditimin e Brendshëm në Sektorin publik”, **Drejtoria e Metodologjisë, Monitorimit dhe Vlerësimit të Cilësisë**, për vitin 2012 ka hartuar programin për “Vlerësimin e veprimtarisë së njësive të auditimit të brendshëm” duke programuar mbikëqyrjen e kësaj veprimtarie në 30 njësi audituese. Nga të dhënat e paraqitura kjo Drejtori ka realizuar 28 misione auditimi, por nuk ka kryer auditimet e programuara në Ministrinë e Financave dhe në Ministrinë e Shëndetësisë. Nga shqyrtimi i disa programeve të auditimit dhe i konkluzioneve të paraqitura në Raportet Finale të auditimit u konstatuan mangësi, e konkretisht:

1. Në programet e punës të hartuara nga kjo drejtori dhe të miratuara nga Titullari i NJQH/AB nuk janë parashikuar për auditim kapacitetet audituese që nevojiten për çdo njësi në raport me numrin efektiv të ditëve të punës dhe me numrin e auditimeve të planifikuara, si një tregues i rëndësishëm për të përcaktuar, ngarkesën për një auditues, krahasuar kjo edhe me numrin e njësive vartëse për t’u audituar.

2. Programet e punës janë hartuar në mënyrë standarde për të gjitha auditimet që do të kryhen në njësitë e AB, ndonëse kanë veçori e natyrë të ndryshme kështu, përmendim programin e auditimit në OST dhe Programin e Auditimit në Bashkinë Ballsh, janë identikë ndonëse kanë natyra të ndryshme.

3. Në programet e punës nuk është parashikuar, mënyra e rekrutimit të punonjësve të auditimit konform kërkesave të ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, ndonëse në raportin e veprimtarisë së vitit 2011-2012 është konstatuar se në disa njësi audituese janë rekrutuar dhe ushtrojnë aktivitetin si auditues në kundërshtim me dispozitat ligjore 71 punonjës, pa përvojë në auditim dhe të paçertifikuar.

4. Nga auditimi i kryer, konstatohet se në raportet periodike dhe vjetore që Njësitë Audituese, kanë paraqitur në NJQH/AB ka pasaktësi, pasi të dhënat e paraqitura prej tyre për nivelin arsimor dhe profesional në raste të veçanta janë të pasakta.

5. Gjatë vlerësimit të veprimtarisë audituese në Ministrinë e Drejtësisë, u konstatua se auditimet e kësaj strukture në 17 raste janë kryer të mbivendosura, pasi disa subjekte janë audituar më parë nga auditimet e brendshme të tyre, e konkretisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, apo nga Zyrat Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe më pas janë kryer përsëri nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm të Ministrisë së Drejtësisë. Kjo mbivendosje ka sjellë përdorim jo efektiv të fondeve buxhetore dhe shpërdorim të kapaciteteve audituese në kundërshtim me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 69, datë 29.09.2010, ku është përcaktuar se *“njësitë audituese, nuk duhet të kryejnë misione auditimi në subjektet që kanë vetë njësi auditimi vetëm në raste të veçanta që e gjykon titullari i institucionit”.*

6. Nga auditimi i kryer për ushtrimin e kompetencave të NJQH/AB për vlerësimin e veprimtarisë së njësive audituese në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, u konstatua se, në programet e punës nuk janë parashikuar si pikë e veçantë auditimi **a)** gjetjet e konstatuara me impakt negativ financiar dhe klasifikimi i tyre duke i ndarë në dy kategori në gjetje që përbëjnë shkelje të disiplinës financiare me dëm ekonomik dhe rekomandimi i tyre për zhdëmtim nga personat përgjegjës dhe gjetje apo impakt negativ financiar si dhe **b)** cilësia e formulimit të rekomandimeve për përmirësimin e gjendjes.

Parashikimi në programet e angazhimeve të drejtimeve të mësipërme, ka të bëjë jo vetëm me cilësinë e gjetjeve dhe klasifikimin e tyre, por edhe me rritjen e cilësisë së formulimit të rekomandimeve pasi nga auditimi u konstatua se një pjesë e rekomandimeve kanë nivel të dobët dhe jo profesional formulimi.

II.6 Mbi veprimtarinë e Njësisë Qendrore të Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm, për zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm.

Në zbatim të ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010 dhe Rregullores së Brendshme, miratuar nga Ministri i Financave, Drejtoria e Zhvillimit Profesional dhe Analizës, misionin dhe veprimtarinë e saj e orienton për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm e cilësor në zhvillimin profesional të audituesve të brendshëm publikë, për të siguruar ngritjen dhe përsosjen e kapaciteteve në funksion të forcimit të rolit profesional të auditimit të brendshëm dhe nivelit të rezultateve të arritura në ushtrimin e këtij funksioni.

Gjatë vitit 2012, ka vijuar organizimi, administrimi dhe zhvillimi i trajnimeve për çertifikimin si “Auditues i Brendshëm në Sektorin Publik” një produkt i drejtpërdrejtë i bashkëpunimit midis DZHP&A dhe Komisionit të Kualifikimit që është dhe përgjegjësi kryesor i këtij procesi. Certifikimi ka qënë fakultativ sipas kërkesave individuale për trajnim. Vetëm gjatë vitit 2012, janë vlerësuar fitues të titullit auditues i brendshëm në sektorin publik 296 kandidatë, për të qënë pjesë e strukturave audituese dhe të menaxhimit financiar.

Zhvillimet e reja në fushën e auditimit të brendshëm, nxisin kërkesën për rritjen e cilësisë së punës audituese, vlerësimin dhe komunikimin transparent të rezultateve të kësaj veprimtarie dhe natyrisht kërkon trajnim të vijueshëm të audituesve të brendshëm publik për të përditësuar njohuritë në fushën e auditimit të brendshëm publik por gjatë vitit 2012 ky trajnim nuk u arrit të zhvillohej, për shkak se Ministria e Financave, e miratoi paketën rregullative për çertifikimin dhe trajnimin e vijueshëm të detyrueshëm në fund të muajit dhjetor me Urdhrin e Ministrit të Financave nr. 71, datë 26.12.2012 “Për miratimin e kuadrit rregullator të procesit të kualifikimit të Audituesve të Brendshëm në Sektorin Publik”.

III. Marredhënjet e bashkëpunimit ndërmjet KLSH-se me Ministrinë e Financave (NJQH/AB dhe DIFP)

Standardi Ndërkombëtar i Institucioneve Supreme të Auditimit, **ISSAI 9150 – “Bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet audituesve të SAI-ve dhe audituesve të brendshëm në sektorin publik”**, udhëzon se si të arrihet bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet SAI-ve dhe Audituesve të Brendshëm në sektorin publik, duke respektuar funksionet dalluese dhe kërkesat profesionale të të dy palëve. **Megjithëse, Audituesit e SAI-ve dhe Audituesit e Brendshëm kanë role të diferencuara dhe qartësisht të përcaktuara, qëllimi i përbashkët i tyre është për të nxitur qeverisjen e mirë, nëpërmjet kontributeve për transparencë në përgjegjshmërinë për përdorimin e burimeve publike, gjithashtu për të nxitur administrimin publik eficient, efektiv dhe me ekonomikitet. Nëpërmjet bashkërendimit dhe bashkëpunimit, SAI dhe Audituesi i Brendshëm, përmirësojnë eficiencën dhe efektivitetin e punës të të dy palëve.**

SAI-t kanë përgjegjësinë shtesë të vlerësimit të efektivitetit të funksionit të auditimit të brendshëm. Nëse funksioni i auditimit të brendshëm gjykohet se është efektiv, pikërisht nga bashkëpunimi ndërmjet SAI dhe Audituesit të Brendshëm do të përfitojnë të dyja palët (ISSAI 1/3 dhe 16).

Në sektorin publik, SAI-t dhe Audituesit e Brendshëm mund të bashkëpunojnë në mënyra të shumëllojshme. Një bashkëpunim i tillë mund të maksimizojë përfitimet e siguruar prej punës së përbashkët në fushat ku ka një mbulim pjesërisht të njëra tjetrës (përputhje pjesërisht) në objektin e punës që kryhet nga SAI-t dhe Audituesit e Brendshëm.

Përsa konstatohet auditimi i brendshëm dhe jashtëm kanë role të ndryshme, por kjo nuk pengon që KLSH dhe auditimi i brendshëm të bashkëpunojnë dhe të bashkërendojnë punët për të siguruar arritjen e objektivave të programuara nga secila palë në interes të miradminstrimit të fondeve publike dhe mbrojtjes së pronës publike dhe shtetërore. Pra, mbështetja realisht në punën e auditimit të brendshëm, për fusha apo subjekte të cilët janë audituar më parë prej auditimit të brendshëm, duke bërë të mundur që audituesit e KLSH të kenë më shumë kohë dhe kapacitete audituese në dispozicion, për t'i përdorur apo përqëndruar në fusha të cilat nuk janë mbuluar më parë nga auditimi i brendshëm, në mënyrë të veçantë për kryerjen e auditimeve të performancës. Vlen të cilësohet se, pavarësia dhe objektiviteti i audituesit të brendshëm janë faktorë të rëndësishëm për KLSH-në, pasi dihet se shërbimet e auditimit të brendshëm janë të varura nga drejtuesi i njësisë brenda të cilit ato janë krijuar. **Audituesit e KLSH, duhet të jenë të kujdesshëm dhe objektiv kur vlerësojmë dhe vendosim se cilësia e punës së auditimit të brendshëm në subjektin ku janë për auditim, duhet marrë në konsideratë.**

Bashkëpunimi dhe bashkërendimi zyrtar ndërmjet KLSH-së dhe MF është organizuar nëpërmjet marrëveshjes së bashkëpunimit, të lidhur në 8 maj 2012, nga Kryetari i KLSH Bujar Leskaj dhe Ministri Financave z. Ridvan Bode. Marrëveshja me nr. 191/5 Prot. të KLSH dhe nr. 7307 Prot. të Ministrisë së Financave, datë 08.05.2012.

Nëpërmjet kësaj marrëveshje synohet arritja e një bashkëpunimi të frutshëm ndërmjet KLSH dhe MF, respektivisht me strukturat e Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm dhe të Drejtorisë së Inspektimit Financiar Publik. Kjo marrëveshje është dëshmi e vendosjes në mënyrë institucionale, për herë të parë të marrëdhënieve të ndërsjellta të bashkëpunimit dhe bashkërendimit ndërmjet auditimit të jashtëm dhe auditimit të brendshëm. Në zbatim të nenit 5 të kësaj marrëveshjeje “Kordinimi ndërmjet palëve”, të Marrëveshjes së Bashkëpunimit të lidhur ndërmjet ka filluar nga funksionimi Sekretariati i përbërë një Drejtor i Përgjithshëm në KLSH dhe drejtuesit e NJQH/AB dhe DIFP, Sekretariat i cili ka si synim përcaktimin e drejtimeve të punës për intensifikimin e tyre në të ardhmen.

IV. MBI ZBATIMIN E REKOMANDIMEVE TË DËRGUARA NGA KLSH.

Nga auditimi i ushtruar në Ministrinë e Financave KLSH ka rezultuar me një sërë rekomandimesh për të cilat Ministria e Financave ka shpehur dakortesine dhe vullnetin pozitiv për zbatimin e tyre dhe konkretisht:

<i>Teksti i Rekomandimit</i>	<i>Veprimet e ndërmara nga strukturat respektive</i>
	Përgjigjet e Ministrisë së Financave derguar me shkresen nr. 5167/21 date 03.09.2013 <u>lidhur me masat e rekomanduara nga KLSH.</u>
<u>Rekomandimi nr. 1</u> Nga auditimi u konstatua se, Ministria e Financave për periudhën objekt auditimi, ka zbatuar rregullat e përcaktuara në ligjin nr. 10 296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” , por nga zbatimi në praktikë i këtij ligji konstatohet se ka mjaft probleme që lidhen me menaxhimin financiar	<u>Për rekomandimin nr. 1</u> Përgjigja e Ministrisë së Financave: I konsiderojme shume te rendesishme propozimet e KLSH per fuqizimin e Ligjit baze te financave publike dhe ndryshimet e propozuara nga KLSH ne Ligjin e Menaxhimit Financiar dhe udhezimet e dala ne zbatim te tij (perfshi udhezimin e menaxhimit te aktiveve). <i>Këto do te diskutohen me Komisionin</i>

<p>të fondeve publike dokumentimin e veprimeve ekonomike, me mbajtjen e kontabilitetit, me caktimin e nëpunësit zbatues të njësive publike, me përcaktimin e përgjegjësive materiale të punonjësve që shkaktojnë dëme ekonomike, me sanksionet që duhen aplikuar për parregullsitë financiare (e konstatuara,) etj. Bazuar në sa më sipër (e për rrjedhojë) rekomandojmë që:</p> <p><i>Ministria e Financave të ndërmarrë procedurat e duhura ligjore për përmirësimin e ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, në lidhje me aspektet e listuara më poshtë por jo vetëm (me qëllim që):</i></p> <p>1. Në <u>nenin 6</u>, pika 1, të shtohen; germat “f” dhe “g”, me këtë përmbajtje:</p> <p>f. Dokumentet standarde vertetues të veprimeve ekonomike, që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrativ.</p> <p>g. Standardizimin e programeve kompjuterike të çertifikuara që duhet të përdorin të gjitha njësitë e qeverisjes së përgjithshme për mbajtjen e kontabilitetit dhe plotësimin e pasqyrave financiare.</p> <p>2. Në <u>nenin 12</u>, pika 1, të hiqet emërtimi “me diplomë universitare në shkencat ekonomike ose juridike...” dhe të zëvendësohet me emërtimin “në shkencat ekonomike për kontabilitet dhe financë”.</p> <p>3. Pas <u>nenit 29</u>, të shtohet neni 29/1, ku të përcaktohet, përgjegjësia financiare e punonjësve të njësive publike për dëmet ekonomike të shkaktuara qëllimisht apo nga neglizhenca gjatë ose në lidhje me procesin e ekzekutimit të detyrave zyrtare.</p> <p>4. Pas pikës 1, të <u>nenit 29</u>, të shtohet pika 1/1, ku të përcaktohen sanksionet për çdo shkelje të përcaktuar në nenet 9, 10, 11 e 12 të këtij ligji, për nëpunësit autorizues dhe zbatues të njësive publike.</p>	<p><i>European dhe MoF Austriake dhe Franceze në kuadrin e implementimit të projektit IPA 2012, që do të nise në Janar 2014 dhe ku është parashikuar rishikimi i kuadrit ligjor ekzistues.</i></p>
<p><u>Rekomandimi nr. 2</u></p> <p>Nga verifikimi i zbatimit të rekomandimit të mëparshëm në lidhje me masat që duhet të merrte Ministria e Financave për nëpunësat Zbatues të NJQP të cilët duhet të përmbushin kriteret ligjore si dhe referuar faktit që rreth 20% e nëpunësve zbatues të Njësive të qeverisjes së përgjithshme rezultojnë në kundërshtim me kriteret e kuadrit rregullator dhe meqenëse Njësive publike ju la afati kohor</p>	<p><u>Pwr rekomandimi nr. 2</u></p> <p>Përgjigja e Ministrisë së Financave : Në lidhje me zbatimin e rekomandimit, do të merren masat me procedim me qëllim zbatimin e këtij rekomandimi.</p>

<p>3 muaj (nga data e marrjes se shkresës se MF) për rregullimin e situatës, por në asnjë rast nuk u krye bllokimi i veprimeve në thesar,</p> <p>rekomandojmë që:</p> <p>- Për të gjitha rastet e konstatimit në kundërshtim me kriteret e përcaktuara, të njoftohen titullarët e njësive shpenzuese që të marrin masa të menjëhershme për zbatimin e procedurave për emërimin e nëpunësve zbatues sipas kriterëve ligjore në rast të kundërt të fillojnë procedurat të bllokohen veprimet në thesar të këtyre punonjësve pasi ushtrojnë funksione në statusin e punonjësve të cilët nuk përmbushin kriteret ligjore.</p>	
<p><u>Rekomandimi nr. 3</u></p> <p>Duke e konsideruar si një mjet shumë të rëndësishëm në ndihmë të një qeverisje sa më të mirë, grupi i auditimit i kushtoi një vëmendje të madhe analizës së punës së strukturave të auditimit të brëndshëm dhe masave që duhet të ndërmerren për të rritur rolin e tyre në institucionet publike kryesisht mbështetjes që duhet ti japin drejtimit në realizimin e objektivave.</p> <p>Auditimi konstatoi se, pavarësisht kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 212, datë 30.03.2012 “Për ngritjen e njësive të auditimit të brëndshëm”, në këtë vendim, nuk janë përcaktuar kriteret e matshme për ngritjen e këtyre njësive në raport me rëndësinë dhe madhësinë sipas llojeve të institucionit, fondet buxhetore që menaxhojnë këto institucione etj.</p> <p>Për këtë rekomandojmë që:</p> <p>NJQH/AB të nisë procedurat ligjore për përmirësimin e VKM nr. 212, datë 30.03.2012 “Për miratimin e kriterëve për ngritjen e njësive të auditimit të brëndshëm në sektorin publik”, me qëllim përcaktimin e kriterëve të matshme për ngritjen e njësive të auditimit të brëndshëm dhe strukturën e tyre në njësitë e qeverisjes së përgjithshme. Këto kriteret duhet të vendosen duke mbajtur parasysh rëndësinë, madhësinë, strukturat vartëse, treguesit vjetorë buxhetorë, numrin e punonjësve të punësuar në këto njësi dhe tregues të tjerë, të cilët të vlerësuar në kompleks janë elementë që shërbejnë për të përcaktuar ngritjen e një strukture auditimi dhe nivelin e saj.</p>	<p><u>Pwr rekomandimi nr. 3</u></p> <p>Përgjigja e Ministrisë së Financave: NJQH/AB do kerkoje miratimin e urdherit dhe ngritjen e grupit te punes per te permiresuar VKM 212, date 30.03.2012, “Per miratimin e kriterëve per ngritjen e Njesive te AB ne sektorin publik”..... Permiresimi do te konsistoje ne vendosjen dhe percaktimin e kriteret te matshme per ngritjen e NjAB ne institucionet e qeverisjes qendrore dhe lokale te lidhura me treguesit buxhetore, menyren e organizimit operacional dhe funksional, vartesine, nr e punonjesve, etj... qe te marra sebashku na japin mundesine per te gjykuar/vleresuar ne kompleks mbi nevojen dhe mundesine e ngritjes se struktures audituese ne organizate. Afati i zbatimit: 3-m i 4-t i vitit 2013, dhe 2014 ne vazhdim.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 4</u></p> <p>Nga auditimi në drejtim të përbërjes</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 4</u></p> <p>Përgjigja e Ministrisë së Financave: NjQH/AB do</p>

profesionale të stafit auditues u konstatua se, nga 391 punonjës auditues që janë të punësuar në fund të vitit 2012, 330 prej tyre ose 84% janë specialistët të fushave ekonomike, 42 auditues janë të profesionit juristë ose 11% e tyre dhe vetëm 19 auditues ose 5%, u përkasin specialiteteve të tjera teknike. Nga shqyrtimi i të dhënave që kanë paraqitur njësitë e AB në NJQH/AB rezultoi se, nga njësitë audituese janë rekrutuar edhe punonjës me profesione që nuk përshtaten me vendin e punës, si ing.mekanik, zooteknikë, mësues edukimi fizik, gjuhë letërsi, punë sociale, ushtarakë, ing.gjeolog dhe agronomi, konkretisht: Në NJQH/AB në Ministrinë e Financave me profesion zooteknik dhe ing.mekanik, SAB në Ministrinë e Shëndetësisë auditues me arsim edukim fizik, në METE auditues me arsim gjuhë letërsi, ISSH auditues me profesion ushtarak etj. Këto emërime bien në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010.

Sipas të dhënave që kanë raportuar SAB në NJQH/AB, në fund të vitit 2012 në këto struktura ishin të punësuar si auditues të brendshëm 71 punonjës të paçertifikuar. Për shkak të problematikave të konstatuara në disa njësi të auditimit të brendshëm por dhe duke e konsideruar me rëndësi rekrutimin e audituesve të sektorit publik lidhur me plotësimin me sukses të misionit të tyre në përmirësimin e sistemeve të drejtimit dhe të kontrollit rekomandojmë që:

- NJQH/AB të ndërmarrë iniciativën e duhur ligjore për hartimin dhe miratimin nga Ministri i Financave të një udhëzimi, në të cilën të përcaktohen:

a. Kriteret e punësimit të audituesve të brendshëm në sektorin publik, duke specifikuar në mënyrë të veçantë rastet tepër të rralla, kur në këto struktura do të punësohen punonjës të profesioneve të tjera jashtë përcaktimit kryesor ekonomist dhe jurist.

b. Prioritetin që duhet të kenë personat e certifikuar si auditues të brendshëm publik nga NJQH/AB, për t'u punësuar si auditues i brendshëm.

c. Rastet kur nuk është e mundur rekrutimi i personave të certifikuar, të përcaktohet detyrimi i certifikimit të tyre jo më vonë se dy vjet nga data e punësimit në këto struktura.

d. Përgjegjësia që NJQH/AB ka në monitorimin e punësimit të audituesve në

kerkoje miratimin e urdherit dhe ngritjen e grupit të punës për hartimin udhëzimit lidhur me përcaktimin e kriterëve me të detajuara dhe me të hollësishtme lidhur me punësimin e AB me profesion të ndryshëm nga ekonomiste dhe juriste referuar nenit 19 të LAB. Keto përcaktime do të jene të lidhura dhe me perparësitë në punësim të personave të certifikuar si AB kur kjo është e mundur, dhe në të kundërt t'i jepet atyre një afat kohor jo më shumë se 2 vite për tu certifikuar. Po kështu ky udhëzim do të jete i lidhur dhe në unison dhe me strategjinë e trajnimit dhe të certifikimit të AB. Afati i zbatimit: 3-m i 4-t i vitit 2013, dhe 2014 në vazhdim.

<p>SAB, dhe detyrimin e raportimit periodik tek ministri për zbatimin e këtij udhëzimi si dhe krijimin i regjistrit kombëtar të audituesve të sektorit publik të punësuar.</p>	
<p><u>Rekomandimi nr. 5</u></p> <p>Nga auditimi i kryer në realizimin e programit të vitit 2012 nga njësitë e auditimit të brëndshëm, konstatohet se për kryerjen e një auditimi mesatarisht janë planifikuar 31 ditë pune efektive. Sipas të dhënave të paraqitura konstatohet se SAB të ndryshme për kryerjen e një auditimi kanë programuar afate kohore të ndryshme për 1 auditim, duke filluar nga 50 deri në 100 ditë efektive, madje në disa raste është arritur deri te kryerja e 1 auditimi në vit, veprime këto që tregojnë se nuk ka parashikime të sakta të ngarkesave mesatare për 1 auditues.</p> <p>- NJQH/AB të hartojë rregulla të qarta për të gjitha SAB-të që në programet strategjike afatmesme që hartohen prej tyre të ketë referenca të qarta lidhur me kohën mesatare për një auditim kjo edhe sipas objekteve që auditohen apo tregues të tjerë që synojnë shfrytëzimin maksimal të burimeve njerëzore duke ndikuar në këtë rast në uljen e kostove të auditimit dhe përdorimin efektiv të fondeve buxhetore.</p>	<p><u>Pwr rekomandimi nr. 5</u></p> <p>Përgjigja e Ministrisë së Financave: Mbi rekomandimin e lënë sqarojmë se: NjQH/AB e mbështetur dhe ne zbatim te udhezimit te MOF, nr.12, date 12.05.2012 “ Per procedurat e kryerjes se veprimtarise se auditimit te brendshem ne sektorin publik”, do te filloje menjehere punen per hartimin e udhezuesit me rregulla te qarta per llogaritjen e kohes se nje auditimi te lidhur me specifikat e subjekteve per t’u audituar si dhe me burimet efektive te auditmit. Ky udhezues do ti dergohet NjAB gjate fazes se hartimit te planeve te tyre vjetore dhe strategjike. Por njekohesisht do te sherbeje dhe si nje baze per hartimin e moduleve te trajnimeve te vijueshme te detyrueshme te AB. Afati i zbatimit: 3-m i 4-t i vitit 2013, dhe 2014 ne vazhdim.</p>
<p><u>Rekomandimi nr. 6</u></p> <p>Ka rezultuar se për vitin 2012, SAB-të kanë dhënë gjithsej 7650 rekomandime nga të cilat janë zbatuar vetëm 43,2%, e tyre, nga 63,2% që ka qënë niveli i zbatimit të tyre për vitin 2011. Ky fakt duhej të merrej në analizë nga NJHQ/AB për të konkluduar nëse kjo zbatueshmëri e ulët ka të bëjë me nivel të dobët të strukturave audituese në përcaktimin e gjetjeve edhe në formulimin e rekomandimeve, apo në mos vlerësimin e duhur nga niveli i drejtimit të njësive të qeverisjes. Gjithsesi u konstatua që ky nivel i ulët i zbatimit të tyre nuk është përgjithësuar dhe ngritur përpara Komitetit të Auditimit të Brendshëm, Ministrinë të Financave dhe Këshillit të Ministrave, konform nenit 13, të ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.</p> <p>Për këtë, rekomandojmë që:</p> <p>- NJQH/AB të marrë masa për të kryer analiza të hollësishme për gjetjet materiale të</p>	<p><u>Pwr rekomandimi nr. 6</u></p> <p>Rekomandim i pranuar. Përgjigja e Ministrisë së Financave: Ne lidhje me këtë rekomandim <u>sqarojmë se:</u> NjQH/AB e mbështetur dhe ne zbatim te udhezimit te MoF, nr.12, date 12.05.2012 “ Per procedurat e kryerjes se veprimtarise se auditimit te brendshem ne sektorin publik”, dhe te dhenave te siguruara nga raportet e paraqitura nga SAB prane NJQH /AB do te identifikohen problemet lidhur me rekomandimet e lena dhe te perealizuara dhe nje raport me problemet dhe njesite perkatese te AB do ti adresohet Drejtorise se Monitorimit dhe Vleresimit te Cilesise. Kjo Drejtori do te perfshije ne axhenden e saj keto informacione dhe nga analiza prane cdo SAB, do te percaktoje shkaqet e situates se krijuar lidhur me cilesine e dhenies dhe zbatimit te rekomandimeve. Bazuar ne problematikat e evidentuara te seciles SAB, do te hartohen modulet e trajnimeve te vijueshme te detyrueshme te AB. Afati i zbatimit/kryerjes: gjate vitit 2014 ne vazhdim.</p>

<p>konstatuara dhe formulimin e rekomandimeve sipas SAB, me qëllim që të japë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë së strukturave audituese në përputhje me standardet dhe kërkesat e manualit, me metodat dhe udhëzimet e miratuara nga Ministri i Financave, konform nenit 16 të ligjit “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.</p>	
<p><u>Rekomandimi nr. 7</u></p> <p>Nga auditimi u konstatua se, deri në datën 31.12.2012, NJQH/AB ka certifikuar si auditues të brendshëm në sektorin publik gjithsej 1505 punonjës të njësisive të qeverisjes së përgjithshme, ndërsa nevojat për 109 njësitë audituese në shkallë sistemi janë për 406 auditues, çka tregon se deri tani janë certifikuar 3,7 herë më tepër auditues se sa nevojat për to. Gjatë vitit 2013, NJQH/AB ka certifikuar edhe 296 auditues të tjerë, ku përfshihen edhe 71 audituesit e paçertifikuar. Këto të dhëna tregojnë se NJQH/AB i ka përqëndruar kapacitetet e saj kryesisht në certifikimin e audituesve të rinj dhe jo trajnimit të detyrueshëm të audituesve të brendshëm të punësuar në SAB, me qëllim rritjen dhe përmirësimin e njohurive bazë të stafeve ekzistuese të Auditimit të Brendshëm.</p> <p>Për këtë, rekomandojmë që, <i>Për një periudhë që do të gjykohet e përshatshme</i> nga NJQH/AB dhe Ministri i Financave, të minimizohet certifikimi i audituesve publik dhe të fokusohet puna në drejtimit të trajnimit të vijueshëm e të detyrueshëm të audituesve të brendshëm të angazhuar në procesin e auditimit në SAB.</p>	<p><u>Për rekomandimi nr. 7</u></p> <p>Përgjigja e Ministrisë së Financave: Ne lidhje me këtë rekomandim sqarojme se: NjQH/AB mbeshtetur dhe ne zbatim te LAB, te Urdhrit te MoF nr. 71 date 26.12.2012, Per miratimin e kuadrit rregullator te procesit te kualifikimit te audituesve te brendshem ne sektorin publik”dhe ne rekomandimet e KLSH, do te rishikojte raportet e numrit te kandidateve qe do te kerkohen per miratim nga Ministri i Financave per tu certifikuar, duke e ulur ate ne raport me vitet e kaluara, dhe duke shtuar numurin dhe punen e NJQHAB ne drejtim te trajnimit te vijueshem te detyrueshem, te audituesve qe jane certifikuar dhe qe ushtrojne profesionin e AB. Afati i zbatimit: gjate vitit 2014 ne vazhdim.</p>

PJESA E KATËRT: MBI AUDITIMET E PERFORMANCËS

“*Auditimi i Performancës është një shqyrtim i pavarur i eficiencës dhe efektivitetit të sipërmarrjeve qeveritare, programeve dhe organizmave të saj, me fokus të veçantë ekonomikitetin dhe me synim përmirësimin*”. Ky është përkufizimi i përgjithshëm që jep INTOSAI në standartet e veta 3000-3100, të cilat adresojnë pikërisht këtë lloj auditimi në nivel institucionesh supreme të auditimit. Auditimi i performancës mbështetet mbi vendimet e marra ose objektivat e përcaktuara nga legjislativi dhe mund të kryhet për të gjithë spektrin e sektorit publik. Ai dallon nga auditet standarte financiare dhe ato të ligjshmërisë, sepse është më fleksibël në përzgjedhjen e subjekteve, objekteve, metodave dhe dhënien e opinionëve. Nga vetë natyra e tij, ky lloj auditimi ndërthur metodat investigative me ato shkencore të kërkimit dhe përpunimit të informacionit, operon mbi baza të larmishme dijesh dhe eksperiencash, është më i hapur ndaj gjykimeve dhe interpretimeve dhe nuk kryhet sipas një protokollit standart paraprak. Është kusht vital për cilësinë e këtij lloji auditimi, që të aplikohen perspektiva të ndryshme e për rrjedhojë dhe audituesit duhet të vijnë nga sfera të ndryshme të aktivitetit njerëzor.

Auditimi i performancës është një nga mënyrat kryesore përmes të cilit taksapaguesit, financierët, vendim-marrësit, ekzekutuesit, media dhe shoqëria në përgjithësi “ushtrojnë kontroll” dhe penetrojnë në mënyrën se si kryhen punët dhe si arrihen rezultatet. Kriteret e këtij lloji auditimi janë të shumta dhe përmenden: vlera e shtuar, zinxhirët kompleksë të politikave, prania e risqeve, ndërhyrjet strukturore, obligimet ndërkombëtare, emergjenca sociale, materialiteti financiar, vizibiliteti i programit, mundësia për auditim, etj, etj.

Auditimi i performancës nuk ka si synim të kritikojë sipërmarrjet qeveritare. Duke evidentuar shkaqet, proceset, funksionet, kapitalin human dhe financiar të përfshirë në kryerjen e “biznesit” qeveritar, ky lloj auditimi synon korrigjimet e duhura, aplikimin e teknikave më të fundit shkencore, përmirësimin e 3 E-ve dhe tek e fundit rritjen e mirëqënies sociale përmes aktivitetit ekonomik publik. Auditimi i performancës është në vetvete formë modernizimi për atë që auditohet dhe atë që auditon.

Por cilat janë shtyllat kryesore mbi të cilat mbështetet auditimi i performancës? Të gjitha programet dhe sipërmarrjet qeveritare (dhe pjesa më e madhe e proceseve që ato gjenerojnë) mundin, të paktën teorikisht, të analizohen nën lupën e një formule që përshkruan se si ato lëvizin nga një pozicion në tjetrin, duke shfrytëzuar burime të ndryshme, me qëllim arritjen e objektivave të caktuara. Në auditimin e performancës, formula që studion mbarvajtjen e punëve mbështetet mbi dy pyetje-shtylla kryesore:

- A po bëhen gjërat siç duhet?
- A po bëhen gjërat që duhen?

Pyetja e parë fokuson kryesisht “prodhuesin” dhe adreson problemin nëse vendimet e marra po zbatohen siç duhet. Kjo pyetje zakonisht shoqërohet me një perspektivë normative, që do të thotë se audituesi kërkon të dijë nëse zbatuesi i procesit i është përmbajtur rregullave ose kërkesave. Me qëllim zgjerimit e analizës, pyetja mund të shtrihet edhe mbi faktin nëse aktivitetet e realizuara janë ato të duhurat – duke e marrë të mirëqenë që proceset e përzgjedhura janë të mira. Deri në këtë fazë të procesit, auditimi i performancës fokusohet kryesisht mbi ekonomikitetin dhe eficiencën e operacioneve (aspekti mikro).

Objekti i analizës zgjerohet së tepërmi me pyetjen e dytë – nëse po bëhen apo jo gjërat e duhura. Me fjalë të tjera, nëse janë aplikuar politikat e duhura siç duhet, apo janë përdorur burimet adekuate.

Kjo pyetje e dytë i referohet efektivitetit ose ndikimit në shoqëri. Në fakt, pyetja mund edhe të nënkuptojë se një sipërmarrje qeveritare – ose një masë e përzgjedhur për të arritur një objektiv specifik – po i ekspozohet riskut që të konstestohet nga audituesi. Një auditues performance, për shembull, mund të zbulojë një masë që është ineffektive dhe jo në përputhje me objektivat. Por, në momentin që audituesi fillon të dyshojë nëse vetë përkushtimi publik është ose jo i arritshëm,

ai/ajo duhet të tregojë kujdes për të mos tejkaluar kornizën e punës së vet duke shkelur kufirin dhe duke u futur në territor politik.

Prirjet aktuale ndërkombëtare në këtë fushë

Funksioni i auditimit të performancës nga institucionet supreme të auditit nisi të aplikohet në fundin e viteve '60 nga GAO amerikane. Ky lloj auditit në Amerikë është shtrirë që prej atëherë në nivelet shtetërore dhe lokale të vendim-marrjes financiare. Shumë vende të tjera kanë sot një ekspertizë të pasur në auditet e performancës. Mund të përmenden NAO britanike, Bunderechnungshof-i gjerman e ai austriak, Algemene Rekenkamer-i hollandez apo dhe Gjykata Sllovene e Auditimit. Në secilin e prej këtyre vendeve, auditimi i performancës së institucioneve publike siguron jo vetëm rritjen dhe përmirësimin ekonomik të vendit, por është një formë e shprehjes së zbatimit të ligjit, rritjes së transparencës, përfshirjes sociale në vendim-marrje, pra tek e fundit një formë e aplikimit të demokracisë.

Një qeverisje e mirë shprehet përmes një performace të mirë dhe vendet e zhvilluara perëndimore e kanë kthyer fokusin e tyre pikërisht tek auditet e performancës. Dekadat e fundit kanë qenë dëshmitare të ndryshimeve të thella ekonomike, sociale, politike, klimatike e demografike. Lëvizjet e popullsisë, ndryshimi i moshës mesatare të saj, rritja e kufizimeve në energji, burime ekonomike e monetare, kërkesat për rritje të vazhdueshme të mirëqënies, etj., të gjitha këto kanë rritur ndërgjegjësimin e publikut për aktivitetin ekonomik qeveritar. Të amplifikuara edhe nga kriza e viteve të fundit, performanca është bërë sot një çështje e të gjithëve, qofshin këta punonjës të sektorit privat apo atij publik. Pikërisht për këto arsye, në secilin prej vendeve të sipër-përmendura, këto lloj auditesh zënë rreth 30-40% të punës audituese. Me përdorimin e mjeteve moderne të komunikimit të informacionit, ndikimi që raportet e institucioneve supreme të auditit kanë mbi performancën ekonomike qeveritare është sot më i madh se ndonjëherë. Vetëm në Slloveni, Gjykata e Llogarive citohet nga mediat 8-10 herë në javë për gjetjet e saj, duke qenë kështu një nga institucionet avangardë në ruajtjen e fondeve dhe transparencës publike. Në Hollandë, raportet e auditëve të performancës citohen dhe futen në referencat e doktorantëve, planeve strategjike të zhvillimit të institucioneve, manualet e operacioneve, etj. Në Britani, auditet e performancës nuk kufizohen vetëm në çështjet apo institucionet britanike, por e kanë kthyer vëmendjen mbi probleme në rang planetar e global, siç janë problemet e klimës dhe ato të energjisë. Gjithçka ka vetëm një emërues të përbashkët: rritjen e ndërgjegjësimit të strukturave vendim-marrëse, me synim përmirësimin e bërjes së gjërave, në mënyrë shkencore dhe bashkëkohore.

Në një studim të kryer mbi auditet e performancës në 10 vende të rajonit, të cilat janë tashmë pjesë e Bashkimit Europian ose aspirojnë t'i bashkangjiten atij, rezulton ndër të tjera se:

1. Një pjesë e mirë e vendeve kryejnë audite të përbashkëta pajtueshmërie dhe performace;
2. Pothuajse të gjitha SAI-t e këtyre vendeve janë pjesëmarrëse në trajnime dhe shkëmbim eksperiencash në fushën e auditimit të performancës. Këto seminare interaktive janë vitale në përfitim të ekspertizës dhe setit të nevojshëm profesional nga praktikantët më të mira.
3. Koncepte fundamentale si “menaxhimi i performancës”, “përgjegjësia e performancës”, “standartet, indikatorët dhe parametrat e performancës” janë ende “fjalë të huaja” për shumicën e menaxherëve të sektorit publik;
4. Në mjaft prej këtyre vendeve, Parlamenti dhe/ose Qeveria nuk janë optimalisht të gatshme të trajtojnë siç duhet raportet e performancës (dhe jo vetëm) nga SAI-t përkatës dhe mund mos të jenë të detyruara ligjërisht të reagojnë për këto raporte;
5. Mungojnë sistemet efektive të menaxhimit të performancës dhe edhe kur janë prezente, mungojnë kapacitetet e përshtatshme menaxheriale, sistemet nuk janë të lidhura siç duhet me performancën aktuale dhe prania e konsulentëve dhe donatorëve të huaj vetëm sa krijon kunfuzion, sepse sugjerimet e tyre nuk janë të pajtueshme me kulturën menaxheriale;

6. Pothuajse në të gjitha SAI-t është sfidë e vërtetë të fusësh ndryshime dhe novacione, veçanërisht në një mjedis ku tradita është e rëndësishme. **Përshtatja është një proces që kërkon kohën e vet dhe nuk duhet të vijë si revolucion, por si evolucion.**

Auditimet e Performancës në KLSH

Të tilla audite kanë filluar të kryhen në këtë institucion që nga viti 2008. Duke përfshirë një problematikë të gjerë, këto audite kanë adresuar çështje si: integrimin në shoqëri të personave me aftësi të kufizuara, zbatimin e projektit për ruajtjen e liqenit të Ohrit, performancën e drejtorive të tatimeve dhe doganave, trajtimin e mbetjeve spitalore, marrëveshjen konçesionare të Aeroportit të Rinasit, Agjensinë Telegrafike Shqiptare, si edhe një sërë auditimesh performace të bashkive të ndryshme. Një pjesë e këtyre auditimeve është kryer me asistencë të huaj dhe kryesisht hollandeze, duke rezultuar kështu në një punë të mirë dhe me vlera për kërkime dhe thellime të mëtejshme në këto lloj auditesh.

Gjithsesi, konceptimi i auditimeve të performancës në kaluarën ka qenë ai i auditimit derivat, njohës dhe pjesor, si pjesë rutinore e procesit të punës dhe jo si risi, punë krijuese e mirëfilltë, bashkëkohore dhe integrale. Me ndërrimin e filozofisë drejtuese, auditimi i performancës po shndërrohet në një nga shtyllat e zhvillimit dhe modernizimit të KLSH-së. Në përgjigje të kësaj fryme të re, duke e trajtuar me prioritet të lartë auditimin e performancës së institucioneve publike në Shqipëri u krijua në 1 Tetor të 2012, departamenti i ri të auditimit të performancës. Aktualisht, pjesë e këtij departamenti janë 14 punonjës më formime të larmishme, eksperiencë të pasur dhe grada shkencore. Ky departament do të jetë “shtylla moderne” e Kontrollit të Lartë të Shtetit. Një strukturë që do i shtojë vlerë jo vetëm këtij institucioni, por gjithë administratës publike dhe taksapaguesve shqiptarë. Një pjesë e rëndësishme e planit strategjik të institucionit, është kontribut i këtij departamenti dhe për këtë departament.

Sinergjizimi i punës me departamentet e tjera, rritja e cilësisë dhe numrit të auditimeve të performancës me synim arritjen e parametrave të SAI-ve homologe lider në rajon e më gjerë, shtimi i kapaciteteve njerëzore dhe infrastrukturore për këtë lloj auditi, përgatitja e manualit të performancës për KLSH-në dhe asistimi në formulimin e parametrave të performancës për sektorë të administratës publike, urbanizimi i konceptit të auditimit të performancës në krejt administratën publike, por edhe më tej në mjedise akademike, media, organizma profesionale, OJF e OJQ, etj., shtimi i vlerës së fondeve publike dhe rritja e përgjegjshmërisë janë disa nga objektivat strategjike që departamenti të ri ka futur në axhendën e institucionit.

Ndër auditimet e realizuara nga ky departament përmenden:

6. Hekurudha Shqiptare

Hekurudha është duke u mbajtur në punë në kushte dhe rrethana shumë të vështira. Auditimi i kryer për gjendjen aktuale të hekurudhës reflekton situatën ekonomike dhe politike të saj. Shërbimi që i ofrohet shtetasve shqiptarë në sistemin hekurudhor në Shqipëri është i përballueshëm (tarifa të ulëta), por jo i sigurtë, jo-efiçient dhe aspak miqësor me mjedisin. Pritshmëria e përdoruesve të këtij lloj transporti është në kah të kundërt me shërbimin dhe politikat e zhvillimit të sistemit hekurudhor ofruar sot nga strukturat menaxhuese të tij. Ministria e Transporteve ka hartuar vazhdimisht politika dhe strategji për zhvillimin e sistemit hekurudhor, por që nuk kanë gjetur zbatim, pasi hartimi i tyre nuk ka qenë në raport të drejtë me fondet që janë vënë në dispozicion për t'i bërë ato të zbatueshme. Politikat e hartuara nga Ministria e Transporteve për të krijuar një hekurudhë bashkëkohore, fleksibël dhe konkurruese në treg, përgjithësisht kanë qenë të pamundura për t'u realizuar nga Hekurudha Shqiptare me fondet në dispozicion. Burimet e akorduara për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore janë të pamjaftueshme dhe çojnë në degradimin e mëtejshëm të rrjetit, mirëmbajtja e infrastrukturës hekurudhore kërkon më shumë fonde, asnjë masë nuk është ndërmarrë për rehabilitimin e rrjetit hekurudhor, sektori i transportit hekurudhor është i pazhvilluar dhe pa investime thelbësore për

mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës. Hekurudha nuk po operon si një korporatë e veçantë dhe të marrë vendimet e saj tregtare, për shkak të varësisë së saj dyfishe, ku politik-bërja dhe vendim-marrja për zhvillime strategjike i përket Ministrisë së Transporteve, ndërkohë që fondet e akorduara janë kompetencë e Ministrisë së Financave.

Këshilli Mbikëqyrës ka kryer një punë rutinë duke miratuar programe ekonomike apo bilance, të cilat në fakt nuk kanë reflektuar politika menaxhimi dhe zgjidhje të mundshme të cilat do të mund të përmirësonin treguesit ekonomikë. Këshilli Mbikëqyrës ka luajtur rolin e një organi administrativ joefektiv, pa zhvilluar apo pa i propozuar Ministrisë së Transporteve politika të reja menaxhimi për një zhvillim të ri për Hekurudhën dhe përmirësim të treguesve të saj ekonomikë.

DPHSH është pothuaj e pafuqishme për realizimin e objektivave të vendosura, pavarësisht përpjekjeve të saj për përjasjen e objektivave dhe realizimin e tyre. Në kushtet e pamjaftueshmërisë së fondeve për investim, si edhe të rënies së të ardhurave nga kontratat e transportit të mallrave ajo nuk ka mundur të realizojë objektivat për zhvillim afatmesëm apo afatgjatë. Largësia midis objektivave të parashikuara dhe mundësive reale për t'i realizuar është tejet e skajshme.

Faktorët që frenojnë zhvillimin, por dhe masat për përmirësimin e saj, janë bërë vazhdimisht prezente nga Administratori i Shoqërisë në raportet periodike të veprimtarisë ekonomike-financiare të saj, drejtuar Këshillit Mbikëqyrës dhe analizuar prej saj dhe Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës, si dhe në materiale të veçanta drejtuar zyrtarisht titullarëve të MPPT, METE dhe Ministrisë së Financave.

Pavarësisht analizimit të faktorëve që frenojnë zhvillimin, por dhe masat për përmirësimin e rrjetit të transportit hekurudhor, të parashikuar në VKM Nr.817, datë 23.11.2011 "Për miratimin në parim të planit kombëtar të transportit" (rishikimi i parë pesë-vjeçar), gjendja e tij është e pandryshueshme dhe vazhdon të përkeqësohet.

Numri i punonjësve dhe stafit në HSH, përkundrajt rrjeteve të ngjashme hekurudhore, rezulton në një nivel të lartë. Është i nevojshëm hartimi i një strategjie afatgjatë, e cila të përfshijë reduktimin e ndjeshëm në numrin e punonjësve dhe stafeve, për të ruajtur koston dhe përmirësuar produktivitetin. Reduktimi i punonjësve duhet të shkojë paralel me rritjen e investimeve në drejtim të mekanizimit dhe sinjalistikës hekurudhore.

Në formën e saj aktuale hekurudha nuk mund të ketë një të ardhme, ku të ardhurat e gjeneruara nuk mund të mbulojnë koston e nevojshme për ta vënë në funksionim atë.

Theksojmë se në gjendjen e saj aktuale, hekurudha shqiptare nuk mund të arrijë një pozicion të rëndësishëm në treg edhe në 7 vitet e ardhshme 2013-2020, pasi burimet e caktuara për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore janë të pamjaftueshme, me rrezikun e përkeqësimit të mëtejshëm të rrjetit.

Për sa më lart, KLSH ka rekomanduar:

- MPTT në mënyrë të menjëhershme të rishikojë planin e zbatimit të politikave dhe strategjive të hartuara për zbatim në sistemin Hekurudhor në përputhje me fondet e akorduara.
- MPTT në bashkëpunim me Hekurudhën Shqiptare të bëjnë rishikimin e burimeve të akorduara për mirëmbajtjen e infrastrukturës hekurudhore, pasi janë të pamjaftueshme dhe çojnë në degradimin e mëtejshëm të rrjetit.
- MPTT, Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtoria e përgjithshme e Hekurudhave, të rrisin frymën e bashkëpunimit midis tyre për të bërë të mundur realizimin edrejttimeve kryesore të strategjisë të zhvillimit të sistemit tonë hekurudhor, pjesë e objektivave të MPPT. Hendeku midis objektivave të parashikuara dhe mundësive reale për t'i realizuar, është tejet i skajshëm.
- MPTT t'i propozojë Këshillit të Ministrave marrjen e vendimit që Hekurudha Shqiptare të jetë një korporatë e veçantë, e cila të luajë një rol efikas për zgjidhjen e problemit të transportit në Shqipëri, duke rritur të ardhurat; ulur koston; siguruar sisteme që lejojnë një formë më të sigurtë

të funksionimit; të zhvillojë aftësitë komerciale dhe të marketingut që do ta mundësojnë hekurudhën të rivalizojë përkundrejt mënyrave më pak të qëndrueshme të transportit dhe më të ndjeshme ndaj kërkesave të tregut.

- MPTT të studiojë mundësinë e hartimit të një kontrate shumëvjeçare midis ministrive të transportit me shoqërinë e udhëtarëve/shoqërinë kryesore lidhur me subvencionin shtetëror për detyrimin e shërbimit publik që përcakton shërbimet e transportit të udhëtarëve që duhet të ofrohen, vëllimin (numrin e trenave, përbërjen e trenave) dhe cilësinë, duke evituar kompensimin e tepërt. Shërbimet fitimprurëse të mallrave nuk duhet të përfitojnë nga financat shtetërore
- MPTT të rishikojë dhe vlerësojë mundësinë e zbatimit të studimeve të fizibilitetit për zgjerimin në perspektivë të rrjetit për në Portin e Vlorës, Porto Romano dhe lidhjen me Aeroportin e Tiranës.
- Këshilli Mbikëqyrës të luajë rolin e një organi administrativ efektiv, duke propozuar në Ministrinë e Transporteve politika të reja menaxhimi për një zhvillim të ri për Hekurudhën dhe të orientojë organet drejtuese të HSH drejt zgjidhjeve të mundshme menaxheriale të cilat do të mund të përmirësojnë treguesit ekonomikë.
- DPH të bëjë ndarjen e qartë të llogarive për transportin e mallrave, transportin e udhëtarëve dhe infrastrukturën. Kjo ndarje do t'iu japë mundësi operatorëve ta llogarisin produktivitetin e personelit në bazë të formulave specifike për secilin aktivitet tregtar, pasi kjo ndarje e llogarive deri në këto momente ka qenë formale.
- DPH të hartojnë strategji afatgjatë, e cila të përfshijë reduktim të ndjeshëm në numrin e punonjësve dhe stafëve për të ruajtur koston dhe përmirësimin e produktivitetit, për arritjen e niveleve mesatare të BE-së të produktivitetit të personelit. Kjo politikë duhet bazuar në një parashikim të kujdesshëm të trafikut i cili do të kërkojë përditësim të rregullt. Reduktimi i punonjësve duhet të shkojë paralel me rritjen e investimeve në drejtim të mekanizimit dhe sinjalistikës hekurudhore dhe mbulimin e detyrimeve financiare që rrjedhin nga ndërprerjet e kontratave të punës me punonjësit që do të reduktohen.
- DPH duhet të kryejë rishikimin e nivelit të sigurisë në të gjitha operacionet e Hekurudhës Shqiptare e cila duhet të përfshijë mirëmbajtjen e stacioneve hekurudhore, operacionet me trenin, adoptimin e një sistemi të ri të sinjalizimit dhe kontrollit, duke i dhënë hekurudhës një performancë më të mirë për sigurinë, dhe funksionimin e një sistemi hekurudhor efikas të sigurtë, i cili ndihmon në reduktimin e ndotjes së ajrit.
- DPH duhet të hartojë dhe vendosë procedura të përshtatshme për të mirëmbajtur vagonët hekurudhorë, të paktën në një gjendje të pranueshme. Mungesa e një procedure të tillë kufizon kryerjen e procesit të mirëmbajtjes të vagonëve të udhëtarëve, duke çuar në standarte të papranueshme për sigurinë e udhëtarëve, dhe po kufizon më tej numrin e udhëtarëve.
- DPH të identifikojë faktorët që prekin produktivitetin e ulët, të vlerësojë arsyet dhe efektin e çdo faktori të identifikuar. Këtu duhet të përfshihet një analizë e strukturës së flotës e krahasuar me kërkesat e tregut dhe duhet përcaktuar numri i vagonëve të nevojshëm për nivelet e tanishme të trafikut.
- DPH duhet të hartojë politika të qarta marketingu në prezantimin e shërbimeve të rregullta të ndërmjetme Tiranë – Durrës dhe shërbimet në qytetet e tjera të rregullohen për të dhënë mundësi më të mira udhëtimi, duke pasqyruar nevojat e udhëtarëve.
- DPH duhet të rrisë fokusin dhe përgjegjësinë për të menaxhuar problemet e saj tregtare dhe ndryshimet organizative, si çështje urgjente që kërkojnë zgjidhje të menjëhershme, të cilat janë jetike për hekurudhën, nëpërmjet një ekipi eficient për të trajtuar mundësi të reja të biznesit të mallrave, rigjallërimin e ofertave për udhëtarët, dhe papërshtatshmërinë e orarit ekzistues.
- DPH duhet marrë vendim në lidhje me flotën e tepërt që prek kostot e shfrytëzimit në mënyrë negative. Flota e mbetur duhet të zbatojë metoda të reja të shpërndarjes, bazuar në nevojat e tregut, në mënyrë që të rritet rendimenti i shfrytëzimit.

- DPH duhet të hartojë menjëherë një regjistër themeltar të AAM-ve edhe pse këto inventarë janë analitikisht në njësitë e biznesit të saj. Parimet e llogaritjes nuk plotësojnë standardet kombëtare të kontabilitetit dhe të praktikës së mirë dhe për më tepër prodhojnë vlera keq-drejtuese të aseteve dhe borxhe afatgjata. Objekte, të cilat duhej të kishin dalë jashtë përdorimit, mbahen ende në sistem dhe kanë vlera jo reale.
- DPH të heqë ose të jepen për skrap aktivet jo ekonomike. HSH është ngarkuara nga barra e aktiveve jo ekonomike, të cilat kanë rezultuar tepër nga ndryshimi i kërkesës për transport hekurudhor. Inventari i mjeteve lëvizëse që shfrytëzohen është një përqindje e vogël e aktiveve gjithsej, çka përbën një barrë të konsiderueshme për nivelet e produktivitetit dhe ndotjen e ambientit
- DPH duhet të ndërtojë një data-bazë adekuate nëpërmjet të cilit të bëhet vlerësimi i nevojave për mallra, shërbime dhe punë, pasi vërehen edhe diferenca mes planifikimit dhe realizimit të kontratave; ekzistojnë dallime të konsiderueshme në çmimet e artikujve të njëjtë në vite të ndryshme me karakteristika teknike plotësisht të ngjashme ose të njëjta. Në procesin e vlerësimit të nevojave dhe në përcaktimin e specifikave teknike duhet të marrin pjesë specialistë të fushës.

7. ATSH

Veprimtarinë e saj ATSH e ushtron në bazë të Dekretit të Presidiumit të Kuvendit Popullor, nr. 1960, datë 09.11.1954 “Mbi Agjencinë Telegrafike Shqiptare”. Në kushtet e zhvillimeve të reja politike dhe ekonomike të vendit pas viteve 90-të në bazë të këtij ligji, ajo e mbështet veprimtarinë vetëm në një nen e konkretisht në nenin 8 të këtij Dekreti ku përcaktohet se “Agjencia Telegrafike Shqiptare varet nga Këshilli i Ministrave i cili cakton strukturën organizative”. Kjo bën që ky institucion të funksionojë deri tani pa ligj të rinovuar i cili të krijojë mundësinë e përcaktimit të rregullave të funksionimit dhe organizimit, lidhje organike me ligjet e tjera që rregullojnë veprimtarinë e saj, t’i japë pavarësinë si institucion, të përcaktojë rregullat e bashkëveprimit me institucione të tjera shtetërore e privatë, kjo në kushtet e ndryshimeve të mëdha politike dhe ekonomike të ndodhura tashmë prej rreth 20 vitesh. Gjithashtu edhe rregullorja e saj e hartuar dhe rinovuar në vite, nuk është e mbështetur ligjërisht dhe e pa miratuar nga Këshilli i Ministrave.

ATSH ka planifikuar dhe realizuar tregues ekonomikë (të ardhurat nga shitja e produkteve) në rënie nga njëri vit në tjetrin. Në “Programet buxhetore” për vitet objekt auditimi, të hartuara nga sektori i financës, nuk i është kushtuar vëmendje objektive të politikës së programit buxhetor, kjo referuar përkufizimeve sipas nenit 3 të ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për Menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë”.

ATSH nuk i ka përdorur me efektivitet burimet e saj, kjo duke parë tendencën në rritje të zërit paga kundrejt totalit të shpenzimeve në raport me tendencën në ulje të produktit të prodhuar nga i njëjti numër gazetarësh. Kështu duke krahasuar numrin e lajmeve të prodhuar në vitin 2008 deri në vitin 2011 rezulton se janë prodhuar rreth 21 % produkte në formë lajmesh më pak me të njëjtin numër gazetarësh dhe fond page në rritje. Ky subjekt nuk llogarit koston mesatare të prodhimit të lajmit dhe as atë të transmetimit të tij. Nuk ka bërë asnjë studim tregu me vlerë për nevojën publike për shërbimet e ATSH-së, vlerësimet dhe pritshmërinë e qytetarëve ndaj produkteve të saj. Të ardhurat në total dhe ato të krijuara nga kontratat me klientët e huaj kanë pësuar rënie nga viti në vit. Konkretisht në vitet 2008-2011 me të ardhurat e krijuara, ATSH ka mbuluar mesatarisht vetëm 7% të shpenzimeve të kryera.

ATSH nuk ka standarde në formën e rregulloreve ose manualeve për:

- përcaktimin nëse një informacion është i saktë, i paanshëm dhe i vërtetë;
- vlerësimin e punonjësve për punimet në formën e dossierëve, komenteve, reportazheve dhe titujve;
- përcaktimin e kritereve, mbi të cilat bëhet përzgjedhja e lajmeve të huaja dhe vendase, të cilat përkthehen në shqip dhe në gjuhë të huaj;

- të bërë të mundur verifikimin e dhënies së lajmeve nga shpejtësia, saktësia, sasia dhe cilësia në raport me mediat e tjera.

ATSH nuk ka bërë analiza nëse produkti i saj ka humbur treg gjatë viteve 2008-2011 nga konkurrenca, nuk ka bërë pyetësorë me konsumatorë të saj të ndërmjetëm (televizionet, gazetat, radiot, etj.) dhe fundorë (vizitorë të *website* të saj, qytetarë të thjeshtë të përzgjedhur rëndom, etj), për opinionin e tyre ndaj produktit të saj. Gjithashtu nga auditimi rezulton se ATSH nuk ka strategji të marketingut të produkteve dhe shërbimeve, si dhe nuk është hartuar asnjë plan strategjik afatmesëm dhe afatgjatëpër realizimin e qëllimeve të saj në të ardhmen.

- Për periudhën e audituar 2008-2011, në lidhje me Kontratat dhe Marrëveshjet me abonentët e huaj dhe vendas ATSH:

- Nuk ka bërë vlerësimin enevojave dhe argumentiminligjor të procedurave të lidhjes së tyre;
- Nuk ka negociuar para procesit të lidhjes së tyre me partnerët e huaj, për të arritur një çmim të arsyeshëm, bazuar në çmimet e tregut, vendas apo të huaj;
- Nuk ka raporte të ndjekjes apo monitorimit të kontratave dhe marrëveshjeve;
- Nuk ka të shprehur në mënyrë eksplicite ndjekjen dhe zbatimin e kontratave dhe marrëveshjeve të lidhura me partnerët e huaj;
- Nuk është nxjerrë asnjë urdhër administrativ për caktimin e personit që do të merret me ndjekjen e këtyre kontratave apo marrëveshjeve.
- Nuk është bërë punë e mirë në drejtim të lidhjes së kontratave me kompanitëcelulare, agjensi të medias së shkruar dhe për dhënien e lajmit televizioneve kombëtare dhe jo kombëtare që operojnë në vend.
- Disa nga shkaqet e mos rinovimit apo mos pranimit të lidhjes së kontratave janë :
- Shfaqja e një mungese interesi ndaj shërbimeve që ofron ATSH-ja;
- Vështirësi teknike në hapjen e faqesë internetit;
- Mundësi të tjera informacioni falas që ofrohen përmes internetit;
- Mundësi reale për përvetësim të shërbimeve, nëpërmjet rrjedhjes së fjalëkalimeve të klientëve të ATSH-së;
- Kërkohet gamë më e gjerë lajmesh të kategorive të ndryshme: ekonomi, sociale, kulturë, etj.

- Për sa më lart KLSH ka rekomanduar:

- Duhet miratuar një ligj i ri për veprimtarinë dhe strukturën e ATSH-së. Këto ndryshime ligjore duhet të adresojnë specifikisht;
- Reformimin strukturor imediat të institucionit, duke punuar vetëm me sektorin jashtë vendit dhe për lajmet jashtë vendit. Rrjedhimisht duke **përgjysmuar** strukturën, buxhetin dhe numrin e punonjësve të saj. Ky reformim duhet ndërmarrë sa më shpejt, në mënyrë që të përfshihet në buxhetin e ri, me fillimin e vitit 2013.
- Mundësinë e kalimit të ATSH-së si një drejtori e veçantë pranë Televizionit Shqiptar, përsëri duke theksuar përgjysmimin e strukturës dhe buxhetit të saj për të rritur eficiencën. Edhe kjo mundësi duhet konsideruar ligjërisht sa më shpejt, në mënyrë që të implementohet me fillimin e vitit 2013.
- Në zbatim të ligjit të ri, në një perspektivë afatmesme ose afatgjatë, të vlerësohet mundësia e privatizimit të ATSH-së, për të rritur pavarësinë, eficiencën, cilësinë dhe konkurrueshmërinë e institucionit. Shumica e agjensive simotra në botë zotërohen privatisht ose pjesërisht privatisht.
- Në zbatim të ligjit të ri, në një perspektivë afatmesme ose afatgjatë, të vlerësohet mundësia e kailimit në një kompani sh.a mediatike me financime të përbashkëta të buxhetit të shtetit dhe shoqërive private.
- Në zbatim të ligjit të ri, ATSH duhet të hartojë rregulloren e brendshme, si dhe të hartojë planin strategjik afatmesëm dhe afatgjatë për realizimin e qëllimeve të saj në rritjen e performancës.

- ATSH të marrë masa për fuqizimin e saj cilësor si e vetmja media shtetërore duke rritur performancën edhe në paraqitjen e saj vizive (internet, televizion, rrjetet sociale, etj). Konkretisht:
 - ATSH të ngrejë grup pune, për analizimin e nivelit shumë të ulët të realizimit të ardhurave, për hartimin e preventivave që lidhen me koston e prodhimit dhe të transmetimit të produktit të saj, për studimin e tregut për nevojën e shërbimeve të ofruara nga ATSH si dhe t'i kushtojë vëmendje menaxhimit financiar në lidhje me objektivat e politikës së programit buxhetor.
 - ATSH-ja duhet të marrë masa në drejtim të përmirësimit të performancës të produktit saj për të bërë të mundur që:
 - të sigurojë një përshkrim të besueshëm, gjithëpërfshirës dhe të saktë të ngjarjeve të ditës,
 - të jetë një forum për shkëmbim komentesh dhe kritikash të grupeve përbërëse dhe më ndikuesetë shoqërisë,
 - të prezantojë dhe qartësojë synimet dhe vlerat e shoqërisë,
 - të sigurojë qasje të plotë të ndodhive të ditës, me anë të së cilës i shërben publikut për të qenë i informuar,
 - të shërbejë si një “*watchdog*” i qeverisë.
 - ATSH të hartojë standarde në formën e rregulloreve ose manualeve, etj, që të përcaktojnë, mënyrën e vlerësimit të punonjësve për punimet e tyre, ngarkesa në punë, verifikimin e dhënies së lajmeve në raport me mediat e tjera, të testojë veten dhe cilësinë e shërbimeve të saj nëpërmjet pyetësorëve.
 - ATSH duhet të përmirësojë teknologjinë, me synimin kryesor rritjen e shpejtësisë në hapjen e faqes në internet, rritjen e shikueshmërisë, rritjen e numrit të lexuesve dhe përdoruesve të saj.
 - ATSH, të intensifikojë marrëdhëniet me institucionet vendase dhe partnerët e huaj për përthithjen e projekteve me qëllim modernizimin e saj, të përdori të gjitha format e marketingut për rritjen e shitjeve të produkteve dhe të shërbimeve të saj për rritjen e të ardhurave, si dhe të përcaktojë kush ka detyrimin ligjor të ndjekjes dhe zbatimit të kontratave apo marrëveshjeve me partnerët e huaj.

8. Trajtimi i mbetjeve urbane në Bashkinë Fier

Mungesa e politikave të duhura të mbetjeve, në lidhje me parandalimin e tyre, grumbullimin, trajtimin dhe depozitimin, si dhe mungesa e një shërbimi të përshtatshëm ka bërë që në zona të ndryshme të qytetit të Fierit, sidomos në brigjet e lumenjve, të gjenden përgje mbeturinash të tipeve nga më të ndryshmet, duke i kthyer këto zona në të ashtuquajtura vend-depozitime të jashtëligjshme mbetjesh dhe ç'është më e keqja në zona të ndotura

Zhvillimi i vrullshëm dhe rritja e konsumit kanë çuar në krijimin e një sasive të madhe mbetjesh të depozituara. Rreth 80% e të gjitha mbetjeve vijnë si rrjedhojë e veprimtarive bujqësore, industriale dhe të bizneseve, një pjesë e madhe e të cilave janë të ripërdorshme (plastikë, metal, letër, qelq, materiale të bio-degradueshme, materiale organike). Rreth 20% e sasisë së mbetjeve të krijuara vijnë nga mbetjet shtëpiake, një pjesë e madhe e të cilave janë të ripërdorshme.

Fusha e depozitimit të mbetjeve në këtë qytet është e pa rrethuar edhe pse shumë pranë saj ndodhen shtëpi banimi të qytetarëve. Kjo mënyrë e administrimit të mbetjeve shkakton një ndotje shumë të lartë të mjedisit. Mbetjet e hedhura në fushë çlirojnë e përhapin në ajrin përreth gazra toksikë që përbëjnë problem tejet serioz për shëndetin e qytetarëve.

Ndërmarrja e Pastrimit nuk disponon dokumentacion apo standarde, ku të mbështetet për kryerjen e punës, sidomos për sa i përket sigurimit dhe transportit të mbetjeve. Vend-depozitimi i mbetjeve nuk ka kushtet më minimale për depozitimin e mbetjeve të rrezikshme si kimikate, mbetjeve spitalore, të cilat hidhen së bashku me mbetjet e tjera urbane, pa asnjë lloj trajtimi të veçantë. Në këtë vend-depozitim nuk ka peshore që të kryejë matjen e sasisë së mbetjeve të gjeneruara nga sektorë të ndryshëm të depozituara në fushë. Pranë vend-depozitimit janë ndërtuar disa banesa që mund të jenë formale, ndërkohë që shumica e tyre ekzistojnë para se kjo

vend hedhje të caktuara si pikë depozitimi për qytetin. Pranë vend-depozitimit kalon lumi i Gjanicës, ujërat e të cilin ndoten nga mbetjet urbane dhe derdhen në det, duke shkaktuar dëmtime të pariparueshme për zonën përreth.

Bashkia Fier, në kuadër të Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve të Ngurta, ka zgjedhur të zbatojë si opsionin më të mundshëm, “Sistemin me tre Kosha”. Në plan janë paraqitur dy opsione (skenarë) afatmesëm që do të zhvillohen më tej në një perspektivë afatgjatë. Bashkia Fier, mbështetur dhe në bazë të projektit holandez, duhej të kujdesej për ndarjen e mëtejshme, të mbetjeve para se të depozitoheshin në fushën e mbetjeve për të krijuar lëndë të parë për kompanitë e riciklimit dhe mjete financiare për vete.

Mungesa e informimit të publikut në lidhje me problemet e menaxhimit të mbetjeve sipas hierarkisë ka sjellë pamjaftueshmëri të njohurive në lidhje me pyetjet *ku, kur, pse* dhe *sa* mbetje prodhon komuniteti në shtëpi, biznese apo ambiente të tjera, dhe cilat janë mënyrat e mbledhjes për të lehtësuar riciklimin e mbetjeve në tërësi.

Bashkia Fier në vitin 2010 ka hartuar Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane bashkiake të qytetit të Fierit, në bashkëpunim me CO-Plan (Instituti për Zhvillimin e Habitatit). Në këtë plan ndër të tjera janë përcaktuar dhe objektivat strategjike për t’u realizuar në fushën e riciklimit të mbetjeve, drejtoritë përgjegjëse në bashki për realizimin e tyre bashkë me partnerët e tjerë si dhe afatet kohore. Objektivat e përcaktuar janë zërtëruar më tej në veprime të detajuara që janë të nevojshme për t’u ndërmarrë, por bashkia nuk ka ndërmarrë hapa të mëtejshëm për plotësimin e tyre. Në fazat e mëvonshme të këtij projekti pilot është vënë re se:

- kjo metodë realisht nuk ka funksionuar gjë që ka ardhur si rezultat i përzierjes së mbetjeve në sistemin e kazanëve me 3 ndarje.
- procesi i riciklimit aktualisht zhvillohet në qendrën e riciklimit, në territorin e vend-depozitimit të mbetjeve urbane të Bashkisë Fier, por nuk u konstatua efikasiteti i saj.
- domosdoshmëria e dhënies së informacionit për përfitimet mjedisore të riciklimit, mënyrat e grumbullimit të mbetjeve është një nga mënyrat për të rritur pjesëmarrjen e komunitetit në kontributin e procesit të riciklimit.
- përveç mungesës së informacionit dhe të një tradite, mungesa e konteinerëve të ndarë dhe të përcaktuar sipas natyrës së mbetjeve kanë ndikuar dhe ndikojnë, duke bërë pothuajse të parralizueshëm zhvillimin e procesit të riciklimit.

Vetë dampa ose fusha e mbetjeve nuk ka studim teknik e inxhinierik për sheshin e vend-hedhjes së mbetjeve urbane. Dampa ose fusha e mbetjeve nuk ka studim gjeomjedisor për sheshin e vend-hedhjes së mbetjeve urbane dhe as Raport të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis - VNM.

Programet e hartuara dhe të realizuara nga Bashkia Fier për edukimin publik mbi mbetjet urbane kanë qenë sporadike. Programet për edukimin publik në këtë drejtim në pjesën më të madhe të rasteve kanë pasur një tematikë më të gjerë mjedisore dhe nuk janë përqendruar vetëm në tematikën e nxehtë të menaxhimit të mbetjeve urbane në qytetin e Fierit.

Tregjet për materialet e rikuperueshme janë të rëndësishëm në kalimin nga një sistem linear për heqjen e mbetjeve në një sistem për rikuperimin e vlerës.

Bashkia Fier është akoma në hapat e parë dhe ka bërë shumë pak për përmirësimin e situatës në lidhje me menaxhimin e mbetjeve. Bashkia Fier aktualisht po zbaton Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve, ku si objekt tjetër është shtrirja e shërbimit cilësor dhe në zonat periferike të qytetit.

Ajo nuk ka arritur të përzgjedhë metodën më të përshtatshme për menaxhimin e mbetjeve urbane. Projektet e Bashkisë Fier në lidhje me menaxhimin e mbeturinave, për të ardhmen janë tërësisht të lidhura me vënien në zbatim Planit Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve.

Referuar prodhimit aktual të mbetjeve në nivel lokal, jetëgjatësia e përdorimit të këtij vend-depozitimi të rehabilituar do të shkonte jo më shumë se 2-3 vjet. Ky studim nuk është vënë në jetë nga Bashkia Fier, si rezultat i mungesës së fondeve të nevojshme për realizimin e tij.

Duke marrë në konsideratë trojet në dispozicion në Rajonin e Fierit, çmimin e tokës dhe distancat nga akset e rrugëve, ndërtimi i një landfill-i rajonal në bashkëpunim me njësitë lokale kryesore si Vlora, Lushnja, Berati dhe qytete të tjerë më të vegjël, si dhe me Komunat përreth mund të jetë një zgjidhje ekonomike. Politika kombëtare vazhdon të shikojë si mënyrën më të përshtatshme ndërtimin e një landfill-i rajonal për të menaxhuar në mënyrë të integruar mbetjet urbane edhe për vitet në vazhdim.

Kosto kapitale dhe kosto e përdorimit të landfille-ve lidhet direkt me numrin e popullsisë për të cilën planifikohet dhe sasinë e mbetjeve të prodhuara. Kosto e përpunimit të mbetjeve është afërsisht dy herë më e ulët për një landfill që i shërben një popullsie prej rreth 250.000 banorësh që mendohet të ketë rajoni se ajo e një landfill-i të planifikuar për 90.000 banorë që parashikohet të ketë qyteti i Fierit për vitet 2015-2016.

Si rezultat, landfill-i lokal është një alternativë e përjashtuar, për shkak të kostove të larta dhe zgjidhja do jetë një landfill rajonal. Gjithashtu, përdorimi i mjeteve të transportit në landfill duhet të marrë në konsideratë ekonominë e shkallës, pasi përdorimi i tyre për një sasi të ulët mbetjesh do të rezultonte me rritje të kostos kapitale të këtyre mjeteve dhe të shpenzimeve operative të përpunimit të mbetjeve. Deri në vitin 2015 është parashikuar të arrihet në nivelin e riciklimit të 15% të mbetjeve totale të gjeneruara nga sektorë të ndryshëm.

Me ndarjen në burim të mbetjeve në tre konteinerë duhet të rritet sasia e mbetjeve të ricikluara.

Përsa i përket bashkëpunimit të Bashkisë Fier me Ministrinë e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe Agjencinë Rajonale të Mjedisit në drejtim të menaxhimit të mbetjeve urbane sipas udhëzimeve të SKM-së mund të thuhet se gjatë përgatitjes së PLMMU, specialistët e Bashkisë Fier janë konsultuar me ekspertë të ministrisë e ARM-së, duke patur si orientim kryesor pikërisht këtë strategji.

Duhet theksuar se Bashkia Fier ka mbetur në hapat e para të realizimit të masave të përcaktuara nga Strategjia Kombëtare e Mbetjeve, në fazën e përcaktimit të objektivave afatgjata e afatmesme si dhe në përcaktimin e detyrave për drejtoritë përkatëse në Bashkinë Fier. Pas kësaj faze nuk vërehet asnjë përparim i mëtijshëm në drejtim të realizimit të detyrave të përcaktuara nga SKM-ja.

Një konkluzion i tillë është arritur duke marrë parasysh faktin se puna e kryer për hartimin e PLMMB ka rezultuar deri tani, jo efektive, pasi nuk është arritur as miratimi i këtij plani nga Këshilli Bashkiak i Fierit, në mënyrë që më pas të fillonte puna për zbatimin e tij.

Për sa më lart KLSH ka rekomanduar:

- Bashkia Fier në shërbim të qytetarëve e mbrojtjes së mjedisit të zbatojë strategjitë afatmesme e afatgjata për parandalimin e ndotjes dhe të marrë masa të forta për të nxitur zgjedhjen e opsionit më të mirë për minimizimin e mbetjeve, depozitimin, rikuperimin, riciklimin e kompostimin, si dhe ripërdorimin e reduktimin e mbetjeve.
- Ndërmarrja e pastrimit Fier, bazuar në standardet e BE-së, të përcaktojë, rregullore, udhëzime, kritere, standarde, manuale dhe dokumente e formularë standardë që duhen në të gjitha fazat e menaxhimit teknik dhe trajtimit mjedisor të mbetjeve urbane nga grumbullimi deri tek depozitimi i tyre.
- Bashkia Fier, në bashkëpunim me Ministrinë e Mjedisit Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, të marrë hapat e duhur ligjorë për mbylljen e fushës së depozitimit të mbetjeve urbane të qytetit Fier dhe ndërtimin e një landfill-i të ri rajonal për depozitimin përfundimtar të mbetjeve urbane.
- Bashkia Fier në bashkëpunim me Ministrinë e Shëndetësisë, Spitalin Rajonal të Fierit dhe struktura të tjera t'i japë zgjidhje të menjëhershme mënyrës së depozitimit, grumbullimit, transportimit dhe trajtimit të mbetjeve spitalore me ndikim shumë negativ në mjedis dhe shëndetin human.
- Bashkia duhet të nxisë realizimin e modelit të ndarjes në burim të mbetjeve urbane sipas një kompozimi "praktik" të koshit të riciklimit dhe në përputhje me strategjinë e MMPAU-së, në mbetje:

- të riciklueshme (të thata);
- organike/të ndryshme (të njoma);
- të rrezikshme.
- Të miratohet në Këshillin Bashkiak të Qytetit të Fierit Plani Lokal i Menaxhimit të Mbetjeve Urbane i hartuar në vitin 2010 në bashkëpunim me CO-Plan dhe të fillojë zbatimin e tij.
- Bashkia Fier duhet të vendosë, cilët materiale duhet të riciklohen, cilët materiale do të grumbullohen dhe në çfarë volumi, në mënyrë që të fillojë planifikimin e programit të riciklimit i bazuar në legjislacionin specifik të vendit, duke siguruar një mundësi bashkëpunimi midis publikut dhe sektorëve privatë.
- Bashkia Fier të ndërmarrë hapat e duhur ligjorë që Ndërmarrja e Pastrimit Fier dhe kompania e kontraktuar nga Bashkia Fier për riciklimin e mbetjeve urbane, të pajisen me leje mjedisore për ushtrimin e aktivitetit të tyre.
- Bashkia Fier në bashkëpunim me donatorët të hartojë programe efektive për edukimin e publikut (komuniteti, shkollat) në drejtim të çështjeve që kanë të bëjnë me menaxhimin e mbetjeve dhe riciklimin e tyre, duke siguruar bashkëpunimin me qytetarët dhe sektorin privat, bazuar në legjislacionin specifik të vendit.
- Bashkia Fier të hartojë program të veçantë për të arritur progresin e nevojshëm në procesin e ndarjes së e mbetjeve shtëpiake në kazanë të ndryshëm, me qëllim riciklimin e tyre, në drejtim të:
 - informimit dhe ndërgjegjësimin e komunitetit në nivel lokal,
 - stimulimit promovimit dhe mbështetjes së publikut.
- Bashkia Fier të monitorojë performancën për çdo komponent të veçantë të menaxhimit të mbetjeve urbane më qëllim që ai të jetë sa më eficient dhe efikas për të ardhmen.
- Bashkia Fier në bashkëpunim me Ndërmarrjen e Pastrimit të Qytetit të Fierit, të:
 - llogarisë saktë koston e plotë të menaxhimit të mbetjeve urbane,
 - përcaktojë tarifën e diferencuar për çdo kategori që përfiton në bazë të koston,
 - mundësojë rritjen e nivelit të arkëtimit të tarifave të pastrimit,
 - kryejë rakordime për përcaktimin e saktë të numrit të bizneseve dhe numrit të familjeve të cilët paguajnë tarifën së pastrimit,
 - të mundësojë rritjen e investimeve në fushën e menaxhimit të mbetjeve urbane.
- Bashkia Fier të marrë parasysh hartimin e Rregullores së Menaxhimit të Mbetjeve Urbane duke u mbështetur në Strategjinë Kombëtare të Mbetjeve si dhe në Planin Lokal të Menaxhimit të Mbetjeve Urbane.

9. Kontratat e shërbimit të dializës në QSUT dhe ish-Spitalin Ushtarak

Ministri i Mbrojtjes, me urdhërin nr. 171, datë 05.02.2010, ka urdhëruar Repartin Ushtarak 4666, me fondet buxhetore të miratuara për vitin 2010, të përballojë shpenzimet për shërbimin e dializës për ushtarakët aktivë të FA, si edhe ka urdhëruar Spitalin Ushtarak Qendror Universitar (SUQU) të veprojë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore fuqi për prokurimin e shërbimit të dializës.

Tenderi është zhvilluar në datën 09.04.2010, me procedurë me “negocim pa shpallje të kontratës” me fond limit 94.507.560 lekë pa TVSH. Në tender është ftuar të marrë pjesë vetëm operatori ekonomik "UNIVERS-ALB". Ky operator ka dalë fitues dhe në datën 15.04.2010 është lidhur kontrata e zbatimit ndërmjet SUQU dhe këtij operatori ekonomik.

Përdorimin e kësaj procedure Autoriteti Kontraktor e ka mbështetur në piken 2, gërma “b”, të nenit 33, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” e cila përcakton se: “Procedura me negocim, pa botim paraprak të njoftimit të kontratës, mund të përdoret kur, për arsye që lidhen me të drejtën ekskluzive ose të drejtën e autorit, kontrata nuk mund të ekzekutohet përveçse me një operator të vetëm ekonomik”. Kushti plotësohet vetëm në rastet e artikulave për të cilët nuk ka konkurrencë në treg dhe kur një gjë e tillë vërtetohet nga autoriteti përkatës, që mbikëqyr konkurrencën në treg”. Përderisa nuk ka fakte të shkruara që ta

përkufizojnë këtë operator si të vetmin në treg, nuk mund të thuhet që ky është operatori i vetëm që ofron këtë shërbim, duke e konsideruar qëndrimin e SUQU si të paracaktuar. Spitali minimalisht duhet t'i ishte drejtuar Autoritetit të Konkurrencës për të konfirmuar këtë fakt.

Për këtë procedurë të drejtpërdrejtë, Autoriteti Kontraktor i ka kërkuar operatorit ekonomik në kërkesat e veçanta dhe paraqitjen e licencave përkatëse lidhur me shërbimin objekt i kontratës, të lëshuara nga Ministria e Shëndetësisë. Mirëpo, licencat profesionale nuk janë dokumente që provojnë se operatori ekonomik ka të drejtë ekskluzive për shërbimin e hemodializës në tregun shqiptar, në përputhje me nenin 9, të Ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", i cili përcakton se: "ky ligj nuk zbatohet për kontratat e shërbimit publik, të lidhura nga një autoritet kontraktor me një tjetër kontraktor ose bashkim autoritetesh kontraktore, bazuar në një të drejtë ekskluzive, që ata gëzojnë sipas legjislacionit në fuqi".

Pra, e drejta ekskluzive duhet te jepet sipas legjislacionit në fuqi kur një gjë e tillë vërtetohet nga autoriteti përkatës, i cili mbikëqyr konkurrencën në treg. Për pasojë përdorimi i kësaj procedure prokurimi vjen në kundërshtim me Ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", me VKM nr.1, datë 10.01.2006 "Për rregullat e Prokurimit Publik" dhe me ligjin nr. 9121, datë 28.07.2003 "Për Mbrojtjen e Konkurrencës", i ndryshuar.

Kjo shkelje ka sjellë formalizëm në zbatimin e kësaj procedure prokurimi, shmangien e konkurrencës, përqendrim të kufizuar të këtij tregu vetëm në një operator ekonomik, abuzim me pozitën dominuese në treg, e shoqëruar kjo me efektivitet të munguar në përdorimin e fondeve buxhetore. Po kështu ka sjellë efekte negative ekonomike me rritje të ndjeshme të kostove buxhetore të këtij shërbimi, të cilat kanë dalë në dukje dhe janë reflektuar gjatë zbatimit të kontratës së shërbimit.

Nga SUQU, në datën 15.04.2010 është lidhur kontrata e zbatimit me nr. 146, me operatorin fitues "UNIVERS-ALB. Kontrata ka për objekt dhënie e shërbimit të dializës për 60 pacientë, për 14 seanca secili në muaj, me vlerë të një seance 12.501 lekë dhe në total 94.507.560 lekë, pa TVSH. Kontrata do të shtrihej me afat kohor 60 muaj.

Kjo kontratë, në zbatim të nenit 3, është rinovuar dy herë, duke i shtrirë afatin e zbatimit deri në fund të vitit 2012 (madje është rinovuar edhe për vitin 2013). Burimi i financimit në të gjitha rastet ka qenë buxheti i shtetit, nëpërmjet Ministrisë së Mbrojtjes dhe institucioneve vartëse të saj. Në total për të gjithë periudhën e zbatimit, Spitalit Amerikan i janë paguar për shërbimin e kryer 397.981.836 lekë.

Nga auditimi mbi zbatimin e kontratës u konstatua:

a) Në paragrafin e 4 të nenit 2 dhe në paragrafin e 2 të nenit 3 të kësaj kontrate përcaktohet se, "rinovimi i kontratës do të bëhet çdo fillim viti, në rast se akordohet fond nga buxheti i shtetit". Në zbatim të kësaj pike Drejtori i SUQU, në datën 08.01.2011 rinovon kontratën për vitin 2011, me afat deri në datë 31.12.2012 dhe në datën 04.01.2012 rinovon kontratën për vitin 2012 me afat deri në 31.12.2012. Por u konstatua se, në buxhetin e SUQU dhe të Ministrisë së Mbrojtjes nuk janë planifikuar fonde si për vitin 2011, ashtuedhe për vitin 2012 me destinacion mbulimin e këtij shërbimi. Për pasojë në zbatim të kësaj pike të kontratës, Drejtori i Spitalit duhej të njoftonte kontraktuesin për ndërprerjen e kontratës, për të mos krijuar detyrime financiare dhe mos vënien në vështirësi buxhetin e shtetit për pagimin e tyre. Gjithashtu, duke parë sasinë e madhe të fondeve që konsumon ky shërbim për shkak të ofrimit nga të tretë, duhej të ndërhynte dhe të insistonte pranë Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Shëndetësisë, Ministrisë së Financave, madje dhe në Këshillin e Ministrave për planifikimin e fondeve dhe marrjen e masave për kryerjen e këtij shërbimi nga vetë SUQU.

b) Në paragrafin 3 të nenit 3 të kontratës përcaktohet se, "kjo kontratë ndërpritet në rast të implementimit të shërbimit të hemodializës në SUQU."

Vlera limit e kontratës ka dalë nga studimi i tregut i përgatitur nga QSUT. Dhe SUQU është bazuar në këtë studim, si në koston e shërbimit, në termat e referencave dhe në specifikimet teknike dhe në mbështetje të tyre ka përgatitur dokumentet e tenderit dhe vlerën e kontratës që

do të prokurohej. Sipas këtij studimi të QSUT, për ndërtimin e një qendre të mirëfilltë hemodialize për trajtimin e 85-100 pacientëve, është llogaritur një kosto fillestare e përafërt rreth 810.000 euro, në të cilën janë përfshirë punimet për rikonstrukcionin e ndërtesës prej 300 m², aparatura dhe pajisje.

Nëse drejtoria SUQU do të gjykonte bazuar në shumatat që ky shërbim po harxhonte nga fondet publike (afërsisht 600.000 euro në vit) në zbatim të këtij neni të kontratës, paralel me zbatimin e saj, gjatë vitit 2010 duhej të gjente ambientet në ndërtesat e spitalit dhe të kërkonte pranë Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe KM që të planifikoheshin fonde buxhetore për të bërë të mundur fillimin e këtij investimi, dhe jo të mjaftohej vetëm me kërkesa buxhetore drejtuar këtyre institucioneve për të shlyer detyrimet ndaj subjektit privat, që janë krijuar nga detyrimet e kontratës. (Në këtë rast vlen të theksojmë se, Spitali Amerikan ushtron veprimtarinë në ambientet e marra me qira apo me koncesion nga vetë SUQU).

Mirëpo ka ndodhur e kundërta, pikërisht, për të motivuar zgjatjen e afatit të kontratës, gjatë vitit 2010, është ngritur grup pune tjetër për argumentimin e kostos së ndërtimit të një qendre hemodialize. Analiza e kostos së ndërtimit, vënies në funksionim të qendrës, si dhe kostot e realizimit të shërbimit (output-i), nxjerrë nga ky grup pune, është mbështetur në studimin e sipërcituar të bërë nga QSUT, por vërehet që çmimet për njësi të këtyre zërave janë dy herë më të larta se çmimet e përcaktuara në studimin e QSUT, pa ndonjë shpjegim të qenësishëm të këtij dyfishimi. Pavarësisht se studimi i referohet një qendre që do t'i shërbente 60 pacientëve (nga 80-100 që ishte studimi referues i QSUT), kosto për qendrën arrin vlerën 1.614.800 euro (kundrejt 810.000 euro të studimit të QSUT). Dhe në përfundim të studimit të SUQU, grupi i punës ka dalë me këtë konkluzion: “Nisur nga kosto e lartë e ndërtimit të një qendre dialize, mendojmë se vazhdimi i shërbimit të dializës realizuar nga Spitali Amerikan do të ruajë cilësinë e shërbimit, si dhe do të zgjidhë përfundimisht nevojat e pacientëve tanë për këtë shërbim”.

Mbi këtë përfundim Drejtoria e QUSU ka motivuar kryerjen e këtij shërbimi në Spitalin Amerikan dhe ka rinovuar kontratën me nr. 146, datë 15.04.2010 deri në fund të vitit 2012 e në vazhdim.

Por, nga auditimi në lidhje me analizën e ngritjes së qendrës së dializës dhe koston për vënien në funksionim të saj, del se vlera e realizimit të projektit të shërbimit të dializës e përcaktuar në studimin e SUQU prej 1.614.800 euro është dy herë më e madhe se vlera e përcaktuar në studimin e bërë nga QSUT, e cila është 810.000 euro. Po kështu, duke marrë në konsideratë subjektet private punojnë me marzh fitimi, atëherë nëse ky shërbim do të kryhej nga vetë spitali kjo do të ishte një kosto e kursyer. Me një llogaritje të shpejtë, për një vit mesatarisht 11,6 milionë lekë ose rreth 83.000 euro do të kurseheshin vetëm për shkak të ofrimit me kosto të shërbimit dhe për të gjithë periudhën e zbatimit të kontratës Prill 2010- Dhjetor 2012 rreth 35 milionë lekë ose 250.000 euro do të ishte kursimi total. Ky (kursimi) duhet të ishte shtuar si kosto oportune në alternativën nëse shërbimi i dializës do të kryhej nga vetë SUQU, duke ulur vlerën e realizimit të projektit të shërbimit.

c) Në pikën 5/3 të nenit 5 të kontratës përcaktohet se; “dhënësi, brenda vlerës së përcaktuar në kontratë, merr përsipër hapjen e fistulave, vendosjen e kateterave, ekzaminimet laboratorike të nevojshme për pacientin, si dhe ushqimin e pacientit.

Në koston e shërbimit të një seance dialize, në çmimin 90 euro ose 12.501 lekë, pa TVSH, janë përfshirë edhe çmimi i hotelerisë dhe i ushqimit të pacientëve. Pra, në vlerën e kontratës është përfshirë edhe kosto e hotelerisë dhe e ushqimit. Por gjatë zbatimit të kontratës të gjithë pacientët e trajtuar me dializë nuk janë trajtuar me ushqim dhe fjetje. Por, çmimi që ze ushqimi dhe fjetja në koston për njësi të një seance dialize është e pamundur të llogaritet, pasi siç u tha më lart, nuk kemi vlerësime të zërave të kostos. Megjithatë, duke qëndruar në këtë analizë, kemi rezerva edhe në vlerat e trajtimit me ushqim dhe hoteleri të pacientëve, të cilat ndikojnë jo pak në uljen e vlerës së projektit të ngritjes së qendrës së dializës.

Si përfundim dalim konkluzionin:

Edhe pse Spitali Ushtarak Qendror Universitar i ka pasur dhe i ka te gjitha mundësitë financiare dhe infrastrukturore për ngritjen e një qendre për trajtimin e hemodializës, ka neglizhuar ngritjen e saj, me arsyen e mospërballimit të kostos nga buxheti i shtetit, duke vlerësuar gabim vlerën e këtij projekti dhe koston për njësi të shërbimit, me qëllimin e vetëm dhënien dhe vazhdimin e kryerjes së këtij shërbimi nga një operator ekonomik privat.

- Për sa më lart KLSH ka rekomanduar:

- Rinovimi i kontratës me shoqërinë private "UNIVERS-ALB", "Për dhënien e shërbimit të dializës për 60 pacientë", të realizohet vetëm kur studimi ekonomik për koston e shërbimit të konfirmojë këtë praktikë si më eficientja dhe me efektivitet në përdorimin e fondeve publike. Një rinovim i pastudiuar pas këtij raporti do të ndikonte negativisht në performancën e përdorimit të fondeve nga ky institucion.

- Sa më shpejt të mundësohet ngritja e një grupi pune të përbashkët, me specialistë të fushës së dializës nga SUQU, QSUT dhe Ministria e Shëndetësisë, si dhe ekspertë të jashtëm të fushës ekonomike, që të analizojnë gjendjen dhe numrin e pacienteve që duhet të trajtohen me dializë, trendin e kërkesave për një periudhë të afërt dhe në funksion të kërkesës të përcaktojnë koston e saktë të këtij shërbimi

- Të bashkëpunohet me Ministrinë e Shëndetësisë, me Qendrën Spitalore Universitare "Nënë Tereza", Tiranë, dhe t'i kërkohe Këshillit të Ministrave, që, në funksion të një projekti të vlerësuar drejt dhe me profesionalizëm, të japë mbështetjen e nevojshme financiare për të mundësuar krijimin e infrastrukturës së duhur për implementimin e shërbimit të hemodializës në ambientet e SUQU dhe nga vetë personeli mjekësor i SUQUT, si një mënyrë që do të rrisë ekonomikitetin dhe efektivitetin e përdorimit të fondeve për sigurimin e një shërbimi të tillë.

LISTA E SUBJEKTEVE TË AUDITUAR PËR ZBATIMIN E BUXHETIT TË VITIT 2012

1. Administrata e Presidencës.
2. Administrata e Kuvendit
3. Aparati i Këshillit të Ministrave.
4. Ministria e Financave
5. Ministria e Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjetikës
6. Ministria e Brendshme
7. Ministria e Mbrojtjes
8. Ministria e Punëve Publike dhe Transportit
9. Ministria e Arsimit dhe Shkencës
10. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.
11. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
12. Ministria e Shëndetësisë
13. Ministria e Punëve të Jashtme
14. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Konsumatorit
15. Ministria e Integritit
16. Banka e Shqipërisë
17. Gjykata e Lartë
18. Prokuroria e Përgjithshme
19. Avokati i Popullit
20. Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive
21. Akademia e Shkencave
22. Instituti i Sigurimeve Shoqërore
23. Instituti i Sigurimit të Kujdesit Shëndetësor
24. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit.
25. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve
26. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave
27. Drejtoria e Hetimit Doganor në DPD
28. Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve
29. Agjencia e Prokurimit Publik
30. Instituti Statistikave
31. Autoriteti Rrugor Shqiptar
32. Drejtoria e Përgjithshme e Inspektoratit Shtetëror dhe Shërbimeve Shoqërore
33. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit Social Shtetëror.
34. Agjencia e Kërkimit, Teknologjisë dhe Inovacionit
35. QSU “Nënë Tereza” Tiranë
36. Universiteti “Eqrem Çabej” Gjirokaster
37. Qendra Kombëtare e Kinematografisë
38. Avokati i Prokurimeve
39. Drejtoria e Shërbimeve Qeveritare
40. Drejtoria Arsimore Rajonale Shkodër
41. Universiteti i Tiranës.
42. Njësia e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit
43. Dega e Doganës Berat
44. Dega e Doganës Elbasan
45. Dega e Doganës Kakavijë
46. Dega e Doganës Lezhë

47. Dega e Doganës Morinë
48. Dega e Doganës Tre-Urat Përmet
49. Projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Milot-Rrëshen”
50. Projekti “Ndërtimi i terminalit të Portit të Durrësit”
51. Projekti “Përmirësimi i rrugëve dytësore dhe lokale”
52. Projekti “Rehabilitimi i spitalit të Shkodrës, faza III”
53. Projekti “Ndërtimi i segmentit rrugor Kalimash-Rexhepaj”
54. Projekti "Rehabilitimi i hidrocentraleve Bistrica 1 dhe 2"
55. Projekti "Zhvillimi i sektorit privat"
56. Projekti “ Ndërtimi i By- pass Durrës dhe nyja e Vorës”
57. Projekti “ Programi rural, furnizimi me ujë”
58. Prefektura Berat
59. Prefektura Korçë
60. Prefektura Tiranë
61. Këshilli i Qarkut Gjirokastrë
62. Këshilli i Qarkut Berat
63. Këshilli i Qarkut Kukës
64. Bashkia Durrës
65. Bashkia Fier
66. Bashkia Tiranë
67. Bashkia Fushë Arrëz
68. Bashkia Fushë Krujë
69. Bashkia Kelcyrë
70. Bashkia Belsh
71. Bashkia Bilisht
72. Bashkia Bulqizë
73. Bashkia Çorovodë
74. Bashkia Divjakë
75. Bashkia Kavajë
76. Bashkia Konispol
77. Bashkia Krumë
78. Bashkia Koplík
79. Bashkia Kuçovë
80. Bashkia Leskovik
81. Bashkia Libohovë
82. Bashkia Manëz
83. Bashkia Roskovec
84. Bashkia Sukth
85. Bashkia Vau Dejës
86. Bashkia Ballsh
87. Bashkia Patos
88. Bashkia Gjirokastrë
89. Bashkia Lezhë
90. Komuna Qendër Bilisht
91. Komuna Gjinar, Elbasan
92. Komuna Bucimas, Pogradec
93. Komuna Kolsh, Kukës
94. Komuna Libofsh Fier
95. Komuna Zharrëz Fier
96. Komuna Dishnicë, Përmet

97. Komuna Karbunarë, Lushnjë
98. Komuna Levan, Fier
99. Komuna Qendër, Vlorë
100. Komuna Xarrë, Sarandë
101. Komuna Lukovë, Sarandë
102. Komuna Ishëm, Durrës.
103. Drejtoria e Përgjithshme e Punëtorëve nr. 1, Bashkia Tiranë
104. Drejtoria e Punëtorëve nr. 2, Bashkia Tiranë
105. Drejtoria e Punëtorëve nr. 3, Bashkia Tiranë
106. Sh.a Porti Detar, Vlorë
107. Operatori i Sistemit të Transmetimit, Tiranë
108. Autoriteti Aviacionit Civil, Tiranë
109. Porti Detar Shëngjin, Lezhë
110. Agjencia Nacionale e Trafikut Ajror, Tiranë
111. Drejtoria e Shërbimit të Trupit Diplomatik, Tiranë
112. Qendra e Trajtimit të Studentëve sh.a, Shkodër
113. Qendra Trajtimit të Studentëve nr.2, Tiranë
114. Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Durrës
115. Albpetrol sh .a, Fier
116. Ujësjetllës Kanalizime sh.a, Fier
117. Posta Shqiptare sh.a, Tiranë
118. Enti Kombëtar i Banesave, Tiranë

ANEKSI NR 2.

TË DHËNA PËRMBLEDHËSE PËR SHKELJET ME PASOJË DËM EKONOMIK NË TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET EBUXHETIT TË SHTETIT DHE DETYRIMET DEBITORE DERI ME 31.12.201

në milionë/lekë

I. Vlera e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në të ardhurat e buxhetit:		133,3
1.	Në sistemin e tatimeve dhe doganave, shkelje të legjislacionit	30,7
2.	Nga mosarkëtimi i të ardhurave nga dhënia me qira e pronës	5,6
3.	Në pushtetin vendor	97,0
II. Vlera e shkeljeve me pasojë dëm ekonomik në shpenzimet:		414,3
1.	Në shpenzimet e personelit	13,8
2.	Në shpenzimet operative	9,1
3.	Në zbatimin e procedurave të prokurimit;	191,0
4.	Në projektet me financim të huaj	103,3
5.	Në pushtetin vendor	97,1
GJITHSEJ (I+II):		547,6

III. VLERA E KONSTATIMEVE NË SHOQËRITË ANONIME ME PASOJË DËM EKONOMIK GJATË VITIT 2012

në milionë/lekë

1.	Albpetrol sh.a. Fier mosarkëtim të ardhurash si pasojë e mosbatimit të detyrimeve kontraktore,	2 199
2.	Albpetrol sh.a. Fier në fushën e pagave dhe shërblimeve	447.3
3.	Në shtate shoqëri anonime në fushën e shpenzimeve	76.8
4.	Vlera e demit ekonomik shkaktuar buxhetit te shtetit nga nga mos arkëtimi i garancisë së ofertës së paraqitur nga shoqëria “Vetro Energy PTE Ltd” per privatizimin e shoqërisë “Albpetrol”sha, Patos”.	11,900
5.	TOTALI	14,623.1

GJITHSEJ IV (I+II+III) =15,170.7 milionë lekë

IV. TË DHËNA PËRMBLEDHËSE MBI DETYRIMET DEBITORE DERI MË DATËN 31.12.2012

në milionë/lekë

1.	Vlera e detyrimeve debitore në sektorin e tatimeve (DPT)	69,936
2.	Vlera e borxhit doganor në sektorin e doganave (DPD)	4,086
3.	Vlera e detyrimeve të prapambetura të kontributeve të padorezuar në ISSH	8,542
GJITHSEJ:		82,564

GJITHSEJ III+IV =97,734.7 milionë lekë

ANEKSI NR 3.

FJALORI I SHKURTIMEVE

AB	Auditi i B rendshëm
ALUIZNI	Agjencia e L egalizimit, U rbanizimit dhe I ntegritit të Z onave/ N dërtimeve Informale
AP	Auditimi i P erformancës
APP	Agjencia e P rokurimit P ublik
AKTI	Agjencia e K ërkimit, T eknologjisë dhe I novacionit
BSH	B anka e S hqipërisë
BB	B anka B otërore
BE	B ashkimi E uropian
BEI	B anka E vropiane e I vestimeve
BERZH	B anka E vropiane për R indërtim e Z hvillim
BKT	B anka K ombëtare T regëtare
DAP	Departamenti A ministratës P ublike
DAR	Drejtoria A rsimore R ajonale
DIAS	Drejtoria e I nformacionit dhe A nalizës S tatistikore
DIFP	Drejtoria e I nspektimit F inanciar P ublik
DPTH	Drejtoria e P ërgjithshme e T hesarit
DPB	Drejtoria e P ërgjithshme e B urgjeve
DPB	Drejtoria e P ërgjithshme e B uxhetit
DPD	Drejtoria e P ërgjithshme e D oganave
DPAB	Drejtoria e P ërgjithshme e A uditimit të B rendshëm
DPPSH	Drejtoria e P ërgjithshme e P olicisë së S htetit
DPT	Drejtoria e P ërgjithshme e T atimeve
DS	Drejtoria S pitalore
DRT	Drejtoria R ajonale T atimore
DRSKSH	Drejtoria R ajonale e K ujdesit S hëndetësor
DRSSH	Drejtoria R ajonale e S igurimeve S hoqërore
DPSHTRR	Drejtoria e P ërgjithshme e S hërbimeve të T ransportit R rugor
DP	Drejtoria e P ërgjithshme
DPUK	Drejtoria e P ërgjithshme e U jësjetës K analizime
DST	Dokumentet S tandarde të T enderit
DSHQ	Drejtoria e S hërbimeve Q everitare
EMP	E kipi i M enaxhimit të P rogramit
GMS	G rupi M enaxhimit S trategjik
IDA	O rganizata N dërkombëtare për Z hvillim
ILKDP	I nspektoriati i L artë i D eklarimit dhe K ontrollit të P asurive
INSTAT	I nstituti i S tatistikës
ITAP	I nstituti i T rajnimit të A ministratës P ublike
ISKSH	I nstituti i S igurimeve të K ujdesit S hëndetësor
ISSH	I nstituti i S igurimeve S hoqërore
INTOSAI	O rganizata N dërkombëtare e I nstitucioneve S upreme të K ontrollit
IT	T eknologjia e I nformacionit
KA	K ëshilli A ministrativ
KBFSP	K ontrolli i B rendshëm F inanciar në S ektorin P ublik
KESH	K orporata E lektroenergjetike S hqiptare
KLSH	K ontrolli i L artë i S htetit
KM	K ëshilli i M inistrave

KMCAP	Komisionet Mjekësorë të Caktimit të Aftësisë për Punë
LPP	Ligji i Prokurimeve Publike
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
MASH	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
MD	Ministria e Drejtësisë
MB	Ministria e Brendshme
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MM	Ministria e Mbrojtjes
MF	Ministria e Financave
MFK	Menaxhimi Financiar i Kontrollit
MBUMK	Ministria e Bujqësisë e Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit
METE	Ministria e Ekonomisë dhe Energjetikës
MPF	Mjekët e Përgjithshëm të Familjes
MPÇSSHB	Ministria e Punëve, Çështjeve Sociale e Shanseve të Barabarta
MPPTT	Ministrisa e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit
MSH	Ministria e Shëndetësisë
MTKRS	Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve
NIPT	Numri i Identifikimit të Personit të Tatueshëm
NJQH	Njesia Qendrore e Harmonizimit
NjQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
NJTPM	Njësia e Tatim Paguesve të Mëdhenj
NJMLF	Njësia e Mbikëqyrjes së Lojrave të Fatit
NJQHAB	Njësia Qendrore e Harmonizimit të Auditimit të Brendshëm,
KBFP	Kontrolli i Brendshëm Financiar Publik
OST	Operatori i Sistemit të Transmetimit
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
PAK	Persona me Aftësi të Kufizuar
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
PIU	Project Implementation Unit (Njësi e Zbatimit të Projektit)
PM	Personelit Mbështetës
QSH	Qendër Shëndetësore
QKR	Qendra Kombëtare e Regjistrimit
QKL	Qendra Kombëtare e Licencimit
QKK	Qendra Kombëtare Kinematografisë
QSU	Qendra Spitalore Universitare
RSH	Republika e Shqipërisë
Sh.a.	Shoqëri anonime
T.v.sh.	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UK	Ujësjellës Kanalizime
SKK	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
SHSSH	Shërbimi Social Shtetërorë
SIGMA	Suport for Improvement in Governance and Management (Mbështetja për Përmirësim në Drejtim dhe Menaxhim)
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
ZAMMT	Zyra e Administrimit, Menaxhimit dhe Mbrojtjes së Tokës
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme
ZRPP	Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme

